
بسم الله الرحمن الرحيم
إنه من سليمان وإنه

Prof.Muhamend Tekij Misbah El JEZDIJ

LEKSIONE NË DOKTRINË ISLAME

1-2-3

Shoqata "FLLADI"

Titulli i librit: **Leksione në doktrinën islame**
Autori: **Prof.Muhamend Tekij Misbah El Jezdi**
E përktheu nga arabishtja: **Pëllumb JAUPI**
Rradhitja kompjuterike: **Pëllumb JAUPI**
E redaktoi: **Jetmir ÇELA**
E korrektoi: **Liseda RAMAJ & Vullnet MERJA**
Përkujdesja kompjuterike: **Fatmir SHUTINA**

PARATHËNIE

"E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: 'Unë, me të vërtetë jam mysliman'."[1]

Studimi i temave doktrinore dhe përballja me dyshimet a dilemat që hidhen mbi to janë nga studimet shkencore më të nderuara, më të vyera dhe më të domosdoshme sepse nën dritën e tyre njeriu plotëson lumturinë e tij në këtë botë dhe në botën e përtejme (në Dynja dhe në Ahiret), por edhe përmirëson moralin dhe sjelljen e tij. Vlera e tij përfitohet nga vlera reale e besimit dhe e doktrinës së vërtetë, pa të cilat nuk mund të ketë vlerë dhe ekzistencë, por edhe vetë jeta do të ishte e pavlerë dhe një mirazh mashtrues si dhe do të ishte e pamundur të gjenim një shpjegim të saktë për origjinën e jetës dhe dukuritë e saj. ***"Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisin bagëtia, do të kenë Zjarrin si vendbanim!"***[2]

A ka më keq se kaq? Në këtë të vërtetë fshihet filozofia e krijimit të njeriut, si dhe sekreti i dërgimit të profetëve dhe zbritjes së librave qiellorë.

Bazat e fesë janë të përftuara (*ixhtihadije*) dhe jo të trashëguara (*taklidije*)

Në këtë rast nuk është e nevojshme që të zgjerohemi shumë dhe të sqarojmë rreth domosdoshmërisë së studimit të çështjeve doktrinore dhe rëndësisë së tyre.

Doktrina islame e cila konsiderohet baza e çështjeve të

1. Sure "Fussilet", ajeti 33.
2. Sure "Muhammed", ajeti 12.

moralit dhe të dispozitave të jurisprudencës (*ahkam fik'hijje*) në kufijtë e doktrinës së detyrueshme për besimin e çdo myslimani duhet që të bazohet në argumentimin e saj mbi bazat e mendjes, logjikës, fakteve dhe argumenteve dhe jo traditës fetare e imitimit (*taklid*).

Çdo person i cili zotëron aftësi mendore dhe mund të bëjë perceptimin dhe dallimin mes gjërave, duhet kërkojë dhe të hetojë në këtë fushë, duhet t'i rrokë bazat e doktrinës me mendjen e tij dhe me të kuptuarit e drejtë. Ashtu siç natyrshmëria (*fitrah*) që ka vendosur Allahu i Madhëruar tek njeriu dhe arsyeja e natyrshme e udhëzojnë njerëzimin për tek këto baza, ashtu edhe çdo njeri posedon fuqinë e përvetësimit të doktrinave bazë të fesë, edhe pse arritja në faza sublime e njohje të lartë kushtëzohen nga kalimi i disa fazave të tjera prej fazave shkencore, praktike dhe mendimore, të cilat nuk i obligohen çdokujt dhe jo çdokush është i aftë që t'i kalojë ato.

Prandaj, Kur'ani i fton njerëzit që të besojnë tek Allahu, tek profetët dhe tek bota e përtejme dhe e zgjon mendjen dhe natyrshmërinë njerëzore si dhe e nxit njeriun të mendojë e të logjikojë:

"A nuk e shohin ata mbretërinë e qiejve e të Tokës dhe gjithçka që ka krijuar Allahu...?!"[3]

"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."[4]

"**Thuaj (**o Muhamed**): "Unë ju këshilloj vetëm një gjë: ngrihuni sinqerisht për Allahun, dy nga dy ose një nga një, e pastaj gjykoni për shokun tuaj (**Muhamedin**) që nuk është i çmendur."**[5]

"...**Dhe kështu, Allahu do t'i ngjallë të vdekurit dhe do t'ju tregojë mrekullitë e veta, që ju të kuptoni."**[6]

3. Sure "El-A'raf", ajeti 185.
4. Sure "Er-Rum", ajeti 21.
5. Sure "Es-Sebe'", ajeti 46.
6. Sure "El-Bekare", ajeti 73.

Profeti i Islamit (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imamët (udhëheqësit) e pagabueshëm (*paqja qoftë mbi ta!*) e ndoqën këtë rrugë. Ata, gjithashtu, bindën arsyet njerëzore dhe i nxitën drejt besimit dhe bazave themelore të fesë. Kështu, "*Nehxhul Belagha*", "*Usul'ul Kafij*", "*Teuhidi*" i Sadukut, e libra të tjerë, janë të mbushur plot me shembuj studimesh e argumentesh logjikë, ku paraqiten argumentet më të mira, shumica e të cilave harmonizohen dhe ndërthuren me natyrshmërinë (*fitrah*) e që paraqiten me mënyrat dhe shprehjet më të këndshme.

Duke u inspiruar nga Zbulesa (*vahj*) dhe duke ecur në rrugën e Kur'anit dhe Sunetit, dijetarët e Islamit që në shekujt e parë bënë kërkime dhe studime të gjera rreth temave të ndryshme doktrinore të cilat studiojnë ekzistencën e Allahut, emrat e Allahut dhe cilësitë e Tij, profetësinë në përgjithësi dhe në veçanti, temat që kanë lidhje me ringjalljen si dhe tema të tjera. Këto ishin temat më të nxehta, më të shumta dhe më të ëmbla në forumet shkencore dhe tubimet e dijes. Ne jemi të detyruar të theksojmë se këto pikënisje kanë qenë pikënisjet e lëvizjes shkencore në botën islame.

Zgjerimi i studimit rreth doktrinave (*akaid*) dhe shfaqja e apologjetikës (*kelam*)

Në kohën që Islami ishte përhapur dhe shtrirë në vende dhe popuj të ndryshëm, u përball me mendime e besime të ndryshme, si dhe me shumë kundërshtime, pyetje dhe dyshime. Kjo solli dhe lindjen natyrale të grupimeve e rrymave. Gjithashtu, apologjetika (*'ilmul kelam*) filloi të rritej dhe zgjerohej në formë e në përmbajtje, në sipërfaqe e në thellësi. Gradualisht hyri në çështjet e shkencave të tjera si në filozofi, shkencat e natyrës, shkencat sociale dhe ato politike.

Dyert e hapura të botës islame bënë që të qarkullojnë në mesin e myslimanëve doktrinat e tjera. Pa dyshim, kjo solli debate e polemika në përballjen me doktrinën islame e që i

detyroi dijetarët myslimanë të dilnin në mbrojtje të Islamit. Polemikat dhe studimet e gjata kërkimore të cilat i kanë kryer imamët tanë (*paqja qoftë mbi ta!*), si Imam Sadiku dhe Imam Rizai (*paqja qoftë mbi ta!*) dhe që u pasuan nga nxënësit e tyre Hisham ibn Hakem dhe Mu'min et-Tak me opinionistët dhe apologjetët e ndryshëm janë tregues të qartë për kohën dhe rrethanat në shekullin e dytë dhe të tretë hixhri përsa i përket përhapjes së studimit rreth bazave të fesë.

Pas kësaj periudhe, kjo shkencë u quajt teologji ose apologjetikë (*'ilmul kelam*) dhe ata që u specializuan në të u quajtën teologë ose apologjetë (*mutekel'limun*). Ekzistojnë mendime të ndryshme rreth shkakut të këtij emërtimi, por ky term vazhdon të jetë i përhapur edhe sot e kësaj dite.

Në shumë grupime islame u shfaqën shumë teologë (kelamistë) të mëdhenj e të njohur, u shkruan shumë libra në periudha të ndryshme kohore që i përshtateshin teologjisë në këto periudha dhe çështje të cilat përballeshin me të. Kanë qenë shumë teologë shi'itë nga të hershmit dhe prej tyre mund të përmendim Hisham ibn Hakemin, Hisham ibn Salimin, Hamran ibn A'junin, Mu'min et-Takin, Fadl ibn Shadhanin, dy Nubekhtët, Ibn Miskeuejhin, Shejh Sadukun, Shejh Mufidin, Sejjid Murtedanë, Nasirudin Tusin, Al-lame Hul-lin etj. Nga të mëvonshmit mund të përmendim Ismail Tabrasij Nurij, Sejjid Abdullah Shibrin, Shejh Xheuad el Belagin (*Allahu qoftë i kënaqur prej tyre të gjithëve!*). çdonjëri prej këtyre eruditëve shkruajti libra dhe studime në fushën e bazave të fesë duke iu përgjigjur mendimeve dhe studimeve të të tjerëve (*Allahu i shpërbleftë me të mira për çka i dhanë Islamit!*).

Zgjerimi i papritur i jurisprudencës (*fik'h*) dhe bazave (*usul*) të saj dhe ngurtësimi i teologjisë (*kelam*)

Në shekujt e fundit dijetarët tanë iu drejtuan çështjeve të jurisprundecës (*fik'h*) dhe bazave (*usul*) të saj duke derdhur shumë mund dhe duke harxhuar gjithë energjitë dhe

mundësitë e tyre në studimin e të gjitha aspekteve, duke u mundësuar këtyre dy disiplinave në mënyrë të menjëhershme e mbresëlënëse përhapjen dhe masivizimin, gjë e cila nuk kishte ndodhur më parë. U shkruajtën shumë libra të mëdhenj duke trajtuar gjerësisht në vëllime të shumtë këto disiplina, dukë u bërë studime të imtësishme e të thella deri në çështjet e vogla dytësore. Krejt e kundërta ndodhi me studimet doktrinore (*buhuth akaidijje*). Një tablo krejtësisht e kundërt tregon "bllokimin e tregut" dhe rënien e interesimit për dituritë islame. Ajo që është për të ardhur keq është se kjo pamje është ende ekzistuese. Ndoshta kjo dukuri nuk ka qenë e njohur dhe nuk ka patur këto rezultate të rrezikshme e të dëmshme në periudhën e safavitëve dhe kaxharitëve. Por pas asaj periudhe, sidomos gjatë periudhës së fundit dhe pas lidhjes së vendeve islame me vendet e tjera në tërësi, pas daljes në pah të mendimeve të reja dhe ndikimi i ideve dhe parimeve perëndimore e lindore mbi këto vende duke u shoqëruar ky ndikim me një zhurmë mediatike të gjerë i ndihmuar nga arritjet shkencore të teknologjisë ka hyrë në mendjet e brezit bashkëkohor e sidomos rinisë; natyrisht, e gjithë kjo çoi në tronditjen e besimit të tyre. Në këtë klimë të dhimbshme vazhdimësia e kësaj gjendjeje përbën fatkeqësi e cila nuk mund të përballohet. Kjo gjendje e vështirë dhe këto kushte na e bëjnë të domosdoshme përkujdesjen për çështjet teologjike kelamiste, përballjen me dyshimet, diskutimin e argumenteve të tyre dhe përgjigjjen rreth pyetjeve që shtrohen. E gjithë kjo duhet të bëhet sipas një metodologjie moderne dhe sipas një programi që i përshtatet brezit të ri, veçanërisht në Iran ku natyrshmëria e Islamit është më e plotë, ku edhe etja për dije është më e madhe, ku ndihet nevoja për paraqitjen e drejtë të doktrinës islame dhe mbrojtjen e saj. E gjithë kjo e bën këtë mision të shenjtë më të qartë dhe më të domosdoshëm.

Disa shenja prapambetjeje në disiplinën doktrinore

Është për të ardhur keq kur vëmë re dobësim në përgatitje dhe mosangazhim në radhët e dijetarëve të fesë dhe qendrave shkencore për t'u thelluar në këto lloj studimesh. Energjitë më të rëndësishme shkencore vazhdojnë të derdhen vetëm në ato dy fusha. Nuk kemi vënë re këtë njohje rreth filozofive dhe parimeve bashkëkohore. Gjithashtu, nuk vëmë re dëshirë për t'u njohur me to apo diskutimin e tyre.

Nëpërmjet kësaj shohim brezin e ri ose të përballet me largimin nga feja dhe mohimin e saj ose vazhdon të jetë i hutuar dhe i humbur, kërkon i etur ujin e jetës dhe nuk e gjen atë. Ndërsa, sa i përket brezit të vjetër, mjaftohet me keqardhjen dhe ndjenjën e dhimbjes dhe ndonjëherë me mallkimin duke mos gjetur rrugë tjetër.

Faktori më i rëndësishëm në dukurinë e mendimit hibrid (*fikrun hexhin, iltikat*)

Mund të themi se faktori më i rëndësishëm në shfaqjen e dukurisë së mendimit hibrid (*iltikat*) në Iran dhe në disa vende islame ishte se rinia dashamirëse ndaj fesë, e cila nuk mundi t'i ndërpriste plotësisht marrëdhëniet me fenë, gjithashtu nuk mundi t'i përballonte pyetjet dhe dyshimet dhe duke mos gjetur shpëtim ku mundeshin të mbroheshin, të detyruar për të dalë nga ky boshllëk ku kishin rënë dhe të nxitur nga disa njerëz të mashtruar filluan të devijonin çështjet doktrinore, ideore, ekonomike e shumë disiplina të tjera islame. Disa nga këto përpjekje çuan në mohimin e disa të vërtetave fetare. Si rezultat i injorancës, ata vazhduan të ecnin pas disa ideve dhe teorive të cilat nuk mund t'i pranojnë as ata që kanë gjysmën e njohurive të parimeve bazë të Islamit. Për mendimin hibrid (*iltikat*) ka ndikuar edhe një tjetër faktor: një grup marksistësh të cilët nuk dolën hapur dhe qartë me doktrinën e tyre ateiste, edhe interesat nuk i lejuan ata por qëndruan të fshehtë dhe

dyfytyrësh. Ata vazhdonin t'i paraqisnin mësimet dhe idetë marksiste kinse ishin në harmoni me fenë e të pranueshme nga Kur'ani, *Nehxhu'l Belagha* dhe Suneti. Pas kësaj i paraqisnin para rinisë së pazhvilluar duke i veshur kësaj përmbajtjeje heretike rrobat e fesë.

Mendimi hibrid (*iltikat*) është një nga problemet doktrinore më të rënda në shekullin ku jetojmë. Në të kaluarën ai kishte njëlloj ekzistence ngase ishte përqafuar nga një pjesë e studentëve, një pjesë e intelektualëve të pashkolluar, e një pjesë ishin mahnitur nga Perëndimi dhe Lindja, si dhe një pjesë e rinisë që ju bashkuan me shumë lehtësi.

Disa iluzionistë mendonin se çdonjëri që kishte mundësi që të përkthente përciptas disa fjali të qarta ose disa ajete kur'anore pastaj ka shkruar me një metodologji poeti duke luajtur me fjalë ndikuese konsiderohet dijetar në Islam, i cili ka të drejtë të japë opinione dhe mendime në çështje të ndryshme islame që kërkojnë specializim të veçantë, studim në brendësi dhe imtësi. Ky lloj dijetari mundet të dalë me mendimet e tij përballë dijetarëve të cilët kanë derdhur maksimumin e mundësive të tyre në studimin dhe realizimin e veprave rreth bazave të Islamit. Pas kësaj ata i akuzojnë për ashpërsi, naivitet, cektësi, prapambetje dhe ngurtësim mendimi, e të tjera parrulla të kota si këto, për t'i larguar nga masa e gjerë.

El-Mutahari dhe El-Beheshti, dy kolosët e përballjes me mendimin hibrid (*iltikat*) dhe ateizmin

Pas një kohe të gjatë dhe një periudhe të zhurmshme e të dhimbshme, që për fat të keq gllabëroi shumë nga ajka e rinisë tonë, aq sa vazhdojmë të vuajmë akoma pasojat e saj, u shfaqën në hauzanë shkencore dy figura nga ato figura të cilat zotërojnë dituri të madhe. Këta dy dijetarë të Islamit kishin dije të gjerë në filozofinë e Lindjes dhe të Perëndimit, ishin njohës të çështjeve bashkëkohore dhe njiheshin mirë nëpër hauza dhe në untiversitete. Ata të dy janë dëshmorët e mendimit, të

kulturës, të devotshmërisë dhe të Revolucionit, Mutahari dhe Beheshti. Ata u ngritën, iu përveshën punës dhe punuan pa u lodhur për të mbushur boshllëkun intelektual dhe doktrinor për të qenë kujdestarë të vërtetë të kësaj rruge.

Me hyrjen e tyre në universitete dhe takimin me studentët në sallat e leksioneve duke mbajtur leksione dhe simpoziume të ndryshme, duke shkruar artikuj dhe libra, ata ofruan atë që kërkonte ky grup i madh intelektualësh universitarë (sigurisht duke mos mohuar dhe rolin që kanë luajtur të tjerët në këtë fushë).

Këta të dy kolosë folën me logjikë të fortë, me mënyrë të ëmbël dhe me një gjuhë të pranueshme duke lënë pas vetes gjurmë të thella e të pavdekshme.

Sot në kohën që vepron ligji islam dhe bota drejtohet drejt forcës mbresëlënëse të Islamit, kur ndjenjat e të gjithëve kërkojnë të njihen përsëri me këtë fe të shenjtë dhe në kohën e rishqyrtimit të disa mendimeve të gabuara, trajtimi i çështjeve doktrinore në mënyrë sa më të qartë e sa më të përkryer - dhe në krye të tyre studimet doktrinore dhe paraqitja e tyre e vërtetë para shoqërisë - konsiderohet nga detyrat dhe misionet më të rëndësishme që janë ngarkuar mbi supet e dijetarëve të Islamit. Kjo detyrë nuk mund të krahasohet me asnjë shërbim tjetër. Do ishte në nder të hauzave që të kujdeseshin për dijet islame, ashtu siç kujdesen për jurisprudencën (*fik'h*) dhe bazat (*usul*) e saj; kjo është më e pakta që mund të bëhet. Nuk do të ishte pak nëse do të ofrohej për këto studime gjysma e asaj që ofrohet prej studimeve, mësimeve dhe kërkimeve. Kjo do ta nxirrte Kur'anin gradualisht nga vetmia dhe do ta paraqiste Islamin e shtrenjtë në formën e tij origjinale.

E lusim të Lartësuarin që të ngjallë shpirtin e eruditit Tabatabai, i cili ishte i pari që e hapi këtë derë duke i drejtuar të rinjtë myslimanë në këtë rrugë dhe duke ua shtuar edhe më shumë krenarinë dijetarëve shiitë.

Përpjekje të reja në përhapjen e kulturës doktrinore

Ky libër të cilin e kemi në dorë është shkruar nga një prej nxënësve të dalluar të eruditit të ndjerë Tabatabai. Ky është dijetari i madh, profesor Muhamed Tekij Misbah El Jezdi. Ky libër është përshtatur në formën e një grupi leksionesh (mësimesh) në çështjet e monoteizmit me një metodologji të thjeshtë për t'u kuptuar nga mendjet dhe për t'u studiuar në nivele shkencore të mesme, me shpresën se do të plotësojë disa nevoja aktuale. Shpresojmë se në të ardhmen do të plotësojmë disa nevoja për nivelet e tjera. Kërkojmë dhe shpresojmë se gjithë dijetarët të cilët kanë mundësi t'u përgjigjen nevojave të brezit të ri, t'u përgjigjen pyetjeve të tyre dhe t'i trajtojnë problemet e tyre ideore dhe doktrinore, duke ndjerë më tepër përgjegjësi si dhe duke u kujdesur që të shpenzojnë më tepër energji në rrugën e paraqitjes së dijeve të ndritshme të Kur'anit famëlartë dhe kulturës famëlartëe islame. Ata duhet të studiojnë me imtësi dhe thellësi gjithë parimet, filozofitë, teoritë e tjera të ndryshme dhe të përballen me to. Në qoftë se ka patur në të kaluarën disa doktrina dhe çështje, si krishtërimi dhe paganizmi, për të cilat dijetarët tanë kanë shkruar shumë libra ku kanë diskutuar dhe i kanë zmbrapsur ato (*Allahu qoftë i kënaqur me mundin dhe punën e tyre!*), sot janë shfaqur çështje dhe parime të cilat kanë edhe më shumë ndikim dhe i kanë çuar edhe më tepër drejt humbjes. Sot trinia e krishterë nuk ka atë shkëlqimin e mëparshëm; Ungjilli gjithashtu, por edhe kisha nuk ka atë shenjtërinë e dikurshme. Po, janë disa lëvizje politike me të cilat duhet të përballemi politikisht.

Lufta ndaj Islamit nga llogore të reja

Rreziku i sotëm nga mendimet e reja ateiste të cilat paraqiten në mënyra të ndryshme, me ngjyra të çelura e tërheqëse, por që kanë të përbashkët një gjë e cila i bashkon dhe ajo është kundërshtimi i feve qiellore e veçanërisht Islamit. Detyrë e

hauzave tona është që të gjejnë zgjidhje për këto rryma e orientime të reja dhe të vihen në gatishmëri për përpjekje shkencore në këtë fushë.

Kjo detyrë natyrisht nuk është e lehtë. Nuk është e thënë që çdokush që kryen një kurs në fik'h, në usul, në filozofi apo në tefsir është i aftë të marrë penën e të përballet me filozofët në Perëndim e në Lindje. Kjo lloj përballjeje me siguri mund të jetë edhe e dëmshme në qoftë se bëhet pa diturinë e plotë dhe pa njohjen e të gjitha bazave.

Është e domosdoshme që të edukojmë një grup nga nxënësit e dijes për këtë detyrë, duke nisur që në periudhat e hershme të studimit dhe pas specializimit të tyre, në mënyrë të mjaftueshme në apologjetikën islame *('ilmu'l kelami'l islamij*). Është e domosdoshme që ata të njihen dhe të mësojnë mendimet dhe rrymat e reja nga burimet origjinale - në qoftë se është e mundur - dhe pas kësaj të bëjnë krahasimin ndërmjet tyre dhe së fundmi diskutimin dhe përgjigjen e tyre në këtë fushë dhe në fusha të tjera të ngjashme me to, ku ka shumë punë dhe detyra të cilat nuk i kemi realizuar.

Mbetemi me shpresë se do të vijë dita kur Revolucioni Islam do të mundësojë që të paraqitet Islami i vërtetë, duke ofruar në këtë mënyrë një shërbim të madh për njerëzimin.

Ahmed Xhenneti

3 Rebi Eth-Thani, 1407 h

HYRJE

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botërave, paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi krijesën më të mirë, Muhamedin dhe familjen e tij të pastër, veçanërisht të mbeturin e Allahut (*Bakijetull'llah*) mbi Tokë dhe na bëftë ndihmës dhe përkrahës të tij!

Besimet dhe mendimet themelore përbëjnë bazën dhe shtyllën e çdo rendi vlerash morale dhe ideologjie të ngjashme. Ato ndikojnë në mënyrë të ndjeshme apo të pa ndjeshme në sjelljen e njeriut dhe veprimet e tij. Nga këtu vërejmë se për të ngritur sistemin moral dhe etikën e sjelljes në Islam si dhe forcimin e tij, është e nevojshme që ne të forcojmë në shpirtrat tanë shtylla dhe baza të besimit të cilat konsiderohen rrënjët e kësaj peme të madhe të begatshme, për të marrë prej saj gjithmonë frute të ëmbla e të shijshme duke garantuar lumturinë në Dynja dhe Ahiret.

Kjo ishte arsyeja që dijetarët islamë që në shekullin e parë të shfaqjes së Islamit u drejtuan në shpjegimin dhe sqarimin e besimit islam me mënyra dhe metoda të ndryshme e ndërmjet tyre dijetarët e teologjisë të cilët shkruajtën libra teologjikë për nivele dhe kohëra të ndryshme.

Edhe në kohën tonë, gjithashtu, duke veçuar dyshimet e reja, janë shkruar disa libra në besimin islam të cilat janë vënë në dispozicion dhe në duart e të gjithëve. Këto libra në shumicën e rasteve janë shkruar për dy nivele krejtësisht të ndryshme:

I pari: Niveli i përgjithshëm, me një metodë të thjeshtë dhe sqarime të shumta.

I dyti: Niveli i veçantë (për një kategori të specializuar), me një metode të ndërlikuar, fraza të rënda dhe terma shkencore.

Kështu, biblioteka islame vazhdoi të ishte bosh nga librat që ishin të përshtatshëm për një kategori të nivelit mesatar. Kaluan shumë vite të gjatë dhe shkollat fetare islame vuajtën për libra të tillë në mësimdhënie, duke ndjerë nevojë të ngutshme për to.

Me propozim të përgjegjësve të nderuar dhe ndihmesën nga të mirënjohurit e shoqatës "Në rrugën e drejtë", filluam me përgatitjen e këtij libri i cili dallohet nga veçoritë e mëposhtme:

1- I vumë përpjekjet dhe fuqitë tona në renditjen e temave të librit sipas një renditjeje logjike.

2- U përpoqëm, brenda mundësive, të përfitonim nga përzgjedhja e termave dhe fjalive të qarta e të thjeshta, duke anashkaluar përdorimin e termave të ndërlikuar dhe fjalive të vështira. Nuk përdorëm shprehje të përafërta në kuptim por i lamë rrugë përdorimit të shprehjeve letrare të mrekullueshme.

3- Në përforcimin e temave u përpoqëm të përfitojmë nga argumente logjikë e të qartë dhe jemi larguar nga përdorimi i shumtë i argumenteve duke qenë se një pjesë e tyre mund të jenë edhe të dobëta.

4- Bëmë maksimumin tonë në mospërdorimin e sqarimeve të shumta duke qenë se ato shpesh e mërzisin studentin, por duke iu përmbajtur zbatimit të normave në shkurtimin e nevojshëm.

5- Duke qenë se ky libër është shkruar për t'u studiuar nga një nivel mesatar, jemi munduar të largohemi nga përmendja e argumenteve të ndërlikuar, të thellë, të rëndë, të cilat kanë nevojë për njohje të filozofisë, tefsirit, fik'hut dhe hadithit. Në raste të veçanta, kur e kemi parë të nevojshme paraqitjen e parathënieve të domosdoshme për t'u sqaruar, e kemi treguar se ku mund të vazhdohet të studiohet dhe të plotësohet studimi i aspekteve të tjera të çështjeve në libra të tjerë. Kjo është për ata studentë që janë të zellshëm dhe kanë dëshirë për vazhdimin e studimeve.

6- E kemi ndarë përmbajtjen e librit në mësime të ndara, në mënyrë që çdo mësim të studiohet në një orë mësimi.

7- Shënimet e rëndësishme të disa mësimeve i kemi përforcuar në mësimet pasardhëse dhe nganjëherë i kemi përsëritur në mënyrë që të përforcohen më shumë në mendjen e studentit.

8- Në fund të çdo mësimi kemi shtruar disa pyetje për ta ndihmuar edhe më shumë studentin në përvetësimin, kuptimin dhe mësimin e përmbajtjes.

Ne nuk kemi aspak dyshim se ky libër ka pikat e tij të dobëta, por jemi me shpresë se ato do të korrigjohen në botimet e ardhshme, edhe me ndihmën e këshillave dhe vërejtjeve të profesorëve të nderuar.

Me shpresë se prijësi i kohës tonë (*shpirtrat tanë i qofshin falë dhe e shpejtoftë Allahu daljen e tij të nderuar!*) do të na e pranojë këtë shërbim të vogël dhe do të kënaqet me të si shlyerjen e një pjese të borxheve që kemi ndaj hauzasë shkencore dhe dëshmorëve të Islamit.

Muhamed Tekij Misbah El Jezdi
Dhul Hixhe el haram, 1406 h
Gusht, 1986

PJESA E PARË

Leksioni i parë

ÇFARË ËSHTË FEJA?

Përkufizimi i fesë

Qëllimi i këtij libri është paraqitja dhe studimi i doktrinës islame e cila në terminologji përmblidhet me "bazat e fesë". Nga këtu ne detyrohemi që të sqarojmë shkurtimisht termin "fe" dhe termat e përshtatshëm që lidhen me të. Kjo, ashtu siç përmendet edhe në logjikë, sepse faza e studimit të "parimeve përfytyruese" (përkufizimeve), është etapa e parë e studimit dhe radhitet para gjithë çështjeve të tjera.

Termi "fe" (*dijn*) është një fjalë arabe. Ajo është përmendur në gjuhën arabe me kuptimin nënshtrim dhe shpërblim... Ndërsa në terminologji nënkupton: "Besimi në Krijuesin e gjithësisë dhe njeriut, në mësimet dhe dispozitat praktike të përshtashme për këtë besim." Nga këtu rrjedh termi "jofetarë, ateistë" për të gjithë ata që nuk besojnë tek Krijuesi në mënyrë absolute, por ata besojnë tek rastësia dhe bashkimi i kushteve në krijimin e dukurive të gjithësisë. Ato njihen si veprime të materies dhe natyrës. Me termin "fetarë" thirren të gjithë ata që besojnë në Krijuesin e gjithësisë, edhe në qoftë se besimet, veprimet dhe shenjtëritë e tyre fetare janë përzier me disa devijime, paragjykime dhe legjenda.

Ky është shkaku që fetë që i besojnë njerëzit ndahen në të drejta (vërteta) dhe të gabuara. Feja e vërtetë është një shprehje e cila përmbledh besimet e vërteta që janë në përputhje me realitetin, mësimet dhe rregullat e të cilave zotërojnë një pasuri të mjaftueshme për vlerësimin e tyre dhe për t'i patur në konsideratë ato.

Bazat e fesë dhe degët e saj

Kuptimi terminologjik i fjalës *fe* shfaqet në mënyrë të përmbledhur në atë që sqaruam dhe cekëm më sipër ku feja përmblidhet në dy grupe kryesore:

1- Doktrina ose doktrinat të cilat përbëjnë themelet ose bazat e saj.

2- Mësimet dhe dispozitat praktike, të përshatshme për këto themele dhe shtylla të doktrinës të cilat rrjedhin dhe burojnë në të vërtetë nga këto themele.

Prej këtu e shohim të përshtatshme që ta emërtojmë grupin e doktrinave të fesë me "baza" dhe gupin e rregullave praktike me "degë", ashtu si i kanë përdorur dijetarët myslimanë këto dy terma në fushën e besimit dhe rregullave islame.

Botëkuptimi[1] dhe idelogjia

1. Koncepti "botëkuptim" (*ru'je keunijjeh*) është shprehur me terma dhe shprehje të ndryshme në librat e shkruar në gjuhën arabe. Ata nuk i janë përmbajtur një termi të vetëm. Ne mundemi që të përmendim këtu disa nga ato që gjetëm në libra të ndryshëm: botëkuptim (*ru'je keunijjeh*) - ndoshta është më i përmenduri ndër të gjithë -, vizioni gjithëpërfshirës për botën, koncepti i përgjithshëm për botën, koncepti filozofik për botën, interpretimi i përgjithshëm për botën, përfytyrimi i përgjithshëm, përfytyrimi i përgjithshëm i ekzistencës, pikëpamja për botën, pikëpamja për gjithësinë, koncepti i përgjithshëm për botën apo koncepti i përgjithshëm për ekzistencën.

Ajo që vëmë re është se disa prej tyre përmendin fjalën *ekzistencë* (*vuxhud*) e disa të tjerë *botë* (*'alem*) ose gjithësi (*keun*). Disa nuk flasin për botën dhe gjithësinë, por mjaftohen me një vëzhgim të përgjithshëm, ose përfytyrim të plotë, interpretim gjithëpërfshirës; kjo për shkak të argumentimit të temës të cilën po studion rreth kësaj fjale.

Gjenden edhe disa përmbledhje të tjera me të cilat mund të njihet lexuesi. Ajo që mund të merret edhe si origjinë e këtij termi janë burimet e huaja. Ky është edhe shkaku që çdo njëri prej tyre e ka përkthyer si i është dukur më e drejtë, prandaj shohim këto dallime ndërmjet tyre. Duhet të theksojmë se të gjithë kishin qëllimin e njëjtë - atë të përafrimit në kuptimin e drejtë të cilin e shpjegon ky libër që ndodhet në duart e tua.

Në këtë libër i jam përmbajtur termit *botëkuptim* (*ru'je keunijjeh*) pasi vërejta se disa libra të përkthyer nga gjuhën persiane e kanë përdorur. Për të bashkuar energjitë dhe për të mos i ngatërruar lexuesit e librave të përkthyer

Termat *botëkuptim* dhe *idelogji* janë përdorur në kuptime të përafërta.

Nga kuptimet e botëkuptimit është se ai është: "*Grup doktrinash dhe vizionesh të harmonizuara rreth gjithësisë dhe njeriut por dhe rreth ekzistencës në pamje të përgjithshme*". Nga kuptimet e termit *idelogji* përmendim se ajo është: "*Përmbledhja e mendimeve të përgjithshme e të harmonizuara rreth sjelljes së njeriut dhe veprimeve të tij.*"

Në dritën e këtyre dy kuptimeve mundemi që të marrim parasysh se sistemi doktrinor (*akaidi*) dhe fondamental (*usuli*) për çdo fe është vizioni i tij i përgjithshëm, dhe sistemi i dispozitave të saj praktike të përgjithshme është ideologjia e asaj feje. Në këtë mënyrë mundet zbatimi i këtyre dy koncepteve në bazat e fesë dhe degët e saj. Por është e domosdoshme që të theksojmë se termi *ideologji* nuk përmbledh dispozitat e veçanta ashtu siç edhe termi *botëkuptim* nuk përmbledh besimet e veçanta.

Gjithashtu, është për t'u shënuar se *ideologjia* përdoret ndonjëherë në kuptimin e përgjithshëm, pra, e përmbledh termin *botëkuptim*.[2]

Botëkuptimi hyjnor dhe materializmi

Mund të dallojmë se ndërmjet shumë njerëzve janë disa lloje botëkuptimesh. Ne mundemi t'i ndajmë ato të gjitha në bazë të besimit dhe mohimit të çështjeve metafizike në dy grupe të mëdha:

1. Botëkuptim hyjnor.
2. Botëkuptim materialist.

Në kohët e mëparshme ai që bazohej në botëkuptimin materi-

nga persishtja e kam përdorur këtë term. Vlen për t'u theksuar, gjithashtu, se librat islamë të botuar në gjuhën persiane e kanë përdorur këtë term me shumicë. (Përkthyesi nga persishtja në arabishte.)

2. Për më shumë sqarime rreth botëkuptimit dhe ideologjisë shihni leksionin e parë të librit "Ideolozhi tatbighi" (*Ideologjia praktike*) [në gjuhën perse].

alist thirrej "natyralist" dhe nganjëherë "i shthurur" e "ateist" (mosbesues, jobesimtar) ndërsa në kohën tonë ai thirret "materialist".

Gjithashtu, materialistët ndahen në grupe dhe rryma të shumta më e njohura prej tyre në kohën tonë është "materializmi dialektik" i cili përfaqëson dimensionin filozofik marksist.

Nga sa sqaruam më sipër vërejmë se fusha e vizionit kozmik nuk përcaktohet me kufijtë e besimeve fetare, sepse termi "botëkuptim" është gjithëpërfshirës për vizionet ateiste dhe materialiste sikurse termi "ideologji" nuk përdoret vetëm për dispozitat dhe mësimet fetare.

Fetë qiellore dhe bazat e tyre

Dijetarët e feve, profesorët e sociologjisë dhe njohësit e popujve dhe racave janë ndarë në shpjegimin e tyre për lindjen e feve te ndryshme. Mendimi islam i cili është nxjerrë nga burimet islame është se: "Feja ka lindur me njeriun dhe se njeriu i parë mbi Tokë që është Ademi (*paqja qoftë mbi të!*) ka qënë gjithashtu edhe i profet i Allahut dhe thirrës në monoteizëm". Ndërsa fetë politeiste janë përfundime dhe pjella të shtrembërimeve, të deformimeve dhe veprave sipas preferencave, shijeve dhe dëshirave të personave dhe grupeve të ndryshme.[3]

3. Një pjesë e devijimeve të cilat i kanë paraqitur disa fe qiellore për të marrë kënaqësinë e tiranëve dhe zullumqarëve është se e konceptonin rrethin e fesë vetëm në marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe Allahut, si dhe ligjet hyjnore kufizohen dhe i përkasin vetëm riteve dhe rrymave të veçanta. Politika dhe administrimi i shoqërisë në veçanti ndodhen jashtë rrethit të fesë. Në të vërtetë, çdo fe qiellore udhëheq çdo aspekt që lidhet me nevojat e njeriut në shoqëri për të arritur në lumturinë e Dynjasë dhe Ahiretit. Mendjet e njerëzve të zakonshëm e kanë të pamundur që ta njohin. Ne do ta sqarojmë këtë çështje në kohën e përshtatshme. Profeti i fundit i dërguar nga Allahu i njohu njerëzit me të gjitha të dhënat dhe ligjet, rregullat fetare për të cilat kanë nevojë deri në fundin e botës. Dihet se një pjesë e rëndësishme e mësimeve islame janë të lidhura me çështjet sociale, ekonomike dhe politike.

Fetë monotoiste janë fetë qiellore me bazë të vërtetë, të cilat bashkohen në tri baza kryesore të përgjithshme:

• Besimi në Zotin një.

• Besimi në Jetën e Përtejme (*Ahiret*). Çdo njeri në botën tjetër do të marrë shpërblimin për veprat e kryera në jetën e kësaj bote (*Dunja*).

• Besimi në dërgimin e profetëve (*enbija*) dhe të dërguarve (*rusul*) nga Allahu i Madhëruar për të udhëzuar njerëzimin në plotësimin e tyre përfundimtar dhe kënaqësinë e tyre në këtë botë (*Dunja*) dhe në botën tjetër (*Ahiret*).

Këto tri baza përfaqësojnë realisht përgjigjet vendimtare mbi pyetjet kryesore të cilat i parashtrohen njerëzve të vetëdijshëm: Kush është krijuesi i gjithësisë dhe filluesi i saj? Si do të jetë fati (përfundimi) i jetës? Cila është rruga për të njohur një sistem të ri më të mirë të jetës?

Sistemi që mundemi të njohim nëpërmjet Revelatës hyjnore është ai që përfaqëson ideologjinë e cila buron në të vërtetë nga vizioni i gjithësisë hyjnore.

Për besimet që në bazë kanë obligime, detyrime, argumente dhe shpjegime, janë botuar botime të panumërta. Dallimet ndërmjet këtyre besimeve kanë qenë shkaku i shfaqjes së feve, grupeve dhe rrymave fetare të ndryshme. Vërejmë se kontradiktat në besimin e profetësisë së disa të dërguarve të Zotit si dhe besimi tek Librat që bazohen ata është shkaku kryesor në mospajtimin ndërmjet feve hebraike, kristiane dhe islame. Gjithashtu, dalin dhe shumë dallime të tjera në besim dhe vepra praktike, pasi që nuk pajtohen disa prej tyre me besimet e tjera bazë. Për shembull, besimi i të krishterëve në trininë e shenjtë nuk pajtohet me njësimin, edhe në qoftë se përpiqen të krishterët ta justifikojnë këtë besim. Përcaktimi i pasuesit të Profetit (*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të dhe mbi familjen e tij!*), dhe a duhej zgjedhur ai nga njerëzit apo duhej përcaktuar nga Allahu, ka qenë shkaku kryesor në kontradiktat ndërmjet shiitëve dhe Ehli Sunetit në Islam.

Pra, Njësimi, Profetësia dhe Jeta e Përtejme përbëjnë

themelet kryesore të çdo feje qiellore. Ekzistojnë edhe besime të tjera të cilat kanë lindur nga analizimi, zbërthimi dhe pasimi i këtyre besimeve. Ne mundemi që t'i marrim si besime të drejta sipas një përkufizimi të veçantë. Për shembull, mundemi që ta konsiderojmë besimin në ekzistencën e Allahut si "parimin e parë", besimin në njësimin e Tij si "parimin e dytë", besimin në parimin e profetësisë si një nga themelet e të gjitha feve, si dhe besimin në parimin e profetësisë së vulës së të gjithë profetëve (Profetit Muhamed) si një nga themelet e fesë islame.

Disa dijetarë shiitë e konsiderojnë drejtësinë *('adl*) – që degëzohet nga Njësimi - si një nga parimet e pavarura. Po ashtu, për Imametin – që rrjedh nga parimi i profetësisë – besojnë se është një nga bazat e tjera. Në të vërtetë përdorimi i fjalës "parim" (bazë) në terminologji është si një term i cili nuk ka vend për diskutim ose debat rreth tij.

Pra, termi "bazat e fesë" mundet të përdoret në dy kuptime:

- Të përgjithshëm.
- Të përveçëm.

Termi i përgjithshëm – i cili është përballë termit "degët e fesë" dhe tërësisë së dispozitave – përmbledh të gjitha besimet e konsideruara.

Termi i përveçëm përmbledh bazat e besimit. Me termin "bazat e fesë" me kuptim të plotë pa e veçuar me një fe të përcaktuar, mund të thërresim edhe besimet e përbashkëta ndërmjet të gjitha feve qiellore. Si shembull mund të sjellim tri parimet: Njësimi, Profetësia dhe Jetën e përtejme (*mi'ad*)". Në qoftë se do të shtonim edhe disa parime të tjera, do ta përcaktonim si "bazat e veçanta të fesë". Gjithashtu, në qoftë se do t'u cilësojmë disa besime të veçanta të një medh'hebi apo grupi të caktuar, atëherë do t'i quanim "parimet e fesë dhe të medh'hebit" ose "bazat e besimeve për një medh'heb të caktuar".

Pyetje:

1. Përcakto kuptimin gjuhësor dhe terminologjik të fesë?

2. Përkufizo vizionin e gjithësisë dhe ideologjinë dhe trego dallimin ndërmjet tyre?

3. Sqaro dy llojet e përmendura të vizionit të gjithësisë?

4. Shpjego termin e përgjithshëm dhe të përveçëm të parimeve fetare?

5. Cilat janë parimet e përbashkëta të feve qiellore? Cila është rëndësia e tyre?

Leksioni i dytë

KËRKIMI RRETH FESË

Motivet e studimit

Nga veçoritë psikologjike të njeriut për njohjen e të vërtetave dhe njohjen e realitetit që i shfaqet çdo njeriu që nga fillimi i fëmijërisë e deri në fund të jetës së tij janë shtysat instinktive dhe natyrore. Ky është shkaku natyral për njohjen e së vërtetës e cila shpreh nganjëherë (dashurinë për vëzhgimin) dhe që mundet ta shtyjë njeriun të mendojë dhe të meditojë për çështje dhe probleme të cilat janë bërë në emër të fesë, si dhe mundësia për të studiuar fenë e vërtetë.

Nga këto çështje mund të përmendim:

A mund të ketë ekzistencë për gjërat jo materiale dhe që nuk preken e janë të fshehta (*gajb*)? Në qoftë se ekziston, a ekziston marrëdhënie ndërmjet botës së fshehtë (të padukshme) dhe botës së prekshme materiale? A do të kufizohet dhe limitohet ekzistenca e njeriut vetëm me trupin (materien)? A kufizohet jeta e tij vetëm me jetën në tokë, apo ka edhe jetë tjetër? Në qoftë se ka jetër tjetër, a ka lidhje ndërmjet jetës në tokë dhe jetës së përtejme?

Në qoftë se ekzistojnë lidhje, atëherë cilat janë fenomenet që ndikojnë në çështjet e jetës së përtejme? Cila është rruga për njohjen e rregullit të vërtetë për jetën? Rregull i cili garanton kënaqësinë e njeriut në këtë botë dhe botën e përtejme? Së fundmi, cili është ky rregull?

Pra, instinkti i dëshirës për të hulumtuar është motivi i parë që e shtyn njeriun për të studiuar të gjitha çështjet dhe problemet, mes të cilave edhe çështjet fetare dhe njohja e fesë së vërtetë.

Motivi i dytë e bën edhe më të fortë dëshirën e njeriut për të njohur të vërtetat. Me të vërtetë plotësimi i kënaqësisë për të gjitha gjërat të cilat lidhen me motivin ose motivet e natyrshme (*fitrijeh*) përveç dëshirës për të hulumtuar dhe plotësimin e tyre nuk arrihet vetëm se duke plotësuar dijet dhe dituritë e veçanta.

Sigurimi i kënaqësive dhe interesave te ndryshme materiale të kësaj bote varet nga puna dhe energjitë e harxhuara. Gjithashtu, përparimi i teknologjisë e ka ndihmuar shumë njeriun në plotësimin e nevojave të tij. Feja, gjithashtu, e ndihmon njeriun në plotësimin e nevojave, sigurimin e të mirave e interesave të cilat ajo proklamon, mbrojtjen nga të këqijat dhe rreziqet që ajo paralajmëron. Pra, feja është nga fushat të cilat e ftojnë njeriun për mirë. Kjo e bën studimin për përfitim dhe mbrojtje nga të këqijat dhe rreziqet një motiv më tepër për studimin e fesë. Megjithëse të dhënat në këtë fushë janë të shumta, përsëri nuk sigurohen kushte të mjaftueshme për njohjen e gjithë të vërtetave. I mbetet vetë personit të zgjedhë në studimin e tij çështje dhe probleme që trajtohen më lehtë, që përfundimet e tyre janë më tepër të prekshme, si dhe janë rruga më e shkurtër që të shpien në realizimin e qëllimeve të proklamuara, duke iu larguar çështjeve fetare të besimit të cilat kanë nevojë të besohen ashtu siç janë, sepse është i vështirë trajtimi i prekshëm i tyre dhe përgjigjet e tyre të shpien në humbje. Ne duhet të sqarojmë se çështjet fetare kanë rëndësi të veçantë, sikurse duhet të kuptojmë se studimi i ndonjë çështjeje tjetër nuk ka të njëjtën vlerë e rëndësi siç ka studimi i çështjeve fetare.

Vëmë re disa psikologë[1] dhe psikanalistë që besojnë se adhurimi i Zotit dhe besimi në tërësi është arsyeja e katërt e natyrshmërisë njerëzore që burojnë me lindjen e njeriut. "Ndjenja fetare" konsiderohet si dimensioni i katërt i shpirtit njerëzor e cila vjen mbas dëshirës për të hulumtuar, ndjenjës

1. Kthehu tek librat vijues: "*Ndjenja fetare*", "*Njeriu ky mister*", "*Feja dhe shpirti*".

për të vepruar vepra të mira dhe ndjenjës për të qënë i bukur.

Argumentet nga historia, arkeologjia dhe antropologjia tregojnë se praktimi i fesë dhe adhurimi i Allahut është një dukuri e qëndrueshme në një mënyrë apo një tjetër gjatë brezave të njerëzimit përgjatë gjithë historisë. Kjo qëndrueshmëri dhe kjo dukuri gjithëpërfshirëse është argument për natyrshmërinë njerëzore.

Gjithëpërfshirja e motivit të natyrshmërisë nuk tregon domosdoshmërisht ekzistencën e përhershme e të dukshme tek të gjithë njerëzit, duke e nxitur njeriun të realizojë qëllimet e tij të shprehura, por mund të jetë e fshehur në brendësitë më të thella të njeriut për shkak të faktorëve që e kanë rrethuar atë dhe të edukimit të tij jo të drejtë, duke e devijuar nga rruga e drejtë. Kjo vihet re në të gjitha instinktet dhe dëshirat edhe pse përballen me fshehjen dhe devijimet e pakta apo të shumta.

Në dritën e këtij opinioni, studimi i fesë është arsye natyrale e pavarur nga asgjë tjetër për të cilën nuk kemi nevojë për ta mbështetur domosdoshmërisht me fakte dhe argumente.

Mund ta mbështesim këtë mendim me argumente tekstuale (ajete kur'anore dhe transmetime hadithore) që lidhen me natyrshmërinë e fesë, por meqenëse ndikimi i kësaj prirjeje nuk është i ndjeshëm dhe mundet që dikush ta mohojë ekzistencën e këtij lloj motivi në veten e tij gjatë debatit, për këtë arsye nuk bazohemi shumë në këtë mendim dhe vazhdojmë të thellohemi rreth rëndësisë së studimit të fesë duke kërkuar argumente që bazohen tek logjika.

Rëndësia e studimit të fesë

Nga ajo që pamë më sipër u sqarua se motivi i natyrshmërisë së njeriut për njohjen e të vërtetave nga njëra anë, si dhe interesat e dëshira për përfitime dhe sigurimi nga dëmet dhe rreziqet nga ana tjetër, formojnë një motiv të fortë për njeriun. Ai është të medituarit rreth diturive dhe mendimeve të përfituara.

Në dritën e kësaj, vërejmë se kur personi ka njohuri rreth ekzistencës së personaliteteve të mëdha përgjatë historisë dhe pretendon se ata janë të dërguar nga Krijuesi i gjithësisë për të udhëzuar njerëzimin drejt lumturisë së tyre në këtë botë dhe në botën tjetër, duke derdhur gjithë mundësitë e tyre në rrugën e përmbushjes së mesazhit të tyre, në udhëzimin e njerëzimit dhe duke mbartur të gjitha metodat e sakrificave dhe sfidave, si dhe duke sakrifikuar shpirtrat e tyre në rrugën e përmbushjes së qëllimeve të tyre, ky njeri i motivuar me këto lloje motivesh është në kërkim të studimit të fesë për të parë vërtetësinë e thirrjes së profetëve.

Duke parë a ka argumente logjike të mjaftueshme bindëse për vërtetësinë e këtyre thirrjeve, veçanërisht kur e di se thirrja e tyre përmban përgëzimin për lumturinë dhe kënqësinë e përjetshme dhe paralajmërimin për vuajtjen dhe dënimin e përhershëm, besimi në thirrjen e tyre përmban përfitimet e pritshme të pafundshme, ndërsa kundërshtimi i tyre pasohet me dëme dhe rreziqe të pritshme e të pambarimta. Këtij njeriu nuk i mbetet asnjë shkak i vetëm që të jetë i pakujdesshëm dhe të mbajë një qëndrim mospërfillës ndaj fesë.

Po, është e vërtetë që disa studiues mund ta anashkalojnë studimin e fesë, kjo për shkak të dembelizmit të tyre dhe dëshirës së tyre për të pushuar dhe për t'u çlodhur. Besimi në fenë u kushtëzon atyre shumë kushte dhe i kufizon dhe ndalon ata nga praktikimi[2] i shumë gjërave të cilat i dëshirojnë për veten e tyre. Ata duhet të pranojnë pasojat e rënda të këtij dembelizmi, zhgënjimi dhe kotësie dhe çfarë e pason atë nga ndëshkimi i përjetshëm dhe vuajtja e përhershme.

Këta fatzinj, të marrë dhe idiotë i përngjajnë atij fëmijës së sëmurë e të paditur i cili nuk shkon tek mjeku nga frika e përdorimit të barnave të hidhura dhe kështu është i destinuar të vdesë. E gjithë kjo sepse ky fëmijë nuk ka mbushur moshën madhore që të ketë mundësi të përcaktojë atë që është

2. ***"Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë."*** (Surja El-Kijame, ajeti 5)

e dobishme dhe e dëmshme për të. Duhet shtuar, gjithashtu, se moszbatimi i këshillave të mjekut nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se ia shkurtojnë ato pak ditë jetë që i kanë mbetur në këtë botë. Ndryshe është puna me njeriun në moshë madhore, i zgjuar i cili është në gjendje të mendojë e dallojë se çfarë është e dobishme e çfarë është e dëmshme për të, si dhe të peshojë kënaqësitë e përkohshme me dënimin e përhershëm.

Kur'ani famëlartë na tërheq vëmendjen në shembujt e atyre që ishin të pavëmendshëm e të shkujdesur dhe që janë më të humbur se kafshët. **"...Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit."**[3]

Në një ajet tjetër: **"Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (***ndaj së vërtetës***) e që nuk hanë arsye."**[4]

Përgjigje mbi keqkuptimet

Ndoshta dikush këmbëngul që duhet larguar nga mendimi dhe studimi i çështjeve fetare me argumentin se: është më mirë që të derdhet energji rreth një çështjeje dhe mundësisë së zgjidhjes së saj, kur njeriu mendon se për zgjidhjen e tyre është një mundësi.

Kjo nënkupton arritjen në përfundim dhe zgjidhjen nëpërmjet fuqive të tij, por ne nuk mendojmë dhe shpresojmë se një gjë të tillë ndodh nëse studiohet rreth fesë dhe çështjeve fetare. Nga këtu themi se është më mirë që të derdhim fuqi dhe djersë në vepra rreth të cilave mendohet se mund të arrihen përfundime.

Atyre u përgjigjemi:

E para: Shpresa për zgjidhen e çështjeve fetare nuk është me më pak vlerë se përpjekja për zgjidhjen e çështjeve shkencore. Ne e dimë se zgjidhja e shumë çështjeve shkencore për të arritur në përfundime ka marrë dhjetra vite kohë, fuqi dhe

3. Sure "El A'raf", ajeti 179.
4. Sure "El Enfal", ajeti 22.

mund të dijetarëve të asaj fushe.

E dyta: Vlera e mundësisë nuk i nënshtohet një shkaku të vetëm e cila është "shkalla e mundësisë" dhe kaq, por është shumë e rëndësishme gjithashtu të vihet re "shkalla e asaj që është e mundshme".

Për shembull, sa është përafërsisht fitimi në një veprim ekonomik 5% apo në një veprim tjetër 10%, duke patur parasysh se sasia e pritshme e fitimit në shumën e parë vërtitet rreth një mijë rialëve dhe në të dytën njëqind rialë? Në veprimin e parë parashikohet pesë herë më tepër se në veprimin e dytë, megjithëse shkalla e parashikimit në të është 5%, shumë e cila është sa gjysma e parashikuar në shumën e dytë 10%, dhe rëndësia e gjithë kësaj është për shkak të parashikimit të vlerës së saj.[5]

Përfitimi i parashikuar në studimin rreth fesë është i pakufizuar dhe i pambarimtë. Edhe në qoftë se parashikimi për të arritur në rezultat është shumë i dobët, por pavarësisht përfundimit të dobët të parashikuar për t'u arritur, vlera e studimit dhe shpenzimi i fuqive në këtë rrugë kanë rëndësi të madhe dhe ia kalojnë disa herë vlerës së çdo studimi të kryer në rrugë të tjera të cilat kanë përfundime të kufizuara apo të dobëta.

Mendja njerëzore e pranon që studimi të largohet nga feja, edhe në qoftë se kemi një vendim përfundimtar rreth asaj që feja është e gabuar dhe e pasaktë, apo që çështjet nuk kanë zgjidhje. Ashtu siç dihet nuk ka një rrugë që të çon në një vendim përfundimtar dhe qetësues.

5. 1000 x 5 ÷ 100 = 5000 ÷ 100 = 50
100 x 10 ÷ 100 = 1000 ÷ 100 = 10
50 ÷ 10 = 5

Pyetje

1. Cili është motivi që e shtyn njeriun të njohë të vërtetat?

2. Përse nuk i studiojnë njerëzit të gjitha të vërtetat?

3. Cilat janë ndjenjat fetare? Cilat janë argumentet për ekzistencën e tyre?

4. Trego domosdoshmërinë e studimit të bazave fetare?

5. A mundemi ta konsiderojmë humbjen e shpresës për të arritur në zgjidhjen e të vërtetës së çështjeve fetare si shkak për t'u larguar nga studimi i fesë? Përse?

Leksioni i tretë

KUSHTI VLERËSUES PËR JETËN NJERËZORE

Hyrje

Në leksionet e mëparshme shpjeguam rëndësinë e studimit të fesë si dhe rrugën që duhet ndjekur për njohjen e fesë së vërtetë me një stil të thjeshtë, i cili bazohet në themelet e motiveve natyrale të njeriut për kërkimin e të mirave personale dhe mbrojtjen nga dëmet.[1]

Ky është një motiv të cilin çdonjëri prej nesh mund ta ndiejë në brendësinë e tij. E shprehur ndryshe, njeriu është i bindur me një bindje të padiskutueshme e cila nuk paraqet gabime dhe dyshime.

1. Forma artistike e këtij argumeti është si vijon: Në qoftë se ka mundësi për të arritur tek përfitimi, të mbrohet nga dëmet, dëshira e natyrshme e njeriut është të studiojë fenë për të cilën pretendon se të drejton në rrugën e drejtë, të përfitimit të pafund dhe mbrojtjen nga dëmet e pambarimta. Nuk duhet harruar se arritja e këtyre përfitimeve, mbrojtja nga dëmet janë dëshira natyrore të njeriut të cilat e bëjnë të domosdoshëm studimin e fesë. (Kjo domosdoshmëri është domosdoshmëri e shkakut të mangët në raport me ekzistencën e pasojës.) Por arritja e dobisë dhe siguria nga dëmi është dëshirë e natyrshme e njeriut, prandaj edhe studimi i një feje si kjo është domosdoshmëri. Ky argument është në formë analogjie të veçantë. Ajo ngrihet mbi një analizë logjike të përcaktuar, mbi rregulla praktike logjike dhe përfundon në qenien e shkakut (veprave të zgjedhura) të domosdoshme me analogji, për të arritur kështu tek pasoja (përfundimi i kërkuar), ashtu si e kemi sqaruar në temën e tij.

Argumenti që ne kërkojmë në këtë mësim mundet të shtrohet, gjithashtu, edhe në një formë tjetër: Në qoftë se është arritja e përsosurisë njerëzore është një kërkesë natyrore, atëherë njohja me bazat e botëkuptimit i cili është kushti kryesor në përsosurinë shpirtërore, bëhet gjithashtu i domosdoshëm.

Meqenëse përsosuria është një kërkesë natyrore, atëherë edhe njohja me shtyllat e sipërpërmendura është e domosdoshme.

Në këtë mësim do të përpiqemi që të sqarojmë të njëjtën ide por me një metodë tjetër e cila bazohet në parathënie më të sakta për të arritur nëpërmjet tyre në përfundime. Çdo njeri në qoftë se nuk studion rreth fesë dhe nuk mendon për të, si dhe nuk beson në vizionin kozmik dhe në vëzhgimin e vërtetë ideologjik, atëherë atë nuk mund ta konsiderojmë njeri të vërtetë. Një nga kushtet për të vlerësuar jetën njerëzore është respektimi i vizionit kozmik dhe ideologjia e vërtetë. Në qoftë se do të bazohet gjatë jetës së tij në botëkuptimin dhe ideologjinë e vërtetë, atëherë ai njeri do të jetojë jetën e tij si njeri.

Ky argument bazohet në tri pika:

1- Njeriu në kërkim të përsosurisë.

2- Përsosuria e njeriut arrihet nëpërmjet përzgjedhjes së veprave që burojnë nga gjykimi mendor.

3- Dispozitat praktike të arsyes përbëhen dhe dalin nën dritën e teorive të përcaktuara të ndjeshme ku më e rëndësishmja e tyre është botëkuptimi i tre shtyllave, pra njohja e prejardhjes së krijimit (Njësimi), përjetësia (jeta e përtejme, e pasvdekjes) dhe rruga e drejtë e cila garanton dhe ofron lumturinë (Profetësia). Pra, njohja e ekzistencës, njohja e njeriut dhe njohja e rrugës. Fillojmë me sqarimin e çdonjërës prej këtyre tri pikave.

Njeriu në kërkim të përsosurisë

Çdo njeri po të meditojë në instinktet e tij të brendshme si dhe dëshirat shpirtërore, do të vëzhgojë shumë nga instinktet e tij bazë. Ajo është dëshira për përsosuri. Nuk mund të gjejmë asnjë njeri i cili do të dëshironte të meta në veten e tij, përkundrazi e shohim atë që të përpiqet sipas mundësive të tij për t'i larguar këto të meta dhe mangësi dhe për të arritur përsosurinë. Njeriu, para arritjes së saj, përpiqet që t'i fshehë ato nga të tjerët.

Në qoftë se kjo shtysë do të vendoset në rrugën e saj të shëndoshë dhe të drejtë do ta drejtojë njeriun drejt shërim-

it dhe plotësimit të tij material e shpirtëror, por në qoftë se ndodh e kundërta dhe vendoset në rrugën e shtrembët për shkak të disa kushteve dhe faktorëve, tek njeriu do të shfaqen shumë cilësi të këqija si p.sh. mendjemadhësia, dëshira për t'u mburrur dhe veprat që bëhen për t'u dukur në sy të të tjerëve, rënia e reputacionit dhe zhvlerësimi i tij.

Si përfundim, shohim se dëshira për t'u përsosur është një instinkt natyror i fshehur në brendësi të shpirtit njerëzor, por që në përgjithësi manifestohet emocionalisht. Ne, sikur të meditojmë sadopak, do të shohim se baza dhe origjina e çdo shfaqjeje emocionale është dëshira për t'u përsosur.

Përsosuria e njeriut arrihet me bindjen ndaj mendjes (logjikës)

Procesi i rritjes dhe i zhvillimit të bimëve bëhet nëpërmjet një rregulli të pashmangshëm. Ai i nënshtrohet realizimit të kushteve dhe faktorëve të jashtëm. Pema nuk mund të rritet me dëshirën e saj, si dhe nuk prodhon frutet që ajo përzgjedh. Shkaku është se tek bimët nuk ekzistojnë ndjenjat dhe dëshirat.

Tek kafshët mund të themi se ekziston dëshira dhe përzgjedhja në përsosjen e tyre, por ajo është një dëshirë që buron nga instinkte kafshërore të verbra. Puna dhe veprimtaria e tyre kufizohet në kufijtë e nevojave natyrore, në dritën e ndjenjave të ngushta që kufizohen nga shqisat e kafshëve.

Ndërsa njeriu, duke shtuar dhe ato çka posedon nga veçoritë e bimëve dhe kafshëve, dallon me dy veçori shpirtërore:

Nga njëra anë, ai nuk i kufizon dëshirat e tij në kufijtë e nevojave natyrale dhe nga ana tjetër njeriu posedon fuqinë e të menduarit (logjikës) ku nëpërmjet saj ai mund t'i zgjerojë dijet e tij në kufijtë e pafundësisë. Njeriu, për shkak të këtyre veçorive, i tejkalon kufijtë e dëshirave të ngushta natyrore dhe drejtohet drejt pafundësisë.

Ashtu si veçohet përsosuria e bimëve e cila buron nga fuqia e përcaktuar bimore, përsosuria kafshërore arrihet nga dëshirat që burojnë prej instinkteve dhe ndjenjave. Gjithashtu, edhe përsosuria njerëzore, e cila bazohet në të vërtetë në përsosurinë shpirtërore, arrihet nëpërmjet dëshirave të ndjenjave dhe nën dritën e udhëzimit të arsyes dhe orientimit të saj, arsye e cila njeh të gjitha drejtimet e ndryshme dhe nivelet e kërkuara. Në kohën që ato do të përplasen dhe ngatërrohen, mendja do të zgjedhë më të mirën e tyre.

Nga këtu mësojmë se veprat njerëzore realizohen me dëshirat që burojnë nga preferenca dhe kërkesa me të cilat veçohet vetëm njeriu, nën dritën e udhëzimit të arsyes dhe orientimit të saj. Veprat të cilat burojnë vetëm nga instinktet kafshërore quhen vepra kafshërore, ashtu si lëvizjet të cilat e kanë burimin vetëm nga fuqia mekanike e trupit të njeriut quhen lëvizje fizike.

Dispozitat praktike të arsyes kanë nevojë për baza teorike

Përzgjedhja e veprave është rruga nëpërmjet të cilës arrin në përfundimet e kërkuara dhe i nënshtrohen vlerës së saj. Qëllimi i përfundimit të kërkuar, i cili është proklamuar përgjatë gjithë ndikimit të tij arrin në përsosurinë e shpirtit, ashtu edhe përzgjedhja e veprave, në qoftë se çon në humbjen e përsosurisë shpirtërore, do të ketë vlera negative.

Mendja mundet që të drejtojë përzgjedhjen e veprave dhe vlerësimin e tyre. Kjo arrihet në qoftë se mendja do të vështronte përsosurinë dhe nivelin e njeriut, duke patur njohuri të plotë rreth tij, kudo qoftë ai në hapësirat e shtrira përgjatë jetës së tij të fazës plotësuese të cilën ai mund ta përmbushë.

Është e domosdoshme për mendjen që të kuptojë rëndësinë e ekzistencës së njeriut dhe qëllimin e krijimit të tij. Prej këtu arrijmë në ideologjinë e vërtetë, në rregullin e krijimit i cili drejton përzgjedhjen e veprave.

Nuk do të mund të realizohej botëkuptimi i vërtetë,

zgjidhja e çështjeve dhe temave, po të mos zgjidheshin këto çështje, si dhe nuk mund të kishte një normë të sigurtë e të prerë me vlera për veprat.

Gjithashtu, po të mos njihej qëllimi nuk do të mund të përcaktonim rrugën e cila do të na dërgonte tek ky qëllim. Pra, këto perceptime teorike të cilat përbëjnë temat kryesore të botëkuptimit, janë në të vërtetë themeli i sistemit të vlerave dhe dispozitave praktike të arsyes.

Konkluzioni

Në dritën e këtyre të dhënave, ne mundemi të vërtetojmë rëndësinë e studimit të fesë, sakrifikimin e energjive për të arritur në ideologjinë dhe botëkuptimin e vërtetë të bazuar në argumentin e mëposhtëm:

Tek njeriu ekzistojnë instinktet natyrore të përsosurisë njerëzore. Nëpërmjet ushtrimit të disa veprave, njeriu ka për qëllim që të arrijë përsosurinë e vërtetë. Nisur nga shkaku i njohjes së veprave dhe ushtrimeve të cilat të dërgojnë tek qëllimi i proklamuar, është e domosdoshme që të njihet fillimisht përsosuria e tij përfundimtare.

Kjo realizohet nëpërmjet njohjes së vërtetësisë së ekzistencës, të prejardhjes së tij dhe përfundimit të tij. Pas kësaj duhet të përcaktojë marrëdhëniet pozitive dhe negative ndërmjet veprave të ndryshme si dhe të sqarojë etapat dhe nivelet e ndryshme të përsosurisë së tij.

Kjo bëhet derisa t'i mundësohet që të arrijë të ecë në rrugën e vërtetë e cila të çon në përsosurinë njerëzore. Në qoftë se e ka të pamundur që të ecë në këto dije teorike (bazat e botëkuptimit), atëherë e ka të pamundur që ta pranojë sistemin e vërtetë praktik (ideologjinë).

Pra, si përfundim, mund të themi se është detyrë studimi dhe njohja e fesë së vërtetë, e cila përmbledh botëkuptimin dhe ideologjinë e vërtetë. Në të kundërt, është e pamundur përsosuria njerëzore. Veprat të cilat nuk burojnë nga këto

parime, ndjenja dhe dije nuk mund të quhen vepra njerëzore.

Ata të cilët nuk përpiqen të studiojnë fenë e vërtetë, apo ata të cilët e njohën atë, por e mohuan dhe devijuan me vendosmëri duke iu nënshtruar epsheve dhe dëshirave të tyre kafshërore e kënaqësive materiale kalimtare, ata në të vërtetë janë kafshë ashtu siç thotë edhe Kur'ani famëlartë: **"...kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisin bagëtia..."**[2]

Meqënëse ata i humbën veçoritë njerëzore, për këtë ndëshkimi i tyre do të jetë i tmerrshëm dhe i vështirë.

Shkaku i gjithë kësaj është shpenzimi i fuqive të tyre dhe dhuntive njerëzore të shumta. **"Lëri ata që të hanë e të kënaqen dhe le t'i mashtrojë shpresa; ata do ta marrin vesh!"**[3]

Pyetje

1. Cilat janë premisat të cilat kompozojnë argumentin e dytë rreth domosdoshmërisë së studimit të fesë?

2. Sqaro dëshirën njerëzore për përsosuri?

3. Cilat janë veçoritë kryesore të njeriut?

4. Cilat janë marrëdhëniet ndërmjet këtyre cilësive dhe përsosurisë së vërtetë?

5. Si bazohet ideologjia në botëkuptim?

6. Sqaro mënyrën logjike të argumentit të dytë.

2. Sure "Muhammed," ajeti 12.
3. Sure"El-Hixhr", ajeti 3.

Leksioni i katërt

MËNYRA E TRAJTIMIT TË ÇËSHTJEVE TË BOTËKUPTIMIT

Hyrje

Përpjekja e njeriut për të studiuar rreth zgjidhjes së çështjeve themelore të botëkuptimit dhe njohja e tij me bazat e fesë së vërtetë është pyetja e parë me të cilën ai ballafaqohet. Cila është rruga që ai duhet të ndjekë për zgjidhjen e këtyre çështjeve? Si të arrijë në perceptimet themelore të vërteta? Cilat janë rrugët e njohjes? Cila është rruga e njohjes që duhet ndjekur për të arritur tek këto perceptime?

Studimet e detajuara dhe teknike të këtyre temave i mbulon departamenti i epistemologjisë, një nga nëndegët e filozofisë. Është ky departament i cili kryen të gjitha llojet e studimeve dhe vlerësimin e diturive njerëzore. Studimi i kësaj teme me të gjitha detajet e çështjeve na largon ne nga qëllimi që kërkojmë nga ky libër. Ky është shkaku që ne do të studiojmë vetëm disa çështje për të cilat ne kemi nevojë këtu, ndërsa përgjithësimin dhe gjithëpërfshirjen do t'ua lëmë librave që janë të veçantë në këtë fushë.[1]

Llojet e dijes

Ne mund ta ndajmë diturinë nisur nga disa aspekte në katër grupe kryesore:

1. Për t'u zgjeruar mund të shihet pjesa e dytë e librit *"Ta'limu'l felsefeh"* (*Mësimi i filozofisë*), artikulli "Njohja" në librin *"Ed Difa' 'an Khanadiki'l Ajdjuluxhijjeh"* (*Mbrojtja e hendeqeve të ideologjisë*), si dhe mësimi i pestë deri në të gjashtëmbëdhjetin tek *"El Ajdjuluxhijjetu'l Mukareneh"* (*Ideologjia e krahasuar*).

1- ***Njohja eksperimentale dhe shkencore*** (në termin e veçantë): Kjo dituri arrihet duke u mbështetur tek shqisat, megjithëse mendja luan një rol të madh në çrrënjosjen e ndjenjave dhe përgjithësimin e tyre. Kjo njohje përfitohet nga shkencat eksperimentale, si për shembull fizika, kimia dhe biologjia.

2- ***Njohja racionale*** (mendore): Përbëhet nga koncepte të debatueshme dhe për të arritur tek ajo mendja është ajo që luan rolin kryesor. Përfitimi i saj arrihet nëpërmjet ndjeshmërisë dhe eksperimentit. Fushat e kësaj njohjeje janë: logjika, shkencat filozofike dhe matematika.

3- ***Njohja adhurimore:*** Kjo njohje luan një rol dytësor. Ajo është vazhdim i vërtetimit të njohjeve të mëparshme. Kjo njohje e ka burimin aty ku mbështetet, pra tek Lajmi (lajmi i vërtetë). Pjesë e kësaj njohjeje llogariten dijet dhe të dhënat të cilat takohen (gjenden) tek pasuesit e feve nga tregimet (lajmet) e udhëheqësve dhe përfaqësuesve të tyre fetarë, ku ndoshta besimi i tyre është më fort i rrënjosur se besimet e lindura nga ndjeshmëritë dhe eksperimentet.

4- ***Njohja dëshmuese*** (të qenët vetë dëshmitar për të): Kjo njohje ndryshon nga grupet e mëparshme. Ajo ka lidhje me thelbin e njohurisë pa patur ndërmjetës për të kuptuar mendërisht këto dije ashtu siç është çështja e një sërë dijesh tek të cilat njeriu arrin nëpërmjet pamjeve mendore. Kjo njohje dëshmuese ndërtohet nga gabimet dhe dyshimet. Duhet theksuar, ashtu siç e sqaruam në vendin e saj, se ajo që lidhet me njohjen dëshmuese dhe gnostike, zakonisht në realitet është shpjegim mendor për gjërat që shihen, çka pranon gabimin dhe dyshimin.[2]

Llojet e botëkuptimit

Nisur nga ndarja që bëmë më sipër për diturinë, mundemi që gjithashtu të ndajmë vizionin kozmik sipas

2. Kthehu tek libri "*Ta'limu'l felsefeh*"(*Mësimi i filozofisë*), mësimi i trembëdhjetë.

grupeve të mëposhtme:

1- Botëkuptim shkencor: Njeriu nëpërmjet rrugës së diturive eksperimentale njihet me vizionin e përgjithshëm rreth krijimit.

2- Botëkuptim filozofik: Arrihet nëpërmjet argumentimit dhe studimeve mendore.

3- Botëkuptimi fetar: I cili arrihet nëpërmjet rrugës së besimit të udhëheqësve fetarë dhe besimit të njoftimeve të tyre.

4- Botëkuptim gnostik (*irfanij*): I cili arrihet nëpërmjet rrugës së zbulimit, dëshmimit dhe reflektimit.

Tani ne na mbetet të studiojmë se a mundet që çdonjëra prej këtyre rrugëve të trajtojë çështjet e vizionit kozmik, themeli i trajtimit të vërtetë i të cilit ofron zgjidhje të drejta. Po të mundemi ta vërtetojmë këtë, atëherë mundemi të kërkojmë më të mirën e saj.

Kritikë dhe vlerësim

Duke vëzhguar fushën e ngushtë dhe të kufizuar të njohjes ndijimore dhe eksperimentale, vërejmë se fusha e saj kufizohet në dukuritë materiale dhe natyrore.

Atëherë na bëhet e qartë se nuk mund të njohim bazat e botëkuptimit dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me të duke u bazuar vetëm në të dhënat e dijeve eksperimentale, sepse shembujt e këtyre çështjeve janë jashtë fushës së dijeve eksperimentale dhe juridiksionit të saj.

Asnjë prej dijeve eksperimentale nuk ka të drejtë t'i mohojë ose provojë dhe të flasë rreth këtyre çështjeve. Për shembull, ne nuk mund të provojmë ose mohojmë ekzistencën e Allahut të Madhëruar nëpërmjet eksperimenteve të kryera (*Allahu na ruajttë!*).

Shkaku është sepse hapësira e eksperimenteve të ndjeshme është e shkurtër në krahasim me shtrirjen e metafizikës, për të provuar ose mohuar diçka që është jashtë fushës së dukurive materiale.

Nga këtu vërejmë se botëkuptimi shkencor dhe eksperimental (në kuptimin e termit *botëkuptim* të cilin e përmendëm më sipër) nuk është veçse mirazh mashtrues dhe nuk mund të quhet me termin *botëkuptim* në kuptimin e tij të vërtetë. Ne mundemi ta quajmë – në supozimin më të mirë – "njohje e botës materiale". Shembulli i kësaj njohjeje nuk mund të na japë zgjidhje të drejta për çështje themelore të botëkuptimit.

Ashtu siç e përmendëm edhe më sipër, dijet dhe perceptimet që arrihen nëpërmjet rrugës së adhurimit si dhe roli i tyre është dytësor ashtu si edhe vetë vërtetimi i mëhershëm i konsideruar burim ose burime prej të cilave rrjedhin këto dije. Fillimisht është e domosdoshme që ne të vërtetojmë profetësinë e të Dërguarit, që të merren në konsideratë thirrja dhe njoftimet e tij. Por para kësaj, ne duhet të vërtetojmë ekzistencën e Dërguesit (Allahut të Madhëruar).

Është e qartë se ne nuk mund ta vërtetojmë vetëm nga fjala e vetë Profetit ekzistencën e Dërguesit dhe profetësinë e vetë të dërguarit. Ne nuk mundemi të themi, për shembull, në Kur'anin famëlartë thuhet se Allahu ekziston, pra, vërtetohet ekzistenca e Tij. Po, pasi ne të kemi vërtetuar ekzistencën e Allahut dhe kemi vërtetuar ekzistencën e profetësisë së të Dërguarit të Islamit dhe të njihemi me të, atëherë ne mund të themi edhe se Kur'ani Famëlartë është në të drejtë.

Pas gjithë kësaj, mundemi të pranojmë të gjithë besimet dytësore, mësimet obliguese (për të punuar me to), bazuar në lajmëtarin e sinqertë dhe burimin e marrë në konsideratë.

Sa i përket çështjeve themelore, është e domosdoshme vërtetimi paraprak i tyre në rrugë të tjera. Rruga adhurimore nuk është faktor në trajtimin e çështjeve themelore të botëkuptimit.

Ndërsa rreth rrugës gnostike (*irfan*) dhe iluminizmit (*ishrak*) duhet të flasim më gjatë:

Së pari: Botëkuptimi është një dije e cila përbëhet nga të kuptuarit mendor, por në botën e reale (dëshmuese) nuk ka vend për këtë fushë, të kuptuarit mendor. Nisur nga këto kup-

time, për të arritur deri tek dëshmia ndodhen disa lloje faljesh të cilat pikasen në fillimet e kuptimeve.

Së dyti: Shpjegimi i këtyre vëzhgimeve, zbulimeve dhe paraqitja e tyre nëpërmjet shprehjeve dhe kuptimeve ka nevojë për aftësi mendore të caktuara. Arritja e tyre nuk realizohet vetëm pas një ekperience të gjatë, përpjekjeve mendore dhe studimeve filozofike. Ata të cilët nuk i posedojnë këto fuqi mendore përdorin shprehje dhe kuptime të ngjashme. Ky mund të jetë një faktor i rrezikshëm i cili i çon në devijim, humbje dhe dështim.

Së treti: Në shumë raste ndoshta përngjasojnë dëshmitë e vërteta me mendimet imagjinare ose shpjegimet mendore të këtyre realiteteve. Në disa raste ndoshta paraqitet kjo përzierje dhe ngjasim edhe para vetë dëshmitarit.

Së katërti: Nuk mund të arrijmë tek të vërtetat të cilat pasqyrohen nëpërmjet shpjegimeve mendore me "botëkuptimin" vetëm pas shumë vitesh të gjata progresi dhe sjelljeje gnostike. Besimi i njeriut në udhën e progresit dhe të sjelljes e cila shprehet nëpërmjet dijeve praktike ndalet në formimin e tij mbi baza teorike dhe çështje themelore të botëkuptimit.

Pra, para fillimit të praktikimit të progresit dhe sjelljes, është i domosdoshëm trajtimi i këtyre çështjeve.

Njohja dëshmuese arrin në përfundim të këtij progresi dhe sjelljeje. Në të vërtetë është gnosa e vërtetë ajo që e bën njeriun të veprojë me vendosmëri dhe me sinqeritet në rrugën e adhurimit të Allahut të Madhëruar. Shembulli i kësaj vendosmërie dhe sjelljeje është ndalur në dijen e kahershme të Allahut të Madhëruar në rrugën e adhurimit dhe bindjes ndaj Tij.

Konkluzion

Rezultati që arrihet pas gjithë këtij studimi është se rruga e vetme për çdo studiues në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve themelore të botëkuptimit është rruga e mendjes dhe metoda

logjike. Si përfundim, vërejmë se botëkuptimi i vërtetë është botëkuptim filozofik.

Ne duhet ta dimë se kur kufizuam trajtimin e çështjeve të sipërpërmendura me rrugën e mendjes, kufizuam gjithashtu botëkuptimin me botëkuptimin filozofik. Me këtë nuk duam të tregojmë se për të arritur tek ky vëzhgim duhet të ndalemi dhe t'i trajtojmë gjithë çështjet dhe temat filozofike, por mjafton trajtimi i vetëm disa çështjeve filozofike të hapura e të përafërta në intuitë për të arritur nëpërmjet tyre tek vërtetimi i ekzistencës së Allahut të Madhëruar, e cila është çështja më e rëndësishme e botëkuptimit, edhe pse specializimi në çështje si këto dhe përfitimi i fuqisë për përballjen me këto kundërshtime e dyshime si dhe zgjidhja e tyre do të kenë nevojë për një studim të gjerë filozofik.

Gjithashtu, kur ne kufizuam perceptimet dhe dijet frutdhënëse dhe praktike për zgjidhjen e çështjeve themelore dhe trajtimin e tyre me perceptimet mendore, nuk kishim qëllim mospërpjekjen për të përfituar nga gjithë perceptimet dhe dituritë e tjera në trajtimin e këtyre çështjeve, por ne mundemi të përfitojmë shumë nga argumentet logjike nëpërmjet ca premisave me të cilat arrihet njohja ndijimore ose nëpërmjet rrugës së prekshme dhe eksperimentale.

Po ashtu, mund të përfitojmë nga njohuritë adhurimore për trajtimin e çështjeve dytësore dhe besimeve dytësore të cilat argumentohen duke u vërtetuar nga Kur'ani dhe Suneti (që janë dhe referimet e burimet e fesë). Së fundmi, pasi jemi siguruar mbi vëzhgimin kozmik dhe ideologjinë e vërtetë, mundemi që të arrijmë tek zbulimet dhe vëzhgimet nëpërmjet ecjes në etapat e sjelljes dhe progresit, pa ndërmjetësimin e koncepteve logjike në shumë të vërteta të cilat vërtetohen me argumente mendore.

Pyetje

1. Trego llojet e dijes njerëzore dhe fushat e saj?

2. Cilat janë llojet që mund të paraqiten në botëkuptim?

3. Cila është rruga që mundemi nëpërmjet saj të vërtetojmë çështjet themelore të botëkuptimit?

4. Si vlerësohet botëkuptimi shkencor?

5. Si mundemi të përfitojmë nga njohuritë eksperimentale në çështjet e botëkuptimit?

6. Si mundemi të përfitojmë nga njohuritë adhurimore në vërtetimin e çështjeve doktrinore? Cila është fusha e tyre?

7. Cili është vizioni kozmi gnostik? A mundet trajtimi i çështjeve themelore të botëkuptimit mbi bazat e dëshmisë gnostike? Pse?

Leksioni i pestë

NJOHJA E ALLAHUT

Hyrje

Sqaruam në pjesën e mësipërme se baza e fesë është besimi në ekzistencën e Zotit një, Krijuesit të gjithësisë. Gjithashtu, sqaruam se dallimi kryesor ndërmjet botëkuptimit hyjnor dhe botëkuptimit materialist është ekzistenca e këtij besimi apo mosekzistenca e tij.

Nga këtu rrjedh çështja e parë e cila paraqitet para studiuesit të së vërtetës, studiues i cili para çdo gjëje duhet të arrijë në një përgjigje të vërtetë rreth kësaj pyetjeje: A ekziston Allahu apo jo? Për të gjetur përgjigjen e kësaj pyetjeje, ashtu si e kemi përmendur dhe në leksionet e mëparshme, duhet të përdorim mëndjen që të arrijmë në një përgjigje përfundimtare dhe të vërtetë sido që të jetë ajo përgjigje, pozitive a negative

Në rast se përgjigjja është pozitive, studiuesi fillon dhe kërkon rreth çështjeve që burojnë prej saj, siç janë: monoteizimi, drejtësia dhe gjithë cilësitë hyjnore. Në qoftë se përgjigjja konsiderohet negative dhe vërtetohet teoria kozmike materialiste, atëherë nuk është e nevojshme që të studiohen çështjet e tjera që lidhen me fenë.

Njohja ekzistenciale (*ma'rife hudurije*) dhe njohje e përftuar (*ma'rife husulije*)

Mund të imagjinohen dy lloje të njohjes së Allahut:

E para: Njohja ekzistenciale (e dëshmuar).

E dyta: Njohja e përftuar.

Njohje ekzistenciale (e dëshm**uar)** do të thotë që *njeriu ta njohë Zotin nëpërmjet një ndjenje të brendshme a dëshmie të zemrës pa ndërmjetësinë e koncepteve logjike.*

Është mëse normale që njeriu të zotërojë këtë dëshmi ndijimore (të dallueshme ose të vetëdijshme) përsa i përket Allahut të Madhëruar – ashtu si pretendohet nga gnostikët e mëdhenj – njeriu nuk ka nevojë për argumente dhe argument logjik. Por siç e theksuam më sipër, dituria e transmetuar nuk është e mundshme për njerëz të zakonshëm.[1]

Para se të vlerësohet me rëndësinë e edukimit e ngritjes të vetes së tij dhe kalimin e fazave të progresit dhe sjelljes mirënjohëse. Sa i përket shkallëve të dobëta të kësaj dije, ajo edhe në qoftë se gjendet tek njerëzit e zakonshëm gjithashtu nuk është e ndjeshme dhe e vetëdijshme. Ky është shkaku që e vetme e ka të pamundur të arrijë tek botëkuptimi ndjesor dhe i vetëdijshëm.

Njohje e përftuar do të thotë që *njeriu, nëpërmjet disa koncepteve të përgjithshme (si p.sh.: Krijuesi është Ai që zotëron botën me çdo gjë dhe ka mundësi për çdo gjë) të arrijë në njohje ndijimore të fshehtë; pra, të besojë në ekzistencën e Allahut dhe Qenien e Tij të Lartësuar në kufijtë e këtyre të dhënave, (pra, që Allahu është Krijuesi i gjithësisë), duke i shtuar edhe njohuri të tjera të dijes së përfituar ku nëpërmjet saj të arrijë* në një sistem doktrinor harmonik (*botëkuptimi).*

Ajo që arrihet drejtpërsëdrejti nga hulumtimet mendore dhe të dhënat e argumenteve filozofike quhet njohje e përftuar. Kur mendja njerëzore arrin që të disponojë dijen e përfituar mundet që të arrijë nëpërmjet saj tek njohja e dëshmuar, ndijimore dhe e vetëdijshme.

---

1. Është mëse e natyrshme se ne nuk mundemi të mohojmë ekzistencën e disa personave të dalluar dhe të veçantë të cilët posedojnë këto dëshmi të ndjeshme, ashtu si besojmë në të drejtën e profetëve dhe imamëve të pagabueshëm (*paqja qoftë mbi ta!*). Ata dalloheshin me një lloj dëshmie që në fëmijërinë e tyre, aq sa disa prej tyre e posedonin këtë dëshmi që në djep.

Njohja e natyrshme (*ma'rife fitrije*)

Shpesh ne ndeshim këtë shprehje në tregimet e udhëheqësve fetarë, të diturve dhe të mençurve si "Njohja e Allahut është e natyrshme" ose "Natura e njeriut e njeh Allahun". Për të njohur më mirë kuptimin e vërtetë të kësaj shprehjeje duhet që të sqarojmë termin "natyrshmëri" (*fitrah*).

Natyrshmëri (*fitrah*) është fjalë arabe dhe kuptimi i saj është natyrë, shfaqje, instinkt. Gjërat të cilat janë të lidhura me të, pra që kthehen tek ajo dhe quhen instinkte, ekzistojnë në natyrën e krijesave. Ne mund të dallojmë tri cilësi tek instinktet:

1- Instinktet janë të përbashkëta tek të gjitha llojet e krijesave edhe në qoftë se ndryshojnë në ekzistencën e tyre tek njerëzit ku disa janë më të forta e disa më të dobëta.

2- Instinktet janë të qëndrueshme gjithmonë përgjatë gjithë historisë. Nuk mundet që instinktet të ekzistojnë në një periudhë të caktuar dhe mos të ekzistojnë në një periudhë tjetër.[2]

3- Instinktet ekzistojnë që nga krijimi. Kjo e bën të panevojshme që t'i mësosh apo të t'i mësojnë. Ato mund të kenë nevojë për zhvillimin, forcimin, drejtimin dhe udhëzim.

Ne mund t'i ndajmë instinktet njerëzore në dy grupe:

a - Instinkte dhe perceptime të natyrshme të cilat i zotëron çdo njeri, pa patur nevojë që t'i mësojë ato.

b- Instinkte (preferenca, dëshira) të cilat janë të mbjella te çdo njeri.

Nga këtu vërtetohet se çdonjëri e njeh në njëfarë mënyre Allahun pa patur nevojë për ta mësuar atë. Ne mundemi që ta quajmë "njohje e natyrshme e Allahut". Në qoftë se vërtetohet ekzistenca e një lloj orientimi për tek Allahu dhe adhurimi i Tij, mundemi ta quajmë "adhurim i natyrshëm i Allahut"ose "fetari e natyrshme"

2. **"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut."** (Surja Er-Rum, ajeti 30.)

Në leksionin e dytë ne kemi theksuar se shumë nga mendimtarët e konsiderojnë fetarinë dhe orientimin kah Allahu e feja nga veçoritë psikologjike të njeriut dhe i kanë thirrur ato me emrin "ndjenja fetare" ose "emocione fetare". Këtu mund të shtojmë se njohja e Allahut është konsideruar, gjithashtu, nga kërkesat natyrore të njeriut. Por duhet theksuar se ashtu siç nuk është motivi natyror për adhurimin e Allahut nga motivet emocionale, gjithashtu edhe motivi natyror për njohjen e Tij është një motiv jo emocional.

Njerëzit e zakonshëm mjaftohen me hulumtimin mendor rreth njohjes së Allahut.

Është e domosdoshme që të mos nënvlerësojmë një fakt shumë të rëndësishëm: meqë tek çdonjëri nga njerëzit e zakonshëm ekziston një shkallë njohjeje e përftuar e këtij besimi - sado e dobët të jetë - atëherë çdokush mundet të besojë në ekzistencën e Allahut duke medituar dhe argumentuar, duke e njohur dhe rritur gradualisht dijen e tij joemocionale, derisa të arrijë në fazat emocionale.

Ajo që ne përfitojmë nga njohja e natyrshme e Allahut është që zemra e njeriut e njeh Allahun. Thellë në brendësi të shpirtit të tij ekzistojnë rrënjë dhe dëshira emocionale për njohjen e Allahut, rrënjë që janë të gatshme për t'u rritur dhe forcuar por tek njerëzit e thjeshtë nuk kanë atë fuqi që t'i kënaqë plotësisht në mendimet, meditimet dhe argumentet e tyre logjike.

Pyetje

1. Cila nga çështjet e botëkuptimit është çështje themelore bazë? Për ç'shkak është çështje themelore?

2. Sqaro njohjen e dëshmuar dhe njohjen e përftuar në njohjen e Allahut?

3. A mund ta arrijmë në njohjen e dëshmuar nëpërmjet rrugës së argumenteve logjike?

4. Cili është roli i njohjes së përftuar dhe ndikimi i saj në njohjen e dëshmuar?

5. Sqaro kuptimin natyrshmëri?

6. Shpjego cilësitë e natyrshmërisë?

7. Trego degët e natyrshmërisë?

8. Cila është çështja e natyrshmërisë që lidhet me Allahun?

9. Sqaro njohjen e natyrshme të Allahut?

10. A mundet që njohja e natyrshme e Allahut të kënaqë njerëzit e zakonshëm pa argumentet mendore? Pse?

Leksioni i gjashtë

RRUGA E LEHTË PËR NJOHJEN E ALLAHUT

Mënyrat e njohjes të Allahut

Ekzistojnë disa mënyra të ndryshme për njohjen e Allahut të cilat përmenden në librat e ndryshëm të filozofisë dhe teologjisë, në tregimet e shumta të imamëve të fesë, gjithashtu përmenden dhe në librat qiellorë.

Këto janë fakte dhe argumente të ndryshme e të shumta dhe në aspekte të shumëllojshme që ndodhen në mesin tonë. Disa prej tyre i kemi përftuar nga prezantimet e provuara shkencërisht kurse disa të tjera formohen nga hulumtimet e sinqerta mendore. Një pjesë e tyre kanë për qëllim provimin e ekzistencës së Allahut, Sunduesit në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ndërkohë që pjesa tjetër ka për qëllim provimin e Qënies të Tij e cila nuk ka nevojë në ekzistencën e Tij për qënie tjetër, pra "Ekzistent i domosdoshëm" (*Vaxhibu'l vuxhud*). Nën dritën e këtij argumenti del e domosdoshme që të mbështetemi në fakte dhe argumente të tjera për të vërtetuar Cilësitë e Tij të larta.

Ne mundemi që të bëjmë një krahasim të thjeshtë. Në një aspekt, argumentet dhe faktet për ekzistencën e Allahut i përngjasojnë rrugëve dhe urave që ndodhen mbi lumenjtë e mëdhenj të cilat shërbejnë për të kaluar nga njëri breg në tjetrin. Disa prej tyre, si urat e thjeshta të drurit, janë vendosur për të kaluar në to një njeri i lehtë në mënyrë që të arrijë shpejt në destinacionin e tij, ndërsa disa të tjera janë të gjata prej guri, janë të fuqishme dhe rezistojnë për një kohë të gjatë. Por janë edhe disa të tjera prej hekuri, si hekurudha, të cilat janë dredha-dredha dhe përshkojnë kodra, fusha dhe tunele të gjatë që

janë bërë për të ecur trena të rëndë mbi to.

Njeriu i cili posedon një intelekt të thjeshtë mund ta njohë Zotin e tij nëpërmjet rrugëve shumë të thjeshta; pas kësaj ai vazhdon në adhurimin dhe nënshtrimin ndaj Allahut. Ai i cili e ka të mbushur trurin e tij me dyshime të rënda duhet ta përshkojë atë rrugën e gurtë. Për sa i përket atij të cilit është i ngarkuar me pesha të rënda dhe të shumta nga dyshimet dhe vesveset, ai e ka të domosdoshme që të ndjekë atë rrugën me baza të forta edhe në qoftë se gjenden në rrugë sfida, vështirësi dhe dredha.

Ne këtu do të tregojmë rrugën e lehtë e të thjeshtë për njohjen e Allahut dhe pas kësaj do të paraqesim disa rrugë dhe argumente mesatare. Ndërsa përsa i përket rrugëve dhe argumenteve të vështira të cilat bazohen në trajtimin dhe kuptimin e shumë bazave filozofike, janë për ata të cilët në mendjet e tyre ka shumë dyshime ose kanë për qëllim trajtimin e dyshimeve dhe shpëtimin e të humburve dhe të devijuarve.

Veçoritë e rrugës së lehtë

Për të treguar rrugën e lehtë dhe për ta përfocuar me argumente ekzistencën e Allahut të Madhëruar po theksojmë veçoritë e saj.

Më të rëndësishmet ndër to mund të theksojmë:

1- Kjo rrugë nuk ka nevojë për parashtrime të vështira, të ndërlikuara dhe artistike. Mundet parashtrimi i kësaj rruge me një metodologji të thjeshtë e të qartë për të gjithë njerëzit me nivele të ndryshme kulturore dhe të kuptuari.

2- Kjo rrugë e përball njeriun në mënyrë të drejtpërdrejtë me Allahun, Krijuesin, të Gjithëdijshmin dhe të Gjithëpushtetshmin, në ndryshim me shumë fakte dhe argumente filozofike dhe teologjike të cilat fillimisht vërtetojnë Ekzistentin, që cilësohet si Ekzistent i domosdoshëm. Për këtë është e domosdoshme mbështetja në argumente të tjera për të përforcuar Dijen e Tij, Fuqinë e Tij, Urtësinë e Tij, Krijueshmërinë e Tij,

Sundimin e Tij dhe gjithë Cilësitë e tjera të Tij.

3- Rëndësia e kësaj rruge dhe roli i saj para çdo gjëje është shpëtimi i natyrshmërisë, marrja në dorë e dijes së natyrshme dhe prurja e saj tek bota e mendjes dhe e ndjenjave. Në qoftë se njeriu do të meditojë rreth elementeve të kësaj rruge do të jetonte një jetë gnostike, sikur do të shikonte fuqinë e Allahut në planifikimin e dukurive dhe ndodhive kozmike dhe përcaktimin e tyre. Është pikërisht ajo fuqi që njeh natyrshmëria në brendësinë e saj.

Për shkak të këtyre veçorive dhe dallimeve e përzgjodhën udhëheqësit fetarë dhe kujdestarët e feve qiellore këtë argument për ta paraqitur para njerëzve. Ata i mbështetën të gjithë njerëzit për të ecur në këtë rrugë. Disa nga pasuesit e tyre i veçuan disa veçori në metoda dhe argumente të ndryshme, ose i përdorën në polemikat dhe debatet e tyre me dijetarët ateistë dhe filozofët materialistë.

Argumentet e qarta

Kjo është një rrugë e lehtë për të argumentuar ekzistencën e Allahut të Madhëruar. Ajo bazohet në meditimin e argumenteve të Allahut dhe fakteve të Tij, argumente të cilave u gëzohet kjo botë e gjerë, ashtu siç edhe shprehet në Kur'anin famëlartë "meditim në argumentet e Allahut".

Ashtu sikurse çdonjëra nga dukuritë e gjithësisë në Tokë, në qiell dhe në ekzistencën e njeriut është argument dhe fakt për qëllimin e thirrur, si dhe një kërkesë e njohur e cila buron nga zemra në drejtim të qendrës së ekzistencës në çdo vend dhe kohë.

Ky libër që ke në duar është fakt dhe argument për të. A nuk njihesh nëpërmjet leximit të tij me ekzistencën e autorit dhe qëllimin e tij? A ke menduar ndonjë ditë se ky libër është rezultat i bashkimit të veprimeve dhe ndikimeve materiale pa patur një autor që e ka patur për qëllim?

A nuk është çmenduri dhe injorancë të mendosh se një

enciklopedi që përmblidhet në qindra vëllime është gjendur si rezultat i shpërthimit metalik dhe pas kësaj janë transformuar grimcat e saj në shkronja, u bashkuan rastësisht dhe në mënyrë të rregullt në disa faqe letre për të formuar shkrimet?! Pas kësaj u bashkuan këto fletë në mënyrë krejt rastësore për të formuar vëllimet në mënyrë të rregullt?!

Ky besim i verbër tek rastësia në shpjegimin e krijimit të gjithësisë së madhe e të pamatë, me gjithë çfarë mban në të nga fshehtësitë dhe ligjet e njohura e të panjohura është çmenduri dhe injorancë një mijë herë më e madhe se shpjegimi i librit si dukuri nga dukuritë e rastësisë.

Po. Çdo sistem që ka një qëllim është argument mbi Rregullatorin. Ne shohim këto sisteme në të gjitha anët e gjithësisë. Ato të gjitha janë sisteme të plota që tregojnë për një Krijues të Urtë, i Cili është i përhershëm që drejton dhe udhëheq çdo gjë. Që nga dega e trëndafilit që lartësohet në kopësht ndërmjet dheut dhe plehut, me lulet e ndryshme të bukura dhe aromën kundërmuese. Pema e mollës e cila del nga farat e vogla dhe prodhon çdo vit kokrra të shumta me ngjyra të ndezura, aromë të këndshme dhe shije të shijshme. Kështu bëjnë të gjitha pemët e tjera me forma, ngjyra dhe veçori të ndryshme. Po bilbili i këngëtar që kalon degë më degë, po zogu i cili del nga veza dhe ecën në tokë, po viçi i porsalindur i cili fillon e pi nga gjiri i nënës së tij, po qumështi që ka mbushur gjirin e nënës së tij, kush e përgatiti për të pirë të porsalindurin e ri…?! Të gjitha këto janë argumente.

Është e vërtetë se të gjitha këto të bëjnë të habitesh… Është një rregullsi që të bën të çuditesh… Si shfaqet vallë qumështi në gjoksin e nënave në të njëjtën kohë me lindjen e foshnjeve të tyre?! Po peshqit që përshkojnë çdo vit kilometra të tërë për herë të parë, me qëllim që të vendosin vezët e tyre?! Po zogjtë shtegtarë që nuk gabojnë asnjëherë në udhëtimet e tyre?! Po tufat e bletëve të cilat dalin çdo mëngjes nga kosheret e tyre duke përshkruar hapësira të gjata për të përfituar nga lulet e ndryshme e që kthehen natën në kosheret e tyre…?!

Këto të gjitha janë argumente.

Më e çuditshme nga kjo është se bletët, lopët dhe dhentë japin përherë e më shumë mjaltë dhe qumësht se ç'është e nevojshme, për të përfituar njeriu, kjo krijesë e dalluar dhe e veçantë!!! Por njeriu që është mosmirënjohës e mohon Begatuesin, polemizon rreth Tij dhe e lufton Atë!!!

Po të vështrojmë trupin e njeriut, vërejmë shumë argumente të cilat tregojnë urtësinë dhe të bëjnë të reflektosh, mahnitesh dhe çuditesh. Trupi përbëhet nga organe në harmoni me njëra-tjetrën. Çdo organ përbëhet nga pjesë të përshtatura pr funksionin e tyre. Çdo organ përbëhet nga miliona qeliza të gjalla të veçanta, megjithëse ato e kanë prejardhjen nga një qelizë e njëjtë që është qeliza mëmë. Çdo qelizë përbëhet nga elementë të nevojshëm me përmasa e të dhëna të ndryshme.

Çdo organ është vendosur në trup në vendin e përshtatshëm për të luajtur rolin e tij në organizëm. P.sh. thithja e oksigjenit nga mushkëritë dhe lëvizja e tij në trup nëpërmjet rruazave të kuqe të gjakut, prodhimi i sheqerit në mëlçi bëhet në masën e nevojshme, rigjenerimi i lëkurës së dëmtuar dhe ndërrimi i qelizave të dëmtuara me të reja, luftimi i mikrobeve, viruseve dhe armiqve të cilët sulmojnë trupin nëpërmjet rruazave të bardha, hormonet e ndryshme të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në veprimtarinë jetike të organizmit... Të gjitha këto janë argumente.[1]

Kush është ai që e ngriti këtë sistem të çuditshëm e të mahnitshëm?! Këtë sistem të cilin mijëra dijetarë përgjatë dhjetra shekujsh nuk kanë mundur t'ia zbulojnë të fshehtat? Çdo qelizë përbën një sistem të vogël. Çdo grup qelizash formojnë një organ nga organet dhe përbëjnë një sistem më të madh. Këto grupe sistemesh të shumta e të ndryshme përbëjnë atë sistemin e madh, të plotë, të përgjithshëm që është

1. Për t'u zgjeruar më tepër rreth këtyre të dhënave e të vërtetave, kthehu tek libri "*Allahu jetexhel'la fi 'asri'l 'ilm*" (*Allahu shfaqet madhërishëm në epokën e dijes*).

trupi. Çështja nuk përfundon këtu. Këto sisteme të panumërta të cilat nuk llogariten në gjallesat e gjalla dhe jo të gjalla përbëjnë sistemin e madh të gjithësisë e cila është bota e natyrës e drejtuar nga një Zot i Gjithëpushtetshëm, i Urtë. **"Ky është Allahu. Atëherë, përse i largoheni Atij?"**[2]

Është e natyrshme se njohuritë njerëzore shtohen dhe zgjerohen. Gjithashtu, zbulimi i më shumë ligjeve dhe marrëdhënieve ndërmjet dukurive natyrore zbardh më tepër të fshehtat dhe fuqinë e krijimit, por meditimi dhe të menduarit rreth këtyre dukurive të thjeshta dhe argumenteve të qarta është i mjaftueshëm për zemrën e pastër e të pandotur.

Pyetje

1. Trego rrugët e ndryshme që vërtetojnë ekzistencën e Allahut dhe cilësitë e çdonjërës prej tyre.

2. Cila është rruga e lehtë që vërteton ekzistencën e Allahut dhe cilat janë cilësitë dhe veçoritë e saj?

3. Sqaro argumentet dhe shenjat që kanë për qëllim dukuritë?

4. Trego formën logjike të argumentit të sistemit.

2. Sure "El-En'am", ajeti 95.

Leksioni i shtatë

VËRTETIMI I EKZISTENTIT TË DOMOSDOSHËM (*Vaxhibu'l vuxhud*)

Hyrje

Në mësimin e kaluar treguam se teozofët dhe teologët (kelamistët) ngritën argumente të shumta mbi vërtetimin e ekzistencës së Allahut të Madhëruar. Ato janë përmendur gjerësisht në librat e filozofisë dhe teologjisë. Ne këtu po përmendim një argument të vetëm i cili bazohet në më pak premisa, por ai është i logjikshëm, i qëndrueshëm dhe më i afërt me arsyen. Do të përpiqemi që ta sqarojmë atë, por është e domosdoshme të theksojmë se ai është një argument që e vërteton ekzistencën e Allahun me titullin: "Ekzistent i domosdoshëm". Pra, Ai ekziston dhe ekzistenca e Tij është e domosdoshme dhe nuk ka nevojë për ekzistenca të tjera. Ndërsa, përsa i përket cilësive të Tij provuese, dëshmuese (si Dija dhe Fuqia) dhe mohuese (si ekzistenca e Tij jo në formë trupore e fizike, mosqënia e Tij në një vend dhe kohë të caktuar). Ky argument nuk e merr përsipër këtë por është i domosdoshëm vërtetimi i tij me argumente të tjera.

Formulimi i argumentit

Ekzistenti - sipas supozimit logjik - ndahet në ekzistent i domosdoshëm (*vaxhibu'l vuxhud*) ose në ekzistent i mundshëm (*mumkinu'l vuxhud*). Logjikisht, asnjë ekzistent nuk mund të dalë jashtë këtyre dy supozimeve.

Ne nuk mund t'i konsiderojmë të gjithë ekzistentët si të

mundshëm, sepse ekzistenti i mundshëm ka nevojë për shkak (*'il-leh*) dhe në qoftë se çdo shkak është ekzistent i mundshëm dhe ai do të ketë nevojë për një shkak tjetër, atëherë absolutisht nuk do të gjendej asnjë ekzistent. Pra, zinxhiri i vazhdimësisë së shkaqeve (*teselsulul 'ilel*) është i pamundur (*muhal*). Kësisoj, mbetet i domosdoshëm përfundimi i zinxhirit të shkaqeve tek një ekzistent që nuk është pasojë e një ekzistenti tjetër, pra, të Ekzistentit të domosdoshëm (*vaxhibu'l vuxhud*).

Ky argument është argumenti më i lehtë filozofik për të vërtetuar ekzistencën e Allahut. Ai është formuluar nga disa premisa të prera logjike dhe nuk ka nevojë për asnjë premisë të prekshme apo eksperimentale. Por meqenëse në këtë argument janë përdorur disa terma dhe koncepte filozofike, na mbetet si detyrë sqarimi i këtyre termave dhe premisave të cilat përbëjnë këtë argument.

E mundshmja (*imkan*) dhe e domosdoshmja (*vuxhub*)

Çdo çështje, sado e thjeshtë të jetë, përbëhet më së paku nga dy koncepte kryesore: subjekti, boshti (*meudu'*) dhe sqaruesi (*mahmul*). Për shembull fjalia "*Dielli rrezaton.*" përbëhet nga *dielli* që është boshti dhe *rrezaton* që është sqarues.

Sqaruesi që vërteton boshtin a subjektin duhet domosdoshmërisht të jetë pjesë e një prej këtyre gjendjeve:

- Është i pamundur (*muhal*), si p.sh. "Numri 3 është më i madh se numri 4"
- Është i nevojshëm (*darurij*), si p.sh. "2 është gjysma e 4"
- Nuk është as i pamundur dhe as i nevojshëm, si p.sh. "Dielli është sipër kokave tona".

Në logjikë termi që përdoret për rastin e parë është "moslejim" (*imtina'*), në rastin e dytë është "nevojë" (*darurah*) ose "domosdoshmëri" (*vuxhub*), ndërsa në rastin e tretë është "mundshmëri" (*imkan*) – në kuptimin e veçantë.

Meqenëse filozofia studion ekzistentin dhe duke qenë se i pamunduri (*muhal*) nuk ekziston, atëherë filozofët e ndajnë

ekzistentin – sipas supozimit logjik - në ekzistent të domosdoshëm (*uaxhib*) dhe ekzistent të mundshëm (*mumkin*).

Ekzistenti i domosdoshëm: Është shprehje e ekzistentit që ekziston me veten e tij (vetvetiu) pa patur nevojë për ekzistent tjetër. Natyrisht, ky ekzistent është pa fillim (*ezelij*) dhe pa mbarim (*ebedij*). Një gjë që ka qenë joekzistente (*ma'dum*) në një kohë të caktuar tregon se ekzistenca e saj nuk është vetvetiu, por ka patur nevojë për ndihmën e një ekzistenti tjetër. Ky është shkaku (*sebeb*) ose kushti (*shart*) në realizimin e ekzistencës së saj. Me humbjen e ekzistecës tjetër humbet edhe vetë ajo dhe asgjësohet.

Ekzistenti i mundshëm: Nënkuptojmë ekzistentin që nuk mund të ekzistojë i vetëm a vetvetiu pa ndihmë tjetër. Ekzistenca e tij varet nga ekzistenca e dikujt tjetër dhe ndalet po nga ai.

Kjo ndarje që ngrihet mbi bazat e supozimit logjik, e mohon domosdoshmërisht ekzistencën e "ekzistentit të pamundur" (*mumteni'ul vuxhud*), por nuk tregon për ekzistuesit e jashtëm se te cila ndarje nga dy ndarjet e mësipërme bën pjesë, te *vaxhibu'l vuxhud* apo *mumkinu'l vuxhud*. Thënë ndryshe, mund ta përfytyrojmë vërtetësinë e kësaj çështjeje në tri forma:

1- Çdo ekzistent është ekzistent i domosdoshëm.

2- Çdo ekzistent është ekzistent i mundshëm.

3- Disa ekzistentë janë ekzistentë të domosdoshëm dhe disa janë ekzistentë të mundshëm.

Sipas supozimit të parë e të tretë vërtetohet ekzistenca e ekzistentit të domosdoshëm. Tani duhet të kërkojmë rreth këtij supozimi: A mundet që të gjithë ekzistentët të jenë të mundshëm apo jo? Në qoftë se ne kemi mundësi ta kundërshtojmë dhe ta hedhim poshtë këtë supozim, atëherë vërtetohet në formë të prerë dhe përfundimtare ekzistenca e Ekzistentit të domosdoshëm, edhe në qoftë se do të duhen fakte dhe argumente të tjera për njësimin e Tij dhe gjithë cilësitë e Tij.

Për të hedhur poshtë supozimin e dytë, duhet që ne të

shtojmë një premisë tjetër mbi argumentin e përmendur. Ajo është: Pamundësia (*istihale*) për të qenë të gjithë ekzistentët ekzistentë të mundshëm. Por kjo premisë nuk është një aksiomë. Prandaj për të vërtetuar dhe komentuar këtë premisë thuhet si vijon: Çdo ekzistent i mundshëm (*mumkinu'l vuxhud*) ka nevojë për shkak (*'il-leh*) dhe vazhdimësia e zinxhirit të shkaqeve (*teselsulu'l 'ilel*) është e pamundur (*muhal*). Por zinxhiri i shkaqeve detyrimisht duhet të përfundojë tek një ekzistent që të mos jetë ekzistent i mundshëm dhe që të mos ketë nevojë për një shkak, pra tek një ekzistent i domosdoshëm (*vaxhibu'l vuxhud*). Prandaj në këtë argument hyjnë disa koncepte të tjera filozofike të cilat ne do t'i sqarojmë më poshtë.

Shkaku (*'l-leh*) dhe pasoja (*ma'lul*)

Në qoftë se një ekzistent ka nevojë për një ekzistent tjetër dhe që për ekzistencën e tij duhet të mbështetet tek një ekzistent tjetër, në terminologjinë filozofike ky ekzistent që ka nevojë (*muhtaxh*) quhet "pasojë" (*ma'lul*), ndërsa tjetri quhet "shkak" (*'il-leh*). Shkaku (*'il-leh*) mund të mos jetë i pavarur (*mustegnijeh*) në mënyrë absolute, madje mund të jetë nevojtar (*muhtaxheh*) tek një ekzistent tjetër. Por nëse shkaku nuk do të ishte nevojtar dhe në të nuk do të ndodhej ndonjë pasojë shkakësore (*ma'lulijeh*), ai do të ishte "shkak absolut" (*'il-leh mutlakah*), si rrjedhojë do të ishte i pavarur absolut.

Deri këtu jemi njohur me termat filozofikë *shkak* e *pasojë* (*'il-leh ue ma'lul*) dhe përkufizimet e tyre. Tani ne do të qartësojmë këtë premisë: "Çdo ekzistent i mundshëm ka nevojë për një shkak (sjellës në ekzistencë)".

Duke patur parasysh se ekzistenti i mundshëm nuk gjendet (nuk vjen në ekzistencë) vetvetiu dhe se ardhja e tij në ekzistencë varet detyrimisht nga një ekzistent apo disa ekzistentë të tjerë, kauza (çështja) vijuese është çështje intuitive (aksiomë): Çdo sqarues (*mahmul*) i referohet një subjekti (*meudu'*) dhe e vërteton atë ose vetë ose për ndonjë shkak tjetër, p.sh.

çdo gjë ose ndriçon vetë, ose ndriçon nëpërmjet diçkaje tjetër, dritës; dhe çdo trup është i yndyrshëm ose vetë ose nëpërmjet diçkaje tjetër, dhjamit. Ndërsa, nëse diçka nuk është as e ndritshme e as e yndyrshme në vetvete dhe as nëpërmjet diçkaje tjetër - siç janë drita e dhjami -, është e pamundur që ajo gjëja të cilësohet si e ndritshme apo e yndyrshme!

Pra, vërtetimi i ekzistencës së një objekti është ose vetvetiu ose me ndihmën e diçkaje tjetër dhe në qoftë se nuk bëhet vërtetimi i ekzistenës së objektit vetvetiu, atëherë duhet të bëhet me ndihmën e dikujt tjetër. Nën dritën e kësaj, çdo ekzistent i mundshëm që nuk vjen në ekzistencë vetvetiu patjetër ekziston me ndihmën e një ekzistenti tjetër dhe është i varur me varësi shkakësie (*ma'lul*) nga ai. Kjo është rregulla e pranuar logjike: "Çdo ekzistent i mundshëm ka nevojë për një shkak (sjellës në ekzistencë)".

Porse disa pretendojnë se ligji i shkakësisë thotë se çdo ekzistent ka nevojë për një shkak. Mbi këtë bazë pretendojnë se është e domosdoshme që të ketë një shkak edhe për Allahun e Madhëruar. Ata janë të pavëmendshëm ndaj faktit se objekti i ligjit të shkakësisë (*kanunu'l 'il-lijjeh*) nuk është çdo ekzistent në mënyrë absolute, por objekti i këtij ligji është ekzistenti i mundshëm (*mumkinu'l vuxhud*) dhe i varuri nga shkaku apo pasoja (*ma'lul*), pra, çdo ekzistent i varur e nevojtar që ka nevojë për një shkak, jo çdo ekzistent në mënyrë absolute.

Pamundësia e zinxhirit të shkaqeve

Premisa e fundit që u përdor në këtë argument është: *Zinxhiri i shkaqeve duhet të përfundojë detyrimisht tek një ekzistent që është i pavarur vetvetiu.* Ose siç është përdorur në terminologji: "Zinxhiri i shkaqeve (*teselsulu'l 'ilel*) deri në pafundësi (*ila ma la nihaje*) është i pamundur (*muhal*)". Nën dritën e kësaj vërtetohet ekzistenca e Ekzistentit të domosdoshëm (*Vaxhibu'l vuxhud*) dhe Ai është Shkaku i Parë që ekziston vetvetiu dhe nuk ka nevojë për dikë tjetër që të ekzistojë.

Filozofët kanë përmendur argumente të shumtë për ta kundërshtuar zinxhirin e shkaqeve dhe për ta hedhur poshtë atë. Në të vërtetë, hedhja poshtë e këtij zinxhiri në fushën e shkaqeve është më pranë intuitës. Njeriu e dallon atë me meditimin më të thjeshtë, pra duke vërejtur se ekzistenca e pasojës ka nevojë për shkakun dhe është e kushtëzuar nga ekzistenca e tij. Në qoftë se do të supozojmë se kjo shkakësi dhe ky kushtëzim është i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, atëherë nuk do të ekzistonte asnjë ekzistent, sepse nuk mund të pranohet logjikisht supozimi i ekzistencës së një zinxhiri ekzistentësh të ndërlidhur pa ekzistencën e një ekzistenti tjetër që përfaqëson skajin që i lidh ato.

Le të supozojmë një skuadër në garën e vrapimit. Të gjithë anëtarët e saj janë vendosur në vijën e nisjes në gatishmëri për të vrapuar. Çfarë do të ndodhte sikur çdonjëri prej anëtarëve të skuadrës të ketë vendosur në veten e tij se nuk do ta nisë garën pa filluar shoku i tij? Po të jetë ky një vendim i përbashkët i të gjithëve? Asnjëri prej tyre nuk ka për ta nisur vrapin dhe kështu nuk ka për t'u realizuar gara e vrapimit në mënyrë absolute. E njëjta gjë ndodh edhe në qoftë se ekzistenca e çdo ekzistenti është e varur nga realizimi i ekzistencës së një ekzistenti tjetër. Asnjëherë nuk do të kishim ndonjë ekzistent. Si përfundim, realizimi i ekzistencës së ekzistencave të jashtme është argument për ekzistimin e një ekzistenti që është i pavarur dhe i pakushtëzuar.

Sqarimi i argumentit

Tani, nën dritën e premisave të sipërcituara i rikthehemi edhe një herë sqarimit të këtij argumenti.

Çdo gjë që mundemi ta konsiderojmë ekzistuese nuk mundet të dalë jashtë këtyre dy gjendjeve:

• Ose ekzistenca e tij është e domosdoshme dhe ekziston vetvetiu apo siç njihet me termin "Ekzistent i domosdoshëm" (*Vaxhibu'l vuxhud*).

• Ose ekzistenca e tij është jo e domosdoshme, por e varur nga një ekzistent tjetër apo siç njihet me termin "ekzistent i mundshëm" (*mumkinu'l vuxhud*).

Është e natyrshme se, nëse realizimi i diçkaje do të ishte i pamundur, atëherë nuk do të ekzistonte absolutisht dhe nuk mund ta konsideronim kurrë ekzistent. Pra, çdo ekzistent është ose "ekzistent i domosdoshëm" (*Vaxhibu'l vuxhud*) ose "ekzistent i mundshëm" (*mumkinu'l vuxhud*).

Nëse do të përqendroheshim saktësisht në termin "ekzistent i mundshëm" do të na bëhej e qartë se gjëja e cila i nënshtrohet këtij koncepti, medoemos është pasojë dhe nevojtare e një shkaku, sepse ekzistenti që nuk ekziston vetvetiu medoemos vjen në ekzistencë nëpërmjet një ekzistenti tjetër, ashtu si çdo atribut (cilësi) nuk mund të përshkruhet vetvetiu, por duhet të përshkruhet nëpërnjet diçkaje tjetër. Ky është koncepti i parimit të shkakësisë: Çdo ekzistent i varur dhe i mundshëm ka nevojë për një shkak dhe jo çdo ekzistent ka nevojë për një shkak. Kjo, që të mos thuhet se Allahu ka nevojë për një shkak apo të thuhet se besimi në një Zot që nuk është sjellë në ekzistencë nga një shkak, është shkatërrim i ligjit të shkakësisë!!!

Nga ana tjetër, në qoftë se çdo ekzistent do të ishte i mundshëm dhe nevojtar për një shkak, atëherë nuk do të gjendej asnjë ekzistent. Kjo është e njëjtë me atë që theksuam më sipër në lidhje me anëtarët e skuadrës së vrapimit, ku çdonjëri kishte marrë vendim të mos e niste vrapimin derisa shoku i tij ta fillonte. Në këtë rast, nuk do të realizohej vrapimi në mënyrë absolute. Si përfundim, ekzistenca e ekzistentëve të jashtëm është argument për ekzistencën e Ekzistentit të domosdoshëm (*Vaxhibu'l vuxhud*).

Pyetje

1. Sqaro termin logjik dhe filozofik për mundshmërinë (imkan) dhe domosdoshmërinë (vuxhub)?

2. Përkufizo "Ekzistentin e domosdoshëm" dhe "ekzistentin e mundshëm"?

3. Cilat janë hipotezat të cilat mund të supozohen për ndarjen logjike të ekzistentit në "Ekzistent të domosdoshëm" dhe "ekzistent të mundshëm"?

4. Përkufizo shkakun ('l-leh) dhe i pasojën (ma'lul)?

5. Çfarë tregon ligji i shkakësisë?

6. Përse ka nevojë për një shkak "ekzistenti i mundshëm"?

7. A nënkupton ligji i shkakësisë që për ekzistencën e Allahut të ketë shkak? Dhe përse?

8. Besimi në një Zot të pakrijuar, a është shkatërrim i parimit të shkakësisë?

9. Sqaro pamundësinë e zinxhirit të shkaqeve?

10. Trego formën logjike të këtij argumenti dhe sqaro me imtësi mendimin të cilin ka për qëllim përforcimi i saj?

Leksioni i tetë

CILËSITË E ALLAHUT

Hyrje

Përmendëm në leksionin e kaluar se treguesi i shumë prej argumenteve filozofikë është vërtetimi i ekzistencës së një ekzistenti që titullohet "Ekzistent i domosdoshëm" (*Vaxhibu'l vuxhud*) dhe duke shtuar edhe argumentet e tjera vërtetohen Cilësitë e Tij mohuese (*selbije*) e vërtetuese (*thubutije*). Nëpërmjet gjithë këtyre argumenteve njihemi me Allahun e Madhëruar dhe Cilësitë e Tij të veçanta për Të, me të cilat dallohet nga gjithë krijesat e Tij. Përndryshe, thjesht vërtetimi i qenies së Tij Ekzistent i domosdoshëm, nuk mjafton për njohjen e Tij ekzaktësisht, sepse ndoshta dikush beson se edhe materien ose energjinë mund t'i nënkuptojë termi *ekzistent i domosdoshëm* (*vaxhibu'l vuxhud*). Nga këtu na del detyrë që të vërtetojmë nga njëra anë Cilësitë Mohuese (*selbije*) hyjnore, për t'u njohur nëpërmjet tyre me pastërtinë e Ekzistentit të domosdoshëm ndaj cilësimit me cilësitë e veçanta të krijesave (pastrim i cili nuk mund të aplikohet tek asnjë nga krijesat e Tij) dhe nga ana tjetër është i domosdoshëm vërtetimi i Cilësive Vërtetuese (*thubutije*) hyjnore që të na bëhet e qartë vlefshmëria e adhurimit të Tij dhe për të shtruar kështu rrugën për vërtetimin e gjithë shtyllave të besimit si profetësia (*nubuve*), ringjallja (*mi'ad*) dhe çfarë degëzohet prej tyre.

Nëpërmjet argumentit të mëparshëm kemi arritur në konkluzionin se Ekzistenti i domosdoshëm nuk ka nevojë për shkak sjellës në ekzistencë dhe se Ai është shkak për ekzistencën e të mundshëmve (*mumkinat*). Pra, ne kemi vërtetuar dy cilësi të Ekzistentit të domosdoshëm.

E para: Mospasja e Tij nevojë për asnjë ekzistent tjetër. Sepse në qoftë se do të kishte nevojën më të vogël për ndonjë ekzistent tjetër, ekzistenti tjetër do të ishte shkak për të. Ne mësuam se kuptimi i shkakut (*'il-leh*) në terminologjinë filozofike është: ekzistenti tjetër, ndaj të cilit ndihet nevoja.

E dyta: Ekzistentët e mundshëm janë pasoja dhe kanë nevojë për Të (*muhtaxhe ilejh*): Ai është Shkaku i Parë për ekzistencën dhe krijimin e tyre.

Në dritën e këtyre dy përfundimeve përpiqemi të kërkojmë rrjedhojat e çdonjërës prej këtyre dy cilësive dhe vërtetimin e Cilësive Mohuese (*Selbije*) dhe Vërtetuese (*Thubutije*) të Ekzistentit të domosdoshëm. Natyrisht, për vërtetimin e çdo cilësie prej tyre janë përmendur argumente dhe shembuj të shumtë në librat filozofikë dhe teologjikë. Duke patur parasysh lehtësimin e kuptimit dhe përthithjen e tij, si dhe ruajtjen e lidhjes ndërmjet leksioneve, ne do të përzgjedhim faktet dhe argumentet që lidhen me argumentin e kaluar.

Pafillimshmëria (*ezelije*) e Allahut dhe pafundshmëria (*ebedije*) e Tij

Në qoftë se ekzistenti është pasojë e një ekzistenti tjetër apo ka nevojë për të, atëherë ekzistenca e tij është pasuese e ekzistentit tjetër dhe e varur prej tij dhe në qoftë se nuk ekziston shkaku i tij, atëherë edhe ky ekzistent nuk do të ekzistonte. Pra, nëse do të zhdukej në një periudhë kohore të caktuar, ky do të ishte argument për pamundësinë dhe nevojën e tij si dhe mundshmërinë (*imkan*) e ekzistencës së tij.

Përderisa Ekzistenti i domosdoshëm ekziston vetvetiu duke mos patur nevojë për asnjë ekzistent tjetër, për këtë arsye Ai është i përjetshëm (pa fillim e pa mbarim) në ekzistencë (*Ebedijj'ul vuxhud*).

Prej këtu vërtetohen dy cilësi nga Cilësitë e Tij:

E para: Pafillimshmëria e Tij (*ezelijjetuhu*), që do të thotë se nuk është parakaluar nga hiçi, asgjëja (*'adem*) në të kaluarën.

E dyta: Pafundshmëria e Tij (*ebedijjetuhu*), që do të thotë se nuk do të jetë kurrë i asgjësuar (*ma'dum*) në të ardhmen. Ndonjëherë këto dy cilësi përmblidhen në fjalën *i Përhershëm* (*Sermedij*).

Mbi bazën e kësaj, themi se çdo ekzistencë që e ka prejardhjen nga asgjëja apo që mundet të zhduket dhe ***shkatërrohet, nuk mund të jetë Ekzistent i domosdoshëm***. Me anë të kësaj sqarohet kotësia e supozimit të ekzistencës së domosdoshme për çdo dukuri materiale.

Cilësitë mohore (*Es-Sifatu's Selbije*)

Është edhe një cilësi tjetër me të cilën përshkruhet Ekzistenti i domosdoshëm. Ajo është thjeshtësia (*El-Besatah*), mospërbërja e tij nga pjesë. Sepse çdo gjë e përbërë ka nevojë për pjesët e saj. Ndërsa Ekzistenti i domosdoshëm është i pastër nga të gjitha nevojat. Në qoftë se do të supozonim se pjesët e Ekzistentit të domosdoshëm nuk do të ekzistonin me veprim (*bil fi'l*), por pjesët e tij ekzistojnë me forcë (*bil kuvveh*) si supozuara të një vize, edhe ky lloj supozimi bie poshtë dhe është i kotë, për shkak se një gjë e përbërë forcërisht nga pjesë mund t'i nënshtrohet logjikisht ndarjes edhe në qoftë se nuk realizohet ndarja e saj realisht nëpërmjet veprimit nga pamja e jashtme.

Kuptimi i mundësisë së ndarjes do të thotë mundësi e zhdukjes dhe e asgjësimit të tij. Është njëlloj me një vijë gjatësia e së cilës është një metër, kur ndahet në dy pjesë, atëherë gjatësia e saj nuk do të jetë më një metër. Më herët kemi mësuar se Ekzistenti i domosdoshëm nuk mund t'i nënshtrohet asgjësimit (*zeval*) dhe zhdukjes (*fená*).

Meqenëse përbërja nga pjesët si pasojë e veprimit apo e forcës është nga veçoritë e trupave, me anë të kësaj vërtetohet se çdo trup fizik nuk mund të jetë Ekzistent i domosdoshëm. Pra, vërtetohet se Allahut të Madhëruar nuk i përshkruhet e as i përfytyrohet trup. Na bëhet e qartë, gjithashtu, se Allahu

i Madhëruar nuk mund të shihet me sy dhe nuk mund të rroket me asnjë shqisë tjetër. Kjo sepse perceptimi nëpërmjet shqisave rrok vetëm trupat dhe është veçori e trupave.

Duke mohuar trupëzimin e Ekzistentit të domosdoshëm mohohen prej Tij të gjitha veçoritë e trupave, si supozimi i qenies së Tij në vend dhe në kohë. Kjo sepse vendi mund të përfytyrohet për diçka që ka vëllim dhe që zgjatet në kohë dhe çdo gjë kohore mund t'i nënshtrohet ndarjes si pasojë e zgjatjes në kohë dhe moshës.

Ky konsiderohet një lloj zgjatjeje dhe përbërjeje nga pjesët forcërisht. Kështu, ne vërtetojmë se është e pamundur t'i përfytyrohet Allahut të Madhëruar ndonjë kohë apo vend. Gjithashtu, çdo ekzistent që i nënshtrohet kohës apo vendit nuk mund të jetë Ekzistent i domosdoshëm.

Së fundmi, duke mohuar ndaj Ekzistentit të domosdoshëm kohën, i mohojmë Atij edhe lëvizjen, ndryshimin dhe plotësimin, përsosjen. Kjo sepse çdo lëvizje apo ndryshim nuk mund të bëhet pa faktorin kohë.

Pra, ata të cilët i cilësojnë Allahut vend, si Arshin, apo i cilësojnë Atij lëvizjen dhe zbritjen nga qielli, apo që besojnë se Ai mund të shihet me sy, nuk e kanë njohur Allahun me një njohje të drejtë.[1]

Në përgjithësi, çdo nocion që tregon një lloj mangësie, kufizimi dhe nevoje nuk mund t'i cilësohet Allahut të madhëruar. Të gjitha këto ia mohojmë Atij. Ky është kuptimi i cilësive mohore të Zotit.

1. Është përcjellë thënia mbi ekzistencën e të Lartësuarit në aksh vend, apo zbritjen e tij nga qielli, apo shikimin e tij me sy nga disa grupe të Ehli Sunetit, ashtu si edhe thënia për transformimin e Allahut të Madhëruar, përsosurinë dhe ndryshimin e Tij që është përcjellë nga shumë filozofë perëndimorë siç janë Hegeli, Bergsoni, Uilliam Xhejmsi dhe Uajt'hedi. Por duhet ta dimë se mohimi i lëvizjes dhe ndryshimit nga Allahu i Madhëruar nuk do të thotë vërtetim i moslëvizjes së Tij, por nënkupton vërtetimin e qëndrueshmërisë së Tij vetvetiu (*thebatuhu bidhatihi*). Qëndrueshmëria është antitezë e ndryshimit, ndërsa moslëvizja (*sukun*) është paaftësia e lëvizjes dhe nuk cilësohet me të vetëm se diçka që i nënshtrohet lëvizjes.

Shkaku Sjellës në ekzistencë (*El 'Il-letu'l Muxhideh*)

Përfundimi i dytë tek i cili arritëm me anë të argumentit të mësipërm është:

"Ekzistenti i domosdoshmëm është shkak për ekzistencën e ekzistentëve të mundshëm." Tani do të studiojmë rrjedhojat e këtij përfundimi.

Në fillim do të përmendim një sqarim rreth ndarjeve të shkakut (*eksamu'l 'il-leh*) dhe pas kësaj do të përmendim veçoritë e shkakësisë hyjnore.

Shkak ('il-leh) - në kuptimin e tij të përgjithshëm - quhet çdo ekzistent që përfaqëson anën me të cilën lidhet një ekzistent tjetër dhe që varet prej tij. Ai përfshin edhe kushtet (*shurut*) dhe përbërësit (*mu'iddat*). Nuk ka për Allahun e madhëruar asnjë shkak me këtë kuptim.

Mosekzistenca e shkakut për Allahun e madhëruar do të thotë se Ai nuk është i varur, as i lidhur e as i kushtëzuar nga ndonjë ekzistent tjetër, kështu që nuk mund të përfytyrohet në adresë të Tij asnjë kusht (*shart*) apo mjet përcaktues (*mu'idd*).

Ndërsa, përsa i përket faktit se Allahu i madhëruar është shkak (*'il-leh*) për krijesat, kjo domethënë se Ai është Sjellësi i tyre në ekzistencë.

Kjo është një ndarje e veçantë nga ndarjet e shkakësisë vepruese. Për ta sqaruar edhe më tepër këtë mendim, duhet që t'u hedhim një shikim të shkurtër nënndarjeve të shkakut (*'il-leh*), ndërsa për më gjerë ua lëmë mundësinë librave filozofikë.

Ne e dimë se sa është e domosdoshme për mbirjen e bimëve ekzistenca e rrënjëve dhe e tokës së përshtashme, ujit dhe ajrit. Por mos të harrojmë se duhet edhe faktori natyror apo njerëzor për ta shpërndarë farën në tokë dhe për ta ujitur atë.

Të gjithë këta faktorë - nën dritën e përkufizimit të termit "*shkak*" (*'il-leh*) – konsiderohen nga shkaqet e mbirjes së bimëve. Këto shkaqe të ndryshme, të para nga këndvështrime të ndryshme, mund t'i ndajmë në grupe.

Ato shkaqe, ekzistenca e të cilave konsiderohet përherë e domosdoshme për ekzistencën e pasojës (*ma'lul*) quhen "shkaqe të vërteta" (*'ilel hakikije*). Ai grup shkaqesh, ekzistenca e të cilave nuk është e domosdoshme për ekzistencën e pasojës (*ma'lul*), (si bujku apo faktori natyror mbjellës dhe fushat pjellore për mbirjen e bimëve), ato quhen "shkaqe mjete, përcaktues apo përgatitorë" (*'ilel mu'idde*, *mu'iddat*).

Ndërsa ato shkaqe që mund të zëvendësohen nga shkaqe të tjera quhen "shkaqe alternativë" (*'ilel bedile*).

Të gjitha shkaqet e tjera quhen "shkaqe të kufizuara" (*'ilel munhasire*), pasi nuk mund të zëvendësohen nga shkaqe të tjera gjatë procesit të ndikimit.

Ekziston edhe një lloj tjetër shkaqesh i cili ndryshon plotësisht nga shkaqet të cilat i përmendëm më sipër në shembullin e bimëve. Mund të shohim një shembull të tij në lëmin e psikologjisë njerëzore si dhe tek disa dukuri dhe gjendje shpirtërore.

Kur njeriu sjell në mendjen e tij një imazh logjik apo kur vendos për të ndërmarrë një punë çfarëdo, në veten e tij ndodh një dukuri psikologjike, e cila quhet imazh logjik (*surah dhihnije*) apo vullnet (*irade*), ekzistenca e së cilës lidhet me ekzistencën e unit a shpirtit. Prej këtu, konsiderohet pasojë e unit (*ma'luletun lin-nefs*). Kjo lloj pasoje nuk ka asnjë lloj pavarësie nga shkaku i saj dhe nuk mund të shkëputet apo të jetë e pavarur në ekzistencën e saj nga ekzistenca e shkakut të saj.

Në të njëtën kohë, vërejmë se efekti a ndërveprimi i unit me imazhin logjik apo vullnetin është i kushtëzuar nga kushte të caktuara të cilat burojnë nga natyra e mangësisë, e kufizimit dhe e mundshmërisë së ekzistencës, me të cilat karakterizohet uni a shpirti.

Nga këtu, del se efektshmëria (veprueshmëria dhe ndikueshmëria) e Ekzistentit të domosdoshëm ndaj gjithësisë është shumë më e përsosur dhe shumë më e lartë se efektshmëria e unit a shpirtit ndaj gjendjeve dhe dukurive psikologjike e shpirtërore.

Nuk mund të gjejmë ngjashmëri mes efektshmërisë së Allahut dhe mes gjithë efektshmërive të krijesave.

Kjo, sepse ky *Bërës* (*Fa'il*) pa asnjë nevojë sjell në ekzistencë dhe krijon pasojën (krijesën) e Tij dhe është kjo pasojë (krijesë) ajo që varet me gjithë ekzistencën e vet nga Ai.

Veçoritë e Shkakut Sjellës në ekzistencë (*El-'Il-letu'l Muxhideh*)

Duke patur parasysh çfarë theksuam më sipër, mund të përmendim disa nga veçoritë e rëndësishme me të cilat karakterizohet "Shkaku Sjellës në ekzistencë" (*El-'Il-letu'l Muxhideh*):

1- Shkaku Sjellës në ekzistencë (*El-'Il-letu'l Muxhideh*) duhet të përmbledhë të gjitha përsosuritë e shkaqeve, krijesave (*ma'lulat*) në mënyrë të plotë e absolute, që të jetë në gjendje të derdhë (*ifadah*) mbi çdo ekzistent a krijesë sipas masës së kapacitetit (*kabilije*) dhe gatishmërisë (*isti'dad*) pranuese të ekzistentit a krijesës, ndryshe nga shkaqet përgatitore apo materiale të cilat kryejnë detyrën përgatitore dhe sigurojnë platformën e përshtatshme për transformimin e pasojës (*ma'lul*) dhe ndryshimin e saj, jo në origjinën e ekzistencës së saj, por në ndryshueshmërinë e saj dhe nuk është e nevojshme ekzistenca e tyre (e shkaqeve përgatitore apo materiale) për përsosurinë e pasojës a ekzistentit të krijuar. Për shembull, nuk është kusht dheu për përsosuritë (*kemalat*) e bimëve, apo ekzistenca e prindërve për përsosuritë (*kemalat*) e fëmijëve të tyre.

Ndërsa Allahu, Sjellësi në ekzistencë (*El-Muxhid*) duhet të posedojë të gjitha përsosuritë ekzistenciale, me gjithë thjeshtësinë (mospërbërjen) e Tij dhe mospranimin e ndarjes së Tij në pjesë.[2]

2. Duhet të dimë se krijimi i përsosurive të krijesave nga Allahu i Madhëruar, nuk nënkupton që disa nocione të krijesave (si nocionet *trup* dhe *njeri*) të pranohen e të përshkruajnë Allahun e madhëruar apo t'i atribuohen Atij. Këto nocione përshkruajnë ekzistentët (*meuxhudat*) e mangët e të kufizuar, kështu që nuk mund të pështkruajnë Allahun e madhëruar, i Cili

2- Shkaku Sjellës në ekzistencë (*El-'Il-letu'l Muxhideh*) e sjell pasojën e saj nga asgjëja, nga hiçi; me një fjalë: e krijon atë, por pasi e krijon atë nuk i mangësohet asgjë nga ekzistenca e Tij. Ndryshe nga faktori natyrë, detyra e të cilit është ndryshimi i pasojës ekzistuese, duke shpenzuar fuqi dhe energji në kryerjen e kësaj detyre. Dhe nëse do të supozohej shkëputja e ndonjë gjëje nga Qenia e Ekzistentit të domosdoshëm, si rrjedhojë Qenia hyjnore do të pranonte ndarjen dhe ndryshimin. Dhe ne e vërtetuam kotësinë dhe pavlefshmërinë e kësaj hipoteze.

3- Shkaku Sjellës në ekzistencë (*El-'Il-letu'l Muxhideh*) është shkak i vërtetë. Kësisoj, ekzistenca e tij është e domosdoshme për ekzistencën e pasojës, ndryshe nga shkaku përcaktues (*'il-leh mu'iddeh*) për të cilën nuk ka nevojë ekzistenca e pasojës. Nën dritën e kësaj, disa teologë kelamistë (*mutekellimun*) nga Ehli Sunneti kanë thënë se gjithësia nuk ka nevojë për Allahun për ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e saj, ashtu sikurse kanë thënë edhe disa filozofë perëndimorë se bota natyrore është sikurse ora e cila kurdiset dhe pastaj vazhdon të punojë vetë; e njëjta gjë ndodh edhe me gjithësinë e cila gjatë veprimtarisë së saj nuk ka nevojë për Allahun. Këto mendime janë shumë larg nga e vërteta. Përkundrazi, gjithësia ka nevojë gjithmonë për Allahun në çdo çështje dhe në çdo gjendje të saj. Në qoftë se do të ndalej Krijuesi qoftë edhe një çast nga përkujdesja ndaj gjithësisë, nuk do të kishte mbetur më asgjë së ekzistuari në gjithësi.

posedon përsosuritë e pafundme e të pakufishme.

Pyetje

1. Përse duhen njohur Cilësitë e Allahut?

2. Cilat janë përfundimet dhe të dhënat e argumentit të mësipërm?

3. Cili është argumenti i përhershmërisë së Allahut?

4. Si mundemi ta vërtetojmë se Qenia hyjnore (*Edh-Dhat'ul Ilahije*) është e thjeshtë (jo e përbërë) dhe se Ai është i pastër nga përbërja me pjesë me veprim e me forcë?

5. Cili është argumenti që Allahu nuk ka trup (fizik)?

6. Përse ne nuk mundemi ta shohim Allahun?

7. Cili është argumenti i mospërfshirjes së Allahut të madhëruar në kohë dhe në vend?

8. A mund t'ia atribuojmë Allahut lëvizjen dhe moslëvizjen? Pse?

9. Trego ndarjet e shkakut (*'il-leh*)?

10. Shpjego veçoritë e Shkakut Sjellës në ekzistencë (*El-'Illetu'l Muxhideh*)?

Leksioni i nëntë

CILËSITË QENËSORE (*Es-Sifatu'dh Dhatijeh*)

Hyrje

Më parë kemi mësuar se Allahu i madhëruar është Shkaku Sjellës në ekzistencë (*El-'Il-letu'l Muxhideh*) i gjithësisë dhe se Ai zotëron të gjitha përsosuritë e ekzistencës. Të gjitha llojet e përsosurisë që ndodhen në çdo ekzistent e kanë burimin e tyre prej Tij, duke mos i pakësuar përsosurisë së Tij asgjë, gjatë dhënies së saj për krijesat e Tij. Për ta bërë më të kuptueshëm këtë mendim po japim këtë shembull:

Profesori i furnizon me dije studentët e tij dhe kjo gjë nuk e pakëson dijen e tij aspak. Natyrisht, dhënia e ekzistencës dhe e përsosurive ekzistenciale nga Allahu i madhëruar është shumë më e lartë dhe më famëlartëe se ky shembull. Ndoshta formulimi më i afërt në lidhje me këtë aspekt është të themi se bota e ekzistencës është dritë dhe shfaqje e madhërishme (*texhel'li*) e Qenies së shenjtë hyjnore, siç mund të kuptohet edhe nga ajeti i nderuar **"Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës."**[1]

Po të vërejmë përsosuritë e pambarimta hyjnore, çdo nocion përshkruan një përsosuri nga përsosuritë, pa shkaktuar asnjë mangësi apo kufizim që mund të përfytyrohet apo atribuohet Allahut të madhëruar, përsosuri të cilat i janë atribuuar Allahut të Lartësuar në ajetet e nderuara kur'anore dhe hadithet sherife, në lutjet dhe përgjërimet (*munaxhat*) e transmetuara nga imamët e pagabueshëm (paqja qoftë mbi ta!). Shembuj të këtyre nocioneve janë: drita, përsosuria, bukuria, dashuria, gëzimi etj.

1. Surja En-Nur, ajeti 35.

Ndërsa ajo që është përmendur nga atributet hyjnore në librat e doktrinave (*akaid*), të filozofisë dhe të teologjisë islame (*el-kelam'ul islamij*) është vetëm një numër i kufizuar cilësish të cilat ndahen në dy grupe: Cilësi Qenësore (*Sifat Dhatije*) dhe Cilësi Vepruese (*Sifat Fi'lije*). Fillimisht do të bëjmë një sqarim rreth këtyre dy grupeve e më pas do të përmendim cilësitë më të rëndësishme, duke i vërtetuar dhe argumentuar ato.

Cilësitë Qenësore (*Dhatije*) dhe Vepruese (*Fi'lije*)

Cilësitë të cilat i atribuohen Allahut të Lartësuar janë:

a) ose nocione të dala nga Qenia Hyjnore, duke patur parasysh se ato gjejnë apo sjellin në ekzistencë një nga llojet e përsosurisë, si p.sh. Jeta (*El-Hajat*), Dija (*El-'Ilm*) dhe Fuqia (*El-Kudre*).

b) ose nocione që e kanë burimin nga marrëdhëniet apo lidhjet ndërmjet Allahut të Lartësuar dhe krijesave të Tij, si p.sh. Krijueshmëria (*El-Khalikijje*) dhe Furnizueshmëria (*Er-Razikijje*).

Grupi i parë quhet "Cilësi Qenësore" (*Sifat Dhatije*), ndërsa grupi i dytë quhet "Cilësi Vepruese" (*Sifat Fi'lije*).

Dallimi kryesor ndërmjet këtyre dy grupeve të atributeve është se: Në grupin e parë Qenia e Shenjtë Hyjnore është dëshmi e jashtme e atyre cilësive, ndërsa në grupin e dytë ato cilësi tregojnë një farë raporti (*nisbe*) dhe përkatësie (*idafe*) ndërmjet Allahut të Lartësuar dhe krijesave të Tij, ku Qenia Hyjnore dhe qeniet e krijesave përfaqësojnë dy anët e përkatësisë dhe raportit, si p.sh. atributi i krijimit (*El-Khalikijjje*) i cili buron nga lidhja ekzistenciale e krijesave me Qenien Hyjnore (Allahun), ku Allahu dhe krijesat përfaqësojnë dy anët e kësaj përkatësie, porse nuk ekziston jashtë Qenies së Shenjtë Hyjnore dhe qenieve të krijesave ndonjë e vërtetë tjetër e jashtme që të cilësohet si atribut i krijimit (*El-Khalikijjje*).

Natyrisht, Allahu i Madhëruar e zotëron vetvetiu fuqinë apo mundësinë për të krijuar, por dihet që Fuqia është prej

Cilësive Qenësore, ndërsa Krijimi (*El-Khalk*) është një koncept shtesë i cili buron nga pozita e veprimit. Prej këtu, Krijuesi (*El-Khalik*) konsiderohet prej Cilësive Vepruese. Në qoftë se ne do ta interpretojmë me "I Fuqishmi\I Afti për të krijuar", atëherë arsyetimi ynë na çon te cilësia *El-Kudre* (Fuqia\Aftësia). Cilësitë Qenësore hyjnore më të rëndësishme janë: Jeta (*El-Hajat*), Dija (*El-'Ilm*) dhe Fuqia (*El-Kudre*).

Ndërsa Dëgjimi (*Es-Sem'*) dhe Shikimi (*El-Besar*), nëse i komentojmë këto të dyja si *I Dijshëm për gjërat që dëgjohen (mesmu'at) dhe që shikohen (mubsirat)*, apo *I Aftë (El-Kadir) të dëgjojë dhe të shikojë*, atëherë këto përkojnë me emrat I Gjithëdijshmi (*El-'Alijm*) dhe I Forti (*El-Kadijr*). Dhe në qoftë se nga ato të dyja nënkuptohen dëgjimi dhe shikimi, si veprime të cilat rrjedhin nga marrëdhënia ndërmjet Qenies së Dëgjuesit e Shikuesit dhe gjërave që dëgjohen dhe shikohen, është e domosdoshme që t'i konsiderojmë këto të dyja prej Cilësive Vepruese, ashtu sikurse Dija (*El-'Ilm*) ndonjëherë përdoret me këtë kuptim dhe në këtë kontekst quhet Dije Vepruese.

Disa teologë kelamistë e konsiderojnë Fjalën (*El-Kelam*) dhe Vullnetin (*El-Irade*) nga Cilësitë Qenësore, dy atribute këto të cilat do t'i trajtojmë në vijim.

Vërtetimi i Cilësive Qenësore

Njëra nga mënyrat më të lehta për të vërtetuar cilësitë e Jetës, Aftësisë dhe Dijes hyjnore është mënyra e mëposhtme:

Këto nocione kur përdoren për krijesat tregojnë përsosuritë e tyre. Prandaj edhe janë në nivelin më të përsosur te Shkaku Sjellës në ekzistencë. Çdo përsosuri që gjendet në çdo krijesë e ka prejardhjen nga Allahu.

Pra, është e domosdoshme që të jetë Allahu i Lartësuar, Krijuesi posedues i ekzistencës së asaj përsosurie që të ketë mundësi t'ia japë krijesës. Është e pamundur që Ai që e krijon jetën të mos e zotërojë atë, apo Ai që ua dhuron krijesave dijen dhe aftësinë\fuqinë të jetë i paditur e i paaftë\i pafuqishëm.

Kush nuk posedon diçka, nuk mund ta japë atë.

Pra, ekzistenca e këtyre cilësive që tregojnë përsosuri tek disa krijesa është argument për ekzistencën e tyre tek Krijuesi i lartësuar pa asnjë mangësi apo përcaktim e kufizim. Allahu i madhëruar është posedues i Jetës, Dijes dhe Aftësisë së pakufishme. Tani të fillojmë t'i sqarojmë më gjerësisht secilën nga këto cilësi.

Jeta (*El-Hajat*)

Koncepti "jetë" përdoret në dy kategori krijesash:

E para: Tek bimët të cilat kanë veçorinë e rritjes.

E dyta: Tek kafshët dhe njerëzit të cilët zotërojnë ndjenja dhe vullnet.

Kuptimi i parë i konceptit "jetë" nënkupton mangësi dhe nevojë. Kjo, sepse natyra e rritjes presupozon që gjëja që rritet, në fillimet e saj nuk posedon përsosuri (*kemal*). Por, si rezultat i disa faktorëve dhe ndikimeve të jashtme në të ndodhin disa ndryshime, të cilat gradualisht e çojnë drejt një përsosurie të re. Ashtu siç e shpjeguam në temën mbi Cilësitë Mohore, është e pamundur që këto çështje t'i përshkruhen Allahut të Madhëruar.

Ndërsa kuptimi i dytë është koncept përsosurie (*mefhum kemalij*), edhe pse në disa lidhje kuptimore (*mesadijk*) që kanë të bëjnë me mundshmërinë (*imkanije*), atij mund t'i përqasen disa mangësi dhe kufizime. Por ne mund t'i përfytyrojmë një nivel pafundësie, i cili nuk përmban asnjë mangësi, kufizim apo nevojë, siç është rasti i koncepteve të ekzistencës dhe të përsosurisë.

Jeta, në kuptimin e saj të qenësishëm për dijen dhe veprueshmërinë sipas vullnetit, është thelbësore për ekzistencën jomateriale. Kjo sepse edhe në qoftë se jeta u atribuohet gjallesave materiale, prapëseprapë, në realitet, jeta është cilësi e shpirtit dhe jo e trupit të tyre. Por trupi cilësohet me të (jetën) për shkak të lidhjes dhe varësisë së shpirtit me

trupin. Thënë me fjalë të tjera: Ashtu siç është zgjatimi një nga pashmangshmëritë e ekzistencës trupore, po ashtu edhe jeta është nga pashmangshmëritë e ekzistencës së thjeshtë e jo të përbërë (jotrupore).

Prej këtu del një tjetër argument për Jetën hyjnore, i cili është: Qenia e shenjtë hyjnore është e thjeshtë, pra jo e përbërë, jotrupore - siç e vërtetuam në leksionin e kaluar. Dhe duke qenë se ekzistenti i thjeshtë ekziston vetvetiu, si rrjedhojë, Allahu i lartësuar ekziston me Jetën e Tij vetvetiu.

Dija (*El-'Ilm*)

Koncepti i Dijes është koncepti më i qartë dhe më i evidentueshëm, por lidhjet kuptimore të këtij nocioni që ne njohim tek krijesat janë kuptime të mangëta e të kufizuara. Ndërsa koncepti i dijes me këto veçori me të cilat cilësohen krijesat nuk mund të jetë i denjë edhe për Allahun e Madhëruar.

Porse mendja, ashtu sikurse e bëmë të njohur edhe më parë, mundet të përfytyrojë për këtë koncept përsosurie një lidhje kuptimore pa mangësi dhe pa kufizime a përcaktime, që të jetë vetë Qenia e të Dijshmit (*'Ajnu Dhatil-'Alim).*

Dhe kjo është Dija qenësore e Allahut të madhëruar.

Ne mund ta vërtetojmë Dijen e Allahut të lartësuar në mënyra të shumta. Prej tyre:

• Mënyra me anë të së cilës kemi vërtetuar gjithë Cilësitë Qenësore. Pra, meqë dituria ekziston tek krijesat, është e domosdoshme që të ekzistojë në nivelin më të përsosur e më të plotë edhe tek Krijuesi.

• Mbështetja për vërtetimin e saj tek argumenti i rregullsisë. Çdo dukuri dhe krijesë është e pajisur me rregullsi dhe mjeshtëri a perfeksion. Kjo tregon më së shumti mbi dijen e Krijuesit të saj. Siç vihet re në një libër shkencor, apo në një poemë të mrekullueshme, apo në një tablo artistike, çdo element vërteton kulturën, shijen dhe eksperiencën që zotëron autori i tyre. Asnjë i mençur nuk mund të imagjinojë që një

libër shkencor apo filozofik ta ketë shkruar një injorant dhe i pakulturuar. Pra, si mund të imagjinohet që gjithë kjo gjithësi madhështore me gjithë ç'ka brenda nga fshehtësitë dhe mrekullitë të jetë krijuar nga një i paditur?

• Përfitimi nga disa premisa teorike filozofike (jointuitive, joaksiomatike), si p.sh. rregulla *"Çdo ekzistent jo i përbërë, abstrakt (muxherred) e i pavarur është i ditur."*; ashtu siç është vërtetuar në librat e veçantë rreth këtyre studimeve.

Orientimi i njeriut kah Dija hyjnore luan një rol të madh në ndërtimin e personalitetit të tij. Këtë të vërtetë e ka përforcuar shumë herë edhe Kur'ani famëlartë. Një ndër ajetet e nderuara që flet për këtë është: ***"Allahu e di shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra."***[2]

Fuqia, Aftësia (*El-Kudrah*)

Për dikë që e kryen punën e tij me vullnetin e tij dhe përzgjedhjen e tij thuhet se zotëron aftësi a fuqi për punën e tij. Pra, aftësia (*kudrah*) është shprehja e fuqisë dhe iniciativës së dikujt me vullnet të lirë përzgjedhës (*fa'il mukhtar*) për të kryer një vepër të cilën ai mundet ta kryejë. Sa më i përsosur të jetë bërësi për nga shkalla ekzistenciale (*mertebe vuxhudije*), aq edhe më i aftë është. Natyrisht, Ekzistenti që zotëron përsosurinë e përkryer e të pafundme, ka Aftësi a Fuqi të pakufizuar. "***Pa dyshim, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.***"[3]

Është rasti që këtu të theksojmë disa vërejtje:

1- Vepra me të cilën lidhet Aftësia duhet të jetë medoemos e mundshme për t'u realizuar. Një gjë që është e pamundur (*muhal*) në vetvete, apo rrjedhojë e të pamundurës nuk ka lidhje me Aftësinë. Shprehja: *Allahu është i Aftë a i Fuqishëm të bëjë çdo gjë* nuk ka kuptimin p.sh. Është i Aftë të krijojë një zot tjetër (kjo për arsyen e vetme se Zoti nuk është krijesë), apo supozimi se Allahu është i Aftë ta bëjë numrin 2 më të madh

2. Sure "Gafir", ajeti 19.
3. Sure "El-Bekare," ajeti 20; si dhe ajete të tjera veç saj.

se 3, apo të krijojë djalin para babait.

2- Aftësia për të bërë çdo gjë nuk e obligon dhe as e detyron Allahun që të kryejë çdo vepër që është i Aftë për ta kryer, por Ai realizon ato vepra që dëshiron t'i realizojë. Allahu, i Urti dëshiron vetëm vepra të mira dhe të urta dhe nuk realizon vetëm se këto vepra, edhe pse është i Aftë (*Kadir*), gjithashtu, të kryejë vepra të papëlqyeshme dhe të këqija. Në leksionet e ardhshme do të bisedojmë rreth Urtësisë hyjnore.

3- Aftësia në kuptimin që ne e përmendëm, përmbledh gjithashtu edhe përzgjedhjen (*ikhtijar*). Allahu i lartësuar, ashtu si posedon shkallët më të larta dhe më të përsosura të Aftësisë, gjithashtu Ai posedon gjithë shkallët më të përsosura të përzgjedhjes. Asnjë faktor nuk mund ta poshtërojë e detyrojë në kryerjen e ndonjë vepre, apo t'ia mohojë Atij lirinë e përzgjedhjes. Kjo, sepse ekzistenca e çdo ekzistenti\krijese dhe aftësia e tij\saj është prej të Allahut të Lartësuar dhe nuk mund të poshtërohet apo sundohet nga fuqitë dhe aftësitë të cilat Ai ua mundësoi të tjetërëve.

Pyetje

1. Cilat janë konceptet të cilat mund t'i përdorim për Allahun e Lartësuar?

2. Trego Cilësitë Qenësore dhe ato Vepruese? Trego dallimin mes tyre?

3. Cila është mënyra e përgjithshme për të vërtetuar Cilësitë Qenësore?

4. Për cilat nocione përdoret koncepti *jetë*? Cili është kuptimi që mund ta përdorim për Allahun e Madhëruar?

5. Trego argumentin e veçantë i cili përdoret për Jetën hyjnore?

6. Përmend tre argumente për Dijen hyjnore?

7. Sqaro konceptin Aftësia (*El-Kudrah*) dhe përmend argumentin që vërteton Aftësinë\Fuqinë hyjnore?

8. Cilat janë gjërat me të cilat Aftësia nuk ka lidhje?

9. Përse Allahu nuk vepron vepra të papëlqyeshme dhe të këqija?

10. Sqaro kuptimin e të qënit të Allahut përzgjedhës (i lirë dhe jo i varur)?

Leksioni i dhjetë

CILËSITË VEPRUESE

Hyrje

Në leksionin e kaluar treguam se Cilësitë Vepruese janë shprehje e nocioneve të cilat burojnë nga krahasimi i Qenies Hyjnore me qeniet e krijesave nëpërmjet vërejtjes së përkatësisë, raportit dhe lidhjes së veçantë (kuptimore) ndërmjet tyre, ku Allahu dhe krijesat përfaqësojnë dy anët e kësaj përkatësie, si p.sh. atributi i krijimit (*El-Khalikijjje*) i cili buron nga lidhja ekzistenciale e krijesave me Allahun e Madhëruar. Dhe në qoftë se nuk do të vërehej kjo lidhje (kuptimore) mes tyre nuk do të nxirrej ky nocion.

Lidhjet dhe përkatësitë që mund të imagjinohen mes Allahut dhe krijesave nuk mund të numërohen e të kufizohen, por mund të ndahen në mënyrë përgjithësuese parë nga një këndvështrim i caktuar në dy grupe:

• Grupi i parë: Vërejtja e përkatësive të drejtpërdrejta ndërmjet Allahut dhe krijesës, si p.sh. sjellja në ekzistencë, krijimi, shpikja (*ibda'*) etj.

• Grupi i dytë: Përkatësitë të cilat mund të përfytyrohen pas përfytyrimit të përkatësive dhe lidhjeve të tjera, si p.sh. furnizimi (*rizk*), sepse në fillim duhet të përfytyrojmë lidhjen e ekzistentit të furnizuar me gjënë me të cilën furnizohet, pastaj të përfytyrojmë sigurimin dhe dhënien nga Allahu i Lartësuar të asaj gjëje, për të arritur nëpërmjet saj tek nocioni *Furnizuesi* (*Er-Razik* dhe *Er-Rezzak*). Madje, nganjëherë ne mund të përfytyrojmë përkatësi dhe lidhje të shumta ndërmjet vetë krijesave, para se të arrijmë tek Cilësia Vepruese e Allahut të Madhëruar dhe pas kësaj të shohim lidhjen (kuptimore) me

Allahun e Madhëruar.

Ka edhe përkatësi si rrjedhojë e disa përkatësive të tjera të mëparshme ndërmjet Allahut dhe krijesave të Tij, si p.sh. *Falja* (*El-Magfireh*), e cila është rrjedhojë e Zotësisë Legjislative Hyjnore (*Er-Rububijjetu't-Teshri'ijjetul-Ilahijjeh*), përcaktimit të dispozitave obliguese nga Allahu i Lartësuar dhe kundërshtimi i këtyre dispozitave nga ana e robit.

Pra, për të arritur tek Cilësitë Vepruese është i nevojshëm një lloj krahasimi dhe atribuimi a raporti varësie ndërmjet Allahut të Madhëruar dhe krijesave, si dhe përfytyrimi i një lloj lidhjeje e përkatësie ndërmjet Krijuesit dhe krijesës, për të arritur nëpërmjet saj tek koncepti shtesë që bazohet në dy anët e përkatësisë. Prej këtej, Qenia Hyjnore e Shenjtë nuk është vërtetuese e Cilësive Vepruese nëse nuk merren parasysh këto përkatësi dhe atribuime.

Ky është edhe dallimi kryesor ndërmjet Cilësive Qenësore dhe atyre Vepruese. Më parë kemi përmendur se ne mund t'i vërejmë Cilësitë Vepruese nëpërmjet vëzhgimit të bazave nga të cilat burojnë ato, për të përfunduar kështu tek Cilësitë Qenësore, si në rastin e *Krijuesi* (*El-Khalik* a *El-Khal'lak*) nëse e komentojmë si *I Afti për të krijuar* (*El-Kadir 'alel-khalk*), kthehet tek cilësia *I Afti\I Gjithëfuqishmi* (*El-Kadijr*); apo cilësitë *Dëgjuesi* (*Es-Semi'*) dhe *Shikuesi* (*El-Besir*) nëse i komentojmë si *Ditës i çdo gjëje që dëgjohet dhe i çdo gjëje që shikohet* kthehet tek cilësia *I Gjithëdijshmi* (*El-'Alijm*).

Janë edhe një sërë konceptesh të cilat llogariten si Cilësi Qenësore, të cilave mund t'u përfytyrohen kuptime përkatësie e vepruese. Ky është shkaku që të konsiderohen prej Cilësive Vepruese, si p.sh. koncepti *Dije* i cili është përdorur në shumë ajete kur'anore me kuptimin e Cilësisë Vepruese.[1]

Ajo që ka më shumë rëndësi dhe që ne duhet ta përforcojmë këtu është: Kur përfytyrojmë lidhjen ndërmjet Allahut

1. Shih në Kur'an: suren "El-Bekare", ajetet 187 dhe 235; suren "El-Enfal", ajeti 66; suren "El-Fet'h", ajetet 18 dhe 27; suren "Ali Imran", ajetet 140 dhe 142; suren "El-Maide", ajeti 94; suren Et-Teube, ajeti 16; suren "Muhammed", ajeti 31.

të Madhëruar dhe ekzistentëve materialë, nën dritën e kësaj përftojmë Cilësinë e posaçme Vepruese të Allahut të Lartësuar. Kjo cilësi do të përcaktohet me disa kufij kohorë dhe vendorë për shkak të lidhjes së saj me ekzistentët materialë të cilët përfaqësojnë njërën anë të varësisë, edhe pse kjo Cilësi, duke parë lidhjen e saj me Allahun e Madhëruar në anën tjetër të përkatësisë, është e pastër (e patëmetë) nga kushtëzimet dhe kufizimet.

Për shembull, ofrimi i furnizimit (*rizk*) një personi bëhet në rrethana kohore dhe vendore të caktuara. Porse, këto kushtëzime dhe kufizime, në realitet, janë të lidhura me personin që i bëhet furnizimi dhe nuk kanë të bëjnë me Furnizuesin. Qenia Hyjnore është e pastër (e patëmetë) nga çdo raport a proporcion kohor dhe vendor.

Kjo vërejtje e hollësishme dhe delikate konsiderohet çelës për zgjidhjen e shumë dilemave të cilat ndikojnë janë ngritur në çështjen e njohjes së atributeve dhe veprave hyjnore, e të cilat kanë çuar në shumë mosmarrëveshje ndërmjet dijetarëve dhe mendimtarëve.

Krijueshmëria (*El-Khalikijjeh*)

Pas vërtetimit të Ekzistentit të Domosdoshëm dhe faktit që Ai është edhe Shkaku i Parë për ekzistencën e ekzistentëve të mundshëm, si dhe duke patur parasysh se të gjithë ekzistentët kanë nevojë për Allahun në ekzistencën e tyre, në këtë mënyrë del në pah Cilësia e Krijueshmërisë (*El-Khalikijjeh*) së Ekzistentit të Domosdoshëm dhe fakti që ekzistentët e mundshëm (*mumkinat*) cilësohen si të krijuara. Koncepti *Krijuesi* (*El-Khalik*) tek i cili arrihet nëpërmjet kësaj lidhjeje ekzistenciale është i njëjtë me Shkakun Sjellës në ekzistencë (*El-'Il-letu'l Muxhideh*). Të gjithë ekzistentët e mundshëm nevojtarë të cilët përfaqësojnë njërën anë të përkatësisë, cilësohen si të krijuara, krijesa (*makhlukah*).

Nganjëherë për termin "krijim" përfytyrohet një kuptim

shumë më i kufizuar. Ekzistentët të cilët u sollën në ekzistencë nga një lëndë e mëparshme konsiderohen nanë e përkatësisë, ndërsa përballë saj koncepti "shpikje", i cili përdoret në ekzistentët të cilët nuk janë paraprirë nga lëndë të mëparshme [si qeniet e thjeshta\jo të përbëra (*muxherredat*) dhe lënda e parë]. Mbi këtë bazë, sjellja në ekzistencë ndahet në dy grupe: krijim dhe shpikje.

Pra, procesi i krijimit, të cilin e kryen Allahu i Madhëruar, nuk mund t'i ngjasojë asnjë veprimi njerëzor ndaj gjërave dhe prodhimit të tij të produkteve. Kjo për shkakun e vetëm sepse njeriu ka nevojë për lëvizjen gjatë punës së tij, për përdorimin e pjesëve të trupit, në mënyrë që lëvizja e tij të përfaqësojë veprimin, ndërsa dukuria që ndodh nëpërmjet saj quhet "rezultat i veprimit".

Ndërsa në krijimin e Allahut, "krijimi" nuk është një gjë dhe "krijesat" një gjë tjetër. Kjo, megjithë pastërtinë e Allahut të madhëruar nga lëvizja dhe veçoritë e ekzistentëve truporë. Sepse nëse do të kishte për Krijueshmërinë e Allahut evidencë objektive të jashtme të shtuar mbi qenien e krijesës, atëherë do të ishte ekzistent i mundshëm dhe një krijesë e radhës nga krijesat e Allahut. Kështu, do të kthehej edhe një herë diskutimi rreth krijimit të Vetes së Tij (gjë, e cila është absurde).

Por, ashtu siç e përmendëm edhe në përkufizimin që u bëmë Cilësive Vepruese, këto cilësi janë koncepte që përftohen logjikisht nga përkatësitë dhe atribuimet ndërmjet Allahut dhe krijesave të Tij, të cilat rroken nëpërmjet perspektivës logjike.

Zotësia (*Er-Rububijjeh*)

Nga lidhjet që vihen re ndërmjet Allahut dhe krijesave, është edhe fakti se krijesat jo vetëm që kanë nevojë për Allahun në origjinën e ekzistencës së tyre, por çdo aspekt i ekzistencës të tyre është i lidhur me Allahun e madhëruar. Krijesat nuk kanë asnjë lloj pavarësie. Allahu i lartësuar mundet që të sillet me krijesat e Tij si të dojë, e të bëjë me ta çfarë të dojë.

Kur ne e vërejmë këtë lidhje përgjithësisht, prej saj del në pah koncepti i *Zotësisë* (*Er-Rububijjeh*), nga pasojat e të cilit theksojmë administrimin e çështjeve dhe nga rrjedhojat e tij të shumta kuptimore përmendim p.sh. *Ruajtësi* (*El-Hafidh*), *Jetëdhënësi* (*El-Muhji*), *Jetëmarrësi* (*El-Mumijt*), *Furnizuesi* (*Er-Razik*), *Udhëzuesi* (*El-Hadi*), *Urdhëruesi* (*El-Amir*), *Ndaluesi* (*En-Nahi*) etj.

Çështjet që kanë të bëjnë me Zotësinë mund t'i ndajmë në dy grupe:

• *Grupi i parë*: Zotësi Krijuese (*Er-Rububijjetu't-Tekuinijjeh*), e cila përmbledh administrimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ekzistentët dhe plotësimin e nevojave të tyre. Me një fjalë: administrimin e gjithësisë.

• *Grupi i dytë*: Zotësi Legjislative (*Er-Rububijjetu't-Teshri'ijjeh*), e cila është e veçantë për administrimin e ekzistentëve që posedojnë ndjenja dhe aftësi zgjedhëse. Ajo përmbledh disa çështje siç janë: dërgimi i profetëve, dërgimi i librave qiellorë, caktimi i obligimeve dhe përgjegjësive dhe vendosja e dispozitave dhe ligjeve. Zotësi absolute hyjnore do të thotë që: të gjitha krijesat, në të gjitha çështjet e tyre ekzistenciale janë të lidhura me Allahun e madhëruar dhe se marrëdhëniet dhe lidhjet mes tyre përfundojnë tek lidhja me Krijuesin.

Allahu i lartësuar është Ai që administron dhe drejton disa krijesa nëpërmjet disa krijesave të tjera. Është Ai i Cili i furnizon nëpërmjet burimeve të rizkut të cilat i siguron dhe i krijon Vetë.

Është Ai i Cili i udhëzon krijesat të cilat zotërojnë ndjenja nëpërmjet rrugëve të brendshme (si mendja dhe gjithë fuqitë perceptuese) dhe rrugëve të jashtme (siç janë profetët dhe librat qiellorë). Është Ai i Cili vendos për të përgjegjshmit (*mukel'lefijn*) rregulla e ligje dhe cakton përgjegjësi e obligime.

Zotësia, ashtu si Krijueshmëria, është një koncept plotësues, me ndryshimin se në aspektet e saj të ndryshme vërehen përkatësitë e veçanta ndërmjet vetë krijesave, ashtu siç e

përmendëm te koncepti i Furnizimit.

Në qoftë se do të meditojmë me hollësi konceptet Krijueshmëri dhe Zotësi dhe qenien e tyre nga cilësitë plotësuese, do të na bëhet e qartë se ka pandashmëri ndërmjet këtyre dy cilësive. Është e pamundur që Zoti i gjithësisë të mos jetë Krijuesi. Përkundrazi, Ai që i krijoi krijesat me ato veçori të caktuara dhe me ato marrëdhënie ndërmjet tyre, është Ai i cili ruan dhe i administron ato. Në të vërtetë, koncepti i Zotësisë dhe i Administrimit (*Tedbijr*) buron nga mënyra e krijimit të krijesave dhe lidhjeve të tyre.

Të merituarit e adhurimit (*El-Uluhijjeh*)

Ka studime të shumta mes dijetarëve rreth konceptit (*Ilah*) dhe (*Uluhijje*) e që janë përmendur në librat e komenteve të Kur'anit (*tefsir*). Kuptimi që ne zgjedhim për këtë koncept është: "***Ilah*** *do të thotë 'I Adhuruari' ose 'Ai i Cili meriton adhurimin dhe bindjen'.*"

Sikurse termi "libër" (*kitab*) nënkupton gjënë e shkruar (*mektub*), pra, diçka që vlen për të shkruajtur. Nën dritën e këtij kuptimi, *T*ë Merituarit *e Adhurimit* (*El-Uluhijje*) është një cilësi që në qoftë se duam ta tregojmë duhet që detyrimisht të përfytyrojmë adhurimin e njerëzve dhe bindjen e tyre ndaj Tij. Edhe pse të humburit besojnë zota të rremë, Ai që e meriton adhurimin dhe bindjen është Krijuesi, Allahu.

Kjo shkallë e besimit është kufiri që detyrimisht duhet ta plotësojë çdo njeri në besimin e tij përkundrejt Zotit. Duke shtuar edhe besimin se Allahu është Ekzistent i Domosdoshëm, dhe se Ai është Krijuesi dhe Menaxhuesi, dhe se e gjithë bota i nënshtrohet Vullnetit të Tij, gjithashtu duhet të besojë se vetëm Ai e meriton adhurimin dhe bindjen. Prej këtu rrjedh edhe motoja e Islamit "Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut – *La ilahe il-lAllah*".

Pyetje

1. Cila është marrëdhënia ndërmjet Cilësive Qenësore dhe Vepruese? Si ndërthuren me njëra-tjetrën?

2. Përse Cilësitë Vepruese janë të lidhura dhe të kufizuara me kufij kohorë dhe vendorë?

3. Sqaro nocionin Krijueshmëri dhe trego dallimin ndërmjet Sjelljes në ekzistencë (*El-Ijxhad*) dhe Shpikjes (*El-Ibda'*)?

4. Cili është shkaku që nuk mund të përfytyrojmë për Krijueshmërinë një evidencë objektive të shtuar mbi qenien e krijesave?

5. Qartëso konceptin Zotësi?

6. Sqaro ndarjet e Zotësisë?

7. Përmend pandashmërinë mes Krijueshmërisë dhe Zotësisë?

8. Qartëso konceptin *Uluhijje* dhe pandashmërinë e tij nga Krijueshmëria dhe Zotësia?

Leksioni i njëmbëdhjetë

CILËSITË E TJERA VEPRUESE

Hyrje

Nga temat që ngrihen në apologjetikë (*'ilmu'l-kelam*) është edhe tema e Vullnetit hyjnor (*Irade Ilahijjeh*). Në tryezën e studimit janë hedhur aspekte të ndryshme dhe rreth tyre ka patur kontradita dhe mosmarrëveshje, si për shembull: A është Vullneti nga Cilësitë Qenësore apo nga Cilësitë Vepruese? A është Vullneti i pafillimtë (*kadijm*) apo i krijuar (*hadith*)? A është vetëm një Vullnet apo janë disa?

Kjo, duke shtuar edhe studimet me të cilat është përballur filozofia rreth vullnetit në përgjithësi dhe Vullnetit hyjnor në veçanti.

Është mëse e qartë se studimi i kësaj teme është i gjerë për t'u përmbledhur në këtë libër. Prandaj, fillimisht po shpjegojmë termin *vullnet* dhe pas kësaj do të paraqitim një studim të shkurtër rreth Vullnetit hyjnor.

Vullneti (*El-Irade*)

Termi "vullnet" në përdorimet përkufizimore përdoret të paktën në një nga dy kuptimet:

- I pari: Dëshirë.
- I dyti: Vendosmëri në kryerjen e një pune.

Kuptimi i parë është shumë i gjerë në përdorimin e tij, ku përfshin dëshirën e jashtme për gjërat[1] dhe veprimet e vetë personit dhe veprimet e të tjerëve; ndryshe nga kuptimi i dytë

1. Ashtu si në ajetin e nderuar: ***"Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër."*** (El-Enfal, ajeti 67.)

që përdoret në veçantinë e veprimeve të një personi.

Vullneti, sipas kuptimit të parë (dëshirës), edhe pse ndodhet tek njeriu në formën e dukurive cilësore dhe situatave psikologjike shpirtërore, prapëseprapë ne mund të përfytyrojmë një kuptim të përgjithshëm duke e zhveshur nga mangësitë, në mënyrë që të pranojë përputhje dhe cilësim të ekzistentëve esencialë, madje edhe të Vetë Allahut të madhëruar, ashtu sikurse e kryen mendja procesin logjik të pastrimit të *Dijes* absolute nga mangësitë. Prej këtu, gjithashtu ne mund ta konsiderojmë Dashurinë (*El-Hubb*) me të Cilën quhet dashuria e Allahut për Veten e Tij si Cilësi Qenësore.

Pra, nëse me *Vullnet Hyjnor* (*Irade Ilahijje*) nënkuptojmë dëshirën për përsosuri e cila, së pari, ka të bëjë me Përsosurinë e pafundme hyjnore dhe që në nivele pasuese ka të bëjë me përsosuritë e gjithë ekzistentëve duke qenë se ato janë gjurmë të Përsosurisë të Tij, kjo na jep mundësinë që ta konsiderojmë prej Cilësive Qenësore; pra, si gjithë Cilësitë e tjera Qenësore, të jetë edhe ajo një Cilësi e pafillimtë dhe e vetme, njëkohësisht Vetë Qenia e Shenjtë Hyjnore.

Ndërsa, përsa i përket Vullnetit në kuptimin e vendosmërisë për kryerjen e një pune, ai pa asnjë dyshim është prej Cilësive Vepruese, sepse kufizohet me kufizime kohore, parë nga perspektiva e lidhjes së tij me gjërat e krijuara, ashtu siç vihet re edhe në përdorimet kur'anore: "***Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë asaj "Bëhu!" - dhe ajo bëhet.***"[2]

Por, është e domosdoshme të theksojmë se cilësimi i Allahut të madhëruar me Cilësitë Vepruese nuk do të thotë se ndodh ndonjë ndryshim apo ndikim në Qenien hyjnore, por do të thotë se vërehet njëfarë përkatësie dhe atribuimi ndërmjet Qenies hyjnore dhe krijesave të Tij nga një kënd i veçantë dhe nën hijen e disa kushteve të veçanta, duke nxjerrë kështu një koncept të caktuar përkatësie e që është një prej Cilësive Vepruese.

2. Sure "Jasin", ajeti 82.

Në aspektin e vullnetit vëmë re këtë lidhje: Çdo krijesë është krijuar nga ana e një Qenieje që i siguron përsosurinë, të mirën dhe interesin. Ekzistenca e saj në kohë dhe vend të caktuar dhe sipas një mënyre të veçantë, është e lidhur me Dijen dhe Dashurinë hyjnore.

Allahu i Madhëruar e ka krijuar vetë me përzgjedhjen e Tij, pa e detyruar askush në këtë krijim. Duke vëzhguar këtë marrëdhënie, bëhet i qartë koncepti i përkatësisë i quajtur "Vullnet", i Cili kufizohet nga kufij nëse vihet re lidhja me diçka të kufizuar.

Ky koncept përkatësie cilësohet si i rastësishëm (*hadith*) dhe sasior, sepse përkatësia është e dy anëve dhe se incidenca\rastësia (*huduth*) dhe sasia (*kethre*) në njërën anë janë të mjaftueshme për t'ia kaluar këto cilësi vetë përkatësisë.

Urtësia (*El-Hikme*)

Duke mediturar rreth asaj që përmendëm për Vullnetin hyjnor, na bëhet e qartë se Vullneti nuk lidhet me sjelljen e diçkaje në ekzistencë në mënyrë të kotë, të rastësishme dhe pa urtësi, por me të cilën lidhet në thelb Vullneti hyjnor është ana e përsosurisë dhe e së mirës tek gjërat.

Meqenëse ngjeshja e trupave materialë me njëra-tjetrën çon në shkaktimin e mangësive dhe dëmeve si pasojë e veprimit të disa trupave ndaj disa të tjerave, për këtë arsye Dashuria hyjnore për përsosuri shkakton sjelljen në ekzistencë të të gjitha gjërave në mënyrë të atillë që posedon mirësinë dhe përsosurinë më të shumtë dhe më dominuese. Dhe duke vënë re këto marrëdhënie e lidhje, arrihet te koncepti "interes" (*maslaha*).

Përndryshe, interesi nuk ka ekzistencë të pavarur nga ekzistenca e krijesave, që të ndikojë në ekzistencën e tyre dhe që të ketë ndikim edhe në Vullnetin hyjnor. Me fjalë të tjera: *Nuk ka ekzistencë të jashtme të pavarur të quajtur "interes" (maslaha) që të ndikojë në ekzistencën e krijesave, e jo më të thuhet se ai ndikon te Vullneti hyjnor.*

Ajo që arrihet nga kjo është: Meqenëse veprat hyjnore e kanë burimin nga Cilësitë Qenësore si Dija, Aftësia\Fuqia dhe Dashuria për përsosurinë dhe mirësinë, për këtë arsye, këto vepra mund të mos e përfshijnë interesin, por ato gjithmonë e disponojnë interesin, pra posedon mirësinë dhe përsosurinë më dominuese.

Ky lloj vullneti quhet "Vullnet i Urtë". Kështu ne njohim një tjetër Cilësi nga Cilësitë Vepruese të Allahut të lartësuar e cila është Urtësia (*El-Hikme*). Ajo, si gjithë Cilësitë e tjera Vepruese, fillon e mbaron tek Cilësitë Qenësore.

Duhet të theksojmë se kryerja e një vepre për hir të interesit, nuk do të thotë se interesi është një shkak final (*'il-letun ga'ije*) i Allahut të Lartësuar. Madje, interesi konsiderohet qëllim dytësor dhe vijimor, ndërsa qëllimi kryesor i veprave të Allahut është dëshira e Tij për Përsosurinë e pafundme qenësore, e Cila lidhet me vijimësinë e ndikimeve e saj, pra, me përsosurinë e krijesave.

Prej këtu rrjedh thënia se shkaku final i Veprave hyjnore, është vetë shkaku veprimor, jo se Allahu ka ndonjë qëllim të pavarur apo shtesë në Veten e Tij. Ky mendim nuk bie ndesh me konsideratën se përsosuria, e mira dhe interesi te krijesat janë qëllime dytësore dhe vijimore. Ky është edhe shkaku që në Kur'anin famëlartë disa Vepra hyjnore janë shpjeguar me disa çështje dhe qëllime të cilat përfundojnë tek përsosuria dhe mirësia e krijesave, duke i sjellë dobi vetë krijesës.

Ajetet kur'anore kanë përmendur se sprovat, përzgjedhja e punëve më të mira, adhurimi i Allahut dhe arritja e mëshirës së veçantë të përjetshme hyjnore[3] janë qëllimet dhe synimet nga krijimi i njeriut. Çdonjëra prej këtyre qëllimeve është një parashtrim për qëllimin tjetër, sipas radhitjes që përmendëm më sipër.

3. Shih në Kur'an: suren "Hud", ajeti 7; suren "El-Mulk", ajeti 2; suren "El-Kehf", ajeti 7; suren "Edh-Dharijat," ajeti 56; suren "Hud", ajetet 108 e 119; suren "El-Xhathije", ajeti 23; suren "Ali Imran", ajeti 15; suren "Et-Teube", ajeti 72.

Fjala hyjnore (*El-Kelamu'l-Ilahij*)

Nga termat të cilat i janë atribuar Allahut të Lartësuar është koncepti i "Të Folurit" (*Et-Tekel'lum*).

Që në kohët e hershme janë bërë studime rreth Fjalës hyjnore (*El-Kelamu'l-Ilahij*) ndërmjet teologëve kelamistë (*mutekel'limun*). Madje thuhet se edhe shkaku i këtij emërtimi (*'Ilmu'l Kelam* – apologjetikë, teologji) është përfshirja e dijetarëve të kësaj disipline në debatin rreth Fjalës hyjnore.

Esh'arinjtë e kanë konsideruar prej Cilësive Qenësore, ndërsa mu'tezilitët e kanë konsideruar prej Cilësive Vepruese. Një nga çështjet që kanë shkaktuar polemika të forta ndërmjet këtyre dy medh'hebeve është çështja: "*A është Fjala e Allahut, Kur'ani, i krijuar apo i pakrijuar?*" Arriti deri aty sa një pjesë e tyre akuzuan pjesën tjetër për blasfemi (*kufr*), për shkak të mendimeve të ndryshme rreth kësaj teme.

Duke vënë re përkufizimin të cilin përmendëm rreth Cilësive Vepruese dhe Cilësive Qenësore, na bëhet e qartë se: *Të Folurit është prej Cilësive Vepruese*, sepse përftohet nga përfytyrimi i një dëgjuesi që merr qëllimin e folësit dhe idenë e tij nëpërmjet dëgjimit të zërit, shikimit të shkrimit, perceptimit kuptimor në mendjen e tij apo nëpërmjet çdo rruge ose mënyre tjetër.

Në të vërtetë, koncepti "Folësi" (*El-Mutekel'lim*) përftohet nga lidhja ndërmjet Allahut të madhëruar, i Cili dëshiron t'i zbulojë dikujt një të vërtetë të caktuar dhe dëgjuesit (që i adresohet Fjala), i cili e percepton këtë të vërtetë dhe e merr atë. Kjo, përveç rastit kur Folësi dëshiron ndonjë kuptim tjetër, si p.sh. Aftësia për të folur apo Dija për përmbajtjen e Fjalës.

Me këtë shpjegim, kjo Cilësi fillon dhe përfundon tek Cilësitë Qenësore, ashtu siç përmendëm të ngjashmet me të kur folëm për disa nga Cilësitë e tjera Vepruese. Ndërsa Kur'ani famëlartë, në kuptimin e fjalëve të shkruara, të shprehjeve, të koncepteve që ekzistojnë në mendje apo të vërtetës së ndritshme dhe absolute, ai është i krijuar. Vetëm në qoftë

se thuhet se Dija Qenësore Hyjnore është e vërteta e Kur'anit, në këtë kontekst kjo Cilësi interpretohet si atribut i Dijes Qenësore.

Por këto interpretime rreth Fjalës hyjnore dhe Kur'anit famëlartë janë shumë larg nga botëkuptimi i zakonshëm i debateve dhe duhen evituar.

Vërtetësia (*Es-Sidk*)

Fjala hyjnore, kur përmban urdhër, ndalim dhe shprehje (ligjëratë të drejtë – *insha'*), nëpërmjet tyre ajo cakton dispozitat dhe detyrat vepruese të krijesave dhe nuk mund të cilësohet si e vërtetë apo e gënjeshtërt, sepse ligjërata e drejtë nuk mund të cilësohet si e vërtetë apo e gënjeshtërt.

Por në qoftë se përmban njoftim për të vërtetat ekzistuese apo ngjarjet e kaluara dhe të ardhshme, atëherë cilësohet si e vërtetë, siç thuhet në Kur'anin famëlartë: *"E kush është në fjalë më i vërtetë se Allahu?"*[4]

Kjo Cilësi përfaqëson themelin për marrjen në konsideratë të një tjetër lloj argumentimi, i cili është "argumentimi tekstual (*naklij*) dhe adhurimor (*te'abbudij*)" për vërtetimin e çështjeve dytësore të vizionit kozmik dhe vërtetimin e shumë çështjeve ideologjike.

Nga argumentet logjikë të cilët mund të ngremë për të vërtetuar këtë Cilësi është ky: Fjala e Allahut është nga çështjet e Zotësisë Hyjnore dhe administrimit të gjithësisë dhe njeriut dhe bazohet mbi bazën e Dijes dhe Urtësisë për drejtimin e krijesave dhe udhëzimin e tyre si dhe ofrimin e mënyrave të transmetimit të informacionit dhe të njohurive të sakta për dëgjuesit.

Dhe në qoftë se do të ishte e mundur që të kundërshtonte realitetin apo thjesht të supozohej kundërshtimi i realitetit në të, atëherë nuk do të ishte e mundur që t'i bindeshim në gjithë këto çështje e të bazoheshim mbi të. Kjo do të ishte në kundër-

4. Sure "En-Nisa", ajeti 87.

shtim me qëllimin e Fjalës hyjnore dhe në kundërshtim me Urtësinë hyjnore.

Pyetje

1. Cili është kuptimi që e konsideron Vullnetin si Cilësi Qenësore? Cili është kuptimi që e konsideron si Cilësi Vepruese?

2. Cila është marrëdhënia që vihet re ndërmjet Allahut të Madhëruar dhe krijesave për të arritur në kuptimin e Vullnetit si Cilësi Vepruese?

3. Si cilësohet Vullneti hyjnor me incidencë (*huduth*) dhe sasi (*kethre*)?

4. Fol për Urtësinë hyjnore?

5. Si arrihet në konceptin "interes" (*maslaha*)?

6. Me çfarë kuptimi mund ta konsiderojmë interesin, mirësinë e krijesave dhe përsosurinë si qëllim të krijimit?

7. Sqaro Fjalën hyjnore?

8. Trego argumentin logjik për Vërtetësinë (*Es-Sidk*) e Allahut të Lartësuar?

Leksioni i dymbëdhjetë

STUDIMI I FAKTORËVE TË DEVIJIMIT

Hyrje

Në leksionin e parë ne shpjeguam se botëkuptimi përgjithësisht ndahet në dy grupe:

- Botëkuptimi hyjnor.
- Botëkuptimi materialist.

Çështja më e rëndësishme rreth të cilës ndahen këto dy vizione është çështja e ekzistencës së Një Zoti të Gjithëdijshëm e të Plotpushtetshëm. Botëkuptimi hyjnor e konsideron si bazë themelore këtë çështje, ndërkohë që teoria materialiste e mohon atë.

Në leksionet e kaluara, duke iu përshtatur këtij libri, studiuam rreth vërtetimit të ekzistencës së Allahut dhe paraqitëm Cilësitë më të rëndësishme hyjnore, Cilësitë Mohore dhe Cilësitë Vërtetuese, Cilësitë Qenësore dhe ato Vepruese.

Për të forcuar dhe thelluar besimin mbi këtë bazë themelore, do t'i qasemi shkurtimisht kritikës së vizionit kozmik materialist duke bërë të qartë nëpërmjet saj, përveç vërtetimit të botëkuptimit hyjnor, rrëzimin dhe prishjen e bazave mbi të cilat mbështetet vizioni materialist.

Për të realizuar këtë qëllim, do të flasim në fillim rreth faktorëve të devijimit nga botëkuptimi hyjnor dhe orientimit drejt ateizmit. Pas kësaj do të shpjegojmë pikat e dobëta më të rëndësishme të botëkuptimit materialist.

Faktorët e devijimit

Materializmi dhe ateizmi janë të vjetër në historinë e njerëzimit edhe pse gjithmonë ka ekzistuar ndërmjet popu-

jve besimi në Allahun. Këtë e tregojnë ngjarjet historike dhe arkeologjia. Që në kohët e hershme kanë ekzistuar individë dhe grupe ateiste që e mohonin ekzistencën e Allahut, por përhapjen më të madhe ateizmi e mori në shekullin XVIII në Europë dhe pas kësaj filloi të përhapej ndikimi i tij gradualisht në çdo cep të botës.

Kjo frymë ateiste, edhe pse filloi si kundërshtim ndaj aparatit të Kishës dhe Krishtërimit, stuhia e saj shkundi të gjitha fetë dhe rrymat fetare. Perëndimi e eksportoi orientimin ateist tek të gjithë popujt në të njëjtën kohë kur eksportoi industrinë, artin dhe teknologjinë.

Kjo valë ateizmi u përhap gjatë shekullit të fundit me përhapjen e parimeve shoqërore dhe ekonomike marksiste në shumë vende e popuj, duke formuar kështu pengesën më të madhe dhe sëmundjen më të rrezikshme me të cilën është përballur ndonjëherë njerëzimi.

Faktorët që ndihmuan në përhapjen dhe zgjerimin e kësaj dukurie të devijuar e devijuese janë të shumtë dhe studimi i të gjithë atyre kërkon një libër të veçantë,[1] por ne mund të përmendim në mënyrë të përgjithshme tri grupe nga faktorët e kësaj fushe:

1- Faktorët psikologjikë

Cilët mund të jenë ata faktorë që e detyrojnë njeriun drejt mosbesimit dhe ateizmit edhe në qoftë se nuk i ndjen individi ndikimet e saj në veten e tij?

Nga faktorët më të rëndësishëm mund të theksojmë: dëshira për qetësi e pushim, dembelizmi, tendenca për kotësinë, shthurja dhe ndjenja e papërgjegjësisë.

Energjitë që duhet t'i shpenzojë njeriu për studime e kërkime, veçanërisht në fushat të cilat nuk ofrojnë kënaqësi materiale të prekshme (pasi energjitë e shpenzuara në këto kënaqë-

1. Profesor Mutahariu i ndjerë ka bërë një studim rreth këtyre faktorëve në librin e tij *Shkaqet e animit kah materializmi*.

si i pengojnë njerëzit dembelë, ata që e kalojnë kohën kot dhe joambiciozët nga studimi dhe kërkimi), gjithashtu dëshira për shthurje, devijime shtazore e kotësi, çrregullsia dhe ndjenja e papërgjegjësisë i pengon ata të drejtohen e të anojnë kah botëkuptimi hyjnor.

Sepse pranimi i botëkuptimit hyjnor dhe besimi në Krijuesin e Urtë, konsiderohet si pikënisje për një grup doktrinash (*mu'tekedat*) të tjera të cilat e obligojnë njeriun me ndjenjën e përgjegjësisë në të gjitha veprimet që ai kryen me përzgjedhje. Kjo përgjegjësi e detyron njeriun në shumë qëndrime dhe aspekte të mohojë dëshirat e tij dhe t'u përmbahet disa rregullave.

Përmbajtja ndaj këtyre rregullave nuk përshtatet me dëshirat për të shthurje. Prej këtej, kjo dëshirë shtazore, edhe pse duket e pandjeshme, është shkak për dobësimin e rrënjëve dhe bazave të këtyre përgjegjësive e rregullave, si dhe për mohimin e ekzistencës së Allahut të madhëruar.

Ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që dalin në pah nëpërmjet faktorëve të tjerë, të cilët luajnë rolin e tyre në orientimin drejt ateizmit dhe mosbesimit.

2- Faktorët shoqërorë

Janë disa kushte dhe situata negative shoqërore që shfaqen në disa shoqëri e popuj, ku ata të cilët mbajnë në dorë frerët e çështjeve fetare luajnë rol në shkaktimin dhe përhapjen e tyre.

Në këto kushte dhe situata e humbasin vizionin e drejtë shumë nga dritëshkurtërit dhe mendimdobët dhe as nuk kanë mundësi të studiojnë në thellësi faktorët e vërtetë që janë pas këtyre ngjarjeve dhe situatave.

Prandaj, kur shohin rolin e fetarëve gjatë zhvillimit të këtyre ngjarjeve, ia veshin fesë akuzën si shkaktare dhe iluzionojnë se doktrinat fetare janë shkaktare të zhvillimit të këtyre ngjarjeve e situatave negative; kjo i çon ata të largohen nga feja

Kushtet shoqërore në të cilat jetoi Europa gjatë periudhës së Rilindjes janë një shembuj të qartë të këtyre faktorëve.

Qëndrimet negative të Kishës në çështje të ndryshme fetare, legjislative dhe politike ishin nga faktorët më të rëndësishëm në largimin e njerëzve nga Krishtërimi, madje nga feja në mënyrë të përgjithshme.

Është shumë e rëndësishme për të gjithë ata të cilët janë të ngarkuar me çështjet fetare që të kenë shumë kujdes nga ndikimi i këtyre faktorëve, duke njohur deri në thellësi pozitën e tyre që kanë tek njerëzit si dhe delikatesën e misionit të tyre dhe rëndësinë e saj. Ata duhet ta dinë se gabimet e tyre mund të çojnë deri në shthurjen e shoqërisë dhe palumturinë e saj.

3- Faktorët ideologjikë

Të gjitha ato iluzione dhe dyshime të cilat i vijnë në mendje njeriut apo i dëgjon prej të tjerëve duke mos patur mundësi që t'i përballojë për shkak të dobësisë dhe mangësisë së potencialit të tij intelektual dhe argumentues, detyrohet që t'i nënshtrohet ndikimit të këtyre dyshimeve, ose së paku i shkaktojnë një ndjenjë lëkundjeje dhe dileme në mendjen e tij, gjë e cila e pengon atë të arrijë qetësi dhe qëndrueshmëri në pranimin e së vërtetës.

Ne mund t'i ndajmë faktorët ideologjikë sipas rolit të tyre në grupe dytësore, si p.sh. dyshime që bazohen mbi animin kah gjërat e prekshme, dyshime që burojnë nga besimet e legjendave, dyshime që burojnë nga komentimet e gabuara dhe argumentimet e dobëta, dyshime të cilat lidhen me ndodhi dhe katastrofa të dhimbshme duke besuar se ato janë në kundërshtim me Urtësinë dhe Drejtësinë hyjnore, dyshime të cilat burojnë nga supozimet shkencore ku disa mendojnë se ato janë në kundërshtim me doktrinat fetare, dyshime që lidhen me disa dispozita dhe mësime fetare, veçanërisht çështjet ligjore, çështjet e të drejtave dhe ato politike.

Ndoshta mund të jenë dy faktorë apo edhe më shumë faktorë që ndihmojnë të gjithë në formimin e një gjendjeje pavendosmërie dhe dyshimi, kundërshtie dhe ateizmi.

Nganjëherë vihet re se lodhjet e ndryshme psikologjike ndoshta mund të jenë një faktor në përgatitjen e shfaqjes së dyshimeve dhe supozimeve, duke i shkaktuar individit një sëmundje psikologjike shpirtërore - makthin ideor (*vesvas fikrij*).

Si rezultat i kësaj, ky i sëmurë bie në gjendjen e dyshimit duke mos u kënaqur me asnjë fakt dhe argument, njëlloj si i prekuri nga makthet në punën e tij: ai nuk beson në saktësinë e asnjë pune të cilën ai e vepron. Po ta vëresh ai i lan duart dhjetra herë, megjithatë ai sërish nuk është i qetë mbi pastërtinë e dorës së tij, edhe pse dora mund të ketë qenë e pastër që herën e parë.

Përballja me faktorët e devijimit

Nëse do të meditojmë mbi faktorët e devijimit, ku pamë se ato janë të shumtë e të shumëllojshëm, atëherë do të na bëhet e qartë se përballja me çdo faktor do të kërkonte një rrugë të caktuar si dhe qëndrime e trajtime të veçanta. Për shembull, për problemet shpirtërore dhe morale duhet bërë trajtimi i tyre nëpërmjet edukatës së rregullt dhe kujdesit që duhet treguar ndaj ndikimeve negative të saj, ashtu siç e përmendëm në leksionin e dytë dhe të tretë, ku studiuam domosdoshmërinë e studimit të fesë dhe ndikimet e gabuara nga mosinteresimi dhe mosstudimi i saj.

Gjithashtu, përballja me ndikimet negative të faktorëve shoqër orë - përveç punës për parandalimin e këtyre situatave dhe faktorëve - kërkon edhe sqarimin se ka ndryshim të madh ndërmjet kotësisë së fesë dhe devijimit të fetarëve, qëndrimeve e veprimeve të tyre të gabuara. Vigjilenca ndaj ndikimit të faktorëve psikologjikë dhe socialë sjell si rezultat, më së paku, mosnënshtrimin e individit ndaj këtyre faktorëve.

Gjithashtu, duhen marrë masa të sakta dhe qëndrime

të drejta ndaj komplikimeve dhe ndikimeve të faktorëve ideologjikë, si dallimi ndërmjet besimeve mitologjike dhe besimeve të vërteta, apo shmangia nga përdorimi i argumenteve të dobët dhe jo logjikë për vërtetimin e besimeve fetare.

Gjithashtu, duhet t'u sqarojmë atyre këtë të vërtetë: dobësia e argumentit nuk tregon pavërtetësinë e pretendimit.

Është e qartë se studimi i gjithë faktorëve të devijimit dhe përmendja e rrugëve dhe mënyrave të përshtashme për t'u përballur me çdonjërën prej tyre nuk i përshtatet këtij studimi. Prandaj, ne do të mjaftohemi me përmendjen e disa faktorëve ideologjikë të ateizmit si dhe përgjigjen ndaj disa dyshimeve që lidhen me to.

Pyetje

1. Cila është dobia e përftuar nga kritika dhe studimi i vizionit kozmik materialist?

2. Si u përhap rryma e ateizmit në shekujt e fundit?

3. Trego faktorët psikologjikë të devijimit nga feja?

4. Shpjego faktorët shoqërorë të dukurisë së devijimit?

5. Sqaro faktorët ideologjikë dhe çfarë faktorësh rrjedhin prej tyre?

6. Si ndodh makthi ideor (*vesvas fikrij*)?

7. Si të përballemi me faktorët e devijimit?

Leksioni i trembëdhjetë

KEQKUPTIME DHE ZGJIDHJE

Besimi në një **Ekzistent t**ë **paperceptuesh**ëm *(t*ë *pakapsh*ëm*)*

Një nga keqkuptimet e thjeshta të cilat ngrihen rreth besimit te Allahu është: Si mund të besojmë në një ekzistent që nuk i nënshtrohet perceptimit ndijimor (*idrak hissij*), pra, që nuk mund të perceptohet nëpërmjet shqisave?

Ky keqkuptim vjen në mendjet e njerëzve me intelekt të ulët e të thjeshtë në formë përjashtimi (*istib'ad*) ose habie (*istighrab*), duke u habitur nga mundësia e ekzistencës së një Ekzistenti që nuk e rrokin shqisat dhe duke e përjashtuar mundësinë e ekzistencës së Tij. Por janë edhe disa dijetarë të cilët në themel të mendimeve të tyre mbështeten mbi bazën ndijimore (*asaletu'l-hiss*).

Në këtë mënyrë ata e mohojnë Ekzistentin e pakapshëm nga shqisat (*gajr mehsus*), ose së paku ata nuk e pranojnë Atë me një njohje të sigurtë e të prerë. Përgjigjja ndaj këtij keqkuptimi është: Perceptimet ndijimore (*mudrekat hissije*) ndodhin si rezultat i lidhjes së organeve a gjymtyrëve të trupit me trupat dhe organizmat fizikë dhe çdo shqisë nga shqisat tona dallon një nga dukuritë fizike që përshtatet asaj shqise me natyrën e saj dhe sipas disa kushteve të caktuara.

Ashtu siç nuk mund të imagjinojmë dot që syri të rrokë zërat apo veshi të rrokë ngjyrat, po ashtu është shumë e nevojshme të kuptojmë se shqisat tona nuk janë të afta t'i rrokin të gjithë ekzistentët. Kjo sepse:

E para: Janë disa ekzistentë materialë të cilat është e pamundur të perceptohen nëpërmjet shqisave (për shkak se shq-

isat tona janë të kufizuara), p.sh. rrezet ultravjollcë apo infra të kuqe, valët elektro-magnetike etj.

E dyta: Ne i perceptojmë shumë të vërteta jo nëpërmjet rrugës së shqisave të dukshme dhe i besojmë ato si të vërteta bindëse, megjithëse ato nuk mund të perceptohen nëpërnjet shqisave. Për shembull, ne e ndiejmë gjendjen e frikës, dashurisë dhe vullnetit në veten tonë dhe i besojmë ato si të vërteta të pakundërshtueshme edhe pse ato janë gjendje psikologjike shpirtërore, siç është edhe vetë shpirti i cili nuk mund të perceptohet nëpërmjet perceptimit ndijimor, madje edhe vetë perceptimi është dukuri jo materiale dhe e paprekshme.

Roli i frikës dhe i padijes në besimin tek Allahu

Një keqkuptim tjetër të cilin e kanë ngritur dijetarët e sociologjisë është: "Besimi ka lindur si rezultat i frikës nga disa rreziqe e brenga, veçanërisht ato rreziqe të cilat e kanë burimin nga tërmetet, bubullimat dhe të tjera fatkeqësi e katastrofa natyrore. Në realitet, njeriu, për të qetësuar shpirtin e tij, shpiku (*Zoti na faltë!*) një ekzistent imagjinar që është "Zoti" dhe filloi ta adhuronte.

Kështu që, sa më shumë të njihemi me shkaqet natyrore të këtyre dukurive dhe mënyrat për t'u përballur me to, aq më shumë dobësohet besimi tek Zoti."

Marksistët e përhapën këtë ide me shumë zhurmë në shkrimet e tyre duke e përshkruar atë si një nga të dhënat e sociologjisë dhe pas kësaj e bënë atë si mjet me të cilin "peshkonin" budallenjtë dhe të mashtruarit.

Për të kundërshtuar këtë keqkuptim themi:

- *E para*: Baza e këtij keqkuptimi është një supozim i hedhur nga disa sociologë, pa u mbështetur në ndonjë argument shkencor që të vërtetojë saktësinë e tij.
- *E dyta*: Shumë nga dijetarët e mëdhenj të kohës tonë janë njohur me shkaqet e këtyre dukurive natyrore më shumë se paraardhësit e tyre, por ata besojnë në ekzistencën e Al-

lahut të Urtë me një besim të sinqertë dhe të palëkundur.[1] Si përfundim, besimi tek Allahu nuk buron nga frika dhe padija.

• *E treta*: Nëse frika nga disa dukuri apo padija rreth shkaqeve natyrore të disa dukurive është faktor në orientimin drejt Allahut, kjo nuk do të thotë se Allahu është pjellë e frikës së njeriut dhe injorancës së tij. Kjo vihet re tek shumë motive psikologjike (*deuafi' nefsije*) si dëshira për kënaqësi, dëshira për t'u dukur etj., të cilat ishin shtysa e shumë prej përpjekjeve dhe studimeve shkencore, artistike e filozofike, pa e cenuar asgjë e keqe rëndësinë e këtyre përpjekjeve dhe studimeve.

• *E katërta*: Nëse ka ende njerëz që besojnë se Allahu i Lartësuar është Shkaktar i gjithë këtyre dukurive pa ndonjë shkak të njohur dhe u dobësohet ky besim me zbulimin e shkaqeve natyrore, duhet ta konsiderojmë këtë si argument për dobësinë e të kuptuarit dhe të besimit të tyre dhe jo si argument për mosmarrjen në konsideratë të besimit tek Zoti. Kjo, sepse qenia e Allahut të lartësuar shkak për këto dukuri kozmologjike nuk është nga natyra e shkaqeve natyrore dhe as në nivelin e tyre, por shkakësia e Tij është gjithëpërfshirëse dhe në gjatësinë e ndikimit të të gjitha shkaqeve materiale dhe jo materiale. Njohja e shkaqeve natyrore apo mosnjohja e tyre nuk ka absolutisht asnjë ndikim në vërtetimin apo mohimin e Tij.

A është ligji i shkakësisë i përgjithshëm dhe absolut?

Është edhe një tjetër keqkuptim që e kanë ngritur disa dijetarë perëndimorë. Ai është: "Ligji i shkakësisë, nëse është parim gjithëpërfshirës, ai e përfshin edhe Allahun e Madhëruar, prandaj duhet të supozojmë një shkak për Allahun gjithashtu, megjithëse supozohet se Allahu është e Shkak i Parë dhe që nuk ka shkak për Të.

1. Si p.sh.: Ajnshtajn, Kris Morrison, Aleksis Karel dhe të tjerë shkencëtarë të mëdhenj të cilët kanë shkruar artikuj e libra rreth ekzistencës së Allahut. Disa prej tyre janë përmbledhur në librin "*Allahu jetexhel'la fi 'asri'l 'ilm*" (*Allahu shfaqet madhërishëm në epokën e dijes*).

Pra, besimi tek një Zot për të Cilin nuk ka shkak është zhvleftësim dhe shkatërrim i ligjit të shkakësisë, si dhe argument për mosgjithëpërfshirjen e Tij.

Nëse e mohojmë gjithëpërfshirjen e tij, atëherë nuk mund të mbështetemi tek kjo rregull për të vërtetuar Ekzistentin e domosdoshëm, sepse dikush ndoshta mund të thotë se substanca origjinale, materia (*madde aslijje*) apo fuqia u gjend vetvetiu, pa shkak dhe nga ndryshimet dhe shndërrimet e saj janë krijuar të gjitha dukuritë dhe sendet."

Ashtu si e kemi përmendur edhe në leksionin e shtatë, ky keqkuptim është rezultat i një shpjegimi të gabuar rreth origjinës së parimit të shkakësisë. Ata menduan se domethënia e tij është se çdo gjë ka nevojë për shkak.

Në fakt, koncepti i saktë është: **"Çdo ekzistent i mundshëm apo çdo ekzistent i varur është i mangët dhe ka nevojë për një shkak."** Ky parim është i përgjithshëm e i domosdoshëm dhe nuk pranon përjashtime.[2]

Ndërsa supozimi se materia apo fuqia origjinale janë gjendur pa shkak dhe se shndërrimet e tyre janë shkak për ekzistencën e gjithë dukurive në gjithësi, kjo është diçka që kundërshtohet nga shumë kundërshtime të cilat do t'i studiojmë në leksionet e ardhshme.

Të dhënat nga shkencat eksperimentale

Nga keqkuptimet e kësaj fushe veçojmë: "Besimi në ekzistencën e Krijuesit të gjithësisë dhe të njeriut nuk përshtatet me disa nga arritjet e shkencave moderne dhe të dhënat e tyre. Për shembull, është vërtetuar nga shkenca e kimisë mbetja e sasisë së materies dhe fuqisë dhe qëndrimi i saj gjithmonë.

Si rrjedhojë, asnjë krijesë nuk mund të vijë nga asgjëja, hiçi (*'adem*) dhe asnjë ekzistent nuk mund të pasohet kurrë nga asgjëja, edhe pse besimtarët besojnë se Zoti i solli në ekzis-

2. Këtë ide do ta sqarojmë më shumë në leksionet e ardhshme.

tencë krijesat e Tij nga asgjëja.

Gjithashtu është vërtetuar në shkencën e biologjisë se gjallesat e kanë prejardhjen nga ekzistentë jo të gjallë dhe kanë evoluar gradualisht deri sa arritën tek njeriu si rezultat i zhvillimit dhe ngritjes, edhe pse besimtarët besojnë se Zoti është Ai që ka krijuar çdo ekzistent më vete."

Në përgjigje të këtij keqkuptimi ne mund të themi:

Së pari: Parimi i mbetjes së materies dhe fuqisë\energjisë është një parim shkencor empirik, mbi të cilën mund të bazohemi vetëm për dukuritë që i nënshtrohen eksperimentit. Ky parim nuk mund të trajtojë çështjen filozofike: a është materia dhe fuqia e pafillimtë (*ezelijje*) dhe e pambarimtë (*ebedijje*) apo jo?

Së dyti: Mbetja e sasisë së materies dhe energjisë dhe qëndrueshmëria e saj nuk do të thotë se nuk kanë nevojë për Krijuesin, madje sa më shumë që zgjatet mosha e gjithësisë aq më shumë ka nevojë për Krijuesin.

Kjo, sepse e përbashkëta dhe shkaku i nevojës që ka pasoja, efekti (*ma'lul*) për shkakun (*'il-leh*) është mundshmëria (*imkan*) dhe nevoja qenësore e pasojës dhe jo incidenca (*huduth*) dhe kufizimi kohor.

E thënë ndryshe, materia dhe energjia përfaqësojnë shkakun material të gjithësisë dhe jo shkakun veprues të saj. Vetë ato të dyja kanë nevojë për shkakun veprues.

Së treti: Mbetja e sasisë së materies dhe energjisë dhe qëndrueshmëria e tyre nuk do të thotë të mohojmë incidencën e dukurive të reja apo shtimin dhe pakësimin e tyre.

Këto dukuri si p.sh. shpirti, jeta, ndjenja, vullneti etj., nuk janë nga lloji i materies dhe energjisë që shtesa apo mangësia e tyre të mohojë parimin e vazhdimësisë së materies dhe energjisë.

Së katërti: Supozimi i evolucionit, megjithëse nuk arriti konsideratën dhe vlerën e mjaftueshme shkencore, ku shumë prej dijetarëve të mëdhenj e kanë kundërshtuar, ai nuk e kundërshton besimin tek Allahu.

Ajo që më së shumti supozon ky supozim është vërtetimi e një lloj shkakësie përgatitore ndërmjet gjallesave dhe nuk e mohon lidhjen e saj me Sjellësin në ekzistencë. Argument për këtë është se shumë nga përkrahësit e këtij supozimi besojnë në një Zot, Krijues të gjithësisë dhe njeriut.

Pyetje

1. Cilat janë kundërshtimet mbi besimin tek e perceptueshmja dhe mohimin e gjërave të paperceptueshme (*gajr mehsuse*)?

2. Cilat janë kundërshtimet që u parashtrohen disa sociologëve që thonë se frika apo padija është shkaku në burimin e besimit në ekzistencën e Allahut?

3. A e mohon besimi në ekzistencën e Allahut gjithëpërfshirjen e ligjin të shkakësisë? Pse?

4. A e mohon parimi i mbetjes së materies dhe energjisë besimin tek Allahu apo jo? Pse?

5. A e hedh poshtë evolucioni besimin në ekzistencën e Allahut? Pse?

Leksioni i katërmbëdhjetë

BOTËKUPTIMI MATERIALIST
(Paraqitje dhe kritikë)

Bazat e botëkuptimit materialist

Ne mund të përfytyrojmë bazat dhe themelet e mëposhtme të botëkuptimit materialist:

• *E para*: Ekzistenca është ekuivalente e materies[1] dhe e materiales. Pra, një gjë konsiderohet ekzistente në qoftë se është materie që përmban vëllim dhe tre dimensionet (gjatësi, gjerësi dhe lartësi) ose që është veti e materies, e cila përshkruhet me sasi dhe që pranon ndarjen. Mbi këtë bazë mohohet ekzistenca e Allahut, sepse Ai është Ekzistent jo material dhe mbinatyror.

• *E dyta*: Materia është e pafillimtë dhe e pambarimtë, nuk është e krijuar dhe nuk ka nevojë për asnjë shkak; dhe siç përkufizohet në filozofi ajo është "ekzistencë e domosdoshme."

• *E treta*: Nuk mund të thuhet se ekziston për gjithësinë një qëllim apo shkak objektiv, teleologjik (*'il-leh gaijje*), sepse gjithësia nuk ka një veprues që posedon ndjenja dhe vullnet që të mund t'i përshkruajmë atij ekzistencën e një qëllimi dhe objektivi në veprat dhe krijimin e tij.

• *E katërta*: Dukuritë natyrore (jo lënda e parë e gjithësisë) ndodhin si rezultat i shndërrimeve në atomet e materies dhe ndërveprimit mes tyre. Nga këtu mund të themi se duku-

1. Për t'u njohur më tepër me konceptin e materies dhe përkufizimin e saj, kthehu tek libri "*Ed Difa' 'an Khanadiki'l Ajdjuluxhijjeh*" (*Mbrojtja e hendeqeve të ideologjisë*), "*Er-Ru'jetu'l Keunijetu'l Maddijjeh*"(*Vizioni kozmologjik materialist)*, f. 292-297, dhe "*Ta'limu'l Felsefeh*"(*Mësimi i filozofisë*), pjesa e dytë, leksioni i dyzetenjë.

ritë e mëparshme janë një lloj kushtëzimi dhe shkakësie përgatitore për dukuritë e ardhshme natyrore. Sipas një supozimi të largët, mund të pranojmë njëfarë shkakësie vepruese përgatitore natyrore ndërmjet trupave materialë, p.sh. pema konsiderohet veprues natyror për frytet.

Gjithashtu, dukuritë fizike dhe kimike mund t'ua adresojmë faktorëve dhe ndikimeve të tyre, porse nuk ka ndonjë dukuri që të ketë nevojë për faktorin hyjnor, krijues dhe sjellës në ekzistencë. Gjithashtu, në mund t'u shtojmë këtyre bazave edhe *një bazë të pestë* e cila ka të bëjë me epistemologjinë (*'ilmu'l-ma'rife*) dhe mund të konsiderohet parësore mbi gjithë bazat.

Ajo është: "Njohja që buron nga eksperimenti i prekshëm, është njohja e vetme që mund të merret parasysh dhe meqë eksperimentet e prekshme vërtetojnë vetëm ekzistencën e materies dhe materiales nuk vërtetojnë ekzistencën e ndonjë gjëje tjetër, për këtë arsye nuk mund të pranojmë ekzistencën e asgjëje tjetër veç tyre.

Porse ne, në leksionin e kaluar sqaruam rrëzimin e kësaj baze[2] dhe nuk do t'i rikthehemi diskutimit të saj edhe një herë, kështu që na mbetet të diskutojmë vetëm katër bazat e tjera.

Korrektimi i bazës së parë

Kjo bazë e cila konsiderohet si baza dhe shtylla më e rëndësishme e botëkuptimit materialist, nuk ka ndonjë argument, është pretendim i pavlefshëm dhe nuk mund të ngrihet ndonjë argument për të mohuar atë që gjendet përtej natyrës, veçanërisht të jetë në përputhje me njohjen materialiste që ngrihet mbi baza ndijimore dhe eksperimentale.

Kjo, sepse çdo eksperiment shqisor nuk mund të tregojë për diçka që është jashtë fushës dhe specialitetit të tij (siç janë

2. Për hollësi më të zgjeruara kthehuni tek libri *"El-Ajdjuluxhijjetu'l Mukareneh"* (*Ideologjia e krahasuar*), nga leksioni i tetë deri në leksionin e gjashtëmbëdhjetë, si dhe në librin "*Ta'limu'l felsefeh*" (*Mësimi i filozofisë*), nga leksioni i trembëdhjetë deri në leksionin e tetëmbëdhjetë.

materia dhe materialja) pastaj për të dhënë opinionin e tij për mohimin a vërtetimin e asaj gjëje.

Sipas supozimit më të largët, ajo që mund të thuhet - në përshtatje me metodën materialiste - është se ne nuk mund të vërtetojmë ekzistencën e diçkaje metafizike (përtej natyrës), prandaj së paku, duhet të pranojmë mundësinë e ekzistencës së saj.

Sepse, pamundësia e vërtetimit nuk nënkupton në të vërtetë mosekzistencën e saj, ashtu sikurse kanë thënë: **"Mosprania nuk do të thotë mosekzistencë."** Më parë e kemi bërë të ditur se njeriu percepton shumë gjëra jo materiale të cilat nuk cilësohen si karakteristika dhe veçori të materies, si p.sh. shpirtin të cilin njeriu e percepton nëpërmjet dijes ekzistenciale (*'ilm hudurij*).

Gjithashtu janë ngritur shumë argumente logjikë mbi ekzistencën e çështjeve abstrakte në librat filozofikë[3] dhe argumenti më i mirë për ekzistencën e shpirtit janë ëndrrat e vërteta, shumë nga veprat e njerëzve që kanë fituar kënaqësinë e Zotit, gjithashtu shumë nga mrekullitë e profetëve (*paqja e Zotit qoftë mbi ta!*) dhe kerametet e evlijave.[4]

Sidoqoftë, për rrëzimin e kësaj baze mjaftojnë argumentet që kemi ngritur mbi ekzistencën e Allahut dhe moscilësimin e Tij me trup fizik.[5]

Korrektimi i bazës së dytë

Kjo bazë mbështetet mbi pafillimshmërinë (*ezelijje*) e materies dhe pafundshmërinë (*ebedijje*) e saj. Si konkluzion, kanë arritur se materia nuk është e krijuar.

Kjo bazë diskutohet si vijon:

3. P.sh. shih librin "*Ta'limu'l felsefeh*" (*Mësimi i filozofisë*), pjesa e dytë, leksioni i dyzetekatërt dhe leksioni i dyzetenëntë.
4. Libri "*Diskutim i shkurtër mbi bazat marksiste*", leksioni i dytë.
5. Kthehu tek leksioni i shtatë dhe i tetë tek ky libër, dhe tek leksioni i gjashtëdhjetedytë dhe gjashtëdhjetetretë në librin "*Ta'limu'l Felsefeh*" (*Mësimi i filozofisë*).

• *Së pari*: Ne nuk mund të vërtetojmë pafillimshmërinë e materies dhe pafundshmërinë e saj mbi bazën e argumenteve shkencorë dhe eksperimentalë. Kjo sepse fusha e eksperimentit dhe mundësitë e tij janë të kufizuara dhe se ai nuk trajton shembuj të kësaj fushe. Asnjë eksperiment nuk mund të vërtetojë pafundësinë e gjithësisë përsa i përket kohës dhe vendit.

• *Së dyti*: Pafillimshmëria e materies nuk nënkupton mospatjen nevojë për Krijuesin. Për shembull, supozimi i ekzistencës së një lëvizjeje mekanike të pafillimtë do të kërkonte, gjithashtu, ekzistencën e një fuqie lëvizëse të pafillimtë dhe jo të vërtetonte mospatjen nevojë për një fuqi lëvizëse.

Përveç kësaj, pretendimi se materia nuk është e krijuar, do të thotë se ajo është ekzistente e domosdoshme. Në leksionin e tetë e vërtetuam pamundësinë e materies për të qenë ekzistente e domosdoshme.

Korrektimi i bazës së tretë

Baza e tretë e mohon synimin dhe qëllimin e krijimit të gjithësisë dhe vjen si rezultat natyror për mohimin e Krijuesit. Natyrisht, nëse do të vërtetojmë ekzistencën e një Krijuesi të Urtë, atëherë kjo bazë do të rrënohet.

Porse mbetet pyetja që përfaqëson një kundërshtim të fortë mbi këtë bazë dhe që i shtrohet me këmbëngulje çdo njeriu objektiv: Çdo njeri i mençur, kur sheh teknologjitë njerëzore arrin të rrokë qëllimin dhe synimin pas këtyre teknologjive. Ndërsa kur sheh rregullsinë e mrekullueshme dhe mahnitëse të gjithësisë, marrëdhënien dhe harmoninë e përkryer ndërmjet dukurive dhe të dhënave të plota të cilat nuk numërohen, si ka mundësi që nuk percepton dot qëllimin e saj?

Korrektimi i bazës së katërt

Baza e katërt e botëkuptimit materialist është kufizimi i

shkakësisë midis marrëdhënieve materiale të dukurive. Rreth kësaj baze ka kundërshtime të forta. Po veçojmë më të rëndësishmet prej tyre:

1. Sipas kësaj baze, i bie që të mos ketë ekzistent të ri në gjithësi, megjithëse ne shohim gjithmonë praninë e ekzistentëve të rinj, veçanërisht në botën e njerëzve dhe kafshëve, ku më të rëndësishmet janë jeta, ndjenja, pasioni, dashuria, mendimi, kreativiteti dhe vullneti.

Materialistët thonë se këto dukuri janë nga vetitë e materies, asgjë tjetër!!!

Si kundërpërgjigje u themi:

• *Së pari*: Vetia që shoqëron materien dhe materiet në tërësi dhe që nuk mund të ndahet prej saj është: shtrirja (*imtidad*) dhe pranimi i ndarjes. Kjo veti nuk është as vetë dukuria dhe as ndikon në dukuritë dhe ekzistentët që përmendëm.

• *Së dyti*: Pa dyshim se këto dukuri të cilat quhen "veti të materies", nuk kanë ekzistuar në materiet jo të gjalla. Pra, ka qenë një kohë kur lënda\materia nuk i posedonte këto veti, por pastaj u gjendën në të. Pra, këta ekzistentë - të cilët quhen veti të lëndës - kanë nevojë për një ekzistent që t'i vendosë në lëndë; ky Ekzistent është Shkaku Sjellës në ekzistencë.

1. Sipas kësaj baze, të gjitha dukuritë natyrore janë të detyruara (*xhebrijje*) dhe të pashmangshme (*hatmijje*), sepse nuk ka vend për liri përzgjedhjeje dhe vullnet në rrethin e ndikimeve të materies dhe ndërveprimeve të saj. Kundërshtimi i përzgjedhjes - megjithëse është në kundërshtim me ndërgjegjen (*vuxhdan*) dhe intuitën (*bedaha*) – çon në mohimin e përgjegjësive dhe vlerave morale e shpirtërore.

Të gjithë ne i njohim përfundimet e rrezikshme dhe pasojat shkatërruese me të cilat përballet jeta njerëzore si rezultat i mohimit të përgjegjësive dhe vlerave.

Si përfundim, duke theksuar se materia\lënda nuk mund të jetë ekzistent i domosdoshëm - siç e vërtetuam më parë – atëherë duhet të ekzistojë një shkak për materien. Ky shkak nuk mund të jetë nga lloji i shkaqeve natyrore dhe për-

gatitëse, sepse këto marrëdhënie nuk mund të përfytyrohen vetëm se ndërmjet vetë materieve.

Ndërsa e gjithë materia nuk mundet të ketë të njëjtën lidhje me shkakun e saj. Pra, shkaku që solli në ekzistencë materien është një shkak sjellës në ekzistencë dhe është tej materies (metafizik).

Pyetje

1. Sqaro bazat dhe themelet e botëkuptimit materialist.
2. Përkufizo materien dhe materialen?
3. Shpjego kundërshtimet e bazës së parë?
4. Sqaro kundërshtimet e bazës së dytë?
5. Diskuto argumentin e tretë?
6. Sqaro kundërshtimet e bazë së katërt?

Leksioni i pesëmbëdhjetë

MATERIALIZMI DIALEKTIK
(Paraqitje dhe kritikë)

Materializmi mekanik dhe ai dialektik

Materializmi përfaqësohet nga rryma dhe grupime të ndryshme, ku çdonjëra prej tyre e shpjegon incidencën e gjithësisë dhe dukuritë e saj sipas një mënyre të caktuar. Në fillimet e epokës moderne, materialistët i shpjeguan ndodhitë e dukurive natyrore - nisur nga konceptet fizike të Njutonit - sipas lëvizjes mekanike.

Domethënë: Çdo lëvizje që shkaktohet nga një fuqi lëvizëse e caktuar, hyn në trupin lëvizës nga jashtë. Ata e përfytyruan botën si një aparat gjigant, ku fuqia lëvizëse kalon nga njëra pjesë e saj në tjetrën; kjo çon në lëvizjen gjithëpërfshirëse të saj.

Kjo teori u quajt "materializëm mekanik" (*maddijje mikanikijje*). Por, për shkak të pikave të dobëta dhe boshllëqeve të shumta që ka, është debatuar nga kundërshtarët e saj.

Një nga këto pika është: Në qoftë se çdo lëvizje shkaktohet nga fuqi të jashtme, atëherë është e domosdoshme të supozohet, gjithashtu, ekzistenca e një fuqie lëvizëse që vepron nga jashtë për të lëvizur lëndën e parë të botës.

Kjo na çon të besojmë në ekzistencën e një ekzistenti tej materies, që të jetë, të paktën, shkaku i lëvizjes së parë në botën e materies.

Gjithashtu, materializmi mekanik mund të kundërshtohet duke thënë se: fuqia mekanike shpjegon lëvizjet vendosëse dhe ato shndërruese, por dukuritë kozmike nuk mund

të kufizohen sipas ndryshimeve dhe shndërrimeve vendore. Prandaj duhet që të besojmë në ekzistencën e një shkaku tjetër dhe një faktori tjetër për të komentuar të gjitha dukuritë e gjithësisë.

Dobësia e materializmit mekanik në qëndrimin e saj përballë gjithë këtyre kundërshtimeve i detyroi materialistët të kërkonin një tjetër faktor për të shpjeguar këto shndërrime në gjithësi dhe, së paku, u përpoqën të shpjegonin disa lëvizje me një shpjegim dinamik, duke supozuar një vetëlëvizje të materies.

Pjesë e grupit themelues të teorisë së materializmit dialektik ishin Marksi dhe Engelsi. Ata e konsideruan faktorin lëvizës si antagonizëm të brendshëm të fshehur në brendësi të dukurive materiale. Ata përfituan në këtë fushë nga idetë filozofike të Hegelit, dhe duke shtuar edhe besimin e tyre në bazat materialiste që janë: pafundshmëria e materies (pretendimi se materia nuk zhduket dhe nuk rilind), moskrijimi i saj, lëvizja gjithëpërfshirëse dhe ndërveprimi ndërmjet dukurive, ata deduktuan tri baza për shpjegimin e supozimit të tyre.

1- Baza e antagonizmit të brendshëm (*tedadd dakhilij*).

2- Baza e kapërcimit (*tafra*), apo transformimi i shndërrimeve sasiore në shndërrime cilësore.

3- Baza e mohimit të mohimit (*nefju'n-nefj*) , ose dinamika e natyrës.

Ne do të përpiqemi të shpjegojmë shkurtimisht çdonjërën prej këtyre bazave dhe parimeve dhe më pas do t'i diskutojmë ato.[1]

1. Për t'u zgjeruar më tepër kthehu tek librat: *"Ed Difa' 'an Khanadiki'l Ajdjuluxhijjeh"* (*Mbrojtja e hendeqeve të ideologjisë*), *"Mekalatun fil Hareketi ue'd-Dialektik"(Artikuj mbi* lëvizjen *dhe dialektikën)* dhe *"Er-Ru'jetu'l Keunijetu'l Maddijjeh"*(*Vizioni kozmologjik materialist*).

Baza e antagonizmit (*aslu't-tedadd*)

Materializmi dialektik beson se çdo dukuri përbëhet nga dy të kundërta: *teza* dhe *antiteza* dhe se antagonizmi është faktori në lëvizjen e asaj dukurie dhe shndërrimin e saj. Si pasojë e ndezjes së konfliktit ndërmjet të dyjave, triumfon *antiteza*, për të shkaktuar një dukuri të re: *sintezën*. Për shembull, veza e pulës përmban embrionin që zhvillohet gradualisht duke tretur lëndët ushqimore që përmban në veten e saj dhe pas një farë kohe del zogu, që simbolizon sintezën.

Rryma elektrike me dy kahet, atë pozitive dhe atë negative, është një tjetër shembull i antagonizmit në dukuritë fizike. Gjithashtu, edhe veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes në aritmetikë, si dhe numri i plotë real (integrali) në matematikën e avancuar.

Dialektika luan rolin e saj, gjithashtu, në ngjarjet shoqërore dhe historike. Në shoqërinë kapitaliste ekziston një shtresë që quhet proletariat, klasa punëtore, e cila përfaqëson "antitezën" dhe të kundërtën e shtresës kapitaliste. Klasa punëtore do të vazhdojë të rritet dhe të zhvillohet gradualisht derisa të triumfojë në fund në luftën e saj kundër klasës kapitaliste. Rezultati i kësaj do të jetë "sinteza", shoqëria socialiste komuniste.

Palaçot e teorisë marksiste shtojnë se baza e antagonizmit vërteton pavlefshmërinë (rrënimin) e teorisë metafizike, e cila kundërshton antagonizmin (*tedadd*) dhe kontradiktën (*tenakud*).

Diskutim

Në fillim është e nevojshme të shpjegojmë se askush nuk e kundërshton ekzistencën e dy ekzistentëve materialë të përafërt dhe në krah me njëri-tjetrin, ku njëri prej tyre dobëson tjetrin, madje ndoshta shkakton shkatërrimin dhe zhdukjen e tjetrit, ashtu siç mund të vihet re një gjë e tillë midis ujit dhe

zjarrit. Por:

• *Së pari*: Ky rast nuk është përgjithësues dhe nuk mund ta pranojmë si ligj natyror përgjithësues. Ne mund të paraqitim qindra, madje mijëra shembuj që e kundërshtojnë këtë rast.

• *Së dyti*: Ekzistenca e një antagonizmi të tillë në disa incidenca dhe dukuri natyrore nuk ka të bëjë fare me antagonizmin dhe kontradiktën, të cilat i mohon logjika klasike dhe filozofia metafizike.

Sepse ajo çfarë është konsideruar e pamundur është bashkimi ndërmjet dy të kundërtave apo dy të ndryshmëve "në një objekt të vetëm". Shembujt të cilët u dhanë për antagonizmin marksist nuk cilësohen si të një objekti.

Ne nuk kemi nevojë t'u qasemi shembujve qesharakë dhe që shkaktojnë ironi, të cilat i paraqitën marksistët për bashkimin e dy të kundërtave si p.sh. bashkimi i mbledhjes dhe zbritjes, derivatet dhe integralet, apo si parashikimet e gënjeshtra të cilat i shkruan rreth lindjes së shtetit të proletariatit në vendet kapitaliste.

• *Së treti*: Nëse çdo dukuri është e përbërë nga dy të kundërta, atëherë është e nevojshme që çdonjëra nga dy të kundërtat të karakterizohet nga një përbërje tjetër gjithashtu, pra "tezë" dhe "antitezë", sepse çdonjëra prej tyre është dukuri. Në bazë të parimit të përmendur (baza e antagonizmit) është e domosdoshme që të formohet çdonjëra prej tyre nga dy të kundërta.

Si rezultat i kësaj, është e domosdoshme çdo dukuri e kufizuar dhe e që ka një fund të formohet nga të kundërta të pafundme.

Sa i përket asaj që ata pretenduan se antagonizmi i brendshëm është faktor i lëvizjes - duke patur për qëllim të mbushnin disa nga boshllëqet në materializmin mekanik dhe të kundërshtonin disa nga problemet e saj - kundërshtimi më i ulët i tij është se nuk ekziston asnjë argument shkencor që të mbështesë këtë supozim, duke shtuar këtu se ne nuk mund të

mohojmë ekzistencën e lëvizjeve mekanike të cilat ndodhin si rezultat i fuqisë së jashtme vetëm nëse thonë se lëvizja e topit të futbollit shkaktohet, gjithashtu, nga antagonizmi i brendshëm i topit dhe jo nga këmbët e lojtarëve!!!

Baza e kapërcimit (*aslu't-tafra*)

Vëmë re se shndërrimet në gjithësi nuk kanë ndodhur të gjitha gradualisht apo në të njëjtën kohë, por është e qartë se në shumë aspekte vërehen shumë dukuri të reja llojore të cilat nuk u ngjajnë dukurive të mëparshme dhe nuk mund t'i quajmë zgjatime të shndërrimeve apo lëvizjeve të mëparshme.

Marksistët u kapën pas një tjetër argumenti që është "shpërthimi", "kapërcimi" ose kalimi nga shndërrimet sasiore në shndërrimet cilësore, që do të thotë se shndërrimet sasiore pasi arrijnë një shkallë të caktuar, ato kalojnë në një përshtatje të re duke qenë shkak në ndodhinë e shndërrimit të llojit.

Për shembull, kur vihet uji në zjarr arrin një gradë të lartë temperature, por me ngritjen e temperaturës së tij në një gradë të caktuar që është 100^0C, atëherë do të ndryshojë gjendjen e tij duke u kthyer në avull.

Gjithashtu, çdo pjesëz metalike ka një gradë të caktuar shkrirjeje. Në saje të nxehtësisë arrin në atë gradë dhe shndërrohet në lëng. Edhe në shoqëri, gjithashtu kur ndodhin luftra ndërmjet shtresave të ndryshme të shoqërisë, arrin një fazë e caktuar dhe ndodh revolucioni.

Diskutim

• *Së pari*: Nuk ekziston asnjë dukuri që ta ndryshojë sasinë në cilësi. Ajo që mund të themi është se: ndodhia e një dukurie të caktuar është e kushtëzuar me ekzistencën e një sasie të caktuar. Për shembull, temperatura e ujit nuk e ndryshon atë në avull, por është e nevojshme që të ndryshojë uji në avull nga kushtëzimi i ekzistencës së një grade të caktuar të

temperaturës.

• *Së dyti*: S'është e domosdoshme që të arrijë kjo sasi, si rezultat i rritjes graduale të sasive të mëparshme, por është e mundshme të realizohet si rezultat i zvogëlimit të sasisë së mëparshme dhe pakësimit të saj. Sikurse ndodh në ndryshimin e avullit në ujë që kushtëzohet me uljen e temperaturës.

• *Së treti*: Ndryshimet sasiore nuk ndodhin gjithmonë në mënyrë të rastësishme, por ndodhin në shumicën e rasteve në mënyrë graduale, ashtu sikurse ndodh në shkrirjen e qiririt dhe qelqit.

Pra, ajo që mund të pranohet është nevoja e pranisë së sasisë së caktuar për realizimin e dukurive natyrore, jo ndryshimi i sasisë në cilësi, as domosdoshmëria e shtesës graduale të masës. Ne nuk mund të pranojmë, gjithashtu, kushtin e gjithëpërfshirjes për të gjitha ndryshimet e sasisë dhe llojit.

Pra, si përfundim mund të themi se nuk ekziston një rregull gjithëpërfshirës i gjithësisë që quhet shpërthim apo arritje e shndërrimit të sasisë në cilësi.

Baza e mohimit të mohimit (*aslu nefji'n-nefj*)

Me bazë të mohimit të mohimit – që shpesh quhet ligji i evolimit të dy të kundërtave apo dinamika e natyrës – nënkuptohet se në shndërrimet përgjithësuese dialektike mohohet "tezës" nëpërmjet "antitezës" dhe "antiteza", nëpërmjet rolit të saj mohohet nëpërmjet "sintezës", ashtu siç vërehet tek bimët. Pema mohon farën, por edhe mohohet nga farat e reja. Gjithashtu, embrioni mohon vezën, por edhe veza mohohet nga zogu. Por nëpërmjet kësaj shohim se dukuria e re është më e përsosur se e vjetra.

Thënë ndryshe: lëvizja dialektike është gjithmonë në zhvillim dhe në plotësim e sipër. Rëndësia e këtij parimi konsiston në këto vërejtje, pasi ato tregojnë drejtimin e lëvizjes së shndërrimeve dhe përforcojnë evoluimin dhe përsosurinë e tyre.

Diskutim

Nuk ka dyshim se çdo ndryshim dhe shndërrim e largon gjendjen e mëparshme për të kaluar në një gjendje të re. Ky është argumenti i bazës së mohimit të mohimit. Është ky kuptimi i asaj që nuk ka ardhur diçka e re përveçse asaj që ofron natyra e shndërrimit dhe ndryshimit.

Shpjegimi që përmendëm mbi këtë parim rreth kufizimit të drejtimit të lëvizjes, si dhe lëvizjes gjithmonë e në përsosuri dhe se dukuria pasuese duhet të jetë domosdoshmërisht më e përsosur nga pararendësja e saj është një shpjegim jo i saktë.

Gjithëpërfshirja e të gjitha lëvizjeve dhe ndryshimeve të gjithësisë nuk mund të pranohet. A është bërë më i përsosur uraniumi i cili ndryshon si rezultat i rrezatimit të tij duke u kthyer në plumb? A e arrin uji përsosurinë duke u kthyer në avull dhe e kundërta avulli i cili kthehet në ujë? A është bërë pema më e përsosur kur thahet dhe nuk i mbetet asnjë gjethe dhe frut? Ajo që ne mund të pranojmë është se disa ekzistentë natyrorë mund të kenë më shumë zhvillim dhe përsosuri si rezultat i lëvizjes dhe ndryshimit. Kjo gjendje nuk i përmbledh të gjitha lëvizjet dhe ndryshimet. Kështu që nuk mund ta pranojmë parimin e zhvillimit dhe përsosurisë si një rregull gjithëpërfshirës për çdo dukuri të gjithësisë.

Së fundmi, ne e përforcojmë këtë vërejtje: nëse supozohet vërtetësia e këtyre parimeve në pamje të përgjithshme të gjithësisë, më e largëta që mund të vërtetojnë këto parime është se ato shpjegojnë mënyrën e incidencës së dukurive, siç ndodh me gjithë parimet dhe ligjet e vërtetuara në shkencat natyrore. Por ekzistenca e ligjeve gjithpërfshirëse dhe të vërtetuara në gjithësi nuk do të thotë se dukuritë dhe incidencat e reja nuk kanë nevojë për Shpikësin dhe Sjellësin në ekzistencë. Ashtu siç e kemi vërtetuar edhe në leksionet e kaluara, materia dhe trupat materialë në përgjithësi janë ekzistenca të mundshme dhe kanë nevojë për Ekzistentin e Domosdoshëm.

Pyetje

1. Sqaro dallimin ndërmjet materializmit mekanik dhe materializmit dialektik?
2. Trego bazën e antagonizmit dhe kundërshtimet e saj?
3. Shpjego bazën e shpërthimit\ kalimit dhe kundërshtimet e saj?
4. Shpjego bazën e mohimit të mohimit dhe diskutimin e saj?
5. Nëse supozojmë vërtetësinë e këtyre bazave dhe përgjithshmërinë e tyre, a vërtetohet panevoja e gjithësisë për Krijues? Pse?

Leksioni i gjashtëmbëdhjetë

NJËSIMI I ALLAHUT

Hyrje

Në leksionet e kaluara vërtetuam rëndësinë e ekzistencës së një Zoti, Një Zoti të Urtë e të Fuqishëm\të Aftë, i Cili është Sjellësi në ekzistencë dhe Krijuesi. Ai është Ruajtësi dhe Administruesi i gjithësisë.

Ndërsa në leksionet e fundit paraqitëm studimin e botëkuptimit materialist dhe nëpërmjet diskutimit të llojeve të këtij botëkuptimi, na u bë e qartë se supozimi i botës dhe gjithësisë pa një krijues është një supozim që nuk e pranon logjika dhe një shpjegim që nuk mund të jetë i pranueshëm.

Tani ne do të studiojmë temën e Njësimit, gjithashtu, hedhjen poshtë të mendimeve dhe besimeve të jobesimtarëve.

Ka mendime të ndryshme të disa sociologëve rreth lindjes së besimeve pagane dhe ndryshimeve e devijimeve që kanë pësuar, por nuk ka ndonjë argument të qartë dhe të drejtë për t'i mbështetur gjithë këto mendime dhe interpretime.

Mund të themi se faktori i parë që i ka shtyrë drejt idhujtarisë dhe zotave të shumtë është shumëllojshmëria e dukurive qiellore dhe tokësore. Pra, ata besuan se çdolloj dukurie i nënshtrohej vullnetit të një zoti të caktuar.

Disa besonin se të mirat vinin nga zoti i së mirës dhe se të këqijat nga zoti i së keqes. Prej këtu besuan në ekzistencën e dy zotave që sundonin botën.

Gjithashtu, ata vunë re ndikimin e dritës së diellit, të hënës dhe të planeteve në dukuritë tokësore dhe kështu ata besuan në një lloj hyjnie mbi ekzistencat tokësore nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër është dëshira njerëzore për të adhuruar

diçka të dukshme dhe të prekshme ajo që i ka shtyrë ata që të bëjnë për këta zota të supozuar idhuj dhe toteme (shenja dhe vizatime simbolike) dhe më pas filluan që t'i adhuronin ata puta e idhuj. Gradualisht këto statuja fituan rolin e Zotit tek mendjeshkurtrit dhe primitivët. Me kalimin e kohës, çdo popull, madje çdo fis filloi të shpikë rituale e zakone që buronin nga iluzionet e tyre për të adhuruar idhujt e tyre dhe për të ngopur nëpërmjet këtyre veprimeve dhe ritualeve alternative atë motiv natyror të fshehur në brendësi të tyre për adhurimin e Allahut, si dhe për t'u shtuar tekave të tyre kafshërore dhe kënaqësive të kota ngjyrën e shenjtërisë fetare. Disa nga këto festime, veprime dhe rituale ekzistojnë edhe sot dhe shoqërohen me kërcime, zhurmë, pije alkoolike dhe shthurje seksuale ndërmjet idhujtarëve; të gjitha këto nën ngjyrën e riteve fetare.

Sigurisht, pas gjithë kësaj qëndrojnë arrogantët, tiranët dhe ata që vrapojnë pas pushtetit - njerëz që kanë dashur të plotësojnë dëshirat dhe ambiciet e tyre të këqija duke përfituar nga besimet dhe mendimet naive të padjallëzuara të njerëzve të zakonshëm dhe duke i shfrytëzuar për realizimin e qëllimeve të tyre djallëzore. Për të forcuar darën e tyre në qafën e popujve dhe për të zgjeruar edhe më tepër pushtetin e tyre, ata themeluan besime pagane dhe i përhapën ato duke i veshur vetes së tyre petkun e ngjyrave hyjnore, duke pretenduar zotësinë. Ata e konsideruan adhurimin e tiranëve pjesë të riteve fetare. Ne kemi shembuj të qartë mbi këtë dukuri ku mund të përmendim mbretërit dhe sulltanët duke nisur nga Kina, India, Irani, Egjipti dhe shumë vende të tjera.

Besimet dhe parimet idhujtare u gjendën ndërmjet njerëzve si rezultat i faktorëve të ndryshëm. Ato u përhapën për të qenë shtegu në udhëtimin e përsosjes së vërtetë të njerëzimit, gjë e cila realizohet dhe garantohet nga feja hyjnore dhe Njësimi. Profetët shfrytëzuan pjesën më të madhe të përpjekjeve dhe veprimtarisë së tyre në luftën kundër idhujtarisë dhe politeizmit. Kur'ani famëlartë na ka përmendur shumë histori dhe tregime mbi këtë luftë.

Pra, besimet dhe parimet idhujtare\pagane mbështeten mbi bazat e besimit në zotësinë e një ekzistenti tjetër përveç Allahut të Madhëruar, qoftë ky prej krijesave apo edhe prej dukurive natyrore. Shumë nga idhujtarët besonin në njësimin e Krijuesit të gjithësisë. Në të vërtetë, ata besuan në Krijuesin e Vetëm, por ata thanë se ekzistojnë zota të tjerë të një grade më të ulët duke besuar se këta zota administronin dhe menaxhonin gjithçka ndodhte në gjithësi në mënyrë të pavarur. Ata e quajtën Zotin Krijues "Zoti i Zotave".

Një pjesë mendonin se këta zota që administronin gjithësisë ishin engjëjt. Idhujtarët arabë besonin se engjëjt ishin vajzat e Allahut. Një pjesë tjetër supozonin se ato janë prej xhindëve, ndërsa të tjerë besonin se janë shpirtrat e planetëve apo shpirtrat e disa njerëzve të hershëm, apo se ato janë një lloj i caktuar ekzistencash të padukshme.

Në leksionin e dhjetë ne kemi shpjeguar lidhjen e fortë ndërmjet krijueshmërisë dhe zotësisë së vërtetë. Është e pamundur ndarja e besimit ndaj njërës prej tyre nga tjetra. Besimi në krijueshmërinë e Allahut nuk përshtatet me besimin në zotësinë (*rububijen*) e një tjetri dhe se të gjithë ata që besojnë në këto besime të kundërta nuk kanë qenë të kujdesshëm në kundërshtitë e tyre. Për rrëzimin e këtyre besimeve mjafton sqarimi i të vërtetës dhe sekretit të këtyre kundërshtive. Mbi Njësimin e Allahut janë ngritur fakte dhe argumente të shumta, të cilat janë përmendur në librat e ndryshëm filozofikë dhe ato të apologjetikës. Ne do të mjaftohemi me përmendjen e një argumenti të vetëm, i cili tregon në mënyrë të drejpërdrejtë Njësimin e Zotësisë (*teuhid'ur-rububije*) dhe rrënimin e besimeve të idhujtarëve.

Argumenti mbi Njësimin e Allahut

Supozimi mbi ekzistencën e dy apo më shumë zotave nuk mund të dalë jashtë njërit prej opsioneve të mëposhtme:

- Supozimi se secila nga këto dukuri natyrore dhe këta

ekzistentë janë të krijuar dhe pasoja të gjithë atyre zotave.

• Çdo grup i këtyre dukurive dhe ekzistentëve është pasojë e njërit prej këtyre zotave të supozuar.

• Të gjithë dukuritë dhe ekzistentët janë të krijuar nga një Zot i vetëm dhe të gjithë zotat e tjerë të supozuar janë administrues të gjithësisë.

Supozimi se çdo dukuri dhe krijesë ka disa zota krijues është një supozim i pamundur (*muhal*) sepse të thuash që ekzistojnë dy apo më shumë zota krijues (me kuptimin e shkakut sjellës në ekzistencë) që krijojnë krijesat, do të thotë se çdonjëra prej tyre ofron ekzistencë. Si rezultat i kësaj del se do të kemi disa ekzistenca sipas numrit të zotave të supozuar për të njëjtin send, edhe pse çdo ekzistent ka vetëm një ekzistencë, përndryshe nuk do të ishte një.

Sa i përket supozimit se çdo zot ka krijuar krijesën e tij ose një grup të caktuar krijesash, atëherë - sipas këtij supozimi - duhet që çdo krijesë të varet nga krijuesi i saj duke mos patur nevojë për ekzistentë të tjerë, përveç nevojës e cila mbaron te krijuesi i asaj krijese.

Është një nevojë që lidhet me krijesa të veçanta të krijuesit të tij. Thënë ndryshe, supozimi i zotave të ndryshëm të gjithësisë do të kërkonte gjithashtu edhe ekzistencën e sistemeve të ndryshme në gjithësi, ku secili prej tyre do të ishte i pavarur dhe i ndarë nga tjetri, megjithëse gjithësia ka një sistem të vetëm.

Ashtu sikurse ekziston një lidhje dhe bashkëveprim ndërmjet dukurive që ndodhin në të njëjtën kohë ku secila prej tyre ka nevojë për tjetrën, gjithashtu ekzistojnë lidhje e marrëdhënie ndërmjet dukurive të mëparshme me ato që ndodhin në kohën e tanishme, si dhe ndërmjet dukurive dhe ngjarjeve që ndodhin në kohën e tanishme dhe atyre dukurive që do të ndodhin në të ardhmen. Çdo dukuri e kaluar i hap rrugë ekzistencës së një dukurie pasuese.

Pra, kjo gjithësi e cila përbëhet nga pjesë të lidhura e kohezive dhe që drejtohet sipas një rregullsie të vetme, nuk

mundet të jetë pasojë e disa shkaqeve sjellëse në ekzistencë.

Sa i përket supozimit të tretë sipas të cilit krijuesi i çdo gjëje është një Zot i vetëm, ndërsa të gjithë zotat e tjerë merren me administrimin dhe menaxhimin e gjithësisë; ky supozim, gjithashtu, nuk është i saktë.

Kjo për arsye se çdo pasojë (*ma'lul*) në çdo çështje të ekzistencës së saj ka nevojë për shkakun e saj sjellës në ekzistencë dhe se asnjë ekzistent tjetër i pavarur nuk ka mundësi veprimi në të, përveçse nëse janë nga ato lloj ndërveprimesh që ndodhin ndërmjet vetë pasojave (krijesave) të shkakut (krijuesit), por që i nënshtrohen Vepruesit që i ka sjellë në ekzistencë dhe nuk dalin nga administrimi i fuqisë dhe i pushtetit të Tij. Asgjë nuk ndodh pa lejen e tij krijimore (*tekuinije*).

Në këtë rast, të gjithë ata zota – përveç Zotit Krijues e Sjellës në ekzistencë - nuk janë Zot (*Rabb*) në kuptimin e vërtetë të fjalës. Pra, kuptimi i vërtetë fjalës ***Zot*** është që Ai të veprojë te krijesa e Tij në mënyrë të pavarur.

Kështu, është e domosdoshme që këto veprime dhe ndikime nuk janë të pavarura, madje të gjitha këto burojnë nga Zotësia e Krijuesit (*Rububijet'ul-Khalik*) dhe me fuqinë që i jep Ai Krijues.

Po të mos ishte Ai, nuk do të ishin këto veprime. Supozimi i ekzistencës së këtyre zotave administrues të gjithësisë nuk e mohon Njësimin e Zotësisë (*Teuhid'ur-Rububije*), ashtu sikurse edhe krijimi i cili realizohet me lejen e Allahut nuk e mohon Njësimin në Krijueshmëri. Në Kur'anin famëlartë dhe hadithet e nderuara ka argumente të shumtë që e vërtetojnë krijimin apo administrimin rrjedhimor (*tebe'ij*) e jo të pavarur (*gajr mustekil*) të disa robëve të Allahut. Allahu i madhëruar ka thënë në Kur'anin famëlartë për Isanë (*paqja e Zotit qoftë mbi të!*): **"...se si me vullnetin Tim krijoje një figurë shpendi prej balte, pastaj fryje në të dhe ajo bëhej zog me vullnetin Tim."**[1] Gjithashtu, i Madhëruari ka thënë: **"dhe për ata që i**

1. Sure "El-Maide", ajeti 110.

rregullojnë punët!"[2]

Si përfundim, imagjinimi i ekzistencës së shumë zotave për gjithësinë shkaktohet nga krahasimi dhe përngjasimi që i bëhet Allahut me shkaqet e ndryshme materiale dhe përgatitore, ku mund të mëtohet shumësia e shkaqeve për një pasojë.

Porse është e pamundur të krahasohet Shkaku Sjellës në ekzistencë me të tilla pasoja dhe nuk mund të supozojmë për cilëndo pasojë disa shkaqe sjellës në ekzistencë apo të supozojmë disa zota administrues në mënyrë të pavarur.

Për të rrëzuar këtë iluzion duhet të arsyetojmë me imtësi rreth konceptit të Shkakut Sjellës në ekzistencë dhe veçorive të këtij lloj shkaku derisa të perceptojmë pamundësinë e shumësisë së një shkaku të tillë për një pasojë të vetme.

Po ashtu, duhet të arsyetojmë në lidhshmërinë e gjithësisë për të na u bërë e qartë se ky sistem i ndërlidhur i cili drejton gjithësinë nuk mund të jetë krijesë e shumë zotave apo t'i nënshtrohet administrimit të zotave të pavarur.

Gjithashtu, nga ajo që përmendëm më sipër, na bëhet e qartë se koncepti i administrimit krijimor (*vilaje tekuinije*) për disa rob të mirë të Allahut nuk e mohon besimin në Njësim, por ky administrim krijimor nuk duhet komentuar me kuptimin e Krijueshmërisë apo Zotësisë së pavarur. Gjithashtu edhe koncepti *administrim legjislativ* (*vilaje teshri'ije*) i Profetit të nderuar (*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të!*) dhe Imamëve të pastër (*paqja qoftë mbi ta!*) nuk bie në kundërshtim me Zotësinë Legjislative hyjnore, sepse ky administrim gjendet nga Allahu i Lartësuar, me lejen e Allahut dhe e përftuar nga Allahu.

2. Sure "En-Nazi'at," ajeti 5.

Pyetje

1. Shpjego faktorët të cilët çuan në ekzistencën e besimeve pagane\idhujtare?

2. Cila është baza tek e cila mbështeten besimet idhujtare?

3. Trego lidhjen ndërmjet Krijueshmërisë dhe Zotësisë.

4. Përse nuk mund të supozojmë shumë zota krijues të një incidence të vetme?

5. Cila është arsyeja që nuk mund të themi se çdo grup krijesash janë krijuar nga një zot i caktuar?

6. Cili është kundërshtimi mbi thënien se e gjithë gjithësia është krijuar nga një Zot i vetëm, por në të njëjtën kohë supozohet që ka edhe zota të shumtë që e administrojnë gjithësinë?

7. Nga ka lindur iluzioni i mundësisë së ekzistimit të shumë zotave dhe si mund ta rrëzojmë këtë iluzion?

8. Pse besimi në administrimin krijimor të të dashurve (evlijave) të Allahut nuk bie në kundërshtim me njësimin e Krijueshmërisë dhe Zotësisë?

Leksioni i shtatëmbëdhjetë

KUPTIMET E NJËSIMIT

Hyrje

Fjala ***njësim*** (*teuhid*) që në kuptimin gjuhësor do të thotë *"numërimi i diçkaje dhe konsiderimi i saj një"* është përdorur në terminologjinë e filozofëve, teologëve kelamistë (apologjetëve), moralistëve dhe gnosistëve në shumë kuptime të ndryshme.

Në të gjitha këto kuptime ajo që është vënë re është Njësimi i Allahut nga një këndvështrim i caktuar. Nganjëherë është dashur të theksohet me "kategoritë e Njësimit" apo "gradat, shkallët e Njësimit".

Studimi i gjithë këtyre kuptimeve nuk i përshtatet metodologjisë së këtij libri, kështu që do të mjaftohemi me përmendjen e termave dhe kuptimeve më të njohura dhe që i përshtaten më së shumti temës tonë.

1- Mohimi i aspektit numerik (*nefju't-te'addud*): Termi i parë i njohur i Njësimit është "Besimi në Njëshmërinë (*Uahdanije*) e Allahut" dhe mohimi i aspektit numerik dhe shumësisë së jashtme qenësore. Ky term është antonim i idhujtarisë së dukshme dhe besimit në dy apo më shumë zota, në atë formë që secili prej tyre të ketë ekzistencë të pavarur dhe të ndryshëm nga të tjerët.

2- Mohimi i përbërjes (*nefju't-terkib*): Është termi i dytë i Njësimit, që do të thotë besim në Njëshmërinë, thjeshtësinë/mospërbërjen (*besata*) e brendshme qenësore, mohimin e përbërjes së Qenies së Tij hyjnore nga pjesë në saje të veprimit apo fuqisë. Zakonisht ky kuptim përmendet si Cilësi Mohore (mohimi i përbërjes) – ashtu siç e përmendëm në leksionin e

dhjetë – dhe kjo sepse mendjet tona janë më të familjarizuara me konceptin e përbërjes; ndërsa çfarë është e kundërt me të, pra mohimi i përbërjes, është nga konceptet e thjeshtësisë\ mospërbërjes (*besata*).

3- Mohimi i cilësive shtesë ndaj Qenies (*nefju's-sifati'z-zaide 'ala'dh-Dhat*): Është termi i tretë i cili nënkupton besimin në Njësimin (unitetin, bashkimin) e Cilësive Qenësore me Vetë Qenien hyjnore (*'Ajnu'dh-Dhati'l-Ilahije*) dhe mohimin e cilësive shtesë ndaj Qenies; mund të thuhet edhe "Njësimi i Cilësive" (*Teuhidu's-Sifat*). Në disa transmetime përmendet me termin "mohimi i cilësive" (*nefju's-sifat*), ndryshe nga mendimi i disave (si esh'arinjtë), të cilët besuan në cilësi shtesë ndaj Qenies Hyjnore duke folur për "tetë të pafillimtat" (*el-kudama'uth-themanije*).

Argumenti mbi Njësimin e Cilësive është: Nëse secila nga Cilësitë hyjnore do të kishte një vërtetësi të pavarur (*mis-dak mustekil*), atëherë do të ishte jashtë këtyre gjendjeve:

• Ose do të supozohej se vërtetësia e tyre është brenda Qenies Hyjnore. Ky supozim nënkupton që Qenia Hyjnore të ishte e përbërë nga pjesë. Por ne e kemi vërtetuar më herët pamundësinë e përbërjes së Qenies hyjnore.

• Ose do të supozohej se vërtetësia e tyre është jashtë Qenies Hyjnore. Në këtë rast, ose do t'i konsideronim ekzistentë të domosdoshëm që nuk kanë nevojë për krijues, ose do t'i konsideronim ekzistentë të mundshëm dhe krijesa të Zotit. Supozimi se do të ishin ekzistentë të domosdoshëm do të thotë shumësi qeniesh; kjo është idhujtari e qartë dhe nuk besoj se ka ndonjë mysliman që e beson këtë.

Ndërsa supozimi se këto cilësi janë ekzistentë të mundshëm nënkupton që Qenia Hyjnore – sipas supozimit se nuk i posedon fillimisht këto cilësi – i krijon e i sjell në ekzistencë këto cilësi dhe pastaj cilësohet me to. Për shembull, duke qenë se Qenia Hyjnore nuk e posedon Jetën, Ai krijon një ekzistent që quhet *Jetë* (*El-Hajat*) dhe më pas cilësohet me cilësinë e jetës. Kështu ndodh edhe me Dijen (*El-'Ilm*), Aftësinë\Fuqinë

(*El-Kudre*) etj., edhe pse është e pamundur (*muhal*) që Shkaku Sjellës në ekzistencë të mos posedojë qoftë edhe përsosuritë e krijesave të tij.

Më keq se kaq është nëse besojmë se Krijuesi, në saje të krijesave të Tij, përfiton jetë, dije, aftësi/fuqi dhe pas kësaj cilësohet në saje të tyre me Cilësitë e tjera absolute!!! Duke rrëzuar këto supozime dhe hamendësime, na bëhet e qartë se Cilësitë hyjnore nuk kanë vërtetësi të pavarura nga njëra - tjetra si dhe nga Qenia Hyjnore, por të gjitha këto atribute janë kuptime (koncepte) që arsyeja (*'akl*) i percepton nga një vërtetësi e vetme dhe e thjeshtë (jo e përbërë), që është Qenia e Shenjtë Hyjnore.

4- Njëshmëria Veprimore (Et-*Teuhidu'l-Ef'alij*): Termi i katërt i njësimit është ai i cili konsiderohet nga filozofët dhe teologët kelamistë (apologjetët) si "Njëshmëria Veprimore" (*Et-Teuhidu'l-Ef'alij*), që do të thotë se Allahu i Madhëruar në veprat e Tij nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë dhe se asnjë ekzistent nuk mundet që ta ndihmojë apo t'i ofrojë diçka për realizimin e veprave të Tij.

Ne mund ta vërtetojmë këtë të vërtetë në dritën e veçantisë me të cilën dallohet Shkaku Sjellës në ekzistencë e cila është Panevoja (*El-Kajjumije*) ndaj të gjitha pasojave të saj. Kjo sepse një pasojë si kjo e një shkaku si ky ekziston me gjithë ekzistencën e saj me atë shkak. Sipas terminologjisë filozofike: Çdo pasojë është vetë lidhja dhe varësia me shkakun dhe nuk ka asnjë pavarësi në vetvete.

Thënë ndryshe: Çdo gjë që ka dhe posedon çdo ekzistent, e ka arritur falë atij shkaku krijues, dhe çdo ekzistent i nënshtrohet fuqisë së Allahut, pushtetit të Tij si dhe pronësisë së vërtetë hyjnore.

Ndërsa pronësitë dhe aftësitë e të tjerëve përftohen nga pronësia e vërtetë hyjnore dhe degëzimet e saj, përgjatë Aftësisë/Fuqisë hyjnore duke mos iu kundërvënë asaj. Ashtu siç ndodh me pronësinë simbolike (*milkije i'tibarije*) të pasurisë monetare të fituar nga ana e skllavit: ajo është thjesht zgjatim

i pronësisë simbolike së padronit të tij (*Vetë skllavi dhe ç'ka në dorë janë pronë e padronit të tij*). Atëherë, si mund të ketë Allahu nevojë për ndihmën e diçkaje, e gjithë ekzistenca e së cilës dhe e çdo aspekti të ekzistencës së saj është nga Allahu dhe ekziston falë Tij?!

5- Ndikimi i pavarësisë (*et-te'thiru'l-istiklalij*). Termi i pestë i Njësimit është pavarësia në ndikim,[1] që do të thotë se krijesat e Allahut, në veprimet e tyre, nuk mund të jenë të pavarura nga Allahu i Madhëruar. Ky ndikim dallohet ndërmjet vetë krijesave, pra nga njëra krijesë tek tjetra me lejen e Allahut dhe nën hijen e fuqisë që u jep Allahu i Lartësuar.

Në të vërtetë, Ekzistenti i vetëm i Cili ndikon në çdo vend dhe mbi çdo gjë në mënyrë të pavarur dhe pa patur nevojën e dikujt tjetër është Qenia e Shenjtë Hyjnore. Veprimet e të tjerëve dhe ndikimet e tyre, ndodhin përgjatë veprimit dhe ndikimit të Tij, nën hijen dhe asistencën e Tij si dhe të përftuara nga i Lartësuari. Mbi këtë bazë shohim se si Kur'ani Famëlartë ia atribuon Allahut të Madhëruar ndikimet e vepruesve dhe të shkaqeve natyrore e jo natyrore (si p.sh. engjëjt, xhindet, njerëzit).

Për shembull, Allahut të Lartësuar i atribuohet rënia e shiut, dalja e bimëve, dhënia e fryteve të pemëve dhe shpesh theksohet domosdoshmëria e të perceptuarit dhe të medituarit nga ana e njeriut rreth këtij atribuimi që i bëhet Allahut të Lartësuar.

Ky atribuim është përgjatë atribuimit të vepruesve, shkaqeve dhe faktorëve që e rrethojnë; njeriu duhet të besojë në Të dhe t'i drejtohet Atij gjithmonë sepse Ai është Shkaku i shkaqeve dhe tek Ai mbaron zinxhiri i shkaqeve.

Për ta bërë edhe më të kuptueshme për mendjen këtë ide, le të sjellim një shembull prej çështjeve simbolike: në qoftë se eprori urdhëron nëpunësin e tij për të kryer një punë të caktuar, edhe pse kryhet nga nëpunësi, kjo punë në të njëjtën kohë i atribuohet edhe eprorit apo urdhëruesit që është një nivel më

1. Gnosistët përdorin termin *Njësim i veprave* me këtë kuptim.

lart se ai nëpunësi. Madje njerëzit me logjikë e konsiderojnë atribuimin e punës tek urdhëruesi më të pranueshëm dhe më të fortë logjikisht.

Edhe Veprueshmëria Hyjnore (*El-Fa'ilije Et-Tekuinije*) ka gjithashtu një zinxhir nivelesh. Meqenëse ekzistenca e çdo vepruesi bazohet tek Vullneti Hyjnor – dhe ky bazim mund të përngjasohet nga një kënd i caktuar me imazhet mendore të atij që i përfytyron ato (*Allahut i takon shembulli më i Lartë!*) – për këtë arsye, të gjitha ndikimet ekzistenciale të cilat burojnë prej çdo vepruesi dhe ndikuesi, në nivelin e tyre më lartë janë të varura dhe lidhura me lejen dhe Vullnetin Krijues Hyjnor dhe mbështeten tek Allahu i Lartësuar. (Nuk ka ndryshim dhe fuqi, vetëm se me Allahun e Lartësuar e të Madhëruar!).

Dy konkluzione të rëndësishme

Konkluzioni i Njësimit të veprave është se njeriu nuk sheh askënd dhe asgjë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, si të denjë për t'u adhuruar me të drejtë. Siç e përmendëm edhe më parë, askush tjetër veç Krijuesit dhe Zotit të njerëzve nuk e meriton adhurimin. Të Merituarit e adhurimit (*El-Uluhijje*) është e pandarë nga Krijueshmëria (*El-Khalikijje*) dhe Zotësia (*Er-Rububijje*).

Konkluzioni i dytë i Njësimit në kuptimin e tij të fundit është që njeriu në të gjitha çështjet e tij të mbështetet tek Allahu i Madhëruar, të kërkojë ndihmë vetëm tek Allahu dhe tek askush tjetër, frika të jetë vetëm nga Allahu. Edhe në qoftë se nuk plotësohen shkaqet e zakonshme për njohjen e cila i kërkon këto kushte dhe t'u përgjigjet kërkesave të tij, njeriu sërish nuk duhet të mërzitet e ta kapë dëshpërimi dhe humbja e shpresës sepse Allahu i Madhëruar do ta ndihmojë dhe do ta begatojë me mëshirën e Tij, nga rrugë dhe shkaqe jo të zakonshme si dhe do t'u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të njeriut.

Shembulli i këtij njeriu i cili përjeton këto ndjesi të

Njësimit do të prehet nën hijen e administrimit të veçantë hyjnor për të jetuar i qetë shpirtërisht: **"Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar."**[2]

Këto dy konkluzione ne i gjejmë në ajetin e nderuar kur'anor të cilin çdo mysliman e përsërit të paktën dhjetë herë në ditë **"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë."**[3]

Përgjigje ndaj një keqkuptimi

Në mendjet e disave mund të lindë ky keqkuptim: Njësimi absolut kërkon nga njeriu të mos mbështetet askund tjetër veç Allahut.

Si rrjedhojë, duhet që të mos ndërmjetësojnë për ne të dashurit (evlijatë) e Allahut sepse ndërmjetësimi i tyre është i pasaktë.

Përgjigjja për këtë është: Ndërmjetësimi i të dashurve të Allahut, nëse është me kuptimin që të përgjigjen vetë ata mbi këtë ndërmjetësim dhe të realizojnë e ofrojnë çfarë u kërkohet në mënyrë të pavarur dhe pa patur nevojë për lejen e Allahut dhe ndihmën e Tij, atëherë ky lloj ndërmjetësimi nuk është i përshtatshëm me Njësimin dhe e kundërshton atë.

Nëse ky ndërmjetësim është me kuptimin se Allahu i Madhëruar ia ka lejuar të dashurit (*velij*) të Tij (*velij*) të ndërmjetësojë tek Mëshira e Tij dhe i ka urdhëruar njerëzit që të kërkojnë ndërmjetësimin e këtij të dashuri, atëherë ky lloj ndërmjetësimi, ashtu siç nuk bie ndesh me Njësimin, po ashtu ai konsiderohet nga çështjet e Njësimit në adhurim e bindje dhe realizohet me urdhrin e të Madhërishmit.

Ndërsa përsa i përket asaj se përse Allahu i Lartësuar i ka lejuar këta lloj ndërmjetësuesish dhe pse i ka urdhëruar njerëzit të kërkojnë ndërmjetësim tek të dashurit e Tij, përgjigj-

2. Sure "Junus", ajeti 62.
3. Sure "El-Fatiha", ajeti 5.

ja është: Ky urdhër hyjnor ka urtësitë dhe mirësitë e veta.

Prej këtyre mund të përmendim çështjet vijuese: Njohja me gradat e larta të robëve të Tij të devotshëm; motivimi dhe nxitja që u bëhet të tjerëve për adhurim dhe bindje në mënyrë që të arrijnë në të njëjtën gradë dhe shkallë të lartë; ndalimi i tyre nga mendjemadhësia dhe mburrja ndaj të tjerëve për adhurimin e kryer, pasi dikush mund të pretendojë se ka arritur gradat më të larta dhe se posedon përsosuritë më larta njerëzore. Fatkeqësisht, kjo gjendje vërehet tek ata të cilët nuk e kanë nderin dhe mirësinë e dashurisë për Ehli Bejtin, të pasimit dhe ndërmjetësimit të tyre (*paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ta!*).

Pyetje

1. Sqaro kuptimin gjuhësor dhe terminologjik të Njësimit.

2. Cili është argumenti i Njësimit të Cilësive (*Teuhidu's-Sifat*)?

3. Si mund të vërtetohet Njëshmëria Veprimore (Et-*Teuhidu'l-Ef'alij*)?

4. Sqaro Njësimin me kuptimin e Njësimit në ndikimin e pavarësisë (*et-te'thiru'l-istiklalij*).

5. Cilat janë konkluzionet që rrjedhojnë nga dy grupet e fundit të Njësimit?

6. A e mohon Njësimin ndërmjetësimi i të dashurve të Allahut? Pse?

7. Cila është Urtësia hyjnore në urdhrin e Allahut për ndërmjetësim?

Leksioni i tetëmbëdhjetë

FATALIZMI (*xhebr*) DHE PËRZGJEDHJA (*ikhtijar*)

Hyrje

Njëshmëria në ndikimin e pavarësisë është nga një njohjet me shumë vlerë dhe ka ndikim të madh në edukimin e njerëzve dhe ndërtimin e personaliteteve të tyre. Këtë ide e trajtuam në leksionin e kaluar.

Prandaj edhe Kur'ani famëlartë e ka përforcuar shumë këtë ide duke ofruar me shprehje dhe mënyra të ndryshme terrenin e përshtatshëm për kuptimin e drejtë dhe të saktë të saj. Si pjesë e këtyre shprehjeve është varësia e çdo dukurie nga Leja, Dëshira, Vullneti, Vendimi dhe Caktimi i Allahut.

Kuptimi i saktë dhe i drejtë për këtë temë ka nevojë për pjekuri logjike dhe ideore. Gjithashtu, ka nevojë për studimin dhe shpjegimin e saktë të tij. Ata të cilët janë privuar nga kjo pjekuri e nevojshme logjike apo ata të cilët nuk janë përpjekur që të përfitojnë nga mësimet e imamëve të pagabueshëm dhe komentuesve të vërtetë të Kur'anit famëlartë, ata janë përballur me shumë devijime dhe keqkuptime. Si rrjedhojë, e shpjeguan këtë temë me kufizimin e çdo ndikimi dhe shkakësie nga Allahu i Lartësuar.

Në kundërshtim me shumë ajete të qarta (*muhkeme*) kur'anore, ata mohuan çdo ndikim e shkakësi të shkaqeve dhe të ndërmjetësve. Ata besuan se "zakoni" i Allahut (*'adetu'll-llah*) bëri që të ekzistojë nxehtësia pas ekzistencës së zjarrit, që të ekzistojë ngopja pas ngrënies së ushqimit dhe që të ekzistojë shuarja e etjes pas pirjes së ujit, sepse ndryshe nuk do të kishte asnjë ndikim të zjarrit, ushqimit apo ujit në ekzistencën e nxehtësisë, ngopjes apo shuarjes së etjes.

Përfundime të rrezikshme dhe të gabuara si ky devijim ideor na bëhen të qarta nëse studiojmë ndikimet e tyre në fushën e (lirisë së) përzgjedhjes së veprave të njeriut dhe përgjegjësisë së tij.

Përfundimet e kësaj kategorie mendimesh kanë të bëjnë me atribuimin e veprave njerëzore tek Allahu i Madhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe mohimin në mënyrë absolute të efektshmërisë së njeriut dhe ndikimin e tij në veprat e veta. Në këtë rast, askush nuk është përgjegjës për veprat e tij.

Thënë ndryshe: Prej rezultateve të rrezikshme që të çojnë në humbje të këtij devijimi ideor është edhe thënia për detyrimin, fatalitetin (*xhebrije*) e njeriut dhe mohimin e përgjegjësive të tij. Që do të thotë mohimi i veçorisë më të rëndësishme dhe karakteristikës dalluese njerëzore. Kjo nënkupton kotësinë dhe padobishmërinë e të gjitha sistemeve edukuese, morale, ligjore dhe të të drejtave, prej tyre edhe atë të sistemit legjislativ islam.

Nëse do t'ia hiqnim njeriut të drejtën e përzgjedhjes në veprat që ai kryen, atëherë nuk do të kishte vend për përgjegjësi, detyra, urdhërime e ndalime, obligime, shpërblime dhe ndëshkime. Por do të tregonte absurditetin e sistemit të krijimit dhe paqëllimshmërinë e tij. Kjo, sepse - ashtu siç ajetet kur'anore,[1] hadithet e nderuara dhe argumentet e faktet logjike - qëllimi i krijimit të gjithësisë është përgatitja dhe mundësimi i një terreni të përshtatshëm për krijimin e njeriut, që nëpërmjet efektshmërisë së tij, praktikave dhe veprimeve të tij të përzgjedhura, adhurimeve dhe nënshtrimit të tij ndaj Allahut të Madhëruar, të arrijë përsosuritë më të larta të mundshme dhe pozitën e afërsisë (*kurb*) hyjnore që të meritojë mëshirën dhe ndihmën hyjnore të veçantë që i takon.

Por nëse ne e refuzojmë përzgjedhjen njerëzore dhe e mohojmë përgjegjësinë e njeriut, atëherë ai nuk e meriton që të marrë shpërblimin, begatitë e përjetshme dhe kënaqësinë e

1. Shih ajetet vijuese: sure "Hud", ajeti 7; sure "El-Mulk", ajeti 2; sure "El-Kehf", ajeti 7; sure "Edh-Dharijat", ajeti 56; sure "Et-Teube", ajeti 72.

Allahut. Në këtë mënyrë do të shkatërrohej dhe do të rrënohej qëllimi i krijimit, por edhe sistemi i krijimit do të kthehej në një teatër të madh ku njerëzit do të luanin në të rolin e kukullave - të cilat lëvizin dhe luajnë rolin e tyre pa vullnet dhe përzgjedhje - ku do të ndodhnin disa lëvizje dhe vepra pa vullnetin e tyre, porse pastaj disa do të merrnin ndëshkimin dhe qortimin dhe disa të tjerë shpërblimin dhe lavdërimin.

Nga faktorët më të rëndësishëm që çuan në zgjerimin e këtij orientimi të rrezikshëm dhe të devijuar është lakmia politike e qeverive të padrejta e të zvetënuara, për të orientuar dhe justifikuar nëpërmjet këtyre besimeve veprimet dhe qëndrimet e tyre negative si dhe për t'i detyruar popujt e pavetëdijshëm t'u binden pushteteve të tyre dhe t'i pranojnë qeverisjet e tyre, në mënyrë që masat e shtypura të mos lëvizin dhe të mos ngrihen në revolucione e kryengritje kundër këtyre regjimeve kriminale.

Me të drejtë, ne duhet ta konsiderojmë fatalizmin (*xhebrije*) si faktorin më të rëndësishëm në topitjen dhe përgjumjen e popujve.

Pati prej atyre që u treguan vigjilentë ndaj pikave të dobëta në këtë drejtim, por meqenëse ata nuk zotëronin pjekurinë e duhur logjike dhe aftësinë mendore për të harmonizuar ndërmjet monoteizmit të plotë dhe mohimit të fatalitetit dhe nuk u përpoqën të adoptonin mësimet e Ehli Bejtit të pagabueshëm e të pastër (*paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë ata!*), ata iu drejtuan besimit në delegimin [e veprave] (*tefuid*), duke pretenduar daljen e veprave të përzgjedhura të njeriut nga rrethi i Veprueshmërisë Hyjnore.

Në këtë mënyrë, ata e sprovuan veten e tyre me një tjetër lloj sëmundjeje dhe devijimi ideor dhe u privuan nga parimet dhe mësimet islame dhe të dhënat e tyre të larta.

Ndërsa ata të cilët zotëruan përgatitjen dhe pjekurinë e mjaftueshme mendore, e cila bën të mundur perceptimin dhe kuptimin e këtyre njohjeve, si dhe u njohën me mësuesit dhe komentuesit e vërtetë të Kur'anit famëlartë dhe përfituan dije

prej tyre, u imunizuan nga prekja e këtyre sëmundjeve dhe devijimeve.

Nga njëra anë, ata besuan se veprueshmëria e tyre përzgjedhëse buron nga aftësia që ua dhuron atyre Allahu i Madhëruar me gjithë përcaktimin e përgjegjësisë mbi të. Dhe nga ana tjetër, ata perceptuan ndikimin e pavarur hyjnor në një gradë më të lartë dhe më të shenjtë duke arritur nëpërmjet saj të dhënat e kësaj njohjeje frytdhënëse.

Në hadithet të cilat na janë përcjellë nga Ehli Bejti i Profetit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ne gjejmë hadithe të vyera dhe frytdhënëse në këtë fushë, të cilat janë përmendur në librat e hadithit në kapitujt e titulluar "*Mundshmëria dhe mohimi i fatalizmit dhe delegimit*", gjithashtu në kapitujt e Lejes, Dëshirës, Vullnetit dhe Vendimit e Caktimit Hyjnor.

Janë edhe disa hadithe në të cilat ata persona që nuk janë kompetentë/të kualifikuar ndalohen që të thellohen në çështje delikate si këto dhe në studimet e vështira, që të mos preken nga devijimet dhe dyshimet.

Pa dyshim, tema e detyrimit dhe përzgjedhjes ka dimensione e këndvështrime të ndryshme dhe studimi i të gjitha këtyre nuk i përshtatet këtij libri, por për shkak të rëndësisë dhe rrezikshmërisë së kësaj teme, do të përpiqemi të studiojmë disa nga këto aspekte dhe paraqitjen e tyre në mënyrë të thjeshtëzuar. Gjithashtu, për ata të cilët dëshirojnë që të kërkojnë dhe studiojnë më shumë, theksojmë se duhet të karakterizohen nga durimi dhe të përballojnë më shumë gjatë mësimit të bazave logjike dhe filozofike të kësaj teme.

Sqarimi i përzgjedhjes (*ikhtijar*)

Aftësia për të marrë vendime, për të përzgjedhur dhe zgjedhur është prej çështjeve të cilat njeriu i percepton dhe i pohon. Ndoshta është nga çështjet dhe njohuritë më të sigurta (*jekin*) të njeriut. Secili prej nesh i percepton në veten dhe

brendinë e tij nëpërmjet dijes ekzistenciale (*'ilm hudurij*) e cila nuk gabon, ashtu siç percepton nëpërmjet kësaj dijeje gjendjet e tjera shpirtërore. Edhe në qoftë se dyshon në një gjë, ai nuk dyshon në dyshimin e tij. Ai e percepton këtë "dyshim" të tijin nëpërmjet dijes ekzistenciale, kështu që nuk mund të lëkundet në këtë perceptim.

Gjithashtu, secili prej nesh percepton me meditimin më të ulët në brendinë dhe thellësitë e qenies së tij se ai është i aftë që të flasë me fjalë apo mos të flasë, apo nëse është i aftë ta lëvizë dorën e tij apo mos ta lëvizë atë, apo nëse është i aftë të hajë ushqim apo mos të hajë.

Vendosmëria për të kryer një punë, ndonjëherë arrihet për të ngopur motivet instinktive dhe shtazarake si p.sh. uria e cila e shtyn njeriun drejt vullnetit për të ngrënë ushqim apo i eturi të cilin e shtyn etja drejt synimit për të pirë ujë; kurse ndonjëherë tjetër arrihet për të kënaqur motivet dhe nevojat mendore dhe për realizimin e ambicjeve të larta njerëzore si p.sh. i sëmuri, i cili përdor medikamente të hidhura me qëllim që të kurohet e shërohet duke e ndaluar veten po për të njëjtën arsye nga konsumimi i ushqimeve të shijshme.

Po ashtu edhe kërkuesi i dijes (studenti), i cili për të kërkuar diturinë dhe të vërtetat e privon veten nga shumë të mira materiale duke u përballur me shumë lodhje e vështirësi; edhe ushtari i cili sakrifikon edhe jetën e tij në rrugën e aspiratave të tij të larta.

Në realitet, vlera e njeriut del në pah kur dëshirat e tij ndeshen dhe kundërshtojnë njëra-tjetrën. Për të arritur virtytet morale, përsosurinë shpirtërore e të përjetshme dhe për t'u afruar me kënaqësinë hyjnore, njeriu u kthen shpinën dëshirave rrënuese të ulta shtazarake.

Çdo vepër që njeriu e kryen në përputhje me përzgjedhjen dhe në mënyrë më të vetëdijshme, ka më shumë ndikim në përsosjen e tij shpirtërore e morale ose në rënien dhe degjenerimin e tij, si dhe më të meritueshëm për shpërblimin apo ndëshkimin.

Është mëse e qartë se aftësia për të përballuar dëshirat psikologjike nuk është në shkallë të njëjtë tek të gjithë individët dhe në raport me çdo gjë.

Por çdo njeri e posedon këtë dhunti hyjnore (vullnetin e lirë), në sasi të paktë apo të shumtë, dhe çdokush - me stërvitje e ushtrime - mundet ta forcojë dhe ta rritë atë gjithmonë e më shumë.

Pra, nuk duhet të hezitojmë asnjëherë në ekzistencën e vullnetit dhe të përzgjedhjes.

Duhet që keqkuptimet e ndryshme të mos na çojnë në mëdyshjen e mendjeve rreth një çështjeje sentimentale (*vuxhdanij*) e të pakundërshtueshme (*bedihij*) si kjo.

Ashtu siç e kemi përmendur edhe më parë, ekzistenca e përzgjedhjes (*ikhtijar*) si një prej bazave të pakundërshtueshme, pranohet dhe besohet nga të gjitha sistemet edukative e morale si dhe nga fetë (*edjan*) dhe legjislacionet (*sherai'*) qiellore.

Por, nëse nuk besojmë në ekzistencën e tij, atëherë nuk mbetet asnjë vend dhe justifikim për obligimet, përgjegjësitë, qortimet, lavdërimet, ndëshkimet dhe shpërblimet.

Ajo që çoi në dyshim dhe në mëdyshje për këtë të vërtetë të qartë e të pakundërshtueshme dhe që orientoi drejt fatalizmit, është ekzistenca e disa keqkuptimeve, përgjigjja ndaj të cilave është mëse e domosdoshme në mënyrë që hezitime si këto të mos u afrohen mendjeve.

Prej këtej, do t'i qasemi shkurtimisht diskutimit rreth keqkuptimeve më të rëndësishme.

Diskutimi i keqkuptimeve të fatalistëve

Diskutimet më të rëndësishme të fatalistëve janë si vijon:

1- Vullneti njerëzor përbëhet dhe formohet nën veprimin e shkaktimit të tendencave të brendshme dhe stimulimeve të tyre. Ekzistenca e këtyre tendencave nuk i nënshtrohet përzgjedhjes njerëzore, as shkaktimi i tyre nën veprimin e faktorëve të jashtëm. Kështu që nuk mbetet vend për vullnetin

dhe përzgjedhjen.

Përgjigjja: Shkaktimi i tendencave është përgatitës (*mu'idd*) i vullnetit dhe i vendosmërisë dhe nuk është vendosmëria e vullneti për të kryer një punë rezultat detyrues/fatalist e i pashmangshëm në shkaktimin e tendencave duke i mohuar njeriut aftësinë e kundërshtimit dhe rezistencës.

Si dëshmi për këtë ne mund të përmendim se në shumë aspekte ndodh një gjendje mëdyshjeje dhe dyshimi tek njeriu, ku ai, për të marrë vendime, ka nevojë për të medituar dhe për t'i peshuar mirë të mirat e të këqijat në punë. Ndonjëherë marrja e vendimeve nuk arrihet vetëm se me vështirësi.

2- Është vërtetuar tashmë në shkenca të ndryshme se ka faktorë të ndryshëm të cilët ndikojnë në formimin e vullnetit njerëzor si p.sh. trashëgimia, sekrecionet e gjendrave (të cilat ndodhin si rezultat i ndikimit të lëndëve ushqyese apo medikamenteve të veçanta), gjithashtu edhe faktorët që na rrethojnë dhe ata shoqërorë.

Ndryshimi i njerëzve në qëndrimet dhe sjelljet e tyre i nënshtrohet ndryshimit të këtyre faktorëve. Vihet re, gjithashtu, se edhe tekstet fetare i mbështesin nga afër apo nga larg këto mendime. Pra, nuk mund të thuhet se veprat njerëzore burojnë nga vullneti i lirë.

Përgjigjja: Besimi në përzgjedhjen dhe vullnetin e lirë nuk do thotë kundërshtim i këtyre faktorëve dhe ndikimeve të tyre, por do të thotë se megjithë ekzistencën e gjithë këtyre faktorëve, njeriu mund të përzgjedhë dhe mund të jetë i aftë për të rezistuar dhe kundërshtuar.

Dhe kur motivet e ndryshme të ndeshen dhe të kundërshtojnë njëra-tjetrën, shohim se ai është i aftë për të përzgjedhur disa prej tyre.

Natyrisht, ka edhe disa faktorë të fuqishëm që është e vështirë t'u rezistosh, ku përzgjedhja e një pune që kundërshton kërkesat e saj është shumë e vështirë.

Por ky lloj rezistimi dhe kjo lloj përzgjedhjeje e vështirë ka më shumë ndikim në përsosurinë e njeriut dhe në meri-

timin e shpërblimit dhe shumëfishimin e tij. Ashtu si disa trazime dhe emocione të mprehta ose disa kushte të vështira ndonjëherë bëhen shkak për lehtësimin e ndëshkimeve apo uljen e shkallës së krimit.

3- Një nga keqkuptimet e fatalistëve është: Allahu i Madhëruar i di të gjitha dukuritë që ndodhin në botë dhe gjithësi, prej tyre edhe veprat njerëzore që para se të ndodhin. Dija hyjnore nuk pranon gabime dhe prapambetje. Pra, është e domosdoshme që të gjitha dukuritë të ndodhin e të realizohen sipas Dijes hyjnore të pafillimtë dhe nuk mund të dalin jashtë sferës së Dijes së Tij, kësisoj, nuk mbetet vend për përzgjedhjen njerëzore.

Përgjigjja: Dija hyjnore është e lidhur me çdo dukuri siç janë në realitet dhe veprat e përzgjedhura i di Allahu i Madhëruar siç janë në realitet dhe në përputhje me veçorinë e përzgjedhshmërisë dhe vullnetshmërisë së tyre. Nëse këto vepra do të ndodhnin sipas veçorisë së fatalizmit, atëherë ato do të realizoheshin në kundërshtim me Dijen hyjnore dhe do të ishin jashtë **sferës së Dijes së Tij**.

Për shembull, Allahu i Madhëruar e di se filan individ, në kushte të caktuara, do të vendosë të bëjë një vepër të caktuar dhe se ai do ta realizojë atë vepër.

Dija hyjnore këtu nuk lidhet vetëm me realizimin e veprës, pavarësisht se ajo vepër del nga vullneti i vepruesit dhe përzgjedhja e tij, por lidhet me vetë veprën meqenëse ajo buron nga përzgjedhja e njeriut.

Pra, Dija hyjnore e pafillimtë (*ezelije*) nuk bie ndesh me përzgjedhjen e njeriut dhe me vullnetin e tij të lirë.

Nga keqkuptimet e fatalistëve është edhe keqkuptimi i cili lidhet me çështjen e Vendimit (*kada*) dhe Caktimit (*kader*). Ata besojnë se kjo çështje nuk përshtatet me përzgjedhjen e njeriut.

Këtë temë do ta trajtojmë në leksionin e ardhshëm.

Pyetje

1. Shpjego faktorët që çuan në orientimin drejt fatalizmit dhe në përhapjen e tij.

2. Cilat janë pasojat negative të këtij orientimi?

3. Sqaro ekzistencën e [lirisë së] përzgjedhjes dhe vullnetit të lirë tek njeriu.

4. A është ndikimi i tendencave të brendshme dhe faktorët që i aktivizojnë ato në kundërshtim me përzgjedhjen e njeriut? Dhe pse?

5. Cili është dallimi ndërmjet atyre që u nënshtrohen ndikimeve të disa gjendjeve dhe reagimeve shpirtërore jo të zakonshme si dhe rrethanave të vështira dhe atyre që nuk u nënshtrohen?

6. A nënkuptojnë fatalizëm ndikimet e trashëgimisë, faktorëve që na rrethojnë dhe ato shoqërorë? Dhe pse?

7. A bie ndesh Dija hyjnore e pafillimtë me përzgjedhjen e njeriut? Dhe pse?

Leksioni i nëntëmbëdhjetë

VENDIMI DHE CAKTIMI
(*El-Kada ue'l-Kader*)

Kuptimi i Vendimit dhe Caktimit

Fjala *kadr* do të thotë sasi dhe *takdir* do të thotë matja e diçkaje dhe konsiderimi i saj si masë dhe bërja e çdo gjëje me masë e kufi të caktuar. Ndërsa fjala *kada* do të thotë plotësim dhe mbarim i diçkaje, ekzekutim dhe vendim (ky është një lloj plotësimi në kuptim të figurshëm). Ndonjëherë përdoren të dyja fjalët si sinonime duke u përdorur në kuptimin e fatit.

Kur themi "Caktim Hyjnor" kemi për qëllim se Allahu i Madhëruar për çdo krijesë/incidencë (*hadith*) ka përcaktuar masa dhe kufij cilësorë, sasiorë, kohorë dhe vendorë të caktuar për realizimin e saj konform shkaqeve dhe faktorëve gradualë.

Kur themi "Vendim Hyjnor" kemi për qëllim mbërritjen e krijesës/aksidencës (*hadith*) në fazën e saj përfundimtare e të pashmangshme pasi janë plotësuar të gjitha premisat, shkaqet dhe kushtet për atë krijesë/aksidencë.

Nën dritën e këtij shpjegimi, faza e Caktimit është para fazës së Vendimit duke qenë se se Caktimi ka faza graduale të cilat përfshijnë premisa të largëta, të mesme dhe të afërta. Caktimi është i ekspozuar ndaj ndryshimit sipas ndryshimit të shkaqeve dhe kushteve.

Për shembull, ecuria e përshkallëzuar e fetusit nga një pikë ujë/spermë (*nutfeh*), pastaj në një copë gjaku të ngjizur (*'alakah*) e më pas në një copë mishi (*mudgah*) derisa embrioni të bëhet fetus i plotë – të gjitha këto konsiderohen faza të ndry-

shme të caktimit të tij, sepse ato përmbledhin karakteristikat kohore dhe vendore gjithashtu. Rënia e (dështimi i) fetusit në një nga këto faza konsiderohet ndryshim në caktim.

Ndërsa faza e vendimit është e menjëhershme, jo e përshkallëzuar dhe është e lidhur me disponimin e të gjitha shkaqeve dhe kushteve. Ajo është e pashmangshme dhe nuk pranon ndryshim. Allahu i Madhëruar thotë në ajetin famëlartë vijues: **"Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: "Bëhu!" - dhe ajo bëhet."**[1] Por, ashtu siç edhe e theksuam më sipër, të dyja fjalët [Caktim dhe Vendim (*El-Kada ue'l-Kader*)] ndonjëherë përdoren edhe si sinonime të njëra-tjetrës, prandaj ndahen në të pashmangshme dhe të shmangshme. Nga ky këndvështrim, disa transmetime e lutje bëjnë fjalë për ndryshimin e vendimit. Gjithashtu, sadakaja (lëmosha), mirësjellja ndaj prindërve, ruajtja e lidhjeve e farefisnore dhe lutjet janë nga faktorët që ndryshojnë vendimin.

Vendimi dhe Caktimi teorik (*'ilmij*) dhe identik (*'ajnij*)

Caktimi dhe Vendimi hyjnor ndonjëherë përdoret me kuptimin e Dijes së Allahut në lidhje me disponimin e premisave, shkaqeve dhe kushteve që ndikojnë në realizimin e dukurive, si dhe me kuptimin e Dijes së Tij në lidhje me pashmangshmërinë e realizimit të tyre. Ky quhet "Caktimi dhe Vendimi teorik (*'ilmij*)".

Ndonjëherë përdoret me kuptimin e atribuimit të procesit gradual të dukurive, si dhe atribuimit të realizimit të saj të jashtëm identik (*'ajnij*) tek Allahu i Madhëruar. Ky quhet "Caktimi dhe Vendimi identik (*'ajnij*)".

Në përputhje me atë që përftohet nga ajetet dhe transmetimet, del në pah se Dija hyjnore që përfshin të gjitha dukuritë në formën në të cilën realizohen plotësisht në botën e jashtme është e vendosur në një krijesë të lartë e të nderuar që quhet

1. Sure "Ali Imran", ajeti 47. Shih, gjithashtu, ajetet vijuese: sure "El-Bekare", ajeti 117; sure "Merjem", ajeti 53; sure "Gafir", ajeti 68.

"Leuhi Mahfudh" (Tabela e Ruajtur).

Çdokush që mund të lidhet - me lejen e Allahut - me "Leuhi Mahfudh"-in do të jetë në dijeni në lidhje me dukuritë që kanë ndodhur dhe do të ndodhin në të ardhmen.

Ekzistojnë edhe rrasa/tabela (*eluah*) të tjera, por që janë të një shkalle dhe grade më të ulët se *Leuhi Mahfudh*i. Në to janë vendosur dukuritë në formë të kushtëzuar dhe jo të plota. Kush ka nderin t'i njohë ato do të ketë njohuri të kufizuara, jo të plota dhe të kushtëzuara e që mund të ndryshojnë.

Ajeti famëlartë vijues na flet për të dy llojet e fatit (*masir*): **"Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë (**në këtë libër**); dhe tek Ai është Libri amëz."**[2] Ndryshimi i caktimeve të kushtëzuara dhe të evitueshme përshkruhet në transmetime me fjalën "*beda*".

Pra, besimi në Caktimin dhe Vendimin shkencor nuk shkakton ndonjë problematikë (konfuzion) më të madhe se ajo që përmendëm në temën për Dijen hyjnore të pafillimtë. Ne studiuam gjatë leksionit të kaluar keqkuptimin e fatalistëve në lidhje me çështjen e Dijes Hyjnore, ku na u bë e qartë dobësia dhe zbrazëtia e tij.

Porse problematika më e vështirë vjen në aspektin e besimit të Vendimit dhe Caktimit identik (*'ajnij*), sidomos në aspektin e besimit të fatit/destinit të pashmangshëm.

Na del si detyrë trajtimi i tij dhe përgjigjja ndaj tij, edhe pse u njohëm me përgjigjen përgjithësuese në temën e Njëshmërisë me kuptimin e ndikimit të pavarur.

Marrëdhënia ndërmjet Caktimit e Vendimit dhe përzgjedhjes së njeriut

Më sipër mësuam se besimi në Vendimin dhe Caktimin hyjnor identik (*'ajnij*) nënkupton besimin në ekzistencën e dukurive që nga fillimi i ekzistencës së tyre e deri në fazat e zhvillimit të tyre e deri në përfundimin e jetës së tyre.

2. Sure "Er-Ra'd," ajeti 39.

Madje, që nga çasti i disponimit të të gjitha premisave të largëta të tyre, të gjitha ato i nënshtrohen Administrimit (*tedbir*) të Urtë Hyjnor. Gjithashtu, ne duhet të besojmë se plotësimi i të gjitha kushteve për ekzistencën e tyre dhe mbërritjen e tyre në fazën përfundimtare mbështetet në Vullnetin Hyjnor.[3]

Thënë ndryshe, ashtu siç ekzistenca e çdo dukurie i atribuohet Lejes dhe Providencës [Parashikimit – (*El-Meshi'eh*)] Krijuese të Allahut dhe pa Lejen e Tij asnjë ekzistent nuk mund të shohë botën ekzistenciale, po ashtu edhe ekzistenca dhe krijimi i çdo gjëje mbështetet në Vendimin dhe Caktimin hyjnor. Pa këto të dyja asnjë krijesë/ekzistent nuk mund të mbërrijë në formën dhe kufijtë e caktuar për të dhe as nuk mbërrin në fund të jetës së tij.

Qartësimi dhe shpjegimi i këtyre lidhjeve e i këtyre marrëdhënieve përfaqëson në realitetin e tij njohjen graduale të Njëshmërisë me kuptimin e pavarësisë në ndikim, i cili është nga shkallët më të larta të Njëshmërisë. Vërtetimi i marrëdhënieve të tilla dhe vigjilenca ndaj tyre luajnë rol të madh në ndërtimin e personalitetit të njeriut, ashtu siç e përmendëm edhe më parë.

Ndërsa të atribuarit e dukurive të Lejes, madje edhe Providencës Hyjnore, është më e thjeshtë për t'u kuptuar dhe më e lehtë për mendjet. Ndryshe nga të atribuarit e fazave të tyre përfundimtare dhe të përcaktimit të pashmangshëm Vendimit Hyjnor.

Për shkak të vështirësisë së përvetësimit të tij dhe të kuptimit tij janë kryer studime të shumta në këtë temë. Kjo për arsye se është e vështirë përputhja ndërmjet këtij besimi dhe besimit në përzgjedhjen e njeriut në vizatimin e destinit/fatit të tij dhe përcaktimin e atij fati.

Prandaj shohim se disa teologë/kelamistë esh'arinj që kanë pranuar përfshirjen në Vendimin Hyjnor të veprave

3. Pajtimi mes Vullnetit hyjnor dhe Caktimit hyjnor bëhet i qartë në zbatueshmërinë e ajetit 47 të sures "Ali Imran" me ajetin 82 të sures Jasin: **"Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë asaj "Bëhu!" - dhe ajo bëhet."**

njerëzore janë drejtuar drejt fatalizmit (*xhebr*).

Ndërkohë shohim se një grup tjetër, mu'tezilitët, të cilët nuk mund të besonin në fatalizmin dhe në ndikimet e tij të rrezikshme e negative, e mohuan përfshirjen në Vendimin Hyjnor të veprave njerëzore vullnetare. Secili prej këtyre grupeve i komentoi ajetet kur'anore dhe transmetimet që bien ndesh me mendimin e tyre me ç'ka u përshtatet prirjeve dhe opinioneve të tyre.

Këto janë përmendur në librat e zgjeruar teologjikë dhe në diskutimet e veçanta rreth studimit të fatalizmit (*xhebr*) dhe delegimit (*tefuid*).

Boshti kryesor i kundërshtimit është: Nëse vepra e njeriut është vërtet e përzgjedhur dhe mbështetet në vullnetin e tij, atëherë si mund të themi se ajo mbështetet në Vullnetin e Allahut dhe në Vendimin e Tij?! Dhe, nëse ajo mbështetet në Vendimin Hyjnor, atëherë si mund të themi se ajo i nënshtrohet vullnetit të njeriut dhe përzgjedhjes së tij?!

Për t'iu përgjigjur këtij kundërshtimi dhe për të pajtuar ndërmjet mbështetjes së veprës tek vullneti dhe përzgjedhja e njeriut si dhe mbështetjes së saj tek Vullneti dhe Vendimi i Allahut, ne duhet të studiojmë rreth llojeve të mbështetjes së një pasoje tek shkaqe të shumta, që të na qartësohet lloji i mbështetjes së veprës së përzgjedhur tek njeriu dhe tek Allahu i Madhëruar.

Llojet e ndikimit të shkaqeve të ndryshme

Ndikimin e shkaqeve të shumta në ekzistencën e një dukurie çfarëdo mund ta përfytyrojmë në mënyra të ndryshme:

1- Shkaqet e shumta ndikojnë së bashku, ku secila prej tyre sistemon tjetrën dhe të gjitha kontribuojnë në ekzistencën e dukurisë, si p.sh. bashkimi i rrënjëve, ujit, nxehtësisë etj., ndikojnë në daljen e bimës.

2- Shkaqet alternohen (zëvendësojnë njëra-tjetrën) në ndikim. Pra, duke patur mundësi ta ndajmë atë dukuri në aq

pjesë sa janë edhe shkaqet, ku secila pjesë është pasojë e njërës prej shkaqeve dhe faktorëve të cilët shkaktojnë ndikimin e tyre përgjatë kohës dhe radhës së tyre, siç është rasti i disa motorëve të një aeroplani, të cilët përmbushin me radhë procesin e vazhdimësisë së lëvizjes së aeroplanit.

3- Ndikimi i secilit prej tyre është pasues i tjetrit, ashtu si ndodh me topat sportivë kur përplasen me njëri-tjetrin, ku secili prej tyre bëhet shkak për lëvizjen e tjetrit; apo siç ndodh gjatë procesit "domino" ku nëse ushtrohet ndikim mbi objektin e parë dhe si pasojë ai rrëzohet; duke u rrëzuar, ky do të ushtrojë ndikim te objekti vijues e si pasojë edhe ai do të rrëzohet; e kështu me radhë të gjithë objektet që vijnë njëri pas tjetrit do të rrëzohen.

Një tjetër shembull tjetër i tij është edhe ajo që vërejmë nga ndikimi i vullnetit të njeriut në lëvizjen e dorës, ndikimin e dorës në lëvizjen e stilolapsit dhe ndikimin e stilolapsit në ekzistencën e shkrimit.

4- Ndikimi si pasojë e shkaqeve dhe faktorëve të shumtë gjatësorë/linearë (*tulije*) ku ekzistenca e secilit prej tyre është e ndërlidhur me ekzistencën e tjetrit. Ndryshe nga grupi i tretë ku ekzistenca e stilolapsit nuk varej nga ekzistenca e dorës, apo ekzistenca e dorës nuk varej nga vullneti i njeriut. Në të gjithë këta shembuj ne vumë re se mund të mblidhen shkaqe të ndryshëm për një pasojë, madje bashkimi i tyre është i domosdoshëm.

Ndikimi i Vullnetit Hyjnor dhe vullnetit të njeriut në veprimin e përzgjedhur bën pjesë te grupi i fundit. Pra, ekzistenca e njeriut dhe vullneti i tij janë të lidhur me Vullnetin Hyjnor.

Ndërsa supozimi në të cilin nuk mund të bashkohen dy shkaqe për një pasojë është supozimi në të cilin bashkohen dy shkaqe sjellës në ekzistencë (*'il-letani muxhidetan*) ose dy shkaqe të cilët nuk mund të bashkohen ndërmjet tyre në ndikim në të njëjtën gjerësi (*'ard*) e nivel (*musteva*), apo ndikimi mbi zëvendësin (*bedel*), si p.sh. supozimi i daljes së një vullneti

nga dy veprues me vullnet absolut, apo atribuimin e të njëjtës dukuri tek dy grupe shkaqesh: dy shkaqe absolutë).

Diskutimi i një keqkuptimi

Na u bë e qartë nga sqarimet që përmendëm se atribuimi tek Allahu i Madhëruar i ekzistencës së veprave të përzgjedhura njerëzore nuk bie ndesh me atribuimin e tyre tek vetë njeriu, sepse njëra është zgjatim i tjetrës dhe nuk ka përplasje ndërmjet tyre.

Thënë ndryshe: Atribuimi i një vepre tek një veprues njerëzor është në një nivel, ndërsa atribuimi i ekzistencës së tij është në një nivel tjetër më të lartë se ai nivel. Në këtë nivel është ekzistenca e vetë njeriut, ekzistenca e lëndës/materies tek e cila ai realizon veprën e tij, si dhe ekzistenca e mjeteve të cilat ai i përdor për realizimin e veprës së tij. Të gjitha këto i atribuohen Allahut të Madhëruar.

Pra, ndikimi i vullnetit të njeriut, i cili konsiderohet "pjesa e fundit e shkakut absolut" në veprën e tij, nuk bie në kundërshtim me atribuimin e të gjitha pjesëve të shkakut të plotë tek Allahu i Madhëruar. Sepse Ai, i Madhëruari është Ai i Cili posedon në dorën e Fuqisë së Tij ekzistencën e botës, të njeriut dhe të gjitha çështjet dhe gjendjet e saj e të tij ekzistenciale.

Është Ai i Cili i furnizon ato vazhdimisht me ekzistencë duke bërë që ato t'ia kenë nevojën Atij në çdo kohë dhe çdo situatë. Ato nuk zotërojnë asnjë lloj pavarësie ndaj të Lartësuarit. Bazuar në këtë, edhe veprat e përzgjedhura të njeriut, gjithashtu, ia kanë përherë nevojën Allahut të Madhëruar.

Këto vepra nuk mund të tejkalojnë kufijtë e Vullnetit të Allahut. Gjithë cilësitë, veçoritë, kufijtë dhe karakteristikat e këtyre veprave janë të lidhura me Caktimin dhe Vendimin Hyjnor, dhe jo siç u përmend, se këto vepra ose t'i atribuohen vullnetit të njeriut, ose t'i atribuohen Vullnetit të Allahut.

Kjo, sepse këto dy vullnete nuk janë në të njëjtën gjerësi dhe në të njëjtin nivel, nuk përbën problem bashkimi mes tyre

dhe as nuk ndikojnë në realizimin e veprave me zëvendësim të supozuar (*bedelije*).

Madje, vullneti i njeriut si dhe vetë origjina e ekzistencës së tij, janë të varura nga Vullneti Hyjnor dhe ekzistenca e Vullnetit Hyjnor është e domosdoshme në realizimin e ekzistencës së njeriut dhe vullnetit të tij. **"Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve!"**[4]

Të dhënat e besimit në Vendimin dhe Caktimin

Besimi në Vendimin dhe Caktimin Hyjnor, siç konsiderohet një fazë e lartë e njohjes së Allahut që çon në përsosurinë mendore të njeriut, po ashtu ka edhe ndikime e të dhëna të shumta praktike.

Disa prej tyre i përmendëm më parë e këtu do të përmendim disa të tjera:

Ai që beson se aksidencat (*hauadith*) i nënshtrohen Vullnetit të Urtë të Allahut dhe se ato i atribuohen Caktimit dhe Vendimit Hyjnor, nuk u trembet ngjarjeve të dhimbshme, as nuk gjunjëzohet para tyre dhe as nuk e kaplon frika dhe humbja e shpresës.

Kur beson se këto ngjarje përfaqësojnë njërën anë të rregullit të urtë të gjithësisë dhe se ato realizohen në përputhje me urtësitë dhe dobitë, atëherë i mirëpret krahëhapur. Nëpërmjet këtij besimi ai arrin tek virtytet e vyera si durimi, mbështetja, kënaqësia, dorëzimi etj.

Këtë njeri nuk e tërheqin dhe as nuk e mashtrojnë kënaqësitë e jetës dhe gëzimet e saj. Ai nuk i merr kënaqësitë dhe mirësitë e Allahut për t'u krenuar dhe për t'u bërë mendjemadh me to e as i konsideron begatitë hyjnore shkallë për mburrje e supremaci.

Këto të dhëna me vlerë janë ato të cilat na i tregon ajeti famëlartë: **"S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (**Leuhi Mahfûdh**) më parë se ta krijo-**

4. Sure "Et-Tekuir", ajeti 29.

jmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Këtë paracaktim e kemi bërë**) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë."**[5]

Ne duhet të përforcojmë këtu domosdoshmërinë e mënjanimit të ndikimeve dhe ndërlikimeve të komentimit dhe interpretimit të gabuar dhe devijues rreth çështjeve të Caktimit, Vendimit dhe Njëshmërisë në ndikimin e pavarur.

Një interpretim i gabuar çon në dembelizëm, në papunësi, në poshtërim, në pranim të padrejtësisë dhe të keqes dhe largon nga përgjegjësia.

Duhet ta dimë se lumturia apo vuajtja e pafundme e njeriut janë rezultat i vetë veprave që ai përzgjedh. Allahu thotë: **"...në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon..."**[6]; **"Dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar."**[7]

5. Sure "El-Hadid", ajetet 22-23.
6. Sure "El-Bekare", ajeti 286.
7. Sure "En-Nexhm", ajeti 39.

Pyetje

1. Trego kuptimin gjuhësor të Vendimit dhe Caktimit.

2. Çfarë do të thotë Caktim dhe Vendim Hyjnor?

3. Mbi ç'bazë ndahet Vendimi dhe Caktimi në të pashmangshëm dhe të shmangshëm?

4. Ç'është *beda*ja?

5. Sqaro Vendimin dhe Caktimin shkencor (*'ilmij*) e identik (*'ajnij*).

6. Ç'është "*Leuhu'l Mahfudhi*" dhe "*Leuhu'l Mahv ue'l-Ithbat*" dhe cila është lidhja e tyre me fatin e pashmangshëm dhe të shmangshëm?

7. Sqaro vështirësinë e pajtimit ndërmjet Vendimit e Caktimit dhe përzgjedhjes së njeriut, si dhe dallimet e mendimeve të teologëve (kelamistëve) rreth kësaj çështjeje.

8. Trego llojet e ndikimeve të shkaqeve të shumtë tek e njëjta pasojë dhe sqaro llojin në cilin është i pamundur bashkimi i shkaqeve të shumtë tek e njëjta pasojë.

9. Përgjigjju keqkuptimit të fatalizmit (*xhebr*) në çështjen e Vendimit dhe Caktimit.

10. Shpjego ndikimin e besimit në Vendimin dhe Caktimin hyjnor.

Leksioni i njëzetë

DREJTËSIA E ALLAHUT

Hyrje

Në leksionet e kaluara vumë re ndryshimin ndërmjet këtyre dy grupimeve prej grupimeve kelamiste: esh'arinjve dhe mu'tezilitëve në tema e çështje të ndryshme. Nga këto tema përmendim temat e Fjalës (*El-Kelam*), Vullnetit (*El-Irade*) Hyjnor, Njëshmërisë së Cilësive (*Et-Teuhidu's-Sifatij*), detyrimi/fatalizmi (*xhebr*), Vendimi (*El-Kada*) dhe Caktimi (*El-Kader*). Ne vumë re se mendimet e tyre, në të shumtën e rasteve, ndodhen në dy an**ët** ekstreme - neglizhencës dhe teprimit.

Ndër boshtet bazë të dallimit ndërmjet këtyre dy grupimeve është edhe tema e Drejtësisë Hyjnore (*El-'Adlu'l-Ilahij*). Ajo që bie në sy është dakordimi ndërmjet shiitëve dhe mu'tezilitëve përsa i përket mendimit të tyre rreth kësaj teme.

Këta u thirrën me termin "El-'Adlije" kundrejt esh'arinjve. Për shkak të rëndësisë së saj, kjo temë është konsideruar si një nga temat kryesore në teologji/apologjetikë (*'ilmu'l-kelam*), madje konsiderohet nga bazat e besimit dhe nga veçoritë kryesore të aspektit kelamist tek shiitët dhe mu'tezilitët.

Duhet të theksojmë, gjithashtu, se esh'arinjtë nuk e kundërshtojnë Drejtësinë Hyjnore.

Ata nuk e konsiderojnë Allahun të padrejtë (*Zoti na faltë!*) meqenëse ajetet e qarta kur'anore të cilat nuk pranojnë interpretim e vërtetojnë Drejtësinë Hyjnore dhe e mohojnë çdo ngjyrë nga ngjyrat e padrejtësisë t'i përshkruhet Allahut të Madhëruar.

Studimi i kësaj teme rrotullohet rreth asaj se a mundet mendja njerëzore e vetme dhe pa u mbështetur në burime she-

riatike (në Kur'an dhe në Sunet) të perceptojë e të arrijë në kritere për veprat, veçanërisht për Veprat Hyjnore.

Dhe mbi këtë bazë të gjykojë për domosdoshmërinë e kryerjes së një vepre dhe largimin nga një vepër tjetër.

Për shembull, të gjykojë mendja (logjika) se Allahu i Madhëruar duhet t'i futë besimtarët në Xhenet dhe jobesimtarët në Zjarr. Apo të gjykojë se disa dispozita nuk mund të plotësohen vetëm se duke iu mbështetur Revelatës dhe nëse nuk do ta marrim parasysh Revelatën, atëherë mendja nuk mund të logjikojë e të vendosë për ato dispozita.

Pra, boshti kryesor i dallimit është tema e cila konsiderohet si "e mira dhe e keqja sipas logjikës" (*el-husnu ue'l-kubhu'l-'aklijjejn*). Esh'arinjtë e kanë refuzuar dhe kanë besuar se e mira në çështjet krijimore është ajo që vepron Allahu, ndërsa në çështjet legjislative është ajo që urdhëron Allahu për t'u vepruar dhe se vepra nuk është e mirë në vetvete, prandaj e vepron Allahu ose e urdhëron atë.

Ndërsa "El-'Adlije" (ithtarët e këtij parimi prej shiitëve dhe mu'tezilitëve), besojnë se veprat e mira cilësohen në vetvete si të mira (*hasene*) e të këqija (*kabiha*), pa marrë parasysh atribuimin krijimor (*tekuinij*) dhe legjislativ (*teshri'ijj*) të tyre tek Allahu i Madhëruar.

Deri diku, mendja mundet që të perceptojë anët pozitive dhe ato negative tek veprat dhe pastrimin (*tenzih*) e Qenies Hyjnore nga veprat e këqija. Por ky perceptim logjik nuk do të thotë se mendja (*Allahu na faltë!*) të urdhërojë Allahun dhe ta ndalojë atë, por do të thotë se mendja zbulon përshtatjen e një vepre të caktuar me Cilësitë Absolute Hyjnore dhe mospërshtatjen e një vepre tjetër me to. Mbi këtë bazë del n**ë pah** pamundësia e bërjes së veprave të këqija nga Allahu.

Është e qartë se studimi i hollësishëm i kësaj teme, përgjigjja ndaj keqkuptimeve të cilat i shtynë esh'arinjtë ta mohonin të mirën dhe të keqen sipas logjikës e të përfaqësonin orientimin kundërshtues të "El-Adlije"-s, studimi i gjithë kësaj është i gjatë dhe është e vështirë t'i qasemi në këtë libër.

Gjithashtu, në diskutimet e mu'tezilitëve mund të jenë disa pika të dobëta të cilat e bëjnë të domosdoshme qasjen ndaj tyre dhe diskutimin rreth tyre, aty ku është e nevojshme. Porse shiitët e pranojnë dhe e besojnë thelbin e besimit të së mirës dhe së keqes sipas logjikës, bazë e cila mbështet në Kur'an dhe Sunet dhe përforcohet nga Imamët e pagabueshëm (*paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ta!*).

Prandaj, ne këtu, fillimisht do të sqarojmë konceptin e termit "Drejtësi" dhe pas kësaj do të tregojmë argumentin logjik rreth kësaj Cilësie, e cila është një nga Cilësitë Vepruese Hyjnore. Në fund, do të diskutojmë keqkuptimet më të rëndësishme rreth kësaj çështjeje dhe do t'u përgjigjemi atyre.

Koncepti i Drejtësisë (*El-'Adl*)

Drejtësi në kuptimin gjuhësor do të thotë "barazi" e "shlyerje".

Përgjithësisht përdoret në kuptimin e përkujdesjes ndaj të drejtave të të tjerëve. E kundërta e saj është "padrejtësia", që do të thotë cenim i të drejtave të të tjerëve. Në dritën e kësaj, drejtësi do të thotë: "T'i japësh të drejtën çdokujt që i takon".

Pra, fillimisht duhet të përfytyrojmë një ekzistent që ka të drejtë që përkujdesja ndaj së drejtës së tij të jetë "drejtësi" dhe cenimi i saj "padrejtësi".

Ndonjëherë koncepti i drejtësisë është më i gjerë dhe përdoret për "vënien e diçkaje në vendin e duhur apo kryerja e çdo vepre në mënyrën më të mirë". Në bazë të këtij përkufizimi, drejtësia është sinonim i urtësisë dhe vepra e drejtë është sinonim i veprës së urtë.

Ndërsa se si përcaktohet "e drejta e atij që e meriton" dhe "vendi i duhur i diçkaje", kjo kërkon një diskutim të gjatë dhe përfaqëson pjesën më të rëndësishme të filozofisë së moralit dhe filozofisë së ligjit; dhe ne nuk mund të studiojmë këtu tema si këto.

Ajo që ne duhet të theksojmë këtu është se çdo njeri që

logjikon mund të perceptojë se kushdo që ia merr copën e bukës jetimit pa ndonjë shkak a justifikim ose e derdh gjakun e një të pafajshmi, atëherë ai ka bërë padrejtësi dhe ka kryer një vepër të keqe.

E kundërta e kësaj është nëse dikush e merr copën e bukës nga dora e atij që e ka rrëmbyer dhe ia kthen jetimit ose e ndëshkon vrasësin kriminel me ndëshkimin që e meriton, atëherë ai ka kryer një punë të mirë dhe të drejtë. Ky gjykim i së mirës e së keqes dhe drejtësisë e padrejtësisë nuk bazohet në Urdhrin dhe Ndalimin Hyjnor, sepse me këtë gjykim gjykon edhe ai që nuk beson në ekzistencën e Allahut.

Ndërsa, cili është sekreti i këtij gjykimi dhe cila është fuqia perceptuese që percepton të mirën dhe të keqen etj., këto janë çështje që studiohen në degë e kapituj të ndryshëm të filozofisë.

Pra, mund të përfytyrojmë për drejtësinë dy koncepte: "i përveçëm dhe i përgjithshëm":

• I pari: Përkujdesja ndaj të drejtave të të tjerëve.

• I dyti: Veprimi i veprës sipas urtësisë duke e konsideruar përkujdesjen ndaj të drejtave të të tjerëve si një nga të vërtetat e saj.

Në dritën e kësaj që thamë, nuk i përshtatet drejtësisë mendimi për barazinë mes të gjithë njerëzve apo ndërmjet të gjitha gjërave.

Nuk është mësues i drejtë ai që mban qëndrim të njëjtë ndaj të gjithë nxënësve të tij, duke i barazuar të gjithë në vërejtje e inkurajim, qoftë të zellshmit e qoftë përtacët. Ashtu siç nuk është gjykatës i drejtë ai i cili e ndan një pasurinë a vlerë monetare ndërmjet dy personave që grinden e që e pretendojnë atë pasuri.

Mësues i drejtë është ai i cili e nxit apo e qorton çdo nxënës në masën që e meriton. Gjykatës i drejtë është ai i cili ia jep pasurinë për të cilën grinden atij që i takon. Gjithashtu, ajo që nënkupton Urtësia dhe Drejtësia Hyjnore nuk do të thotë krijimi i krijesave në formë të njëjtë, si për shembull të krijojë për

njeriun brirë, krahë etj., por sipas Urtësisë së Krijuesit është se Ai e ka krijuar botën në një formë të atillë që të jetë sa më e madhe mundësia e realizimit të së mirës dhe së përkryerës, si dhe të krijojë krijesat të cilat formojnë pjesët përbërëse të saj (botës) në një formë që t'i përshtatet atij qëllimi final.

Gjithashtu, kuptimi i Urtësisë dhe i Drejtësisë Hyjnore është që të ngarkojë me përgjegjësi çdo njeri sipas masës së gatishmërisë së tij dhe mundësisë e aftësisë së tij (për ta mbajtur atë përgjegjësi)[1], të vendosë e të gjykojë për të në bazë të aftësisë dhe përpjekjes së tij të përzgjedhur[2], si dhe ta shpërblejë apo ndëshkojë në përshtatje me veprat e tij.[3]

Argumenti mbi Drejtësinë Hyjnore

E përmendëm më sipër se sipas një interpretimi, Drejtësia Hyjnore konsiderohet si një nga vërtetësitë e Urtësisë Hyjnore dhe sipas një interpretimi tjetër Drejtësia është vetë Urtësia Hyjnore.

Është mëse e natyrshme që argumenti i cili vërteton Drejtësinë të jetë i njëjti argument që vërteton Urtësinë Hyjnore. Atë e theksuam në leksionin e njëmbëdhjetë dhe po e ripërsëritim më qartësisht këtu:

Në leksionet e kaluara mësuam se Allahu i Lartësuar posedon gradat më të larta të Fuqisë dhe Përzgjedhjes dhe se Ai është I Aftë që të kryejë apo të mos kryejë një vepër të mundshme (*mumkinu'l-vuxhud*) pa iu nënshtruar ndikimit të asnjë fuqie detyruese e mposhtëse. Porse Allahu i Madhëruar nuk bën çdo gjë që ka mundësi ta bëjë nga veprat, por bën atë që Ai Dëshiron ta bëjë.

Gjithashtu, mësuam se Vullneti i të Lartësuarit nuk është

1. **"Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka..."** (Sure "El-Bekare", ajeti 286).
2. **"...e do të gjykohen me të drejtë dhe nuk do t'u bëhet padrejtësi."** (Sure "Junus", ajeti 54).
3. **"Atë ditë askujt nuk do t'i bëhet ndonjë padrejtësi dhe ju do të shpërbleheni vetëm sipas asaj që keni bërë."** (Sure "Jasin", ajeti 54).

i kotë, i paqëllimshëm dhe i nxituar, madje i Madhëruari nuk dëshiron vetëm se atë që është në përshtatje dhe në përputhje me Cilësitë e Tij të Përsosura. Nëse një vepër nuk përshtatet me Cilësitë e Tij të Përsosura, atëherë ajo vepër nuk kryhet prej Tij në mënyrë absolute.

Meqenëse Allahu i Madhëruar është Përsosuria Absolute, atëherë edhe Vullneti i Tij në mënyrë autentike (*asaleten*) lidhet me anën e përsosurisë së krijesave dhe me më të mirët e tyre.

Nëse nga ekzistenca e ndonjë krijese mund të ndodhin disa të këqija e mangësi në botë, kjo anë e së keqes synohet me përkatësi/pasim (*bi't-tebe'*), që do të thotë se kjo e keqe është e pandarë nga e mira mbizotëruese.

Prandaj, Vullneti lidhet me këtë të keqe me përkatësi/pasim (*bi't-tebe'*) për shkak të lidhjes me të mirën mbizotëruese autentikisht (*asaleten*).

Pra, në përshtatje me Cilësitë e Përsosura Hyjnore, duhet që ta krijojë botën në atë formë që t'i ofrojë asaj përsosurinë mbizotëruese dhe të mirat e mundshme për t'u arritur. Prej këtu vërtetohet Cilësia e Urtësisë së Allahut të Madhëruar.

Mbi këtë bazë, Vullneti Hyjnor lidhet me krijimin e njeriut, sepse njeriu në vetvete është ekzistent i mundshëm (*mumkinu'l-vuxhud*) dhe se ekzistenca e tij është burim i mirësisë mbizotëruese dhe i të mirave të shumta. Nga veçoritë kryesore të njeriut është përzgjedhja dhe vullneti i tij i lirë.

Pa dyshim, posedimi i fuqisë së vullnetit dhe përzgjedhjes konsiderohet nga përsosuritë ekzistenciale, ku ai që e posedon atë konsiderohet më i përsosur se ai që nuk e posedon atë.

Por ajo që është e nevojshme në përzgjedhjen e njeriut është që ai të jetë i aftë për kryerjen e veprave të mira e të pëlqyeshme, të cilat e çojnë në përsosurinë përfundimtare e të pafundme.

Gjithashtu, është e nevojshme në përzgjedhjen e tij që ai të jetë i aftë të kryejë vepra të këqija e të refuzueshme, të cilat

e drejtojnë atë drejt rënies në fundin e humbjes dhe mjerimit të pafund.

Është e natyrshme se ajo gjë me të cilën lidhet Vullneti Hyjnor autentikisht është ecja e njeriut drejt përsosurisë. Por meqenëse ecja përzgjedhëse e njeriut drejt përsosurisë përfshin gjithashtu edhe mundësinë e rënies së tij dhe zvetënimin e tij, të cilat ndodhin si rezultat i nënshtrimit ndaj epsheve vetjake dhe tekave djallëzore, për këtë arsye Vullneti Hyjnor lidhet me këtë rënie përzgjedhëse me përkatësi/pasim (*bi't-tebe'*).

Meqë përzgjedhja e vetëdijshme e ndijimore ka nevojë për njohjen e saktë e të drejtë të rrugëve të së mirës e së keqes, për këtë arsye Allahu i Madhëruar e ka urdhëruar njeriun për të kryer çdo gjë të mirë e që është në interes të tij dhe e ka ndaluar nga çdo gjë që e çon në shthurje, devijim e zvetënim. Kështu i Madhëruari ofron lëvizjen e duhur drejt përsosjes.

Meqenëse obligimet hyjnore janë vendosur dhe legjitimuar me qëllim arritjen e njeriut në rezultatet e punës nëpërmjet këtyre obligimeve hyjnore, pa i shkaktuar Allahut të Madhëruar asnjë përfitim apo dobi për Qenien e Tij, atëherë Urtësia Hyjnore bëri që këto obligime të jenë në përshtatje dhe në përputhje me aftësitë/mundësitë e atyre që u janë ngarkuar ato. Kjo, sepse obligimi i cili nuk ka mundësi të kryhet është gjepur dhe i pavlerë.

Pra, etapa e parë e drejtësisë (në kuptimin e saj të veçantë) - drejtësia në fushën e përgjegjësive obligative, vërtetohet me këtë argument: Nëse Allahu i Madhëruar e obligon robin jashtë mundësive dhe fuqive të tij, ky obligim do të ishte i pazbatueshëm dhe do të ishte vepër pa dobi.

Ndërsa drejtësia në fushën e gjykimit dhe vendimmarrjes në mesin e njerëzve vërtetohet duke patur parasysh sa vijon: Gjykimi dhe vendimmarrja kryhen për të caktuar të drejtat e individëve qofshin ato shpërblime apo ndëshkime. Dhe nëse do të kryheshin në kundërshtim me drejtësinë, atëherë do të sillnin si pasojë mosarritjen e qëllimit.

Së fundmi, drejtësia në aspektin e zbatimit të shpagimit,

shpërblim qoftë apo ndëshkim, vërtetohet duke patur parasysh qëllimin përfundimtar të krijimit, sepse Ai që e krijoi njeriun me qëllimin e arritjes së rezultateve të veprave të tij, qofshin ato të mira apo të këqija, nëse e shpërblen apo e ndëshkon ndryshe nga ajo që meritojnë këto vepra, atëherë Ai nuk e arrin qëllimin e tij.

Pra, argumenti për drejtësinë në kuptimet e saj të vërteta dhe në të gjitha dukuritë është: Cilësitë Qenësore të Allahut nënkuptojnë që Veprat e të Madhëruarit të jenë të Urta dhe të Drejta. Allahu i Madhëruar nuk ka asnjë Cilësi e cila nënkupton padrejtësinë dhe kotësinë.

Keqkuptime dhe sqarime

1- Si përshtaten dallimet dhe ndryshimet e pranishme tek krijesat, veçanërisht te njeriu, me Drejtësinë dhe Urtësinë Hyjnore? Përse nuk i ka krijuar Allahu i Urtë e i Drejtë të gjitha krijesat në formë të barabartë?

Përgjigjja për këtë keqkuptim është: Ndryshimi i krijesave në të dhënat ekzistenciale është çështje e domosdoshme në sistemin e krijimit dhe u nënshtrohet rregullave të shkakësisë dhe pasojës që sundojnë sistemin e krijimit.

Supozimi i barazisë është një supozim naiv. Nëse do të meditonim mirë në këtë, do të dallonim se ky supozim nënkupton lënien pas dore të krijesave!!!

Sepse sikur të gjithë individët e shoqërisë njerëzore do të ishin të gjithë burra ose të gjithë gra, atëherë nuk do të realizohej asnjëherë lindshmëria dhe shtimi i njerëzisë, si dhe do të zhdukej raca njerëzore. Dhe nëse do të ishin të gjitha krijesat njerëz nuk do të kishte me se të ushqeheshin dhe me se të plotësonin kërkesat dhe nevojat e tyre.

Sikur të gjitha kafshët dhe bimët të ishin të njëllojta dhe të kishin veçori të njëjta, atëherë nuk do të ekzistonin gjithë këto dobi të panumërueshme dhe këto pamje tërheqëse e të bukura.

Shfaqja e këtyre apo atyre llojeve të dukurive, në këtë formë apo në një tjetër, të këtyre cilësive apo atyre, u nënshtrohen faktorëve dhe kushteve të pranishme në rrugën e lëvizjes së lëndës dhe shndërrimit të saj.

Askush nuk ka të drejta tek Krijuesi para se të krijohet. Pra, nuk mund ta detyrojë askush Allahun që ta krijojë në këtë formë apo tjetrën, në këtë vend apo tjetrin, në këtë kohë apo tjetrën, që të ketë vend për drejtësi apo padrejtësi.

2- Nëse Urtësia Hyjnore vendos që një njeri të jetojë në këtë botë, atëherë përse e vdes dhe ia merr jetën atij?

Përgjigjja ndaj këtij keqkuptimi

Së pari: Jeta e krijesave dhe vdekja e tyre i nënshtrohet, gjithashtu, ligjeve të krijimit dhe marrëdhënieve shkak-pasojë, të cilat janë të domosdoshme për sistemin e krijimit.

Së dyti: Nëse nuk do të vdisnin krijesat e gjalla, atëherë nuk do të mundësohej terreni për ekzistencën e krijesave pasardhëse dhe do t'u mohohej brezave pasardhës mirësia e ekzistencës dhe e jetës.

Së treti: Nëse do të supozonim vazhdimësinë e jetës së të gjithë njerëzve, atëherë nuk do të kalonte shumë kohë dhe do ta shihnim Tokën të mbushur përplot me njerëz. Toka do t'u ngushtohej në mikëpritjen e saj aq sa secili prej tyre do ta dëshironte vdekjen për shkak të lodhjeve, dhimbjeve dhe urisë që do të ndiente.

Së katërti: Qëllimi kryesor nga krijimi i njeriut është arritja e lumturisë së përjetshme. Në qoftë se nuk do të kalonin njerëzit nga kjo botë në Botën Tjetër nëpërmjet vdekjes, atëherë do të ishte i pamundur realizimi i këtij qëllimi përfundimtar.

3- Ekzistenca e gjithë këtyre fatkeqësive, sëmundjeve dhe katastrofave natyrore (si përmbytjet dhe tërmetet) dhe vështirësive shoqërore (si luftrat dhe llojet e ndryshme të padrejtësive), si përshtaten të gjitha këto me Drejtësinë Hyjnore?

Përgjigje

Së pari: Ngjarjet e dhimbshme natyrore janë të pandashme nga ndikimet e faktorëve materialë, ndërveprimet dhe përplasjet e tyre me njëra-tjetrën. Meqënëse mirësitë e këtyre faktorëve janë më të shumta se të këqijat e tyre, për këtë arsye ato nuk bien në kundërshtim me Urtësinë.

Gjithashtu, shfaqja e mundimeve dhe shthurjeve shoqërore vijnë nga përzgjedhja e veprave nga njeriu. Këtë përzgjedhje e përfshin Urtësia Hyjnore. Por vihet re se dobitë e jetës shoqërore dhe pozitivitetet e saj janë më të shumta se negativitetet e saj, sepse nëse do të ishin negativitetet më të shumta, atëherë nuk do të kishte mbetur asnjë njeri mbi faqen e Tokës.

Së dyti: Ekzistenca e këtyre mundimeve, katastrofave dhe fatkeqësive e shtyn njeriun, nga njëra anë, të hulumtojë rreth njohjes së të fshehtave të natyrës e t'i zbulojë ato. Kjo bën që të lindin kulturat, zbulimet dhe industritë e ndryshme. Nga ana tjetër, zhytja në këto mundime dhe përballimi e trajtimi i tyre, gjithashtu, luan një rol të madh në zhvillimin e fuqive, përgatitjeve, pjekurisë dhe shpërthimit të tyre, si dhe në përsosjen e njeriut dhe zhvillimin e përparimin e tij.

Së fundmi, përballimi i çdo fatkeqësie a dhimbjeje dhe durimi i saj - nëse përballja me to justifikohet me justifikime të vërteta dhe të ligjshme – do të ketë shpërblim të madh në botën e pafundme dhe nuk ka për të shkuar kot, madje do të shpërblehet në formën më të mirë.

4- Si përshtatet me Drejtësinë Hyjnore ndëshkimi i përjetshëm për gjynahet e kufizuara dhe të përkohshme, të cilat i kryejnë mëkatarët në këtë botë?

Përgjigje

Ka një marrëdhënie shkakësie ndërmjet punëve të mira dhe punëve të këqija, si dhe ndërmjet shpërblimit dhe ndëshkimit në Botën Tjetër (*Ahiret*).

Këtë e ka zbuluar Revelata Hyjnore duke i paralajmëruar njerëzit rreth saj. Ashtu siç ne vëmë re në këtë botë (*Dunja*) se disa krime lënë gjurmë të këqija të cilat vazhdojnë për një kohë të gjatë, pavarësisht kohës së shkurtër të kryerjes së krimit [p.sh. nëse njeriu nxjerr syrin e tij apo sytë e dikujt tjetër duke i verbuar ato, ky veprim kryhet në një kohë shumë të shkurtër, por pasoja e tij (verbëria) vazhdon për një kohë shumë të gjatë - deri në fund të jetës], po ashtu edhe gjynahet e mëdha lënë gjurmët e tyre të përjetshme.

Nëse njeriu nuk ofron në këtë botë shlyerjen e nevojshme (p.sh. pendimin), atëherë ai do të jetojë ndikimet e gabuara deri në përjetësi.

Ashtu siç qëndrimi i njeriut i verbër deri në fundin e jetës së tij si rezultat i një gabimi që zgjat vetëm një çast nuk bie në kundërshtim me Drejtësinë Hyjnore, ashtu edhe sprova me ndëshkimin e përjetshëm që është rezultat i veprimit të gabimeve të mëdha nuk bie në kundërshtim me Drejtësinë Hyjnore.

Kjo sepse ajo është rezultat i gjynaheve të cilat i ka kryer mëkatari me vetëdije dhe këmbëngulje.

Pyetje

1. Cilat janë rrënjët e dallimeve në temën e Drejtësisë Hyjnore?
2. Sqaro konceptin e Drejtësisë.
3. A është e barabartë Drejtësia Hyjnore për të gjitha krijesat?
4. Sqaro domosdoshmërinë e Urtësisë dhe Drejtësisë Hyjnore.
5. Cili është argumenti mbi Drejtësinë Hyjnore?
6. Cili është qëllimi i krijimit të njeriut?
7. Si përshtaten dallimet e krijimit ndërmjet krijesave me Urtësinë dhe Drejtësinë Hyjnore?
8. Pse i vdes Zoti i Urtë krijesat e Tij?
9. Si përshtaten fatkeqësitë natyrore dhe shoqërore me Drejtësinë Hyjnore?
10. Si e meritojnë gjynahet e përkohshme e të kufizuara ndëshkimin jo të përkohshëm dhe të pakufizuar?

PJESA E DYTË

Leksioni i njëzetenjëtë

VËSHTRIM RRETH ÇËSHTJEVE TË PROFETËSISË

Hyrje

Në pjesën e parë të këtij libri përmendëm se çështjet bazë të cilat duhet t'i njohë dhe t'i trajtojë njeriu i logjikshëm, me qëllim që me anë të tyre të arrijë në jetën njerëzore që e pëlqen logjika, janë:

1. Kush e krijoi botën dhe njeriun? Kush e drejton dhe menaxhon botën dhe njeriun?

2. Si do të jetë fundi i botës dhe kush është qëllimi përfundimtar i njeriut?

3. Duke vërejtur nevojën e duhur të çdo njeriu për të njohur rrugën e drejtë në jetë, ku nëpërmjet sjelljes së tij të arrijë në lumturinë e vërtetë dhe përsosurinë e kërkuar, cili është mjeti garant për të arritur këtë njohje? Cili është ai që e mbart atë?

Përgjigjja e drejtë për këto pyetje përshkruan këto baza: Monoteizmin, Ringjalljen dhe Profetësinë. Këto konsiderohen si bazat kryesore të çdo feje qiellore.

Në pjesën e parë të këtij libri trajtuam dhe studiuam çështjet e monoteizmit ku arritëm në përfundimin se ekzistenca e të gjitha krijesave e ka burimin tek një Krijues i Vetëm dhe të gjitha menaxhohen dhe drejtohen prej Tij. Askush nuk mund të jetë i panevojshëm për Atë në çdo gjë, në çdo vepër dhe në çdo vend dhe kohë.

Këto çështje i kemi vërtetuar me argumente logjikë.[1] E bëmë

1. Kemi përmendur disa ajete kur'anore gjatë këtyre studimeve. Këtë e kemi bërë jo për të argumentuar por për të përmendur temat ku janë

të qartë, gjithashtu, se këto çështje nuk mund të vërtetohen ndryshe vetëm se nëpërmjet logjikës, sepse argumentimi adhurimor dhe Fjala e Allahut janë të vërteta, nëse më parë vërtetohen me argumente logjike ekzistenca e Allahut dhe Fjala e Tij, pastaj marrja në konsideratë e Fjalës së Tij. Gjithashtu, mbështetja tek thënia profetike apo tek ajo e një imami bëhet pas vërtetimit të profetësisë së atij profeti apo imametit të atij imami, e më pas të merret për argument fjala e tyre. Pra, është i domosdoshëm vërtetimi i profetësisë me argument logjik.

Po, pasi është vërtetuar se Kur'ani Famëlartë thotë të drejtën dhe të vërtetën, atëherë ne mundemi që të nxjerrim argumente për këto çështje nga ky burim hyjnor. Gjithashtu, është e nevojshme të vërtetojmë edhe Ringjalljen nëpërmjet rrugës së Revelatës, edhe pse vetë parimi i Ringjalljes mund të vërtetohet me argument logjik dhe argument të përcjellë.

Pra, për t'u njohur më në brendësi me këto dy çështje (Profetësinë dhe Ringjalljen) dhe për t'i bërë më të qarta, fillimisht ne duhet që të vërtetojmë Profetësinë dhe Ringjalljen me argumente logjike. Pasi të kemi vërtetuar Profetin e Islamit dhe se Kur'ani famëlartë është i vërtetë, ne mund të njihemi me detajet e çështjeve të Profetësisë dhe Ringjalljes me anë të Kur'anit dhe Synetit dhe t'i qartësojmë ato.

Meqënëse veçimi ndërmjet këtyre dy çështjeve ka shumë ndikim në studim, ne do të ndjekim metodën e traditës duke nisur fillimisht me studimin e çështjeve të Profetësisë e më pas do ta pasojmë me çështjet e Ringjalljes. Nëse në disa raste dhe hulumtime do të kemi nevojë për ide, kjo ide duhet studiuar dhe vërtetuar pastaj ne do ta përdorim në argumentimin tonë (si parim tematik) dhe hulumtimin dhe vërtetimin e saj ia lëmë tematikës së saj.

përcjellë dhe çështjet që janë prekur në Kur'anin Famëlartë.

Qëllimi në studimin e kësaj pjese

Qëllimi i parë nga studimi i kësaj pjese të këtij libri është: Vërtetimi i idesë së ekzistencës së një rruge tjetër, përveç të prekshmes, "logjikës", ku nëpërmjet saj arrihet njohja e të vërtetave të ekzistencës dhe e rrugës së vërtetë për jetën. Kjo rrugë nuk ka gabime dhe as dyshime dhe quhet (*vahj* – revelatë). Ajo është një lloj mësimi hyjnor me të cilën veçohen disa nga robtë e zgjedhur të Allahut dhe se e vërteta dhe thelbi i saj janë të panjohura për njerëzit në përgjithësi. Kjo për faktin se ata nuk shohin ndonjë shembull në vetet e tyre, por munden ta arrijnë ekzistencën e Revelatës nëpërmjet ndikimeve dhe shenjave të saj. Ky është shkaku që ata u besojnë thirrjeve të profetëve (*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) dhe Revelatave Hyjnore. Është normale se në qoftë se vërtetohet zbritja e Revelatës dikujt dhe ai ua informon njerëzve mesazhin e tij, atëherë obligohen të gjithë që ta pranojnë atë dhe të punojnë sipas këtij mesazhi. Askush nuk është i justifikuar në kundërshtimin e tij, përveçse kur është një mesazh që i përket një personi të caktuar, apo grupi të caktuar apo kohe të caktuar.

Pra, çështjet bazë të kësaj pjese janë: domosdoshmëria e dërgimit të Profetëve, si dhe rëndësia ruajtjes së Revelatës nga çdo lojë, shtrembërim apo devijim, me qëllim apo nga harresa derisa të mbërrijnë të dhënat e saj tek njerëzit. Thënë ndryshe: Obligueshmëria e pagabueshmërisë së profetëve në marrjen e mesazhit hyjnor dhe përcjelljen e tij. Gjithashtu, ekzistenca e rrugës që vërteton tek njerëzit profetësinë e profetëve

Pasi paraqitëm çështjet bazë të Revelatës dhe Profetësisë me argumente logjike, arritëm në një fazë tjetër studimi rreth çështjeve të tjera siç janë numri i shumtë i profetëve, librat dhe legjislacionet qiellore, përcaktimi i profetit të fundit dhe i librit të fundit qiellor, si dhe përcaktimi i zëvendësve dhe këshilltarëve të tij.

Por, nuk është i lehtë përforcimi i gjithë këtyre çështjeve

me argumente logjike, ndaj është i domosdoshëme të bazuarit në shumë fusha të saj në argumente të shkruara dhe adhurimorë.

Metoda e studimit në teologji

Më parë u qartësuan dallimet kryesore ndërmjet filozofisë dhe teologjisë. Filozofia studion çështjet, vërtetimi i të cilave bëhet me argumente logjikë, ndërsa teologjia përmbledh ato çështje, vërtetimi i të cilave bëhet vetëm me argumente të shkruar dhe adhurimorë.

Thënë ndryshe, raporti ndërmjet çështjeve filozofike dhe çështjeve teologjike është përgjithësi dhe veçanti nga njëra anë, që do të thotë: megjithëse filozofia dhe teologjia përfshijnë çështje të përbashkëta mes tyre, të cilat vërtetohen me argumente logjikë, çdonjëra prej tyre ka çështje të veçanta. Porse, çështjet filozofike parashtrohen me metodë logjike, në ndryshim nga çështjet e veçanta të teologjisë, të cilat vërtetohen me metodologjinë e shkrimit ose adhurimit. Shprehur ndryshe: Metodologjia e studimit në teologji është e kombinuar dhe e dyzuar.

Mund gjithashtu të përfitohet në këtë dije nga metoda logjike dhe nga metoda adhurimore.

Konkluzioni: Gjenden dy dallime bazë mes filozofisë dhe teologjisë:

I pari: Për çdonjërën prej tyre, në shtesë duke të çështjeve të përbashkëta, si p.sh. çështja e monoteizmit, kanë edhe çështje që janë të veçanta dhe nuk studiohen në asnjë shkencë tjetër.

I dyti: Metodologjia e studimit në të gjitha çështjet filozofike është logjike. Ndryshe nga teologjia, e cila në disa çështje të saj si p.sh.: (në çështjet e përbashkëta ndërmjet filozofisë dhe teologjisë) shfrytëzon metodën logjike, ndërsa në çështje të tjera p.sh.: (çështjet e imamatit) shfytëzon metodologjinë e shkrimit dhe transmetimit, e në disa raste të tjera i shfrytëzon të dyja metodat si p.sh. (në vërtetimin e parimit të Ringjalljes).

Ajo që duhet vërtetuar dhe përforcuar se çështjet e veçanta të teologjisë, të cilat vërtetohen nëpërmjet metodës së shkruar dhe asaj adhurimore, nuk janë të gjitha të të njëjtës kategori. Disa prej tyre vërtetohen drejtpërsëdrejti me ajete kur'anore (pasi vërtetohet se Kur'ani Famëlartë është i drejtë dhe me të drejtën sipas argumentit logjik); për shembull argumenti i fjalës të Profetit *(paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe veprave të tij (suneti), e pas kësaj vërtetohen çështjet e tjera duke u mbështetur në fjalën e Profetit; për shembull caktimi i pasuesit të Profetit *(paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe duke u mbështetur në fjalën e Imamëve të pagabueshëm *(paqja qoftë mbi ta!)*. Së fundmi, paraqitja e çështjeve të tjera duke u mbështetur në fjalën e Imamëve të pastër (*paqja qoftë mbi të gjithë ata!*).

Është e natyrshme se rezultati që arrijmë nëpërmjet argumenteve të shkruara (të përcjella) është i vërtetë dhe bindës kur senedi i tyre është i padiskutueshëm dhe argumentet e tyre janë të qarta.

Pyetje

1. Përse i sqaruam çështjet e monoteizmit vetëm me metodën logjike?

2. Kush janë çështjet bazë të Profetësisë?

3. A mund të vërtetohen çështjet bazë të Profetësisë dhe Ringjalljes me argumente të shkruara? A ka ndonjë ndryshim ndërmjet këtyre dy grupeve?

4. Cilat çështje të teologjisë mund të vërtetohen me argumente të shkruara?

5. Cili është shkaku i trajtimit të kapitullit të Profetësisë para kapitullit të Ringjalljes? A ka ndonjë renditje logjike tjetër që i rregullon çështjet e këtyre kapitujve?

6. Cilat janë dallimet ndërmjet filozofisë dhe teologjisë?

7. Në sa grupe mund të ndahet shkenca e teologjisë bazuar në vërtetimin e saj? Përmendi ato sipas renditjes.

Leksioni i njëzetedytë

NEVOJA E NJERIUT PË REVELATËN DHE PROFETËSINË

Domosdoshmëria e dërgimit të Profetëve

Kjo çështje, e cila është prej çështjeve bazë dhe të rëndësishme të kapitullit të Profetësisë, mund të vërtetohet me një argument i cili përbëhet nga tre premisa:

1. Qëllimi i krijimit të njeriut është: Ecja në rrugën e përsosurisë së tij nëpërmjet praktikimit të veprave përzgjedhëse për të arritur në përsosjen përfundimtare. Në këtë përsosuri arrihet vetëm nëpërmjet përzgjedhjes dhe zgjedhjes së tij.
Thënë ndryshe: Njeriu është krijuar që, me adhurimin dhe nënshtrimin e tij ndaj Allahut të Madhëruar, të meritojë mëshirën e cila është e veçantë për njerëzit e përsosur. Vullneti i urtë hyjnor është e lidhur që në zanafillë me përsosurinë e njeriut dhe lumturinë e tij. Por, përderisa kjo përsosuri dhe lumturi sublime nuk mund të arrihet në to vetëm se nëpërmjet rrugës së praktikimit të veprave përzgjedhëse, për këtë ka vendosur që jeta njerëzore të jetë në dy rrugë dhe dy drejtime për të ofruar klimën e përzgjedhjes. Natyrisht, njëra nga rrugët çon drejt vështirësive dhe ndëshkimit që dëshira dhe vullneti hyjnor të jetë i lidhur me pasim dhe jo në zanafillë. Kjo premisë u sqarua gjatë studimit të Urtësisë dhe Drejtësisë Hyjnore.[1]

2. Përzgjedhja logjike dhe ndjenjësore - në shtesë të nevojës për fuqi në praktikimin e veprave, të ofrimit të kushteve dhe klimës së jashtme për praktikimin e veprave të ndryshme, si dhe ekzistencës së shtysësit dhe motivuesit të

1. Kthehu tek mësimi i njëmbëdhjetë dhe i njëzetë në pjesën e parë të këtij libri.

brendshëm të saj - ka nevojë gjithashtu për njohjen e vërtetë të veprave të mira dhe veprave të këqija, të rrugëve të drejta dhe të gabuara. Njeriu ka mundësi të përzgjedhë rrugën e përsosurisë së tij, me plot liri e vetëdije, kur e njeh qëllimin dhe rrugën që të çon drejt saj dhe është i njohur me të gjitha pengesat, devijimet dhe rrëshqitjet.

Pra, urtësia hyjnore ofron për njeriun mjetet dhe domosdoshmëritë për të arritur këto njohuri dhe perceptime. Ndryshe, gjendja këtij njeriu do të jetë si ai personi që fton mikun në shtëpi dhe nuk ia tregon as vendin dhe as rrugën që të çon në të! Është më se e natyrshme se kjo lloj vepre bie në kundërshtim me urtësinë dhe me qëllimin. Kjo premisë është e qartë dhe nuk ka nevojë për sqarime dhe zgjerime të tjera.

3. Dijet dhe njohuritë njerëzore të zakonshme dhe të njohura, të cilat merren si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet të prekshmes dhe logjikës, edhe nëse luajnë rol ndikues në sigurimin e asaj që ka nevojë në jetën e tij, por ato nuk mjaftojnë në njohjen e rrugës së përsosjes dhe lumturisë së vërtetë në të gjitha fushat personale, shoqërore, materiale, shpirtërore të dynjallëkut dhe të ahiretit. Nëse nuk ka rrugë tjetër për mbylljen e të metave dhe boshllëqeve, kurrë nuk realizohet qëllimi hyjnor në krijimin e njeriut.

Duke vërejtur të treja premisat arrijmë në përfundimin se: Urtësia hyjnore ka parashtruar një tjetër rrugë për njerëzimin – përveç asaj të prekshme dhe logjike – për të njohur rrugën e përsosurisë në të gjitha fushat që të ketë mundësi njeriu të përfitojë prej saj (drejtpërdrejt ose nëpërmjet njërit apo tjetrit).

Kjo rrugë është Revelata[2] që e ka vendosur Allahu për profetët, për të përfituar ata në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe për të përfituar të tjerët nëpërmjet të dërguarve për të njohur prej saj atë që duan për të arritur lumturinë dhe përsosurinë përfundimtare.

Ndërmjet këtyre premisave, tek ajo e fundit, ndoshta

2. Ky argument është nga temat përbërëse të çështjeve vepruese (që duhen bërë) dhe çështjeve teorike (ekzistuese).

mund të ketë mëdyshje apo dyshim. Ky është edhe shkaku që na detyron ta sqarojmë dhe të zgjerohemi më tepër rreth saj që të na qartësohet plotësisht mangësia e njohjes njerëzore në përcaktimin e rrugës së përsosjes së plotë të njeriut dhe nevojën e tij për Revelatën.

Mangësitë e njohjes njerëzore

Për të njohur rrugën e vërtetë të jetës në të gjitha aspektet e saj, është e nevojshme njohja me parimin e ekzistencës së njeriut dhe përfundimin e tij, me marrëdhëniet e tij me të gjithë ekzistencat, me lidhjet të cilat mund të ngrihen dhe realizohen me njerëzit e tjerë dhe të gjitha krijesave në tërësi dhe me ndikimin e këtyre lidhjeve dhe marrëdhënieve të ndryshme në lumturinë dhe fatkeqësinë e tij. Gjithashtu, ai duhet të përcaktojë raportet e dobive dhe dëmeve, shkallët e përfitimeve dhe mospërfitimeve si dhe balancën ndërmjet tyre, për të përcaktuar detyrat e këtij numri të madh njerëzish të cilët dallohen me veçori trupore dhe shpirtërore të ndryshme. Çdonjëri prej tyre jeton në kushte natyrore dhe sociale të ndryshme. Por njohja e gjitha këtyre gjërave nuk është e lehtë për një individ apo shoqëri të caktuar por për mijëra grupe të specializuar në dijet e ndryshme që lidhen me njeriun. Ata nuk munden të zbulojnë të tilla etalone dhe parime të ndërlikuara dhe t'i qartësojnë ato në formën e rregullave dhe ligjeve të përsosura, të sistemuara dhe të përcaktuara që të kenë mundësi të ruajnë dhe ofrojnë çdo dobi personale, shoqërore, materiale dhe shpirtërore, të dynjasë apo ahiretit për të gjithë njerëzit. Kur ndodh çrregullimi dhe përplasja ndërmjet llojeve të dobive dhe dëmeve, gjë e cila ndodh në shumë raste, atëherë përcaktohet me imtësi interesi më i rëndësishëm dhe vihet në krye të fushës së veprimit.

Ajo që vihet re prej ndryshimeve të të drejtave dhe ligjeve gjatë historisë njerëzore, tregon se deri më sot, me gjithë studimet dhe energjitë e shumta të harxhuara nga

dijetarët e specializuar përgjatë mijëra viteve, nuk është gjendur një sistem drejtësie ligjesh dhe rregullash i vërtetë i plotë dhe gjithëpërfshirës. Gjithashtu, vihet re se ligjvënësit dhe organizatat e të drejtave në botë, gjithmonë kanë arritur të gjejnë pikat e dobëta në ligjet e përpiluara e të vendosura nga njeriu. Kështu që gjithmonë janë përpjekur për rregullimin apo përsosjen e tyre, duke anulluar një nen apo duke e ndryshuar atë, ose duke shtuar një nen apo duke bërë shënime në to.

Ne nuk duhet të harrojmë se në vendosjen e këtyre rregullave dhe ligjeve, ata kanë përfituar shumë nga sistemet e drejtësisë dhe ligjeve hyjnore dhe legjislacioneve qiellore. Gjithashtu, duhet të dimë se përpjekjet e juristëve dhe ligjvënësve janë drejtuar për sigurimin e dobive sociale të kësaj bote pa i kushtuar vëmendje dobive të ahiretit dhe marrëdhënies së tij me dobitë e dynjasë dhe materiales. Në qoftë se nuk kujdesen për këtë aspekt, i cili konsiderohet si një nga aspektet më të rëndësishme në këtë fushë, atëherë ata nuk do të kenë mundësi që të arrijnë në përfundime të sakta dhe të prera. Kjo për shkak se dobitë materiale të dynjasë, deri në njëfarë shkalle, mund të njihen dhe të përkufizohen nëpërmjet eksperimenteve praktikë. Ndërsa, përsa i përket dobive shpirtërore dhe të ahiretit, ato nuk pranojnë prova të prekshme, si dhe nuk mund përcaktohen me hollësi. Në çastin kur ato përplasen me dobitë materiale të kësaj bote, atëherë nuk mund të njihet kriteri për matjen e rëndësisë së njërit ndaj tjetrit.

Nëpërmjet këtij vëzhgimi dhe gjendjes në të cilën ndodhen ligjet njerëzore, ne mund të përcaktojmë dijen njerëzore përgjatë qindra e nijëra vitesh për të arritur në këtë konkluzion të saktë: Njeriu i parë ka qënë më i paaftë se njeriu i sotëm në përcaktimin e rrugës së drejtë për jetën e tij. Edhe pse njeriu sotëm ka arritur në një sistem ligjor të saktë, të plotë dhe gjithëpërfshirës nëpërmjet provës së mijëra viteve, apo edhe pse mund të thuhet se ky sistem mundet që të ofrojë lumturinë e përhershme dhe të përjetshme, qëndron pyetja:

Si mund të përputhet neglizhenca e brezave të shumtë, të cilët jetuan përgjatë historisë të gjatë në errësirën e injorancës, me Urtësinë Hyjnore dhe me qëllimin e krijimit të tyre?

Përgjigjja është:

Sigurisht, qëllimi i krijimit të njeriut nga fillimi deri në fund pranon realizim në terren real. Nëse do të gjendej rrugë tjetër, përveç asaj të prekshme dhe logjike, për njohjen e të vërtetave të jetës dhe të detyrave individuale e shoqërore, ajo rrugë është Revelata.

Nga ajo që përmendëm më sipër na u qartësua gjithashtu, se sipas këtij argumenti, njeriu i parë ka qënë Profet, i cili e ka njohur rrugën e drejtë të jetës nëpërmjet rrugës së Revelatës, për të realizuar qëllimin e krijimit dhe për të udhëzuar të tjerët.

Dobitë e dërgimit të profetëve

Profetët e Allahut, në shtesë të mësimit të njerëzve dhe udhëzimit të tyre në rrugën e drejtë për përsosjen e vërtetë të njeriut, të marrjes së Revelatës dhe përjlljes së saj tek njerëzit, kanë dobi dhe ndikime të tjera të rëndësishme në fushën e përsosjes njerëzore. Ndër ato më të rëndësishmet janë si vijon:

1. Gjenden shumë të dhëna të cilat mendja njerëzore mundet që t'i perceptojë, por ndoshta është i pavëmendshëm ndaj tyre, ose për shkaku nga nevoja e tyre për një kohë të gjatë dhe provimi i tyre, ose si rezultat i interesimit të personave dhe dhënies së tyre pas çështjeve materiale apo mbizotërimit të dëshirave kafshërore mbi ta, ose ndoshta nuk nuk gjenden tek njerëzit si rezultat i edukatë së devijuar, ose si rezultat i informacioneve të gabuara. Të gjitha këto të dhëna Profetët ua sqarojnë dhe ua qartësojnë njerëzve duke ua kujtuar gjithmonë me qëllim që t'u përballen mësimeve të këqija e të gabuara me mësime të sakta, të vërteta dhe logjike.

Nga këtu njihet shkaku i të cilësuarit të profetëve me dy

cilësitë (këshillues dhe paralajmërues), si dhe të cilësuarit e Kur'anit Famëlartë me emrat (përmendje, këshillë, këshillues). Imami, udhëheqësi i myslimanëve (*paqja qoftë mbi të!*) kur paraqet dobitë dhe mirësitë e dërgimit të Profetëve thotë: *"T'u kujtojnë atyre besën e natyrës (fitre) së Tij; t'u kujtojnë atyre ata që harruan prej mirësive të tij; të diskutojnë me ata me predikim."*

2. Nga faktorët më të rëndësishëm dhe që ka ndikim veprues real në edukimin, udhëzimin dhe përsosjen njerëzore, është ekzistenca e shembullit në vepra. Rëndësia e kësaj është vërtetuar edhe në psikologji. Profetët, të cilët përfaqësojnë njeriun e përsosur, të edukuan nën hijen Hyjnore e kryejnë më së miri këtë mision. Ata, në shtesë të mësimeve dhe informacineve me të cilat kanë furnizuar njerëzimin, kryejnë edhe misionin e edukimit të njerëzve. Ne e dimë se Kur'ani Famëlartë e shoqëron dijen me pastrimin. Në disa ajete, pastrimin e përmend para mësimit.

3. Nga të mirat dhe dobitë e ekzistencës së profetëve në mesin e njerëzve është: Udhëheqja në fushat shoqërore, politike dhe gjyqësore kur ofrohen kushtet e përshtashme për këtë. Është mëse e natyrshme se udhëheqësi i pagabueshëm është një nga mirësitë hyjnore më të mëdha për shoqërinë. Nëpërmjet tij zgjidhen shumë probleme dhe mosmarrëveshje shoqërore dhe u realizohet shpëtimi i ummetit nga mosmarrëveshjet, divergjencat, trazirat dhe devijimet duke e udhëhequr atë drejt përsosurisë së synuar.

Pyetje:

1. Cili është qëllimi në krijimin e njeriut?

2. A është i lidhur Vullneti i urtë hyjnor me palumturinë e njeriut dhe ndëshkimin e tij ashtu si është e lidhur me lumturimin dhe mëshirimin e tij? Apo ka ndryshim ndërmjet tyre?

3. Cilat janë çështjet për të cilat ka nevojë njeriu për të praktikuar përzgjedhjen e tij të vetëdijshme ndijimore?

4. Përse nuk mjafton mendja njerëzore në përftimin e të gjitha njohurive të duhura?

5. Trego argumentin rreth domosdoshmërisë së dërgimit të profetëve.

6. Nëse njeriu mund të njihet me rrugën e lumturisë së kësaj bote dhe të Botës Tjetër nëpërmjet përfitimit nga përvoja e tij e gjatë, a ka nevojë për Revelatën pas kësaj? Dhe pse?

7. A mund të ngrihet argument logjik rreth profetësisë së njeriut të parë? Si?

8. Qartëso dobitë e tjera nga ekzistenca e profetëve.

Leksioni i njëzetetretë

KEQKUPTIME DHE SQARIME

Nga argumenti që përmendëm më sipër mbi domosdoshmërinë e dërgimit të Profetëve (*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*), shfaqen disa pyetje dhe keqkuptime që do t'i paraqesim dhe do t'u përgjigjemi si më poshtë:

Keqkuptimi i parë:

Nëse Urtësia hyjnore obligon dërgimin e profetëve për udhëzim e gjithë njerëzimin, atëherë përse u dërguan të gjithë profetët në një zonë të caktuar gjeografike (Lindja e Mesme), ndërsa zonat e tjera të tokës mbetën larg kësaj mirësie? Veçanërisht, nëse kihet parasysh kufizimi i mjeteve të trasportimit, lidhja dhe shkëmbimi i të dhënave në kohët e lashta, në të cilën lajmet dhe informacionet përhapeshin me vështirësi nga një zonë në një tjetër. Ndoshta mund të ketë patur edhe popuj të cilëve u janë mohuar plotësisht mesazhet e profetëve duke mos u njohur me thirrjen e tyre asnjëherë. Përgjigja për këtë keqkuptim është si më poshtë:

Së pari: Ardhja e profetëve (*paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) nuk është veçuar vetëm në një zonë të caktuar.

Ajetet e nderuara kur'anore tregojnë se çdo populli i është dërguar profet. Ashtu si është përmendur në ajetin 24 të sures Fatir: **"...nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."**; dhe në ajetin 36 të sures Nahl: **"Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (**që u thoshte**): 'Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!"**

Në Kur'anin Famëlartë janë përmendur emrat e disa profetëve të mëdhenj (*paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) dhe nuk përmenden emrat e profetëve të tjerë. Por kjo nuk do të thotë se numëri i profetëve është i kufizuar vetëm me ata që janë

përmendur. Vetë Kur'ani Famëlartë vërteton ekzistencën e shumë profetëve, emrat e të cilëve nuk janë përmendur në këtë Libër të Shenjtë, siç thuhet në ajetin 164 në suren Nisa: **"...dhe për disa të tjerë nuk të kemi treguar ty."**

Së dyti: Argumenti i përmendur për domosdoshmërinë e Revelatës obligon ekzistencën e një tjetër rruge – përveç asaj të prekshme dhe logjike – nga e cila mund të përfitohet për udhëzimin e njerëzve. Ndërsa arritja e udhëzimit të njerëzve realisht është e kushtëzuar nga dy kushte:

I pari: Përzgjedhja e tyre e përfitimit dhe furnizimit nga kjo mirësi hyjnore.

I dyti: Mospengimi i njerëzve nga të tjerët në rrugën e udhëzimit të tyre.

Vihet re se privimi i shumë njerëzve nga udhëzimi i profetëve buron nga përzgjedhja e tyre e gabuar apo si rezultat i pengesave që kanë vënë të tjerët në rrugën e mesazhit të profetëve dhe përhapjes të këtij mesazhi. Ne e dimë shumë mirë se profetët janë përpjekur maksimalisht për largimin dhe heqjen e këtyre pengesave si dhe në luftën kundër armiqve të Allahut, veçanërisht arrogantëve, tiranëve dhe zullumqarëve.

Shumë prej tyre ranë edhe dëshmorë në rrugën e përhapjes së mesazhit të tyre Hyjnor dhe në udhëzimin e njerëzve. Në kohën që kishin përkrahës dhe pasues, i sulmonin ushtarakisht zullumqarët dhe armiqtë dhe ata që ishin pengesat më të mëdha të rrugës së përhapjes së fesë hyjnore.

Ajo që duhet theksuar dhe vërtetuar më tepër është se kjo veçori (e cila është përzgjedhja e rrugës drejt përsosjes njerëzore) detyron që të plotësohen të gjitha këto çështje dhe qëndrime në formën që mbetet në atmosferën e cila siguron përzgjedhjen e të mirën ose të keqes, pra njërën prej dy drejtimeve: (e drejta apo e gabuara). Përveçse kur sundojnë zullumqarët dhe arrogantët duke udhëhequr drejt një faze e cila mbyll plotësisht rrugën e udhëzimit, fik dritën e të vërtetës dhe udhëzimin në popull. Allahu i Madhëruar do t'i ndihmojë përkrahësit e të drejtës, duke u dhënë atyre

përkrahje nëpërmjet rrugëve të gajbit (të padukshmes) dhe rrugëve jo të zakonshme.

Përfundimi: Nëse nuk do të ekzistonin këto lloj pengesash në rrugën e profetëve, atëherë thirrja e tyre do të kishte mbërritur tek të gjithë njerëzit në botë dhe do të furnizoheshin me mirësitë e udhëzimit hyjnor nëpërmjet rrugës të Revelatës dhe profetësisë.

Pra, privimi i shumë njerëzve nga udhëzimi i profetëve është dhe përgjegjësi e atyre që penguan përhapjen e mesazhit dhe qëndruan gurë pengues në rrugën e thirrjes të tyre.

Keqkuptimi i dytë

Nëse dërgimi i Profetëve ka patur si qëllim plotësimin e kushteve të cilat duhet të ofrohen për përsosurinë e njerëzve, atëherë përse gjenden gjithë këto shthurje dhe shkatërrime në botë, megjithë ekzistencën e tyre?

Përse shumica e njerëzve në më të shumtën e kohës jetojnë në mosbesim dhe mosbindje ndaj Zotit ku deri edhe pasuesit e feve qiellore e kundërshtojnë dhe e luftojnë njëri-tjetrin, të cilët ndezën shumë luftra të përgjakshme dhe shkatërruese? A nuk obligon Urtësia hyjnore ofrimin kushteve të tjera që të ndalojnë shfaqjen e këtyre shthurjeve ku më e pakta të jetë që pasuesit e profetëve të ndalojnë luftimin e njëri-tjetrit?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje sqarohet dukshëm nëpërmjet mëtimit në ato veçanti që përmendëm më sipër - e cila është përzgjedhja e rrugës drejt përsosjes njerëzore. Ashtu siç e thamë se Urtësia hyjnore obligon sigurimin e shkaqeve të përsosjes përzgjedhëse (*la el-xheberij*) dhe kushtet e saj për njerëzit me qëllim që ata të cilët dëshirojnë të njihen dhe të ndjekin rrugën e vërtetë dhe nëpërmjet sjelljeve së tyre të arrijnë në përsosurinë dhe lumturinë e tyre. Por ofrimi i këtyre shkaqeve dhe kushteve për këtë lloj përsosurie nuk do të thotë se të gjithë njerëzit do t'i përfitojnë prej saj dhe se patjetër do të zgjedhin rrugën e drejtë. Edhe Kur'ani famëlartë se qëllimi i Allahut në krijimin e njeriut është: **"...për të provuar se kush prej tyre punon më mirë."** (Surja "El-Kehf", ajeti 7)

Kjo përmendet edhe në disa forma në përmbajtjen e ajeteve të Kur'anit famëlartë.[1] Gjithashtu, është përsëritur disa herë në Kur'anin famëlartë se nëse Allahu i Madhëruar do të dëshironte që t'i udhëzonte të gjithë njerëzit në rrugën e Tij të drejtë do t'i kishte larguar ata plotësisht nga devijimi. Por në këtë formë nuk do të kishte mbetur më vend për përzgjedhje dhe veprat e njerëzve do të humbisnin vlerën e tyre njerëzore dhe do të zhvlerësohej qëllimi i Allahut në krijimin e njeriut përzgjedhës.

Si përfundim: Drejtimi i njerëzve drejt shthurjes, humbjes, mosbesimit dhe mosbindjes e ka burimin tek përzgjedhja e tyre e keqe dhe e gabuar. Kjo aftësi për këto lloj veprash është vënë re n qenien e tyre të krijuar. Sigurisht, qëllimi i tyre për të mbërritur te të duhurat dhe ndikimet e tyre është me pasim. Sepse Vullneti hyjnor, edhe në qoftë se është lidhur në zanafillë me përsosurinë njerëzore, por, përderisa ajo me të cilën është i lidhur ky Vullnet është e kushtëzuar nga përzgjedhja, atëherë ky Vullnet nuk e mohon rënien dhe shkatërrimin që burojnë nga përzgjedhja e gabuar. Gjithashtu, Urtësia hyjnore nuk obligon lëvizjen e gjithë njerëzve drejt rrugës së drejtë me detyrim (*xhebrijen*) edhe pse {xhebrij} kundërshton dëshirën dhe vullnetin e tyre.

Keqkuptimi i tretë

Ne vërejmë se Urtësia hyjnore dëshiron që njerëzit përgjithësisht dhe në formën më të mirë të arrijnë përsosurinë dhe lumturinë. A nuk do të ishte më mirë që Allahu i Madhëruar t'u tregonte njerëzve të fshehtat e natyrës nëpërmjet Revelatës që ata të mund të përfitonin dhe të pajiseshin me mirësitë dhe begatitë hyjnore dhe përshpejtojnë drejt përsosurisë dhe përparimit në mënyrë më të shpejtë?

Ne shohim se në ditët tona janë zbuluar shumë prej sekreteve natyrore dhe shpikje të reja të cilat kanë luajtur një rol ndikues dhe mbresëlënës në përparimin e qytetërimeve

1. Surja "Hud", ajeti 7, surja "El-Kehf", ajeti 7, surja "El Mulk", ajeti 2, surja "El Maide", ajeti 48, surja "El En'am", ajeti 165.

dhe zhvillimin e tyre dhe realizimin e shumë mrekullive në fushën e ruajtjes së shëndetit dhe luftimin e sëmundjeve, në zhvillimin e mjeteve të informacionit dhe shkëmbimit të njohurive, në fushën e lidhjes dhe zgjerimit të marrëdhënieve. Pra, nëse profetët do t'i ndihmonin njerëzit duke u ofruar atyre teknologji të habitshme dhe mjetet e qetësisë, atëherë ky faktor do të ndikonte shumë në pozicioni e tyre në shoqëror, në popullaritetin e tyre dhe në forcat politike, gjë e cila do t'i kishte ndihmuar shumë në qëllimin e tyre të proklamuar.

Përgjigje: Shkaku kryesor i ekzistencës së Revelatës dhe profetëve përmblidhet në çështjet dhe fushat të cilat njerëzit nuk mund të arrijnë në to nëpërmjet mjeteve dhe njohjes së zakonshme, ku ata e kanë të pamundur – për shkak të padijes së tyre – përcaktimin e drejtimit të lëvizjes së tyre drejt përsosurisë së vërtetë dhe ecjes në udhën e saj.

Thënë ndryshe: Detyra kryesore e profetëve është të ndihmojnë njerëzit në përcaktimin e drejtimit të jetës së tyre, dhe udhëtimit të tyre drejt përsosjes, që të kenë mundësi të njihen me detyrat e tyre në kushte të ndryshme. Dhe, të përdorin fuqitë dhe mundësitë e tyre në rrugën e realizimit të qëllimit të tyre të synuar, qofshin ata nga banorët e shkretëtirës dhe çadrave apo nga banorët e qyteteve dhe civilizimeve dhe mrekullive teknologjike të zhvilluara. Duhet të njihen me bazat e vlerave njerëzore, me detyrat dhe me obligimet në fushën e adhurimit të Allahut, dhe në jetën e tyre personale e vetjake. Duhet të njihen me detyrat e obligimet ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj gjithë krijesave, që të bëhet e mundur nëpërmjet saj arritja drejt përsosurisë dhe lumturisë së vërtetë dhe të përhershme.

Sa i përket ndryshimeve pranuese, përgatitjeve, mundësive natyrore dhe industriale qofshin ato në të njëjtën kohë apo në kohë të ndryshme ky është rezultat i shkaqeve dhe faktorëve të caktuar të cilët nuk kanë ndikim veprues dhe përcaktues në përsosurinë e vërtetë dhe rrugëtimin e përhershëm. Vërejmë sot në ditët tona zhvillimin shkencor dhe teknologjik i cili ka çuar në zgjerimin dhe përparimin

e të mirave materiale dhe të dynjasë por nuk ka ndikuar në përsosjen e brendshme dhe shpirtërore të njerëzve. Mund të thuhet se ndikimi i saj është i kundërt.

Përfundimi: Urtësia hyjnore u ka mundësuar njerëzve të përfitojnë nga të mirat materiale për vazhdimin e jetës së tyre në këtë botë. Gjithashtu, të bëjnë të mundur që nëpërmjet mendjes dhe Revelatës të bëjnë të mundur përcaktimin e drejtimit të lëvizjes drejt përsosurisë dhe lumturisë së vërtetë.

Sa i përket diferencës në fuqi dhe mundësi trupore dhe shpirtërore dhe ndryshimit të kushteve natyrore dhe sociale dhe gjithashtu përfitimit nga dijet dhe industritë, që të gjitha ato i nënshtrohen kushteve dhe faktorëve të caktuar krijues. Këto ndryshime gjenden sipas sistemit shkak pasojë dhe se këto ndryshime nuk kanë asnjë ndikim veprues në rrugëtimin e përjetshëm të njeriut.

Ndoshta gjendet një individ apo një bashkësi e cila jeton jetën e saj të thjeshtë e të privuar dhe nuk ka përfituar as më të paktën nga pasuritë materiale të dynjasë, por kanë ngjitur shkallët dhe kanë arritur pozitën e lartë në rrugën e përsosurisë dhe lumturisë.

E kundërta është se ndoshta gjendet një individ apo një bashkësi e cila përfiton më shumë nga mrekullitë industriale dhe zhvillimi i dijeve dhe gëzon të mirat e shumta materiale të jetës, por si rezultat i mohimit të të mirave, kryelartësisë dhe zullumit ndaj të tjerëve ndodhet në gradën dhe shkallën më të ulët të vuajtjeve.

Profetët, përveç detyrës së tyre kryesore, e cila është udhëzimi i njerëzve drejt përsosjes dhe lumturisë të përjetshme, kanë dhënë kontribute dhe shërbime dhe ndihma të mëdha frytdhënëse për një jetë më të mirë në këtë dynja. Sa herë që i obligonte Urtësia hyjnore, ata i largonin pak perdet dhe mbulesat për disa të vërteta të panjohura, për të fshehtat e natyrës dhe thesaret e saj duke ndihmuar kështu në zhvillimin e qytetërimeve. Këto ndihma i vëmë re në jetën

e Davudit, Sulejmanit dhe Dhulkarnejnit[2] (*paqja qoftë mbi ta!*). Ata gjithashtu derdhën shumë energji në udhëheqjen e shoqërisë dhe miradministrimin e çështjeve të tyre, siç vihet re në jetën e Jusufit (*paqja qoftë mbi të!*) në tokën e Egjiptit.[3] Të gjitha këto shërbime dhe ndihma konsiderohen shtesë mbi detyrën dhe misioni e tyre kryesor.

Përsa i përket pyetjes se përse nuk u bazuan profetët në fuqinë industriale, ekonomike dhe ushtarake në rrugën e përmbushjes së qëllimit të tyre, ne u përgjigjemi duke thënë: E kemi përsëritur shumë herë se qëllimi i profetëve (*paqja e Zotit qoftë mbi ta!*) është ofrimi i kushteve dhe atmosferës së përshtatshme me përzgjedhjen ndijimore, të vetëdijshme dhe të lirë.

Në qoftë se do të mbështeteshin në fuqi jo të zakonshme, nuk do të realizohej ai udhëzim shpirtëror dhe as përsosuria e lirë për njerëzit, por ata do t'i pasonin nën presioni e aftësive dhe fuqive të tyre dhe jo nga shkaku hyjnor dhe mbi bazën e përzgjedhjes së lirë.

Prijësi i besimtarëve në këtë kontekst thotë: *Po të kishte dashur Zoti të hapte për profetët e Tij thesaret dhe minierat e floririt, të mbillte pemët e Xhennetit dhe të mblidhte përreth tyre zogjtë e qiejve dhe bishat e dheut, do ta kishte bërë. Por po të kishte vepruar kështu, nuk do kishte më sprovë, as shpërblim.... Në qoftë se profetët do kishin autoritet të pasulmueshëm, nder të panjollosshëm dhe mbretëri të fuqishme, ku turmat do duhej të shkonin me ose pa dashjen e tyre, e ku kuajt e kasnecëve s'do t'i hapnin dot rrugë njëri-tjetrit, njerëzit do ta kishin patur tepër të lehtë për t'u kërkuar mësime, dhe tepër të vështirë për t'u ndier kryelartë; atëherë besimi do pranohej thjesht nga frika dhe të gjithë do kishnin qëllim të njëjtë, ndonëse veprat mund të ishin të ndryshme. Por Zoti ka vendosur që njerëzit t'i pasojnë profetët e Tij, të mësojnë për Librat e Tij, të mbeten të përvuajtur përpara Tij, t'i binden vullnetit të Tij dhe të pranojnë*

2. Shih suret: "El-Enbija", ajetet 78-82; "El-Kehf", ajetet 83-97; "Sebe", ajetet 10-13. Ajo që në duam të përforcojmë është se në disa transmetime thuhet se Dhulkarnejni nuk ka qenë *nebij*, por nga *evlija*të e Zotit.

3. Sure "Jusuf", ajeti 55.

nënshtrimin ndaj Tij me sinqeritet të pastër dhe vetëm për hir tëTij, pa gjurmën më të vogël të ndonjë gjëje tjetër; dhe përderisa sprova dhe mundimi janë kaq të mëdha, të mëdha do jenë dhe dhuratat e shpërblimet.[4]

Po, kur njerëzit i drejtohen fesë së vërtetë me dëshirën dhe përzgjedhjen e tyre të lirë, bien dakort për ngritjen e shoqërisë besimtare bazuar te kënaqësia e Allahut të Madhëruar. Pas kësaj duhet përfituar nga fuqitë e ndryshme për të realizuar qëllimet hyjnore, veçanërisht ndëshkimin e jobesimtarëve dhe mbrojtjen e të drejtave të besimtarëve, ashtu siç e vëmë re në shembujt gjatë sundimit të Sulejmanit (*paqja qoftë mbi të!*).[5]

Pyetje:

1. A janë dërguar të gjithë profetët në një zonë të caktuar gjeografike? Cili është argumenti për këtë?

2. Përse nuk është përhapur thirrja e profetëve në çdo anë të botës?

3. Cili është shkaku që Allahu i Madhëruar nuk ofroi kushtet dhe shkaqet për të ndaluar shthurjet dhe luftrat shkatërruese?

4. Pse profetët e Allahut të Madhëruar nuk ia zbuluan njerëzve të fshehtat e natyrës, që pasuesit e tyre të kishin mundësi të përfitonin sa më shumë nga të mirat materiale?

5. Përse profetët nuk përfituan nga fuqitë industriale dhe ekonomike në rrugën e realizimit të qëllimeve të tyre?

4. Nehxhu'l Belagah, ligjërata Kasi'a, f. 291-292, Dr. Subhi Salih. Shih edhe suret "El-Furkan", ajetet 7-10 dhe "Ez-Zuhruf", ajetet 31-35.
5. Suret: "El-Enbija", ajetet 81-82; "En-Neml", ajetet 15-44.

Leksioni i njëzetekatërt

PAGABUESHMËRIA E PROFETËVE

Domosdoshmëria e ruajtjes (mbrojtjes) së Revelatës

Pasi e vërtetuam rëndësinë e Revelatës, si rruga që arrihet nëpërmjet saj tek njohuritë dhe perceptimet e domosdoshme për të mbyllur me anë të saj mangësitë e ndjenjës dhe të logjikës njerëzore, na shfaqet një tjetër çështje e cila është:

Duke vërejtur se njerëzit e zakonshëm nuk mund të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ky mjet njohjeje dhe nuk posedojnë gadishmërinë për të mbartur Revelatën Hyjnore,[1] kjo e bën të domosdoshme lajmërimin e tyre me anë të Mesazhit hyjnor nëpërmjet personave të caktuar (profetëve). Por kush e siguron vërtetësinë e këtij Mesazhi? Si të bindemi se profeti e ka marrë Revelatën hyjnore në mënyrë të saktë, dhe au përcolli dhe ua transmetoi njerëzve në mënyrë të saktë? Nëse ekziston një ndërmjetës (korrier) midis Allahut dhe profetit, atëherë si të bindemi se ai ia ka përcjellë mesazhin profetit në mënyrë të rregullt? Sepse, Revelata është ndikuese në mbylljen e mangësive së njohjes njerëzore kur është e mbrojtur, që nga periudha e burimit e deri në fazën e mbërritjes tek njerëzit, nga çdo shtrëmbërim, devijim i qëllimshëm apo manipulimi, me qëllim paqëllim. Përndryshe, nëse do të supozohet harresa apo pavëmendshmëria, manipulimi i qëllimshëm në përmbajtjen e saj, kjo do të ndikojë në mendjet e njerëzve, dhe se ata do të supozojnë gabimin dhe parregullsinë e mesazhin që i ka mbërritur atyre. Kjo situatë çon në lëkundjen e besimit ndaj

1. Për këtë, në Kur'anin Famëlartë thuhet: **"...Allahu nuk do t'ua zbulojë të fshehtën (**që vetëm Ai e di**), por Allahu zgjedh kë të dojë nga të dërguarit e Tij..."** (Sure "Ali Imran", ajeti 179)

saj. Atëherë, cila është rruga që na bind se Mesazhi Hyjnor u ka mbërritur njerëzve në formë të saktë?

Është më se e natyrshme se kur e vërteta e Revelatës është e panjohur për njerëzit dhe nuk gjendet gadishmëri tek ata për ta pranuar dhe për ta njohur atë, atëherë nuk mbetet asnjë mënyrë për të kontrolluar dhe mbikëqyrur ndërmjetësuesit për njohjen e vërtetësisë së tyre. Po, mund të njihet ekzistenca e gabimeve në Revelatë vetëm në një formë dhe kjo në rastin kur mesazhi bie në kundërshtim me rregullat logjike të vërteta dhe bindëse. Është njëlloj sikur dikush të pretendojë se i ka ardhur Revelata nga Allahu se bashkimi i dy të kundërtave lejohet ose është i detyrueshëm, ose të pretendojë se ka më shumë se një zot (*Allahu na ruajtë*!), ose të pretendojë së Veta e Allahut është e përbërë, apo zhduket me kalimin e kohës. Ne mund ta vërtetojmë gënjeshtrën e këtij pretenduesi duke u mbështetur në rregulla logjike të vërteta bindëse. Duhet të dimë se nevoja kryesore e Revelatës përfaqësohet nga çështjet të cilat nuk mund të vërtetohen apo të mohohen me rrugë logjike dhe nga çështje të cilat logjika, nëpërmjet vlerësimit të përmbajtjes së mesazhit, nuk mund të vërtetojë vërtetësinë apo pavërtetësinë e tij. Atëherë, cila është rruga e vërtetimit të vërtetësisë së përmbajtjes të revelatës, dhe vërteton mbrojtjen e saj nga devijimet, shpifjet, pakujdesitë dhe manipulimet e qëllimshme të ndërmjetësve?

Përgjigja është: Sipas argumentit, të cilin e përmendëm në mësimin njëzetë e dytë, logjika percepton domosdoshmërinë e ekzistencës së një rruge tjetër për njohjen e të vërtetave dhe detyrave vepruese, edhe pse nuk njeh thelbin e kësaj rruge dhe të vërtetën e saj, ajo (logjika) percepton po ashtu se Urtësia hyjnore e ka mundësuar mbërritjen e këtij mesazhi tek njerëzit në formën e drejtë dhe të vërtetë, pa u prekur nga asnjë devijim dhe trillim, ose në të kundërt do të binte në kundërshtim me qëllimin.

Thënë ndryshe: Pasi u bë e ditur se mesazhet hyjnore duhet të arrijnë të transmetohen tek njerëzit nëpërmjet ndërmjetësit

apo ndërmjetësve të sakta me qëllim që të ofrohen kushtet dhe ambjenti i përshtatshëm për përsosurinë e përzgjedhjes njerëzore dhe të realizohet kështu qëllimi Hyjnor në krijimin e njeriut. Duke vërejtur cilësitë e përsomërisë hyjnore, vërtetohet se mesazhet duhet të jenë të mbrojtur nga devijimi, trillimi dhe harresat. Sepse nëse Allahu i Madhëruar nuk do dëshironte mbërritjen e Mesazheve në formë të rregullt tek robtë e Tij, atëherë kjo do të binte në kundërshtim me Urtësinë dhe Vullnetin e urtë hyjnor. Nëse Allahu nuk e di se nëpërmjet cilës rrugë dhe cilit person do ta përmbushë mesazhin e Tij që të mbërrijë i saktë tek robtë e Tij, kjo bie në kundërshtim me dijen e Allahut e cila është e pakufijshme, absolute. Nëse nuk do ishte i aftë në përzgjedhjen e ndërmjetësve të drejtë për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mesazhit nga të këqijat e shejtanëve, atëherë kjo nuk do të përshtatej me fuqinë e Tij të pakufizuar.

Pra, meqenëse Allahu është i Ditur dhe i Njohur për çdo gjë, nuk mund të supozojmë që Allahu është i paditur për gabimet e ndërmjetësit që zgjedh.[2] Duke e njohur fuqinë e Tij të pakufizuar, nuk mund të imagjinojmë pafuqinë e Tij në ruajtjen e Revelatës nga ndërhyrjet e shejtanëve, si dhe ndikimi i faktorëve harresë dhe pakujdesi.[3] Gjithashtu, nuk mund të pranojmë se urtësia Hyjnore nuk dëshiron ruajtjen e mesazhit të Tij nga gabimet.[4] Si përfundim, dituria, fuqia dhe Urtësia hyjnore obligojnë mbërritjen e Mesazhit hyjnor tek robtë e Tij në formën e saktë dhe të vërtetë. Prej këtu vërtetohet mbrojtaj e Revelatës me argumente logjikë. Po ashtu vërtetohet mbrojtja e engjëllit apo engjëjve të Revelatës dhe e profetëve

2. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: **"Allahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet."** (Sure "El-En'am", ajeti 124)

3. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: **"Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të dërguarve që ka zgjedhur. Para dhe pas tyre Ai vë mbikqyrës (engjëj), në mënyrë që ta dijë nëse i përcjellin mesazhet e Zotit të tyre. Ai përfshin me dijen e Vet gjithçka që ata kanë dhe çdo gjë e ka llogaritur imtësisht."** (Sure "El-Xhin", ajetet 26-28)

4. **"...që kush duhej të vdiste, të vdiste me prova të qarta dhe, kush duhej të mbetej gjallë, të jetonte me prova të qarta..."** (Sure "El-Enfal", ajeti 42)

në fushën e pranimit të Revelatës. Gjithashtu vërtetohet edhe pagabueshmëria e tyre nga tradhëtia e qëllimshme, apo nga harresa dhe pakujdesia në rrugën e transmetimit dhe të përcjelljes së Mesazhit hyjnor.

Nga këtu, na qartësohet shkaku i përforcimit të Kur'anit Famëlartë për besnikërinë e engjëllit të Revelatës, fuqinë së tij në ruajtjen e detyrës hyjnore, për largimin e ndikimeve të shejtanëve dhe për amanetin e profetëve. Përgjithësisht, nga ajo që përmendëm më sipër qartësohet vërtetësia e Tij në ruajtjen dhe mbrojtjen e Revelatës deri në mbërritjen e tij tek njerëzit.[5]

Fushat e tjera të pagabueshmërisë

Pagabueshmëria, të cilën me argumentet e mësipërme e vërtetuam për engjëjt dhe profetët (*paqja qoftë mbi ta!*), veçohet vetëm në sferën e marrjes së Revelatës dhe transmetimit të saj. Ekzistojnë edhe disa sfera të tjera të pagabueshmërisë, të cilat nuk vërtetohen me këtë argument. Ato mund t'i ndajmë në tre grupe:

- E para: Ka të bëjë me pagabueshmërinë e engjëjve.
- E dyta: Ka të bëjë me pagabueshmërinë e profetëve.
- E treta: Ka të bëjë me pagabueshmërinë e disa personave siç janë: imamët e pagabueshëm (*paqja qoftë mbi ta!*), Merjemja dhe Fatimja e pastër (*paqja e Zotit qoftë mbi to!*).

Në sferën e pagabueshmërisë së engjëjve: Mund të studiohet në dy çështje, përveç pranimit të Revelatës dhe transmetimit të saj:

E para: Pagabueshmëria e atyre engjëjve të Revelatës të cilët kanë lidhje me pranimin e Revelatës dhe përcjelljen e saj.

E dyta: Pagabueshmëria e të gjithë engjëjve të cilët nuk kanë asnjë lidhje me Revelatën si përshembull: engjëjt

5. Suret: "Esh-Shu'ara", ajeti 93; "Et-Tekuir", ajeti 21; "El-A'raf", ajeti 68; "Esh-Shu'ara", ajetet 107, 125, 143, 162 dhe 178; "Ed-Duhan", ajeti 18; "Et-Tekuir", ajeti 20; "En-Nexhm", ajeti 5; "El-Hakka", ajetet 44-47; "El-Xhin", ajetet 26-28.

e ngarkuar me furnizimin, engjëjt që shkruajnë veprat dhe engjëjt që marrin shpirtrat etj.

Po ashtu, edhe rreth pagabueshmërisë së profetëve që nuk ka të bëjë me mesazhin e tyre, mundem të studiohet në dy çështje:

E para: Mbrojtja e profetëve në bërjen e gjynaheve dhe mëkateve me qëllim.

E dyta: Mbrojtja e tyre nga harresa dhe veprimet padashje.

Këto dy çështje mund të studiohen gjithashtu edhe për joprofetët.

Ndërsa çështjet që lidhen me pagabueshmërinë e engjëjve jo në sferën e pranimit të Revelatës dhe transmetimit të saj, mund të trajtohet me argumente logjikë kur ne të njihemi me të vërtetën e engjëjve. Por studimi i kësaj të vërtete, që nuk është i lehtë, është i papërshtatshëm në këtë pjesë. Ne do të mjaftohemi me përmendjen e dy ajeteve që tregojnë pagabueshmërinë e engjëjve. Ato janë: ajeti 27 i sures "El-Enbija" **"Ata nuk flasin para (***Fjalës së***) Tij dhe veprojnë me Urdhrin e Tij."**, si dhe ajeti 6 i sures Tahrim **"Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër,të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato."**

Këto dy ajete tregojnë qartësisht se engjëjt janë krijesa të nderuara. Ato veprojnë vetëm me urdhër të Allahut dhe nuk i kundërshtojnë urdhrat e Tij. Megjithëse shtrohet pyetja rreth përgjithësimit të ajeteve për të gjithë engjëjt.

Përsa i përket studimi të pagabueshmërisë së disa personave (joprofetë), ky studim i përshtatet studimit të Imamatit. Ky është shkaku që ne do të studiojmë këtu, në veçanti, çështjet që lidhen me pagabueshmërinë e profetëve, edhe pse disa nga këto çështje nuk mund të trajtohen vetëm me argumente të transmetuara dhe të adhurimore. Për këtë, është i domosdoshëm studimi i saj pas vërtetimit të argumentueshmërisë së Kur'anit dhe Sunetit. Por, duke ruajtur përshtatshmërinë ndërmjet temave të këtyre çështjeve që do të

studiojmë në këtë pjesë, do të pranojmë argumentueshmërinë e Kur'anit dhe Sunetit si parim tematik dherëndësinë e studimit e lëmë për në vendin e tij.

Pagabueshmëria e profetëve

Ndërmjet rrymave islame ka dallim rreth asaj se deri ku arrin pagabueshmëria e profetëve në kryerjen e gjynaheve dhe gabimeve. Shiitët Imamitë p.sh. besojnë se profetët janë të pagabueshëm dhe të mbrojtur nga të gjitha gjynahet, të vogla dhe të mëdhaja, që nga lindja e deri në vdekje. Ata nuk kryejnë asnjë gjynah qoftë edhe nga harresa apo pakujdesia. Porse disa rryma të tjera që thonë se profetët nuk kryejnë vetëm gjynahe të mëdhaja. Disa të tjerë thonë se nuk kryejnë që nga koha që hyjnë në moshë madhore, kurse të tjerë thonë që nga koha që u zbret Revelata. Është përcjellë nga disa grupe të Ehli Sunetit (që janë hasheuijeh dhe disa muhadithin) që e mohojnë plotësisht pagabueshmërinë e profetëve dhe arrijnë deri aty sa deklarojnë mundësinë e kryerjes së gjynaheve të qëllimshme nga ana e profetëve, madje edhe gjatë kohës që u zbret Revelata.

Para se të fillojmë studimin e vërtetimit të pagabueshmërisë të profetëve (*paqja qoftë mbi ta!*), është e domosdoshme të sqarojmë disa vërejtje:

E para: Ne nuk nënkuptojmë me pagabueshmërinë e profetëve apo dhe të tjerëve, vetëm moskryerjen e gjynaheve të cilat mund të mos i kryejë edhe një njeri i zakonshëm gjatë gjithë jetës së tij, veçanërisht kur jeta e tij është e shkurtër. Ne nënkuptojmë ekzistencën e një shpirti të fortë që e kundërshton dhe ndalon kryerjen e gjynaheve edhe në kushte shumë të vështira. Kjo arrihet me vetëdije të plotë që gjithmonë e urren gjynahun, si dhe nga vullneti i fortë që i përmban dëshirat e brendshme. Përderisa kjo aftësi arrihet vetëm me mbështetje të veçantë hyjnore, ky është shkaku që i përshkruhet veprimi i saj Allahut të Madhëruar. Në të kundërt, Allahu i Lartësuar

nuk e ndalon njeriun e pagabueshëm nga kryerja e gjynaheve me detyrim (*xhebr*) dhe nuk ia heq të drejtën e përzgjedhjes. I atribuohet Allahut pagabueshmëria e disa personave të cilët posedojnë detyra hyjnore si për shembull profetësia dhe imameti. Thënë ndryshe, Garanti i tyre është Allahu i Lartësuar.

E dyta: Është e domosdoshme që një person i pagabueshëm duhet të mos kryejë vepra të ndaluara siç janë gjynahet e ndaluara në çdo ligj (sheriat), ashtu sikurse kryerja e gjynaheve të ndaluara në sheriatin e tij, apo në atë të cilën nuk bën pjesë ai. Pagabueshmëria e profetit nuk bie në kundërshtim me veprat të cilat janë të lejuara në sheriantin e tij për vetë atë edhe nëse janë të ndaluara në sheriatin paraardhës apo do të jenë të ndaluara në sheriatin pasardhës.

E treta: Qëllimi i gjynahut nga i cili pastrohet i pagabueshmi nga kryerja e saj është: Vepra e cila është (e ndaluar) në terminologji e jurispodencës, ose lënia e veprës e cila është detyrë (vaxhib) në terminologji në jurispodencës. Ndërsa fjala gjynah me gjithë sinonimet e saj si mëkati, përdoret në përdorim më të gjerë dhe përfshin edhe (lënia është më primare) dhe praktikimi i këtyre nuk bie në kundërshtim me pagabueshmërinë.

Pyetje:

1. Si mund ta vërtetohet ruajtja e Revelatës nga çdo e metë apo shtrembërim?

2. Cilat janë fushat e tjera të pagabueshmërisë veç sferës së mbrojtjes së profetit në marrjen e Revelatës dhe transmetimin e saj?

3. Nëpërmjet cilës rruge mund të vërtetohet pagabueshmërinë e engjëjve?

4. Cilat janë mendimet rreth pagabueshmërisë së profetëve (*paqja qoftë mbi ta!*)? Cili është mendimi i shijave imamijetu në këtë fushë?

5. Përkufizo pagabueshmërinë dhe përmend të duhurat e saj.

Leksioni i njëzetepestë

ARGUMENTET MBI PAGABUESHMËRINË E PROFETËVE

Parathënie

Besimi në pagabueshmërinë e profetëve në kryerjen e gjynaheve të qëllimshme apo të paqëllimëshme është prej besimeve të pakundërshtueshme dhe e njohur tek shiitët. Këtë ua kanë mësuar atyre (shiitëve) Imamët e pastër. Ata diskutuan me kundërshtarët e tyre me mënyra të ndryshme. Nga diskutimet dhe debatet e njohura në këtë fushë është debati i imam Rizait (*paqja qoftë mbi të!*) i përmendur në librat e hadithit dhe të historisë.

Ka një mosdakortësi rreth mohimit të harresës nga profetët në çështjet e lejueshme dhe të zakonshme. Këtyre dukurive nuk i shpëtojnë as transmetimet e mbërritura nga Ehli Bejti (*paqja qoftë mbi ta!*) rreth mosmarrvëshjeve dhe kundërshtimeve. Studimi i saj kërkon një fushë më të gjerë. Sidoqoftë nuk mund të konsiderohet nga besimet e domosdoshme.

Argumentet të cilat u përmendën mbi pagabueshmërinë e profetëve (*paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) mund të ndahen në dy grupe.

- E para: Argumentet logjike.
- E dyta: Argumentet e transmetuara.

Edhe pse mbështetja më tëpër është në argumentet e transmetuara, ne do të paraqesim dy argumente logjike dhe më pas do të përmendim disa argumente kur'anore.

Argumentet logjike mbi pagabueshmërinë e profetëve

Argumenti i parë logjik mbi domosdoshmërinë e pagabueshmërisë së profetëve në kryerjen e gjynaheve: Qëllimi bazë në dërgimin e profetëve është udhëzimi i njerëzimit në të vërtetat dhe detyrat të cilat i ka ngarkuar Allahu për njerëzimin. Në të vërtetë ata janë ambasadorët e Allahut për njerëzimin. Ata janë të obliguar për udhëzimin e të tjerëve në rrugën e drejtë. Nëse vetë këta ambasadorë nuk janë të devotshëm dhe nuk u përmbahen mësimeve hyjnore dhe veprojnë të kundërtën e përmbajtjes së Mesazhit të tyre, atëherë njerëzit do të shohin qartë se punët e tyre bien në kundërshtim me fjalët e tyre dhe nuk do të besojnë në fjalët e tyre. Përfundimi i kësaj është se nuk do të realizohet qëllimi i dërgimit të tyre në formën e plotë. Pra, urtësia dhe mëshira hyjnore obligojnë që profetët të jenë të pagabueshëm dhe të pastër nga gjynahet. Prej tyre nuk buron asnjë vepër jo e mirë qoftë ajo edhe nga harresa me qëllim që njerëzit të mos supozojnë se profetët e marrin si pretendim harresën për të kryer gjynahe dhe mëkate.

Argumenti i dytë logjik mbi pagabueshmërinë e profetëve: Profetët ashtu si janë ngarkuar për të përcjellë përmbajtjen e Revelatës dhe Mesazhit tek njerëzit dhe për udhëzimin e tyre në rrugën e drejtë, gjithashtu, janë ngarkuar për t'i pastruar, edukuar dhe përmirsuar sjelljet e njerëzve, si dhe për t'i aftësuar njerëzit dhe për t'i përgatitur ata për në fazën e fundit prej fazave të përsosjes njerëzore. Thënë ndryshe: Profetët kanë mbi shpatullat e tyre – përveç detyrës së misionit të mësimit dhe udhëzimit– kanë edhe detyrën e misionit të edukimit, udhëheqjes dhe drejtimit të njerëzve. Atë edukatë të përgjithshme e cila përfshin njerëzit në përgatijen e tyre në gradat më të larta. Këtë pozitë të lartë nuk e meritojnë veçse ata që arrijnë gradat më të larta të përsosurisë njerëzore dhe posedojnë më shumë zotësi dhe aftësi të përsosura shpirtërore, që është pagabueshmëria.

Duhet të shtojmë gjithashtu rolin e moralit të edukatorit dhe veprat e tij, të cilat ndoshta kanë më shumë ndikim se fjalët e tij në edukimin dhe ndreqjen e të tjerëve. Ai që ka mangësi dhe të meta në veprat e tij, fjala e tij nuk ka atë ndikim që kërkohet. Pra, qëllimi hyjnor realizohet në formën e plotë në dërgimin e profetëve që edukojnë dhe rregullojnë moralin e shoqërisë. Kjo arrihet kur ata profetë janë të pagabueshëm dhe të pastër nga çdo devijim në fjalët dhe veprat e tyre.

Argumente të transmetuara mbi pagabueshmërinë e profetëve

1. Kur'ani Famëlartë i ka përshkruar disa persona si të sinqertë absolutë (*mukhlesinë*).[1] Edhe vetë shejtani nuk mundet që t'i mashtrojë ata. Shejtani është betuar se do t'i mashtrojë gjithë bijtë e Ademit përveç të sinqertëve, të pastërve, ashtu siç është përshkruar edhe në dy ajetet kur'anore 82 e 83 të sures "Sad": **"Ai tha: 'Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robërve të Tu të sinqertë!"**

Nuk ka dyshim se shkaku i humbjes së shpresës së shejtanit në mashtrimin e tyre është mbrojtja dhe pastërtia që zotërojnë nga humbja dhe kryerja e gjynaheve. Përndryshe, armiqësia e tij (shejtanit) qërfshin edhe këta të pastër e të mbrojtur. Po të kishte mundësi që t'i mashtronte, do ta kishte bërë. Pra, i sinqerti (*el mukhles*), i mbrojturi, i pastri është sinonim i të pagabueshmit. Edhe sikur të mos gjendej një argument për veçantinë e profetëve me këtë cilësi, por nuk ka dyshim në përfshirjen e tyre me këtë cilësi.

Kur'ani Famëlartë i ka konsideruar disa profetë të sinqertë (*mukhlesin*), të mbrojtur ashtu siç përmendet në dy ajetet, 45 dhe 46 të sures Sad: **"Kujto robtë Tanë: Ibrahimin, Is'hakun dhe Jakubin, të fortë (**në besim**) dhe largpamës. Ne u dhuruam atyre një virtyt të veçantë, që ta kenë gjithmonë <u>në mend botë</u>n e ardhshme."**

1. Duhet ditur dallimi mes "*mukhles*" dhe "*mukhlis*". Të parin e ka bërë Allahu njeri të pastër e të sinqertë, ndërsa i dyti është personi që i kryen veprat e tij me sinqeritet dhe me qëllim të pastër.

Edhe në ajetin 51 të sures "Merjem": "**Trego në Libër edhe për Musain! Njëmend, Ai ishte i përzgjedhur, ishte i dërguar dhe profet.**"

Gjithashtu është konsideruar shkaku në pastërtinë e Jusufit (*paqja e Allahut qoftë mbi të!*) nga devijimi në kushtet më të vështira dhe ai qëndroi i sinqertë (*mukhles*), i mbrojtur. Kjo është përmendur në ajetin 24 të sures "Jusuf": **"Kështu e larguam nga e keqja dhe vepra e shëmtuar, sepse ai, në të vërtetë, ishte nga robtë Tanë të sinqertë."**

2. Kur'ani Famëlartë i ka obliguar njerëzit që t'u binden profetëve në mënyrë absolute, ashtu siç përmendet në ajetin 64 të sures "Nisa": **"Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t'u binden atyre."** Bindja absolute ndaj tyre është e saktë dhe e drejtë kur është në rrugën e bindjes ndaj Allahut dhe bindja ndaj profetëve nuk duhet të bjerë në kundërshtim me bindjen ndaj Allahut. Urdhri për bindjen absolute ndaj Allahut dhe bindjen absolute ndaj atyre që gabojnë dhe devijojnë janë dy rrugë të kundërta.

3. Kur'ani Famëlartë i ka veçuar postet hyjnore për të gjithë ata që nuk u njollosën me padrejtësinë (zullum). Allahu i Madhëruar në përgjigjen e Tij për Ibrahimin (*paqja e Allahut qoftë mbi të!*), i cili i kërkoi detyrën e prijësisë për djemtë e tij, thotë: **"Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët."**[2]

Ne e dimë se çdo gjynah është padrejtësi që i bëhet vetes. Sipas Kur'anit çdo gjynahqar dhe mëkatar është i padrejtë. Pra, profetët janë zotëruesit e posteve hyjnore (profetësia dhe mesazhi) kështu që ata duhet të jenë të pastër nga çdo padrejtësi dhe gjynah. Ne mund të përmendim edhe ajete të tjera kur'anore mbi pagabueshmërinë e profetëve dhe transmetime të tjera që flasin për këtë.

Sekreti në pagabueshmërinë e profetëve

Në përfundim të këtij leksioni, duhet të flasim edhe rreth

2. Sure "El-Bekare", ajeti 124.

sekretit të pagabueshmërisë së profetëve. Sekreti i mbrojtjes së tyre në aspektin e marrjes së Revelatës është: Perceptimi i Revelatës (*Vahj*) është nga mënyrat e perceptimit që nuk pranon gabime dhe personi i zgjedhur për marrjen e saj i vihen në dispozicion të vërteta shkencore të cilat i percepton nëpërmjet prezencës (*hudur*), duke dëshmuar lidhjen me Reveluesin, pavarësisht nëse kryhet nëpërmjet një ndërmjetësi (engjëlli) apo jo.[3] Pranuesi i Revelatës nuk mund të dyshojë nëse e ka pranuar vahjin apo dhe as të dyshojë se kush është ai i cili ia ka zbritur Revelatën? Cila është përmbajtja apo kuptimi i saj?

Janë transmetuar disa tregime dhe historira të vëna dhe të gënjeshtërta tek të cilat pretendohet se profeti ka dyshuar në pejgamberllëkun e tij! Apo nuk ka ditur se çfarë fliste dhe nuk ka njohur përmbajtjen e Revelatës! Apo nuk ka ditur kush e ka dërguar revelatën! Këto janë të gjitha lajme të pavërteta dhe trillime të cilat i përngjasojnë atij që thotë: unë dyshoj në ekzistencën time dhe në perceptimet e mia prezente!!

Kurse sekreti në pagabueshmërinë e profetëve në fushën e kryerjes së detyrave Hyjnore, dhe prej tyre përmbushja dhe predikimi i mesazhit të Zotit tek njerëzit, kjo kërkon hyrjen e mëposhtëme:

Veprat njerëzore plotësohen kur në brendësi të njeriut arrihet prirja për diçka që e tërheq. Kjo prirje lëviz si rezultat i faktorëve dhe ndikimeve të ndryshme. Njeriu e përcakton rrugën e arritjes në qëllimin e tij me ndihmën e dijeve dhe perceptimeve të ndryshme. Pastaj kryen veprën e përshtatshme me atë qëllim. Në qoftë se gjenden dëshira dhe prirje që kundërshtojnë njëra-tjetrën, atëherë njeriu përpiqet brenda të gjitha mundësive, që të përcaktojë më të mirën dhe atë që ka vlerën dhe rëndësinë më të madhe dhe e përzgjedh në praktikë. Por nganjëherë, si rezultat i mangësisë së dijes dhe njohjes së tij, ai gabon në vlerësimin e më të mirës dhe në përcaktimin e saj. Ose nga pavëmëndshmëria e tij ndaj të së

3. Në Kur'anin famëlartë thuhet: ***"Zemra (****e Muhamedit****) nuk gënjen për atë që ka parë."*** (Sure "En-Nexhm", ajeti 11)

mirës ose si rezultat i të mësuarit të tij me të keqen, gabon në përzgjedhje. Atij nuk i mbetet vend për mendim të drejtë dhe zgjedhje të mirë.

Pra, sa më shumë të jetë i njohur njeriu me të vërtetat dhe sa më i vëmendshëm, i palëkundur ndaj tyre; dhe sa më i fortë të jetë vullneti ndaj disiplinimit të prirjeve dhe reagimeve të brendshme, ai do të jetë më i miri në përzgjedhjen e tij dhe do të jetë më shumë i mbrojtur nga devijimet dhe gjynahet.

Nga këtu, disa njerëz të aftë që posedojnë aftësi të larta të cilëve iu ofrua kultura e duhur dhe vetëdija e domosdoshme dhe u mirësuan me edukim të drejtë, këta do të arrijnë në fazat e ndryshme të përsosurisë dhe përparësisë. Ndoshta mund t'i afrohen kufirit të pagabueshmërisë. Atyre as që u shkon ë mendje të kryejnë gjynah apo vepër të keqe. Po ashtu asnjë njeri i logjikshëm nuk nuk mendon të pijë helm apo diçka tjetër vdekjeprurëse apo të hajë pisllëqe e ndytësira.

Pra, po të supozojmë se një njeri arrin kulmin në aftësitë e tij për perceptimin e të vërtetave, për ngritjen e pastërtisë shpirtërore dhe të zemrës së tij në gradat dhe shkallët më të larta - dhe siç e përshkruan Kur'ani Famëlartë: **"...vaji i saj shkëlqen edhe pa e prekur zjarri..."** – dhe për shkak të kësaj përgatitjeje të fortë dhe kësaj pastërtie vetjake, e merr përsipër Edukimi Hyjnor dhe nxitjes së tij me frymën e shenjtë. Atëherë, ky person do të ngjisë shkallët e përsosjes me shpejtësi të papërshkrueshme. Ndoshta mund të përshkojë në një natë një rrugë që nuk mund ta përshkojë në njëqind vjet. Ndoshta, është iferior ndaj të tjerëve që në periudhën fëmijërisë së tij apo kur ka qenë embroin. Për këtë lloj njeriu, dëmi i mëkateve është bnjësoj si dëmi i helmit. Ashtu sikurse largimi i njerëzve të zakonshëm nga këto vepra vrasëse dhe të ulëta, nuk është me detyrim, edhe largimi i të pagabueshmit nga gjynahu gjithashtu nuk e kundërshton përzgjedhjen e tij.

Pyetje:

1. Përmend argumentet logjikë mbi pagabueshmërinë e profetëve.
2. Cilat janë ajetet kur'anore të cilat tregojnë për pagabueshmërinë e profetëve?
3. Cili është sekreti në ruajtjen e profetëve nga gabimet në marrjen e Revelatës?
4. Si përshtatet pagabueshmëria e profetëve nga gjynahet me liritë e tyre në përzgjedhje?

Leksioni i njëzetegjashtë

KEQKUPTIME DHE SQARIME

Trajtimi i disa keqkuptimeve

Janë hedhur disa keqkuptime rreth pagabueshmërisë së profetëve (*paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), të cilat do t'i paraqesim dhe do t'u përgjigjemi:

Keqkuptimi i parë: Nëse Allahu i Madhëruar është Ai i cili i mbron profetët nga gabime dhe i pastron ata nga kryerja e gjynaheve, kjo nënkupton se u ka siguruar atyre veprimin e çdo detyre dhe obligimi. Atëherë, kjo bën që atyre nuk u vërtetohet veçoria e përzgjedhjes. Ata nuk meritojnë asnjë shpërblim për detyrat që kryejnë dhe për largimin nga gjynahet sepse,nëse Allahu i Madhëruar do të bënte një tjetër person të pagabueshëm atëherë do të ishte si plotësisht si profetët.

Përgjigja rreth këtij keqkuptimi të përmendur sqarohet dukethënë në formë përmbledhëse se pagabueshmëri nuk do të thotë detyrim në kryerjen e detyrave, obligimeve dhe largimin nga gjynahet, ashtu siç u tha edhe në mësimin e kaluar. Kur themi se Allahu i ruan të pagabueshmit qëtë mos gabojnë, nuk nënkuptojmë mohimin e atribuimit të përzgjedhjes në veprat e tyre sepse çdo dukuri, edhe pse në përfundim i atribuohet Vullnetit krijues Hyjnor, siç e sqaruam edhe në studimin tonë rreth Njësimit. Në këtë fushë kemi mbrojtje dhe ruajtje të veçantë nga Allahu. Për këtë, vërtetohet edhe më shumë atribuimi i veprave Allahut, por Vullneti hyjnor është përgjatë vullnetit njerëzor dhe jo për së gjëri. Vullneti i njeriut nuk është zëvendës i Vullnetit Hyjnor.

Gjithë kjo përkujdesje hyjnore, veçanërisht sa i përket

të pagabueshmëve, është e njëllojtë si kushtet, mundësitë dhe rrethanat e veçanta të cilat i ofrohen disa personave të caktuar të cilat bëjnë që përgjegjësia e tyre të jetë më e madhe dhe më e rëndë. Në të tilla raste shpërblimi i tyre për punën e bërë është i shumëfishtë ashtu sikurse edhe ndëshkimi i tyre për kundërshtim është më i rëndë. Në këtë formë bëhet edhe balancimi ndërmjet shpërblimit dhe ndëshkimit. Në qoftë se do të jetë e pamundur përzgjedhja e tij për shkak të mbrojtjes hyjnore atëherë nuk do ta meritonte ndëshkimin. Ky balancim vihet re në rastin e të gjithë atyre që gëzojnë mirësinë e kësaj veçorie. Ashtu si është rasti i gjithë dijetarëve dhe atyre që pasojnë Ehli Bejti (*paqja qoftë mbi ta!*).[1] Përgjegjësia e tyre është më e madhe dhe më e rrezikshme se përgjegjësia e të tjerët. Ashtu sikurse shpërblimi i veprave të tyre është më i madh se i veprave të të tjerëve, gjithashtu ndëshkimi i gjynaheve të tyre është më i madh.[2]

Keqkuptimi i dytë: Profetët dhe gjithë të pagabueshmit e konsiderojnë veten e tyre si pjesë të atyre që bëjnë gabime, siç shihet në lutjet dhe përgjërimet e tyre të transmetuara. Gjithashtu,është përcjellë edhe kërkimi i faljes për gjynahet e bëra. Me vertetimin dhe pranimin e këtij pohimi nga ana e tyre, si mundemi t'i llogaritim prej të pagabueshmëve?

Përgjigje: Me të vertetë të pagabueshmit janë ngritur në gradat më të larta të përsosjes dhe afërsisë hyjnore, duke marrë parasysh edhe ndryshimin e gradave të tyre. Ata e ndiejnë se janë ngarkuar me detyra të rëndësishme që janë shumë lart detyrave të cilat u janë ngarkuar të tjerëve. Duke konsideruar çdo drejtim dhe devijim larg të adhuruarit dhe të dashurit të tyre si gjynah të madh, prej këtu ata marrin qëndrim pendues dhe kërkuesi falje. Më sipër përmendëm se i pagabueshmi nuk nënkupton se është i pastër nga të gjitha veprat që zakonisht në zhargonin e përditshëm quhen "gabime", por

1. Në Kur'anin famëlartë thuhet: **"O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera..."** (Sure El-Ahzab, ajeti 32)

2. Në transmetimin vijues thuhet: *"Injorantit i falen 70 gjynahe para se t'i falet dijetarit një gjynah i vetëm."*

nënkupton pastërtinë e tij nga të gjitha kundërshtimet e detyrave që i janë ngarkuar, si dhe nga kryerjen e të ndaluarave në Jurisprudencë.

Keqkuptimi i tretë: Shumë ajete kur'anore e kanë përmendur pagabueshmërinë e profetëve duke i konsideruar ata (mukhlasin). Shejtani e ka të pamundur që t'u afrohet, megjithëse vetë Kur'ani famëlartë ka përmendur disa veprime dhe ndikime të shejtanit mbi profetët (*paqja qoftë mbi ta!*). Ashtu si është përmendur në ajetin 27 të sures El-A'raf: **"O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrsesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xheneti...",** ku mashtrimi i Ademit dhe Havanë i atribuohet shejtanit, gjë që çoi në daljen e tyre nga xheneti.

Në ajetin 41 të sures Sad, për Ejubin (*paqja qoftë mbi të!*) thuhet: **"...kur iu lut Zotit të vet: "Me të vërtetë, më ka goditur djalli me mundim dhe vuajtje!"**

Në ajetin 52 të sures El-Haxhxh thuhet: **"Ne nuk kemi sjellë para teje (**o Muhamed**) asnjë të dërguar e asnjë profet që djalli të mos i ndërhynte në leximin e tij (***nga shpallja***). Por Allahu e zhdukte ndërhyrjen e djallit dhe më pas i forconte shpalljet e Veta. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."** Kështu u mvishet një vesvesdjallëzor të gjithë profetëve.

Përgjigje: Në asnjë nga ajetet nuk vërehet ndonjë veprim ose ndikim djallëzor që të na tregojë kundërshtinë e profetëve (*paqja qoftë mbi ta!*) ndaj detyrave të obligueshme. Ndërsa, ajeti 27 i sures El-A'raf tregon vesveset e shejtanit ndaj Ademit dhe Havasë për të ngrënë nga pema e ndaluar. Ai nuk lidhet me "mohimin e ndaluar të ngrënies" (nehjun tehrimij bil ekli), por vetëm transmetohet përkujtimi i Ademit e Havasë si dhe paralajmërmi që u bëhet atyre se duke ngrënë nga pema do të dalin nga Xhenneti dhe do të zbresin në tokë. Vesveset e shejtanit shkaktuan kundërshtinë e tyre të këtij mohimi udhëzues (nehjun irshadij). Vihet re se ajo botë nuk ka qënë një botë obligimesh dhe akoma nuk kishte zbritur sheriat. Kurse ajeti 41 i sures Sad tregon për mundimet dhe sfidat me të cilat

u përball Ejubi, (*paqja qoftë mbi të!*), nga ana e shejtanit. Në të nuk ekziston asnjë argument mbi kundërshtimin e urdhrave dhe ndalimeve hyjnore nga ana e tij. Ndërsa ajeti 52 i sures El-Haxhxh ka lidhje me pengesat e shejtanit me të cilat përballet me thirrjen e profetëve, (*paqja qoftë mbi ta!*), gjatë veprimtarisë së tyre. Po ashtu ka lidhje edhe me pengesat që vendos në rrugën e arritjes së qëllimit të tyre në fushën e udhëzimit të njerëzve. Si përfundim Allahu i Madhëruar i prish dinakëritë dhe dredhitë e shejtanëve dhe vërteton fenë e vërtetë.

Keqkuptimi i katërt: Në ajetin 121 të sures Taha "kundërshtim" i atribuohet Ademit, (*paqja qoftë mbi të!*), ndërsa në ajetin 115 të po të njëjtës sure atij i atribuohet harresa. Si përshtatet pagabueshmëria e tij me këto atribuime?

Përgjigjja ndaj këtij keqkuptimi: Më sipër u sqarua dhe u mësua se kundërshtimi dhe harresa nuk kanë lidhje me obligueshmërinë e detyrueshme (teklijfun ilzamij).

Keqkuptimi i pestë: Kur'ani famëlartë i atribuon gënjeshtrën disa profetëve. Ajetet që e tregojnë këtë janë p.sh. ajeti 89 i sures Es-Saffat ku përmendet thënia e Ibrahimi, (*paqja qoftë mbi të!*): **"E tha: 'Unë jam i sëmurë!"** Në të vërtetë ai nuk ishte i sëmurë.

Në ajetin 63 të sures El-Enbija gjithashtu përmendet thënia e tij: **"Ai tha: 'Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre…"** Në të vërtetë ishte ai i cili i shkatërroi idhujt e tyre.

Ajeti 70 i sures Jusuf thotë: **"...e pastaj një lajmëtar thirri: 'O karvan, ju jeni vjedhës të vërtetë!"** Dihet që vëllezërit e Jusufit nuk ishin ata që e kishin kryer vjedhjen.

Përgjigje: Këto shprehje janë përdorur si perifraza (kur dëshiron për të nënkuptuar diçka tjetër), për shkak të disa interesave shumë më të rëndësishme, ashtu si është shpjeguar edhe në disa transmetime. Në disa ajete është treguar se këto shprehje janë me inspirim Hyjnor. Ashtu si tregohet në historinë e Jusufit **"Kështu i bëmë të mundur Jusufit"**. Pra, kjo gënjeshtër nuk konsiderohet mëkat dhe nuk bie në kundërshtim me pagabueshmërinë.

Keqkuptimi i gjashtë: Është transmetuar në historinë e Musait, (*paqja qoftë mbi të!*), se kur një banor egjiptian kopt po zihej me një burrë nga beni Israil, Musai, (*paqja qoftë mbi të!*), e vrau atë. Për këtë shkak ai u largua nga Egjipti. Kur Allahu i Madhëruar e dërgoi të thërriste Faraonin në fe, ai tha: **"Unë jam edhe përgjegjës ndaj tyre për një krim, andaj kam frikë se do të më vrasin."**[3] Kur Faraoni ia përmendi vrasjen Musai iu përgjigj: **"Musai tha: 'E kam bërë atë, kur nuk kam qenë i udhëzuar."**

Si përshtatet shembulli i kësaj historie me pagabueshmërinë e profetëve para marrjes së Revelatës?

Përgjigje:

E para: Vrasja e koptit nuk ishte e qëllimshme, por si rezultat i goditjes sepse Musai nuk kishte për qëllim ta vriste atë.

E dyta: Ajeti **"dhe tek ata kam një gjynah",** i cili është transmetuar me gjuhën e Musait, është sipas këndvështrimit të faraonitëve. Kuptimi i kësaj është se ata më konsiderojnë vrasës dhe frikësohem se mos më vrasin si ndëshkim.

E treta: Fjalia **"unë isha nga të humburit":** Ose është thënë në formë figurative para faraonit që edhe mund të isha i tillë, por më udhëzoi Allahu dhe më dërgoi me këto argumente të prera. Ose qëllimi me "i humbur" është mosnjohja e përfundimit të veprave. Në çdo rast ajo nuk tregon kundërshtim të obligimeve të domosdoshëm hyjnor nga ana e Musait.

Keqkuptimi i shtatë: Në ajetin 94 të sures Junus Allahu i Madhëruar i thotë Profetit (*paqja qoftë mbi të!*): **"Nëse ti (*Muhamed)* je në mëdyshje për atë që të kemi shpallur ty, pyeti ata që kanë lexuar Shkrimet para teje. Pa dyshim, ty të ka ardhur e Vërteta nga Zoti yt, prandaj mos u bëj kurrsesi nga ata që dyshojnë."**

Në ajetin 147 të sures El-Bekare, ajetin 60 të sures Ali Imran, ajetin 114 të sures El-En'am, ajetin 17 të sures Hud,

3. Sure "Esh-Shu'ara", ajeti 14.

ajetin 23 të sures Es-Sexhde e ndalon Allahu i Madhëruar Profetin, (*paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen tij!*) nga dyshimi dhe mëdyshja. Si mundemi të themi se njohja e Revelatës nuk pranon dyshim dhe mëdyshje?

Përgjigjja ndaj këtij keqkuptimi: Këto ajete nuk tregojnë se Profeti ka patur dyshime ose mëdyshje reale, por në kontekstin e përforcimit të kësaj vërejtjeje themi se nuk ka patur dyshim apo mëdyshje në mesazhin e tij, Kur'anin famëlartë dhe përmbajtjen e së vërtetës. Qëllimi i kësaj thënie është (ty të drejtohem por dëgjo o fqinje.

Keqkuptimi i tetë: Në Kur'anin Famëlartë janë përmendur disa gjynahe të profetit (*paqja qoftë mbi të!*), dhe të cilat i ka falur Allahu. Në Kur'anin famëlartë thuhet: **"për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë."**[4]

Përgjigje: Qëllimi i termit gjynah në ajetin famëlartë është: Gjynahu të cilat ndërmorën jobesimtarët kundrejt Profetit (*paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen tij!*) para dhe pas emigrimit (*hixhra*). Ai ishte poshtërimi që u bëri idhujve dhe zotave të tyre. Ndërsa qëllimi i faljes është: përballja me ndikimet që mund të kishte dhe largimi i tyre. Dëshmues më i mirë për këtë shpjegim se çlirimi i qytetit të Mekës, u konsiderua shkak për faljen e tij. Thotë Allahu i Madhëruar: **"Ne të dhamë ty një fitore të qartë, për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë.**

Në qoftë se do të ishte qëllimi në kuptimin teminologjik të termit "gjynah" atëherë nuk do të ishte e nëvojshme të falej në hapjen e Mekës.

Keqkuptimi i nëntë: Në Kur'anin famëlartë flitet për martesën e Profetit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me ish-gruan e Zejd ibn Harithes (djalit të tij të birësuar): **"...dhe ti po u frikësohesh njerëzve, kur më**

4. Sure "El-Fet'h", ajeti 2.

e drejtë është t'i frikësohesh Allahut."[5] Si përshtatet ky ajet me pafajësinë?

Përgjigje: Kjo vepër u krye me urdhrin e Allahut. Shkaku ishte që të prishej një zakon nga zakonet e devijuara të injorancës (i birësuari konsiderohej si fëmijë gjaku). Profeti (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i frikësohej përgojimit të njerëzve për shkak të besimit të tyre të dobët, si dhe prirjeve dhe dëshirave personale. Ai frikësohej se kjo do bënte që ata të largoheshin nga feja. Allahu i Madhëruar nëpërmjet këtij ajeti famëlartë i ka treguar se interesi për prishjen e këtij zakoni të devijuar është më i rëndësishëm dhe më e rëndësishme për të ishte që t'i frikësohej më shumë kundërshtimit të Vullnetit hyjnor, i Cili kërkonte nga Profeti që ta luftonte në mënyrë konkrete këtë zakon të gabuar. Pra, ky ajet ka zbritur në këtë kontekst dhe jo në kontekstin e qortimit të Profetit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Keqkuptimi i dhjetë: Në Kur'anin famëlartë Profeti (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qortohet në disa vende të. Ndër: Në kohën që Profeti i lejoi disa persona që të mos e vazhdonin luftën e të largoheshin. Thuhet në Kur'an: **"Allahu të fal ty që u lejove atyre (***të mungojnë***)... "**[6]

Përmendim, gjithashtu, ndalimin e disa gjërave të lejuara për shkak të kënaqësive të grave të tij: **"O Profet! Përse po ia ndalon vetes atë që ta ka lejuar Allahu, duke kërkuar t'u bësh qejfin grave të tua?!..."**[7]

Si mundet të qëndrojnë këto qortime në të njëjtën linjë me pagabueshmërinë e tij?

Përgjigje: Në të vërtetë këto ajete janë lavdërime në formën e qortimit. Këto tregojnë shkallën e lartë të dashurisë dhe mëshirës që ka poseduar zemra e profetit, aqsa arrinte edhe për hipokritët dhe zemrat e sëmura. Ai nuk ua preu

5. Sure "El-Ahzab", ajeti 37.
6. Sure "Et-Teube", ajeti 43.
7. Sure "Et-Tahrim", ajeti 1.

shpresat dhe nuk i zbuloi të fshehtat e tyre.

Gjithashtu kur ai vuri kënaqësitë e grave të tij para dëshirave të tij, vetëm se ndaloi një të drejtë që i përkiste atij. Kjo nuk do të thotë (Zoti na faltë!) se është përpjekur të ndryshonte ligjet e Allahut, të ndalonte hallallin te njerëzit. Në realitet, këto ajete në njërën anë tregojnë përpjekjet e mëdha të Profetit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe kujdesin e tij të lartë për të udhëzuar jobesimtarët. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin famëlartë:

"A mos vallë ti *(o Muhamed)* **do ta shkatërrosh veten, ngaqë ata (**banorët e Mekës**) nuk duan të besojnë?"**[8]

Gjithashtu ajetet që tregojnë përpjekjet dhe punën e palodhur në rrugën e adhurimit të Allahut, për shembull **"Tâ, Hâ. Ne nuk ta kemi shpallur Kur'anin ty (***o Muhamed***), për të të munduar."**[9]

Sidoqoftë asnjë nga këto ajete nuk e kundërshton pagabueshmërinë e Profetit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

8. Sure "Esh-Shu'ara", ajeti 3.
9. Sure "Taha", ajetet 1-2.

Pyetje:

1. Cila është veçoria përzgjedhëse e të pagabueshmit ndaj të tjerëve? Çfarë shpërblimi meriton vepra e cila buron nga pagabueshmëria hyjnore?

2. Përse profetët dhe evlijatë e Allahut e konsideronin veten të gabueshëm dhe bënin përgjërim (*tedarru'*) e kërkonin falje (*istigfar*)?

3. Si përshtaten ndikimet e shejtanit tek profetët (*paqja qoftë mbi ta!*) me pagabueshmërinë e tyre?

4. Si përshtaten mosbindja (*'isjan*) dhe harresa (*nisjan*) që i janë atribuar Ademit (*paqja qoftë mbi të!*) në Kur'anin famëlartë me pagabueshmërinë e tij?

5. Në qoftë se të gjithë profetët janë të pagabueshëm, cili është shkaku që profetët Ibrahim dhe Jusuf (*paqja qoftë mbi ta!)* kanë thënë gënjeshtra?

6. Cila është dilema që është ngritur rreth pagabueshmërisë së Musait (*paqja qoftë mbi të!*)? Përmende atë bashkë me përgjigjjen e saj?

7. Në qoftë se perceptimi i Revelatës nuk pranon gabim dhe mëdyshje, atëherë përse e ka ndaluar Allahu i madhëruar Profetin e Tij (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga dyshimi dhe mëdyshja në Mesazhin e tij?

8. Si përshtatet atribuimi i gjynahut Profetit të Islamit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në suren Fet'h me pagabueshmërinë e tij?

9. Përmend dilemën që lidhet me historinë e Zejdit dhe përgjigjjen rreth saj?

10. Cila është dilema që lidhet me qortimin e Profetit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)? Përmende atë dhe përgjigjjen e saj?

Leksioni i njëzeteshtatë

MREKULLIA

Rrugët e vërtetimit të profetësisë

Çështja e tretë bazë në kapitullin e profetësisë është: Si të vërtetojmë tek njerëzit sinqeritetin e thirrjes së profetëve të vërtetë dhe gënjeshtrat e thirrësve të rremë?

Nuk ka dyshim se personi i cili është i humbur dhe kryen gjynahe, të cilat i percepton logjika, nuk mund të jetë i besueshëm e asi vërtetë dhe nuk mund të mbeshtetesh në të për asgjë. Ne mund ta vërtetojmë gënjeshtrën dhe deklarimin e tij si profet, nëse do të kushtëzojmë pagabueshmërinë e profetëve, veçanërisht kur pretenduesi thërret në çështje që bien në kundërshtim me logjikën dhe natyrshmërinë njerëzore, ose bien në kundërshtim fjalët me veprat e tij.

Në qoftë se do ta shohim në një tjetër këndvështrim, ndoshta jeta e tij e mëhershme, e cila mund të ketë qenë e pastër dhe morali i tij i mirë, bëjnë që tek njerëzit vlerësues të arrihet bindja dhe vërtetësia ndaj tij. Kjo veçanërisht kur logjika e shëndetshme dëshmon përmbajtjen e thirrjes së tij. Gjithashtu, ne mund të vërtetojmë profetësinë e një personi nëpërmjet përgëzimit të një profeti tjetër, i cili lajmëron për të dhe sjell të dhëna rreth tij duke e përshkruar atë. Kështu që nuk mbetet asnjë dyshim apo mëdyshje tek studjuesit mbi të vërtetën e atij profeti.

Por, Nëse njerëzve nuk u ofrohen fakte, argumente dhe dëshmi që t'i qetësojnë, si dhe nuk arrin tek ata përgëzimi i profetit tjetër, atëherë nevojitet ekzistenca e një tjetër rruge për të vërtetuar profetësinë. Allahu i Madhëruar me urtësinë e Tij e hapi këtë rrugë duke i shoqëruar profetët me mrekulli, të cilat

janë shenja dhe fakte që tregojnë sinqeritetin e thirrjes së tyre. Ky është edhe shkaku që mrekullitë u quajtën "Argumente" (*ajat*).[1]

Përfundimi: Është i mundur vërtetimi i sinqeritetit të profetëve të vërtetë dhe thirrjes së tyre, nëpërmjet tre rrugëve:

• Rruga e fakteve, treguesve dhe dëshmive që të drejtojnë në qetësi. Për shembull sinqeriteti, besueshmëria, rruga e drejtë, mosdevijimi nga rruga e drejtë, drejtësia gjatë gjithë jetës etj. Kjo rrugë realizohet vetëm nga profetë të cilët kanë jetuar vite të gjata ndërmjet njerëzve dhe jeta e tyre ka qënë e njohur tek ata. Ndërsa profetit, të cilit i ka zbritur Revelata në fillimet e rinisë së tij dhe para se njerëzit të njiheshin me personalitetin dhe moralin e tij, nuk mund të njihet vërtetësia e thirrjes së tij dhe sinqeritetin e kësaj rruge nëpërmjet treguesve dhe argumenteve.

• Ta njohë dhe të lajmërojë ardhje e tij profeti i mëparshëm ose bashkohor. Kjo rrugë gjithashtu realizohet nëpërmjet njerëzve të cilët e njohin profetin e parë. Ata u përgëzuan nga profeti i parë dhe e mbështetën atë. Natyrisht që kjo rrugë nuk është e nevojshme edhe për profetin e parë.

• Rruga e shfaqjes së mrekullive, të cilat mund të kenë ndikim të gjerë dhe gjithëpërfshirës. Ne do të mundohemi të studiojmë këtë rrugë.

Përkufizimi i mrekullisë

Mrekullia konsiderohet një çështje e jashtëzakonshme, e cila shfaqet nga pretenduesi i profetësisë me dëshirën e Allahun për të qënë argument i sinqeritetit të pretenduesit.

Vihet re në këtë përkufizim se përmbledh tre shtyllat e mëposhtme:

1. Ekzistenca e disa dukurive të jashtëzakonshme, të cilat

1. Termi "argumente" është përdorur edhe në të dhëna të tjera, ndër të cilat përmendim Diturinë, Mundësinë, Urtësinë Hyjnore në dukuritë e ekzistencës qofshin ato të zakonshme apo të pazakonshme.

nuk mund të realizohen nëpërmjet kushteve të zakonshme.

2. Shfaqja e disa çështjeve të jashtëzakonshme nga profetët me Vullnetin hyjnor dhe me leje të veçantë nga Allahu i Madhëruar.

3. Ajo çështje e jashtëzakonshme mund të jetë argument për sinqeritetin e thirrjes së profetit. Në këtë rast thirret me termin *mrekulli*.

Më poshtë do të përpiqemi që të sqarojmë këto tre shtylla të cilat i përmbledh ky përkufizim.

Çështje që ndodhin jashtë të zakonshmes

Dukuritë qiellore zakonisht ndodhin si rezultat i shkaqeve të cilat ne mund t'i njohim nëpërmjet provave të ndryshme. Si për shembull dukuritë fizike, kimike, biologjike dhe psikologjike. Ka edhe raste të veçanta ku realizohen këto dukuri në një formë tjetër. Ne nuk mund të njihemi me të gjitha shkaqet nëpërmjet provave të prekshme.

Janë disa fakte që tregojnë mbi ekzistencën e faktorëve të një lloji tjetër që ndikojnë në formimin e këtyre dukurive siçjanë veprat e çuditshme dhe mbresëlënëse që i veprojnë disa ushtrues dhe i dëshmojnë ekspertët dhe profesionistët në shkencat e ndryshme duke thënë se këto lloj veprash është e pamundur që të realizohen duke u bazuar në rregullat e njohurive materiale dhe provuese. Këto çështje thirren (çështje të jashtëzakonshme).

E jashtëzakonshmja hyjnore

Përgjithësisht ne mund t'i ndajmë çështjet e jashtëzakonshme në dy grupe:

I pari: Çështje të cilat nuk i kanë shkaqet e tyre të zakonshme, por shkaqet e tyre janë jo të zakonshme na vlerësimi i njerëzve dhe jashtë përzgjedhjes së tyre. Tek ato

shkaqe mund të arrihet nëpërmjet disa ushtrimeve, leksioneve dhe mësimeve të veçanta. Psh veprat e ushtruesve.

I dyti: Veprat e jashtëzakonshme të cilat nuk mund të plotësohen vetëm me Leje të veçantë Hyjnore. Këto vepra nuk mund të jenë në duart e personave që nuk kanë asnjë lidhje me Allahun e Madhëruar. Nga këtu ato vepra kanë dy veçori.

• E para: Nuk pranojnë të studiohen dhe t'u studiohen.

• E dyta: Nuk i nënshtrohen ndikimit të asnjë fuqie tjetër të lartë dhe të fuqishme se ajo vepër dhe asnë faktor tjetë r nuk arrin ta mposhtë atë vepër të jashtëzakonshme.

Shembulli i këtyre çështjeve jo të zakonshme është i veçantë për robtë e zgjedhur të Allahut. Ato mrekulli nuk mund të bien në duart e njerëzve të humbur, por ato janë veçori e profetëve. Ndoshta mund të jenë furnizuar me to edhe disa evlija.

Ky është edhe shkaku që të gjitha këto përmblidhen në termin teologjik me "Mrekulli". Në rastin e ndodhjes së këtyre çështje jo tek profetët thirren (keramete). Dijet hyjnore jo të zakonshme nuk veçohen (me revelatën profetike). Kur pajisen me këto këto dije disa njerëz thirren (Inspirim, frymëzim).

Nëpërmjet kësaj u njohëm me rrugën e dijes së këtyre llojeve jo të zakonshme (hyjnore dhe jo hyjnore). Nëse e jashtëzakonshmja e pranon studimin apo të studjuarit, ose mundet ndonjë faktor tjetër të ndalojë realizimin apo vazhdimin e saj, apo prishjen e ndikimit të saj, kjo vepër nuk mundet të jetë e jashtëzakonshme Hyjnore, ajo mundet të konsiderohet humbje e personit si dhe prishje e besimit, moralit dhe treguesëve të tjerë dhe marrëdhëniet me Allahun e Madhëruar, dhe qënia e veprave djallëzore.

Duke vërjetur një tjeter aspekt ne mundemi të konsiderojmë se Allahu është Vepruesi i këtyre veprave hyjnore të jashtëzakonshme (duke shtuar këtu Veprueshmërinë e Tij në raport me çdo krijesë, prej tyre edhe dukuritë të zakonshme).

Këto realizohen me leje të veçantë nga i Madhëruari.[2]

2. Sure "Er-Ra'd", ajeti 27 dhe sure "Gafir", ajeti 78.

Gjithashtu, ne mund t'ua atribuojmë edhe ndërmjetësve, si për shembull engjëjt dhe profetët me rolin e tyre si ndërmjetës apo veprues. Kur'ani Famëlartë i adreson Isait (*paqja qoftë mbi të!*), ngjalljen e të vdekurve, shërimin e të sëmurëve, krijimin e zogut[3] dhe nuk ka kundërshti ndërmjet tyre, sepse veprimi i Allahut është përgjatë veprimit të robëve.

Veçoritë e mrekullive profetike

Elementi i tretë në përkufizimin e mrekullisë është se: Mrekullitë e profetëve janë fakte dhe argumente i sinqeritetit të thirrjes së tyre. Në teologji thirren me termin (mrekulli) rreth çështjeve jo të zakonshme. Në kohën që del argumenti mbi profetësinë e profetit, duke shtuar atribuimin e tij te leja e veçantë hyjnore e veçantë me pak përgjithësim dhe zgjerim në kuptimin e përgjithshëm, ai argument fakton sinqeritetin e thirrjes së imamëve dhe thirren me termin (keramete) të cilat burojnë nga evlijatë e Allahut dhe ndodhen përballë jotëzakonshmeve të cilat burojnë nga fuqitë djallëzore, si magjitë dhe fallet. Shembulli i këtyre veprave përballet me studimin dhe të studiuarit. Gjithashtu mund t'i nënshtrohen fuqisë më të lartë dhe më të fuqishme. Zakonisht nuk mund të vërtetohet atribuimi i tyre te Allahu nëpërmjet rrugës së njerëzve të këqinj, me moralit të ulët dhe jobesimtarë.

Ajo që duhet theksuar këtu është se mrekullitë e profetëve vërtetohen në formë të menjëhershme ashtu si dhe sinqeriteti i thirrjes së tyre. Sa i përket vërtetësisë së përmbajtjes së mesazhit dhe domosdoshmërisë së nënshtrimit të mësimeve dhe urdhrave të cilat mbërrinin, ato vërtetohen në rrugë jo të drejtpërdrejtë. Thënë ndryshe: Vërtetohet revelata e profetëve (*paqja qoftë mbi ta!*) me argumente logjike, ndërsa përmbajtja e mesazhit të tyre vërtetohet me argumente adhurimore (tekstuale).[4]

Pyetjet:

1. Cilat janë rrugët nëpërmjet të cilave mund të njihemi me

3. Sure "Ali Imran", ajeti 49 dhe sure "El-Maide", ajeti 110.

4. Shih leksionin e katërt nga pjesa e parë dhe leksionin e njëzetenjë të këtij libri.

profetët e vërtetë? Kush është dallimi ndërmjet këtyre rrugëve?
2. Cilat janë argumentet mbi përgënjeshtrimin e thirrësve të rremë?
3. Përkufizo mrekullinë.
4. Cilat janë çështjet jashtëzakonshmes?
5. Cili është ndryshimi ndërmjet jo të zakonshmes hyjnore dhe jo të zakonshmes jo hyjnore?
6. Përmend rrugët për njohjen e jo të zakonshmes hyjnore.
7. Cilat janë veçoritë me të cilat dallohen mrekullitë e profetëve mbi gjithë çështjet jo të zakonshme hyjnore?
8. Sqaro termat mrekulli dhe keramet.
9. A është mrekullia një vepër që i atribuohet Allahut apo Profetit?
10. A është mrekullia argument mbi sinqeritetin e profetit apo vërtetim i përmbajtjes së Mesazhit?

Leksioni i njëzetetetë

KEQKUPTIME DHE SQARIME

Trajtimi i disa keqkuptimeve

Janë ngritur disa keqkuptime rreth çështjes së mrekullisë. Më poshtë do t'i paraqesim dhe do t'u përgjigjemi:

Keqkuptimi i parë: Çdo dukuri materiale ka një të veçantë. Mund të njihemi me të nëpërmjet provave dhe eksperimenteve shkencore. Mosnjohja me shkakun e dukshëm është si rezultat i mungesës së mjeteve të duhura për të kryer provën. Kjo nuk mund të konsiderohet argument për mosekzistencën e një shkaku të zakonshëm për atë dukuri. Nga këtu, mund të pranohet një çështje e vetme në dukuritë e jashtëzakonshme që është se: dukuria e jashtëzakonshme u gjet për shkak të faktorëve të fshehtë dhe të panjohur sipas gjithë përcaktimeve. E konsiderojmë njohjen e shkaqeve në atë kohë, në të cilën nuk njihej akoma, mrekulli. Ndërsa, të mohojmë ekzistencën e shkaqeve, të cilat mund të zbulohen dhe të njihen nëpërmjet eksperimenteve shkencore, kjo do të thotë mohim i parimit të shkakësisë, dhe kjo është e pavlefshme.

Përgjigje: Parimi i shkakësisë do të thotë se çdo ekzistencë është e lidhur me një shkak. Por ky parim nuk obligon që të jetë çdo shkak i aftë për njohje dhe zbulim nëpërmjet eksperimenteve shkencore. Nuk ekziston asnjë argument për këtë sepse, fusha e eksperimenteve shkencore dhe hapësira e saj është e kufizuar me çështjet natyrore. Është e pamundur të vërtetohet nëpërmjet mjeteve dhe paisjeve laboratorike ekzistenca e çështjeve metafizike apo të bëhet mohimi i tyre, apo të vërtetohet mosndikimi i tyre.

Ndërsa shpjegimi i mrekullisë me njohjen e shkaqeve të

panjohura është i pasaktë. Kjo sepse, nëse kjo njohje arrihet nëpërmjet rrugës së shkaqeve dhe faktorëve të zakonshëm, atëherë nuk ka ndonjë dallim ndërmjet saj dhe ndërmjet gjithë dukurive të zakonshme dhe nuk mund të konsiderhet në asnjë mënyrë si çështje e jashtëzakonshme. Ndërsa, po të arrihet njohuria e përmendur në formë jo të zakonshme, ajo, edhe po të jetë e jashtëzakonshme dhe mbështetet te leja e veçantë nga Allahu i Madhëruar dhe ka ardhur si argument mbi vërtetësinë e profetësisë, do të konsiderohet prej pjesëve të mrekullisë (mrekullia shkencore). Ashtu si ishte njohja e Isait, *(paqja qoftë mbi të!)*, mbi atë se çfarë gatuanin dhe hanin njerëzit në shtëpitë e tyre. Kjo është konsideruar prej mrekullive të tij.[1] Por mrekullia nuk mund të kufizohet me këtë lloj dhe të mohohen pjesët e tjera të saj. mundemi të llogaritim mrekullitë sipas ndarjeve (klasifikimeve) dhe as ti mohojmë ato. Së fundi mbetet pyetja për diferencën e kësaj dukurie dhe dukurive të tjera të jashtëzakonshme në marrëdhënien e tyre me parimin e shkakësisë.

Keqkuptimi i dytë: Sipas ligjit të Allahut, zakonisht, çdo dukuri gjendet nëpërmjet një shkaku të posaçëm. Edhe ajetet kur'anore e kanë përmendur këtë: **"E në ligjin Tonë ti nuk gjen ndryshim."**[2] Pra, e jashtëzakonshmja është në pozitën e ndryshimit dhe ndërrimit të zakonit hyjnor, këtë e mohojnë edhe ajetet.

Ky keqkuptim është si paraardhësi i tij, me dallim se i pari u argumentua vetëm me argumente logjikë ndërsa për këtë keqkuptim mbështetja janë ajetet kur'anorë.

Përgjigja: Ky mendim, i cili e konsideron kufizimn e shkaqeve të dukurive në shkaqe të zakonshme prej zakoneve hyjnore të cilat nuk pranojn ndryshim. I tillë mendim nuk ka argument. I ngjashëm me të është pretendimi se kufizimi i shkakut të nxehtësisë te zjarrit është prej ligjeve hyjnore

1. Sure "Ali Imran", ajeti 49.
2. Suret: "El-Isra", ajeti 77; "El-Ahzab", ajeti 62; "Fatir", ajeti 43; "El-Fet'h", ajeti 23.

që nuk pranojnë ndryshim!. Ndaj këtij pretendimi mund të thuhet se shumësia e llojeve të shkaqeve të ndryshme për llojet e pasojave dhe përfytyrimi i shkaqeve jo të zakonshme në vend të shkaqeve të zakonshme, ndodh gjithmonë në botë. Nga këtu, është e domosdoshme të konsiderohen prej ligjeve hyjnore. Kufizimi i shkaqeve me shkaqe të zakonshme konsiderohet ndryshim për to. Këtë e mohojnë ajetet kur'anore famëlartëe.

Si do që të jetë, shpjegimet e ajeteve treguese për mohimin e ndryshimit dhe trasformimit në ligjet hyjnore dhe të mos përfytyrohen në vendin e shkaqeve të zakonshme dhe të menduarit se janë prej nga ligjeve hyjnore që nuk pranon ndryshim, konsiderohet si shpjegim pa argument. Ekzistojnë shumë ajete të tjera që tregojnë për ndodhjen e mrekullive dhe çështjeve jo të zakonshme që qëndrojnë si argument i fortë mbi pavërtetësinë e këtij shpjegimi. Është i rëndësishëm studimi i shpjegimit të tyre të vërtetë në librat e komentimit (*tefsirit*). Këtu po e prekim shkurtimisht duke thënë se: Ky grup i ajeteve e ka për qëllim mohimin e kundërshtimit të të metit nga e meta. Jo sepse ato e mohojnë shumimin e të metave dhe ngritjen e të metës dhe jo të metës jo të zakonshme në vendin e të metës të zakonshme. Ne mundemi të themi se qëllimi i vërtetë nga marrja e këtyre ajeteve është ndikimi i shkaqeve dhe të metave jo të zakonshme.

Keqkuptimi i tretë: Në Kur'anin famëlartë është transmetuar se njerëzit kanë kërkuar disa herë nga Profeti i Islamit, (*paqja qoftë mbi të!*), disa mrekulli. Profeti, nuk e ka bërë një gjë të tillë duke mos ju përgjigjur kështu kërkesës së tyre.[3] Në qoftë se mrekullitë janë një mënyrë për të vërtetuar revelatën, atëherë përse Profeti (*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk ka përfituar nga kjo rrugë për të vërtetuar profetësinë e tij?

Përgjigje: Këto ajete janë të lidhura me kërkesën që kanë

3. Suret: "El-En'am", ajetet 37 dhe 109; "Junus", ajeti 20; "Er-Ra'd", ajeti 7; "El-Enbija", ajeti 5.

bërë ata njerëz me kryenecësi, ose për qëllime të tjera jo për të kërkuar të vërtetën.[4] Para tyre ishin plotësuar të gjitha argumentet dhe ishte vërtetuar profetësia e tij, nëpërmjet tre rrugëve (Argumentet e sinqerta, përgëzimi i profetëve të mëparshëm, shfaqja e mrekullive), si dhe arsyeja tjetër është se urtësia Hyjnore nuk deshi të ju përgjigjej atyre.

Sqarim: Qëllimi i shfaqjes së mrekullive: Ato janë urdhra të përveçëm në rregullin që udhëheq gjithësinë. Nganjëherë janë përgjigje të kërkesave të njerëzve (p.sh. deveja e Salihut (*paqja qoftë mbi të!*), herë tjetër janë jo nga kërkesat e njerëzve (p.sh. mrekullitë e Isait (*paqja qoftë mbi të!*). Është njohja me profetët e Zotit dhe plotësimi i argumentit mbi njerëzit. Mrekullia nuk i obligon dhe as detyron njerëzit që të pranojnë thirrjen e profetëve, si dhe nuk i detyron që të dorëzohen dhe përulen para tyre. Ajo nuk ofron dëshmi të talljes dhe lojës me rregullin e shkaqeve të zakonshme.

Ky qëllim nuk do të thotë t'i përgjigjet çdo dëshire dhe kërkese, por përgjigja nganjëherë është në kundërshtim me urtësinë dhe qëllimin. për shembull kërkesa e disa veprave të cilat e bllokojnë rrugën e përzgjedhjes, si dhe i detyron njerëzit që të pranojnë thirrjen e profetëve (*paqja qoftë mbi ta!*). Apo kërkesa për t'u mbrojtur nga inati, ose kërkesa të tjera që nuk kanë për qëllim studimin e të vërtetës.

Të gjitha këto nga njëra anë do të ulnin rëndësinë e mrekullive për shkak se njerëzit do t'i shikonin ato për të kaluar kohën apo për tu tallur. Ose mund të afroheshin me profetët me qëllim për të realizuar përfitime personale. Ndërsa nga ana tjetër do të dobësohej atmosfera e sprovës, provimit dhe përzgjedhjes së lirë. Njerëzit do t'i ndiqnin profetët jo me dëshirë, të nënshtruar nga ndikimi i faktorëve shtypës dhe të detyruar. Të dyja këto janë në kundërshtim me urtësinë dhe qëllimin e shfaqjes të mbrëkullive.

Përveç këtyre rasteve dhe kur e kërkon urtësia Hyjnore,

4. Suret "El-En'am", ajetet 35 dhe 124; "Es-Saffat", ajeti 14; El-Kamer, ajeti 2; "Esh-Shu'ara", ajetet 4, 5 dhe 197; "El-Isra", ajeti 59; "Er-Rum", ajeti 58.

profetët ju largohen kërkesave të njerëzve, ashtu si mrekullitë e shumta të cilat i janë shfaqur profetit të islamit, dhe shumë prej tyre janë vërtetuar me transmetime. Në ballë të tyre është mrekullia e përjetshme Kur'ani Famëlartë. Në vijim do ta studiojmë këtë pikë.

Keqkuptimi i katërt: Mrekullia është me urdhrin e veçantë të Allahut dhe mundet të jetë argument dhe fakt mbi ekzistencën e lidhjes të veçantë ndërmjet Allahut dhe mbajtësit të mrekullisë. Ajo mund të jetë argument i dhënies së kësaj leje të veçantë për të veçanërisht. Thënë ndryshe: realizimi i veprës së tij me duart e tij dhe nga rruga e dëshirës të tij. Kjo lidhje nuk e detyron logjikën që të jetë lidhja tjetër ndërmjet Allahut të Madhëruar dhe mbajtësit të mrekullisë. Ai është profeti i cili e ka provuar revelatën. Pra, mrekullia nuk mundet të konsiderohet argument logjik mbi vërtetësinë e thirrjes profetike. Ajo që tregon më shumë në këtë fushë është argumenti hipotetik ose vetëm i kënaqshëm.

Përgjigje: Veprat jashtë normales, edhe nëse janë jashtë normales hyjnore, nuk në vetvete tregojnë mbi ekzistencën e marrëdhënies me revelatën. Nga këtu nuk mund të konsiderohen kerametet e Evlijave të Allahut argument i profetësisë së tyre. Ne këtu po flasim për atë person i cili pretendon se është profet dhe e ka shfaqur mrekullinë si argument dhe dëshmi i sinqeritetit të thirrjes së tij. Nëse do të supozojmë se ky person gënjen në pretendimin e profetësisë, kjo do të thotë se ai ka ndërmarrë një gjynah të madh dhe ndërmerr në punën e tij gabimin më të madh në Dynja dhe në Ahiret.[1]

Ky person i tillë asnjëherë nuk mund të ketë lidhje me Allahun e Madhëruar. Urtësia Hyjnore nuk i jep atij mundësi, fuqi dhe mrekulli, me qëllim që të mos jetë shkak i humbjes dhe devijimit të njerëve të tjerë.[2]

1. Suret "El-En'am", ajetet 31, 93 dhe 144; "El-A'raf", ajeti 37; "Junus", ajeti 17; "Hud", ajeti 18; "El-Kehf", ajeti 15; "El-Ankebut", ajeti 68, "Esh-Shura", ajeti 24.
2. Sure "El-Hakka", ajetet 44-46.

Përfundimi: Logjika arsyeton me qartësi se personi i cili e meriton këtë lidhje të veçantë me Allahun e Madhëruar dhe të furnizohet me fuqi dhe t'i shfaqen mrekullitë, është ai person i cili nuk e tradhëton Zotin e tij dhe nuk është shkak për humbjen e robëve dhe për drejtimin e tyre kah vuajtja e tyre e përjetshme.

Pra, shfaqja e mrekullisë është argument i prerë logjik mbi vërtetësinë e thirrjes profetike, si dhe atij që pretëndon profetësinë e sinqertë në thirrjen e tij.

Pyetje:

1. Cila është përmbajtja e parimit të shkakësisë (*mebdeu'l-'il'lije*)? Dhe çfarë rrjedh prej tij?

2. Pse besimi në parimin e të metës nuk e kundërshton parimin e mrekullisë?

3. Përse nuk pranohet shpjegimi i mrekullisë me dijen e të metave të panjohura?

4. Pranimi i mrekullisë a e mohon pranimin e rrugës Hyjnore për ndryshim? Pse?

5. A i shfaqin profetët mrekullitë vetë? Apo ata i shfaqnin si përgjigje të kërkesave të njerëzve?

6. Pse nuk i janë përgjigjur profetët çdo kërkese të njerëzve për mrekulli?

7. Sqaro këtë shprehje: Mrekullia nuk është argument i supozuar vetëm për të kënaqur, por është argument logjik i sinqeritetit të thirrjes profetike.

Leksioni i njëzetenëntë

VEÇORITË E PROFETËVE

Profetët e shumtë

Deri tani kemi studiuar tri çështje bazë nga çështjet e profetësisë dhe arritëm në këtë rezultat, duke vështruar mangësitë e dijes njerëzore për të arritur tek të gjitha të dhënat dhe dituritë ndikuese në lumturinë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër, Urtësia hyjnore obligon caktimin e profetit ose profetëve, të cilëve u mësohen disa të vërteta të domosdoshme që t'ua përcjellin njerëzve në formën e saktë, pa u prekur nga asnjë deformim apo manipulim. Nga ana tjetër, duhet që profetët t'i përcjellin ato të vërteta në atë formë që njerëzve t'u plotësohet argumenti. Rruga më e mirë dhe më gjithëpërfshirëse në këtë aspekt është shfaqja e mrekullisë.

Këto kuptime i kemi vërtetuar me argumente logjikë, por këto argumente nuk tregojnë domosdoshmërinë e ekzistencës së shumë profetëve, librave dhe legjislacioneve qiellorë. Në qoftë se do të supozojmë kushtet e jetës njerëzore në atë formë që një profet mund të sqarojë çdo gjë që kanë nevojë njerëzit deri në fund të botës dhe ku çdo njeri apo bashkësi, përgjatë historisë deri në mbarim të kësaj jete, do të kenë mundësinë të njihen me detyrën e tij nëpërmjet mesazhit të këtij profeti, kjo nuk është aspak në kundërshtim me këtë argument.

Ne e dimë se:

E para: Jeta e njeriut - e çdo njeriu, qoftë ai edhe profet - është e kufizuar dhe e shkurtër. Urtësia e krijimit nuk e lejon qëndrimin e profetit të parë të jetë gjallë deri në fundin e botës, që të ketë mundësi të udhëzojë personalisht të gjithë njerëzit.

E dyta: Pamundësia e bashkimit dhe përngjasimit

të kushteve të jetesës njerëzore në kohërat dhe vendet e ndryshme. Ky ndryshim dhe dallim në kushte, dhe veçanërisht duke vërejtur besimin gradual i cili paraqitet në marrëdhëniet shoqërore, mundet që të ketë ndikim në mënyrën e udhëheqjes, ligjeve shoqërore, cilësinë dhe sasinë e tyre. Ndoshta nganjëherë kjo kërkon vendosjen e rregullave të reja. Në qoftë se do të obligohej sqarimi i të tilla rregullave dhe do të përcilleshin nëpërmjet profetit të dërguar para mijëra vitesh, atëherë ky sqarim dhe predikim do të ishin të kotë. Po ashtu është e vështirë memorizimi dhe praktikimi i tyre në fusha dhe aspekte të caktuara.

E treta: Në shumë nga kohërat dhe epokat e kaluara nuk kishte mjete informacioni. Ishte e pamundur mundësia e përhapjes dhe ofrimit të thirrjes së profetëve në formën e cila do t'i mundësonte një profeti të përhapte mesazhin e tij tek të gjithë njerëzit në botë.

E katërta: Me kalimin e kohës, mësimet profetike mund edhe të devijohen[3] në mesin e një populli për shkak të faktorëve të ndryshëm. Ato edhe mund të arrijnë të shpjegohen në mënyrë të devijuar e të gabuar. Mbase pas një periudhë kohore ato mund të trasformoheshin në një fe të deformuar e të devijuar, siç është edhe rasti me fenë monoteiste të Isait *(paqja qoftë mbi të!)* që u trasformua në fe trinie.

Nëpërmjet këtyre vërejtjeve qartësohet urtësia e dërgimit të shumë profetëve, *(paqja qoftë mbi ta!)*, si dhe ndryshimi i legjislacioneve qiellore rreth disa ligjeve të adhurimit dhe rregullave shoqërore[4] edhe pse i bashkon baza e doktrinave dhe themelet e moralit. Bashkimi në bazat e rregullave personale dhe shoqërore[5], si p.sh., namazi ka qenë obliguar në të gjitha fetë qiellore, edhe pse popujt ndryshojnë në mënyrën e praktikimit dhe rreth kibles nga drejtohen për ta

3. Për t'u njohur më shumë me shembujt e këtyre devijimeve, shih librin e shejh Muhamed Xheuad el-Belagi en-Nexhefiut "*El-Huda ila Dijni'l Mustafa*" (*Udhëzimi në fenë e të Përzgjedhurit*).
4. Sure "El-Maide", ajeti 48; surja "El-Haxh", ajeti 67.
5. Suret: "El-Bekare", ajetet 131-137 dhe 285; sure "Ali Imran", ajetet 19-20.

falur namazin. Po kështu, zekati dhe sadakaja kanë qenë të obliguara në të gjitha legjislacionet edhe pse ndryshojn te sasia dhe llojet nga e cila jepet zekati dhe sadekaja.

Sido që të jetë, çdo njeri duhet të besojë te të gjithë profetët dhe nuk duhet të bëjë dallim ndërmjet tyre. Ai duhet të besojë dhe të vërtetojë profetësinë, mesazhet dhe mësimet që u kanë zbritur[6] pa bërë dallim ndërmjet tyre. Nuk lejohet përgënjeshtrimi i asnjë profeti nga njerëzit. Mohimi i ndonjë ligji nga ligjet e tyre, konsiderohet mohim i të gjitha rregullave të Allahut.[7] Natyrisht, detyra praktike e çdo populli, në çdo kohë, është pasimi i mësimeve praktike të profetit të atij populli dhe të asaj kohe.

Gjëja e cila duhet theksur dhe duhet përforcuar këtu është: Mendja njerëzore, nëpërmjet vëzhgimeve të mëparshme, mundet të arrijë njohjen e Urtësisë e dërgimit të shumë profetëve dhe librave qiellorë, si dhe të njohë ndryshimin ndërmjet legjislacioneve qiellore. Kështu ai mund të gjykojë se në çfarë kohe dhe vend duhet dërguar profet i ri apo sheriat i i ri. Po ashtu, mendja percepton se kur nuk duhet dërguar profet tjetër, sidomos kur rrethanat dhe situata e jetesës së njerëzve është e tillë sa që mund të arrijë mesazhi i profetëve për mbarë njerëzit dhe mesazhi i tij është i saktë dhe i ruajtur i pandryshuar.

Numri i profetëve

Më sipër treguam se mendja nuk e zotëron rrugën e vërtetimit të numrit të profetëve dhe librave qiellorë. Vërtetimi dhe konstatimi i tyre bëhet vetëm nëpërmjet argumenteve të transmetuar. Kur'ani Famëlartë, edhe pse dëshmon se Allahu i Madhëruar ka dërguar tek çdo popull profet,[8] por ai nuk ka përcaktuar numrin e popujve dhe të profetëve të tyre. Ai

6. Suret: "Esh-Shura", ajeti 13; surja "En-Nisa", ajetet 136 dhe 152; surja "Ali Imran", ajetet 84-85.
7. Suret: "En-Nisa", ajeti 150; surja "El-Bekare", ajeti 85.
8. Suret: "Fatir", ajeti 24; "En-Nahl", ajeti 36.

është mjaftuar me përmendjen e emrave të njëzet apo pak më shumë prej profetëve *(paqja qoftë mbi ta!)* duke përmendur historinë e disa prej tyre pa përmendur emrat e tyre.[9] Është transmetuar në disa tregime nga Ehli Bejti i pastër[10] *(paqja qoftë mbi ta!)* se Allahu i Madhëruar ka dërguar njëqind e njëzet e katër mijë profetë. Zinxhiri i profetëve fillon nga Ademi, babai i njerëzimit *(paqja qoftë mbi të!)* dhe përfundon me Muhamedin, i biri e Abdullahut, *(paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Duhet shtuar se emërtimi profet (*en nebij*) për një nga profetët e Allahut, tregon për atë post të veçantë hyjnor. Ata posedojnë cilësi të tjera si paralajmërues, njoftues, përgëzues.[11] Ata konsiderohen nga të pastrit dhe të sinqertët. Disa prej tyre kanë arritur gradën e (mesazhit). Është transmetuar në disa tregime se numri i të dërguarveve të Allahut (er rusul) është treqind e trembëdhjetë.[12]

Për këtë do të studiojmë këtu kuptimin e Profetësisë dhe Mesazhit si dhe dallimin mes "en Nebij" dhe "er Resul".

Profetësia dhe Mesazhi

Termi *resul* nënkupton mbajtësin e mesazhit, ndërsa termi *nebij* në qoftë se e ka prejardhjen nga fjala lajm (*nebe'e*) atëherë *nebij* do të thotë (ai që sjell një lajm të rëndësishëm). Ndërsa, në qoftë se rrjedh nga fjala (nebeue) nënkupton (atë që gëzon një vend të lartë dhe fisnik).

Disa besojnë se kuptimi *Nebij* është më gjithëpërfshirës se kuptimi *Resul*. Kjo ndodh për shkak se Nebij është ai të cilit i zbriti Shpallja nga Allahu, qoftë i urdhëruar që ta përcjellë Shpalljen tek të tjerët ose jo. Kurse, *Resuli* është i urdhëruar që të përcjellë Shpalljen. Mirëpo, ky shpjegim nuk është i saktë

9. Sure "El-Bekare", ajetet 246 dhe 248.
10. Shih librin *"El-I'tikadat"*(*Doktrinat*) e Sadukut dhe librin *"Biharu'l Enuar"*, vëll. 11, f. 28, f. 32 dhe f. 41, tek botimi i ri.
11. Suret: "El-Bekare", ajeti 213; "En-Nisa", ajeti 165.
12. *"Biharu'l Enuar"*, vëll. 11, f. 32 tek botimi i ri.

sepse, disa ajete e kanë përmendur cilësitë e *Nebijit* pas cilësisë së *Resulit*.[13] Sipas shpjegimit të përmendur, duhet që cilësia e cila përmban kuptim të përgjithshëm, e ajo është *Nebij*, të përmendet para cilësisë së veçantë që është *Resul*. Duhet shtuar mosekzistenca e argumentit që veçon urdhrin e përcjelljes së revelatës vetëm për Resul-in.

Është përcjellë në disa transmetime se pozita e profetësisë është që mbartësi i saj të shohë engjëllin e Shpalljes në gjumë dhe vetëm ai e dëgjon zërin e tij kur është i zgjuar, kurse Resuli e shikon engjëllin e Shpalljes edhe kur është i zgjuar.[14]

Ky dallim nuk mund t'i mbartet kuptimit të shprehjes. Sidoqoftë, ajo duhet pranuar është se *Nebij,* për nga vërtetësia dhe jo perceptimi, është më i përgjithshëm nga *er Resul*. Pra, të gjithë Nebijët e posedonin gradën e Profetësisë. Ndërsa pozita e Mesazhit është e veçantë vetëm për një grup prej tyre. Numri i të dërguarve (*rusul*) sipas transmetimit të mësipërm është (treqind e trembëdhjetë). Natyrisht, grada e tyre është më e lartë nga grada e gjithë Nebijëve. Gjithashtu, profetët nuk kanë qënë të barabartë në gradat dhe përparësitë e tyre.[15] Një pjesë e tyre, gjithashtu kanë fituar dhe gradën e (imamatit).[16]

Profetët e Vendosmërisë së Lartë (*Ulul Azmi*)

Kur'ani Famëlartë e konsideron një grup të profetëve se janë të vendosmërisë së lartë,[17] por nuk i ka përcaktuar cilësitë e tyre. Nga transmetimet e Ehli Bejtit *(paqja qoftë mbi ta!)* përfitohet se numri i profetëve të vendosmërisë së lartë është pesë. Sipas renditjes kohore ata janë: Nuhu, Ibrahimi, Musai, Isai dhe Muhamedi, i biri i Abdullahit (*paqja qoftë mbi ta!*).[18] Dallimi me të cilin ata dallohen, në shtesë të durimit

13. Surja "Merjem", ajetet 51 dhe 54.
14. "*Usulu'l Kafij*", vëll. I, f. 176.
15. Suret: "El-Bekare", ajeti 253; "El-Isra", ajeti 55.
16. Suret: "El-Bekare", ajeti 124; "El-Enbija", ajeti 73; "Es-Sexhde", ajeti 24.
17. Surja "El-Ahkaf", ajeti 35.
18. "*Biharu'lEnuar*" (*Detiidritave*), vëll. XI, f. 33-34; "*Me'alimu'n-Nubueh*", f. 113.

dhe palëkundhsmërisë që ata gëzojnë dhe i tregon Kur'ani Famëlartë është se: Çdonjërit prej tyre i ka zbritur libër dhe legjislacion i veçantë. Legjislacionet e tyre i kanë pasuar profetët e tyre bashkohor dhe profetët pasardhës, deri në kohën që është dërguar profeti tjetër prej atyre të vendosmërisë së lartë me mesazhin, librin dhe legjislacionin e tij të ri.

Nëpërmjet kësaj u qartësua se është e mundur prezenca e dy profetë në të njëjtën kohë. Ashtu siç jetoi në të njëjtën kohë Luti me Ibrahimin (*paqja qoftë mbi ta!*), Haruni dhe Musai (*paqja qoftë mbi ta!)*, Jahja dhe Isai (*paqja qoftë mbi ta!*).

Shënime

Në fund të këtij leksioni do të flasim shkurtimisht për disa vërejtje. Ne do të përmendim shkurtimisht vetëm titujt e temave pa u zgjatur në studimin e tyre:

• Profetët e Allahut dëshmojnë dhe vërtetojnë njëri – tjetrin. Paraardhësi përgëzon për ardhjen e profetit pasardhës.[19] Në këtë mënyrë, pretenduesi i Profetësisë që përgënjeshtrohet nga profetët e mëhershëm apo nga bashkohësit e tij, konsiderohet i rremë.

• Profetët e Allahut nuk kanë kërkuar shpërblim për kryerjen e detyrave profetike dhe obligimeve për njerëzit.[20] Profeti i Islamit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka kërkuar nga populli i tij shpërblim për mesazhin e transmetuar me përjashtim dashurinë për Ehlin Bejtin e tij.[21] Duke ua përforcuar edhe më tepër pasimin dhe kapjen fort pas tyre. Në të vërtetë dobitë e kësaj porosie u kthehen po vetë ummetit.[22]

• Disa profetë kishin poste të tjera hyjnore, siç ishin

19. Surja "Ali Imran", ajeti 81.
20. Suret: "El-En'am", ajeti 90; "Jasin", ajeti 21; "Et-Tur", ajeti 40; "El-Kalem", ajeti 46; "Junus", ajeti 42; "Hud", ajetet 29 dhe 51; "El-Furkan", ajeti 57; "Esh-Shu'ara", ajetet 109, 127, 145, 164, 180; "Jusuf", ajeti 104.
21. Surja "Esh-Shura", ajeti 23
22. Surja "Sebe", ajeti 47.

gjykimi dhe udhëheqja. Mundemi të përmendim nga grupi i atyre profetëve të mëparshëm Davudin dhe Sulejmanin *(paqja qoftë mbi ta!)*. Nga ajeti 64 i sures En-Nisa, i cili obligon bindjen absolute ndaj çdo profeti, përfitohet se të gjithë profetët i gëzonin këto poste.

• Disa xhindë, që janë nga lloji i krijesave të zgjedhura dhe të ngarkuara, të cilët nuk mund të shihen nga njerëzit në kushte të zakonshme, kanë qenë të ditur ndaj thirrjes së disa Profetëve të Allahut. Një pjesë e të devotshmëve të tyre besuan. Në mesin e tyre kishte pasues të Musait *(paqja qoftë mbi të!)* dhe të profetit Muhamedit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*[23], sikurse disa prej tyre i mohuan profetët e Zotit dhe u bënë pasues të shejtanit.[24]

Pyetje:

1. Sqaro shkaqet e dërgimit të shumë profetëve.

2. Cila është detyra e njerëzve kundrejt thirrjes së gjithë profetëve dhe mësimeve të tyre?

3. Cili është rasti që nuk obligon dërgimin e një profeti të ri?

4. Sqaro numrin e profetëve (*nebij*) dhe i të dërguarve (*resul*).

5. Cili është ndryshimi ndërmjet *nebij* dhe *resul*? Cili është raporti ndërmjet tyre përsa i përket kuptimit dhe vërtetimit?

6. Me çfarë detyrash hyjnore lartësohen disa profetë mbi disa të tjerë?

7. Kush janë Profetët e Vendosmërisë së Lartë (*Ulu'l-'Azmi mine'r-Rusul*)? Cilat janë veçoritë e tyre?

8. A mund të ketë shumë profetë në të njëjtën kohë? Në qoftë se kjo është e mundur, përmend disa shembuj.

9. Cilat janë cilësitë e tjera të profetëve të Allahut?

10. Cili është qëndrimi i xhindeve kundrejt profetëve sa i përket besimit dhe mohimit?

23. Sure "El-Ahkaf", ajetet 29-32.
24. Sure "El-Xhinn", ajetet 1-14.

Leksioni i tridhjetë

NJERËZIT DHE PROFETËT

Hyrje

Kur Kur'ani Fisnik përmend profetët e mëparshëm dhe paraqet disa aspekte nga jeta e tyre e ndritshme dhe e begatë duke larguar pluhurin e shtrembërimeve dhe dejvijimeve të qëllimshme dhe të paqëllimshme në faqet e historisë së tyre të ndritshme, kjo do të thotë se ai kujdeset me një përkujdesje të madhe mbi qëndrimet e popujve kundrejt profetëve (paqja qoftë mbi ta!).

Nga njëra anë paraqet qëndrimet e njerëzve kundrejt profetëve të Allahut dhe faktorëve të cilët i shtynë njerëzit që t'i kundërshtojnë profetët. Nga ana tjetër tregon rrugët e udhëzimit dhe të edukimit që kanë përdorur Profetët. Gjithashtu, metodat luftimit e të përballjes së tyre me faktorët e mosbesimit, idhujtarisë dhe devijimit. Po ashtu përmend legjislacionet suneti hyjnore në administrimin e popujve dhe shoqërive, veçanërisht marrëdhëniet dhe qëndrimet e ndërsjellta mes njerëzve dhe profetëve, të cilat përbajnë vëzhgime dhe dhënie të frutshme dhe edukuese.

Të tilla hulumtime, megjithëse nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjet doktrinale dhe apologjike, por meqenëse ato hedhin dritë mbi çështjen profetike, largon shumë paqartësi e ndërlikime dhe për shkak të ndikimit të tyre frytdhënëse në ndreqjen dhe edukimin e njerëzve nga ku merren mësime e këshilla të rëndësishme historike, ato hulumtime kanë një rëndësi shumë të madhe. Në këtë leksion do të përcjellim prej këtyre hulumtimeve ato më të rëndësishmet.

Qëndrimi i njerëzve kundrejt profetëve

Gjatë kohës që profetët hyjnorë filluan të thërrisnin njerëzit në adhurimin e Zotit Një e të Vetëm[1], në bindjen ndaj mësimeve të Tij, në kundërshtimin e idhujve dhe zotave të tyre të rremë, në kundërshtimin e shejtanëve dhe tiranëve, në largimin nga padrejtësia, shthurja, gjynahet dhe veprat e ndaluara, Profetët u përballën me kundërshtimin e njerëzve[2], veçanërisht me kundërshtimin e udhëheqësve dhe të parëve të shoqërisë, të pasurve dhe të shthururve në mesin e tyre që ishin mbytur në jetën e tyre të kotë e zbavitëse[3], mendjemëdhenjve për shkak të pasurisë dhe postit, ose për shkak të dijes dhe kulturës së tyre.[4] Ata u përpoqën me të gjitha mundësitë dhe fuqitë e tyre për të luftuar kundër profetëve dhe për t'u përballur me ta. Ata tërhiqnin shumë prej grupeve dhe palëve të tjera për t'i ndjekur ata dhe për t'i shmangur nga pasimi i rrugës së drejtë.[5] Por, gradualisht filluan t'u besojnë profetëve grupe të pakta nga shtresa e varfër dhe e privuar e shoqërisë.[6]

Është shumë e rrallë që të ngrihet një shoqëri mbi bazat e doktrinës së vërtetë, barazisë, drejtësisë, bindjes së urdhrave të Allahut dhe të profetëve siç vihet re në periudhën e Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!), në të cilën gjendej një shoqëri e tillë.

Ndodh që disa nga mësimet e profetëve u hapin rrugën përhapjes së kulturave të popujve dhe përçohen nga një popull tek një tjetër duke përfituar shumë prej tyre. Ka raste që këto përhapen si vepra dhe propozime që janë shpikur nga udhëheqësit e mosbesimit siç duket në shuëm institucione juridike në botë, të cilët i marrin nga legjislacionet hyjnore dhe më pas i përhapin si ide dhe teori të shpikura prej tyre pa e

1. Sure "El Nahl", ajeti 36, sure "El Enbija", ajeti 25, sure "Fusilet", ajeti 14, sure "El Ahkaf", ajeti 21.
2. Sure "Ibrahim", ajeti 9, sure "El Muminun", ajeti 44.
3. Sure "Sebe", ajeti 34.
4. Sure "Gafir", ajeti 83, sure "El Kasas", ajeti 78, sure "El Zumer", ajeti 49.
5. Sure "El Ahzab", ajeti 67, sure "Sebe", ajetet 31-33.
6. Sure "Hud", ajetet 27-31 dhe 40.

përmendur burimin e orgjinës së këtyre mësimeve.

Faktorët e kundërshtimit të profetëve dhe shkaqet e tyre

Sigurisht, për kundërshtimin e profetëve, përveç faktorit të përgjithshëm që është dëshira e të çliruarit dhe e ndjekjes së lakmive dhe qejfeve,[7] ekzistojnë faktorë dhe shkaqe e tjera që janë: vetëpëlqimi, kryelartësia, mburrja, të cilat më shumë shfaqen në mesin e parive, të pasurve dhe në shpresat e larta të shoqërisë.[8] Prej faktorëve janë edhe fanatizmi, përmbajtja e theksuar me zakonet e vjetra të baballarëve, gjyshërve si dhe zakonet e gabuara të përhapura në mesin e popujve të ndryshëm.[9] Gjithashtu, ruajtja e interesave ekonomike dhe e qendrave shoqërore[10], konsiderohen shtytës i fortë për të pasurit, udhëheqësit dhe dijetarët të mbajnë një qëndrim kundrejt profetëve.

Në anën tjetër, padituria dhe pavetëdija e përhapur në mesin e njerëzve, luajnë rol të madh në mashtrimin dhe rënien në ortakësinë e tiranëve dhe despotëve të mohimi (*kufr*). Imitimi i të fuqishmëve dhe i shumicës bëjnë që njerëzit të ndjekin hamendësitë e tyre dhe të kundërshtojnë fenë të cilën e besojnë vetëm një pakicë. Veçanërisht, shihet se besimtarët praktikanë janë persona të cilët nuk gëzojnë pozita shoqërore të rëndësishme, ose nuk afrohen nga udhëheqësit dhe shumica e shoqërisë. Duhet shtuar këtu edhe presionin e shtresës udhëheqëse.[11]

7. Sure "El Maide", ajeti 70.
8. Sure "Gafir", ajeti 56, sure "El Araf", ajeti 76.
9. Sure "El Bekare", ajeti 170, sure "El Maide", ajeti 104, sure "El Araf", ajeti 28, sure "Junus", ajeti 78, sure "El Enbija", ajeti 53, sure "El Shuara", ajeti 74, sure "Lukman", ajeti 21, sure "El Zuhruf", ajetet 22-23.
10.Sure"Hud",ajetet84-86,sure"ElKasas",ajetet68-79,sure"Teube",ajeti34.
11. Sure "Ibrahim", ajeti 21, sure "Hud", ajeti 27, sure "El Shuara", ajeti 111, sure "Fatir", ajeti 47.

Mënyrat që u përdorën në përballje me profetët

Kundërshtarët e profetëve përdorën mënyra nga më të ndryshmet në përballimin e veprimtarisë së profetëve dhe përpjekjeve të tyre:

• **Tallja**: Fillimisht ata u përpoqën të shkatërronin personalitetin e profetëve dhe ndikimin e tyre nëpërmjet talljes[12], me qëllim që masa e gjerë njerëzve të mos interesoheshin dhe mos ua vinin veshin atyre.

• **Shpifja dhe akuzimi**: Pas talljes, përdorën mënyrën e gënjeshtrës dhe shpifjes duke iu atribuar profetëve shpifje nga më të shëmtuarat si p.sh., profeti është mendjelehtë (*Sefijhun*) ose i çmendur (*mexhnunun*)[13], ose në rastin kur profeti sillte një mbrekulli ata akuzonin se ajo është magji[14]. Shpalljet e profetëve i quanin legjenda (*esatijrun*).[15]

•**Debati**: Gjatë kohës që profetët e Allahut flisnin me njerëzit me gjuhë të urtë, të bazuar në argumenta, diskutonin me ta në formën e dialogut, i këshillonin, u tërhiqnin vëmendjen që të largoheshin nga mosbesimi dhe padrejtësitë; i njihnin me të mirat e bollshme, ndikimet dhe përfundimet e ndritshme të besimit në Allahun dhe adhurimin e Tij; i përgëzonin besimtarët dhe njerëzit e drejtë me lumturinë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër, udhëheqësit e mosbesimit i ndalonin njerëzit dhe të dobëtit të dëgjonin thëniet e profetëve. Më pas përpiqeshin tu përgjigjeshin atyre me logjikë çmendurie e të dobët. Përpiqeshin t'i mashtronin masat e gjera me fjalë të zbukuruara nga jashtë[16] dhe i ndalonin të pasonin Profetët

12. Sure "El Hixhr", ajeti 11, sure "Jasin", ajeti 30, sure "El Zuhruf", ajeti 7, sure "El Mutafifijne", ajetet 29-32.

13. Sure "El Araf", ajeti 66, sure "El Bekare", ajeti 13, sure "El Muminun", ajeti 25.

14. Sure "El Dharijat", ajetet 39, 52, 53, sure "El Enbija", ajeti 3 , sure "El Kamer", ajeti 2.

15. Sure "El Enam", ajeti 25, sure "El Enfal", ajeti 31, sure "El Nahl", ajeti 24, sure "El Muminun", ajeti 83, sure "El Furkan", ajeti 5, sure "El Neml", ajeti 68, sure "El Ahkaf", ajeti 17, sure "El Kalem", ajeti 15, sure "El Mutafifijne", ajeti 13.

16. Sure "Nuh", ajeti 7, sure "Fusilet", ajeti 26, sure "El Enam", ajeti 112,

(paqja qoftë mbi ta!).

Zakonisht në bisedimet e tyre ata përmendnin mënyrat dhe zakonet e vjetra të baballarëve dhe gjyshërve të tyre.[17] Ata përdornin në këtë përballje pasuritë e tyre dhe mundësitë materiale. Duke e konsideruar prapambetjen dhe dobësinë materiale të pasuesve të profetëve si argument mbi pavërtetësinë e besimeve dhe veprave të profetëve.[18] Për t'i larguar njerëzit nga profetët, kundërshtarët kapeshin pas disa pretekseteve të kota dhe bënin pyesnin: Përse Allahu nuk i ka dërguar profetët dhe përfaqësuesit e Tij prej engjëjve? Përse nuk ka dërguar ëngjëj me ta? Përse nuk gëzojnë privilegje ekonomike dhe jetesë të dukshme?[19] Ndonjëherë arrinte kundërshtia e tyre në atë gradë të ulët saqë thoshin: Nuk besojmë derisa Shpallja të na zbresë neve, ose të shohim Allahun me sytë tanë dhe të dëgjojmë fjalën e Tij pa ndërmjetës.[20]

• **Frikësimi dhe dëshira:** Një tjetër mënyrë që e përcjell Kur'ani Fisnik nga shumë popuj është ajo e kërcënimit të tyre ndaj Profetëve të Allahut dhe pasuesve të tyre me ndëshkim, torturim, përzënie nga vendbanimet e tyre, goditjet me gurë ose vrasja e tyre.[21] Nga ana tjetër, përdorin metodën e joshjes duke shpenzuar pasuri të mëdha për të penguar njerëzit që të pasonin profetët.[22]

• **Përdorimin e dhunës dhe i vrasjes:** Në fund, kur shihnin durimin e profetëve (paqja qoftë mbi ta!), qëndrimin

121, sure "Gafir", ajeti 5 dhe 35, sure "El Araf", ajetet 7-71, sure "El Kehf", ajeti 56.

17. Sure "El Bekare", ajeti 170, sure "El Maide", ajeti 104, sure "El Araf", ajeti 28, sure "El Enbija", ajeti 53, sure "Junus", ajeti 78, sure "Lukman", ajeti 21.

18. Sure "Junus", ajeti 88, sure "Sebe", ajeti 35, sure "El Kalem", ajeti 14, sure "Merjem", ajeti 77, sure "El Mudethir", ajeti 12, sure "El Muzemil", ajeti 11, sure "El Ahkaf", ajeti 11.

19. Sure "El En'am", ajetet 7-9, sure "El Isra", ajetet 90-95, sure "El Furkan", ajetet 4-8.

20. Sure "El Bekare", ajeti 118, Sure "El Enam", ajeti 124, sure "El Nisa", ajeti 153.

21. Sure "Ibrahim", ajeti 13, sure "Hud", ajeti 91, sure "Merjem", ajeti 46, sure "Jasin", ajeti 18, sure "Gafir", ajeti 26.

22. Sure "El Enfal", ajeti 36.

dhe vendosmërinë e tyre[23], qëndrimin dhe këmbënguljen e përkrahësve dhe pasuesve të tyre të vërtetë, si dhe duke humbur të gjitha shpresat në ndikimin e mjeteve të informacionit dhe gjithë mënyrave të përdorura përfshi edhe forcën kundër tyre, pas të gjitha këtyre, ata filluan të zbatojnë në praktikë kërkënimin e tyre duke përdorur dhunën dhe forcën dhe vranë shumë prej profetëve.[24] Në këtë mënyrë ata ua ndaluan njerëzve dhe popujve mirësinë më të madhe të Allahut, praninë e profetëve që janë udhëheqësit më të mirë e më të denjë të shoqërisë.

Disa ligje hyjnore në administrimin e popujve

Qëllimi kryesor në dërgimin e profetëve (paqja qoftë mbi ta!) është mundësimi i njerëzve të arrijnë në njohjen e dijeve dhe njohurive të cilat ofrojnë arritjen e lumturisë së kësaj bote dhe Botës Tjetër si dhe, nëpërmjet revelatës, të ndalin të metat dhe gabimet që dalin nga mendjet. Thënë ndryshe, plotësimi i argumentit ndaj tyre.[25] Kur dërgohen profetët, Allahu i Madhëruar për shkak të mëshirës së Tij të madhe për robtë e Tij dhe nëpërmjet administrimit të urtë, ofron një klimë shpirtërore për pranimin e thirrjes të tyre për të ndihmuar njerëzit përgjatë udhëtimit drejt përsosmërisë. Meqënëse faktori më i madh për mohimin, devijimin dhe kundërshtimin e Allahut dhe profetëve është ndjenja e mospasjes nevojë si dhe pavëmendshmëria ndaj nevojave të gjera dhe të përgjithësshme të krijesave. Ky është shkaku që Allahu i Madhëruar ofroi klimën dhe kushtet që i shtynë njerëzit të drejtohen kah nevojat dhe domosdoshmëritë e tyre, si dhe në shpëtimin nga pakujdesia, zhgënjimet dhe fanatizmi. Ndoshta i sprovon me disa sprova dhe fatkeqësi që i shtynjë

23. Sure "Ibrahim", ajeti 12.
24. Sure "El Bekare", ajetet 61, 87,91, sure "Al Imran", ajetet 21, 112, 181, sure "El Maide", ajeti 7, sure "El Nisa", ajeti 155.
25. Sure "El Nisa", ajeti 65, sure "Taha", ajeti 134.

ata të ndiejnë dobësitë e tyre dhe të drejtohen drejt Zotit.[26]

Mirëpo, ky faktor, gjithashtu nuk ndikon ndikim të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës sepse ka shumë nga ata njerëz, veçanërisht ata që gëzonin më shumë nga të tjerët mundësi materiale dhe jetuan për shumë vite jetuan jetë të shthurur në llogari të padrejtësive që u bënin të tjerëve, të cilët Kur'ani Fisnik i përshkruan se ata janë si guri, por edhe më të ashpër. Ata jo vetëm që nuk u zgjuan nga pavetëdija e tyre[27], por vazhduan të qëndrojnë të pavetëdijshëm duke ecur në rrugën e humbjes së tyre edhe pse sprovat binin mbi ta. Po ashtu, nuk ndikuan tek ata këshillat, predikimet dhe paralajmërimet e profetëve.

Kur Allahu i Madhëruar ua largonte prej tyre dënimin, e përfundonte gjendjen e sprovave dhe përsëri u jepte njerëzve nga mirësitë e Tij ata thonin: **"Edhe etërit tanë i paten goditur hidhërimet e gëzimet". Kështu që Ne i dënonim papritmas, pa e marrë vesh ata."**[28] Por ata sërisht u kthyen në padrejtësitë dhe zullumin e tyre, në grumbullimin e pasurive dhe zhvillimin e fuqive të tyre të pavëmendshmë se zgjerimi dhe shumimi i pasurive dhe i fuqive të tyre janë sprova hyjnore që i con në vështirësitë e kësaj bote dhe të Botës Tetër.[29]

Si do që të jetë, kur arrin numri i pasuesve të Profetëve dhe mbështetësve të tyre në atë shkallë nëpërmjet së cilës mund të ngrenë një shoqëri të pavarur, mund të mbrojnë veten e tyre dhe të luftojnë armiqtë e Allahut, ata janë urdhëruar për luftën e shenjtë (*Xhihad*).[30] Me duart e tyre Allahu do të hedhë dënimin mbi kokat e jobesimtarëve.[31] Përveç kësaj, me urdhrin e profetëve, besimtarët mënjanohen nga jobesimtarët dhe largohen prej tyre. Dënimi i Allahut, nëpërmjet rrugëve

26. Sure "El En'am", ajeti 42, sure "El Araf", ajeti 64.
27. Sure "El Enam", ajeti 42, sure "El Muminun", ajeti 76.
28. Sure "El Araf", ajeti 95
29. Sure "El Araf", ajetet 182, 183, sure "Al Imran", ajeti 178, sure "El Teube", ajetet 55, 85, sure "El Muminun", ajetet 54-56.
30. Sure "Al Imran", ajeti 146.
31. Sure "El Teube", ajeti 14.

të tjera, do të bjerë mbi kokat e popullit jobesimtar tek i cili nuk shpresohet asnjë mirësi dhe kthim te Allahu.[32] Ky është ligji i Allahut, i cili nuk pranon ndryshim në administrimin e popujve dhe në menaxhimin e tyre[33] (93).

Pyetje

1. Cili është qëndrimi i njerëzve kundrejt thirrjes të Profetëve (paqja qoftë mbi ta!)?
2. Përmend faktorët kundërshtues të profetëve dhe qëllimet e tyre.
3. Cilat janë mënyrat që përdorën kundërshtarët e Profetëve?
4. Përmend ligjet hyjnore në dërgimin e profetëve dhe qëndrimin e njerëzve ndaj tyre.

32. Sure "El Ankebut", ajeti 40 dhe ajete të shumta.
33. Sure "Fatir", ajeti 43, sure "Gafir", ajeti 58, sure "El Isra", ajeti 77.

Leksioni i tridhjetëenjë

PROFETI I ISLAMIT

Hyrje

Janë dërguar dhjetëra mijëra profetë nga Allahu në periudha historike të ndryshme dhe vende të ndryshme të botës. Ata e kryen detyrën e tyre më së miri në udhëzimin e njerëzve dhe edukimin e tyre. Ata lanë pas trashëgimi dhe gjurmë të ndritshme dhe frytdhënëse për popujt. Çdonjëri prej tyre edukoi një grupim bazuar mbi bazat e besimit të vërtetë dhe të vlerave të larta, të cilët patën ndikim jo të drejtpërdrejtë tek të tjerët. Disa prej profetëve arritën të ndërtojnë bashkësi monoteiste të bazuar mbi monoteizmin, drejtësinë dhe morën përsipër detyrën e udhëheqjes së tyre.

Ndër ta u dalluan Nuhu, Ibrahimi, Musai dhe Isai, (paqja qoftë mbi ta!), të cilëve Allahu u zbriti libra qiellorë përfshirës të ligjeve dhe rregullave individuale dhe shoqërore si dhe mësime dhe detyra morale dhe juridike të përshtatshme me rrethanat vendore dhe kohore. Ata i vunë në shërbim të njerëzve për t'i udhëzuar ata në atë që ka mirësi në këtë botë dhe në Botën Tjetër

Mirëpo, me kalimin e kohës këta libra u zhdukën plotësisht ose u përballën me devijime dhe ndryshime shkrimore dhe spirituale. Si rezultat i gjithë kësaj u deformuan sheriatet qiellore. Sikurse u përball Teurati, libri që i zbriti Musait (paqja qoftë mbi të!), me devijime e ndryshime të shumta. Ndërsa nga Inxhili, libri që i zbriti Isait (paqja qoftë mbi të!), ska mbetur asgjë prej tij përveç asaj që kanë shkruar pasuesit e tij dhe janë përmbledur nën titullin "Libri i Shenjtë)" (El Kitab El Mukades).

Çdo njeri i drejtë, nëse do t'i hedhë një vështrim Teuratit dhe Inxhilit që ndodhen sot në përdorim, do ta kuptojë se nuk janë librat që i zbritën Musait dhe Isait (paqja qoftë mbi ta!). Teurati, në shtesë të asaj që e përfytyron Allahun e Madhëruar në formën e njeriut, sepse, është i paditur për shumë çështje[1], pendohet shumë për veprat që ka vepron[2], lufton me një nga robtër e tij, Jakubin (paqja qoftë mbi të!) dhe nuk mundet ta mposhtë atë, dhe, në përfundim tërhiqet që njerëzit mos e shohin zotin e tyre në gjëndje të mjeruar.[3] Gjithashtu, Teurati i atribon profetëve të Zotit shumë vepra të deformuara dhe të shëmtuara. I atribon kurvërinë me të ndershmet Zoti na ruajtë-Davudit[4] (paqja qoftë mbi të!), pirja e alkolit dhe kurvërinë me të afërmet ia mvesh Lutit (paqja qoftë mbi të!)[5]. Në shtesë të gjitha këtyre që u thanë, Teurati përmend me detaje historinë e vdekjes së Musait (paqja qoftë mbi të!), mënyrën e vdekjes dhe vendin e vdekjes së tij[6] duke u ditur se Teurati i zbriti vetë Musait (paqja qoftë mbi të!)!! A nuk është e mjaftueshme vetëm kjo pikë për të kuptuar pavërtetësinë e atribuimit të këtij libri Musait (paqja qoftë mbi të!)?!

Përsa i përket Biblës (Inxhijli), është në një gjendje edhe më të keqe se Teurati. Sot nuk gjendet asnjë libër që i ka zbritur Isait (paqja qoftë mbi të!). Edhe vetë të krishterët nuk pretendojnë se Inxhili që ekziston është libri që Allahu ia zbriti Isait. Ky libër që qarkullon sot përmbledh disa shkrime që i atribuohen disa pasuesve të Isait. Në shtesë të lejimit të pirjes së alkolit, prodhimi i tij konsiderohet prej mbrekullive të Isait (paqja qoftë mbi të).[7]

Shkurtimisht, ajo Shpallje që i zbriti Musait dhe Isait (paqja qoftë mbi ta!), është devijuar dhe trasformuar dhe nuk

1. Teurati, Sefer Tekuijn, kapitulli i tretë, nr 8-12.
2. Teurati, Sefer Tekuijn, kapitulli i gjashtë, nr 6.
3. Teurati, Sefer Tekuijn, kapitulli i 32, nr 24-32.
4. El Ahdul Kadijm, libri i Samuelit i dyti, kapitulli 11.
5. Teurati, Sefer Tekuijn, kapitulli i 19, nr 30-38.
6. Teurati, Sefer Tethnije, kapitulli i 34.
7. Inxhili i Gjonit, kapitulli i dytë.

mund të kryejnë misionin e tyre në udhëzimin e njerëzimit.

Porse si dhe pse u realizua ky devijim dhe trasformim, është një histori e gjatë dhe nuk është vendi këtu për të hulumtuar rreth saj.[8]

Në shekullin e gjashtë pas lindjes së Mesihut, në periudhën që bota ishte zhytur e gjitha në errësirën e injorancës dhë padrejtësisë, ishin shuar pishtarët e udhëzimit hyjnor në çdo anë të botës, Allahu i Madhëruar dërgoi vulën e profetëve të tij dhe më të mirin e tyre, në vendin më të prapambetur e më të zhytur në padrejtësi. Ai të ndezë përjetësisht pishtarin e Shpalljes ndriçuese për të gjithë njerëzimin me anë të librit hyjnor të përjetshëm dhe të mbrojtur nga devijimi dhe ndryshimi. T'u mësojë njerëzve dijet e vërteta, urtësinë qiellore, rregullat dhe ligjet hyjnore dhe ta udhëheqë mbarë njerëzimin drejt lumturisë të kësaj bote dhe Botës Tjetër[9] (102).

Irijësi i besimtarëve, imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) në disa ligjërata të tij e përshkruan gjendjen dhe situatën në të cilën jetonte bota gjatë periudhës së dërgimit të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) duke thënë: "Allahu e dërgoi atë pas një përiudhe të profetëve, ishin përhapur përcarjet dhe problemet ndërmjet popujve, ihin ndezur luftërat, bota kishte humbur dritën, sundonin mashtrimet dhe padrejtësitë, ishin shuar shpresat, ishte përhapur e keqja dhe informacionet e gabuara ishin drejtuar drejt njerëzimit, frutet e tyre ishte zhgënjimi, shija e tyre ishte përçarja dhe simbol i tyre ishte frika...[10]

Që nga koha e shfaqjes të Profetit të Islamit, studimi rreth Shpalljes së Profetit dhe mesazhit të tij, dhe se feja islame e shenjtë është e drejtë, u konsiderua si tema më e rëndësishme e çdo studiuesi të vërtetës, (sigurisht pas teuhidit). Me konstatimin e kësaj teme e cila duhet të shoqërohet me

8. Idh'harul Hak i autorit Rahmetullah El Hindi, El Huda fi dijnul Mustafa i autorit El Belagi, Rahe Seadet, në Persisht, i autorit El Sha'ranij.
9. Sure "El Xhuma", ajetet 2-3.
10. Nehxhul Belaga, El Hutbetu 187, botimi i Menar, me autor Subhi Salih, si dhe botimi i Menar, El Hutbetu 89, fq. 121-122.

konstatimin se Kur'ani Fisnik është i vërtetë, me konsiderimin se është libër i vetëm qiellor në duart e njerëzve, i mbrojtur nga devijimet dhe ndryshimet. Është libri që do të udhëzojë njerëzimin deri në fundin e botës në rrugën e vetme për të vërtetuar besimet e vërteta. Do na njohë me sistemin e mrekullueshëm (krijimit), detyrat dhe ligjet vepruese, si zotëron çelësat e trajtimit e të zgjidhjes së të gjitha çështjeve të vizionit kozmik dhe ideologjik.

Argumenti mbi mesazhin e Profetit të Islamit

Në leksionin e njëzet e shtatë përmendëm se mund të vërtetojmë Profecinë e profetëve nëpërmjet tri rrugëve:

• *E para*: Njohja e jetës dhe moralit të tyre, si dhe mbështetja në argumente, tregues dhe të dhëna që çojnë në bindje.

• *E dyta*: Njoftimet e profetëve paraardhës dhe përgëzimet e tyre.

• *E treta*: Mrekullia.

Të trija këto rrugë gjendeshin te profeti i Islamit. Nga njëra anë Profeti jetoi me banorët e Mekës dhe u njohën nga afër me moralin dhe sjelljen e tij për dyzet vjet. Gjatë gjithë këtyre viteve ata nuk gjetën qoftë edhe nje pikë të dobët në jetën e tij të ndritshme dhe të mbushur me dritë e me bereqet. Atë e njohën si të drejtë, të sinqertë dhe besnik. Për këto cilësi atë e quanin "besnik" (*emijn*). Natyrisht as që mund të mendohej gënjeshtra tek ky person.

Në anën tjetër, janë përcjellë përgëzimet e profetëve të mëparshëm dhe lajmet e tyre mbi Profecinë e tij.[11] Një pjesë e idhtarëve të librit e prisnin ardhjen e tij. Ata i njihnin disa shenja të qarta të tij.[12] Ata u thoshin idhujtarëve arabë se do të dërgohet me mesazhin hyjnor një prej bijve profetit Ismail (që ishin prej fiseve arabe), i cili i vërteton profetët e mëparshëm

11. Sure "El Saf", ajeti 6.

12. Sure "El Araf", ajeti 157, sure "El Bekare", ajeti 146, sure "El Enam", ajeti 20.

dhe fetë monoteiste.[13] Duke u bazuar mbi këto lajme dhe përgëzime, Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e besuan disa prej dijetarëve jahudinjë e të krishterë, megjithëse një pjesë e tyre kundërshtuan që ta përqafonin Islamin duke iu nënshtruar dëshirave të tyre psiqike dhe djallëzore.

Kur'ani Fisnik na e tregoi këtë rrugë duke thënë: "**Vallë, a nuk është provë për ata** (mekasit)**, që atë** (Muhamedin) **e kanë njohur dijetarët e bijve të Izraelit?**"[14]

Njohja e Profetit të Islamit nga dijetarët e beni israilit, bazuar në lajmërimet e profetëve të mëparshëm, ashtu sikurse konsiderohet argument i qartë mbi vërtetësinë e mesazhit të tij dhe që argument bindës për ithtarët e librit, po ashtu, konsiderohet argument bindës se edhe vetë profetët e mëparshëm përgëzues kanë qenë të drejtë. Gjithashtu, konsiderohet edhe argument për të tjerët se Profeti i Islamit është profet i drejtë dhe i vërtetë. Kjo, sepse ata vetë e shohin me sytë e tyre dhe e dallojnë me mendjet e tyre të vërtetën e lajmeve, përgëzimeve dhe shenjave të cilat i njoftuan profetët e mëparshëm për profetin e fundit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Ajo që të habit dhe që tërheq vëmendjen është se edhe në vetë Inxhilin dhe Teuratin e devijuar e të ndryshuar megjithë përpjekjet për të fshehur këto lajme dhe përgëzime, gjenden disa pika të ndritshme të cilat janë argument për studiuesit rreth të vërtetës. Sikurse janë udhëzuar në fenë e shenjtë Islame shumë prej dijetarëve jahudinjë dhe të krishterë, të cilët janë kërkues të së drejtës dhe të vërtetës, dhe kjo nga ndikimi i këtyre pikave të ndritshme dhe lajmet e mbetura në dy librat, Teurati dhe Inxhili.[15]

13. Sure "El Bekare", ajeti 89.

14. Sure "El Shuara", ajeti 197.

15. Mund të konsiderojmë prej tyre Mirza Muhamed Rida (një prej dijetarëve të mëdhenj jahudnjë në Teheran), autor i librit "Ikametu Shuhud fi er Reddi alal Jehud". Haxh Baba El Kazuijni El Jezdi (prej dijetarët jehudnjë në Jezd), autor i librit Mahdharu Shuhud fi Reddi alal

Në librat e historisë dhe hadithit janë regjistruar shumë prej mrekullive të qarta të cilat kanë dalë nga Profeti. Shumica e atyre transmetimeve ka arritur në kufirin e (teuatur) konsekuetit.[16] Porse përkujdesja hyjnore çoi në ekzistencën e një tjetër mrekullie tjetër që të argumentonet mbi Profetin dhe fenë e tij të përjetshme. Në shtesë të atyre mrekullive, të cilat janë argument i atyre që ishin prezentë dhe dëshmitarë, ndërsa të tjerët njihen me to nëpërmjet transmetimit, edhe kjo mrekulli tjetër është e përjetshme dhe argument mbi njerëzimin në përjetësi. Ai është Kur'ani Fisnik.

Në leksionin e ardhshëm do të flasim rreth mrekullisë së Kur'anit Fisnik.

Pyetje

1. Përmend gjendjen e librave të cilët sollën profetët e mëparshëm.

2. Përmend disa fakte të ndryshimit në Teurat.

3. Argumento humbjen e Inxhilit orgjinal.

4. Sqaro rëndësinë e temës "Mesazhi i Profetit Islam."

5. Sqaro rrugët nëpërmjet të cilave vërtetohet Mesazhi i Profetit të nderuar (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Jahud". Profesor Abdulehad Davud, prift i krishterë i mëparshëm, autor i librit "Muhamedu fi Teurati uel Inxhijli" i cili është përkthyer së fundmi në anglisht dhe persisht.

16. Kthehu tek Biharul Anuar, vëllimi i 17, fq. 225 deri në fund të vëllimit 18, si dhe gjithë librat e hadithit dhe historisë.

Leksioni i tridhjetëedytë

MREKULLIA E KUR'ANIT FISNIK

Kur'ani është mrekulli

Vërtet, Kur'ani është Libri i vetëm qiellor i cili ka deklaruar qartësisht dhe forcërisht se askush nuk mund të sjellë të njëjtë me të, edhe sikur të mblidhen njerëzit dhe xhinët nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë.[1] Ata nuk mund të sjellin as dhjetë sure të njëjta me suret e tij.[2] Jo vetë, kaq, ata nuk mund të sjellin as edhe një sure të vetme të shkurtër të njëjtë me të dhe të përbërë nga një rresht.[3]

Pastaj, Kur'ani i sfidoi të gjithë dhe i fton në ballafaqim. Këtë e dëshmon në shumë ajete. Pamundësia e tyre për të kryer një vepër të tillë dhe pamundësia për t'iu përgjigjur kësaj sfide, tregojnë se ky libër dhe mesazhi profetik e kanë burimin te Allahu i Madhëruar.[4]

Pra, ajo që nuk ka aspak dyshim dhe as më të voglën mëdyshje, është se ky libër fisnik mbart me vete thirrjen se është një mrekulli, sikurse ai që e solli atë ia prezantoi njerëzve si mrekulli të përjetshme dhe si argument të prerë mbi profecinë e tij deri në përjetësi. Sot, pasi kanë kaluar katërmbëdhjetë shekuj, ky zë hyjnor vazhdon të trokasë në veshin e të gjithëve, ditën dhe natën, nëpërmjet mjeteve të informacionit mike dhe armike duke qënë argument për ta.

Nga ana tjetër, profeti i Islamit që nga dita e parë e thirrjes të tij, u përball me armiq të egër, smirakë, të cilët u përpoqën me të gjitha forcat e tyre për ta luftuar këtë fe hyjnore. Pasi

1. Sure "El Isra", ajeti 88.
2. Sure "Hud", ajeti 13.
3. Sure "Junus", ajeti 38
4. Sure "El Bekare", ajeti 23- 24.

i humbën shpresat nga ndikimi i kërcënimeve, mashtrimeve dhe intrigave të tyre, planifikuan vrasjen dhe zhdukjen e Profetit. Por, të gjitha kurthet dhe intrigat e tyre dështuan me përgatitjen e Allahut të Urtë që Profeti të emigronte natën dhe në fshehtësi për në Medine. Pas emigrimit, gjithë jetën e tij fisnike e kaloi në luftra dhe beteja të shumta kundër idhujtarëve dhe aleatëve të tyre prej jahudinjëve. Që nga vdekja e tij e deri më sot, hipokritët e brendshëm dhe armiqtë e jashtëm, janë përpjekur dhe përpiqen me të gjitha fuqitë dhe mundësitë e tyre që ta shuajnë këtë dritë hyjnore. Sikur të mundeshin e të sillnin një libër të tillë si Kur'ani, do ta kishin bërë pa asnjë mëdyshje.

Në kohën sotme, të gjitha fuqitë e mëdha në botë mendojnë se Islami është armiku më i madh që kërcënon pushtetin e tyre të padrejtë dhe lakmitë e tyre djallëzore. Për këtë, megjithë fuqitë dhe mundësitë e tyre financiare, ekonomike, politike dhe informatike e tyre që posedojnë, ata e luftojnë Islamin. Nëse do të mundeshin të përballojnë sfidën kur'anore dhe të shkruajnë qoftë edhe një rresht të vetëm që t'i përngjasojë një sureje të shkurtër të Kur'anit, do ta bënin atë dhe do ta shfaqnin nëpërmjet mjeteve të të informacionit mbarëbotërore të tyre. Sepse, një punë e tillë është më e lehta dhe më pak e kushtueshme, kurse ndikimi i saj në përballjen me Islamin dhe frenimin e tij nga mospërhapja, është më i madh.

Si përfundim, pas gjithë këtyrë vëzhgimeve, çdo njeri i zgjuar dhe i logjikshëm do ta kuptojë se Kur'ani Fisnik është një libër i veçantë, i cili nuk pranon imitim. Është e pamundur për çdo person apo bashkësi që të sjellin një të tillë si ai, sado që të shpenzojnë energji e përpjekje, apo të studiojnë e të ushtrohen. Pra, ai posedon të gjitha veçoritë e mrekullisë (atë të qënit hyjnor dhe jashtëzakonshëm, si dhe nuk pranon imitim dhe është argument për vërtetësinë profetike). Nga këtu, ky libër është argumenti më i mirë e i prerë mbi vërtetësinë e thirrjes së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Po ashtu, tregon se feja e shenjtë islame

është në të drejtë dhe se nga mirësitë më të mëdha hyjnore për bashkësinë islame është që ky Libër ka zbritur në atë formë që do të qëndrojë përgjithmonë dhe është mrekulli. Ai ka në brendësi, vërtetësinë, konsiderimin dhe rregullsinë për vete dhe për të tjerat. Ky është një argument që çdo njeri e kupton dhe e pranon pa patur nevojë për mësim apo specializim.

Elementët e mrekullisë në Kur'anin Fisnik

Pasi u njohëm në mënyrë të përmbledhur se Kur'anin Fisnik është fjala e Allahut dhe mrekulli, tani do të sqarojmë disa nga elementët e mrekullisë kur'anore:

a- Retorika e Kur'anit dhe elokuenca e tij: Elementi i parë prej elementëve të mrekullisë në Kur'anin është retorika dhe elekuencae tij. Që do të thotë se Allahu për të paraqitur qëllimet e Tij në çdo temë, ka përdorur fjalët më të ëmbla dhe më të bukura, shprehjet më të goditura, domethënëse, të drejta, realiste dhe argumentuese. Nëpërmjet kësaj arrihet kuptimi i kërkuar te lexuesit me mënyrat më të mira dhe më të afërta për tu kuptuar. Përzgjedhja e këtyre shprehjeve dhe fjalëve të përshtashme për kuptimet e larta dhe precize, bëhet vetëm nga ai që ka njohuri të plotë për të gjitha veçoritë e shprehjeve, për hollësinë e kuptimeve e veçanta dhe për marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet tyre që të ketë mundësi të përzgjedhë fjalët dhe shprehjet më të mira, duke patur parasysh edhe dimensionet e kuptimeve të qëllimta, si dhe gjendjen dhe pozitën. Këto njohuri shkencore gjithpërfshirëse nuk mund të ndodhet te asnjë njeri pa ndihmën e Shpalljes dhe të inspirimit hyjnor.

Të gjithë e kuptojnë atë që përmbledh në vetvete Kur'ani Fisnik prej ëmbëlsisë së melodisë dhe tingujve tërheqës. Vërtet, ata që e njohin gjuhën arabe, artin e retorikës e të elekuencës, e dallojnë lartësinë e retorikës e të elekuencës që ka Kur'ani.

Ndërsa përshkrimi se ai është mrekulli në retorikë dhe elekuencë, këtë e bëjnë vetëm ata që janë ekspertë dhe

specialistë në artet e ndryshme të gjuhës, në krahasimin që e dallon Kur'anin nga të gjitha llojet e fjalëve letrare dhe retorike. Këtë mision nuk e kryen askush përveçse poetët, shkrimtarët dhe letrarët arabë. Kjo sepse, ajo që i dallinte arabët në kohën që zbriti Kur'ani ishte retorika dhe letërsia të cilat kishin arritur majat. Arabët përzgjidhnin disa poema dhe vargje, të cilat pas kritikës dhe vlerësimit, konsideroheshin si arritja më e mirë artistike dhe letrare.

Vihet re gjithashtu, se urtësia dhe përkujdesja hyjnore gjykon që mrekullia e çdo profeti të përshtatet me dijet dhe artet e përhapura në atë kohë. Kjo me qëllim që të njihet dhe të dallohet mirë superioriteti i mrekullisë mbi çdo përpjekje dhe arritje njerëzore. Imam Hadi (paqja qoftë mbi të!), është pyetur nga ibn Sukejti: "Përse e Allahu i dha Musa ibn Imranit, (paqja qoftë mbi të!) shkopin, dorën e bardhë dhe mjetet e magjisë?" "Përse i dha Isait mjetet e mjekësisë?" Përse i dha Muhamedit paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi të gjithë të dërguarit!) fjalën, retorikën dhe ligjëratën?"

Imami u përgjigj: "*Allahu i Lartësuar, kur e dërgoi Musain (paqja qoftë mbi të!) tek populli i tij gjatë asaj periudhe ishte e përhapur magjia. Ai u solli atyre nga Allahu diçka që ishte e pamundur për ata. Me anë të saj, ai ua prishi atyre magjitë dhe atë e konstatoi argument për ata. Allahu i Madhëruar e dërgoi Isain, (paqja qoftë mbi të!), në periudhën që njerëzit kishin shumë nevojë për mjekësinë. Ai solli nga Allahu i Madhëruar atë që nuk ishte në mesin e tyre. Ai ngjalli të vdekurin, shëroi sëmundje të pashërueshme me lejen e Allahut duke ua konstatuar argument për ta . Allahu i Madhëruar E dërgoi Muhamedin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në periudhën kur shumica e njerëzve të asaj kohe ishin poetë dhe oratorë. Ai solli nga Allahu i Madhëruar këshilla dhe urtësi me të cilat i zhvlerësoi fjalët e tyre, duke vërtetuar kështu revelatën përmbi ta.*"[5]

Po, oratorët arabë të asaj periudhe si psh Uelijd ibn Mugireh el Makhzumij, Utbetu ibn Rebiatu, Tufejl ibn

5. Usulul Kafij, vëllimi i parë, fq. 24.

Amr, dëshmuan se Kur'ani ishte në gradë shumë të lartë në retorikë dhe elekuencë. Ata thanë se ai është superior mbi të gjitha krijimet letrare dhe retorikën njerëzore.[6] Një shekull pas zbritjes së tij, disa persona si psh: Ibn Ebi El Auxha, ibn Mukaffa, Ebi Shakir Dijsani dhe Abdulmelik el Basri, u përpoqën të provonin fatin e tyre në kundërshtimin e Kur'anit.

Përgjatë një viti ata shpenzuan gjithë fuqitë dhe mundësitë e tyre në këtë fushë, por nuk u mbarësuan në këtë veprim. Në fund deklaruan paaftësinë e tyre para Kur'anit. Në kohën që u bashkuan në Xhaminë e Shenjtë (*Mesxhidul Haram*) për të diskutuar veprat dhe përpjekjet e tyre përgjatë atij viti, pranë tyre kaloi imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) dhe u lexoi ajetin e mëposhtëm: **"Thuaj: "Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin."**[7]

b- Analfabetizmi i Profetit: Kur'ani Fisnik, edhe pse përgjithësisht është në përmasa të vogla, është një libër që përmbledh lloje të ndryshme diturish, dijesh, ligjesh, legjislacionesh individuale dhe shoqërore. Ai ka nevojë të studiohet me një studim të plotë nga grupe njerëzish specialistë të cilët duhet të përpiqen me të gjitha energjitë e tyre shkencore dhe përgjatë viteve të gjata që të zbulojnë gradualisht disa thesare dhe të fshehta të fshehura dhe nëpërmjet tyre të arrijnë në të vërtetat e shumta. Edhe pse zbulimi i çdo të vërtete, të fshehte dhe thesari të tij nuk mund të bëhet vetëm nga ata të cilët posedojnë diturinë dhe mbështetjen hyjnore.

E gjitha përmbajtja e Kur'anit përbëhet nga shumë dije të sakta e të larta, nga mësimet më të larta morale e më me shumë vlerë, nga ligjet më të përsosura dhe më të drejta, nga rregullat më të mira për adhurimin dhe nga rregullat e urta personale dhe shoqërore, nga këshillat më me ndikim dhe më të dobishme, nga tregimet historike më të mira më edukuese

6. A'lamul Uera, fq. 27, 28, 49. Sijretu ibn Hisham, vëll. 1, fq. 293 dhe 410.
7. Sure "El Isra", ajeti 88. Kthehu tek tefsiri "Nuru Thakalejn", rreth këtij ajeti.

dhe më këshilluese, nga mënyrat më të mira edukuese dhe përvetësuese... etj. Thënë shkurtimisht: Përmbledh të gjitha parimet për të cilat ka nevojë njeriu për të realizuar lumturinë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër. E gjitha kjo është përzierë me metodën më të përsosur dhe më të kënaqshme, e cila nuk ka të të ngjashëm dhe të gjithë grupet e ndryshme të shoqërisë mund të përfitojnë sipas mundësive dhe aftësive që kanë.

Përmbledhja e gjithë këtyre dijeve dhe e të vërtetave në këtë libër të tillë është mbi mundësinë dhe fuqinë njerëzve të zakonshëm. Ajo që të çudit dhe të mahnit më se tepërmi është se ky libër madhështor u shfaq në duart e një njeriu i cili nuk e ka njohur shkrimin dhe leximin gjatë gjithë jetës së tij. Kurrë gjatë jetës së tij nuk e kapur lapsin dhe as letrën. Ai u rrit në një mjedis larg civilizimit dhe kulturës.

Më e habitshmja është se përgjatë dyzet viteve para Profecisë, nuk është dëgjuar prej tij ndonjë fjalë mrekullie. Edhe gjatë kohës së Profecisë dhe mesazhit, gjithshka që vinte nga ajetet kur'anore dhe nga Revelata hyjnore dallohej për metodologjinë e veçantë. Ajo ndryshonte plotësisht nga të gjitha diskutimet dhe fjalimet. Ky dallim i qartë mes këtij libri dhe thënieve të tjera të profetit është i qartë, i kuptueshëm dhe i prekshëm nga të gjithë.

Kur'ani Fisnik tregon për këto gjëra duke thënë: **Para këtij, ti** (Muhamed) **nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin.**"

Në një ajet tjetër thuhet: **"Thuaj: "Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t'jua kisha lexuar dhe as që do të bënte Ai që ta mësoni ju atë. Unë kam jetuar një kohë (të gjatë) në mesin tuaj para profetësisë, a nuk po mendoni?"**[8]

Ajeti 23 i sures "El Bekare" është tregues i kësaj mrekullie: "**Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tone** (Muhamedit a.s.)**, atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe**

8. Sure "Junus", ajeti 16

dëshmitarët tuaj (që i adhuroni) **në vend të Allahut, nëse jeni të sinqertë.**"

Përfundimi: Nëse do të supozojmë – të pamundërënfuqinë e qindra grupeve të specializuara dhe të kulturuara, të cilat bashkëpunojnë ndërmjet tyre për të prurë një libër të tillë të cilin nuk mundet ta bjerë një njeri analfabet.

Pra është e qartë se një libër i tillë me të gjithë veçoritë dhe të dhënat e specializuara i ardhur nga një njeri i pashkolluar, i cili nuk dinte ç'është dija, është një anë tjetër prej anëve të mrekullisë së Kur'anit.

c- Përputhja dhe mosekzistenca e mosmarrëveshjeve: Kur'ani Fisnik është libër që ka zbritur përgjatë njëzet e tre viteve të jetës të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ajo ishte një periudhë e trazuar dhe e mbushur me ngjarje të vështira e të ashpra. Ishte e mbushur me shumë sfida dhe ndodhi të hidhura dhe të gëzuara. Por të gjitha këto ndryshime nuk ndikuan në përputhjen e përmbajtjes së Kur'anit dhe metodologjisë së mrekullisë së tij. Kjo përputhja dhe mosekzistenca e ndryshimeve në përmbajtjen e Kur'anit Fisnik është një tjetër aspekt nga aspektet e mrekullisë së tij. Edhe kjo shenjë, njësoj si dy shenjat e mëparshme, përmendet në Kur'anin Fisnik: **"A nuk përsiatin ata për Kur'anin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie."**[9]

Sqarim: Çdo njeri përballet të paktën me dy lloje ndryshimesh:

I pari: Dijet dhe eksperiencat e tij vijnë vazhdimisht duke u shtuar dhe duke u rritur. Ky shtim dhe kjo rritje në kulturën, dijet, eksperiencat dhe mundësitë e tij kundërshtojnë veprat dhe fjalët e tij. Është mëse e natyrshme që do të ketë ndryshim të qartë ndërmjet thënieve të tij përgjatë njëzet vjetëve.

I dyti: Ngjarjet e ndryshme në jetë bëjnë që të shfaqen gjendje shpirtërore dhe ndjenja të ndryshme. P.sh., shpresa dhe humbja e saj, gëzimi dhe hidhërimi, shqetësimi dhe qetësia. Ky ndryshim i gjendjes ndikon shumë në mendimet

9. Sure "El Nisa", ajeti 82.

e njeriut veprat dhe fjalët e tij. Natyrisht, me ashpqrsimin e këtyre ndryshimeve dhe me zgjerimin e tyre, ndryshojnë shumë edhe thëniet e njeriut. Në realitet, ndryshimi i fjalëve i nënshtrohet ndryshimit psikologjik dhe ky i fundit i nënshtrohet ndryshimit të rrethanave natyrore dhe shoqërore.

Nëse supozojmë se Kur'ani Fisnik është krijim i Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) si njeri që i nënshtrohet çdo ndryshimi të përmendur, duke parë rrethanat e ndyshme të cilat përjetoi gjatë jetës të tij, është mëse e domosdoshme që të shfaqen ndryshime të mëdha në fjalët e tij, në formën dhe përmbajtjen e tyre, megjithëse tek ai nuk është vënë re asnjë shenjë e këtyre ndryshimeve.

Pra, kjo përputhshmëri dhe mosekzistenca e mosmarrveshjeve në përmbajtjen kur'anore, konsiderohen një tjetër argument që ky Libër është nga një burim dijesh i qëndrueshëm dhe i pakufishëm. Ai është Allahu i Madhëruar, Sunduesi i gjithësisë.

Pyetje

1. Sqaro këtë ide: Kur'ani Fisnik mbart në vetvete thirrjen se është mrekulli.

2. Cili është argumenti i përgjithshëm mbi mrekullinë e Kur'anit?

3. A mund të supozojmë se dikush nuk dëshironte të sillte diçka të ngjashme me Kur'anin? Apo të supozojmë dikënd që e solli dhe ne nuk e dimë? Përse?

4. Fol rreth mrekullisë retorike në Kur'an?

5. Cila është marrëdhënia e pashkollimit të profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me mrekullinë e Kur'anit?

6. Si tregon se mosekzistenca e mosmarrëveshjeve në Kur'an se ai është mrekulli?

Leksioni i tridhjetëetretë

RUAJTJA E KUR'ANIT NGA NDRYSHIMET

Hyrje

Argumenti mbi domosdoshmërinë e profetësisë, siç e theksuam edhe më sipër, kërkon që mesazhi i Allahut të mbërrijë te njerëzit në formë të saktë e jo devijuar e i ndryshuar me qëllim që ata të kenë mundësinë që të përfitojnë prej atij mesazhit, sepse në të gjendet lumturia e kësaj bote dhe e Botës Tjetër. Pra, nuk është e nevojshme të studiojmë ruajtjen e Kur'anit Fisnik që nga burimi i tij deri tek mbërritja tek njerzit, siç është për çdo libër tjetër qiellor. Mirëpo, ashtu sikurse e studiuam edhe më parë, librat e tjerë qiellorë u përballën me devijime e ndryshime pas mbërritjes së tyre në duart e njerëzve, ose pas një farë kohe nga prezantitmi i tyre u fshehën dhe u zhdukën. Ne mund të verëjmë këtë edhe sot ku nuk ka asnjë gjurmë të dy librave që i kanë zbritur Nuhut dhe Ibrahimit (paqja qoftë mbi ta!). Gjithashtu, nuk ekziston asnjë kopje orgjinale e librave të Musait dhe Isait (paqja qoftë mbi ta!). Duke marrë parasysh këtë të vërtetë, lind pyetja e mëposhtëme: Cila është rruga që na tregon se libri i cili ndodhet sot në duart tona i quajtur Kur'ani Fisnik është po i njëjti libër që i ka zbritur Porfetit të Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), dhe nuk ka pësuar ndonjë ndryshim apo devijim dhe as është përballur me shtesa dhe mangësi?

Është më se normale se kushdo që lexon sadopak historinë e Islamit dhe të myslimanëve do të njihet me përkujdesjen e Profetit dhe pasuesve të tij të pamëkatë (paqja qoftë mbi ta!) për të shkruar ajetet kur'anore dhe sistemimin e

tyre. Po ashtu, do të me përkujdesjen e madhe të myslimanëve në mësimin përmendësh të ajeteve të Kur'anit Fisnik, dhe siç është transmetuar se në një betejë të vetme janë vrarë shtatëdhjetë hafiza të Kur'anit Fisnik. Gjithashtu, kushdo që njihet me teuaturin e përcjelljes së Kur'anit Fisnik përgjatë katërmbëdhjetë shekujsh, me interesimin për numërimin e ajeteve, fjalëve dhe shkronjave të tij, ai studiues i historinë së Kur'anit Fisnik kurrë nuk vjen në mendje supozimi i devijimit apo i ndryshimit të Kur'anit.

Por, pa marrë parasysh këto fakte dhe argumenta historike që çojnë në bindje, ruajtjen e Kur'anit Fisnik nga devijimet dhe ndryshimet mund të argumentohet edhe me argumenta logjikë dhe të transmetuara. Pra, së pari mund të vërtetohet nëpërmjet fakteve logjikë se nuk është bërë asnjë shtesë, dhe pas kësaj, duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit, mund të vërtetohet se nuk ka asnjë mangësi në Kur'anin që është sot në duart tona.

Nga këtu marrim shkas të studiojmë temën e ruajtjes të Kur'anit Fisnik nga devijimi e ndryshimi nëpërmjet dy anëve të pavarura:

Mosekzistenca e shtesave në Kur'an

Të gjithë myslimanët janë të një mendimi se në Kur'anin Fisnik nuk ekzistojnë shtesa. Të këtij mendimi janë të gjithë ata të cilët e kanë studiuar atë nëpër botë. Ata nuk kanë gjetur asnjë faktor dhe shkak që të mendojnë se ekzistojnë shtesa në Kur'anin Fisnik. Po ashtu, nuk ekzsiton asnjë dëshmues për këtë supozim. Megjithatë, ne mund ta rrëzojmë supozimin e pranisë së shtesave në Kur'an nëpërmjet argumentit logjik me sqarimin e mëposhtëm:

Nëse do të supozojmë se në Kur'anin Fisnik ka shtesa, kjo do të thotë se mund të sillej një i tillë si ai. Ky supozim nuk përshtatet me mrekullinë e Kur'anit dhe me pamundësinë e fuqisë njerëzore që të sjellin të tillë si Kur'ani. Nëse do të

supozojmë se ka shtesë një fjalë apo edhe një ajet i shkurtër si **"Ato do të jenë të stolisura me gjelbërim."**[1], atëherë do të ndodhë përplasja e rregullit të fjalëve, si dhe dalja nga forma orgjinale dhe mrekullore e Kur'anit. Në këtë rast mundet kopjimi i tij dhe sjellja e një të ngjashmi si ai. Kjo sepse rregulli është mrekullia në shprehjet Kur'anore janë të lidhura gjithashtu me përzgjedhjen e fjalëve dhe shkronjave. Duke u përballur fjalët dhe shkronjat me ndryshimin, atëherë ai del nga gjendja e mrekullisë.

Pra, ai argument i cili konstaton mrekullinë e Kur'anit Fisnik, është po i njëjti që konstaton dhe dëshmon ruajtjen e tij nga shtesa. Po ashtu, me të njëjtin argument konstatohet dhe vërtetohet mosekzistenca e mangësive në fjalët dhe fjalitë, e cila çon në nxjerrjen e ajeteve nga gjendja e mrekullisë. Kurse fshirja e një sureje të plotë apo e një tematike të plotë, në atë formë që nuk çon në nxjerrjen e disa ajeteve nga gjendja e mrekullisë, ka nevojë për argument tjetër.

Mosekzistenca e mangësive në Kur'an

Dijetarë të mëdhenj të Islamit, si nga Shiiat ashtu edhe nga Ehli Suneti, kanë vërtetuar se Kur'ani nuk ka mangësi ashtu sikurse nuk ka shtesa. Ata kanë sjellë shumë argumenta mbi këtë të vërtetë. Mirëpo, për fat të keq, si rezultat i përcjelljes së disa transmetimeve të sajuara në librat e hadithit tek të dyja grupet, si dhe shpjegimi dhe kuptimi i gabuar i disa transmetimeve të konsideruara si të sakta[2], disa supozuan, për mos të thënë janë të mendimit se janë hequr disa ajete nga Kur'ani Fisnik.

Përkundër ekzistencës së argumentave dhe fakteve historike të besueshme mbi ruajtjen e Kur'anit Fisnik nga çdo devijim e ndryshim, qoftë shtesë a mangësi, apo nga fshirja që çon në prishje e rregullit të Kur'anit mrekulli, mund të

1. Sure "El Rahman", ajeti 64.
2. Siç janë transmetimet e përcjella në tefsirin e disa ajeteve.

vërtetojmë dhe të knstatojmë bazuar te vetë Kur'ani, se është i mbrojtur dhe i ruajtur nga fshirja e një qoftë e një ajeti apo e një sureje të veçantë.

Pasi e vërtetuam se çdo gjë që përmban Kur'ani pranishëm është fjalë e Allahut dhe në të nuk ka asnjë shtesë, atëherë përmbajtja e ajeteve të tij janë argumenti më i fortë prej argumenta të transmetueshme dhe të pasuara. Prej kuptimeve nga të cilat mund të përfitohet prej ajeteve fisnike është se Allahu i Madhëruar ka premtuar ruajtjen dhe mbrojtjen e Kur'anit nga çdo devijim e ndryshim, ndryshe nga librat e tjerë qiellorë, detyra e ruajtjes së tyre e vendosi në qafat e njerëzve.[3]

Këtë mendim ne e përfitojmë nga ajeti 9 i sures "El Hixhr", i cili thotë: **"Ne me madhërinë tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithësesi jemi mbrojtës të tij."**

Ky ajet fisnik përbëhet nga dy fjali: Në fjalinë e parë "**Ne e kemi zbritur Kur'anin**", përforcon dhe dëshmon se është Allahu i Madhëruar ai që e ka zbritur Kur'anin Fisnik. Gjatë zbritjes së tij, Kur'ani nuk është përballur me asnjë devijm apo ndryshim. Në fjalinë e dytë **"Ne do ta ruajmë atë"**, ku janë përdorur sërisht shenjat e përforcimit dhe forma që tregon vazhdimësinë, ka premtuar se do ta ruajë Kur'anin nga çdo devijim deri në fund.

Ky ajet, edhe pse tregon se nuk ka shtesa në Kur'an, por të argumentuarit e mospranisë së shtesës me anë të këtij treguesi është argument përqarkues sepse nëse do të supozohet diçka shtesë në Kur'an, kjo shtesë do të përfshijë edhe ajetin. Mohimi i këtij supozimi po me këtë ajet nuk është i saktë. Pra ne e hedhim poshtë këtë supozim me të njëjtin argument që vërtetojmë mrekullinë e Kur'anit. Pas përfitimit nga ky ajet konstatuam ruajtjen e Kur'anit nga fshirja e një ajeti apo sureje të pavarur. Në këtë mënyrë dhe nëpërmjet argumentit logjik dhe të transmetuar, vërtetojmë dhe konstatojmë mbrojtjen e

3. Është përcjellë në ajetin e 44 të sures "El Maide" rreth dijetarëve jehudë dhe të krishterë.

Kur'anit Fisnik nga çdo ndryshim, shtesë dhe mangësi.

Së fundi, duhet të theksojmë një vërejtje shumë të rëndësishme: Ruajtja e Kur'anit nga ndryshimet nuk do të thotë të konsiderojmë çdo libër dhe kopje të Kur'anit si Kur'an i plotë dhe i ruajtur nga çdo gabim në shkrim dhe lexim. Ose, ai nuk mund të përballet me asnjë shpjegim të gabuar apo devijim të brendshëm; ose, ajetet dhe suret janë renditur sipas renditjes së zbritjes të tyre. Por do të thotë se Kur'ani do të qëndrojë mes njerzve në atë formë ku çdo studiues të arrijë në të vërtetën e ajeteve të tij ashtu siç kanë zbritur, pa ndonjë shtesë apo mangësi. Prej këtu, themi se mangësitë në disa kopje të Kur'anit, ndonjë gabim në to, ndryshimi i leximeve, renditja e ajeteve apo sureve në ndryshim me kohën e zbritjes, ekzistenca e ndryshimeve të brendshme, ndryshimi i shpjegimeve sipas mendimeve personale, e të tjera, të gjitha këto nuk e ndryshojnë dhe nuk mohojnë ruajtjen e Kur'anit nga ndryshimet të cilat ne jemi duke hulumtuar.

Pyetje

1. Përse e studiojmë temën "Mbrojtja e Kur'anit nga ndryshimet"?

2. Cilat janë faktet historike mbi mbrojtjen e Kur'anit Fisnik nga ndryshimet?

3. Cili është argumenti që përforcon mbrojtjen e Kur'anit?

4. Sqaro argumentin mbi mosekzistencën e shtesave në Kur'an.

5. Cili është argumenti se nuk ekzistojnë mangësi në Kur'an?

6. A mund të argumentojmë me të njëjtin argument mosekzistencën e shtesave në Kur'an? Pse?

7. Sqaro këtë ide: Mangësitë dhe gabimet në disa kopje të Kur'anit, ndryshimet e leximeve, ndryshimi mes shkrimit të renditjes së ajeteve dhe sureve dhe zbritjes së tyre, ekzistenca e shpjegimeve të gabuara etj, nuk e mohojnë ekzistencën e mbrojtjes të Kur'anit nga devijimet.

Leksioni i tridhjetëekatërt

ISLAMI FE UNIVERSALE DHE E PËRJETSHME

Hyrje

Më parë u njohëm se besimi në të gjithë profetët dhe të gjitha mesazhet që ata kanë sjellë është i domosdoshëm.[1] Mohimi i një prej profetëve, ose i një ligji nga ligjet dhe mësimet e tyre, do të thotë mohim i fuqisë së legjislacionit hyjnor dhe është njësoj si mohimi (*kufr*) i shejtanit (*djallit*).

Pasi vërtetuam dhe konstatuam mesazhin e profetit islam, është i domosdoshëm besimi në të dhe në të gjitha ajetet që i kanë zbritur atij si dhe në të gjitha mësimet dhe rregullat që solli nga Allahu i Madhëruar.

Por, besimi në çdo profet dhe librin e tij qiellor, nuk obligon veprimin në bazë të legjislacionit të tij. Vërejmë se myslimanët i besojnë të gjithë profetëve të mëdhenj dhe të gjithë librave qiellorë por, ata nuk munden dhe nuk u lejohet që të veprojnë në bazë të sheriateve të mëparshme. Gjithashtu, më parë theksuam se: Detyra praktike e çdo ymmeti është të veprojë sipas mësimeve që i kanë zbritur profetit të dërguar për atë popull.[2] Pra, gjithë njerëzimi është i detyruar që të veprojë sipas legjislacionit islam kur konstatohet se mesazhi i profetit të Islamit nuk është i veçantë për një popull, si arabët, dhe as nuk është dërguar profet tjetër pas tij që të anullojë legjislacionin e tij. Thënë ndryshe: *Islami është fe universale, mbarëbotërore dhe e përjetshme.*

Prej këtu, obligohemi që të hulumtojmë rreth kësaj çështjeje: A është mesazhi i profetit islam universal,

1. Kthehu në leksionin e nëntëmbëdhjetë të këtij libri.
2. Kthehu në leksionin e nëntëmbëdhjetë të këtij libri.

mbarëbotëror dhe i përjetshëm? Apo është i posaçëm për një kohë dhe për popull të caktuar?

Është më se e qartë se kjo temë nuk mundet të studiohet vetëm me metodologjinë logjike, por duhet të mbështetemi edhe në metodologjinë e studimit të shkencave të transmetuara dhe historike. Që do të thotë, është e domosdoshme t'u kthehemi dokumentave dhe burimeve të konsiderueshme. Për atë që konstaton se Kur'ani është i drejtë dhe konstaton profecinë e profetit të Islamit dhe pagabueshmërinë tij, atëherë nuk ekziston asnjë burim tjetër më i saktë se Kur'ani dhe Suneti.

Islami fe mbarëbotërore

Qënia e Islamit fe mbarëbotërore dhe mospërcaktimi dhe moskufizimi i tij me një rracë apo zonë të caktuar, obligon këdo, deri edhe për ata të cilët nuk e kanë përqafuar këtë fe, që ta dinë se thirrja islame është përgjithshme dhe gjithëpërmbledhëse, e pakufizuar me një zonë të përcaktuar gjeografike. Duhet të shtojmë këtu shumë nga dëshmitë dhe argumentat historike të cilat tregojnë se Profeti i nderuar u ka dërguar letra udhëheqësve dhe mbretërve të shteteve të asaj kohe. Psh. Perandorit të Romës, Shahut të Iranit, udhëheqësve të Egjiptit, të Shamit dhe Habeshit, si dhe udhëheqësve të fiseve të ndryshme arabe. I dërgoi çdonjërit prej tyre lajmëtar të veçantë. I ftoi ata të gjithë që ta përqafojnë këtë fe të shenjtë dhe i paralajmëroi mbi mohimin, mosbesimin dhe mospërqafimin e Islamit.[3]

Nëse feja islame nuk do të ishte një fe mbarëbotërore, nuk do të realizohej thirrja e saj gjithëpërfshirëse. Popujt dhe racat e ndryshme do të justifikoheshin për mospërqafimin e kësaj feje.

3. Letrat e Profetit paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) janë përmendur në librat e konsiderueshëm të historisë. Ato janë grumbulluar gjithashtu në një libër të veçantë me titull "Letrat e Profetit."

Kështu që nuk mund të bëhej ndarja mes besimit se Islami është në të drejtë dhe domosdoshmërisë së veprimit sipas këtij legjislacioni hyjnor. Askush nuk përjashtohet nga detyrimi për të zbatuar këtë fe të Allahut.

Argumentet kur'anore rreth qënies së Islamit fe mbarëbotërore

Më parë treguam se Kur'ani Fisnik është argumenti më i mirë dhe burimi më i konsideruar për këtë të vërtetë. Konsiderimi i këtij burimi dhe argumenti i tij u sqarua në leksionet e mëparshme. Kushdo që i hedh një vështrim, qoftë edhe të shpejtë, këtij libri hyjnor, do ta kuptojë qartë përgjithshmërinë e thirrjes së tij dhe mosveçimin e tij për një race, komb apo gjuhë.

Ndër to është se në shumë ajete, Kur'ani u bën thirrje të gjithë njerëzve **"O ju njerëz"**[4], **"O bijtë e Ademit"**[5]. Udhëzimi i tij është për të gjithë njerëzimin (njerëz)[6] dhe për të gjitha botët (*alemijn*)[7]. Thirrja e Profetit u drejtohet gjithë njerëzve (*nas*)[8] dhe botëve (alemijne).[9] Në një nga ajetet e tij, dëshmon gjithpërfshirjen e thirrjessë tij për këdo që e mbërrin.[10] Nga ana tjetër, u bën thirrje pasuesëve të feve të tjera, duke i qortuar (idhtarët e librit).[11] Kur'ani Fisnik konstaton mesazhin e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), për ata si dhe

4. Sure "El Bekare", ajeti 21, sure "El Nisa", ajetet 1 dhe 174, sure "Fatir", ajeti 15.
5. Sure "El Araf", ajetet 26, 27,28,31,35, sure "Jasin", ajeti 60.
6. Sure "El Bekare", ajeti 185 dhe 187, sure "Al Imran", ajeti 138, sure "Ibrahim", ajeti 1 dhe 52, sure "El Xhathije", ajeti 20, sure "El Zumer", ajeti 41, sure "El Nahl", ajeti 44, sure "El Kehf", ajeti 54, sure "El Hashr", ajeti 31.
7. Sure "El Enam", ajeti 90, sure "Jusuf", ajeti 104, sure "Sad", ajeti 87, sure "El Tekuijr", ajeti 27, sure "El Kalem", ajeti 52.
8. Sure "El Nisa", ajeti 79, sure "El Haxh", ajeti 49, sure "Sebe", ajeti 28.
9. Sure "El Enbija", ajeti 107, sure "El Furkan", ajeti 1.
10. Sure "El Enam", ajeti 19.
11. Sure "Al Imran", ajetet 65, 70, 71, 98, 99, 110, sure "El Maide", ajeti 19 dhe 135 sure "El Teube", ajeti 33, sure "El Fet'h", ajeti 28, sure "El Saf", ajeti 9.

tregon qëllimin e zbritjes të Kur'anit Fisnik që është përhapja e Islamit dhe lartësimi i tij mbi gjithë fetë e tjera.[12]

Duke mediturar mbi këto ajete, nuk mbetet asnjë dyshim mbi përgjithshmërinë e thirrjes kur'anore dhe përbotshmërinë e fesë islame.

Përjetësia e Islamit

Ajetet e përmendura konstatojnë përgjithësinë e Islamit dhe qënien e tij fe mbarëbotërore nëpërmjet përdorimit të shprehjeve me kuptim të përgjithshëm p.sh. (bijtë e Ademit, njerëz, botëve). Po ashtu, këtë konstatim e shohim kur u drejtohen popujve të tjerë përveç arabëve, pasuesve të feve të tjera (o idhtarët e librit). Gjithashtu, nëpërmjet moskufizimit kohor, mohon lidhjen dhe kufizimin e Islamit me një kohë të caktuar. Këtë e vërteton edhe ajeti i mëposhtëm: **"...për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë..."**[13] . Kështu që nuk mbetet asnjë dyshim në lidhje me këtë çështje.

Këtë të vërtetë mund ta argumentojmë edhe me dy ajetet, 41 dhe 42 të sures "Fusilet" që thonë: **"...Ai është vërtet një Libër i madhëruesheëm. Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtra nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.**" .

Këto ajete tregojnë se Kur'ani Fisnik nuk e humbet asnjëherë vërtetësinë dhe saktësinë e tij. Po ashtu edhe argumentet që vërtetojnë vulën e profecisë me profetin e Islamit (këtë do ta studiojmë në leksionet e ardhshme), rrëzojnë çdo pandehje dhe hamendësim të abrogimit të kësaj feje hyjnore nëpërmjet ndonjë profeti apo legjislacioni tjetër.

Janë përcjellë shumë transmetime që e përforcojnë këtë idenë që feja Islame është e përjetshme. Ndër to përmendim: "E lejuara (hallall) e Muhamedit është e lejuar (hallall) deri në Ditën e Kijametit dhe e ndaluara (harami) i Muhamedit është

12. Sure "El Teube", ajeti 33, sure "El Fet'h", ajeti 28, sure "El Saf", ajeti 9.
13. Sure "El Teube", ajeti 33, sure "El Fet'h", ajeti 28, sure "El Saf", ajeti 9.

e ndaluar (haram) deri në Ditën e Kijametit."[14]

Duhet theksuar, gjithashtu, se përjetësia e Islamit, ashtu sikurse qënia e tij mbarëbotërore, konsiderohet nga domosdoshmëritë e kësaj feje hyjnore dhe nuk është nevoja për argumenta të tjerë përveç argumentave të cilët vërtetojnë se Islami është në të drejtë dhe e drejta.

Sqarimi i disa keqkuptimeve

Armiqtë e Islamit, të cilët përpiqen me gjithçka për t'u përballur me këtë fe hyjnore dhe për të ndalur përhapjen dhe zgjerimin e saj, nëpërmjet përhapjes së disa keqkuptimeve, duan të konstatojnë nëpërmjet tyre se feja islame ka zbritur vetëm për Gadishullin Arabik dhe nuk është një mesazh që përfshin mbarë njerëzimin!

Ata u kapën pas disa ajeteve të cilat tregojnë se Profeti ishte i urdhëruar që të udhëzonte të afërmit dhe fisin e tij, banorët e Mekës dhe ata rreth saj.[15] Gjithashtu, ajeti (69) i sures "El Maide" pasi flet për jahudijë, sabiinët dhe të krishterët, e konsideron boshtin e lumturisë te besimit dhe te kryerja e veprave të mira dhe nuk u përmend ndikimin e përqafimit të fesë islame në lumturi.

Në shtesë të kësaj, Jurisprudenca islame (*fikhu islam*) nuk i konsideron idhtarët e librit në të njëjtën gradë me idhujtarët, por thotë se nëse ata paguajnë taksën (*xhizjen*) (që është vend të khumsit dhe zekatit të caktuara për myslimanët) ata jetojnë të sigurtë nën hijen e shtetit islam. Ata mund të punojnë në bazë të rregullave të sheriatit të tyre. Ky është argument për të gjtha fetë.

Në përgjigje të këtij keqkuptimi të ngritur themi se: Ajetet të cilat përmendin fisin e Profetit, apo banorët e Mekës, është në konteksin që tregojnë fazat e thirrjes. Thirrja fillon me

14. El Kafij, vëll. 1, fq. 58, vëll 2, fq. 17. El Bihar, vëll. 2, fq. 260, vëll 24, fq 288. Uesailu Shiatu, vëll. 18, fq 124.

15. Sure "El Shuara", ajeti 214, sure "El En'am", ajeti 92, sure "El Shura", ajeti 7, sure "El Sexhde", ajeti 3, sure "El Kasas", ajeti 46, sure "Jasin", ajetet 5 dhe 6.

fisin e tij të afërm; më pas, me banorët e Mekës dhe rrethinat e saj e pas kësaj, vjen duke u zgjeruar për mbarë njerëzimin në të gjithë botën. Këto ajete nuk mund të jenë përveçësuese për ajetet që tregojnë se Mesazhi i Profetit është mbarëbotëror. Duhet shtuar se mënyra e formulimit të këtyre ajeteve e mohon qënien e tyre të veçantë. Kjo veçanti kërkon më shumë veçanti dhe kjo është e refuzuar tek të logjikshmit dhe arsyetuesit

Përsa i përket ajetit të përmendur në suren "El Maide", ai është në postin e sqarimit të kësaj të vërtetë se nuk mjafton vetëm emërtimi me këtë fe për të arritur në kënaqësinë e vërtetë. Por, faktori i lumturisë është besimi i vërtetë dhe zbatimi i detyrave të cilat Allahu i Madhëruar i ka caktuar për robtë e Tij. Në bazë të argumentave që vërtetojnë se Islami është një fe mbarëbotërore dhe e përjetshme, duhet që të gjithë njerëzit, pas shfaqjes së profetit të Islamit, të punojnë dhe të zbatojnë rregullat e kësaj feje dhe legjislacionin e saj.\

Kurse,veçoria me të cilën dallohen idhtarët e librit nga idhujtarët në fenë islame nuk do të thotë se falen nga përqafimi i Islamit dhe veprimi me të. Por, në të vërtetë është butësi ndaj tyre në këtë jetë për disa interesa. Sipas mendimit të Shiave kjo butësi është e përkohshme. Vendimi përfundimtar të ndaj tyre do të shpallet në kohën e shfaqjes së udhëheqësit të kohës (Allahu e shpejtoftë daljen e tij!). Qëndrimi ndaj tyre do të jetë i njëjtë si qëndrimi ndaj gjithë jobesimtarëve. Këtë kuptim mund ta përfitojmë edhe nga fjala e Allahut të Madhëruar: **"... për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë..."**

Pyetje

1. Në cilën formë obligohen të gjithë njerzit që të pasojnë Sheriatin Islam?

2. Sqaro argumentat kur'anorë mbi qënien e Islamit fe mbarëbotërore dhe e përjetshme.

3. Cilat janë argumentat e tjerë rreth kësaj ideje?

4. Sqaro këtë ide: Ajetet të cilat e urdhërojnë profetin e Islamit të udhëzojë fisin e tij të afërt dhe banorët e Mekës nuk tregojnë se mesazhi i tij është i veçantë për ta.

5. Shpjego këtë ide: Ajeti 69 i sures "El Maide" nuk tregon që të jetë ndaluar ndonjë popull të përqafojë Islamin.

6. Sqaro idenë: Leja që u është dhënë idhtarëve të librit që të veprojnë sipas legjislacionit të tyre nuk tregon se ata janë falur që të përqafojnë Sheriatin Islam.

Leksioni i tridhjetëepestë

VULA E PROFETËSISË

Hyrje

Duke vërejtur përjetësinë e fesë islame, nuk mbetet asnjë mëdyshje se mund të dërgohet ndonjë profet tjetër i cili do të abrogojë a anullojë legjislacionin islam (*Sheriatin islam*). Mirëpo, mbetet vetëm një supozim që është: Mundësia e dërgimit të ndonjë profeti tjetër, i cili do ta predikojë Islamin dhe do ta përhapë atë, ashtu siç ishin ngarkuar shumë profetë paraardhës me këtë mision, qofshin ata bashkëkohës të Profetit që kishte sheriatin, si psh. Luti (paqja qoftë mbi të!) që ishte bashkohës i Ibrahimit dhe pasues i sheriatit të tij, ose profetët të cilët u dërguan pas profetit që i zbriti sheriati dhe ata e zbatonin të njëjtin sheriat. Shembull janë shumë profetë të Beni Israelit. Nga këtu, është e dodosdoshme të bëjmë një studim të pavarur rreth vulës së profecisë, profetit të Islamit, me qëllim që të mos mbetet asnjë supozim i tillë.

Argumenti kur'anor mbi vulën e profecisë

Prej domosdoshmërive të Islamit është edhe ndërprerja e zinxhirit të profetëve (paqja qoftë mbi ta!) dhe vulosja e këtij zinxhiri me profetin e Islamit dhe nuk është dërguar dhe nuk do të dërgohet kurrë profet pas tij.

Deri edhe jomyslimanët e dinë se kjo e vërtetë është pjesë e parimeve islame dhe çdo mysliman është i obliguar që ta besojë këtë të vërtetë. Prandaj, kjo çështje është prej domosdoshmërive të fesë që nuk ka nevojë të argumentohet. Megjithatë, ajo mund të kuptohet edhe më mirë nga Kur'ani Fisnik dhe transmetimet e shumta muteuatire.

Në Kur'anin Fisnik thuhet: **"Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë."**[1]

Në këtë ajet thuhet qartës se profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e tij qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është vula e gjithë profetëve.

Disa armiq të Islamit ngritën dy kundërshtime mbi argumentimin e këtij ajeti se profeti është vula e profetëve.

I pari: Fjala "vulë" ka edhe kuptim tjetër përveç përfundimit. Ajo është unaza e dorës, rrethi që vihet në gisht për zbukurim. Ka mundësi që kuptimi i fjalës "vulë" në këtë ajet, mund të jetë edhe ky i unazës.

I dyti: Duke konsideruar se kuptimi i fjalës vulë është kuptimi i njohur, porse kuptimi i saj është që zinxhiri i profetëve (*enbijave*) vuloset me profetin (paqja dhe bekimet e tij qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nuk tregon për përfundimin e zinxhirit të të dërguarve (*er Rusul*) me anë të tij .

Përgjigja e kundërshtimit të parë: Kuptimi vulë (el khatim) është për atë me të cilën vuloset (përmbyllet) dicka. Unaza e gishtit është quajtur me këtë emër marrë për këtë kuptim, për të firmosur dhe vulosur letrat e të ngjashme me to.

Përgjigja e kundërshtimit të dytë: Çdo profet që gëzon pozitën e Revelatës, ai gjithashtu gëzon edhe pozitën e Profecisë. Me përfundimin (përmbylljen) e zinxhirit të profetëve përfundon edhe zinxhiri i resulëve (mesazhierëve), sikurse e theksuam edhe më parë.[2] Kuptimi i fjalës (nebij), edhe pse nuk është më i përgjithshëm se fjala (Resul), "en nebij" për nga përmbajtja është më i përgjithshëm se fjala "er resul".

1. Sure "El Ahzab", ajeti 40.
2. Leksioni i nëntëmbëdhjetë në këtë libër.

Argumentat e transmetuera mbi vulën e profecisë

Është përcjellë qartësisht se profeti i Islamit është vula e profecisë. Kjo është transmetuar në qindra transmetime dhe prej tyre është hadithi i pozitës (*hadijthul menzileh*)[3], të cilin e kanë transmetuar nga Profeti në formë muteuatiri si Shiiat, ashtu edhe Ehli Suneti dhe kuk ka asnjë dyshim në përmbajtjen e tij. Këtë hadith Profeti e ka thënë në kohën që ai u nis për në luftën e Tebukut dhe në Medine la Aliun si zëvendës të tij. Aliu qau dhe Porfeti i tha: *"A nuk ke dëshirë të jesh në të njëjtën pozitë siç ishte Haruni për Musain, por me përjashtim se pas meje nuk do të ketë profet."*

Në një transmetim tjetër profeti (paqja dhe bekimet e tij qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"O ju njerëz, nuk ka profet pas meje dhe nuk ka ymet tjetër pas jush."*[4]

Në një hadith tjetër thuhet se profeti ka thënë: *"O ju njerëz, nuk ka profet tjetër pas meje dhe nuk ka synet tjetër pas synetit tim."*[5]

Ky kuptim është transmetuar në shumë ligjërata të tjera në "Nehxhul Belaga"[6] si dhe në transmetimet, lutjet, vizitat (*zijaretet*) imamëve të pastër, por vendi është i ngushtë për t'i transmetuar të gjitha.

Sekreti në vulën e profetëve

Më sipër theksuam[7] se urtësia e numrit të shumtë të profetëve dhe e dërgimit të tyre gradualisht është se: Një person i vetëm e kishte të pamundur të përcillte mesazhin

3. Biharul Anuar, vëll. 37, fq. 254-289, Sahihu i Buhariut, vëll.3, fq. 58, Sahihu i Muslimit, vëll. 2, fq. 323. Sunenu ibn Maxhah, vëll. 1, fq. 28. Mustredrekul Hakim, vëll. 3, fq. 109. Musned ibn Hanbel, vëll. 1, fq. 28, vëll.1, fq. 331, vëll. 2 fq. 369, dhe 437.
4. Uesailu Shiatu, vëll.1, fq. 15, El Hisal, vëll. 1, fq. 322, El Hisal, vëll. 2, fq. 487.
5. Uesailu Shiatu, vëll.18, fq. 555, Men la Jehdharuhu el Fakijh, vëll. 4, fq. 163, Keshful Gumetu, vëll. 1, fq. 21.
6. Nehxhul Belagah, ligjërata e parë, ligjerata e 69, 83, 87, 129, 168, 193, 230.
7. Leksioni i nëntëmbëdhjetë në këtë libër.

hyjnor dhe ta përhapë atë në të gjitha vendet e botës, në çdo popull dhe sidomos në kohët e mëparshme.

Kjo ishte njëra anë. Ndërsa nga ana tjetër, zgjerimi i marrëdhënieve, shfaqja e dukurive të reja shoqërore, obligonin vendosjen e rregullave të reja ose ndryshimin e ligjeve të mëparshme. Gjithashtu, ndodhja e ndryshimeve dhe devijimeve si rezultat i ndërhyrjeve të qëllimshme, si dhe nga shkaku i paditurisë së disa personave apo grupeve, e gjitha kjo kërkonte rregullimin dhe ndryshimin e mësimeve hyjnore nëpërmjet një profeti tjetër. Në qoftë se do të ishin kushtet dhe rrethanat nëpërmjet të cilave një profet i vetëm të përcillte mesazhin hyjnor për gjithë botën, duke u mbështetur tek mbështetësit dhe pasuesit e tij; nëse ligjet dhe mësimet e atij profeti do të ishin në përshtatje me çdo nevojë dhe kërkesë të shoqërisë bashkëkohëse dhe të ardhshme dhe këto ligje do të siguronin të gjitha nevojat e domosdoshme mbi çështjet dhe problemet e reja dhe do të gjendej garantues që do të merrte përsipër qëndrimin e atyre ligjeve dhe mbrojtjen nga devijimet, nëse do të gjendeshin të gjitha këto, nuk është i nevojshëm dërgimi i një profeti tjetër.

Mirëpo, dijet dhe njohuritë e zakonshme njerëzore nuk mund të përcaktojnë këto kushte dhe faktorë. Ndërsa Allahu i Madhëruar me diturinë e Tij të pakufishme që me të rrethon gjithëçka, e ka mundësinë që të përcaktojë kohën e realizimit të këtyre rrethanave. Është Ai i Cili mund të lajmërojë vulën e profetëve, sikurse e bëri në Librin e fundit prej librave të Tij qiellor.

Megjithëse vula e profetëve nuk do të thotë ndërprerje e plotë e marrëdhënieve të udhëzimit mes Allahut dhe robëve të Tij. Allahu i Lartësuar i jep prej diturive të gajbit disa prej robëve të Tij të devotshëm kur e sheh atë të nevojshme, edhe nëse nuk bëhet nëpërmjet vahjit të profecisë. Shiiat besojnë se këto dituri të fshehta Allahu ua ka dhënë imamëve të pastër. Në leksionet e ardhshme do të flasim rreth kësaj teme.

Përgjigje mbi keqkuptimin

Më sipër arritëm në përfundimin se sekreti i vulës së profecisë është:

Së pari: Profeti i Islamit me ndihmën e mbështetësve dhe pasuesve të tij, mund ta përçojë mesazhin e tij në veshët e gjithë njerëzve në mbarë botën.

Së dyti: Sipërmarrja e mbrojtjes së Librit qiellor nga çdo ndryshim.

Së treti: Legjislacioni Islam është në gjendje që t'u përgjigjet të gjitha nevojave njerëzore deri në fundin e botës.

Mirëpo shfaqen kundërshtime te pika e tretë që thotë: Kompleksiteti i marrëdhënieve shoqërore në periudhat e kaluara çoi në vendosjen e ligjeve të reja ose në ndryshimin e ligjeve të mëparshme dhe për këtë dërgohej një profet tjetër. Kjo gjë vazhdoi gjithashtu edhe pas profetit të Islamit sepse, kanë ndodhur ndryshime të dukshme dhe marrëdhëniet shoqërore janë bërë më të ndërlikuara. Si ka mundësi që këto ndryshime nuk duan një legjislacion (*sheriat*) të ri?

Përgjigja: Ashtu sikurse e theksuam edhe më sipër, një njeri i zakonshëm nuk është në gjendje të përcaktojë ndryshimet që mund të ndodhin dhe të cilat kërkojnë ndryshimin e legjislacionit bazë sepse, ne nuk i njohim të gjitha shkaqet e rregullave dhe urtësinë e tyre. Por, nëpërmjet argumenteve konstatuese të përjetësisë së Islamit dhe vulës të profecisë, zbulojmë panevojshmërinë e ndryshimit të ligjeve dhe legjislacionit bazë të Islamit.

Vërtet, ne nuk e mohojmë ekzistencën e disa dukurive të reja shoqërore të cilat kërkojnë ligje të reja, por në Sheriatin islam janë vendosur baza dhe rregulla të përgjithshme nga të cilat nxirren rregullat dytësore. Këtë e bën ai që ka kompetenca në këtë fushë dhe që nxjerr rregullat e duhura nga legjislacioni bazë islam. Kjo ide trajtohet më gjerë në Jurisprudencën islame (*Fikhun Islam*) te tematika: Kompetencat e shtetit islam (imami i pagabueshëm dhe uelijul fakih).

Pyetje

1. Pasi e konstatuam përjetësinë e Islamit, përse është i nevojshëm studimi rreth vulës së profecisë?

2. Si mund ta vërtetojmë vulën e profecisë me argument kur'anor?

3. Përmend keqkuptimet që u shfaqën rreth këtij argumenti dhe përgjigjen e tyre.

4. Përmend tre transmetime nga transmetimet që tregojnë vulën e profecisë.

5. Përse zinxhiri i profetëve u vulos (përmbyll) me profetin Islamit?

6. A është vula e profecisë mbyllje e rrugëve të përfitimit nga dituritë hyjnore? Dhe pse?

7. Ndryshimet shoqërore pas shfaqjes së profetit islam kërkojnë legjislacion të ri? Pse?

8. Si mundet që t'i përgjigjet nevojës shoqërore për ligje të cilat trajtojnë ngjarje dhe dukuri të reja?

Leksioni i tridhjetëegjashtë

IMAMATI (UDHËHEQËSIA)

Hyrje

Profeti, (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) pas emigrimit në Medine, mbrojtjes së banorëve të saj ndaj tij dhe myslimanëve që emigruan nga Meka, të cilët u quajtën "Muhaxhirë", emigrantët dhe banorët e Medinës u quajtën "Ensarë"(përkrahës), ai vendosi bazat e shoqërisë islame dhe të administrimit të saj. Xhamia e Profetit ishte streha ku mblidheshin myslimanët për të zgjidhur çështjet dhe problemet e tyre ekonomike dhe jetësore. Në shtesë të qënies së saj vendadhurim, xhamia ishte pikënisja e përhapjes të mesazhit hyjnor; vendi i mësimit të njerëzve dhe edukimit të tyre; vendi trajtimit të mosmarrëveshjeve dhe çështjeve gjyqësore; ishte qendra e vendimarrjeve ushtarake dhe furnizimit të fronteve të luftës me njerëz dhe pajisje; ishte vendtrajtimi i të gjithë çështjeve shtetërore. Thënë me fjalë përmbledhëse: I gjithë administrimi i çështjeve të njerëzve, qofshin ato fetare apo të kësaj bote, kryhej nga vetë profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Myslimanët e shihnin veten e tyre të obliguar në bindjen ndaj mësimeve dhe urdhrave të profetit, sepse Allahu i Madhëruar në shtesë të obligimit absolut për bindje ndaj profetit,[1] ka urdhëruar qartë dhe prerazi se profetit i

1. Sure "Al Imran", ajeti 32 dhe 132, sure "El Nisa", ajetet 12, 14, 69, 80, sure "El Maide", ajeti 92, sure "El Enfal", ajetet 1, 20, 46, sure "El Teube", ajeti 71, sure "El Nur", ajetet 51, 54, 56,sure "El Ahzab", ajetet 66, 71, sure "El Huxhurat", ajeti 14, sure "El Fet'h", ajetet 16, 17, sure "Muhamed",ajeti 32, sure "El Muxhadele", ajeti 12, sure "El Mumtehine", ajeti 12, sure "El Tegabun", ajeti 12, sure "El Xhin", ajeti 23.

takon vilajeti dhe udhëheqja e këtij populli[2], veçanërisht në fushën politike, gjyqësore dhe ushtarake.

Me fjalë të tjera: Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), në shtesë të postit të Profecisë dhe mesazhit, postit të detyrës së mësimit të rregullave dhe të sqarimit të tyre, kishte gjithashtu një tjetër post hyjnor, që ishte udhëheqja e ymetit islam dhe vilajeti mbi të. Nga ky post degëzohen poste të tjera si gjyqësori, udhëheqja ushtarake etj. Feja islame, ashtu sikurse përfshin detyrat e adhurimit dhe moralit, gjithashtu përfshin edhe rregullat politike, ekonomike, juridike etj. Profeti, ashtu sikurse ishte ngarkuar edhe me detyrën e predikimit, mësimit dhe edukimit, po ashtu, ishte ngarkuar nga Allahu i Madhëruar me misionin e zbatimit dhe praktikimit të rregullave dhe legjislacionit të Allahut. Pra, në dorën e Profetit ishte e gjithë detyra e udhëheqjes.

Është mëse e natyrshme se feja, e cila pretendon udhëheqjen e mbarë njerëzimit deri në fundin e kësaj bote, nuk mund të mosinteresohet dhe të mos përkujdeset për çështjet dhe problemet e njerëzve. Nuk është e mundur që një shoqëri e ngritur mbi bazën e fesë, të mos ketë këtë mision dhe post politik dhe qeveritar. Këto detyra dhe përgjegjësi, përmblidhen të gjitha nën temën (Imametu).

Mirëpo fjala është se kush duhet ta kryejë këtë detyrë pas vdekjes të Profetit? Kush është ai që e cakton një person të tillë (imamin) në këtë detyrë (post)?

Vallë, a është Allahu i Madhëruar Ai që e caktoi Profetin në këtë detyrë, caktues edhe për të tjerët? A qëndron legjimitetit i këtij posti te caktimi hyjnor? Apo caktimi nga Allahu i Madhëruar është i posaçëm vetëm për profetin, kurse njerëzit pas të zgjedhin imamin dhe të caktojnë udhëheqësin e tyre? A kanë të drejtë njerëzit të zgjedhin imamin apo jo?

2. Sure "Al Imran", ajeti 152, sure "El Nisa", ajetet 42, 59, 65, 105, sure "El Maide", ajeti 87, sure "El Haxh", ajeti 67, sure "El Ahzab", ajetet 6, 36 sure "El Muxhadele", ajetet 8-9, sure "El Hashr", ajeti 7.

Kjo është pika kryesore e dallimit mes Shiave dhe Ehli Suneti. Shiat besojnë se imamati është pozitë hyjnore. Është e domosdoshme që në këtë post të përzgjidhen nga ana e Allahut të Madhëruar njerëzit e virtytshëm. Allahu i Madhëruar, nëpërmjet të Dërguarit të Tij, profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), caktoi si prijës të besimtarëve imam Aliun (paqja qoftë mbi të!) i cili do të ishte pasues i tij i drejtpërdrejtë dhe pas tij caktoi njëmbëdhjetë imamë nga fëmijët e imam Aliut si pasues të tij.

Ehli Suneti besojnë se imamati hyjnor është njëlloj si Profecia dhe Shpallja, e cila ka përfunduar me vdekjen e Profetit. Profeti ia ngarkoi njerëzve misionin e caktimit të imamit pas tij. Disa nga dijetarët e mëdhenj të Ehli Sunetit kanë deklaruar se: nëse dikush sundon me forcën e armëve mbi njerëzit dhe kap frerët e çështjeve të tyre, atëherë të tjerët janë të detyruar që t'u binden atij.[3]

Është mëse e qartë se të tilla ide i hapin derën tiranëve dhe zullumqarëve për të arritur lakmitë dhe ambicjet e tyre, si dhe ofrojnë kushte dhe faktorë për përcarje dhe prapambetjes mes myslimanëve.

Në realitet, Ehli Suneti me besimin e tyre se imami nuk është caktim nga ana e Allahut, vendosën gurin e themelit të idesë së largimit të fesë nga politika. Sipas besimit të Shiitëve kjo çështje është e rrezikshme dhe udhëkryq i rrezikshëm për devijim nga rruga islame e drejtë dhe e vërtetë dhe nga adhurimi i Allahut në të gjitha aspektet dhe dimensionet e jetës. Gjithashtu, ka qenë pikënisje për mijëra devijime të tjera të cilat u shfaqën në mesin e myslimanëve pas vdekjes të Profetit.

Nga këtu, është e domosdoshme që çdo mysliman duhet ta studiojë këtë temë me seriozitet dhe larg nga imitimi

3. El Ahkam el Sulltanijetu, i Ebu Ja'li, ue terxhemetu "es Seuad el a'dham" i Ebi Kasim el Samerkandi, e përktheu Suad El Adham, fq. 40-42.

dhe fanatizmi.[4] Duhet të përpiqet me të gjitha mundësitë e tij të zbulojë medhhebin e vërtetë dhe ta mbrojë atë. Duhet që mbi gjithçka të vëmë interesin e përgjithshëm të botës islame. Është detyrë që pasuesit e medhhebeve të ndryshme të distancohen nga përçarja, konflikti dhe mosmarrëveshja, të cilat i hapin rrugë armiqve të Islamit që të realizojnë lakmitë e tyre dhe të plotësojnë ambicjet djallëzore. Nuk duhet të kryhen vepra të cilat shkaktojnë zgjerimin e përçarjes së rreshtave të myslimanëve dhe dobësojnë fuqitë e tyre përballë jobesimtarëve. Në fund, dëmet dhe shkatërrimet e këtyre përçarjeve do të prekin të po vetë myslimanët duke çuar në dobësimin e ymetit islam. Mirëpo, ruajtja e bashkimit dhe e unitetit mes myslimanëve nuk duhet të jetë pengesë për studimin dhe përpjekjen në rrugën e njohjes së medhhebit të vertetë dhe në krijimin e kushteve të dhe atmosferës së përshtatshme për studimin e çështjeve të imamatit dhe trajtimin e saj. Këto çështje, të cilat me trajtimin e tyre të saktë, ndikojnë në jetën e myslimanëve dhe lumturinë e tyre në këtë botë dhe Botën Tjetër.

Kuptimi i Imamatit

El Imametu, në gjuhësi do të thotë "udhëheqje". Çdokush që udhëheq një grup quhet imam, qoftë ai në rrugën e drejtë apo në rrugën e gabuar. Në Kur'anin Fisnik udhëheqësit e jobesimtarëve janë quajtur "Imamët e mosbesimit."[5]

Ai që udhëheq myslimanët gjatë faljes, gjithashtu, quhet "imam i xhematit".

4. Është për t'u përmendur se dijetarët e mëdhenj kanë shkruar shumë libra dhe studime në këtë fushë në gjuhë dhe metodologji të ndryshme. Ata shtruan rrugën e drejtë për studiuesit rreth të vërtetës. Mund të përmendim shembuj të shumtë si: "Kitab Abakatul Enuar, El Gadijr, Delalilu Sidk, Gajetul Meram ue Ithbat el Hudat. Atë që nuk e kanë lejuar rrethanat për studim dhe zgjerim, e inkurajojmë që të lexojë librin "El Muraxheat", i cili është një përmbledhje letërkëmbimesh ndërmjet dy dijetarëve, Shiitë dhe Ehli Suneti, si dhe librin "Aslu Shiatu ue Usuluha".
5. Sure "El Teube", ajeti 12.

Në terminologjinë e apologjisë (*ilmulkelam*) fjala *el Imametu* është: Udhëheqja e përgjithshme, gjithëpërfshirëse e ymetit islam në të gjitha fushat fetare dhe të dynjasë.

Është përmendur fjala "*dunjauijeh*", të kësaj jete, për të përforcuar gjerësinë e fushës së imamatit sepse edhe administrimi i çështjeve të dynjasë së ymetit islam është pjesë e fesë islame.

Në mendimin e shiave, kjo udhëheqje dhe drejtim është e ligjëruar nëse është nga ana e Allahut të Madhëruar dhe këtë pozitë nuk e fiton asnjë person vetëm ai që është i mbrojtur nga gabimet në sqarimin e rregullave dhe njohurive islame dhe është i pastër nga gjynahet. Në të vërtetë, imami i pagabueshëm i ka të njëjtat detyra të profetit, përveç Shpalljes dhe Mesazhit. Ashtu sikurse fjalët e tij janë argument në sqarimin e të vërtetave, legjislacionit, ligjeve dhe dijeve islame, po ashtu duhet zbatuar bindja ndaj urdhrave dhe ligjeve të tij në çështjet e ndryshme qeverisëse.

Prej këtu dalim në përfundimin se dallimet mes Shiave dhe Ehli Sunetit mbi temën e Imamatit është në tri çështje:

E para: Është e domosdoshme që Imami të jetë caktuar nga Allahu.

E dyta: Duhet që imami të ketë dijen e dhuruar nga Allahu dhe të jetë i ruajtur nga gabimet.

E treta: Është e domosdoshme që të jetë i mbrojtur nga gjynahet dhe mëkatet.

Është e qartë se pagabueshmëria nuk është prej veçorive të Imamatit, sepse Fatime Zahraja (paqja qoftë mbi të!), sipas besimit të Shiave, ishte e pagabueshme, por nuk kishte gradën e Imamatit. Po ashtu edhe Merjemja (paqja qoftë mbi të!) e kishte pozitën e pagabueshmërisë. Mund të ketë edhe në mesin e evlijave të Allahut prej atyre që e kanë arritur pozitën e pagabueshmërisë edhe pse ne nuk i njohim ata. Njeriu i pagabueshëm nuk mund të njihet vetëm e vetëm nëpërmjet rrugës së njohjes hyjnore.

Pyetje

1. Cilat janë postet e tjera hyjnore të profetit të Islamit përveç Shpalljes dhe Mesazhit?
2. Cila është pika kryesore e dallimit ndërmjet Shiave dhe Ehli Sunetit?
3. Cilat janë ndikimet në besimin te Imamati i pacaktuar nga ana e Allahut?
4. Përmend kuptimin gjuhësor dhe terminologjik të Imamatit.
5. Cilat janë çështjet bazë të temës së Imamatit?

Leksioni i tridhjetëeshtatë

NEVOJA E PRANISË SË IMAMIT

Hyrje

Shumë prej atyre të cilët nuk i kanë studiuar çështjet doktrinale në thellësi pandehin dhe hamendësojnë se dallimi ndërmjet Shiave dhe Ehli Sunetit sa i përket çështjes së Imamatit, përqëndrohet rreth një pike: Shiitët besojnë se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) caktoi Ali ibn Ebi Talibin halif të tij në administrimin e ymetit, ndërsa Ehli Suneti besojnë se nuk ka ndodhur një caktim i tillë dhe se njerëzit, me zgjedhjen e tyre të plotë dhe me vullnetin e tyre, zgjodhën udhëheqësin. Ndërsa halifi (zëvendësi i profetit) i parë e caktoi vetë halifin që do ta zëvendësonte. Në periudhën e tretë, misioni i zgjedhjes së halifit iu ngarkua një grupi të përbërë nga gjashtë persona. Halifin e katërt e zgjodhën njerëzit me zgjedhje të përgjthshme. Prandaj, nuk ekziston një mënyrë e caktuar për të caktuar halifin në mesin e myslimanëve. Për këtë, pas halifit të katërt ky post u mor prej atij që ishte më i fuqishëm ushtarakisht nga të tjerët, sikurse është mënyra zbatuese në vendet jomyslimane.

Thënë ndryshe: Disa supozojnë se Shiitët besojnë në çështjen e caktimit të imamit të parë ashtu sikurse besojnë Ehli Suneti në caktimin e halifit të dytë nga halifi i parë me një ndryshim se mendimin e Profetit dhe caktimin e tij nuk e pranuan njerëzit, kurse mendimin e halifit të parë dhe caktimin e tij e pranuan njerëzit!

Shtrohet pyetja: Si paska të drejtë halifi i parë që të caktojë halife pas tij? A nuk ishte Profeti i Allahut, sipas besimit të Ehli Sunetit, më i ndjeshëm dhe më i kujdesshëm

për Islamin se halifi i parë? Si e neglizhoi profeti ymetin islam të posalindur që të rrinte pa udhëheqës, ndërkohë që, sa herë dilte nga Medina, në luftë në rrugën e Allahut, ai caktonte një halif pas tij në Medine, duke mos harruar se Profeti ka lajmëruar se do të ndodhnin përçarje dhe mosmarrëveshje në ymetin e tij?

Duke lënë mënjanë këtë pyetje dhe pyetje të tjera, është e rëndësishme të dimë se dallimi ndërmjet Ehli Suneti dhe Shiitëve para çdo gjëje është rreth kësaj pike: A është pozita e imamatit pozitë fetare dhe i nënshtrohet sheriatit dhe caktimit hyjnor, apo është pushtet i dynjasë që i nënshtrohet faktorëve shoqërorë?

Shiitët besojnë se edhe vetë Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), nuk ishte i pavarur në caktimin e halifit pas tij, por ai e caktoi atë me urdhërin nga Allahu. Në realitet, urtësia në vulën e Profecisë është e lidhur plotësisht me caktimin e imamit të pagabueshëm. Me ekzistencën e një imami të tillë, ai do të kujdeset për ofrimin e interesave të domosdoshme në ymetin islam mbas Profetit.

Prej këtu bëhet e qartë se përse imamati prezantohet në mendimin Shiit si parim i besimit dhe jo si rregull dytësor juridik; përse merren në konsideratë tre kushtet për imamin (dituria e dhuruar nga Allahu, pagabueshmëria dhe caktimi hyjnor); përse u përzien këto kuptime në traditën Shiite me kuptimin e merxhiijetit për njohjen e rregullave të Allahut, të qeverisjes dhe udhëheqjes së ymetit islam derisa termi imamat tregon për të gjitha këto kuptime.

Pasi u njohëm me kuptimin e imamatit dhe pozitën e tij ndërmjet doktrinës Shiite, do të studiojmë rreth saktësisë së këtij besimi.

Domosdoshmëria e ekzistencës së imamit

Në leksionin e njëzet e dy u sqarua se realizimi i qëllimit të krijimit të njeriut është i lidhur me udhëzimin e tij nëpërmjet

Shpalljes. Urtësia e Allahut bëri që të dërgohen profetët të cilët i mësonin njerëzve rrugën e lumturisë në këtë botë dhe në Botën Tjetër duke iu përgjigjur kësaj nevoje. Gjithashtu, ata bënë edukimin e personave të aftë për t'i çuar ata në fazën finale të përsosurisë dhe predikuan për praktikimin dhe zbatimin e rregullave dhe legjislacioneve fetare dhe shoqërore.

Në leksionin e tridhjetë e katërt dhe tridhjetë e pestë sqaruam se feja islame është fe e përbotshme dhe e përjetshme. Është e pandryshueshme dhe pas profetit të Islamit nuk do të ketë profet tjetër. Vula e profetëve përputhet me urtësinë e dërgimit të profetëve, sepse legjislacioni qiellor i fundit i përgjigjet të gjitha nevojave njerëzore. Qëndrimi i këtij legjislacioni përmbyllës është i garantuar deri në fundin e kësaj bote. Kur'ani Fisnik e ka marrë vetë përsipër këtë garanci. Allahu i Madhëruar është betuar se do ta ruajë këtë Libër Fisnik nga çdo ndryshim dhe devijim. Jo të gjitha rregullat dhe mësimet islame përfitohen nga pamja e jashtme e ajeteve kur'anore. Psh. Kur'ani Fisnik nuk na e tregon mënyrën e kryerjes të namazit dhe numrin e rekateve të tyre, si dhe qindra rregulla të tjera të detyrueshme dhe të pëlqyeshme.

Kur'ani Fisnik nuk është në rangun e shpjegimit të imtësive të legjislacionit, por duhet thënë së kjo detyrë iu ngarkua Profetit[1] që të sqaronte nëpërmjet diturisë që i dhuroi Allahu i Madhëruar (përveç Shpalljes së Kur'anit). Prej këtu vërtetohet dhe konstatohet argumenti i Sunetit (traditës) të Profetit, që konsiderohet prej referimeve bazë për njohjen e Islamit.

Mirëpo kushtet dhe rrethanat e vështira në të cilat jetoi Profeti, sikurse ishin vitet të cilat jetoi i izoluar në lagjen e Ebi Talibit, apo dhjetë vite luftrash me armiqtë e Islamit, nuk i dhanë mundësi atij që të sqaronte të gjitha rregullat dhe legjislacionin islam për mbarë njerzit. Edhe atë të cilën e mësuan shokët e tij nuk garantonte sigurinë e ruajtjes së

1. Sure "El Bekare", ajeti 151, sure "Al Imran", ajeti 164, sure "El Xhuma", ajeti 2, sure "El Nahl", ajetet 44, 64, sure "El Ahzab", ajeti 21, sure "El Hashr", ajeti 7.

saj. Ata u ndryshuan në mënyrën e marrjes së abdesit edhe pse të gjithë e shihnin duke e kryer këtë veprim për vite të tëra. Pra, nëse ata kanë mosmarrëveshje dhe kontradita rreth rregullave të një vepre për të cilën kanë nevojë të gjithë myslimanët dhe e kryejnë atë disa herë në ditë, duke ditur që nuk kanë ndonjë shtysë apo motiv që të bëjnë devijime dhe ndryshime të qëllimshme, atëherë rreziku i gabimit, dyshimi në transmetim dhe devijimet e qëllimshme janë më të shumta në fushën e ligjeve specifike, veçanërisht ato rregulla dhe ligje të cilat përplasen me interesat dhe lakmitë e disa personave dhe grupeve të veçanta.[2]

Nga këtu bëhet e qartë se feja islame mund të paraqitet si fe e plotë dhe gjithëpërfshirëse, e cila i përgjigjet të gjitha nevojave dhe mbarë njerëzimit deri në fundin e botës. Nëse do të supozonim ekzistencën e një rruge që do të përmbushte interesat e domosdoshme të ymetit në brendësi të vetë fesë, ato interesa të cilat mund të përballen me rrezikun dhe shkatërrimin dhe me vdekjen e profetit, kjo rrugë do të ishte caktimi i halifit të drejtë, i cili zotëron diturinë e dhënë nga Allahu e cila e mundëson atë të sqarojë të vërtetat fetare me të gjitha dimensionet e tyre.

Ai gëzon zotërimin e pagabueshmërisë e cila e bën atë që të mos i nënshtrohet ndikimit të motiveve dhe shtysave të brendshme dhe djallëzore. Gjithashtu, ai mund të kryejë rolin edukues, të cilin e posedonte edhe Profeti, si dhe edukimin e personave të aftë dhe ngritjen e tyre në gradat më të larta të përsosmërisë. Në kohën që krijohen kushtet e përshtatshme shoqërore, udhëheq, drejton dhe administron çështjet e ymetit islam, praktikon legjislacionin shoqëror islam dhe zbaton e përhap të drejtën dhe drejtësinë në botë.

2. Në librin e tij El Gadijr, eruditi El Eminij ka përmendur emrat e 700 sajuesve të hadithit. Mendohet se ata kanë sajuar rreth 100 mijë hadithe. Kthehu tek El Gadijr, vëll. 5, fq. 208.

Konkluzioni

Vula e profetëve është në përputhje me urtësinë hyjnore nëse do të shoqërohet me caktimin e imamit të pagabueshëm, i cili zotëron të gjitha veçoritë e Profetit të Islamit, përveç Revelatës dhe Mesazhit. Kështu vërtetohet domosdoshmëria e ekzistencës së Imamit. Po ashtu edhe domosdoshmëria e pajisjes me dijen e dhuruar nga Allahu, pozita e pagabueshmërisë, si dhe domosdoshmëria e caktimit të tij nga ana e Allahut të Madhëruar, sepse vetëm i Lartësuari e njeh personin të cilit i ka dhënë diturinë dhe pagabueshmërinë, si dhe, në parimisht, Ai e zotëron të drejtën e pushtetit mbi robtë e Tij. Ai i Lartësuari mund t'ia dhurojë këtë të drejtë personave të cilët gëzojnë kushtet dhe kriteret e caktuara.

Ajo që duhet të theksojmë më tepër është se: Ehli Suneti nuk i përmend këto cilësi te asnjë halif. Ata nuk thonë se caktimi i tij bëhet nga Allahu i Madhëruar dhe nga Profeti. Sipas tyre, halifat nuk kanë diturinë e ofruar nga Allahu dhe nuk zotërojnë pagabueshmërinë.

Ata kanë transmetuar në librat e tyre, që konsiderohen referenca, të metat e tyre, dyshimet e tyre dhe paaftësitë e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve fetare që drejtonin njerëzit. Prej atyre transmetimeve është ai që përcjellin për halifin e parë i cili ka thënë: "*Unë kam një shejtan që më brengos.*"[3] Kanë transmetuar nga halifi i dytë i cili ka thënë: "*Përzgjedhja e halifes së parë u bë me të shpejtë dhe pa u menduar mirë.*"[4] Ai vazhdimisht e përsëriste këtë shprehje: "*Nëse nuk do të ishte Aliu do të ishte shkatërruar Umeri.*"[5] Kurse të këqijat e halifit të tretë[6] halifat e Beni Umejes dhe Beni Abas janë aq të qartë sa nuk ka nevojë të përmenden. Ata njihen nga çdonjëri që ka lexuar sadopak rreth historisë së myslimanëve.

3. Sherh Nehxhul Belaga i autorit ibn Ebi Hadijd, vëll. 1, fq. 58, dhe vëll. 4, fq. 231-262. El Gadijr, vëll. 7, fq. 102-180.
4. Sherh Nehxhul Belaga, vëll. 1, fq. 142-185, vëll. 3, fq. 57.
5. El Gadijr, vëll. 6, fq. 93 dhe në vazhdim.
6. El Gadijr, vëll. 8, fq. 97 dhe në vazhdim.

Shiitët janë të vetmit që besojnë në ekzistencën e tre kushteve tek dymbëdhjetë imamët. Ajo çka përmendëm e vërteton saktësinë e besimit të tyre në çështjen e Imamatit dhe nuk ka nevojë për argumenta më të gjerë dhe detajues. Në leksionin e ardhshëm do të paraqesim disa argumenta të marra nga Kur'ani dhe Suneti.

Pyetje

1. Përmend mendimin e Shiitëve mbi temën e imamatit dhe dallimin mes mendimit të tyre dhe mendimit të Ehli Sunetit.

2. Përse e konsiderojnë Shiitët imamatin si parim të doktrinal?

3. Sqaro mendimin e domosdoshmërisë së imamit?

4. Cilat janë rezultatet që dalin nga ky sqarim?

Leksioni i tridhjetëetetë

CAKTIMI I IMAMIT

Në leksionin e kaluar sqaruam se vula e profetëve, pa u caktuar imami i pagabueshëm, bie në kundërshtim me urtësinë e Allahut. Përsosuria e fesë islame, që është e përbotshme dhe e përjetshme, është e lidhur me caktimin e halifeve të devotshëm pas Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të gëzojnë të njëjtat pozita hyjnore si profeti, përveç Shpalljes dhe Mesazhit.

Kjo ide mund të përfitohet edhe nga ajetet e Kur'anit Fisnik dhe transmetimeve të shumta të cilat i kanë përcjellë Shiitët dhe Ehli Suneti në shpjegimin e këtyre ajeteve. Prej atyre ajeteve është ajeti i tretë i sures "El Maide": **"...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj..."**

Të gjithë komentuesit kanë rënë ndakort se ky ajet ka zbritur në Haxhin e Lamtumirës, disa muaj para vdekjes të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ajeti fisnik, pasi tregon për humbjen e shpresës së jobesimtarëve për të dëmtuar Islamin, thotë: "... **Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë..."** përforcon plotësimin dhe përsosurinë e fesë në atë ditë, si dhe plotësimin e mirësisë së Allahut të Lartësuar.

Duhet theksuar se shumë nga transmetimet e përcjella rreth shkakut të zbritjes së këtij ajeti, qartësohet se përsosja dhe plotësimi, që janë të shoqëruara me humbjen e shpresës së jobesimtarëve për të dëmtuar Islamin, u realizuan me caktimin e halifit të Profetit nga ana e Allahut të Madhëruar. Kjo, sepse armiqtë e Islamit pandehnin se Islami do të mbetej

pa udhëheqës pas vdekjes të Profetit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), veçanërisht, kur dihej se Profeti nuk kishte pasardhës meshkuj. Në këtë mënyrë, Islami do të përballej me dobësi dhe zhdukje. Mirëpo, Islami e arriti përsosmërinë e tij me caktimin e halifes së Profetit. Kështuqë u plotësua mirësia e Allahut dhe u zhdukën lakmitë e jobesimtarëve dhe shpresat e tyre.[1]

Ky caktim u realizua kur Profeti u kthye nga Haxhi i Lamtumirës. Të gjithë haxhinjtë u grumbulluan në vendin e quajtur "Gadijr Khum". Gjatë një fjalimi të gjatë që u mbajti, Profeti i pyeti *"A nuk jam më parësor tek ju se sa vetë vetat tuaja?"*[2] I thanë: *"Po"*. Pastaj mori dorën e Aliut (paqja qoftë mbi të!) e ngriti lart para njerzve dhe tha: *"Për të gjitha ata që unë jam kujdestari (udhëheqësi) i tij, Aliu është kujdestari (udhëheqësi) i tij."* Me këtë, vërtetoi për imamin caktimin hyjnor dhe të gjithë njerzit e pranishëm i dhanë besën atij. Prej tyre ka qenëe dhe halifi i dytë i cili duke e përgëzuar i tha: *"Urime urime o Ali. U bëre udhëheqësi im dhe udhëheqësi i gjithë besimtarëve dhe besimtareve."*[3]

Në atë ditë zbriti ajeti fisnik: **"...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj..."** I Dërguari i Allahut pasi madhëroi Allahun tha: *"U plotësua profecia ime, u plotësua feja e Allahut dhe udhëheqësia e Aliu pas meje."*

Është përcjellë një transmetim nga një prej dijetarëve të mëdhenj të Ehli Sunetit (El Hameuejni) i cili thotë: *"U ngrit Ebu Bekri dhe Umeri dhe pyetën: "O i Dërguari i Allahut, a janë këto ajete të veçanta për Aliun?"* U përgjigj: *"Po. Për atë dhe për porositësit e mi deri në Ditën e Kijametit."* I thanë: *"O i Dërguari i Allahut. Na i trego ata edhe neve."* Profeti u tha: *"Aliu vëllai*

1. Për t'u zgjeruar edhe më tepër rreth këtij ajeti, kthehu tek tefsiri "El Mijzan", vëll. 5, fq. 156 dhe në vazhdim.

2. Këtë e tregon edhe ajeti 6 i sures "El Ahzab", i cili thotë: **"I Dërguari është më i afërt për besimtarët..."**

3. Për t'u siguruar më tepër rreth vërtetësisë së prerë të zinxhirt të hadithit dhe argumentit të tij kthehu tek "Abakatul Enuar" dhe "El Gadijr".

im, zëvendësi im, trashëgimitari im, amaneti im, halifi im i këtij populli dhe udhëheqësi i çdo besimtari pas meje. Pas tij vjen biri im Hasani, pas tij biri im Husejni dhe pas tyre, nëntë nga djemtë e birit tim Husejnit njëri pas tjetrit. Kur'ani është me ata dhe ata janë me Kur'anin. Ata nuk e ndajnë atë dhe ai nuk i ndan ata derisa të bashkohen me mua te burimi."[4]

Nga transmetime të shumta përfitohet se Profeti ishte urdhëruar para kësaj që të njoftonte zyrtarisht njerëzit për prijësinë e prijësit të besimtarëve por, ai kishte frikë se njerëzit do ta konsideronin si mendimin e tij personal dhe nuk do ta pranonin. Për këtë, priste rastin e volitshëm që të krijoheshin kushtet dhe rrethanat për të njoftuar këtë caktim, derisa zbriti ajeti fisnik: "**O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.**"[5]

Nëpërmjet përforcimit të domosdoshmërisë së njoftimit të këtij mesazhi hyjnore, i cili është në të njëjtën shkallë me mesazhet e tjerë hyjnorë dhe se mospërmbushje e tij do të thotë mospërmbushje e gjithë mesazhit hyjnor, Allahu i Madhëruar e përgëzoi profetin se do ta ruajë nga të gjitha ndikimet e pritshme të kësaj vepre. Me zbritjen e këtij ajeti, Profetit ju bë e qartë ardhja e kohës së përshtatshme për të realizuar këtë mision të rëndësishëm dhe nuk është me interes që ta vonojë atë, gjë që e realizoi në "Gadijr Khum."[6]

Vërejmë se ajo çfarë e veçanton këtë ditë është lajmërimi zyrtar i këtij caktimi para njerëzve dhe dhënia e besës nga ana e tyre. Porse, Profeti i Allahut vazhdimit e kishte përsëritur

4. Gajetul Meram, kapitulli 58, hadithi 4. transmetuar nga Feraid i Hameuejnit.

5. Sure "El Maide", ajeti 67. Për më tepër sqarim rreth këtij ajeti kthehu tek tefsiri "El Mijzan", vëll. 6, fq. 41 dhe në vazhdim.

6. Dijetarë të mëdhenj të Ehli Sunetit e kanë përcjellë këtë ngjarje nga rshtatë shokë të Dërguarit të Allahut që janë: Zejd ibn Erkam, Ebu Saijd el Khuderij, Ibn Abas, Xhabir ibn Abdullah El Ensarij, Berae ibn Azab, Ebu Hurejra dhe ibn Mesud. (El Gadijr, vëll. 1).

çështjen e hilafetit të imam Aliut pas tij gjatë periudhës së mesazhit të tij në forma dhe mënyra të ndryshme.

Në kohën që zbriti ky ajet: "**Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm**"[7] në fillim të Revelatës, i Dërguari i Allahut iu drejtua të afërmve të tij duke u thënë: "*Kush prej jush më mbështet në këtë çështje e ai do të jetë vëllai im, porositësi im dhe halifi im.*" Të dy grupet ranë dakort që të tërhen, përveç Ali ibn Ebi Talibit, i cili ishte i pari që ju përgjigj."[8]

Gjithashtu, kur zbriti ajeti: **"O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja…"**[9] është obliguar bindja në mënyrë absolute ndaj atyre të cilët kanë drejtimin. Bindja ndaj tyre konsiderohet në të njëjtën shkallë me bindjen ndaj Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Xhabir ibn Abdullahu e pyeti Profetin: "Kush janë ata që është bërë detyrë bindja ndajtyre?" I Dërguari i Allahut iu përgjigj: "Ata janë halifat e mi o Xhabir dhe prijësit e myslimanëve pas meje. I pari është Ali ibn Ebi Talib, më pas Hasan ibn Ali, Husejn ibn Ali, Ali ibn Husejn, Muhamed ibn Ali i njohur ndryshe në Teurat si El Bakir, do ta njohësh o Xhabir dhe bëji prej meje selam, më pas Sadik, Xhafer ibn Muhamed, Musa ibn Xhafer, Ali ibn Musa, Muhamed ibn Ali, Ali ibn Muhamed më pas Hasan ibn Ali, më pas ai që ka emrin tim dhe llagabin tim. Argumenti i Allahut në tokën e Tij dhe e qëndrueshmja e Tij për robtë e Tij, ibn Hasan ibn Ali."[10]

Sikurse njoftoi Profeti, Xhabiri jetoi deri në kohën e imam El Bakir (paqja qoftë mbi të!) dhe ia përcolli atij selamin e të Dërguarit të Allahut.

Në një hadith të transmetuar nga Ebi Basiri ky i fundit ka thënë: "Pyeta Ebu Abdullah Sadikun (paqja qoftë mbi të!) për thënien e Allahut të Lartësuar: **"O besimtarë! Bindjuni**

7. Sure "El Shuara", ajeti 214.
8. Abakatul Enuar, El Gadijr.
9. Sure "El Nisa", ajeti 59.
10. Gajetul Meram, fq. 267, vëll. 10, botimi i vjetër. Ithbatul Hudat, vëll. 3, fq. 123. Jenabiul Meuedetu, fq. 494.

Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja…" Mu përgjigj: " Ky ajet ka zbritur për Ali ibn Ebi Talib, Hasanin dhe Husejnin (paqja qoftëmbi ta!)". I thashë: "Njerzit thonë se përse nuk është përmendur emri i Aliut dhe i Ehli Bejtit në Librin e Allahut të Lartësuar?" Ai tha: "U thuaj atyre se të Dërguarit të Allahut i kanë zbritur ajetet e namazit dhe në asnjë prej tyre nuk është përmendur asgjë lidhur me rekatet katër apo tre, por këtë e sqaroi i Dërguari i Allahut. Po kështu, kur zbritën ajetet e haxhit e të zekatit. Gjithashtu, kur zbriti ajeti **"...bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja…"** i Dërguari i Allahut ka thënë: "*Për atë që unë jam kujdestar (udhëheqës), Aliu është kujdestari (udhëheqësi) i tij.*" Ai ka thënë: "*Ju lë porosi librin e Allahut dhe Ehli Bejtin tim. Unë e kam lutur Allahun e Lartësuar që të mos i ndajë nga njëri-tjetri derisa të takohen memuan te burimi.* Ai mu përgjigj e më tha: "*Mos i mësoni ata sepse janë më të ditur se ju. Ata kurrë nuk iu nxjerrin nga porta e udhëzimit dhe kurrë nuk iu fusin në portën e humbjes.*"[11]

I Dërguari i Allahut e ka përsëritur shpesh këtë fjalë deri në ditët të fundit të jetës së tij dhe ka thënë: "*Po ju lë dy amanete të rënda (çmuara), Librin e Allahut dhe Ehli Bejtin tim. Ata të dy nuk ndahen kurrë derisa të kthehen tek unë te burimi.*"[12] Gjithashtu ka thënë: "*Sigurisht, Ehli Bejti im në mesin tuaj janë sikurse anija e Nuhut, kush hipën në të shpëton dhe kush nuk hipën, mbytet.*"[13] Në shumë raste i drejtohej Aliut duke i thënë "*Ti je prijësi i çdo besimtari pas meje.*"[14] Egzistojnë edhe dhjetra hadithe të tjera por vendi nuk na lejon që ti përmendim të gjitha.[15]

11. Gajetul Meram, fq. 265, vëll. 3, botimi i vjetër.
12. Ky gjithashtu është nga hadithet e muteatir dhe është përcjellë nga i Dërguari i Allahut në rrugë të shumta prej dijetarëve të mëdhenj të Ehli Sunetit si Tirmidhiu, Nisaiu dhe autori i Mustedrekut.
13. Mustedreku i Hakimit, vëll. 3, fq. 151.
14. Mustedreku i Hakimit, vëll. 3, fq. 134, dhe fq. 111. Sauaiku, i bnu Haxher, fq. 103. Musned ibn Hanbel, vëll. 1, fq. 331, dhe vëll. 4, fq. 438 etj.
15. Kemaludijni dhe Temamu Niametu, i El Suduk. El Bihar, i El Mexhlisij.

Pyetje

1. Cili është ajeti që lidhet me caktimin e imamit? Trego argumentin e tij për këtë?

2. Trego ngjarjen në të cilën është caktuar prijësi i besimtarëve imam.

3. Përse e vonoi Profeti, informimin e prijësisë së prijësit të besimtarëve, imam Aliut? Si e realizoi atë?

4. Përmend transmetimet që tregojnë për prijësinë e të gjithë imamëve.

5. Sqaro transmetimet e tjera që tregojnë prijësinë e Ehli Bejtit (paqja qoftë mbi ta!)

Leksioni i tridhjetëenëntë

PAGABUESHMËRIA DHE DITURIA E IMAMIT

Hyrje

Në leksioni e tridhjetë e gjashtë theksuam se dallimi mes Shiitëve dhe Ehli Suneti mbi temën e Imamatit është në tri çështje:

• E para: Domosdoshmëria e caktimit të Imamit nga ana e Allahut.

• E dyta: Domosdoshmëria e cilësimit të tij me cilësinë e pagabueshmërisë.

• E treta: Është e domosdoshme që Imami të ketë diturinë e dhuruar nga Allahu.

Në leksionin e tridhjetë e shtatë i vërtetuam të treja pikat me argumenta logjikë.

Në leksionin e tridhjetë e tetë përmendëm disa argumenta transmetues mbi caktimin e imamit të pastër nga ana e Allahut të Madhëruar. Në këtë leksion do të studiojmë rreth pagabueshmërisë dhe diturisë të dhuruar nga ana e Allahut.

Pagabueshmëria e Imamit

Pasi vërtetuam se Imamati është post hyjnor, të cilin Allahu ia dhënë Ali bin Ebi Talibit dhe fëmijëve të tij, ne mund ta nxjerrim pagabueshmërinë e tyre nga ky ajet fisnik: **"...Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët."**[1]

Allahu i Madhëruar e ka mohuar që t'u japë pozitë hyjnore atyre të cilëve janë përlyer me gjynahe. Nga ajeti i parë gjithashtu përfitohet urdhri për bindje të plotë ndaj tyre

1. Sure "El Bekare", ajeti 124.

dhe e ka shoqëruar këtë bindje me bindjen ndaj Profetit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).[2] Bindja ndaj tyre nuk bie ndesh me bindjen ndaj Allahut të Madhëruar. Pra, çështja e bindjes në mënyrë të plotë ndaj tyre do të thotë garanci e pagabueshmërisë së tyre.

Gjithashtu, pagabueshmërinë e Ehli Bejtit (paqja qoftë mbi ta!) mund ta përfitojmë edhe nga ajeti i pastërtisë i cili thotë: **"...O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**[3]

Sqarimi i mëtejshëm: Vërtet, vullneti legjislativ i Allahut në pastrimin e robëve të Tij nuk veçon askënd. Pra, vullneti i veçantë për Ehli Bejtin (paqja qoftë mbi ta!) është vullnet i krijimit hyjnor, i cili nuk pranon kundërshtime, siç thotë ajeti i mëposhtëm: **"Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë asaj "Bëhu!" - dhe ajo bëhet."**[4]

Pastrim i plotë dhe mohim i të gjitha papastërtive, do të thotë pagabueshmëri (*ismetun*). Ne e dimë se medhhebet dhe grupacionet islame nuk pretendojnë ekzistencën e pagabueshmërisë tek askush që rrjedh nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), përveçse Shiitët, të cilët besojnë në pagabueshmërinë e Zahrasë (paqja qoftë mbi të!) dhe dymbëdhjetë imamëve.[5]

Jemi të detyruar të dëshmojmë se gjenden më më shumë se shtatëdhjetë transmetime, shumica e të cilëve janë përcjellë nga dijetarët e Ehli Sunetit, që tregojnë se ky ajet i bekuar ka zbritur për pesë të pastërit.[6] Është përcjellë nga Suduku, nga prijësi i besimtarëve, imam Aliu, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: *"O Ali, ky ajet ka zbritur për ty, për dy nipat e mi dhe për imamët nga djemtë e tu." E pyeta: "O i Dërguari i Allahut, sa*

2. Sure "El Nisa", ajeti 59.
3. Sure "El Ahzab", ajeti 33.
4. Sure "Jasin", ajeti 82.
5. Për sqarime më të hollësishme rreth këtij ajeti kthehu tek tefsiri "El Mijzan" dhe tek libri "El Imametu uel Uilajetu fil Kur'anil Kerim"
6. Gajetul Meram, fq. 287-293.

imamë do të jenë pas teje? Më tha: "Ti o Ali, më pas dy djemtë e tu Hasani dhe Husejni, më pas Aliu djali i Husejnit, më pas Muhamedi djali i Aliut, më pas Xhaferi djali i Muhamedit, më pas Musai djali i Xhaferit, , më pas Aliu djali i Musait, më pas Muhamedi djali i Aliut, më pas Aliu djali i Muhamedit, më pas Hasani djali i Aliut, më pas El Huxhetu (imam Mehdiu) djali i Hasanit. Kështu i gjeta emrat e tyre të shkruar te këmba e Arshit dhe e pyeta Allahun e Lartësuar rreth kësaj. Ai mu përgjigj: "O Muhamed, ata janë imamët e pastër dhe të pagabueshëm pas teje dhe armiqtë e tyre janë të mallkuar."[7]

Gjithashtu, hadithi Thakalejn, në të cilin Profeti dhe Ehli Bejti i tij janë shoqëruar me Kur'anin. Ai dëshmon dhe përforcon se nuk nuk do të ndahen kurrë. Ky është një argument i qartë mbi pagabueshmërinë e tyre sepse kryerja e gjynaheve, qoftë i vogël dhe padashje, do të thotë ndarje praktike nga Kur'ani.

Dituria e Imamit

Nuk ka dyshim se Ehli Bejti i Profetit (paqja qoftë mbi ta!) janë pajisur dhe furnizuar me diturinë e tij (profetit) më shumë se të tjerët. Ashtu si ka thënë vetë profeti për ata: *"Mos i mësoni ata sepse janë më të ditur se ju"*[8], veçanërisht prijësi i besimtarëve, i cili u rrit dhe u edukua në prehërin e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), që në fëmijërinë e tij. Ai (imam Alu) qëndroi me Profetin dhe nuk u nda deri në çastet e fundit të jetës së tij të begatë. Ai merrte, furnizohej dhe pajisej me dituritë e Profetit. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë për Aliun: *"Unë jam qyteti i dijes dhe Aliu është porta e tij."*[9]

7. Gajetul Meram, fq. 293, vëll. 6.
8. Gajetul Meram, fq. 265, Usulul Kafi, vëll. 1, fq. 294.
9. Mustedrekul Hakim, vëll. 3, fq. 226. Është rasti për t'u përmendur se një nga dijetarët e Ehli Sunetit shkruajti një libër me titull "Fet'hul Melekil el alij bi sihati hadijth medijnetu elilmi Ali) dhe u botua në Kajro. E shkruajti në vitin 1354 hixhri

Është transmetuar nga prijësi i besimtarëve i cili ka thënë: *"I Dërguari i Allahut më ka mësuar një mijë porta. Nga çdo portë hapen një mijë porta që shkojnë në mijë e mijëra (milion) porta. Dhe mësova çfarë ishte dhe çfarë do të jetë deri në Ditën e Kijametit. Mësova dijen e vdekjes dhe të sprovave si dhe retorikën dhe elekuencën."*[10]

Mirëpo dituria e Ehli Bejtit (paqja qoftë mbi ta!) nuk kufizohet vetëm në atë që kanë dëgjuar nga Profeti, me ndërmjetës apo pa ndërmjetës, por ata gjithashtu gëzonin një dituri jo të zakonshme, e cila përftohej nëpërmjet inspirimit[11] siç ishte inspirimi që i ndodhi Dhulkarnejnit[12], Merjemes dhe nënës së Musait.[13] Në Kur'anin Fisnik, disa inspirime janë konsideruar si Shpallje, por nuk janë si Shpallja profetike. Me këtë lloj diturie disa imamë kanë arritur gradën e imamatit që në periudhën e fëmijërisë së tyre. Ata kishin njohuri për çdo gjë dhe nuk kishin nevojë për t'u mësuar e për t'u shkolluar nga të tjerët.

Kjo ide përftohet prej transmetimeve të shumta që janë përcjellë nga vetë imamët e pastër ku argumenti i tyre konstatohet nëpërmjet pagabueshmërisë së tyre. Para se të paraqesim disa shembuj prej atyre transmetimeve, do të përmendim këtë ajet të Kur'anit Fisnik i cili përmend një person ose disa persona: **"Ai që zotëron diturinë e Librit"**. Përmendja e tij është argument se Profeti është me të drejtën. Ajeti është: **"Jobesimtarët thonë: "Ti nuk je i dërguar!" Thuaju** (o Muhamed!): **"Mjafton Allahu për dëshmitar midis meje dhe jush dhe** (ai) **ata që** (ka) **kanë dijeni për Librin."**[14]

Atij që i krahasohet dëshmia me dëshminë e Allahut, edhe pse dija ndaj Librit e bën të meritueshëm për këtë dëshmi, s'ka dyshim se ky person gëzon një pozitë të lartë.

10. Jenabiul Meuede, fq. 88, Usulul Kafi, vëll. 1, fq. 296.
11. Usulul Kafi, Kitabul huxhetu, fq. 264 dhe fq. 270.
12. Sure "El Kehf", ajetet 65-98, Usulul Kafi, vëll. 1, fq. 268.
13. Sure "Ali Imran", ajeti 42, sure "Merjem", ajetet 17-21, sure "Taha", ajeti 38, sure "El Kasas", ajeti 7.
14. Sure "El Rad", ajeti 43.

Në një tjetër ajet e shohim këtë dëshmi duke e lexuar i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!): **"A janë** (të barabartë me jobesimtarët)**, ata, që mbështeten në provë të qartë nga Zoti i tyre, që ndiqet nga një dëshmitar prej tij..."**[15] Fjala prej tij (minhu) tregon se ky dëshmitar është prej të afërmve të Dërguarit të Allahut dhe Ehli Bejtit të tij. Janë përcjellë transmetime të shumta nga Shiitët dhe Ehli Suneti të cilët e përforcojnë dhe e vërtetojnë se ky dëshmitari është Ali ibn Ebi Talibi.

Prej atyre transmetimeve është ai që e ka përcjellë ibn el Magazili el Shafiij nga Abdullah ibn Atai, i cili ka thënë: *"Isha ulur me Ebi Xhaferin (Imam el Bakir paqja qoftë mbi të!) kur para nesh kaloi ibn Abdullah ibn Selam (Abdullahu ka qenë prej dijetarëve të ithtarëve të librit dhe e pranoi Islamin në kohën e Profetit) dhe i thashë: "Allahu më bëftë kurban për ty, a është ky personi që zotëron diturinë e Librit?" Më tha: "Jo. Porse ai është shoku juaj, Ali ibn Ebi Talibi, për të cilin kanë zbritur ajeti nga Libri i Allahut të Madhëruar":* **"Ai që zotëron diturinë e Librit"**

Dhe: **"Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët..."**[16]

Janë përcjellë shumë transmetime nga të dy grupet që thonë se qëllimi i fjalës "dëshmitar", në suren "Hud", është Ali ibi Ebi Talib.[17] Nëse do të meditojmë rreth veçorisë e cila e dallon të lartpërmendurin në thënien "prej tij" na bëhet e qartë se qëllimi është imam Ali ibn Ebi Talib.

Gjithashtu, na bëhet e qartë rëndësia e (Diturisë së Librit) kur meditojmë rreth historisë së Sulejmanit dhe sjellja e Arshit të Belkisës tek ai, të cilën e përmend Kur'ani Fisnik: "**Po ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: "Unë do të ta sjell ty sa çel e mbyll sytë..."**[18]

Në këtë ajet përfitohet se njohja e një pjese të diturisë së Librit ka ndikim mbresëlënës e të habitshëm. Prej këtu mund

15. Sure "Hud", ajeti 17.
16. Sure "El Maide", ajeti 55.
17. Gajetul Meram, fq. 359-361.
18. Sure "El Neml", ajeti 40.

të kuptojmë ndikimet e mëdhaja kur njihet e gjithë dituria e Librit.

Do të përcjellim këtu disa transmetime që flasin rreth diturisë së Ehli Bejtit (paqja qoftë mbi të!).

Në një hadith të gjatë të imam Rizait thuhet: *"Kur Allahu e zgjedh robin e Tij për çështjet e njerëzve, Ai ia zgjeron kraharorin, vendos në zemrën e tij krojet e urtësinë, ia inspiron diturinë me inspirim që të mos ketë nevojë pas kësaj për përgjigje dhe nuk çoroditet ndaj shpërblimit. Ai është i pagabueshëm, i mbarësuar, i mbrojtur dhe i ruajtur nga gabimet e gjynahet. Allahu ia dhuron të gjitha këto për të qënë argument për robtë e Tij dhe dëshmitar i Tij për krijesat. E gjithë kjo është mirësia e Allahut që ia jep atij që do... a mund të zgjedhin një të tillë e ta paraqesin? A ka i zgjedhuri i tyre këto cilësi?"*[19]

Nga Hasan ibn Jahja el Medaini i ka thënë Ebi Abdullahu (paqja qoftë mbi të!): *"Më trego për imamin, i cili në qoftë se pyetet si përgjigjet?"* Tha: *"Ispirim, dëgjim dhe ndoshta të gjitha."*[20]

Në një transmetim tjetër Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *"Çdo imam që nuk e di çfarë bën dhe ku ecën, nuk është argument i Allahut për krijesat e Tij."*[21]

Në shumë transmetime të tjera të përcjella nga imam Sadiku përmendet se ai ka thënë: *"Nëse dëshiron imami të mësojë diçka, e mëson atë."*[22]

Është transmetuar prej tij gjithashtu se shumë herë, kur është pyetur për fjalën e Allahut: "**Dhe ne të inspiruam ty një shpirt nga ne**", ka thënë: *"Ka qenë një krijesë më e madhe se Xhebraili, Mikaili i cili shoqëroj me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e informonte dhe e mbronte. Pas Profetit qëndronte me imamët."*[23]

19. Usull Kafi, vëll. 1, fq. 198-203.
20. Biharul Anuar, vëll.26, fq. 58.
21. Usulul Kafi, vëll. 1, fq. 258.
22. Usulul Kafi, vëll. 1, fq. 258.
23. Usulul Kafi , vëll. 1, fq. 273.

Pyetje

1. Përmend ajetet me anë të të cilave mund të vërtetojmë pagabueshmërinë e imamit.
2. Përmend transmetime që tregojnë mbi pagabueshmërinë e imamit.
3. Cilat janë rrugët nëpërmjet të cilave arrihet dituria e veçantë e Imamit?
4. Kush janë ata të cilët e poseduan këtë dituri në periudhat e mëparshme?
5. Cili është ajeti që tregon për diturinë e imamit? Si e tregon atë?
6. Sqaro rëndësinë e diturisë së Librit.
7. Përmend shembuj nga transmetimet që lidhen me diturinë e imamit.

Leksioni i dyzet

IMAM MEHDIU
(Allahu ia shpejtoftë ardhjen!)

Hyrje

Në hulumtimet e kaluara përmendëm disa hadithe që përmbanin emrat e dymbëdhjetë Imamëve (paqja qoftë mbi ta!). Mirëpo janë përcjellë shumë hadithe të tjera prej Shiitëve dhe Ehli Sunetit nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ku në disa prej haditheve tregohet vetëm numri i tyre, e në disa të tjerë është shtuar se të gjithë Imamët janë nga Kurejshët. Në disa hadithe të tjera thuhet se numri tyre është sa numri i prijësve të Beni Israilëve. Në disa të tjera thuhet se nëntë prej tyre janë prej djemve të Imam Hysejnit. Së fundi, në disa hadithe (muteuatireh) të përcjella nga Ehli Suneti dhe të transmetuara në burimet e Shiitëve, përmenden emrat e tyre njëri pas tjetrit.[1]

Janë përcjellë shumë hadithe nga burimet Shiite rreth imamatit të çdonjërit prej Imamëve të pastër dhe vendi këtu nuk na lejon që t'i përmendim në këtë përmbledhje.[2] Për këtë, leksionin tonë të fundit të këtij libri do ta veçojmë për studimin rreth Imamit të dymbëdhjetë, imamin e Zamanit (Allahu ia shpejtoftë ardhjen!). Duke ruajtur edhe përmbledhjen, shkurtimisht do të hulumtojmë disa prej çështjeve më të rëndësishme.

1. Muntekhabul ether fi imam thanij asher, botimi 3, fq. 10-140.
2. Kthehu tek "Biharul Anuar", "Gajetul Meram", "Ithbatul Hudat" e të tjerë libra të hadithit.

Qeverisja hyjnore mbarëbotërore (universale)

Mësuam se qëllimi i parë dhe kryesor në dërgimin e profetëve është plotësimi i kushteve të nevojshme për udhëzimin e njerëzore për dhe përsosmërinë e tyre të lirë të arsyeshme dhe të ndjeshme. Realizimi i këtij qëllimi arrihet nëpërmjet përhapjes së Shpalljes së Allahut tek njerëzit. Janë vërejtur edhe qëllime të tjera pas këtij qëllimi ndër to mund të përmendim: Ndihma për udhëzim logjik, edukimi shpirtëror i personave të aftë dhe të pregatitur dhe së fundi theksojmë se profetët e mëdhenj (paqja qoftë mbi ta!) janë përpjekur të krijojnë shoqëri shembullore bazuar mbi adhurimin e Allahut, të vlerave dhe mësimeve hyjnore dhe mbi bazën e përhapjes së drejtësisë në tokë. Çdonjëri prej tyre, sipas mundësisë, hodhi nga një hap në tokë në këtë rrugë. Disa prej tyre ia arritën të ngrenë shtetin hyjnor në zona dhe periudha kohore të caktuara, por për asnjërin prej tyre nuk u plotësuan kushtet e përshtatshme për ngritjen e një qeverisjeje mbarëbotërore.

Vërejmë se pamundësia e plotësimit të kushteve dhe e rrethanave të përshtatshme nuk do të thotë se profetët nuk i kanë përcjellë mësimet në mënyrën dhe formën e duhur, ose mangësi në administrimin dhe udhëheqjen e tyre. Gjithashtu, nuk do të thotë mosrealizim i qëllimit hyjnor të dërgimit të tyre, sepse ashtu siç e theksuam, qëllimi hyjnor është: Krijimi i kushteve dhe i klimës së përshtatshme për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe përzgjedhjen e rrugës të tyre: "(Këta janë) **të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve…**"[3]

Njerëzit nuk janë të detyruar ta përqafojnë fenë e vërtetë dhe të ndjekin udhëheqësit hyjnorë. Vërtet, ky qëllim u realizua.

Allahu i Madhëruar, në librat e Tij qiellorë, ka premtuar ngritjen e qeverisë hyjnore për të gjithë rruzullin tokësor.

3. Sure "El Nisa", ajeti 165.

Kjo mundet të konsiderohet si një nga lajmet e fshehta sa i përket krijimit të klimës së përshtatshme për të pranuar fenë e vërtetë në një rreth të gjerë të shoqërisë njerëzore. E gjithë kjo do të realizohet me duart e disa personave apo grupeve të veçanta e të zgjedhura dhe me mbështetjen e fshehtë hyjnore, që do të largojnë pengesat nga rruga e ngritjes të qeverisjes mbarëbotërore dhe do të përhapin drejtësinë tek popujt e privuar nga të padrejtët dhe që i kanë humbur shpresat nga parimet dhe sistemet udhëheqëse. Ky mund të konsiderohet qëllimi përfundimtar i dërgimit të vulës së profetëve dhe fesë së tij botërore e të përjetshme. Kjo sepse Al'llahu i Madhëruar në Kur'anin Fisnik thotë: **"...për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë..."**[4]

Meqënëse Imamati është plotësuses i profetësisë, si dhe realizues i urtësisë së vulës së profecisë, arrijmë në këtë përfundim: Ky qëllim do të realizohet nëpërmjet Imamit të fundit. Kjo ide është përmendur në shumë transmetime (muteuatire) të përcjella rreth imam Mehdiut (shpirtërat tanë qofshin flijim për të!) duke e përforcuar edhe më tepër.

Fillimisht do të theksojmë ajetet nga Kur'ani Fisnik që përmbajnë përgëzimin dhe premtimin për ngritjen e shtetit mbarëbotëror, më pas do të përmendim shembuj nga transmetimet që lidhen me këtë temë.

Premtimi Hyjnor

Allahu i Madhëruar në Kur'anin Fisnik thotë: **"Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë."**[5]

Kjo përmbajtje përmendet në një ajetet nga Musai[6] (paqja qoftë mbi të!). Ajo që nuk pranon dyshim e mëdyshje është se do të vijë ajo ditë në të cilën do të realizohet premtimi i Allahut.

4. Sure "El Teube", ajeti 33, Sure "El Fet'h", ajeti 28, sure "El Saf", ajeti 9. Kthehu edhe te Biharul Anuar, vëll. 51, fq. 50, vëll. 22 fq. 60, vëll. 58 dhe 59.
5. Sure "El Enbija", ajeti 105.
6. Sure "El Araf", ajeti 128.

Në një tjetër ajet përmendet historia e Faraonit, i cili i privonte njerëzit: **"Por vullneti Ynë ishte që t'u jepnim mirësi atyre që qenë të shtypur në tokë, t'i bënim prijës e trashëgimtarë."**[7]

Ky ajet, edhe pse ka zbritur për beni israilët dhe për marrjen e drejtimit të çështjeve nga ana e tyre pas shpëtimit nga grushti i Faraonit, porse në të vërtetë shprehja (*ue nuridu*), tregon për vullnetin e vazhdueshëm të Allahut. Për këtë, kjo shprehje është në përputhje me shumë transmetime që flasin për shfaqjen dhe ardhjen e imam Mehdiut (Allahu ia shpejtoftë ardhjen!).[8]

Në një vend tjetër në Kur'an Allahu u drejtohet myslimanëve duke thënë: **"Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë** (në adhurim)**. Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë** (besimin)**, pikërisht ata janë të shthurur."**[9]

Në disa transmetime thuhet se e vërteta e plotë e këtij premtimi do të realizohet në formë të plotë në kohën e shfaqjes së imamit të fshehur (imam Mehdiu).[10]

Janë edhe disa ajete të tjera të cilat përmendin Imamin e fshehur.[11] Ne nuk do t'i përmendim për të ruajtur përmbledhjen në libër.[12]

Shembuj nga transmetimet

Transmetimet, të cilat i kanë përcjellë Shiitët dhe Ehli Suneti nga Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut

7. Sure "El Kasas", ajeti 5.
8. Biharul Anuar vëll. 51, fq. 54, vëll. 35 fq. 63-64.
9. Sure "El Nur", ajeti 55.
10. Biharul Anuar vëll. 51, fq. 58, vëll. 50 fq. 54, vëll. 34 fq. 35.
11. Shembulli i këtyre ajeteve **".... të jetë feja e gjitha për Zotin", "...për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë...", "Ajo që ju është lënë nga Allahu, është më e mirë për ju, nëse jeni besimtarë..",** etj.
12. Biharul Anuar vëll. 51, fq. 44-64.

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) rreth imam Mehdiut e kalojnë pragun e konsekuentit (*et teuatur*). Transmetimet të cilat i kanë përcjellë vetëm Ehli Suneti arrijnë pragun e konsekuentit (*et teuatur*). Këtë e pohojnë edhe një grup nga dijetarët e tyre (Ehli Sunetit).[13] Një grup i dijetarëve të Ehli Sunetit e konsiderojnë besimin te Imam Mehdin se është besim i të gjitha rrymave islame.[14] Disa prej tyre kanë botuar libra dhe broshura rreth Imam Mehdiut[15] dhe shenjave të shfaqjes së tij. Përmendim këtu disa transmetime të cilat i kanë përcjellë Ehli Suneti.

Nga transmetimet e shumta të cilat janë përcjellë nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), përmendim: *"Sikur të mbetet nga koha edhe një ditë e vetme, Allahu do të dërgojë një burrë nga Ehli Bejti im që ta mbushë atë (botën) me drejtësi ashtu siç u mbush me padrejtësi."*[16]

Nga Umu Seleme transmetohet se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: *"Mehdiu është nga gjeneza ime dhe nga fëmijët e Fatimes."*[17]

Ibn Abasi transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Aliu është imami i Ymetit tim pas meje dhe nga fëmijtë e tij është i prituri, i cili kur do të shfaqet do ta mbushë Tokën me drejtësi ashtu siç u mbush me shthurje dhe padrejtësi."*[18]

---

13. El Sauaikul Muhrika, i ibn Haxher, fq. 99, Nurul Ebsar, i Sheblenxhij fq. 155, Is'afu Ragibijn fq. 140, El Futuhatul Islamije vëll. 2, fq. 211.
14. Sherhu Nehexhul Belaga i ibn Ebi Hadijd vëll. 2, fq. 535. Sebaiku Dheheb i Suejdij fq. 78, Gajetul Me'mul vëll. 5, fq. 362.
15. Ndër ato libra: "El bejan fi Ahbar Sahib el Zeman" me autor Hafidh Muhamed bin Jusuf el Kenxhij el Shafi'ij, i cili ka jetuar në shekullin e shtatë dhe libri "Burhan fi Alamatul Mehdi Akhiri Zaman" me autor El Mutekij el Hindi, i cili ka jetuar në shekullin e dhjetë.
16. Sahihu Tirmidhi, vëll. 2, fq. 46, Sahihu Ebi Davud, vëll. 2, fq. 207, Musned ibn Hanbel, vëll. 1, fq. 378, Jenabiul Meuede, fq. 186, 285, 440, 488, 490.
17. Isafu Rragibijn, fq. 134, transmetuar nga Sahihu Muslim, Ebi Davudi , Nisaiu, ibn Maxhah dhe Bejhekiu.
18. Jenabiul Meuede, fq. 494.

Fshehtësia dhe enigma e saj

Fshehtësia konsiderohet nga veçoritë e imamit të dymbëdhjetë (Allahu ia shpejtoftë ardhjen!). Kjo është përforcuar në transmetimet e shumta të përcjella nga Ehli Bejti. Ndër to:

Është transmetuar nga Abduladhijm El Hasenij nga imam Muhamed Xheuad (paqja qoftë mbi të!), nga prindërit e tij (paqja qoftë mbi ta!) nga prijësi i besimtarëve, imam Aliu (paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: *"Për Kaimin që është prej nesh do të ketë fshehtësi të gjatë. Mua më duket sikur Shiitët do të përpiqen të gjejnë mirësi në mungesë të tij, si dhe kërkojnë bariun (imamin) e tyre por nuk e gjejnë dot. Kush është i palëkundshëmi në fenë e tij dhe nuk i ashpërsohet zemrën për shkak të fshehjes së gjatë të Imamit të tij, ai është me mua në të njëjtën gradë Ditën e Kijametit..."*[19]

Është transmetuar nga imam Sexhadi, nga babai i tij, nga gjyshi i tij Ali ibn Ebi Talibi, i cili ka thënë: *"I fundit prej nesh ka dy të fshehta njëra prej tyre është më e gjatë se tjetra. Në udhëheqësinë e tij është vetëm ai person me bindje të fortë dhe me njohje të rregullt."*[20]

Për t'u njohur edhe më tepër me sekretin e fshehtësisë së imamit dhe me enigmën e saj është e rëndësishme që t'i hedhim një vështrim jetës të imamëve të pastër (paqja qoftë mbi ta!) dhe historisë së tyre.

Ne e dimë se shumica e njerzve pas vdekjes të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i dhanë besën Ebu Bekrit, pas tij Umerit dhe pas Umerit Othmanit. Në fund të udhëheqjes së Othmanit ndodhi rebelimi si rezultat i gabimeve që e kishin burimin nga dallimi devijues dhe Othmanin e vranë. Pas vrasjes së Othmanit, njerëzit ia dhanë besën prijësit të besimtarëve, imam Aliut (paqja qoftë mbi të!).

19. Muntekhab El Ether, fq. 255.
20. Muntekhab El Ether, fq. 251.

Edhe pse Aliu ishte halifja i përzgjedhur nga Allahu i Madhëruar dhe Profeti i Tij, ai heshti gjatë periudhës së udhëheqjes së tre halifave të parë për të ruajtur interesat e Ymetit të ri mysliman. Ai asnjëherë nuk fliste për diçka pa patur argument të plotë për të. Në të njëjtën kohë, nuk u tërhoq asnjë çast nga ofrimi i shërbimeve dhe i përpjekjeve të tij në interes të Islamit dhe të myslimanëve. Mirëpo, e gjithë periudha e hilafetit të tij kaloi duke luftuar në luftra të ndryshme, si ajo e Devesë, lufta me Hauarixhët dhe në fund ra dëshmor nga dora e një prej Hauarixhëve.

Imam Hasani vdiq i helmuar me urdhër të Muaviut. Pas vdekjes së Muavijes erdhi në pushtet i biri i tij Jezijdi, i cili nuk interesohej as me të dukshmet e Islamit. Ishte e mundur që Islami të përballej me shkatërrim dhe shfarosje si rezultat i kësaj rruge degraduese. Për këtë, imam Husejni ra dëshmor, por ai zgjoi tek myslimanët vetëdijen e tyre, megjithëse nuk ju krijuan kushtet shoqërore për ngritjen e një shteti të drejtë islam. Gjithë Imamët e pastër që erdhën pas tij vepruan për të forcouar parimet e besimit dhe për të përhapur e ngulitur njohjet dhe ligjet islame dhe edukimin e shpirtrave të aftë. Kur i lejonin kushtet, i nxisnin njerëzit –fshehtas- për të luftuar të padrejtët dhe tiranët. Ata mbillnin në njerëz shpresën për realizimin e ngritjes së shtetit hyjnor mbarëbotëror dhe në përfundim të gjithë ranë dëshmorë njëri pas tjetrit.

Sido që të jetë, përgjatë dy shekujve e gjysëm, imamët e pastër arritën të paraqesin të vërtetat islame dhe sqarimin e tyre për njerzit, edhe pse përballeshin me probleme, sfida dhe sakrifica të shumta e të ashpra. Disa prej atyre të vërtetave ia shpjeguan njerëzvë në përgjithësi dhe disa të tjera ata i shpjeguan pasuesve dhe shokëve të tyre të veçantë. Në këtë mënyrë, u përhapën dijet islame me të gjitha dimensoinet e tyre në mesin e ummetit islam. Me këtë veprim u sigurua qëndrimi i sheriatit muhamedan dhe në vendet e ndryshme islame u krijuan grupe që nxisnin kuundërshtimin dhe luftimin e udhëheqësve të padrejtë. Kjo vepër i mundësoi ata që edhe

në formë të kufizuar t'i ndalojnë tiranët dhe të padrejtët për arritjen e qëllimeve të tyre.

Ajo që i frikësonte më së shumti dhe u ngjallte frikën udhëheqësve të padrejtë dhe i zemëronte më së shumti, ishte premtimi për shfaqjen e imam Mehdiut, prania e të cilit kërcënonte ekzistencën dhe udhëheqjen e tyre. Ky ishte shkaku që udhëheqësit në kohën e imam Hasan El Askeri (paqja qoftë mbi të!) vendosën një mbikqyrje të rreptë ndaj tij pët vrarë çdo fëmijë mashkull që i lindte atij. Vetë imam Askeriu, i cili ishte në lulen e rinisë, ra dëshmor nga duart e tyre. Por ishte vullneti i Allahut që të lindë imam Mehdiu që të kontribojë në shpëtimin e njerëzisë. Imam Mehdiu nuk është takuar me babanë e tij kur ishte gjallë. Deri në moshën pesë vjeçare ai takohej vetëm me njerëz të veçantë prej shiave.

Pas vdekjes së babait të tij, imami lidhej me njerëzit nëpërmjet katër përfaqësuese, të cilët ishin ngarkuar me përfaqësi të posaçme njëri pas tjetrit.[21]

Pastaj, filloi edhe (fshehtësia e madhe), e cila do të vazhdojë për një kohë të papërcaktuar. Kjo do të vazhdojë deri në kohën në të cilën njerëzit janë të përgatitur për të pranuar udhëheqjen hyjnore mbarëbotërore. Në atë kohë do të shfaqet edhe imami me urdhrin e Allahut të Madhëruar.

Pra, sekreti kryesor i fshehjes së tij është: Ruajtja dhe mbrojtja e tij nga duart e despotëve dhe tiranëve. Në disa transmetime janë përcjellë edhe urtësi të tjera. Ndër to, sprovimi i njerzve dhe provimi i vendosmërisë së tyre pas plotësimit të argumentit. Vërejmë se njerëzit nuk u janë mohuar të mirat e imamit përgjatë fshehjes së tij. Sikurse është përcjellë, imami është si dielli pas reve ku përfitohet nga drita dhe rrezet e tij.[22] Shumë persona janë mbarësuar në takimin e imamit, edhe pse shfaqet në formën e një burri të panjohur. Prej tij kanë përfituar shumë në përmbushjen e nevojave dhe në zgjidhjen

21. Ata janë: Othman bin Said, Muhamed bin Othman bin Said, Husejn bin Rruh dhe Ali bin Muhamed el Semeri.
22. Biharul Anuar, i El Mexhlisij, vëll. 52, fq. 92

e problemeve materiale dhe shpirtërore. Qëndrimi i tij i gjallë konsiderohet faktor i madh nxitës në përhapjen qetësisë dhe shpresës mes njerëzve me qëllim që të përpiqen të ndreqin vetat e tyre dhe të përgatiten për pritjen e tij.

Pyetje

1. Kush është qëllimi përfundimtar në dërgimin e Profetit të Islamit(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)?
2. Si realizohet një qëllim i tillë?
3. Cilët janë ajetet që përgëzojnë për ngritjen e shtetit hyjnor mbarëbotëror?
4. Përmend shembuj të transmetimeve nga Ehli Suneti që flasin rreth imam Mehdiut.
5. Përmend shembuj nga transmetimet e Ehli Bejtit rreth fshehjes së imamit.
6. Sqaro fshehjen e vogël dhe fshehjen e madhe dhe dallimin ndërmjet tyre.
7. Sqaro enigmën e fshehjes së imam Mehdiut.
8. Cilat janë dobitë që mund të përfitojnë njerëzit gjatë kohës së fshehtësisë?

PJESA E TRETË

Leksioni i dyzetenjë

RËNDËSIA E NJOHJES SË PËRFUNDIMIT

Hyrje

Në fillim të këtij libri mësuam rëndësinë e studimit të fesë, bazat e saj, parimet doktrinale (monotezimin, profetësinë dhe ringjalljen). Po ashtu, sqaruam se jeta ndërtohet mbi trajtimin e saktë të këtyre temave. Në pjesën e parë trajtuam çështjet e monoteizmit *(teuhidin)*, në pjesën e dytë trajtuam çështjet e profetësinë dhe imamatit (udhëheqësisë). Këtu do të përpiqemi të trajtojmë nëpërmjet hulumtimit, çështjet më të rëndësishme të Ringjalljes dhe temat e saj, të cilat i përmbledh titulli: Njohja e Përfundimit."

Fillimisht do të sqarojmë veçoritë dalluese të këtij parimi doktrinal dhe ndikimin e tij të veçantë në sjelljet dhe veprimet individuale dhe shoqërore të njeriut. Më pas do të sqarojmë se përshkrimi i vërtetë i ringjalljes qëndron në pohimin e shpirtit të paprekshëm *(gajru mahsusetu)* e të përhershëm. Ashtu siç është (njohja e ekzistencës) pa besimin tek Allahu i Vetë e i Pashoq, është njohje e mangët, gjithashtu, edhe (njohja e njeriut) pa besimin tek shpirti i pavdekshëm, është njohje e paplotë. Më pas do të trajtojmë me studim çështjet bazë të Ringjalljes sipas mënyrës që i përshtatet këtij libri.

Rëndësia e besimit në Ringjallje

Sigurisht, shtytësi për aktivitete dhe veprimtari jetësore, siç është përmbushja e nevojave, dëshirave, realizimi i lakmive dhe ambicjeve, pra, arritja e lumturisë dhe e përsosurisë përfundimtare, programimi i punëve dhe e veprave, mënyra

e drejtimit të tyre, janë të lidhura me përcaktimin e qëllimeve që shpresojnë të gjithë t'i përmbushin gjatë jetës së tyre. Për këtë, njohja e qëllimit përfundimtar luan rol bazë në jetë, në orientimin e veprave, në përzgjedhjen dhe në caktimin e tyre. Në realitet faktori kryesor në përcaktimin e mënyrës së jetës qëndron në llojin e pikëpamjes, vizionit dhe njohjes së njeriut për të vërtetën, përsosurinë dhe lumturinë e tij.

Kush beson se e vërteta e tij është vetëm një grup elementesh materiale, apo e mendon jetën të kufizuar me këto ditë të pakëta të kësaj bote dhe nuk njeh kënaqësi, lumturi e përsosuri tjetër përveç këtyre të mirave dhe përfitimeve që lidhen me këtë jetë, ai do t'i rregullojë veprat dhe sjelljet e tij në atë formë që i plotësojnë atij nevojat dhe kërkesat e kësaj bote.

Ndërsa ai që beson se e vërteta është më e gjerë dhe më e largët se dukuritë materiale, vdekjen nuk e shikon si përfundim të jetës, por e sheh atë si një kalim nga kjo botë e përkohshme tek bota e përhershme dhe veprat e mira i konsideron shkak për të arritur lumturinë dhe përsosurinë e përhershme, ky njeri do të programojë dhe do të përshtasë sistemin e jetës së tij në atë mënyrë që të jetë sa më e frytshme dhe sa më ndikuese për jetën e tij të përhershme. Nga ana tjetër, vështirësitë, gabimet dhe humbjet me të cilat përballet në jetën e kësaj bote, nuk e zbehin vendosmërinë e tij dhe nuk përcjellin në të demoralizim dhe humbje të shpresës, si dhe nuk e pengojnë që të vazhdojë përpjekjet dhe sakrificat e tij në rrugën e kryerjes së detyrave të tij që të arrijë lumturinë dhe përsosurinë e përhershme.

Ndikimi i këtyre dy llojeve të njohjes së njeriut nuk kufizohet vetëm në jetën individuale, por ato kanë ndikim të madh edhe në jetën shoqërore, në qëndrimet e njerëzve dhe marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin. Besimi në jetën pas vdekjes *(Ahiret)*, në shpërblimin dhe ndëshkimin e përjetshëm, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në kryerjen dhe përbushjen e nevojave të nevojtarëve

dhe të të privuarve. Kur në shoqëri sundon ky lloj besimi, nuk është aspak e nevojshme përdorimi i forcës për zbatimin e rregullave dhe ligjeve të drejta, për të luftuar padrejtësinë dhe armiqësinë ndaj të tjerëve. Natyrisht, kur ky besim bëhet botëror dhe gjithëpërfshirës, do të vërejmë se do të pakësohen në mënyrë të ndjeshme shumë nga problemet ndërmjet shteteve.

Nëpërmjet këtyre *(mulahadhateve)* na qartësohet rëndësia e çështjes së Ringjalljes dhe vlera e studimit të saj. Jo vetëm kjo, por edhe besimi në monoteizëm nëqoftëse nuk shoqërohet me besimin në Ringjalljen, nuk mund të ndikojë një ndikim të plotë dhe të përgjithshëm në udhëzimin e jetës në një drejtim të saktë e të rregullt. Prej këtu na zbulohet sekreti i interesimit të feve qiellore, veçanërisht, fesë islame të shenjtë, rreth kësaj baze të doktrinës. Gjithashtu, na zbulohet sekreti i përpjekjeve të profetëve në rrugën e rrënjosjes së kësaj doktrine në shpirtra.

Besimi në Botën Tjetër ndikon në orientimin e sjelljeve dhe veprave individuale dhe shoqërore, nëqoftëse dëshmohet prania e marrëdhënies shkak – pasojë mes qëndrimeve dhe veprave në këtë botë dhe lumturisë dhe vuajtjes në Botën Tjetër. Është e domosdoshme që të pohohet se begatia dhe ndëshkimi në Botën Tjetër janë shpërblim ose ndëshkim i veprave të mira dhe të këqija që kryhen në jetën e kësaj dynjaje.

Nëse do të besojmë se lumturia e Botës Tjetër arrihet në atë botë, ashtu siç arrihen mirësitë dhe kënaqsia e kësaj bote në këtë botë, atëherë besimi në Botën Tjetër do të humbasë ndikimin e tij veprues në veprat e kësaj bote. Pra, bazuar në këtë besim dhe kuptim mund të themi se: në këtë botë duhet përpjekje për të arritur lumturinë e saj. Po ashtu, për të arritur lumturinë e botës tjetër është e nevojshme përpjekja në atë botë pas vdekjes!

Nga këtu, krahas konstatimit të ringjalljes dhe të jetës pas vdekjes, është e domosdoshme të konstatojmë edhe marrëdhënien ndërmjet dy botëve (kësaj bote dhe Botës Tjetër), si dhe ndikimin e veprave zgjedhëse në lumturinë dhe vuajtjen e përjetshme.

Interesimi i Kur'anit për çështjen e Ringjalljes

Ajo që vihet re është se më shumë se një e treta e ajeteve kur'anore kanë lidhje me Jetën e Përjetshme. Në një grup të këtyre ajeteve, Kur'ani përforcon domosdoshmërinë e besimit në Jetën Tjetër.[1] Ndërsa në një grup tjetër tregon ndikimet e mohimit të Ringjalljes.[2] Grupi i tretë flet për mirësitë e përjetshme.[3] Në grupin e katërt Kur'ani paraqet llojet e ndëshkimit të përjetshëm.[4] Gjithashtu, janë edhe shumë ajete të cilat përmendin marrëdhënien ndërmjet veprave të mira dhe të këqija, me rezultatet dhe ndikimet e tyre në Botën Tjetër. Po ashtu, përmes mënyrave të ndryshme, përforcon ndodhinë e Kiametit dhe domosdoshmërinë e tij, si dhe ju përgjigjet dyshimeve dhe dilemave të mohuesve. Disa ajete sqarojnë se shkaku i shumë llojeve të humbjes dhe devijimit është harrimi dhe mohimi i Kiametit dhe Ditës së Gjykimit.[5]

Duke mediturar rreth ajeteve kur'anore vërejmë se grupi më i madh bisedave të profetëve dhe i diskutimeve të tyre me njerëzit vërtitej rreth temës së Ringjalljes. Por mund të thuhet se përpjekjet e tyre për konstatimin e këtij parimi (Ringjaljen) kanë qenë më të shumta se përpjekjet që kanë bërë për vërtetimin dhe konstatimin e monoteizmit. Shkaku ishte se shumica e njerëzve kishin një qëndrim më të ashpër dhe kundërshtues kundrejt Ringjalljes. Shkakun e kokëforcisë dhe kundërshtimit të tyre mund ta përmbledhim në dy gjëra:

• *E para*: Është faktori i përbashkët përmblidhet në mohimin e çdo çështjeje të padukshme dhe jo të prekshme.

• *E dyta*: Është faktori i veçantë që lidhet me temën e Ringjalljes. Është dëshira për liri të plotë dhe mosndjenja e përgjegjësisë. Ashtu si e theksuam më sipër, besimi në Ditën

1. Sure "El Bekare", ajeti 4, sure "Llukman", ajeti 4, sure "El Neml", ajeti 3.
2. Sure "El Isra", ajeti 10, sure "El Furkan", ajeti 11, sure "Sebe", ajeti 8, sure "El Muminun", ajeti 74.
3. Sure "El Rrahman", nga ajeti 46 deri në fundin e sures, sure "El Uakia", ajetet 15-38.
4. Sure "El Haka", ajetet 20-27, sure "El Mulk", ajetet 6 – 11, sure "El Uakia", ajetet 42-56.
5. Sure "Sad", ajeti 26, sure "El Sexhde", ajeti 14.

e Llogarisë dhe Gjykimit konsiderohet një mbështetës i fortë dhe i patundur ndaj ndjenjës së përgjegjësisë. Është motiv për të pranuar më tepër norma në sjellje dhe vepra, si dhe në luftimin e padrejtësisë, armiqësisë, shkatërrimit dhe shthurjes. Me mohimin e Ringjalljes do të hapet rruga për të vërshuar veprimet e pahijshme, epshet, devijimet etj. Kur'ani Fisnik na lajmëroi duke thënë: **"A mendon njeriu se nuk do t'i tubojmë eshtrat e tij? Po, do t'ja tubojmë! Duke qënë se Ne jemi të zotët T'ja rikrijojmë si kanë qënë edhe majat e gishtave të tij. Por, njeriu dëshiron të vazhdojë edhe mëtej në mëkate."**[6]

Këtë gjendje shpirtërore, e cila nuk pranon ta njohë ringjalljen në kuptimin e saj të vërtetë, mund ta vërejmë tek të gjithë ata që përpiqen me thëniet dhe shkrimet e tyre ta përshtasin Ringjalljen dhe "Jeumul Akher" si dhe gjithë shprehjet kur'anore rreth Ringjalljes me dukuritë e kësaj bote, me rilindjen e popujve dhe kombeve, ngritjen e shoqërive joshtresore, me ndërtimin e Xhenetit në këtë tokë. Ose, e sqarojnë Botën Tjetër dhe kuptimet që lidhen me të me kuptimet vlerësuese të krijuara, të konsideruara dhe legjendare.[7]

Kur'ani Fisnik i ka konsideruar tillët si (shejtanët njerëz) dhe (armiqtë e profetëve), sepse me thëniet e tyre mashtruese ata përpiqen që të deformojnë mendjet dhe të mashtrojnë zemrat, t'i largojnë njerëzit nga besimi i vërtetë dhe nga zbatimi i mësimeve dhe ligjeve të Allahut: **"Dhe kështu** (sikurse edhe ty) **çdo pejgamberi i bëmë armiq disa nga njerzit dhe nga xhindet e djallëzuar, që me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë nxit njëri-tjetrin në mashtrime. E silur të donte Zoti yt, ata nuk do bënin atë** (armiqësi)**, po ti lëri ata me ato trillime. Dhe që të anojnë** (te ato fjalë mashtruese) **zemrat e atyre që nuk e besojnë botën e ardhshme dhe që të kënaqen e ngarkohen me ta që janë duke u ngarkuar** (ty nuk të dëmtojnë asgjë)."[8]

6. Sure "El Kijame", ajetet 3-5.
7. Sure "El Neml", ajeti 68, sure "El Ahkaf", ajeti 17.
8. Sure "El Enam", ajetet 112-113.

Konkluzioni

Që njeriu të ketë mundësi të zgjedhë në jetën e tij rrugën e cila e çon në lumturinë e vërtetë dhe në përsosurinë përfundimtare, duhet që të mendojë: A përfundon jeta njerëzore me vdekjen? A ekziston jetë tjetër pas kësaj jete? Kalimi nga kjo botë në botën tjetër, a është si një udhëtim nga një qytet në një tjetër, ku duhet të përgatisë të gjithë gjërat dhe mjetet e nevojshme që i duhen për të jetuar në qytetin ku do të shkojë?

Apo për jetën në botën e ardhshme duhet të përgatitet dhe të punojë në këtë botë, për të arritur rezultatin përfundimtar në Botën Tjetër? Në qoftë se njeriu nuk i trajton këto çështje, e ka të pamundur të njohë rrugën dhe të përcaktojë rregullin e jetës dhe mënyrën e jetesës. E gjithë kjo sepse, nëse nuk e njeh qëllimin e udhëtimit dhe përfundimin e tij, nuk mund të përcaktojë rrugën që e çon atje ku ai do.

Si përfundim, ne e përforcojmë supozimin e ekzistencës së Jetës Tjetër, sado i dobët të jetë supozimi. Ky supozim do të mjaftonte që ta nxiste njeriun e zgjuar dhe të llogjikshëm të studiojë dhe të hulumtojë rreth Jetës Tjetër. E gjithë kjo për shkak se "sasia supozuese" nuk është përfundimtare.

Pyetje:

1. Sqaro dallimin ndërmjet besimit në Ringjallje dhe mosbesimit në të në fushën e drejtimit të veprimtarisë jetësore.
2. Kur mundet që besimi në Jetën Tjetër të ndikojë më shumë në drejtimin e kërkuar të jetës?
3. Shpjego interesimin e Kur'anit mbi temën e Ringjalljes.
4. Shpjego shkakun e qëndrimit kundërshtues dhe mospranues të njerëzve ndaj Ringjalljes.
5. Trego një shembull prej përpjekjeve të disa të sëmurëve shpirtërorë në devijimin e besimit në Ringjallje dhe qëndrimin e Kur'anit Fisnik kundrejt këtyre devijimeve.
6. Sqaro domosdoshmërinë e hulumtimit rreth Ringjalljes, si dhe përparësinë e kësaj domosdoshmërie mbi çështjet e tjera të kësaj bote.

Leksioni i dyzetedy

MARRËDHËNIET E TEMËS SË RINGJALLJES ME SHPIRTIN

Kriteri i përbashkët në qëniet e gjalla

Trupi i njeriut përbëhet nga një grup qelizash siç është edhe te kafshët. Çdo qelizë është në transformim dhe ndryshim të vazhdueshëm. Po ashtu, një numër qelizash nuk janë konstante që nga lindja deri në fund të jetës. Nuk gjen asnjë njeri që të mos i ndryshojë struktura e trupit, ose një grup qelizash të qëndrojnë të pandryshuara përgjatë jetës së tij.

Duke vërejtur këto ndryshime dhe trasformime me të cilat përballen trupat e kafshëve, veçanërisht njeriun, lind një pyetje: Cila është kriteri i përbashkët në konsiderimin e këtij grup të ndryshueshëm qelizash një krijesë të vetme, edhe pse vërejmë shumë herë ndryshimin e pjesëve të tij përgjatë jetës?[1]

Përgjigja e thjeshtë që i jepet kësaj pyetjeje se: Kriteri i përbashkët i unifikimit në çdo qenie të gjallë është lidhja e pjesëve në kohën e njëjtë ose në kohë të ndryshme. Këto qeliza, edhe pse vdesin gradualisht, për t'ia lëshuar vendin qelizave të reja, por duke parë lidhjen e këtyre gjendjeve dhe periudhave ndërmjet tyre, këto grupe të ndryshme mund të konsiderohen ekzistencë e vetme (unike).

Mirëpo, kjo përgjigje nuk është bindëse, sepse, nëse do

1. Para se të bëhet kjo pyetje mund të shtrohet një tjetër pyejtje: Cila është kriteri në grupet e qëndrueshme dhe të mbyllura? Me çfarë kriteri t'i konsiderojmë përbërjet kimike dhe pjesët e trupit një ekzistencë unike, të përbashkët? Për të mënjanuar zgjerimin e tepërt në këtë studim, do ta shmangim këtë lloj hulumtimi dhe i sugjerojmë lexuesit librin: "Studimi filozofisë" *(Ta'lijmul felsefeh)*.

të supozojmë një ndërtesë të përbërë me gurë dhe këto gurë gradualisht shndërrohen dhe ndryshojnë plotësisht formën e mëparshme dhe zëvendësohen tërësisht me gurë të rinj, ne nuk mund ta konsiderojmë më ndërtesën të njëjtë me të mëparshmen edhe nëse përdoren të njëjtat shprehje në formën e dukshme dhe veçanërisht ata të cilët nuk janë njohur me ndryshimet dhe transformimet e pjesëve të këtyre grupeve.

Plotësimi i përgjigjes së mëparshme mund të bëhet në këtë formë: Këto ndryshime graduale nuk e dëmtojnë unifikimin (të përbashkëtën) e grupit gjatë ripërtëritjes për shkak të faktorit natyror dhe faktorit të brendshëm, sikurse vërehet në krijesat e gjalla. Ndërsa ndryshimi i gurëve të ndërtesës është bërë nëpërmjet faktorëve të jashtëm dhe të dukshëm. Për këtë, nuk mund t'i mvishet e përbashkëta e vërtetë përgjatë ndryshimit të pjesëve dhe trasformimit të tyre.

Kjo përgjigje bazohet mbi pohimin e ekzistencës së një faktori të përbashkët natyror, i cili qëndron vetvetiu përherë gjatë periudhave të trasformimit. Ai faktor ruan rregullin dhe përshtatshmërinë e pjesëve dhe gjymtyrëve me të cilat përbëhet trupi. Prej këtu lind pyetja rreth këtij faktori: Cila është e vërteta e tij? Kush është kriteri i tij?

Në bazë të teorisë së njohur filozofike: Kriteri i përbashkët në çdo ekzistencë natyrore është një çështje e thjeshtë (jo e përbërë) dhe jo e prekshme. Ajo quhet "natyrë" ose "pamje".[2] Ky kriter përgjatë ndryshimeve të lëndës dhe trasformimeve të saj nuk shndërrohet. Këtij faktori i thonë "nefs", veçanërisht te krijesat e gjalla, të cilat kryejnë vepra të ndryshme dhe të shumta, si: ushqyerja, rritja dhe shumimi.

Filozofët e lashtë e konsideronin shpirtin e bimëve dhe të kafshëve (materie), kurse shpirti njerëzor abstraksion *(muxher-redeh)*. Shumë nga filozofët myslimanë, si Sadrul Muteelihijne Shirazi ka thënë se edhe shpirti i kafshëve përmban një shkallë abstraksioni *(texher-rudi)*. Ndjenjat dhe dëshirat i konsideruan

2. Është e rëndësishme ta dimë se çdonjëra prej këtyre shprehjeve ka kuptime të tjera terminologjike.

prej të domosdoshmeve dhe shenjave të ekzistentit abstrakt (nefs). Kurse, materialistët të cilët e kufizojnë ekzistencën me materien dhe veçoritë e saj, e mohuan shpirtin abstakt. Materialistët e rinj (si autorët e filozofisë uadijetu) e mohuan çdo gjë që nuk është e prekshme. Ata besonin se e paprekshmja nuk pranon konstatim shkencor. Nga këtu, ata nuk e pranonin ekzistencën e natyrës apo të imazhit të paprekshëm. Sidoqoftë, ata nuk zotëronjë trajtimin e saktë të të përbashkëtës në krijesat e gjalla.

Duke pranuar thënien se kriteri i përbashkët i bimëve është vetë nefsi i tyre, atëherë jeta e bimëve është e varur me ekzistencën e imazhit dhe nefsit të posaçëm në lëndët aftësuese (gadishmëruese). Kur largohet aftësia e këtyre lëndëve, gjithashtu zhduket imazhi ose nefsi i bimëve. Nëse do të supozojmë arritjen e aftësisë për të pranuar imazhin bimor në ato lëndë për herë të dytë, atëherë do të lindë shpirt i ri bimor.

Në këtë kontekst, nuk mund të ketë asnjëherë të përbashkët të vërtetë ndërmjet bimës së vjetër dhe bimës së re, megjithë ekzistencës së ngjasimit të plotë ndërmjet tyre. Kjo do të thotë se nëse do t'i hedhim një vështrim të imtësishëm dhe zbulues nuk mund ta konsiderojmë bimën e re bimë të vjetër.

Ndërsa në lëmën e kafshëve dhe të njerëzve, meqenëse shpirti i çdonjërit prej tyre është abstrakt, ky nefs mund të qëndrojë pasi të jetë prishur dhe të jetë shpërbërë trupi. Dhe kur të bashkohet sërisht me të e ruan njeriu njëshmërinë e tij sikurse ishte gjendja para vdekjes, kur njëshmëria e shpirtit ka qënë e përbashkët me njeriun. Ndryshimi i materialeve (elementëve) të trupit nuk çon në ndryshimin e personit. Nëse dikush beson se ekzistenca e kafshës dhe e njeriut është e kufizuar dhe i përcaktuar me këtë trup të prekshëm dhe me veçoritë e tij dhe e konsideron shpirtin veçori apo grup prej veçorive të trupit, edhe nëse e konsideron shpirtin imazh jo të prekshëm, por që është materiale dhe zhduket e shpërbëhet

kur shpërbëhet trupi, ky person nuk ka një ide (mendim) të saktë rreth Ringjalljes. Kjo sepse, nëse do të supozojmë se trupi përfiton aftësi të reja për jetën, do të shfaqen në të veçori dhe simptoma të reja. Bazuar në këtë, nuk zotëron kriterin e vërtetë për uahdetin e tij sepse duhej që veçoritë e mëparshme të zhdukeshin plotësisht dhe të gjendeshin veçori të reja.

Përfundimi është: Ne mund të përfytyrojmë për jetën pas vdekjes një pamje të saktë dhe të pranueshme nëse do ta konsiderojmë shpirtin si trupi. Por duhet gjithashtu të mos konsiderohet shpirti si një imazh materiale që futet në trup dhe zhduket kur prishet trupi. Pra, së pari duhet të pohojmë ekzistencën e shpirtit. Së dyti është e domosdoshme ta konsiderojmë shpirtin si çështje thelbësore dhe prej simptomave të trupit. Së treti duhet të besojmë se shpirti është i pavarur, qëndron edhe mbas prishjes të trupit. Shpirti nuk është si çdo gjë tjetër e trupit që shkatërrohet me prishjen e trupit.

Qëndrimi i shpirtit në qënien njeërzore

Një vërejtje tjetër që është e nevojshme ta theksojmë është se përbërja e njeriut nga trupi dhe shpirti nuk është njëlloji si përbërja e një lëndë kimike që përbëhen nga dy elementë, siç është uji përbëhet nga oksigjeni dhe hidrogjeni ku nëse ndahet njëri nga tjetri atëherë ekzistuesi i përbërë do ta humbasë cilësinë e tij dhe do të zhduket. Shpirti është elementi bazë dhe kryesor tek njeriu. Përderisa ekziston shpirti, edhe njerëzorja e njeriut dhe personaliteti i personit ekzistojnë. Ndryshimi i qelizave në trupin e njeriut dhe trasformimi i tyre nuk e dëmton tërësinë e personit. Kjo për shkak se kriteri i vërtetë tek njeriu është ajo shpirtërore.

Këtë të vërtetë e ka theksuar edhe Kur'ani Fisnik në përgjigjen e tij ndaj mohuesve të Ringjalljes kur pyetën: Si ka mundësi që njeriu të fitojë një jetë të re pasi të jetë shpërbërë të gjitha pjesët e trupit të tij? Kur'ani u përgjigjet: **"Thuaj:**

Ëngjilli i vdekjes i cili është caktuar për ju."[3] Pra njerëzorja e çdo njeriu dhe personaliteti tij varet nga gjëja e cila e merr Engjëlli i vdekjes dhe jo te pjesët e trupi të cilat shpërndahen dhe përhapen në tokë.

Pyetje:

1. A mund ta konsiderojmë lidhjen e pjesëve të ndryshueshme të një grupi të përbashkët kriteren të vetme? Dhe pse?

2. Cila është kriteri tjetër që mundet të supozohet si i njëjtë ndërmjet përbërësve të trupit?

3. Cila është teoria e njohur filozofike rreth njëshmërisë së ekzistencave të përbëra veçanërisht krijesat e gjalla?

4. Cili është dallimi ndërmjet imazhit natyror dhe shpirtëror?

5. Cili është dallimi ndërmjet shpirtit (nefsit) të bimëve, kafshëve dhe njërzve? Cili është ndikimi i këtij dallimi në çështjen e Ringjalljes?

6. Kush janë parimet për të cilat ka nevojë përfytyrimi i saktë për Ringjalljen?

7. Cili është dallimi mes përbërjes së njeriut nga shpirti dhe trupi dhe përbërjeve kimike?

3. Sure "Es Sexhde", ajeti 11.

Leksioni dyzetetretë

ABSTRAKSIONI I SHPIRTIT

Hyrje

Më parë sqaruam se çështja e Ringjalljes është e lidhur me shpirtin që do të thotë se kur thuhet: "Personit të cilit do t'i kthehet jeta pas vdekjes është po i njëjti person". Pra, shpirti i tij ekziston edhe pas prishjes së trupit të tij. Thënë ndryshe: Çdo njeri, përveç trupit të tij material, zotëron edhe një margaritar (xhevahir) jo material, që është i pavarur nga trupi. Me të lidhet njerëzorja dhe personaliteti i tij. Përkundër kësaj paraqitjeje a forme, supozimi i një jetë të re i të njëjtit person, është supozim jo i pranueshëm.

Për këtë, para se hulumtimit rreth temës së konstatimit të Ringjalljes dhe paraqitjes të çështjeve të saj, duhet të vërtetojmë idenë e mësipërme. Ky leksion është i posaçëm për këtë studim. Ne do ta argumentojmë këtë konstatim nëpërmjet dy rrugëve:

- *E para:* Mënyra logjike.
- *E dyta:* Nëpërmjet rrugës të revelatës. [1]

1. Është e mundur që të iluzohet se: Argumentimi nëpërmjet rrugës së Shpalljes për konstatimin e çështjeve të shpirtit dhe të Ringjalljes është argumentim "deurijun". Kjo sepse në argumentin i cili u ngrit mbi domosdoshmërinë e profetësisë, Bota Tjetër është konsideruar e ndërtuar mbi çështjen e shpirtit, si parim tematik. Prandaj, vërtetimi dhe konstatimi i këtij parimi në vetevete nëpërmjet rrugës së Shpalljes dhe profetësisë i duhet "deurij" Ne duhet të dimë se rregullësia e argumentimit me Shpallje nuk ka nevojë për çështjen e domosdoshmërisë të profetësisë, por ajo varet te realizimi i saj (profetësisë) e cila vërtetohet nëpërmjet mbrekullisë (mendohu thellë!). Meqenëse vetë Kur'ani Fisnik është mrekulli dhe argument se Profeti i Islamit është në të drejtë, atëherë është i pranueshëm dhe i saktë argumentimi me anë të tij për të vërtetuar çështjet e shpirtit dhe Ringjalljes.

Argumentat logjikë mbi abstraksionin e shpirtit

Që në kohët e vjetra dijetarët kanë kërkuar shumë rreth shpirtit (në terminologjinë filozofike i thuhet "nefsun") [2] e veçanërisht dijetarët myslimanë të cilët janë kujdesur shumë rreth kësaj teme. Në librat e tyre filozofikë kanë veçuan kapituj të rëndësishëm rreth këtij studimi, si dhe kanë shkruar literaturë të posaçme në këtë fushë. Gjithashtu, kanë diskutuarme argumente të shumta mendimet dhe idetë të cialt thonë se shpirti është prej siptomave të trupit, apo shpirti është prej formave të trupit i bashkëngjitur me materien e trupit.

Është e qartë se studimi i gjerë i kësaj teme këtu nuk i përshtatet këtij libri. Kjo është arsyeja që do ta studiojmë shkurtimisht dhe do të përpiqemi ta paraqesim me një mënyrë sa më të qartë dhe bindës. Do ta fillojmë këtë studim me një përmbledhje të disa argumentave llogjikë me këtë premisë. Ne e shohim ngjyrën e lëkurës dhe formën e trupit tonë. E ndjejmë ashpërsinë e organeve dhe butësinë e tyre nëpërmjet prekjes. Me brendinë e trupave tanë njihemi në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Por frikën, dashurinë, zemërimin, dëshirën dhe mendimet tona ne mundemi t'i kuptojmë pa patur nevojë për shqisat. Gjithashtu ne njohim atë që i thuhet "unë", i cilin zotëron këto ndjenja, mendime, sentimente dhe gjendje shpirtërore pa përdorur shqisat.

Pra njeriu zotëron dy lloje kuptimi:

- *I pari:* Ka nevojë për shqisat.
- *I dyti:* Nuk ka nevojë për shqisat.

Çështje tjetër: Duke vërejtur gabimet me të cilat përballen shqisat atëherë është i mundur supozimi i gabimit tek lloji i parë i perceptimit, i cili është në ndryshim nga lloji i dytë që nuk lë vend për gabim, dyshim apo mëdyshje. Njeriu mundet

2. Duhet ta dimë se termi filozofik "nefsun" është ndryshe nga termi që përdoret në moral. Në moral është përdorur termi i kundërt i mendjes "el akl" dhe që dëshmon të kundërtën e saj.

të dyshojë në ngjyrën e lëkurës. A është ashtu si e pa në realitet apo jo, por askush nuk mund të dyshojë se a mendon apo jo, e dëshiron dicka apo jo, dyshon në diçka apo jo?!.

Kjo është ideja e cila shtrohet në filozofi që thotë: Dituria e pranishme (hudhurij) është e lidhur drejpërsëdrejti me vetë realitetin dhe për këtë nuk pranon gabim. Kurse dituria e arritur (husulij), përderisa arrihet nëpërmjet imazheve perceptues, pranon në vetvete mëdyshjen dhe dyshimin. [3]

Kuptimi i kësaj është: Dijet dhe njohjet më të sakta dhe më bindëse njerëzore janë ato të pranishme (hudhurijeh) dhe mudrekatet shuhudijeh, të cilat përfshijnë psikologjinë, sentimentet, ndjenjat, gjendjet e ndryshme shpirtërore. Prej këtu shohim se fraza "unë" kuptuesi, dalluesi, dëshiruesi, nuk pranon dyshim dhe mëdyshje asnjëherë. Gjithashtu, ekzistenca e gjendjes së frikës, dashurisë, zemërimit, mendimeve dhe dëshirës nuk pranojnë mëdyshje.

Këtu lind pyetja: A është ky "unë" trupi material dhe i prekshëm? A janë këto gjendjet shpirtërore prej siptomave të trupit, apo ekzistenca e tyre është ndryshe nga ekzistenca e trupit edhe pse "unë" ka marrëdhënie të forta dhe të fuqishme me trupin sepse, shumë prej veprave dhe veprimtarive të "unë", kryhen nëpërmjet trupit. Ashtu siç ndikohet trupi prej tij, edhe ai ndikohet nga trupi.

Duke vërejtur thëniet e lartpërmendura, lehtësohet përgjigja rreth kësaj pyetjeje.

• *Së pari:* Ne e njohim "unë" me diturinë e pranishme (hudhurij), ndërsa trupin e njohim me ndihmën e shqisave. Pra, "unë = nefsun dhe ruhun" dhe jo trup.

• *Së dyti:* "Unë" është ekzistencë që qëndron e ruajtur përgjatë dhjetra viteve në të njëjtin përshkrim dhe personalitet të vërtetë. Ne e njohim këtë përshkrim dhe personalitet nëpërmjet dijes së pranishme (hudhurij), e cila nuk pranon gabime. Kurse, pjesët e trupit përballen me ndryshim dhe trasformim shumë herë dhe nuk ka asgjë të përbashkët

3. Kthehu tek: "Ta'limul Felsefeh", vëll. 1, leksioni i 13.

ndërmjet pjesëve të mëparshme dhe atyre pasardhëse.

• *Së treti:* "Unë" është ekzistencë e thjeshtë dhe nuk pranon as ndarje dhe as copëtim. Nuk mund të ndahet në dy pjesë. Kurse pjesët e trupit që janë të shumta, e pranojnë ndarjen.

• *Së katërti:* Vërehet se të gjitha gjendjet shpirtërore si ndjenjat, dëshirat, etj nuk zotërojnë veçanëri parimore për materialet. Pra, vazhdimësi dhe aftësi për ndarje. Për këtë, këto çështje jomateriale nuk mund të konsiderohen prej siptomave të trupit. Prandaj, duhet që subjekti i këtyre siptomave të jetë xhevahir jomaterial (= abstarkt). [4]

Prej argumentave që na shtynjë të bindemi për ekzistencën e shpirtit, pavarësinë e tij dhe qëndrimin e tij pas vdekjes, janë ëndrat vërteta. Sipas disa informacioneve të sakta, disa persona pas vdekjes, janë shfaqur në gjumë personave të tjerë. Gjithashtu, prej argumentave është sjellja e shpirtërave dhe shikimi i tyre me sy. Konstatimi i abtraksionit të shpirtit mund të bëhet edhe me kerametet e evlijave të Allahut. Por edhe te disa që ushtrohen. Sigurisht, hulumtimi rreth këtyre çështjeve kërkon një libër të veçantë.

Argumentat kur'anorë

Kur'ani Fisnik na tregon se shpirti njerëzor ekziston. Kjo e vërtetë kur'anore nuk pranon dyshim dhe as mëdyshje. Sepse, shpirti e ka prejardhjen nga Allahu i Madhëruar përshkak të nderimit dhe lartësisë së tij[5] ashtu sikurse tregon Kur'ani Fisnik për mënyrën e krijimit të njeriut ku thotë: **"Dhe nga ana e vet i jep shpirt atij."[6]**

Qëllime i kësaj nuk është - Zoti na ruajt - shkëputja e ndonjë pjesë nga Allahu i Madhëruar dhe kalimi i saj te njeriun. Për krijimin e Ademit Allahu i Madhëruar thotë: **"Dhe nga ana ime i dhashë shpirt atij."[7]**

4. Kthehu tek"Ta'limul Felsefeh", vëll. 2, leksioni i 14 dhe 49.
5. Usul el Kafi, vëll. 1, fq. 134.
6. Sure "El Sexhde", ajeti 9.
7 Sure "El Hixhr", ajeti 29, sure "Sad", ajeti 62.

Gjithashtu, nga ajetet e tjera përfitojmë se shpirti nuk është trupor dhe nuk ka veçanëritë dhe karakteristikat e trupit. Shpirti posedon aftësinë e qëndrimit edhe pa trupin. Prej ajeteve është ajo që përcjell me gjuhën e jobesimtarëve: "**A pasi që ne të tretemi në tokë, a thua ne rishtazi do të krijohemi?"**[8] që do të thotë: Edhe në kur të shpërbëhen pjesët e trupit tonë në tokë? Kur'ani Fisnik u përgjigjet duke thënë: "Thuaj: **"Ëngjëlli i vdekjes i cili është caktuar për ju, ua merr shpirtrat, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj."**[9]

Pra e përbashkëta e njeriut dhe e vërteta e tij është shpirti të cilin e merr ëngjëlli i vdekjes dhe vazhdon të qëndrojë dhe nuk janë pjesët e trupit që shpërbëhen dhe treten në tokë.

Në një tjetër ajet thuhet: **"All-llahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes të tyre** (i vdekjes së trupave tyre), **e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur, e atij që i është caktuar ndekja e mban** (nuk e kthen) **, e atë tjetrin** (që nuk i **është caktuar vdekja, por është në gjumë), e lëshon të kthehet deri në një afat të caktuar."**[10]

Për vdekjen e zullumqarëve Kur'ani Fisnik thotë: **"E, silur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjejt kanë shtrirë duarte veta"**[11]

Nga këto ajete dhe nga ajetet e tjera, të cilat nuk po i përmendim për të ruajtjes së përmbledhjes, kuptojmë se shpirti i çdo njeriu kufizohet në atë që e merr Engjëlli i vdekjes dhe ëngjëjt që janë ngarkuar për të marrë shpirtrat. Zhdukja e trupit nuk ndikon në qëndrimin e shpirtit dhe në njëshmërinë e personalitetit njerëzor. Si rezultat i kësaj themi se:

- *Së pari:* Te njeriu ekziston diçka që quhet shpirt.
- *Së dyti:* Shpirti i njeriut ka aftësinë e qëndrimit dhe pavarësisë nga trupi. Ai nuk është prej siptomave dhe imazheve materiale të cilat zhduken.
- *Së treti:* Identiteti i çdo njeriu është i lidhur me shpirtin

8. Sure "El Sexhde", ajeti 10.
9. Sure "El Sexhde", ajeti 11.
10. Sure "El Zumer", ajeti 42.
11. Sure "El Enam", ajeti 93.

e tij. Thënë ndryshe: E vërteta e çdo njeriu është shpirti i tij. Ndërsa trupi luan rolin e mjetit në krahasim me shpirtin.

Pyetje:

1. Përshkruaj diturinë e pranishme (hudhurij) dhe të arritur (husulij) dhe trego dallimet ndërmjet tyre.

2. Shpjego argumentat logjkë mbi abstraksionin e shpirtit?

3. Cilat janë rrugët e tjera me të cilat mund të vërtetohet abstraksioni i shpirtit?

4. Përmend ajetet e Kur'anit që kanë lidhje me këtë temë.

5. Cilat janë përfundimet që arrijmë nga përfitimi prej këtyre ajeteve?

Leksioni i dyzetekatërt

VËRTETIMI I RINGJALLJES

Hyrje

Shënim: Në fillim të këtij libri theksuam se besim në Ringjallje dhe ringjallja e njerzve në Botën Tjetër është prej parimeve të rëndësishme doktrinore në të gjitha fetë qiellore. Edhe Profetët e kanë përforcuar të këtë parim duke u përballur me shumë sfida dhe mundime në rrugën e rrënjosjes dhe ngulitjes së këtij besimi në shpirt e në zemra. Kur'ani Fisnik e konsideron besimin në Ringjallje drejtësi dhe bahkëshoqërues me teuhidin (monoteizmin). Ai e ka përdorur në më shumë se njezet herë fjalën "Allah" dhe "Dita e Fundit". Duhet shtuar këtu se Kur'ani Fisnik flet për çështjen e Ahiretit në më shumë se dy mijë ajete në sure të ndryshme.

Në fillimin e pjesës së tretë në paraqitëm rëndësinë e studimit të njohjes së përfundimit. Sqaruam gjithashtu se pasqyrimi i drejtë i Ringjalljes, bazohet në pohimin e shpirtit dhe e cili konsiderohet e përbashkëta e identitetit të çdo njeriu dhe se shpirti do të ekzistojë edhe pas vdekjes. Mund të thuhet se: personi i cili vdes në këtë botë është po ai që do të ringjallet përsëri në Botën Tjetër.

Pas kësaj ne hulumtuam konstaimin e shpirtit nëpërmjet rrugës së logjikës dhe Shpalljes. Të gjitha këto që të përgatisim rrugën për të studiuar hulumtimet bazë dhe ato kryesore rreth jetës së përjetshme të njeriut. Tani erdhi koha e hulumtimit për konstatimin e këtij parimi të rëndësishë doktrinor.

Ashtu siç konstatuam çështjen e shpirtit nëpërmjet logjikës dhe Shpalljes, gjithashtu edhe kjo çështje mund të konstatohet nëpërmjet këtyre dy rrugëve. Fillimisht do të

përmendim dy argumenta logjikë mbi domosdoshmërinë e Ringjalljes dhe më pas do të paraqesim ajetet kur'anore që flasin rreth Ringjalljes dhe domosdoshmërisë së saj.

Argumenti i urtësisë

Sqaruam në pjesën e parë të këtij libri, e cila ishte e posaçme për teuhidin, se krijimi i njeriut nuk ishte aksidental, i rastësishëm dhe pa një qëllim, por ishte dashuria për të mirën dhe përsosjen, që janë vetë Veta e Shenjtë, të cilat Allahu ua ka dhuruar njerëzve dhe kanë grada e shkallë të ndryshme tek ata. Për këtë, bota është krijuar në atë formë e cila ku mund të arrithet e mira dhe e përsosura. Mbi këtë bazë vërtetuam ciilësinë e urtësisë. Qëllimi i saj është që krijesat të arrijnë në synimin, përsosjen e përshtatshe. Por meqënëse bota materiale është e zhurmshme dhe në të konflikton dhe përplasen të mirat e ekzistencave dhe përsosuritë ndërmjet tyre, atëherë maturia e Allahut të Urtë bën që të sistemojë ekzistencat në formën e atillë që të gjitha të garojnë për të mirat dhe përsosurinë. Thënë ndryshe: Bota të sundohet nga një rregull më i mirë.

Kështu që u sistemuan dhe u përshtatën llojet e elementëve, sasia dhe cilësia e tyre, veprimet dhe lëvizjet e tyre në atë formën që të ofrojnë rrethanat dhe kushtet e përshtatshme për krijimin e bimëve e të kafshëve dhe së fundmi për krijimin e njeriut, krijesa më e përsosur në këtë botë. Nëqoftëse krijimi i botës materiale do të bëhej në atë formë që nuk mundëson krijimin e krijesave të gjalla, zhvillimin e rritjen e tyre, atëherë kjo do të binte ndesh me urtësinë.

Këtu shtojmë: Njeriu zotëron shpirtin që ka aftësinë e qëndrimit përherë dhe ai (njeriu) ka mundësinë që të arrijë përsosurinë e përjetshme, e cila nuk krahasohet me përsosuritë materiale as nga grada dhe as nga vlera, por është më e lartë dhe më inferiore. Nëqoftëse jeta e tij do të kufizohej me këtë jetë të dynjasë, kjo nuk përshtatet me urtësinë e Allahut, veçanërisht kur krahasojmë jetën e dynjasë me lodhjet dhe vështirësitë e

shumta. Në të shumtën e rasteve nuk mund arrihet kënaqësia pa lodhje, probleme dhe vështirësi. Ekspertët kanë arritur në konkluzionin se arritja e këtyre kënaqësive të pakta nuk barazohet aspak kundrejt vuajtjeve dhe mundimeve që përballon njeriu në rrugën e arritjes së tyre. Nga këtu lindi edhe rryma e absurditetit. Disa njerëz iu drejtuan vetëvrasjes megjithë praninë e dëshirës së natyrshme këmbëngulëse për qëndrim dhe jetesë.

Është e vërtetë se nëse jeta e njeriut do të ishte gjithmonë me lodhje, sakrificë dhe zgjidhje problemesh natyrore dhe shoqërore për të kaluar pas kësaj disa çaste kënaqësie e më pas shkon të flejë si rezultat i lodhjes dhe sakrificës të tij. Dhe pas periudhës së shlodhjes ngrihet përsëri për t'u përballur sërish me lodhjet e problemet duke sakrifikuar sa më shumë për të fituar kafshatën e gojës e pastaj kalon pak kohë kënaqësie duke e shijuar atë e pas kësaj s'ka asgjë tjetër. Këtë jetë rutine të pashpresë, të lodhshme, të mbushur me mërzi dhe kotësi nuk e pranon logjika dhe as që rekomandon të zgjidhet. Këtë lloj jete mund ta krahasosh më mirë me shoferin e një makine që e çon makinën e tij te pika e karburantit për ta furnizuar. Pasi e përdor atë karburant shkon në një pikë karburanti tjetër e kështu vazhdon përherë derisa të bjerë fuqia e makinës të tij ose të prishet a përplaset me ndonjë makinë tjetër dhe të shkatërrohet. Është mëse e natyrshme se prej dëshirave bazë te njeriu është dëshira për të jetuar gjatë dhe pavdekshmëria. Këtë dëshirë e ka vendosur Allahu në natyrën e njeriut. Kjo dëshirë konsiderohet fuqia shtytëse dhe nxitëse drejt përjetësisë. Ajo e nxit gjithmonë atë për të vazhduar lëvizjet e tij. Nëse supozojmë se fundi i kësaj lëvizjeje nuk është gjë tjetër vetëm se përplasje me shkënbin e së fundmi shkatërrim e shpërbërje, si mund të përshtatet ekzistenca e fuqisë së kësaj lëvizjeje me me ndërgjegjen dhe qëllimin?

Atëherë, ekzistenca e kësaj prirjeje natyrore përshtatet me urtësinë e Allahut sidomos kur gjendet një botë tjetër përveç kësaj bote që përfundon me vdekjen.

Konkluzioni:

Nëpërmjet bashkimit të këtyre dy premisave me njëratjetrën, pra urtësisë e Allahut dhe mundësinë e jetës së përjetshme për njeriun, arrijmë në këtë konkluzion: Është e domosdoshme ekzistenca e një jete tjetër për njeriun pas kësaj jete të shkurtër dhe të kufizuar me qëllim që jeta e tij mos bie ndesh me urtësinë e Allahut.

Këtë prirje të natyrshme për përjetësi mund ta konsiderojmë premisë tjetër dhe e bashkojmë me urtësinë hyjnore për të formuluar nëpërmjet saj një tjetër argument mbi këtë të vërtetë.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij argumenti, u qartësua se për jetën e përhershme njerëzore është e domosdoshme ekzistenca e një rregulli tjetër. Ajo jetë nuk është si jeta e kësaj dynjaje e mbushur me lodhje të shumta, përndryshe vazhdimësia e jetës së kësaj bote, me gjithë vështirësitë e saj, edhe po të jetë e përjetshme, nuk do të përshtatej me urtësinë hyjnore.

Argumenti i drejtësisë

Njerëzit në këtë botë janë të lirë dhe zgjedhës në kryerjen e veprave të mira apo të këqija. Mirëpo shohim disa njerëz që e kalojnë gjithë jetën e tyre në adhurimin e Allahut dhe shërbimin ndaj robëve të Tij. Githashtu vërejmë disa të këqinj, keqbërës dhe kriminelë, të cilët, për të arritur lakmitë dhe dëshirat e tyre djallëzore, veprojnë llojet më të poshtra të padrejtësisë dhe ngjyrat më të shëmtuara të mëkateve.

Qëllimi i krijimit të njeriut në këtë botë dhe përgatitja e tij me gjithë llojet e prirjeve kundërshtuese, me fuqinë e dëshirës dhe përzgjedhjes, me llojet e dijeve logjike dhe të transmetuara, me ofrimin e ambjentit dhe kushteve për vepra të ndryshme dhe vendosja e tij në mesin edy rrugëve, të drejtës dhe të gabuarës, të mirës dhe të keqes, e gjitha kjo me qëllim që të sprovohet dhe me dëshirën dhe zgjedhjen e tij të zgjedhë

rrugën e përsosjes. Derisa të marrë rezultatet e veprave përzgjedhëse, shpërblimin ose ndëshkimin. Në të vërtetë e tërë jeta e kësaj bote është bërë për njeriun vend sprove dhe përzgjedhjeje për të ngritur identitetin e tij njerëzor. Deri në fund të jetës së tij, njeriu punon dhe kryen detyrat e tij. Po ashtu deri në fund të jetës së tij është i përballur me sprova dhe provime.

Ne vërejmë se të mirët dhe të këqijtë në këtë botë nuk e marrin shpërblimin apo ndëshkimin e përshtatshëm të punëve të tyre. Përkundrazi, shohim se shumë prej kriminelëve dhe keqbërësve u krijohen mundësira dhe u ofrohen kushte dhe kënaqësi më shumë se të tjerëve. Dihet se jeta e dynjasë nuk e përmbush shpërblimin apo ndëshkimin e shumë veprave. Psh. një kriminel, i cili ka vrarë me mijëra njerëz të pafajshëm, për veprimin e tij ai nuk mund të ndëshkohet më shumë se një herë në këtë botë. Natyrisht që do të mbeten shumë prej krimeve të tij pa u ndëshkuar dhe kjo nuk pranohet nga drejtësia hyjnore e cila çdo punë të mirë apo të keqe sado e vogël të jetë do ta shpërblejë dhe do ta ndëshkojë.

Pra, ashtu sikurse konsiderohet kjo botë vendi i sprovave dhe detyrave, është e nevojshme ekzistenca e një bote tjetër që konsiderohet vendi i shpërblimit dhe ndëshkimit, ku çdo njeri do të marrë atë që i përshtatet me veprat e tij. Në këtë mënyrë praktikohet dhe ndihet drejtësia hyjnore[1]

Nëpërmjet kësaj na qartësohet gjithashtu se bota tjetër nuk është një botë ku na jepet mundësia e përzgjedhjes së rrugës dhe kryerjes së detyrave. Rreth kësaj teme do të hulumtojmë më tepër në leksionet e ardhshme.

1. Duke vërejtur atë që përmendëm në kapitullin e "Drejtësisë hyjnore" (leksioni i njëzet), se drejtësia në realitet është prej vërtetësive të urtësisë hyjnore, këtë argument mund ta konsiderojmë prej llojeve të argumentimit nëpërmjet rrugës së urtësisë hyjnore.

Pyetje:

1. Sqaro urtësinë e Allahut dhe marrëdhëniet e saj me rregullin (sistemin) më të mirë.

2. Trego argumentin e urtësisë në të dy mënyrat.

3. Cila është vërejtja që përfitojmë nga ky argument, përveç knstatimit të parimit të Ringjalljes?

4. Sqaro qëllimin e krijimit të njeriut në këtë botë.

5. Shpjego argumentin e drejtësisë.

6. Kush është vërejtja e veçantë që përfitohet nga ky argument?

Leksioni i dyzetepestë

RINGJALLJA NË KUR'ANIN FISNIK

Hyrje

Ajetet kur'anore të cilat flasin rreth vërtetimit të Ringjalljes dhe diskutimit me mohuesit e saj, mund të ndahen në pesë grupe:

1. Ajetet të cilat përforcojnë dhe tregojnë se nuk ekziston argument mbi mohimin e Ringjalljes. Këto ajete konsiderohen si ç'armatosëse për mohuesit.

2. Ajetet të cilat tregojnë dukuri të ngjashme me Ringjalljen dhe me ketë pengohet mohimi i saj. (pra, afrohet në mendje më shumë idea e ndodhisë së Ringjalljes.)

3. Ajetet të cilat sqarojnë dhe u përgjigjen dilemave të mohuesve për Ringjalljen dhe që diskutojnë dhe konstatojnë mundësinë e ndodhjes të saj.

4. Ajetet të cilat përforcojnë se Ringjallja që është një premtim i patjetësueshëm që nuk pranon kundërshtim. Në realitet këto ajete konstatojnë ndodhinë e Ringjalljes nëpërmjet lajmërimeve të lajmëtarit të vërtetë.

5. Ajetet të cilat flasin për argumente logjikë në domosdoshmërinë e Ringjalljes. Në realitet, tri grupet e para të ajeteve tregojnë mundësinë e ndodhjes së Ringjalljes, ndërsa dy grupet e fundit të ajeteve tregojnë domosdoshmërinë e ndodhjes të saj.

Mohimi i Ringjalljes pa argumenta

Një nga mënyrat e diskutimit që Kur'ani Fisnik përdor me ndjekësit e besimeve të kota është se ai u kërkon atyre të sjellin argumenta me qëllim që të zbulojë boshllëkun e besimit të tyre që nuk bazohet mbi baza logjike e arsyetuese, sikurse është thuhet në disa ajete kur'anore: **"Thuaj, sillni argumentat tuaja"** [1]

Në rastet e ngjashme me këtë mënyrë, Kur'ani Fisnik thotë se ata të cilët besojnë në doktrina të kota, nuk zotërojnë as dituri dhe as nuk bazohen në argumenta në përputhje me realitetin. Ata thjesht janë mjaftuar në hamendësime, të cilat nuk janë nuk janë argumente dhe se janë në kundërshtim me realitetin.[2]

Kur'ani Fisnik thotë rreth mohuesve të Ringjalljes: **"Ata edhe thanë: " Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë jona në këtë botë po vdësim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër pos kohës. Ata për këtë nuk dinë asgjë, ata vetëm fantazojnë"**[3]

Në ajete të tjera përforcohet fakti se mohimi i Ringjalljes nuk është tjetër veçse supozim i pabazë dhe pa argument.[4] Është e mundur që këto supozime të kota t'i pranojë robi i dëshirave, epsheve dhe kënaqësive në situatën kur këto supozime janë në përputhje me dëshirat e egos.[5] Si rezultat i veprave të papërshtatshme me egon, nga kryerja e gjynaheve dhe mëkateve këto supozime të kota kur përputhen me unin, këto supozime shkallë-shkallë shndërrohen në besime të

1. Sure "El Bekare", ajeti 111, sure "El Enbija", ajeti 24, sure "El Neml", ajeti 64.
2. Sure "El Muminun", ajeti 117, sure "El Nisa", ajeti 157, sure "El Enam", ajetet 100, 119, 148, sure "El Kehf", ajeti 5, sure "El Haxh", ajetet 3, 8 , 71, sure "El Ankebut", ajeti 8, sure "El Rrum", ajeti 29, sure "Lukman", ajeti 20, sure "Gafir", ajeti 42, sure "El Zuhruf", ajeti 20, sure "El Nexhm", ajeti 28.
3. Sure "El Xhathije", ajeti 24.
4. Sure "El Kasas", ajeti 39, sure "El Kehf", ajeti 36, sure "Sad", ajeti 26, sure "El Xhathije", ajeti 32, sure "El Inshikak", ajeti 14.
5. Sure "El Kijame", ajeti 5.

prera.[6] Ka shumë njerëz që kapen me gjithë fuqinë e tyre pas këtyre besime të brendshme.[7]

Kur'ani Fisnik përcjell thëniet e mohuesve të Ringjalljes, të cilat më së shumti e mohojnë Ringjalljen. Herë herë Kur'ani tregon idetë e gabuara për këtë çështje, të cilat janë shkak i mosbesimit dhe i dyshimit rreth Ringjalljes.[8] Nga këtu, Kur'ani Fisnik nga njëra anë paraqet disa dukuri të ngjashme me Ringjalljen, për të larguar nga mendja dyshimet,[9] ndërsa, nga ana tjetër, tregon përgjigjet e ideve të gabuara derisa mos mbetet asnjë shenjë e ideve të gabuara. Në këtë mënyrë vërtetohet plotësisht mundësia e ndodhjes të Ringjalljes.

Mirëpo, Kur'ani nuk mjaftohet vetëm me këtë masë, por tregon gjithashtu argumenta logjikë mbi domosdoshmërinë e ndodhjes të Ringjalljes, në shtesë të patjetërsisë së premtimit të Allahut dhe të plotësimin të argumentit për njerëzit nëpërmjet Shpalljes, sikurse do ta paraqesim në leksionet e ardhshme.

Dukuri të ngjashme me Ringjalljen

a) Dalja e bimëve nga toka:

Vërtet, ringjallja e njeriut pas vdekjes, nga ana e përparësisë së kësaj jete ndaj vdekjes, është e ngjashme me daljen e bimëve nga toka pas tharjes plotësisht të tyre. Prej këtu, meditimi dhe mendimi rreth kësaj dukurie, e cila ndodh gjithmonë para syve të njerzve, është e mjaftueshme për të arritur në mundësinë e jetës pas vdekjes. Në realitet, shkaku i konsiderimit të kësaj dukurie një çështje të zakonshme dhe se nënvleftësimi i rëndësisë së saj bëhet nga vetë njerëzit, porse

6. Sure "El Rrum", ajeti 10, sure "El Mutafifijnë", ajetet 10-14.
7. Sure "El Nahl", ajeti 38.
8. Sure "Hud", ajeti 7, sure "El Isra", ajeti 51, sure "El Safat", ajeti 16 dhe 53, sure "El Duhan", ajetet 24-36, sure "El Ahkaf", ajeti 18, sure "Kaf", ajeti 3, sure "El Uakia", ajetet 47-48, sure "El Mutafifijn", ajetet 12-13, sure "El Naziat", ajetet 10-11.
9. Rregulli i shembëllsimit në ato që lejohet dhe që nuk lejohet është i njëjtë.

kjo dukuri nuk dallon shumë nga ringjallja e njerëzve pas vdekjes së tyre dhe nga vazhdimit i jetës së re.

Duke dashur të hapë perden e këtij nënvleftësimi dhe mosinteresimi, këtë dukuri, Kur'ani Fisnik u tërheq disa herë vëmendjen e njerëzve dhe ua përsërit atyre me mënyra të ndryshme duke e ngjasuar ringjalljen me daljen e bimëve nga toka.[10]

Ndër këto ajete përmendim: **"Shiko pra, gjurmët e mëshirës së Allahut, se si e ngjall tokën pas vdekjes së saj, e s'ka dyshim se Ai është që do ti ngjallë të vdekurit pse Ai për Çdo send është i Plotëfuqishëm."**[11] (34).

b) Zgjimi i banorëve të shpellës:

Kur'ani Fisnik pasi paraqet realitetin e këtij tregimi mbresëlënës dhe mahnitës, i cili përmbledh shumë të dhëna frutëdhënëse, thotë: **"Dhe ashtu** (sikurse i zgjuam nga gjumi) **i zbuluam** (t'i shohin njerzit), **e të kuptojnë se premtimi i Allahut** (për ringjallje) **është i sigurt dhe se katastrofa e përgjithshme (kiameti) është e padyshimtë"**[12]

Nuk ka dyshim në të dhënat e kësaj ngjarjeje të çuditshme, ku një grup personash ranë në një gjumë të thellë dhe të gjatë që zgjati disa shekuj (treqind vite sipas kalendarit grgorian ose treqind e nëntë vite sipas kaledarit hënor). Pas gjithë kësaj periudhe të gjatë u zgjuan nga gjumi i tyre. Njohja e kësaj ngjarjeje ka ndikim të madh dhe ndikues në orientimin e njeriut në mundësinë e ringjalljes. Kjo për faktin se edhe pse gjumi i ngjan vdekjes (gjumi është vëllai i vdekjes) dhe zgjimi i ngjan Ringjalljes pas vdekjes, por në gjumin e zakonshëm që ne njohim, vazhdon veprimtaria e kësaj bote (veprimtaria biologjike) e trupit në mënyrë normale. Për këtë,

10. Sure "El Araf", ajeti 57, sure "El Haxh", ajetet 5-6, sure "El Rrum", ajeti 19, sure "Fatir", ajeti 9, sure "Fusilet", ajeti 19, sure "El Zuhruf", ajeti 11, sure "Kaf", ajeti 11.
11. Sure "El Rrum", ajeti 50.
12. Sure "El Kehf", ajeti 21.

kthimi i shpirtit pas gjumit nuk është diçka e çuditshme dhe e habitshme. Porse trupi, i cili jeton treqind vjet pa lëndë ushqyese, sipas sitemit të natyrshëm, patjetër që vdes, prishet dhe humbet aftësinë e rikthimit të shpirtit në të.

Prandaj, kjo ngjarje e jashtëzakonshme duhet që t'i tërheqë vëmendjen njeriut, se ekziston një rregull tjetër jashtë normales, që njeriu të kuptojë se kthimi i shpirtit në trup nuk është i lidhur gjithmonë me ofrimin e mundësive dhe kushteve të zakonshme dhe natyrore. Pra, e tillë është jeta e re e njeriut pas vdekjes, edhe pse është në kundërshtim me rregullin e jetës dhe vdekjes në këtë botë, por ajo do të ndodhë dhe do të realizohet bazuar në premtimin e Allahut.

c) Ringjallja e kafshëve:

Kur'ani Fisnik tregon për ringjalljen e disa kafshëve në formën e tyre jo të zakonshme. Ndër to përmendim ringjalljen e katër zogjve në duart e Ibrahimit *(paqja qoftë mbi të!)*[13], ringjalljen e kafshës të cilën e përdornin disa profetë për të hipur, tregimin e së cilës do ta përmendim më pas. Përderisa është e mundur ringjallja e kafshëve, atëherë ringjallja e njeriut nuk është e pamundur.

d) Ringjallja e disa njerzve në këtë botë:

Më e rëndësishme nga e gjitha këto është ringjallja e disa njerzve në këtë botë. Kur'ani Fisnik përcjell disa shembuj mbi këtë.

Prej tyre tregimi i një profeti nga Beni Israilët: "**Ose** (nuk je i njohur) **me shëmbullin e atij që kaloi pranë një fshati që ishte rrënuar në kulmet e tij, e ai tha: "Si e ngjall All-llahu këtë pas shkatërrimit të tij?" E All-llahu e bëri të vdekuar atë** (pyetësin – Uzejrin) **100 vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: " Sa qëndrove** (i vdekur)**?" Ai tha : " Një ditë, ose një pjesë**

13. Sure "El Bekare", ajeti 260.

të ditës!" Ai (Allahu) tha: "Jo, por ke ndenjur i vdekur 100 vjet, shikoje ushqimin dhe pijen tënde si nuk është prishur, e shikoje edhe gomarin tënd (si iu kanë shkapërdredhur eshtrat). **E për të bërë ty argument për njerzit** (bëmë këtë ssprovë), **shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish. E kur ju bë e qartë atij tha: "U binda se me të vërtetë Allahu ka mundësi për çdo send!"**[14]

Në një tjetër ajet Kur'ani Fisnik paraqet historinë e Musait (paqja qoftë mbi të!), me një grup prej beni israilëve: **"Dhe kur i thatë: "O Musa ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim All-llahun haptazi, e atëherë juve ju rrëmbeu rrufeja** (zjarri) **dhe ju e shihnit.* Pastaj, që të jeni mirënjohës pas vdekjes suaj juve ju ngjallëm."**[15] (38).

Gjithashtu, ringjallja e një personi prej beni israilitëve në kohën e Musait (paqja qoftë mbi të!). Kjo ndodhi kur e goditën me një pjesë nga mishi i i një lope të therur. Ky tregim përmendet në suren "Bekare". Për këtë kjo sure është emërtuar me këtë emër për shkak të këtij tregimi në ajetet e saj. Në fund të tregimt thuhet: **"Ja, kështu All-llahu ngjall të vdekurit dhe ua sqaron argumentetet e veta, ashtu që të kuptoni."**[16]

Gjithashtu, ringjallja e disa të vdekurve nga mrekullitë e Isait (paqja qoftë mbi të)[17]. Këta shembuj mund të konsiderohen si dëshmi për mundësinë e Ringjalljes.

14. Sure "El Bekare", ajeti 259.
15. Sure "El Bekare", ajetet 55-56.
16. Sure "El Bekare", ajeti 63.
17. Sure "Al Imran", ajeti 49, sure "El Maide", ajeti 110.

Pyetje:

1. Sqaro mënyrën e përballjes të Kur'anit Fisnik me mohuesit e Ringjalljes.

2. Ku është ngjashmëria ndërmjet daljes së bimëve nga toka dhe ringjalljes së njerëzve në Ditën e Kiametit? Përmend pikëpamjen e Kur'anit Fisnik për këtë çështje.

3. Çfarë përfitohet nga tregimi i Banorëve të Shpellës rreth asaj që i përket temës së Ringjalljes?

4. Shpjego tregimin e ringjalljes së disa zogjve në duart e Ibrahimit (paqja qoftë mbi të!) dhe sqaro marrëdhënien e këtij tregimi me temën e Ringjalljes.

5. Përmend ata profetë të që ka përmendur Kur'ani Fisnik ringjalljen e tyre.

Leksioni i dyzetegjashtë

PËRGJIGJET E KUR'ANIT PËR DYSHIMET E MOHUESVE TË RINGJALLJES

Nga diskutimet e Kur'anit Fisnik me mohuesit e Ringjalljes dhe nga përgjigjet e tij mbi pretendimet e tyre, duket se ata kanë patur ide të gabuara në mendjet e tyre. Ne do t'i paraqesim të renditura me përgjigjet që i përshtaten.

1. Ideja e gabuar rreth rikthimit të të paqenës

Më parë kemi përmendur se Kur'ani Fisnik u është përgjigjur atyre të cilët thonin: Si ringjallet njeriu përsëri pasi shpërbëhet dhe prishet trupi i tij duke u thënë: Ekzistenca (identiteti) juaj bazohet mbi shpirtin tuaj dhe jo mbi organet e trupit tuaj, i cili shpërbëhet në tokë[1]

Nga kjo thënie mund të kuptojmë se motivi që i shtyn mohuesit e ringjalljes është idea e gabuar e cila në filozofi konsiderohet si "pamundësia e rikthimit të të paqenës." Që do të thotë se ata besojnë që njeriu është trupi material i cili shpërbëhet dhe prishet kur vdes. Nëqoftëse do të ringjallet pas vdekjes, atëherë është njeri tjetër sepse rikthimi i të paqenës është e pamundur dhe nuk ka aftësi në vetevete.

Përgjigjen e kësaj ideje të gabuar e qartëson Kur'ani Fisnik që thotë se ekzistenca e personalitetit të çdo njeriu dhe e vërteta e tij përfaqëshet me shpirtin e tij. Thënë ndryshe: *Ringjallja nuk është rikthim i të paqenës por është rikthimi i shpirtit ekzistues.*

1. Sure "El Sexhde", ajetet 109-110.

2. Ideja e gabuar mbi mospranimin e trupit të një jete të re

Ideja e gabuar e mëparshme kishte lidhje me mundësinë e vetëvetishme të ringjalljes, ndërsa kjo ide shikon mundësinë e ndodhjes. Kjo do të thotë se kthimi i shpirtit në trup edhe nuk është e pamundur logjikisht dhe kundërshtim në supozimin e saj, por ndodhia e rikthimit i shpirtit në trup realisht është e kushtëzuar me aftësinë e pranimit të trupit. Ne mendojmë se ardhja e jetës me kushte dhe shkaqe të veçanta, duhet të realizohen gradualisht. Psh. është e nevojshme që spermatozeidi të vendoset në mitër. Duhet të krijohen kushtet e përshtatshme për rritjen dhe plotësimin e tij derisa të bëhet foshnje e plotë në mënyrë graduale dhe të marrë formën e njeriut. Por trupi, i cili shpërbëhet, e humbet aftësinë për jetën.

Përgjigja rreth kësaj ideje të gabuar është: Rregulli i dëshmuar në këtë botë nuk është i vetmi rregull i mundshëm. Kushtet dhe shkaqet të cilat ne njohim nëpërmjet eksperimenteve nuk janë të vetmet kushte dhe shkaqe që ekzistojnë. Dëshmi për këtë janë ndodhitë e disas dukurive të jashtëzakonshme në këtë jetë, si psh ringjallja e disa kafshëve apo njerëzve.

Një përgjigje më të mirë mund të merret nga përmendja e disa dukurive të jashtëzakonshme që përmenden në Kur'anin Fisnik.

3. Ideja e gabuar në fushën e fuqisë së vepruesit

Një tjetër ide e gabuar është: Që të ndodhë çfarëdo dukurie dhe realizimi i saj është kusht fuqia e vepruesit. Përveç kësaj është kusht edhe mundësia e vetevetishme dhe aftësia pranuese. Nga ta dimë se Allahu i Madhëruar nuk zotëron fuqi për të ringjallë të vdekurit?!

Kjo ide është i dobët. Atë e paraqesin ata të cilët janë nuk e njohin në fuqinë absolute të Allahut. Përgjigja për të është: Fuqia e Allahut nuk njeh kufij. Ajo lidhet me çdo gjë

siç e verëjmë që i Lartësuari ka krijuar gjithësinë e gjerë e madhështore me gjithshka mahnitëse dhe të çuditshme. Kur'ani thotë: **"A nuk e dinë ata se All-llahu që krijoi qiejt e tokën dhe nuk u lodh në krijimin e tyre, Ai ka fuqi t'i ngjallë të vdekurit. Po, Ai është i Plotëfuqishëm për çdo send"**[2]

Duhet të shtojmë se rikrijimi nuk është më i vështirë se krijimi i parë dhe nuk ka nevojë për më tepër fuqi. Por mund të thuhet se është më i lehtë dhe më i thjeshtë sepse në rikrijim nuk bëhet gjë tjetër veçse rikthim i shpirtit ekzistues. Në Kur'an thuhet: **"Ata do të thonë: "Kush do të na rikthejë neve në jetë?" Thuaj: " Ai që ju krijoi për të parën herë!" e ata do të tundin kokat e tyre nga ti."**[3]

Dhe: **"Dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) është edhe më e lehtë për të."**[4]

4. Ideja e gabuar rreth dijes së vepruesit

Ide tjetër e gabuar thotë: Nëse Allahu i Madhëruar dëshiron ringjalljen e njerëzve për veprat e tyre, shpërblyese apo ndëshkuese, nga njëra anë duhet të bëjë dallimin ndërmjet trupave të cilat nuk numërohen dhe llogariten, me qëllim që t'ia rikthejë shpirtin çdo trupi shpirtin përkatës. Nga ana tjetër duhet të kujtojë të gjitha veprat e tyre të mira dhe të këqija për të shpërblyer çdonjërën prej tyre me atë që e meriton qoftë ajo e mirë apo e keqe. Pyetja është: Si mund të dallohen dhe të njihen trupat të cilët janë kthyer në pluhur dhe janë përzier pjesët e tyre? Si mundet që Ai të sistemojë e të dallojë veprat e të gjithë njerëzve përgjatë mijëra e miliona vjetëve dhe t'i llogarisë ato?

Këtë ide e paraqesin ata të cilët janë nuk e njohin në

2. Sure "El Ahkaf", ajeti 33. Shih gjithashtu edhe suren "Jasin", ajeti 81, suren "El Isra", ajeti 99, suren "El Safat", ajeti 11, suren "El Naziat", ajeti 27.
3. Sure "El Isra", ajeti 51, gjithashtu shih suren "El Ankebut", ajetet 19-20, sure "Kaf", ajeti 15, sure "El Uakia", ajeti 62, sure "Jasin", ajeti 80, sure "El Haxh", ajeti 5, sure "El Tarik", ajeti 8.
4. Sure "El Rrum", ajeti 27

diturinë absolute të Allahut. Ata e masin diturinë e Allahut me diturinë e tyre të mangët e të kufizuar.

Përgjigja mbi këtë ide të gabuar është se dituria e Allahut nuk njeh kufij. Allahu i Madhëruar është i Gjithëditur për gjithçka dhe nuk harron asgjë.

Kur'ani Fisnik na përcjell pyetjen e Faraonit që i bëri profetit Musa (paqja qoftë mbi të!): **"Çfarë do të ndodhë me ata të cilët kanë jetuar në shekujt e mëparshëm?"** Musai (paqja qoftë mbi të!) iu përgjigj: **"Dija për ata është te Zoti im, e shënuar në një libër. Zoti im nuk gabon e as nuk harron"**[5]

Në një ajet tjetër Kur'ani u përgjigjet dy ideve të fundit të gabuara (të tretës dhe të katërtës) ku thotë: **"Thuaj: "I ngjall Ai që i krioji për herë të parë, e Ai është shumë i dijshëm për Çdo krijim."**[6]

Pyetje:

1. Sqaro idenë e gabuar të pamundësisë së kthimit të të paqenësës dhe përgjigjen e saj.

2. Shpjego këtë ide të gabuar: Pamundësia e trupit për të pranuar një jetë të re dhe përgjigjen e saj.

3. Trego idenë e gabuar në fushën e fuqisë së vepruesit dhe përgjigjen e saj.

4. Sqaro idenë e gabuar në fushën e diturisë së vepruesit dhe përgjigjen e saj.

5. Sure "Ta Ha", ajetet 51-52, sure "Kaf", ajetet 2-4.
6. Sure "Jasin", ajeti 79.

Leksioni i dyzeteshtatë

PREMTIMI I ALLAHUT RRETH KIAMETIT

Hyrje

Kur'ani Fisnik, që është mesazhi i zbritur nga Allahu i Madhëruar për robtë e Tij, e përforcon ndodhinë e Ringjalljes dhe realizimin e saj. Nga njëra anë, Kur'ani e konsideron këtë premtim të paevitueshëm të Allahut. Në këtë mënyrë plotësohet argumenti mbi njerëzit. Nga ana tjetër, Kur'ani tregon argumentat logjik mbi domosdoshmërinë e Ringjalljes me qëllim që njeriut t'i plotësohet dëshira për njohjen logjike dhe i shtohet më tepër argumenti.

Nga këtu, pikëpamjet (qëndrimet) kur'anore mbi Ringjalljen i ndajmë në dy grupe. Për çdonjërin prej grupeve do të paraqesim shembuj nga ajetet kur'anore që lidhen me to.

Premtimi hyjnor i paevitueshëm

Kur'ani Fisnik e konsideron kiametin dhe ringjalljen e të gjithë njerzve në botën tjetër një çështje që nuk pranon dyshim dhe mëdyshje. Ai thotë: **"Kiameti gjithsesi do të vijë, aty nuk ka dyshim."**[1] E konsideron premtim të drejtë që nuk pranon kundërshtim. **"Po ai është premtim i Tij i prerë."**[2]

1. Sure "Gafir", ajeti 59, kthehu tek ajetet e mëposhtëme të sureve "Al Imran", ajetet 9-25, "El Nisa", ajeti 87, "El Enam", ajeti 12, "El Kehf", ajeti 21, "El Haxh", ajeti 7, "El Shura", ajeti 7, "El Xhathije", ajetet 32 dhe 36.
2. Sure "El Nahl", ajeti 38, sure "Al Imran", ajeti 9 dhe 191, sure "El Nisa", ajeti 122, sure "Junus", ajeti 4 dhe 55, sure "El Kehf", ajeti 21, sure "El Enbija", ajeti 103, sure "El Furkan", ajeti 16, sure "Lukman", ajeti 9 dhe 33, sure "Fatir", ajeti 5, sure "El Zumer", ajeti 20, sure "El Nexhm", ajeti 47, sure "El Xhathije", ajeti 32, sure "El Ahkaf", ajeti 17.

Allahu betohet në shumë ajete në realizimin e Ringjaljes: **"Thuaj: "Po, pasha Zotin tim, patjetër do të ringjalleni dhe do të njiheni me atë që keni punuar, e ajo për Allahun është e lehtë!"**[3]

Paralajmërimin dhe tërheqjen e vërejtjes njerëzve me anë të Ringjalljes, Kur'ani e konsideron prej detyrave më të rëndësishme të profetëve: **"Ai** (Allahu) **është i pozitës më të lartë, i zoti i Arshit; Ai me urdhrin e vet ja sjell shpirtin** (shpalljen) **atij që do nga robërit e vet, për t'ua tërhequr vërejtjen ndaj ditës të takimit** (kiametit)**."**[4] Mohuesve të Ringjalljes u ka pregatitur dënim të ashpër në Xhehenem: **"Ne për ata që nuk besojnë ditën e gjykimit kemi përgatitur zjarr të fortë."**[5]

Bazuar në këtë, ai që e kupton se ky Libër qiellorë është i vërtetë, atij nuk i mbetet asnjë fakt që të mohojë ringjalljen, apo të dyshojë në të. Në pjesën e mëparshme na u bë e qartë se çdo njeri është në kërkim të vërtetës. Ai mund ta dallojë se Kur'ani është i vërtetë. Për këtë, askush nuk mund të justifikohet në mosnjohjen e saj, përveçse mëndjelehtët ose ata të cilët kanë shkaqe të tjera që i pengojnë të arrijnë në njohjen e dhe vërtetësinë e Kur'anit.

Përcjellja e argumentave logjikë

Shumë nga ajetet kur'anore posedojnë një mënyrë argumentimi logjik mbi domosdoshmërinë e Ringjalljes. Mund të themi se ato shohin argumentat të urtësisë dhe të drejtësisë. Prej atyre ajeteve janë ato që i përmend Kur'ani në mënyrë pyetëse dhe mohuese: **"A menduat se Ne u krijuam**

3. Sure "El Tegabun", ajeti 7, sure "Junus", ajeti 53, sure "Sebe", ajeti 3.
4. Sure "Gafir", ajeti 15, sure "El Enam", ajeti 130 dhe 154, sure "El Rad", ajeti 2, sure "El Shura", ajeti 7, sure "El Zuhruf", ajeti 61, sure "El Zumer", ajeti 71.
5. Sure "El Furkan", ajeti 11, sure "El Isra", ajeti 10, sure "Sebe", ajeti 8, sure "El Muminunë", ajeti 74.

kot dhe se nuk do të ktheheni ju te Ne?"[6]

Ky ajet kur'anor tregon qartësisht se nëse nuk do të ekzistonte Ringjallja dhe kthimi tek Allahu, atëherë krijimi i njeriut në këtë botë do të ishte utopi. Por utopia nuk ka vend te Allahu i urtë. Prandaj, bota tjetër ekziston me qëllim kthimi tek Allahu i Madhëruar.

Ky argument në të vërtetë është *(kijasun istithnaij)* dhe premisë e parë *(el mukadimetul uulaa),* që është çështje kushtëzore, që tregon se krijimi i njeriut në këtë botë e ka një qëllim të urtë. Ai do të kthehet tek Allahu pas jetës në këtë botë dhe do të marrë rezultatet e veprave të tij në botën tjetër. Këtë e kemi shpjeguar më gjerësisht kur paraqitëm argumentin e urtësisë dhe nuk e shohim të domosdoshme që t'i rikthehemi edhe një herë.

Kurse premisa e dytë *(el mukadimetul eth thanij)* se utopia nuk ka vend te Allahu, në vetvete është çështje e urtësi hyjnore dhe moskotësia e Allahut në vepra dhe veprime, të cilën e konstatuam në pjesën e monoteizmit *(teuhidit)* si dhe kur sqaruam argumentin mbi urtësinë. Nga këtu, ajeti fisnik i përmendur është plotësisht në përputhje me këtë argument.

Duke parë këtë të vërtetë, këtu shtojmë: krijimi i njeriut është në pozitën e qëllimit dhe synimit të krijimit të botës. Nëse krijimi i njeriut në këtë botë do të ishte i kotë (utopi) dhe pa ndonjë qëllim të urtë, atëherë edhe krijimi i botës do të ishte i kotë dhe pa ndonjë qëllim. Këtë të vërtetë mund ta përfitojmë nga ajetet të cilat përforcojnë se ekzistenca e botës tjetër që tregon krijimin e kësaj bote me urtësi.[7] Ekzistenca e botës tjetër, tregon për urtësinë e krijimit të botës. Nga ajetet të cilat flasin për këtë janë ato që përshkruajnë të zotët e mendjeve: **"Dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të tokës** (duke thënë)**: Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dëmit të zjarrit!"**[8]

6. Sure "El Muminun", ajeti 115.
7. Sure "El Enbija", ajetet 16-18, sure "El Rrum", ajeti 8, sure "Sad", ajeti 27, sure "El Duhan", ajetet 35-40.
8. Sure "Al Imran", ajeti 191.

Nga ky ajet përfitojmë se meditimi dhe mendimi mbi mënyrën e krijimit të botës i drejton njerëzit drejt urtësisë hyjnore.

Kjo do të thotë se Allahu i Madhëruar e i Urtë ka patur një qëllim të urtë në këtë krijim madhështor dhe nuk e ka krijuar kot e pa qëllim. Nëse nuk do të ekzistonte një botë tjetër, e cila konsiderohet qëllimi përfundimtar në krijimin e botës, atëherë krijimi do të ishte i kotë dhe pa qëllimtë.

Kurse grupi tjetër i ajeteve kur'anore të cilat tregojnë argumentin logjik mbi domosdoshmërinë e Ringjalljes, pranojnë vërtetësinë dhe përputhshmërinë me argumentin e drejtësisë.[9] Kjo do të thotë se nëpërmjet drejtësisë hyjnore të mirët dhe të këqijtë do të marrin atë që u takon prej punëve që kanë bërë dhe dallon fundin e secilit prej tyre. përderisa ky lloj seleksionimi nuk ekziston në këtë botë, atëherë duhet patjetër ekzistenca e botës tjetër me qëllim që me anë të tij të trupëzohet drejtësia e Tij nga jashtë. Në suren "Xhathije" thuhet: **"A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t'i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre? * All-llahu krijoi edhe qiejt edhe tokën me një drejtësi precize, e për t'u shpërblyer secili njeri me veprat e veta, atyre nuk u bëhet e padrejtë"**[10]

Ajo që duhet përforcuar është se ajeti **"Allahu ka krijuar qiejt dhe tokën me drejtësi"** tregon për argumentin e urtësisë. Po ashtu, argumentin e drejtësisë në realitet mund t'i kthehet argumentit të urtësisë. Kjo për faktin se te tema "Drejtësia e Allahut" e sqaruam se drejtësia është prej të vërtetave urtësisë.

9. Sure "Sad", ajeti 28, sure " Gafir", ajeti 58, sure "El Kalem", ajeti 35, sure "Junus", ajeti 4.
10. Sure "El Xhathije", ajetet 21-22.

Pyetje:

1. Si e vërteton Kur'ani fisnik ringjalljen për të qënë argument për njerëzit?
2. Kush janë ajetet të cilat tregojnë për argumentin e urtësisë? Sqaro mënyrën e argumentimit me anë të tyre.
3. Cilat janë ajetet të cilat tregojnë argumentin e drejtësisë? Sqaro mënyrën e argumentimit me anë të tyre.
4. Si mundet të kthehet argumenti i drejtësisë në argument të urtësisë?

Leksioni i dyzetetetë

KARAKTERISTIKAT E BOTËS TJETËR

Hyrje

Njeriu e ka të pamundur të zotërojë njohje dhe dituri të plota për ato gjëra të cilat nuk i ka provuar, apo nuk i ka kuptuar me anë të njohuri të brendshme dhe dijes hudhurij, apo nuk i kupton nëpërmjet shqisave. Pasi kemi mësuar këtë, nuk mund të supozojmë njohjen e vërtetë të Botës Tjetër dhe ndodhitë e saj në mënyrë precize dhe të plotë. Gjithashtu, nuk mund të arrijmë të njohim realitetin e saj, por duhet të mjaftohemi me përshkrimin që e arrijmë logjikës dhe Shpalljes si dhe t'i përmbajmë vetet tona brenda këtyre kufijve.

Ajo që të bën për të ardhur vërtet keq është se disa persona e kanë përfytyruar Botën Tjetër të njëjtë me këtë botë. Ata shkuan deri aty sa të besojnë se Xheneti i lartë ekziston në këtë botë në ndonjë prej planeteve qiellorë dhe se në një ditë prej ditësh, si rezultat i zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë dhe duke u mbështetur në shpikjet e saj, do të jetë e mundur që njeriu të shkojë në këtë Xhenet dhe të jetojë në të i qetë dhe i lumtur!

Por ka nga ata njerëz të cilët e mohojnë ekzistencën reale të Botës Tjetër dhe e thonë se Xheneti janë vlerat morale të cilat i gëzojnë punëmirët, bamirësit dhe ata që i shërbejnë shoqërisë dhe kombit të tyre. ata thonë se dallimi ndërmjet dynjasë dhe Ahiretit është si dallimi ndërmjet dobisë dhe vlerës.

Është e drejta jonë të pyesim e parë: Nëqoftëse Xheneti ndodhet në ndonjë planet tjetër tek i cili do të arrijnë brezat e ardhshëm, atëherë çfarë kuptimi ka ringjallja e të gjithë njerëzve në Ditën e Kiametit dhe në Ditën e Tubimit të

cilën e dëshmojnë edhe ajetet kur'anore? Si do të plotësohet shpërblimi dhe ndëshkimi i njerëzve për veprat e tyre?!

Gjithashtu, pyesim edhe grupin e dytë: Nëse Xheneti nuk është gjë tjetër vetëm se këto vlera morale, natyrisht që Xhehenemi është e kundërta e këtyre vlerave, atëherë përse Kur'ani Fisnik këmbëngul shumë në konstatimin e ringjalljes dhe në ringjalljen e njerëzve pas vdekjes? Pastaj, a nuk do të ishte më mirë që këtë të vërtetë ta thonin Profetët dhe kështu ata nuk do të përballeshin me akuzat se janë të çmendur dhe tregojnë gojëdhëna etj?

Pasi të kemi kaluar këtë absurditet e marrëzi dhe këto teori boshe, atëherë do të përballemi me kundërshtimet dhe debatet ndërmjet apologëve dhe filozofëve rreth ringjalljes fizike trupore apo shpirtërore dhe me studimet e tyre rreth disa çështjeve si psh: A do të shkatërrohet plotësisht bota materiale apo jo? A do të jetë trupi në Tetën Tjetër i ngjashëm me trupin në këtë botë apo jo? E të tjera çështje.

Sigurisht, këto janë studime dhe përpjekje logjike e filozofike në udhën e zbulimit të të vërtetave dhe për t'u afruar sa më me realitetet dhe meritojnë vlerësim. Në dritën e këtyre studimeve na qartësohen pikat e dobëta e të forta në mendime dhe idet, porse nëpërmjet tyre nuk mund të pretendojmë arritjen në realitetin e Botës Tjetër.

Vërtet, a jemi njohur deri tani me të vërtetat e asaj Bote në formë të plotë? A kanë arritur dijetarët e dijeve ekzakte si psh dijetarët e fizikës, kimisë, biologjisë etj që të njihen me të vërtetat e materies, energjisë dhe llojeve të ndryshme të fuqive? A munden ata të tregojnë të ardhmen e botës në mënyrë të saktë dhe të prerë? A mund ta dinë ata se çfarë do të ndodhë nëse do të humbiste forca e gravitetit në gjithësi ose të ndalojnë elektronet? A do të ndodhin kjo apo jo? A kanë mundur filozofët të sqarojnë bindshëm të gjitha çështjet logjike që lidhen me këtë botë? Janë edhe disa çështje të tjera si psh. të vërtetat e trupave, marrëdhëniet e shpirtit me trupin etj, a nuk kanë nevojë këto çështje për më shumë studim dhe hulumtim?

Atëherë, si mund të shpresojmë që duke u bazuar dhe mbështetur në idetë dhe të dhënat tona të kufizuara e të mangëta të arrijmë në të vërtetat e botës që nuk e kemi provuar asnjëherë?

Është mëse e qartë se mangësia e diturisë njerëzore nuk do të thotë pamundësi e diturisë dhe njohurisë mbi çdo gjë dhe për çdo gjë. Apo kjo mangësi të na pengojë nga përpjekjet për t'u njohur sa më mirë me ekzistencën. Nuk ka dyshim se ne mund të njohim shumë nga të vërtetat me ndihmën e fuqisë mendore të cilën na e ka dhuruar Allahu i Lartësuar. Gjithashtu, mund të zbulojmë shumë nga sekretet e natyrës me ndihmën e shqisave, vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Është e nevojshme që të përpiqemi sa më shumë në rrugën e dijes, shkencës dhe filozofisë për të zhvilluar dijet dhe idetë tona.

Duhet që ne të njohim kufijtë e mendjes dhe të diturive eksperimentuese dhe të pranojmë këtë të vërtetë: **"E juve ju është dhënë fort pak dije"**[1]

Po, vizioni tematiko-shkencor, thjeshtësia e të Urtit, gadishmëria dhe përgjegjësia fetare, të gjitha këto na obligojnë që të jemi të përmbajtur në propozimet e ideve bindëse mbi të vërtetat e kiametit, botës së të fshehtës, (gajbit), kapja pas interpretimeve të cilat nuk bazohen në argumenta, përvecse në kufijtë e argumentave që na e lejon logjika dhe ajetet kur'anore. Si do që të jetë, është mjaftueshme për çdo njeri besimtar që të besojë atë ka zbritur Allahu i Lartësuar. Edhe nëse nuk ka mundësi të përcaktojë veçoritë me saktësi, sqarimin e hollësive dhe veçanërisht atyre të cilave varen nga mendja dhe eksperimentet për të arritur të vërtetat që nuk i arrin diturija jonë.

Është e nevojshme të njohim sasinë që mund të arrihet nga cilësitë e Botës Tjetër dhe veçoritë e saj nëpërmjet rrugës së dijes dhe dallimin e saj nga kjo botë.

1. Sure "El Isra", ajeti 58.

Veçoritë e Botës Tjetër bazuar tek logjika

Duke mediturar rreth argumentave që u përmendën në vërtetimin e domosdoshmërisë së Ringjalljes mund të arrihet tek disa veçori të Botës Tjetër. Këtu do të paraqesim më të rëndësishmet e tyre:

1. Veçoria e parë e Botës Tjetër, tek e cila arrijmë nëpërmjet argumentit të parë të veçantë është: ajo botë duhet të jetë e përjetshme dhe e përhershme. Kjo sepse në këtë argument përforcohet më tepër mundësia e botës të përjetshme dhe prirja natyrore e njeriut për një botë të tillë dhe realizimi i urtësisë hyjnore.

2. Veçoria e dytë, tek e cila arrijmë me të dy argumentat që përmenden në fund të argumentit të parë, është: sistemi i botës tjetër domosdoshmërisht duhet të jetë në atë formë që të realizohet kënaqësia dhe mëshira e pastër nga lodhja dhe vështirësia në mënyrë që të gjithë ata të cilët kanë arritur përsosurinë njerëzore dhe nuk janë përzjerë me asnjë gjynah apo devijim ta shijojnë këtë lumturi. Ndryshe nga sistemi i kësaj bote, i cili nuk mund ta realizojë këtë lumturi të pastër dhe të plotë. Duhet thënë se lumturitë e kësaj bote janë relative dhe të mbushura me lodhje dhe vështirësi.

3. Veçoria e tretë: Bota tjetër duhet të përbëhet të paktën nga dy grupe të veçanta cilësish të cilat janë: mëshira dhe ndëshkimi me qëllim që të bëhet dallimi mes të mirëve dhe të këqijve dhe secili prej tyre të marrë shpërblimin e veprave të tij. Këto dy grupe janë ato që në Sheriat konsiderohen Xhenet dhe Xhehenem.

4. Veçoria e katërt: Tek ajo arrijmë nëpërmjet argumentit të veçantë të drejtësisë. Bota tjetër duhet të jetë e gjerë që të përfshijë shpërblimet dhe ndëshkimet e të gjithë njerzve për çdo vepër që ata kanë kryer, qoftë ajo e mirë apo e keqe. Psh. nëse dikush ka kryer krime vrasje kundër miliona njerzve të pafajshëm, atëherë ndëshkimi të jetë i mundur në atë botë. E nëse dikush do të shpëtonte jetën e miliona njerzve,

shpërblimin e përshtatdshmë dhe të merituar ta marrë në atë botë.

5.Veçoria e pestë: Kjo është një veçori shumë e rëndësishme. Arrijmë tek ajo nëpërmjet argumentit të drejtësisë është: Bota tjetër duhet të jetë vendi i shpërlimit dhe jo vendi i detyrave (veprave).

Sqarimi i kësaj është: Vërejmë se në këtë botë, bazuar në jetën që jeton, njeriu ka ëndrra dhe dëshira të shumta dhe të ndryshme. Ai gjithmonë ndodhet në mesin e dy rrugëve dhe detyrohet të zgjedhë njërën prej tyre. Ai gjithmonë ndodhet përpara detyrave dhe kushteve. Këto detyra vazhdojnë me njeriun deri në çastet fundit të jetës së tij.

Urtësia dhe drejtësia hyjnore kanë bërë që punëmirët dhe punëkëqijtë të marrin shpërblimin dhe ndëshkimin e duhur e të përshtatshëm. Nëse do të supozojmë ofrimin e ambjentit të përshtashëm për këto detyra, gjithashtu ekzistencën e një fushe për përzgjedhjen e rrugës për në botën tjetër, atëherë mëshira hyjnore bën që njeriu të mos pengohet nga praktikimi i detyrave dhe nga përzgjedhja e rrugës.

Pra, është e domosdoshme ekzistenca e botës tjetër përveç botës ku ne jetojmë, me qëllim që çdokush të marrë shpërblimin dhe ndëshkimin që meriton. Në realitet bota tjetër që ne supozojmë duhet konsideruar si një dynja tjetër, kurse e vërteta është se bota tjetër Ahireti është bota përfundimtare, në të cilën nuk ekzistojnë detyra, obligime dhe sprova apo dëshira dhe ëndrra që kundërshtojnë njëra tjetrën.

Kështu që na u qartësuan dallimet më të rëndësishme ndërmjet kësaj bote dhe botës tjetër. Kjo botë është bota e përzgjedhjes dhe e sprovës, kurse bota tjetër është bota që do të jepen ndëshkimet, shpërblimet dhe rezultatet e përjetshme për veprat e mira dhe të këqija të cilat janë kryer në këtë botë. Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *"Sot është dita e punës jo e llogarisë nesër është dita e llogarisë dhe jo e punës"*[2]

2. "Nehxhul Belaga", ligjërata 42.

Pyetje:

1. Përse ne nuk mund të kemi njohuri të sakta dhe të plota rreth Botës Tjetër?

2. Përmend dy shembuj mbi mendimet e devijuesve rreth Botës Tjetër dhe diskutoji ato.

3. Nëpërmjet cilës rrugë mund t'i njohim veçoritë e Botës Tjetër?

4. Shpjego veçoritë e Botës Tjetër mbi bazën logjike.

Leksioni i dyzetenëntë

NGA VDEKJA TEK RINGJALLJA

Hyrje

Më sipër mësuam se nëpërmjet dijeve të mangëta dhe të kufizuara që ne posedojmë, e kemi të pamundur që të njihemi me brendësinë e Ahiretit dhe të vërtetën e tij, si dhe përgjithësisht botën e padukshme. Prandaj, duhet të mjafthemi të dhënat dhe njohuritë e përgjithshme të cilat i arrijmë nëpërmjet argumentave logjikë, dhe veçorive dhe përshkrimeve të cilat na i bën të qarta Shpallja.

Në leksionin e kaluar cekëm disa nga veçoritë dhe cilësitë e përgjithshme me të cilat u njohëm nëpërmjet argumentave logjikë. Tani do të paraqesim cilësitë dhe veçoritë me të cilat nnjihemi nëpërmjet Kur'anit Fisnik.

Është e nevojshme të theksojmë se mundet që disa prej termave që përshkruajnë Botën Tjetër janë terma të ngjashëm ku imazhi që formohet në mëndjet tona nga këto terma të jetë i përpiktë me realitetin e vërtetë.

Ky nuk është për shkak të mangësive në sqarim, por përshkak të mangësisë tonë në kuptim. Ajo që nuk pranon dyshim dhe mëdyshje është se Kur'ani Fisnik ka përdorur termat dhe fjalët më të mira për të paraqitur të vërtetat dhe i shpjegon ato që të jenë në përshtatshme me kuptimin dhe logjikën tonë.

Ajetet kur'anore paraqesin gjithashtu hyrjen e Ahiretit dhe fillimet e tij. Fillimisht do ta nisim me vdekjen e njeriut.

Të gjithë njerzit do të vdesin

Kur'ani Fisnik dëshmon dhe vërteton se të gjithë njerëzit dhe të gjitha krijesat e gjalla do të vdesin dhe askush nuk do të jetojë në këtë botë përjetësisht.

"Çdo gjë që është në të (në tokë) **është e zhdukur."**[1]

Dhe: **"Secili njeri do të shijojë vdekjen."**[2]

Duke ju drejtuar profetit Kur'ani thotë: **"Ti do të jesh i vdekur, e edhe ata do të jenë të vdekur."**[3]

Dhe: **"Ne, asnjë njeri para teje** (Muhamed) **nuk i dhamë jetë të përhershme, e nëse ti vdes, a mos do të mbesin ata për gjithmonë?"**[4]

Në këtë mënyrë, vdekja konsiderohet një ligj i përgjithshëm që nuk pranon përveçësime për asnjë nga krijesat e gjalla në këtë botë.

Marrësi i shpirtrave

Vërejmë se Kur'ani Fisnik ia referon Allahut të Madhëruar marrjen e shpirtrave duke thënë: **"All-llahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre."**[5]

Kjo nga njëra anë. Ndërsa në anën tjetër, Ëngjëlli i vdekjes, konsiderohet si i ngarkuari për marrjen e shpirtrave: **"Thuaj: "Ëngjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju ua merr shpirtrat."**[6]

Në një tjetër ajet thuhet se janë ngarkuar ëngjëjt e Zotit dhe të dërguarit e tij: "**Derisa ku t'i vijë ndonjërit prej jush vdekja atij ja marrin shpirtin të dërguarit tanë."**[7]

Është e natyrshme se kur vepruesi kryen veprën e tij

1. Sure "El Rrahman", ajeti 36.
2. Sure "Al Imran", ajeti 158, sure "El Enbija", ajeti 35.
3. Sure "El Zumer", ajeti 30.
4. Sure "El Enbija", ajeti 34.
5. Sure "El Zumer", ajeti 42.
6. Sure "El Sexhde", ajeti 11.
7. Sure "El Enam", ajeti 61.

nëpërmjet një vepruesi tjetër, atëherë kjo vepër u përket të dyve. Nëse vepruesi i dytë vepron nëpërmjet një tjetri atëherë një përqindje e punës së tij e ka edhe vepruesi i tretë. Meqënëse All-llahu i Madhëruar i merr shpirtrat nëpërmjet ëngjëllit të vdekjes, ndërsa ëngjëlli i vdekjes e kryen këtë detyrë nëpërmjet ëngjëjve që u nënështrohen urdhrave të tij, atëherë vepra e marrjes të shpirtit ndahet në tre.

Butësia dhe ashpërsia në marrjen e shpirtit

Nga ajetet kur'anore vërejmë se marrësit e shpirtrave nuk e kryejnë detyrën e marrjes të shpirtit në mënyrë të njëllojtë tek të gjithë njerëzit. Tek disa e kryejnë detyrën e marrjes të shpirtit me butësi dhe respekt ndërsa në raste të tjera me ashpërsi dhe vështirësi.

Në Kur'an tregohet kur i merret shpirti besimtarëve: **"Të cilëve duke qënë të pastër ëngjëjt jua marrin shpirtin duke u thënë: "Selamun alejkum."**[8]

Dhe kur i merret shpirti jobesimtarëve: **"E si do të jetë atëherë puna e tyre kur ëngjëjt t'ua marrin shpirtrat duke i rrahur fytyrave dhe shpirtrave?"**[9]

Munde të themi se edhe vetë besimtarët dhe jobesimtarët ndryshojnë në vetat e tyre nga gradat dhe shkallët e besimit dhe mosbesimit, në marrjen e shpirtit me butësi dhe ashpërsi.

Mospranimi i besimit dhe pendimit në kohën e vdekjes

Kur afrohet ora e vdekjes, jobesimtarët dhe të pabindurit, i mbulon dëshpërimi për jetën e kësaj bote dhe nuk u mbetet asnjë shpresë për të jetuar. Ata pendohen për gjithçka që kanë vepruar gjatë jetës së tyre dhe shfaqin shenjat e pendimit dhe të besimit për gjynahet e tyre, por ky pendim dhe besim nuk pranohet.

8. Sure "El Nahl", ajeti 32, sure "El Enam", ajeti 93.
9. Sure "El Enfal", ajeti 5, sure "Muhamed", ajeti 27.

Për këtë Kur'ani Fisnik thotë: **"Ditën kur vijnë disa shenja të Zotit tënd, asnjë njeriu nuk i vlen besimi i Tij nëse nuk ka besuar më parë, ose nuk ka bërë në besimin e tij kurfarë të mire."**[10]

Dhe: **"Nuk është pendim** (i pranueshëm) **i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqija dhe vetëm atëherë kur t'i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: "Unë tash u pendova!"**[11]

Dhe: **"Besova se nuk ka Zot tjetër pos atij që i besuan beni israilët, edhe unë jam nga myslimanët!"**[12]

Dhe: **"Ti tani beson, ndërsa më parë kundërshtove dhe ishe njëri prej shkatërruesve!"**[13]

Dëshira për tu kthyer në dynja

Kur'ani Fisnik gjithashtu përcjell se jobesimtarët dhe keqbërësit kur u vjen koha e vdekjes apo kur janë duke shijuar dënimin e ashpër, dëshirojnë që të kthehen në këtë botë që të jenë besimtarë dhe të kryejnë vepra të mira.

Ata kërkojnë nga Allahu i Madhëruar që të kthehen në këtë botë dhe të pastrojnë të kaluarën e tyre, por askush nuk i përgjigjet këtyre dëshirave dhe kërkesave.[14]

Disa ajete theksojnë se edhe sikur të kthehen në këtë botë, ata do të veprojnë përsëri po ato vepra të papëlqyeshme

10. Sure "El Enam", ajeti 158, sure "Sebe", ajetet 51-53, sure "Gafir", ajeti 85, sure "El Sexhde", ajeti 29.
11. Sure "El Nisa", ajeti 18.
12. Sure "Junus", ajeti 90.
13. Sure "Junus", ajeti 91.
14. Duhet ta dimë se Kur'ani e mohon kthimin e atyre të cilëve e kanë kaluar jetën e tyre në mosbesim dhe në kundërshtim me urdhrat e Zotit dhe që shpresojnë të rikthehen në këtë botë për tu pastruar nga gjynahet e tyre kur të vdesin. Gjithashtu, mohon në mënyrë absolute kthimin nga bota tjetër. Kjo nuk do të thotë mohim i të gjitha llojeve të kthimit në këtë botë. Ashtu si e përmendëm edhe më sipër ekzistojnë disa persona që janë kthyer përsëri në këtë botë në mënyrë reale. Bazuar në doktrinën shiite mbi kthimin në jetë mbas vdekjes do të jenë disa persona që do të kthehen mbas shfaqjes të Imam Mehdiu.

që kryenin më parë.[15] Gjithashtu, në Ditën e Gjykimit ata do të dëshironin të njëjtat gjëra dhe do të kërkonin të njëjtat kërkesa por nuk do të tu përgjigjen kërkesave: **"E kur ndonjëri prej tyre i vjen vdekja ai thotë: "O Zoti im më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompesoj atë që lëshova!" Kurrësesi,** (kthim nuk ka) **e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai"**[16]

Dhe: **"Apo, kur ta shohë dënimin të thotë: " Sikur të isha kthyer edhe një herë e të isha bërë prej atyre bamirësve."**[17] (75).

Dhe: **"E sikur ti shihje ata kur janë ndaluar pranë zjarrit e thonë: " Ah sikur të ktheheshim** (në dynja)**, të mos gënjejmë faktet e Zotit tonë e të bëhemi nga besimtarët!"**[18]

Dhe: **"Dhe ata do të klithnin aty: " O Zoti ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim!"**[19]

Në këto ajete dallojmë me qartësi se Bota Tjetër nuk është bota e përzgjedhjes së rrugës dhe e kryerjes së obligimeve e detyrave. Deri edhe bindja që arrin njeriu në gjendjen e vdekjes apo edhe në botën tjetër, nuk ka asnjë ndikim në përsosurinë e njeriut dhe nuk meriton asnjë shpërblim. Ky është shkaku që jobesimtarët dhe të pabindurit kërkojnë të kthehen në këtë botë që të zgjedhin besimin dhe të veprojnë vepra të mira.

Bota e Barzahut (mes kësaj jete dhe Jetës Tjetër)

Në ajetet kur'anore përfitojmë se pas vdekjes dhe para kiametit, njeriu kalon një periudhë kohore në botën e varrit dhe Barzahut. Këu ai merr disa kënaqësi dhe lumturi ose vuajte, vështirësi dhe dhimbje. Në shumë transmetime thuhet se besimtarët gjynahqarë në jetën e tyre në këtë dynja do të përballen gjatë kësaj periudhe në Barzah me disa lloje vuajtjesh dhe dënimesh që u përshtaten gjynaheve të tyre. Në këtë

15. Sure "El Enam", ajetet 27-28.
16. Sure "El Muminun", ajetet 99-100.
17. Sure "El Zumer", ajetet 27-28, sure "El Araf", ajeti 53.
18. Sure "El Enam", ajetet 27-28, sure "El Araf", ajeti 53.
19. Sure "El Sexhde", ajeti 32, sure "Fatir", ajeti 37.

mënyrë ata pastrohen për të qenë të lehtë në Ditën e Gjykimit.

Meqënëse ajetet që lidhen me botën e Barzahut kanë nevojë për studime dhe komentime ne do të mjaftohemi me përmendjen një ajeti të vetëm që thotë: **"E ata kanë para tyre një perde** (distancë periodike) **deri në ditën kur ringjallen."**[20]

Pyetje:

1. Shpjego pikëpamjen e Kur'anit se njeriu nuk do të jetojë përjetësisht në këtë botë duke përmendur ajetet kur'anore që kanë lidhje me këtë çështje.

2. Kush e merr shpirtin e njeriut? Si mund ta sqarojmë ndryshimin ndërmjet ajeteve për këtë çështje?

3. Përmend dallimin në mënyrën e marrjes të shpirtit.

4. Sqaro pikëpamjen e Kur'anit rreth besimit dhe pendimit në kohën e vdekjes duke përmndur ajetet që lidhen me të?

5. Cilin lloj nga llojeve të kthimit në këtë botë e mohon Kur'ani Fisnik? A bie në kumdërshtim mohimi i këtij lloj kthimi me besimin në kthim? Pse?

6. Na shpjego botën e Barzahut.

20. Sure "El Muminun", ajeti 100.

Leksioni i pesëdhjetë

PARAQITJA E KIAMETIT NË KUR'ANIN FISNIK

Hyrje

Nga ajetet e Kur'anit përfitohet se në periudhën e fillimit të Botës Tjetër dhe të ndodhive të saj nuk kryhet vetëm ringjallja e njerëzve por ndodh një ndryshim i plotë në sistemin e kësaj bote. Atëherë, vjen Jeta Tjetër me veçori të tjera të cilën ne nuk mund ta parashikojmë gjendjen e saj me saktësi.

Normalisht nuk zotërojmë të dhëna të sakta mbi këto cilësi. Në atë ditë të gjithë njerëzit do të ringjallen që nga fillimi dhe deri në fund dhe do të shohin përfundimet e veprave të tyre për të jetuar përjetësisht në Xhenet ose në Xhehenem.

Meqënëse ajetet që lidhen me këtë temë janë të shumta dhe studimi i të gjitha ajeteve zgjat shumë, ne do të mjaftohemi vetëm me përmendjen e përmbledhjes.

Gjendja e tokës, deteve dhe maleve

Në tokë do të ndodhë një termet i fuqishëm[1] dhe do të nxjerrë jashtë çfarë fsheh në brendësinë e saj[2], do të përhapen pjesët e saj[3], shpërthejnë detet[4] lëvizin malet dhe ecin[5],

1. Sure "El Zelzele", ajeti1, sure "El Haxh", ajeti 1, sure "El Vakia", ajeti 4, sure "ElMuzemil", ajeti 14.
2. Sure "El Zelzele", ajeti 3, sure "El Inshikak", ajeti 4.
3. Sure "El Haka", ajeti 14, sure "El Fexhr", ajeti 21.
4. Sure "El Tekuir", ajeti 6, sure "El Infitar", ajeti 3.
5. Sure "El Kehf", ajeti 47, sure "El Nahl", ajeti 88, sure "El Tur", ajeti 10, sure "El Tekuir", ajeti 2.

tronditen fuqishëm[6] për t'u bërë si rërë e imët[7] e për tu bërë më pas si lesh i shkrifët[8] e për t'u përhapur në hapësirë[9]. Nga malet e larta do të mbeten vetëm mirazhe e vegime.[10]

Gjendja e qiejve dhe e yjeve

Hëna[11], dielli[12] dhe yjet e mëdhenj dhe disa prej tyre janë më të mëdhenj nga dielli miliona herë dhe shumë më të ndritshëm do të shuhen dhe do të fiken.[13] Sistemi i lëvizjes do të shkatërrohet[14], do të bashkohet dielli dhe hëna[15]. Qielli, i cili është mbulesa që ruan dhe mbulon këtë gjithësi, do të tronditet[16], do të çahet dhe do të shkrihet[17] do të shkrihen qiejt[18] si lëndë të shkrira.[19] Do të mbushet hapësira e gjithësisë me tym dhe re.[20]

Britma e vdekjes

Në këtë situatë e në këtë gjendje i fryhet surit për britmën e vdekjes. Do të vdesin të gjitha ekzistencat dhe krijesat e gjalla.[21] Nuk mbetet në këtë botë asnjë shenjë jete, largohet

6. Sure "El Haka", ajeti 14, sure "El Uakia", ajeti 5.
7. Sure "El Muzemil", ajeti 14.
8. Sure "El Mearixh", ajeti 9, sure "El Karia", ajeti 5.
9. Sure "Taha", ajetet 105 – 107, sure "El Murselat", ajeti 10.
10. Sure "El Kehf", ajeti 8, sure "El Nebe", ajeti 30.
11. Sure "El Kijame", ajeti 8.
12. Sure "El Tekuir", ajeti 1.
13. Sure "El Tekuir", ajeti 2.
14. Sure "El Infitar", ajeti 2.
15. Sure "El Kijame", ajeti 9.
16. Sure "El Tur", ajeti 1, sure "El Haka", ajeti 16.
17. Sure "El Rahman", ajeti 37, sure "El Haka", ajeti 16, sure "El Muzemil", ajeti 18, sure "El Murselat", ajeti 9, sure "El Nebe" 19, sure "El Infitar", ajeti 1, sure "El Inshkak", ajeti 1.
18. Sure "El Enbija", ajeti 104, sure "El Tekuir", ajeti 11.
19. Sure "El Mearixh", ajeti 8.
20. Sure "El Furkan", ajeti 25, sure "El Duhan", ajeti 10.
21. Sure "El Zumer", ajeti 78, sure "El Haka", ajeti 13, sure "Jasin", ajeti 49.

frika dhe mërzitja nga shpirti[22] përveçse ata të cilët janë të njohur me të vërtetat e ekzistencës dhe të fshehtat e saj dhe zemrat e tyre janë të mbushura me dije dhe dashuri hyjnore.

Britma e Bingjalljes dhe fillimi i Kiametit

Pas kësaj fillon bota tjetër, e cila është e përhershme dhe e përjetshme.[23] Toka do të ndriçojë nga drita e Zotit të saj.[24] Bie britma e ringjalljes dhe e tubimit.[25] Jeta do t'u kthehet të gjithë njerëzve (edhe kafshëve gjithashtu)[26] në një çast të vetëm.[27] Të gjithë janë të hutuar.[28]

Si karkaleca dhe flutura janë të përhapur në hapësirë dhe nxitojnë[29] për t'u paraqitur para Allahut të Lartësuar.[30] Njerëzit mblidhen të gjithë në një vend madhështor.[31]

Shumë prej tyre supozojnë se kaluan vetëm një orë në botën e Barzahut një ditë ose më e shumta disa ditë.

Ngritja e qeverisë hyjnore dhe ndërprerja e marrëdhënieve me farefisninë

Në atë botë do të zbulohen të vërtetat[32], pushteti dhe

22. Sure "El Nahl", ajetet 87-89.
23. Sure "Ibrahim", ajeti 48, sure "El Zumer", ajeti 67, sure "Merjem", ajeti 38, sure "Kaf", ajeti 22.
24. Sure "El Zumer", ajeti 69.
25. Sure "El Zumer", ajeti 68, sure "El Kehf", ajeti 99, sure "Kaf", ajeti 20 dhe 42, sure "El Nebe", ajeti 18, sure "El Naziat", ajetet 13-14, sure "El Mudethir", ajeti 8, sure "El Safat", ajeti 19.
26. Sure "El Enam", ajeti 38, sure "El Tekuir", ajeti 5.
27. Sure "El Kehf", ajeti 47, sure "El Nahl", ajeti 77, sure "El Kamer", ajeti 50, sure "El Nebe", ajeti 18.
28. Sure "Kaf", ajeti 20.
29. Sure "Kaf", ajeti 44, sure "El Mearixh", ajeti 43.
30. Sure "Jasin", ajeti 51, sure "El Mutafifijne", ajeti 30, sure "El Kijame", ajetet 12-30.
31. Sure "El Kehf", ajeti 99, sure "El Tegabun", ajeti 9, sure "El Nisa", ajeti 87, sure "El Enam", ajeti 12, sure "Al Imran", ajeti 9, sure "Hud", ajeti 103.
32. Sure "Ibrahim", ajeti 21, sure "El Adijat", ajeti 10, sure "El Tarik", ajeti

fuqia do të jenë të gjitha të Allahut të Madhëruar[33] dhe do të ngrihet mbi të gjitha krijesat frika ku askush nuk mundet të flasë me zë të lartë.[34] Çdo njeri është i zhytur në mendimet e tij dhe mendon për përfundimin që do të ketë. Fëmija do të largohet prej nënës dhe babait të tij. Të afërmit do të largohen nga njëri-tjetri[35] duke u ndërprerë marrëdhëniet ndërmjet tyre.[36]

Do të ndryshojnë shoqëritë dhe marrëdhëniet e ngritura mbi bazën e përfitimeve të dynjasë dhe armiqësive[37] dhe shpirtrat do të mbushen me pendim dhe keqardhje për çfarë kanë humbur në këtë botë (dynja).[38]

Gjykata e drejtësisë hyjnore

Pasi njerëzit paraqiten para Allahut, krijohet gjykata e drejtësisë hyjnore në të cilën janë të pranishme të gjitha veprat e njerëzve[39] dhe do të shpërndahen librat e veprave.[40] Çdo vepër do t'i bashkangjitet vepruesit të saj të vërtetë, ku do të sqarohet qartësisht pa qenë nevoja që të pyetet për veprat e tij.[41]

Në këtë gjykatë do të paraqiten engjëjt, profetët, të përzgjedhurit nga robtë e Allahut dhe dëshmorët.[42]

9, sure "Kaf", ajeti 22, sure "El Haka", ajeti 18.
33. Sure "El Haxh", ajeti 56, sure "El Furkan", ajeti 26, sure "Gafir", ajeti 16, sure "El Infitar", ajeti 19.
34. Sure "Hud", ajeti 105, sure "Taha", ajeti 108 dhe 111, sure "El Nebe", ajeti 38.
35. Sure "Abese", ajetet 34-37, sure "El Shuara", ajeti 88, sure "El Mearixh", ajetet 10-14, sure "Lukman", ajeti 33.
36. Sure "El Bekare", ajeti 166, sure "El Muminun", ajeti 101.
37. Sure "El Zuhruf", ajeti 67.
38. Sure "El Enam", ajeti 31, sure "Merjem", ajeti 39, sure "Junus", ajeti 54.
39. Sure "Al Imran", ajeti 31, sure "El Tekuir", ajeti 14, sure "El Isra", ajeti 49.
40. Sure "El Isra", ajetet 13-14 dhe 71, sure "El Haka", ajeti 19 dhe 25, sure "El Inshikak", ajeti 7 dhe 10.
41. Sure "El Rrahman", ajeti 39.
42. Sure "El Zumer", ajeti 69, sure "El Bekare", ajeti 143, sure "Al Imran", ajeti 140, sure "El Nisa", ajeti 41 dhe 69, sure "Hud", ajeti 18, sure "El Haxh", ajeti 78, sure "Kaf", ajeti 21, sure "El Nahl", ajeti 84 dhe 89.

Dora, këmba, lëkura e trupit do të flasin dhe do të dëshmojnë.[43] Të gjithë njerëzit do të gjykohen me imtësi. Llogaria e tyre do të peshohet në peshoren hyjnore.[44] Gjykimi i tyre do të bazohet mbi drejtësinë.[45] Çdokush do të shohë rezultatet e veprave të tij.[46]

Shpërblimi i atyre të cilët kanë kryer vepra të mira do të shumëfishohet. Kush vepron një vepër të mirë do të dhjetëfishohet me dhjetë të tilla.[47] Askush nuk do të ngarkohet me veprat e tjetërkujt.[48]

Ata të cilët kanë çuar në humbje të tjerët, përveç gjynahut të vet, do të marrin dhe do t'u shtohen edhe gjynahet e të humburve.[49] pa u zbritur nga gjynahet e tyre asgjë, si dhe askujt nuk do t'i pranohet shpagiimi.[50] dhe as ndërnjetësimi i ndonjërit[51], përveçse ndërmjetësimit të atyre që lejon Allahu i Madhëruar për të ndërmjetësuar. Ata do të ndërmjetësojnë sipas disa kritereve me të cilat Allahu është i kënaqur.[52]

43. Sure "El Nur", ajeti 24, sure "Jasin", ajeti 65, sure "Fusilet", ajetet 20-21.
44. Sure "El Araf", ajetet 8-9, sure "El Enbija", ajeti 47, sure "El Muminun", ajetet 102-103, sure "El Karia", ajetet 6-8.
45. Sure "Junus", ajeti 54 dhe 93, sure "El Xhathije", ajeti 17, sure "El Neml", ajeti 78, sure "El Zumer", ajeti 69 dhe 75.
46. Sure "El Nexhm", ajetet 40-41, sure "El Bekare", ajetet 281-286, sure "Al Imran", ajeti 25 dhe 161, sure "El En'am", ajeti 70, sure "Hud", ajeti 111, sure "Ibrahim", ajeti 51, sure "Taha", ajeti 15, sure "Gafir", ajeti 17, sure "El Xhathije", ajeti 22, sure "El Tur", ajeti 21, sure "El Mudethir", ajeti 38, sure "Jasin", ajeti 54, sure "El Zumer", ajeti 24.
47. Sure "El En'am", ajeti 160.
48. Sure "El Nexhm", ajeti 39, sure "El Enam", ajeti 164, sure "Fatir", ajeti 18, sure "El Zumer", ajeti 7.
49. Sure "El Nexhm", ajeti 25, sure "El Ankebut", ajeti 13. Mund të themi se kush ka qënë shkak i udhëzimit të tjerëve do t'i shtohen të mirat, siç e qartësojnë transmetimet.
50. Sure "El Bekare", ajeti 48 dhe 123, sure "Al Imran", ajeti 91, sure "Lukman", ajeti 33, sure "El Maide", ajeti 36, sure "El Hadijd", ajeti 15.
51. Sure "El Bekare", ajetet 48, 123, 254. Sure "El Mudethir", ajeti 48.
52. Sure "EL Enbija", ajeti 28, sure "El Bekare", ajeti 255, sure "Junus", ajeti 3, sure "Merjem", ajeti 87, sure "Taha", ajeti 109, sure "Sebe", ajeti 23, sure "El Zuhruf", ajeti 86, sure "El Nexhm", ajeti 26.

Në drejtim të vendqëndrimit të përhershëm

Në fund shpallet vendimi i Allahut[53], i cili bën dallimin ndërmjet të mirëve dhe të këqinjëve.[54] Besimtarët drejtohen për në Xhenet me fytyra të ndritura dhe të qeshura[55], ndërsa jobesimtarët dhe dyfytyrakët drejtohen për në Xhehenem me fytyra të nxira dhe të poshtëruara.[56]

Të kalojnë sipër Xhehenemit.[57] Drita shkëlqen në fytyrat e besimtarëve dhe u ndriçon rrugën.[58] Ndërsa jobesimtarët dhe dyfytyrakët mbeten në errësirë. Hipokritët u drejtohen besimtarëve me të cilët kanë qënë në dynja duke thënë:

"Ditët kur hipokritët dhe hipokritet atyre që besuan u thonë: "Na pritni (ose na shikoni) **të ndricohemi prej dritës tuaj". U thuhet: "Kthehuni prapa jush** (në dynja) e kërkoni ndonjë dritë!" (Hipokritët e mbetur në errësirë) **i thërsanin ata** (besimtarët): **"A nuk kemi qenë edhe ne së bashku me ju!?"** (besimtarët përgjigjen) **"Po", por ju e shkatërruat veten** (me hipokrizi), **ju prisni kob të zi për besimtarët ju dyshonit në cështjet e fesë dhe ju ju mashtruan shpresat e kota deri kur ju erdhi caktimi i Allahut** (vdekja) **dhe ashtu, përkitazi me All-llahun, mashtruesi ju mashtroi." E sot, prej jush nuk pranohet ndonjë kompesim, e as prej atyre që nuk besuan, vendi juaj është zjarri, ai është ndihma juaj: Sa përfundim i keq është ai."[59]**

53. Sure "El A'raf", ajeti 44.
54. Sure "El Enfal", ajeti 37, sure "El Rrum", ajetet 14-16, 43, 44, sure "El Shura", ajeti 7, sure "Hud", ajetet 105 – 108, sure "Jasin", ajeti 59.
55. Sure "El Zumer", ajeti 73, sure "Al Imran", ajeti 107, sure "Merjem", ajeti 85, sure "El Kijame", ajetet 24-42, sure "El Mutafifijnë", ajeti 24, sure "El Gashije", ajeti 8, sure "Abese", ajetet 38-39.
56. Sure "El Zumer", ajetet 60, 71, sure "Al Imran", ajeti 106, sure "El Enam", ajeti 124, sure "Junus", ajeti 27, sure "Merjem", ajeti 86, sure "Taha", ajetet 101, 124-126, sure "Ibrahim", ajeti 43, sure "El Kamer", ajeti 8, sure "El Mearixh", ajeti 44, sure "El Gashije", ajeti 2, sure "El Isra", ajetet 72, 97, sure "Abese", ajetet 40, 41.
57. Sure "Merjem", ajetet 71-72.
58. Sure "El Hadijd", ajeti 12.
59. Sure "El Hadijd", ajetet 13-15, sure "El Nisa", ajeti 140.

Kur besimtarët i afrohen Xhenetit, u hapen dyert e tij dhe mirëpriten nga ëngjëjt e mëshirës, të cilët i përshëndesin me respekt dhe i përgëzojnë me lumturi të përjetshme.[60]

Ndërsa kur jobesimtarët dhe hipokritët mbërrijnë në Xhehenem u hapen dyert e tij dhe ata i marrin ëngjëjt e ndëshkimit me forcë dhe i premtojnë ndëshkim të përjetshëm.[61]

Xheneti

Në Xhenet gjenden lulishte dhe kopshte, gjerësia e të cilëve është sa qiejt dhe Toka[62] të mbushur me lloje të ndryshme pemësh që mbartin të gjitha llojet e frutave të pjekura dhe lehtësisht të kapshmshme e të ngrënshme.[63] Në të gjenden vendqëndrime të këndshme dhe të gjëra[64], lumenj me ujë të ëmbël[65], qumësht, mjaltë dhe pije të pastra.[66] Në të gjenden çfarë dëshiron dhe kërkon[67], por edhe më tepër se çfarë kërkojnë dhe dëshirojnë.[68]

Veshjet e banorëve të Xhenetit janë prej mëndafshi të hollë e të gjelbër dhe janë të stolisura me argjend dhe lloje të tjera zbukurimesh.[69] Ata janë mbështetur në kolltukë të rehatshëm.[70] Prej banorëve të Xhenetit nuk dëgjohet tjetër

60. Sure "El Zumer", ajeti 73, sure "El Rad", ajetet 23-24.
61. Sure "El Zumer", ajetet 71-72, sure "El Tahrijm", ajeti 6, sure "El Enbija", ajeti 103.
62. Sure "Al Imran", ajeti 133, sure "El Hadijd", ajeti 21.
63. Sure "El Hakatu", ajeti 23, sure "El Nebe", ajeti 32.
64. Sure "El Teubetu", ajeti 72, sure "EL Furkan", ajeti 75, sure "El Zumer", ajeti 20, sure "Sebe", ajeti 37.
65. Sure "El Bekare", ajeti 25, sure "Al Imran", ajeti 15, e dhjetra ajete te tjera.
66. Sure "Muhamed", ajeti 15, sure "El Mutafifijne", ajeti 27.
67. Sure "El Nahl", ajeti 31, sure "El Furkan", ajeti 16, sure "El Zumer", ajeti 34, sure "Fusilet", ajeti 31, sure "El Shura", ajeti 22, sure "El Zufruf", ajeti 71.
68. Sure "Kaf", ajeti 35.
69. Sure "El Kehf", ajeti 31, sure "El Haxh", ajeti 23, sure "Fatir", ajeti 33, sure "El Duhan", ajeti 53, sure "El Araf", ajeti 32.
70. Sure "El Hixhr", ajeti 48, sure "El Kehf", ajeti 31, sure "El Safat", ajeti 44, sure "El Tur", ajeti 20, sure "El Rrahman", ajeti 54, 76, sure "El Uakiatu", ajeti 51-61, sure "El Gashije", ajeti 3-16, sure "Jasin", ajeti 56.

veçse lavdërimi dhe falenderimi i Allahut.[71] Nuk flasin fjalë të kota dhe nuk i dëgjojnë ato[72], nuk i dëmton as vapa dhe as i ftohti[73], nuk e dinë se çfarë është dhimbja, lodhja dhe mërzitja[74], nuk e njohin frikën dhe as hidhërimin[75] dhe në zemrat e tyre nuk ekziston urrejtja dhe smira.[76]

Atyre u shërbejnë djelmosha që janë përherë të tillë sa që kur i kundron të duken si margaritarë të derdhur.[77] U jepet për të pirë në gota nga pijet e Xhenetit, të cilat kanë shije dhe energji që nuk përshkruhen, nuk të bëjnë keq dhe nuk të dëmtojnë.[78] Banorët e Xhenetit ushqehen me lloje të ndryshme frutash dhe mish zogu.[79] Ata argëtohen me gra të bukura, të pastra nga mangësitë.[80] Ata furnizohen me mirësi shpirtërore dhe marrin kënaqësinë e Allahut.[81] Ata marrin nga Zoti i tyre kënaqësi dhe lumturi që nuk ka shkallë krahasimi.[82], E tillë lumturi që nuk përshkrohet, këto mirësi që nuk cilësohen, kjo

71. Sure "El Araf", ajeti 43, sure "Junus", ajeti 10, sure "Fatir", ajeti 34, sure "El Zumer", ajeti 74.
72. Sure "Merjem", ajeti 62, sure "El Nebe", ajeti 35, sure "El Gashije", ajeti 11.
73. Sure "El Insan", ajeti 13.
74. Sure "Fatir", ajeti 35.
75. Sure "El Araf", ajeti 35, sure "Fusilet", ajeti 30, sure "El Zuhruf", ajeti 68, sure "El Ahkaf", ajeti 13.
76. Sure "El Araf", ajeti 343, sure "EL Hixhr", ajeti 47.
77. Sure "El Tur", ajeti 24, sure "El Uakia, ajeti 17.
78. Sure "El Safat", ajetet 45-47, sure "Sad", ajeti 51, sure "El Tur", ajeti 23, sure "El Zuhruf", ajeti 71, sure "El Uakia", ajetet 18-19, sure "El Nebe", ajeti 34, sure "El Mutafifijnë", ajetet 25-28.
79. Sure "Sad", ajeti 51, sure "El Tur", ajeti 22, sure "El Rrahman", ajetet 52, 68, sure "El Uakia, ajetet 20-21, sure "El Murselat", ajeti 42, sure "El Nebe", ajeti 32.
80. Sure "El Bekare", ajeti 25, sure "Al Imran", ajeti 15, sure "El Nisa", ajeti 57, sure "El Safat", ajetet 48-49, sure "Sad", ajeti 52, sure "El Zuhruf", ajeti 70, sure "El Duhan", ajeti 54, sure "El Tur", ajeti 20, sure "El Rrahman", ajetet 56-70,74, "El Uakia", ajetet 22-23, 34-37, sure "El Nebe", ajeti 33.
81. Sure "Al Imran", ajeti 15, sure "El Teube", ajetet 21, 72, sure "El Hadijd", ajeti 20, sure "El Maide", ajeti 119, sure "El Muxhadele", ajeti 29, sure "El Bejine", ajeti 8.
82. Sure "El Sexhde", ajeti 17.

mëshirë kënaqësi e Allahut, të gjitha janë të përhershme[83] dhe e pafundme.[84]

Xhehenemi

Xhehenemi është vendqëndrimi i jobesimtarëve dhe i hipokritëve, të cilët nuk kanë dritë në zemrat e tyre.[85] Ky vend është i gjerë dhe pasi të futen të gjithë jobesimtarët në të dhe mbushet do të thotë Xhehenemi: "A ka më?"[86] Në të ka vetëm zjarr dhe dënim.

Flakët e zjarrit ngjiten në Xhehenem nga të gjitha anët. Gjuhët e tij të frikshme dhe të zemëruara ta shtojnë edhe më tepër frikën dhe egërsinë.[87] Fytyra të vrazhda, të nxira, të shëmtuara.[88] Edhe engjëjt që janë ngarkuar të mbikëqyrin Xhehenemin janë të ashpër, të vrazhdë, në fytyrat e tyre nuk sheh asnjë shenjë mëshire dhe keqardhjeje.[89]

Banorët e Xhehenemit janë të lidhur me zinxhirë të hekurt[90], të rrethuar nga çdo anë me zjarr.[91] Ata janë lënda

83. Sure "El Bekare", ajetet 25-82, sure "Al Imran", ajetet 107, 36, 198, sure "El Nisa", ajetet 13, 57, 122, sure "El Maide", ajetet 85, 119, sure "El Araf", ajeti 42, sure "El Teube", ajetet 22, 72, 89, 100, sure "Junus", ajeti 26, sure "Hud", ajetet 33-108, sure "Ibrahim", ajeti 23, sure "El Hixhr", ajeti 48, sure "El Kehf", ajetet 3, 108, sure "Taha", ajeti 76, sure "El Enbija", ajeti 102, sure "El Muminun", ajeti 117, sure "El Furkan", ajetet 16, 76, sure "El Ankebut", ajeti 58, sure "Lukman", ajeti 9, sure "El Zumer", ajeti 7, sure "El Zuhruf", ajeti 17, sure "El Ahkaf", ajeti 14, sure "Kaf", ajeti 34, sure "El Fet'h", ajeti 5, sure "El Hadijd", ajeti 12, sure "El Muxhadele", ajeti 22, sure "El Tegabun", ajeti 9, sure "El Talak", ajeti 11, sure "El Bejine", ajeti 8.

84. Sure "El Duhan", ajeti 56, sure "Fusilet", ajeti 8, sure "El Inshikak", ajeti 25, sure "El Tijn", ajeti 6.

85. Sure "El Nisa", ajeti 140, dhe dhjetra ajete të tjera.

86. Sure "Kaf", ajeti 30.

87. Sure "Hud", ajeti 106, sure "El Enbija", ajeti 100, sure "El Furkan", ajeti 12, sure "El Mulk", ajetet 7-8.

88. Sure "Al Imran", ajeti 106, sure "El Mulk", ajeti 27, sure "Junus", ajeti 27, sure "El Muminun", ajeti 104, sure "El Zumer", ajeti 60.

89. Sure "El Tahrijm", ajeti 6.

90. Sure "El Rra'd", ajeti 5, sure "Ibrahim", ajeti 49, sure "Sebe", ajeti 33, sure "Gafir", ajetet 71, 72, surer "El Hakatu", ajeti 32.

91. Sure "Ibrahim", ajeti 50, sure "El Furkan", ajeti 13, sure "El Enbija",

djegëse e zjarrit.[92] Në Xhehenem dëgjohen vetëm vuajtjet, klithmat, britmat dhe ulërimat e të mbikëqyrurve të tij.[93] Në fytyrat e banorëve të Xhehenemit hidhet hamijm, i cili është uji i valuar që shkrin çfarë ka në barqet e tyre.[94] kur të kërkojnë ndihmë për të shuar etjen, u jepet ujë i valuar e i pisët dhe i vërsulen atij uji si devetë e etura. Kur e pinë atë u copëtohen zorrët.[95] Ushqimi i tyre është një lloj peme e quajtur Zekkum. Ajo është një pemë që rritet në Xhehenem. Të ngrënit prej kësaj peme ua shton më shumë dënimin dhe diegien e barqeve të tyre.[96] Kurse rrobat e tyre përbëhen nga një lëndë e zezë ngjitëse era e së cilës ia shton edhe më tepër dënimin atyre.[97] Shoqëruesit e tyre në zjarr janë shejtanët dhe xhindët kundërshtarë të cilët dëshirojnë të largohen prej tyre.[98] Çdonjëri mallkon tjetrin dhe armiqësohet me të.[99]

Kur të përpiqen për të shfaqur pendimin dhe të justifikohen para Allahut, do të përballen me ashpërsinë që të pushojnë e të heshtin.[100] Në atë kohë do të strehohen te mbikqyrësit e Xhehenemit: **Dhe ata që gjenden në zjarr, do t'u thonë rojtarëve të Xhehenemit: "Lutjuni Zotit tuaj që të na lehtësojë dënimin, qoftë vetëm një ditë!" Ata do të përgjigjen: "Vallë, a nuk ju kanë sjellë të dërguarit tuaj**

ajeti 39, sure "El Humeze", ajetet 6-7.

92. Sure "El Bekare", ajeti 24, sure "Al Imran", ajeti 10, sure "El Enbija", ajeti 98, sure "El Xhin", ajeti 15, sure "El Tahrijm", ajeti 6.

93. Sure "El Furkan", ajetet 13-14, sure "El Inshikak", ajeti 11.

94. Sure "El Haxh", ajetet 19, 20, sure "El Duhan", ajeti 48.

95. Sure "El Enam", ajeti70, sure "Junus", ajeti 4, sure "El Kehf", ajeti 29, sure "El Uakia", ajetet 42-44, 55, sure "Muhamed", ajeti 15.

96. Sure "El Safat", ajetet 62-66, sure "Sad", ajeti 57, sure "El Duhan", ajetet 45-46, sure "El Uakia", ajetet 52, 53, sure "El Nebe", ajeti 25, sure "El Gashije", ajetet 6-7.

97. Sure "Ibrahim", ajeti 50, sure "El Haxh", ajeti 19.

98. Sure "El Zuhruf", ajetet 38-39, sure "El Shuara", ajetet 94-95, sure "Sad", ajeti 85.

99. Sure "El Araf", ajetet 38-39, sure "El Ankebut", ajeti 25, sure "El Ahzab", ajeti 68, sure "Sad", ajetet 58-64.

100. Sure "El Muminun", ajeti 108, Sure "El Rrum", ajeti 57, sure "Gafir", ajeti 52, sure "El Murselat", ajetet 35-36.

prova të qarta?" Ata do të thonë: "Po, është vërtetë". Do t'u thuhet: "Atëherë thërrisni për ndihmë!" Por thirrjet e tyre do të jenë të kota."[101]

Për herë të dytë ata do të kërkojnë vdekjen, por do t'u vijë përgjigjja: Do të qëndroni në zjarr përjetësisht. **Ata do të thërrasin: "O Malik!** (Më mirë) **Le të na vdesë Zoti yt!", ndërsa Ai do të thotë: "Ju do të qëndroni përherë aty!"**[102]

Megjithëse vdekja i rrethon ata në çdo anë, ata nuk vdesin.[103] Sa herë do të digjen, lëkurët e tyre do të zëvendësohen me lëkurë të reja dhe vazhdon dënimi i tyre.[104]

Do t'u kërkojnë banorëve të Xhenetit pak ujë dhe ushqim. Do t'u jepet përgjigjja se i Lartësuari ua ka ndaluar atyre kënaqësitë e Xhenetit.[105] Banorët e Xhenetit do t'i pyesin: **"Çka ju solli ju në Sekar?" Ata thonë: "Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin** (që bënin namaz); **nuk kemi qënë që ushqyenim të varfrit dhe kemi qënë që përziheshim me të tjerët në punë të kota dhe kemi qënë që nuk e besonim ditën e gjykimit."**[106]

Më pas, do të fillojnë të kuvendojnë ndërmjet tyre.[107] Të humburit do t'u drejtohen atyre që i humbën: Ju jeni ata që na bëtë prej të humburve. Ata u përgjigjen: Ju vetë patët dëshirë dhe na ndoqët.[108] Ata që ishin të privuar dhe të nënshtruar ju drejtohen atyre që ishin të fuqishëm.[109]

Më në fund i drejtohen shejtanit. Ti je ai që na bëri prej të humburve. Shejtani u përgjigjet: **Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do të thotë: "Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju**

101. Sure "Gafir", ajetet 49-50.
102. Sure "El Zufruf", ajeti 77.
103. Sure "Ibrahim", ajeti 17, sure "Taha", ajeti 74, sure "Fatir", ajeti 36.
104. Sure "El Nisa", ajeti 56.
105. Sure "El Araf", ajeti 50.
106. Sure "El Mudethir", ajetet 42-46.
107. Sure "Sad", ajetet 59-64.
108. Sure "El Araf", ajetet 38-39, sure "El Safat", ajetet 27- 33, sure "Kaf", ajetet 27- 28.
109. Sure "Ibrahim", ajeti 21, sure "Sebe", ajetet 31-33.

thirra e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi. Unë tani e mohoj që më bëtë ortak me Allahun (në adhurim)**." Vërtet, keqbërësit do të kenë një dënim të dhembshëm.** [110]

Si përfundim ata nuk ka rrugë tjetër vetëm se t'i dorëzohen dënimit të mosbesimit dhe të humbjes së tyre dhe të qëndrojnë përjetësisht në ndëshkim.[111]

Pyetje:

1. Shpjego gjendjen e tokës dhe të qiellit në kohën e Kiametit
2. Trego mënyrën e fillimit të Kiametit dhe veçoritë e tij.
3. Fol me detaje për Gjykatën e Drejtësisë Hyjnore?
4. Shpjego lëvizjen e besimtarëve dhe jobesimtarëve në drejtim të vendqëndrimit të përhershëm.
5. Kush janë mirësitë e Xhenetit? Sqaroji ato.
6. Sqaro gjendjen e Xhehenemit dhe të banorëve të Xhehenemit.
7. Fol me detaje rreth diskutimit të banorëve të Xhehenemit.

110. Sure "Ibrahim", ajeti 22.
111. Sure "El Bekare", ajetet 39, 81, 162, 217, 257, 275. Sure "Al Imran", ajetet 88, 116, sure "El Nisa", ajeti 169, sure "El Maide", ajetet 37, 80, sure "El Enam", ajeti 128, sure "El Araf", ajeti 36, sure "El Teube", ajetet 17, 63, 68, sure "Junus", ajetet 27, 52, sure "Hud", ajeti 107, sure "El Rad", ajeti 5, sure "El Nahl", ajeti 29, sure "El Kehf", ajeti 74, sure "Taha", ajeti 101, sure "El Sexhde", ajeti 20, sure "El Muminun", ajeti 103, sure "El Ahzab", ajeti 65, sure "El Zumer", ajeti 72, sure "Gafir", ajeti 76, sure "El Zuhruf", ajeti 74, sure "El Muxhadele", ajetet 17, sure "El Tegabun", ajeti 10, sure "El Xhin", ajeti 23, sure "El Bejine", ajeti 6.

Leksioni i pesëdhjetëenjë

KRAHASIMI MES KËSAJ JETE (DYNJASË) DHE JETËS TJETËR (AHIRETIT)

Hyrje

Pasi u njohëm me disa veçori të Ahiretit, nëpërmjet logjikës dhe Kur'anit, mund të bëjmë një krahasim ndërmjet kësaj jete (dynjasë) dhe Jetës Tjetër (Ahiretit) në këndvështrime të ndryshme. Për fat të mirë, edhe Kur'ani Fisnik na e paraqet këtë krahasim dhe mund të përfitojmë prej ajeteve kur'anore për të programuar të saktë jetën në këtë botë dhe në Botën Tjetër dhe të paraqesim se Ahireti është më i mirë.

Aftësia e dynjasë për zhdukje dhe përjetësia e Ahiretit

Jetëgjatësia e kësaj bote është e shkurtër e kufizuar. Dallimi i parë i dukshëm ndërmjet dynjasë dhe Ahiretit është se mosha e çdo njeriu në këtë botë ka një afat të përcaktuar, i cili herët apo vonë do të vijë. Edhe sikur të caktohej që njeriu do të jetonte në këtë botë qindra apo mijëra vjet, patjetër që jeta e tij do të përfundonte me ndryshimin e përgjithshëm përfundimtar të botës natyrore kur t'i fryhet Surit (për herë të parë) ashtu si e shpjeguam edhe në leksionin e kaluar. Ka rreth tetëdhjetë ajete të cilat tregojnë mbi përjetshmërinë e botës tjetër dhe përhershmërinë e saj.[1] Është mëse e qartë se një gjë që është e kufizuar sado të zgjatet jetëgjatësia e saj nuk mund të krahasohet me të pakufizuarën.

Pra, Bota Tjetër është shumë më e mirë se kjo botë sa i përket qëndrueshmërisë. Kjo ide është përforcuar në ajete të

1. Kthehu tek ajetet e përjetësisë dhe të Xhenetit e Xhehenemit.

shumta në Kur'anin Fisnik, me fraza shprehi dhe mënyra të ndryshme, si psh., Ahireti është i përhershëm[2] dhe dynjaja është kënaqësi e shkurtër.[3] Në ajete të tjera e ka krahasuar jetën e kësaj bote me bimët që gjelbërojnë vetëm për pak ditë dhe pas kësaj zverdhen dhe më në fund thahen dhe zhduken[4]. Në një ajet thuhet: "**Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, e ajo që është tek Allahu është e përjetshme."[5]**

Dallimi ndërmjet kënaqësisë dhe dënimit në Ahiret (Jetën Tjetër)

Dallimi tjetër bazë ndërmjet jetës të kësaj bote dhe jetës tjetër është se lumturia e kësaj bote dhe kënaqësitë e saj janë të përziera me lodhje dhe vështirësi. Çështja nuk është se një grup i njerëzve në këtë botë jetojnë të kënaqur e të gëzuar dhe një grup tjetër njerëzish gjithmonë përballen me vështirësi, hidhërime dhe dënim në të gjitha fushat.

Por çështja është se në këtë botë, të gjithë jetojnë një jetë pak ose shumë të mbushur me kënaqësi, gëzime dhe qetësi, si dhe jetojnë gjithashtu hidhërimet, vështirësitë dhe frikën. Bota Tjetër (Ahireti) ndahet në dy pjesë dhe çdonëra prej tyre ka veçoritë dhe dallimet e saj nga tjetra që janë Xheneti dhe Xhehenemi. Tek njëri prej tyre nuk ka asnjë shenjë ndëshkimi lodhjeje, frike dhe vështirësie. Tek tjetri ekziston vetëm zjarr, dhimbje dhe vështirësi.

Natyrisht që kënaqësitë, vështirësitë dhe dhimbjet e Botës Tjetër janë shumë më të mëdhaja nga kënaqësitë, vështirësitë dhe dhimbjet e kësaj bote. Gjithashtu, Kur'ani Fisnik e paraqet këtë krahasim dhe sqaron dallimin ndërmjet mirësive në të

2. Sure "El Kehf", ajeti 46, sure "Merjem", ajeti 76, sure "Taha", ajetet 73, 131, El sure "Kasas", ajeti 60, sure "El Shura", ajeti 36, sure "Gafir", ajeti 39, sure "El Ala", ajeti 17.
3. Sure "Al Imran", ajeti 197, sure "El Nisa", ajeti 77, sure "El Teube", ajeti 38, sure "El Nahl", ajeti 117.
4. Sure "Junus", ajeti 24, sure "El Kehf", ajetet 45-46, sure "El Hadijd", ajeti 20.
5. Sure "El Nahl", ajeti 96.

dyja botët dhe mirësitë e Ahiretit dhe afrimitetin me Allahun janë mbi mirësitë e kësaj bote.[6] Po ashtu paraqet ashpërsinë e dënimit të Botës Tjetër, që është më i ashpër nga çdo vështirësi e e lodhje në këtë botë.[7]

Origjina e Botës Tjetër (Ahiretit)

Një tjetër dallim i rëndësishëm ndërmjet dynjasë dhe Ahiretit është se jeta e kësaj bote është pararendëse e Ahiretit, si dhe një mënyrë për të përfituar lumturinë e përjetshme. Bota Tjetër është bota e përjetshme, përfundimtare dhe origjinale.

Mirësitë dhe kënaqësitë materiale dhe shpirtërore të kësaj bote, edhe pse kërkohen dhe dëshirohen nga njeriu, por duke vërejtur këtë të vërtetë, mësojmë se të gjitha këto janë rrugë sprove dhe faktorë të përsosurisë së vërtetë për të arritur lumturinë e vërtetë e të përjetshme. Ato mirësi nuk posedojn orgjinë në vetvete. Vlera e vërtetë e tyre përfaqësohet me atë që furnizohet njeriu prej atyre për jetën e përjetshme.[8]

Nga këtu themi se kush e harron apo e neglizhon Jetën Tjetër dhe kapet fort pas kënaqësive të kësaj jete dhe pas mashtrimeve të saj dhe i kënaqësitë e saj përfundimtare, ai nuk e njeh vlerën e vërtetë dhe reale të Ahiretit, por hamendëson se ka vlera të kota.

Kjo, sepse ai njeri ka vendosur mjetin në vend të qëllimit. Në këtë vepër nuk gjendet tjetër veçse lojë, dëfrim, zbavitje dhe mashtrim. Për këtë arsye Kur'ani Fisnik e ka përshkruar jetën e kësaj bote se ajo është dëfrim, lojë dhe zbavitje mashtruese.[9]

6. Sure "Al Imran", ajeti 15, sure "El Nisa", ajeti 77, sure "El Enam", ajeti 32, sure "El Araf", ajeti 32, sure "Jusuf", ajeti 109, sure "El Nahl", ajeti 30, sure "El Isra", ajeti 21, sure "El Kehf", ajeti 46, sure "Merjem", ajeti 76, sure "Taha", ajetet 73, 131, sure "El Kasas", ajeti 60, sure "El Shura", ajeti 36, sure "El Ala", ajeti 17.

7. Sure "El Rra'd", ajeti 24, sure "Taha", ajeti 127, sure "El Sexhde", ajeti 21, sure "El Zumer", ajeti 26, sure "Fusilet", ajeti 16, sure "El Kalem", ajeti 33, sure "El Gashije", ajeti 24.

8. Sure "El Kasas", ajeti 77.

9. Sure "Al Imran", ajeti 185, sure "El Ankebut", ajeti 64, sure "Muhamed",

Botën Tjetër Kur'ani e konsideron Jetë të Vërtetë.[10] Duhet të dimë se çdo gjë që u përmend mbi dynjanë dhe moslavdërimin e saj ka lidhje me vizionin e të kapurve fort pas saj. Porse, për robtë e mirë të Allahut, të cilët e njohin të vërtetën e saj dhe që e shohin si mjet, ata shfrytëzojnë çdo çast të saj për të fituar lumturinë të përjetshme. Kjo dynja nuk është gjynahqare, por zotëron vlerë të madhe.

Rezultati i ndikimit të kësaj bote dhe përzgjedhjes së saj

Duke vërejtur veçoritë e Botës Tjetër dhe çfarë përmban prej mirësive të Xhenetit dhe kënaqësisë së All''alut, të cilat janë më të larta dhe më të mira se gjithë kënaqësitë e dynjasë, nuk mbetet asnjë dyshim se ndikimi i kësaj bote dhe dhënia përparësi kësaj më shumë se Ahiretit është një vepër që nuk e pranon logjika.[11] Atë nuk e pason pendimi, por kënaqësia e këtij ndikimi, shëmtimi, pavërtetësisë shfaqet më tepër kur mësojmë ndikimin dhe fortësinë e zemrës me kënaqësitë. Kjo jo vetëm na con në mohimin e lumturisë së përjetshme, por gjithashtu është shkak për vuajtjen e përjetshme.

Sqarim i kësaj: Nëse njeriu do të ketë mundësi të ndikohet nga kënaqësitë e kësaj bote të përkohshme derisa këto kënaqësi të zëvendësojnë lumturinë e përjetshme, pa renditur në veprat e tij asnjë shenjë negative në botën e përjetshme, kjo gjë tregon injorancën dhe budallallëkun e këtij njeriu me gjithë parësoren dhe sipëroren e lumturisë së përjetshme ndaj kënaqësive të kësaj jete.

Duhet të dihet se askush nuk mund t'i largohet përballjes me botën e përjetshme. Kush përpiqet dhe harxhon gjithë fuqitë dhe energjitë e tij në rrugën e jetës të kësaj bote dhe kënaqësive të saj dhe harron botën tjetër, apo e mohon plotësisht atë, atëherë këtij personi jo vetëm që i mohohen

ajeti 36, sure "El Hadijd", ajeti 20.
10. Sure "El Ankebut", ajeti 64, sure "El Fexhr", ajeti 24.
11. Sure "El Ala", ajetet 16-17.

kënaqësitë e Xhenetit, por do të ndëshkohet gjithmonë në dënimin e zjarrit dhe do t'i shtohet shumëfish dënimi.[12]

Nga këtu, vërejmë se në njërën anë Kur'ani e përforcon infrioritetin e mirësive të Ahiretit dhe paralajmëron nga mashtrimi i rremë i kësaj bote.[13] Dhe, nga ana tjetër, numëron të këqijat dhe dëmet e kësaj bote, harrimin e Botës Tjetër ose mohimi saj dhe dyshimin në të. Kur'ani përforcon se të tilla çështje çojnë drejt poshtërimit, fatkeqësisë dhe vuajtjeve të përjetshme[14] Nuk është ashtu si hamendësohet që ndikimi i kësaj bote dhe dhënia pas saj jo vetëm që çon në mosshpërblim në botën tjetër, por ai person do dënohet me ndëshkim të përjetshëm.

E fshehta në këtë është se: I tillë person që është i lidhur kaq shumë me dynjanë i ka humbur dhuntitë e Allahut. I është tharë në dorë ajo pemë tek e cila shpresonte të vilte frytet e lumturisë së përjetshme. Vetë ka ndihmuar që kjo pemë të jetë pa fruta. Ai nuk është kujdesur për të drejtat e Mirësuesit të Vërtetë (adhurimin e Tij). Ai i mirësitë e Allahut në atë rrugë që All-llahu është i pakënaqur. Ky person devijues kur të shohë rezultatet dhe gjurmët të gabuara, do të shpresojë të jetë pluhur dhe të mos sprovohet nga ky përfundimi zymtë dhe i keq.

12. Sure "Hud", ajeti 22, sure "El Kehf", ajetet 104-105, sure "El Neml", ajetet 4-5.

13. Sure "El Bekare", ajetet 102, 200, sure "El Teube", ajeti 38, sure "El Rrum", ajeti 33, sure "Fatir", ajeti 5, sure "El Shura", ajeti 20, sure "El Zuhruf", ajetet 34-35.

14. Sure "El Isra", ajeti 10, sure "El Bekare", ajeti 86, sure "El Enam", ajeti 130, sure "Junus", ajetet 7-8, sure "Hud", ajete 15-16, sure "Ibrahim", ajeti 3, sure "El Nahl", ajeti 22, 107, sure "El Muminun", ajeti 74, sure "El Neml", ajetet 4-5, 66, sure "El Rrum", ajetet 7, 16, sure "Lukman", ajeti 4, sure "Sebe", ajetet 8, 21, sure "El Zumer", ajeti 45, sure "Fusilet", ajeti 7, sure "El Naziatu", ajeti 40.

Pyetje:

1. Sqaro dallimet ndërmjet dynjasë dhe Ahiretit.
2. Trego shkakun për qortimin e dynjasë.
3. Sqaro vështirësitë dhe të këqijat që ka dhënia pas dynjanë.
4. Përse mosbesimi në Ahiret çon në dënimin e përjetshëm?

Leksioni i pesëdhjetëedy

MARRËDHËNIET E DYNASË ME AHIRETIN

Hyrje

Më sipër mësuam se jeta e kësaj bote të njeriut nuk kufizohet vetëm me jetën e dynjasë që është e përkohshme dhe kalimtare por njeriut do t'i kthehet sërisht jeta edhe një herë tjetër në Botën Tjetër për të qëndruar i gjallë përjetësisht. Gjithashtu, mësuam se jeta e Ahiretit është jeta e vërtetë dhe reale dhe se kjo jetë nuk e meriton emërtimin jetë në krahasim me jetën e Botës Tjetër.

Tani na u dha mundësia të hulumtojmë temën e marrëdhënies ndërmjet kësaj bote dhe Botës Tjetër të përcaktimit e llojit të marrëdhënieve ndërmjet tyre. Është e qartë se deri diku lloji i marrëdhënieve u sqarua nëpërmjet studimeve të mëparshme.

Por, meqënëse ekzistojnë disa mendime devijuese në këtë fushë, detyrohemi që të hedhim më tepër dritë mbi këtë temë dhe ta studiojmë gjerësisht për t'u njohur me llojin e marrëdhënieve ndërmjet dynjasë dhe Ahiretit nëpërmjet argumentave logjikë dhe kur'anor.

Dynjaja është fushëmbjellja për Ahiretin

Tema e parë, e cila duhet të përfocohet edhe më tepër është: Lumturia dhe vuajtja në Botën Tjetër janë rezultat i veprave të njeriut në këtë botë. Nuk mund të arrihen mirësitë e Ahiretit nëpërmjet përpjekjeve në atë Botë ku çdokush që ka mundësi fizike apo mendore më shumë se të tjerët të furnizohet me të mira më shumë se të tjerët. Ose disa mashtrues, në sajë

të përdorimit të formave të dredhisë dhe mashtrimit, të kenë mundësi të zotërojnë frytet e përpjekjeve të tjerëve, sikurse hamendësojnë disa njerëz, dhe se Bota Tjetër është e pavarur plotësisht nga kjo botë.

Kur'ani Fisnik na përcjell fjalën e disa jobesimtarëve: **"dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora** (e Kiametit). **Por, edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky** (kopësht)**"**![1]

Në një tjetër ajet thuhet: **"...Unë nuk besoj se do të vijë Ora** (e Kiametit)**, por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë..."**[2]

Ata amendësojnë se në Botën Tjetër kanë mundësi të arrijnë mirësi të shumta nëpërmjet përpjekjeve në atë Jetë. Ose hamendësojnë se kënaqësia e tyre në këtë jetë është mirësi e posaçme e Allahut për ata. Edhe në Botën Tjetër do të përfshihet nga të njëjta kënaqësi e veçantë sikurse në dynja!

Sidoqoftë, kush beson se Bota Tjetër është e pavarur dhe e shkëputur plotësisht nga kjo botë dhe se veprat e mira apo të këqojaa në këtë botë nuk kanë asnjë ndikim në shpërblimin apo ndëshkimin në Botën Tjetër, ai person nuk beson me të vërtetë në Ringjallje, që konsiderohet nga parimet e besimeve të feve qiellore.

Sipas këtij parimi shpërblimi dhe ndëshkimi bazohen te punët e kryera në këtë jetë. Nga këtu, dynjaja është konsideruar si treg, vendi ku shitet dhe blihet dhe vendi ku punohet dhe mbillet për Ahiretin. Prandaj, njeriu duhet të përpiqet në këtë jetë. Duhet të punojë e të mbjellë me qëllim që të korrë frutat dhe fitimiet e përjetshme në Botën Tjetër.[3]

Këtë e tregojnë edhe argumentat e Ringjalljes dhe ajetet kur'anore dhe nuk ka nevojë për më shumë sqarim.

---

1. Sure "El Kehf", ajeti 36.
2. Sure "Fusilet", ajeti 50.
3. Duhet ta dimë se Kur'ani fisnik paraqet gjithashtu shpërblimin dhe ndëshkimin në këtë botë. Ndërsa shpërblimi dhe ndëshkimi i plotë dhe i përhershëm do të jetë në Botën Tjetër.

Mirësitë e kësaj bote nuk tregojnë lumturinë e Botës Tjetër

Disa besojnë se pasuria, fëmija dhe mundësitë e tjera të një jete të begatë në këtë botë do të ofrojnë qetësi dhe lumturi gjithashtu në Botën Tjetër. Ndoshta edhe varrosja e floririt, argjendit, xhevahireve të shtrenjta dhe disa lëndëve ushqimore me të vdekurit është rezultat i këtij besimi.

Kur'ani Fisnik e përforcon më tepër se vetë pasuria dhe fëmija, pa patur parasysh qëndrimin e njeriut ndaj tyre, nuk të ofrojnë tek Allahu[4], si dhe nuk kanë asnjë ndikim dobiprurës dhe përfitues për askënd në Botën Tjetër.[5] Në atë Botë do të ndërpriten marrëdhëniet dhe lidhjet e dynjasë[6] si dhe çdo njeri do të largohet nga pasuritë dhe gjithshka që i përkasin atij.[7]

Të gjithë do të dalin para Allahut të Vetëm.[8] Do të ekzistojnë vetëm marrëdhëniet shpirtërore hyjnore. Për këtë, besimtarët që janë të lidhur me gratë, fëmijët dhe të afërmit e tyre me lidhje të besimit, do të bashkohen së bashku në Xhenet.[9]

Ajo që arrihet është se: Marrëdhënia dhe lidhja mes dynjasë dhe Ahiretit nuk është marrëdhënia mes dukurive të dynjasë. Nuk është siç mund të hamendësohet se kush më i fortë më i kënaqur dhe më i pasur në këtë jetë i tillë do të ringjallet edhe në Jetën Tjetër. Po të ishte çështja e tillë, atëherë Faraoni, Karuni e shumë të tjerë do të ishin më të lumtur në Botën Tjetër.

Por, mund të ketë njerëz që jetojnë të farvër të privuar e të lodhur, mirëpo përshkak të kryerjes së detyarve të Allahut, ata do të ringjallen duke ju ofruar paqja, qetësia, bukuria dhe

4. Sure "Sebe", ajeti 37.
5. Sure "El Shuara", ajeti 88, sure "Lukman", ajeti 33, sure "Al Imran", ajeti 10, 116, sure "El Muxhadele", ajeti 17.
6. Sure "El Bekare", ajeti 166, sure "El Muminun", ajeti 101.
7. Sure "El Enam", ajeti 94.
8. Sure "Merjem", ajetet 80, 95.
9. Sure "El Rra'ad", ajeti 23, sure "Gafir", ajeti 8, sure "El Tur", ajeti 21.

fuqia dhe duke ndjerë kënaqësinë e mirësive të përjetshme në Botën Tjetër.

Disa të paditur hamendësojnë se ajeti i mëposhtëm: **"Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë."**[10], do të thotë se mirësitë e kësaj bote kanë marrëdhënie pozitive me mirësitë e Botës Tjetër. Ata janë të pavetëdijshëm se kuptimi i thënies (i verbër) në këtë ajet. Kuptimi i kësaj fjale nuk është për verbërinë e dukshme që nuk sheh me sy, por kuptimi është për i verbërinë e zemrës, ashtu si është përmendur edhe në ajetin tjetër: **"...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor."**[11]

Dhe: "**Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. Ai do të thotë: "O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?"** (Allahu) **do t'i thotë: "Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar**.[12]

Pra shkaku i verbërisë në atë botë është harrimi i argumentave të Allahut në këtë botë dhe jo verbëria e dukshme. Kështu, marrëdhënia ndërmjet dynjasë dhe Ahiretit nuk është e tipit të marrëdhënieve të shkaqeve dhe shkaktarëve të dynjasë, por e një lloji tjetër.

Mirësitë e kësaj bote nuk tregojnë vuajtje në botën tjetër

Në krahun tjetër disa njerëz besojnë se ekzistojnë marrëdhënie të kundërta ndërmjet mirësive të dynjasë dhe mirësive të Ahiretit. Kënaqësinë e Ahiretit do ta gëzojë ai që u janë mohuar kënaqësitë e kësaj bote. E kundërta e kësaj është se kush ka qenë i lumtur dhe i janë ofruar kënaqësitë e

10. Sure "El Isra", ajeti 72.
11. Sure "El Haxh", ajeti 46.
12. Sure "Ta Ha", ajetet 124-126.

dynjasë do t'i mohohet lumturia në Botën Tjetër. Për këtë, ata janë mbështetur në disa ajete dhe transmetime që tregojnë se apasionuesit e dynjasë nuk do të kenë pjesë në Ahiret.[13]

Ata janë të pavëmendshëm se kërkimi i dynjasë dhe dhënia pas saj nuk do të thotë ofrimi i mirësive të dynjasë, por kërkuesi i dynjasë është ai person i cili i bën kënaqësitë e dynjasë qëllim të veprave dhe veprimtarisë së tij. Ai shpenzon gjithë fuqitë e tij në rrugën e arritjes së saj edhe nëse nuk i narrin ato kënaqës.

Ndërsa kërkuesi i Ahiretit është ai person i cili nuk lidhet me kënaqësitë e dynjasë. Qëllimi i tij është Ahireti, edhe pse i ofrohen shumë prej kënaqësive të kësaj bote. Shembull është Sulejmani dhe shumë profetë të tjerë dhe evlija të Allahut (paqja e Allahut qoftë mbi ta!), të cilëve iu ofruan kënaqësitë e kësaj bote dhe mirësitë e saj, por ata i investuan në rrugën e realizimit të lumturisë së Ahiretit dhe të kënaqësisë së Allahut.

Pra nuk ekziston ndërmjet ofrimit të kënaqësive të dynjasë dhe përfitimit prej mirësive të Ahiretit, marrëdhënie pozitive dhe as në marrëdhëniet negative. Mirësitë e kësaj bote si dhe sprovat e saj janë ndarë ndërmjet njerzve mbi bazën e urtësisë hyjnore.[14] Të gjitha i ka bërë mjete të sprovës të njerzve dhe provimit të tyre.[15]

Sigurimi i të mirave materiale apo mossigurimi i tyre nuk tregon në vetvete afrimitetin në mëshirës hyjnore apo largimin prej saj, si dhe në vetevete nuk çon drejt lumturisë apo vuajtjeve të Ahiretit.[16]

13. Sure "El Bekare", ajeti 200, sure "Al Imran", ajeti 77, sure "El Isra", ajeti 18, sure "El Shura", ajeti 20, sure "El Ahkaf", ajeti 20.
14. Sure "El Zuhruf", ajeti 32.
15. Sure "El Enfal", ajeti 28, sure "El Enbija", ajeti 35, sure "El Tegabun", ajeti 15, sure "El Araf", ajeti 168, sure "El Kehf", ajeti 7, sure "El Maide", ajeti 48, sure "El Enam", ajeti 165, sure "El Neml", ajeti 40, sure "Al Imran", ajeti 186.
16. Sure "Al Imran", ajeti 179, sure "El Muminun", ajeti 56, sure "El Fexhr", ajetet 15-16.

Rezultati

Rezultati në të cilin arritëm nëpërmjet këtyre hulumtimeve është: Mohimi i çdo lidhjeje nga lidhjet e dynjasë me Ahiretin është në të njëjtën gradë me mohimin e Ringjalljes. Por kjo nuk do të thotë se ekziston ndonjë lidhje ndërmjet mirësive të dynjasë dhe mirësive të Ahiretit dhe as mes mirësive të dynjasë dhe dënimit të Ahiretit ose e kundërta.

Thënë në mënyrë të përgjithshme: Marrëdhëniet ndërmjet dynjasë dhe Ahiretit nuk janë nga lloji i marrëdhënieve të dukurive të dynjasë që t'i nënshtrohen ligjeve fizike dhe biologjike. Ajo që na ofron lumturinë ose ndëshkimin në Ahiret janë veprat përzgjedhëse të njeriut në këtë botë. Kjo nuk do të thotë derdhja e fuqisë dhe energjive për të gjetur disa ndryshime tek lëndët, por shkaku i veprimit të tyre nga besimi ose mosbesimi i brendshëm.

Ky është treguesi i qindra ajeteve kur'anore. Ato përforcojnë se furnizuesi i lumturisë në Ahiret është peng i besimit tek Allahu, Ditës së Gjykimit, profetëve të Allahut, kryerjes të veprave të cilat e kënaqin Allahun si psh. namazi, agjërimi, xhihadi (lufta e shenjtë), sadakaja, mirësia me robtë e Allahut, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, lufta kundër jobesimtarëve dhe idhujtarëve, zbatimi i drejtësisë.

Ato përforcojnë gjithashtu se sprovimi me dënim të përjetshëm shkatohet nga mosbesimi, idhujtaria, hipokrizia, mohimi i kiametit, përgënjeshtrimi i profetëve, kryerja e gjynaheve të ndryshme dhe padrejtësitë. Ajete të shumta përforcojnë në mënyrë të përmbledhur se faktori i lumturisë në Ahiret është (besimi dhe kryerja e veprave të mira)[17] dhe

17. Sure "El Bekare", ajetet 25, 38, 62, 82, 103, 112, 277, sure "Al Imran", ajetet 15, 57, 114-115, 133, 179, 195, 198, Sure "El Nisa", ajetet 13, 57, 122, 124, 146, 152, 162, 163, sure "El Maide", ajetet 9, 65, 69, sure "El Enam", ajeti 48, sure "El Teube", ajeti 72, sure "Junus", ajetet 4, 9, 63, 64, sure "El Rad", ajeti 29, sure "Ibrahim", ajeti 23, sure "El Nahl", ajeti 97, sure "El Kehf", ajeti 2, 29-30, 107, sure "Taha", ajeti 75, sure "El Haxh", ajetet 14, 23, 50, 56, sure "El Furkan", ajeti 15, sure "El Ankebut", ajetet 7, 9, 58,

faktori i vuajtjes së përjetshme është mosbesimi dhe veprat e ndaluara.[18](223).

Pyetje:

1. Cili është kundërshtimi ndaj mohimit të marrëdhënieve mes dynjasë dhe Ahiretit?
2. Sqaro kuptimin e kësaj fjalie: Dynjaja është fushëmbjellje për Ahiretin.
3. Cila është lidhja mes mirësive të dynjasë dhe mirësive të Ahiretit?
4. Cila është lidhja mes mirësive të dynjasë dhe dënimit të Ahiretit?
5. Cilat janë ato çështje të kësaj bote në të cilat gjendet lidhje e vërtetë mes tyre dhe lumturisë apo vuajtjes në Ahiret?

---

sure "El Rrum", ajeti 15, sure "Lukman", ajeti 8, sure "El Sexhde", ajeti 19, sure "Sebe", ajetet 4 , 37, sure "Fatir", ajeti 7, sure "Sad", ajeti 49, sure "El Zumer", ajetet 20, 33-35, sure "Gafir", ajeti 40, sure "Fusilet", ajeti 8, sure "El Shura", ajetet 22, 26, sure "El Xhathije", ajeti 30, sure "El Fet'h", ajeti 17, sure "El Hadijd", ajetet 12, 21, sure "El Tegabun", ajeti 9, sure "El Talak", ajeti 11, sure "El Inshikak", ajeti 25, sure "El Buruxh", ajeti 11, sure "El Tijn", ajeti 68, sure "El Bejine", ajetet 7-8.

18. Sure "El Bekare", ajetet 24, 39, 81, 87, 104, 161-162, sure "Al Imran", ajetet 21, 56, 86-88, 91, 116, 167, 177, 196-197, sure "El Nisa", ajetet 14, 56, 145, 151, 161, 168-173, sure "El Maide", ajetet 10, 36, 72, 86, sure "El Enam", ajeti 49, sure "El Teube", ajetet 3, 68, sure "Junus", ajetet 4, 8, sure "El Rra'ad", ajeti 5, sure "El Kehf", ajetet 105-106, sure "El Haxh", ajetet 19, 57, 72, sure "El Furkan", ajeti 11, sure "El Neml", ajetet 4-5, sure "El Ankebut", ajeti 23, sure "Sad", ajeti 55, sure "El Zumer", ajeti 32, sure "Gafir", ajeti 6, sure "El Shura", ajeti 26, sure "El Xhathije", ajeti 11, sure "El Fet'h", ajetet 13, 17, sure "El Hadijd", ajeti 19, sure "El Muxhadele", ajeti 5, sure "El Tegabun", ajeti 10, sure "El Mulk", ajeti 6, sure "El Inshikak", ajetet 22-24, sure "El Gashije", ajetet 23-24, sure "El Bejine", ajeti 6.

Leksioni i pesëdhjetëetretë

LLOJI I MARRËDHËNIEVE MES DYNJASË DHE AHIRETIT

Hyrje

Më parë mësuam se ekzistojnë lidhje të drejtpërdrejta pozitive mes besimit dhe veprave të mira nga njëra anë dhe mes afrimitetit te Allahu dhe kënaqësive të Ahiretit nga ana tjetër. Gjithashtu, ka lidhje mes mosbesimit dhe kundërshtimit nga njëra anë dhe mes largimit nga Allahu dhe ndalimit të kënaqësive të Ahiretit nga tjetër.

Po ashtu, ekzistojnë lidhje të kundërta mes besimit dhe veprave të mira me dënimin në Botën Tjetër, si dhe mes mosbesimit dhe kundërshtimit me kënaqësitë e përjetshme. Ajo që nuk pranon dyshim dhe mëdyshje është se edhe Kur'ani Fisnik i pohon e i dëshmon këto lidhje dhe marrëdhënie. Mohimi i këtyre lidhjeve dhe marrëdhënieve do të thotë mohim i Kur'anit Fisnik.

Mirëpo, nga kjo temë dalin disa çështje të rëndësishme që kanë nevojë për më shumë studim dhe sqarim, si psh., a janë ato marrëdhënie të përmendura të vërteta të krijuara apo janë të vendosura?

Cila është marrëdhënia mes besimit dhe veprave të mira, gjithashtu mes mosbesimit dhe kundërshtimit? A ka ndikim mes vetë veprave të mira dhe veprave të këqijave?

Në këtë leksion do të studiojmë çështjen e parë, për të sqaruar se marrëdhëniet e përmendura janë të krijuara.

Marrëdhënie e vërtetë apo kontraktore?

Disa herë e kemi theksuar se marrëdhëniet ndërmjet veprave të dynjasë dhe kënaqësive ose dënimit të Ahiretit janë prej marrëdhënieve të njohura materiale. Ato marrëdhënie nuk mund të komentohen mbi bazën e ligjeve fizike dhe kimike ose të tjera të ngjashme. Jo vetëm kjo, por kushdo që beson apo hamendëson se fuqitë dhe energjitë e harxhuara në kryerjen e veprave njerëzore do të trupëzohen në Ahiret, sipas teorisë së dryshimit të lëndës në fuqi dhe e kundërta, dhe se në Ahiret do të shfaqen në formën e mirësisë ose dënimit, ai është një besim i gabuar për arsyet e mëposhtme:

E para: Fuqia që përdori njeriu në fjalët dhe veprat e tij, ndoshta nuk mund të shndërrohet as edhe një mollë të vetme, e jo të shndërrohen në mirësi të Xhenetit, të cilat nuk numërohen dhe as nuk llogariten.

E dyta: Kthimi i lëndës në fuqi dhe e kundërta realizohet në bazë të faktorëve të veçantë të përcaktuar dhe nuk ka asnjë lidhje me veprat e mira dhe të këqija, as me qëllimin e vepruesit. Nuk mund të bëhet dallimi mes veprave që burojnë nga sinqeritetti dhe atyre që burojnë nga burrja, bazuar tek ndonjë ligj i natyrës, derisa fuqia e njërës të shndërrohet në mirësi dhe fuqia e tjetrës në dënim.

E treta: Fuqia, e cila është përdorur një herë në rrugën e adhurimit, mund të përdoret edhe një herë tjetër në rrugën e kundërshtimit e të mëkatit.

Mohimi i këtyre marrëdhënieve nuk do të thotë mohim i plotë i marrëdhënieve të vërteta. Hapësira e marrëdhënieve të vërteta përfshin gjithashtu edhe ato marrëdhënie të fshehta, të cilat nuk i nënshtrohen eksperimentit. Ashtu si dituritë eksperimentale nuk mund të vërtetojnë marrëdhëniet e shkaktare mes dukurive të dynjasë dhe Ahiretit, gjithashtu ato dituri nuk mund mohojnë asnjë lloj prej llojeve të marrëdhënieve ndërmjet shkakut dhe pasojës dhe as nuk imponon ndikimin e veprave të mira apo të këqija në shpirtin e njeriut.

Argumentët kur'anorë

Ajetet kur'anore tregojnë më së tëpërmi ekzistencën e marrëdhënies së krijuar. Por, në shumë ajetet kuptohet edhe prania e marrëdhënieve të venndosura, siç janë ajetet të cilat përmbledhin dhe flasin mbi shpërblimin dhe ndëshkimin.[1]

Nga ajetet e tjera mund të përfitojmë se marrëdhënia ndërmjet veprave të njeriut, shpërblimin apo ndëshkimit në Ahiret, i tejkalojnë marrëdhëniet e krijuara *(tekuinijeh)*. Nga këtu mund të thuhet se thëniet e grupit të parë prej ajeteve kanë ardhur për të lehtësuar kuptimin dhe për thjeshtësimin e tij, si dhe për të ruajtur kuptimin shumicës së njerzve, të cilët janë mësuar më së shumti këto kuptime.

Gjithashtu, në transmetim vërejmë dëhmi të shumta të cilat tregojnë se veprat njerëzore përzgjedhëse kanë forma të ndryshme që do të paraqiten në botën e Berzahut dhe Ditën e Kiametit.

Tani do të paraqesim disa shembuj nga ajetet kur'anore të cilat tregojnë për praninë e marrëdhënieve të vërteta ndërmjet veprave të njeriut dhe rezultateve të tyre në Ahiret:

"...Çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj, do ta gjeni tek Allahu."[2]

"(Kini frikë) **ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe."**[3]

"...Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij..."[4]

"kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."[5]

1. Në Kur'anin Fisnik, fjala shpërblim (el exhr), është përdorur rreth nëntëdhjetë herë, ndërsa fjala ndëshkim (el xhezau) së bashku me fjalët që burojnë nga e njëjta rrënjë, përmendet më shumë se njëqind herë.
2. Sure "El Bekare", ajeti 110, shih gjithashtu sure "El Muzemil", ajeti 20.
3. Sure "Al Imran", ajeti 30.
4. Sure "El Nebe", ajeti 40.
5. Sure "El Zelzele", ajetet 7-8.

"...Ju do të shpërbleheni veç për atë që keni bërë!"[6]

"Vërtet, ata që shpenzojnë pasurinë e jetimit pa të drejtë, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në zjarrin flakërues."[7]

Është mëse e natyrshme, se vetëm shikimi i punëve nga njeriu në Ditën e Kiametit se çfarë ka vepruar në dynja, nuk është në vetvete shpërblim ose ndëshkim për to. Porse pamje melekutije e këtyre veprave do të shfaqen në atë ditë prej mirësive dhe dënimit dhe se njeriu do të shpërblehet ose do të ndëshkohet, sikurse përfitohet nga ajeti i fundit që thotë se pamja e brendshme e të ngrënit të pasurisë së jetimit është ngrënia e zjarrit.

Kur të shfaqen dhe zbulohen të vërtetat në Botën Tjetër, njeriu do të shohë se e fshehta e atij ushqimi të ndaluar (ngrënia e pasurisë së jetmit me pa të drejtë) do të jetë zjarri dhe do ta ndjejë djegjen e barkut të tij. Atij do t'i thuhet: Ky zjarr është përshkak të asaj pasurie të ndaluar që hëngre në jetën e dynjasë.

Pyetje:

1. Diskuto komentin mbi trupëzimin e veprave nëpërmjet shndërrimit të fuqive në lëndë gjatë përdorimit për kryerjen e veprave.
2. Si mund të përfytyrohen me një përfytyrim logjik marrëdhëniet e vërteta ndërmjet veprave të njeriut dhe rezultateve të tij në Ahiret?
3. Cilat janë ajetet që tregojnë mbi trupëzimin e veprave? Kush është forma në përdorimin e termave shpërblim dhe ndëshkim e të ngjashme me to?
4. A mund të komentohet trupëzimi i veprave me prezencën e tyre në formën siç u vepruan në dynja? Pse?

6. Sure "El Neml", ajeti 90, sure "El Kasas", ajeti 84.
7. Sure "El Nisa", ajeti 10.

Leksioni i pesëdhjetëekatërt

ROLI I BESIMIT DHE I MOHIMIT NË LUMTURINË DHE VUAJTJEN E PËRJETSHME

Hyrje

Një tjetër çështje është: A është secili prej besimit dhe veprave të mira faktor i pavarur në lumturinë e përjetshme? Apo faktori i lumturisë i përmbledh të dy së bashku ku njëri ndihmon tjetrin në realizimin e lumturisë pa patur asnjëri ndikim veçmas? Gjithashtu, a janë mosbesimi dhe kundërshtimi faktorë të pavarur në dënimin e përjetshëm, apo ky ndikim varet nga bashkimi i të dyjave?

Forma e dytë: Nëse njeriu vetëm ka besuar, ose vetëm ka vepruar vepra të mira, cili do të jetë fundi i tij? Po ashtu, nëse njeriu cilësohet vetëm me mosbesimi, apo vetëm bën gjynahe, cili do të jetë fundi i tij?

Nëse një besimtar kryen shumë gjynahe, ose një jobesimtar kryen shumë vepra të mira, a do të jetë prej banorëve të lumturisë apo prej banorëve të vuajtjeve? Ose: nëse njeriu jeton një periudhë të jetës së tij besimtar i devotshëm dhe kryen vepra të mira dhe pjesën tjetër e kalon në mosbesim dhe kryen gjynahe, atëherë, cili do të jetë përfundimi i tij.

Të tilla çështje kanë filluar hulumtohen që në shekullin e parë hixhri. Disa njerëz siç ishin (havarixhët), besonin se kryerja e gjynaheve është faktor i pavarur në dënimin e përjetshëm. Jo vetëm kaq, kryerja e gjynaheve të çon në mosbesim dhe dalje nga feja (renagatizëm). Kurse një grup tjetër, siç ishin (murxhieh), besonin se mjafton vetëm besimi në lumturinë e përjetshme dhe se kryerja e gjynaheve nuk e dëmtojnë aspak lumturinë e besimtarit.

E vërteta është se jo të gjithë gjynahet të çojnë në mosbesim dhe në vuajtjen e përjetshme edhe pse mundet që shtimi i gjynahehe çon në humbjen e besimit. Në anën tjetër nuk është e vërtetë ideja se me ekzistencën e besimit falen të gjitha mëkatet dhe gjynahet nuk dëmtojnë.

Në fillim të këtij leksioni do të paraqesim sqarimin rreth të vërtetës të besimit dhe mosbesimit. Më pas do të hulumtojmë ndikimin e të tyre në lumturinë dhe vuajtjen e përjetshme. Kurse çështjet e tjera do t'i paraqesim në leksionet e ardhshme.

E vërteta e besimit dhe e mosbesimit

Besimi është gjendje shpirtërore që buron nga dija dhe kuptimi dhe prirja drejt tij. Besimi pranon përsosurinë dhe mangësinë apo edhe dobësinë si rezultat i ndikimit të dy faktorë që janë: dituria dhe prirja. Nëse njeriu nuk e di praninë e diçkaje, edhe sikur të ketë dije të supozuar, nuk mundet ta besojë atë.

Duhet ta dimë se nuk mjafon vetëm dija dhe njohja për të arritur në besim sepse ka mundësi që e njohura apo të domosdoshmet e saj, të jetë në kundërshtim me dëshirat dhe prirjet e tij. Personi mund të priret kundër kësaj gjëje të njohur. Për këtë ai nuk vendos dhe për të punuar një punë dhe ndoshta vepron të kundërtën e asaj që duhet vepruar. .

Në Kur'anin Fisnik flitet rreth faraonëve: **"Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta."**[1]

Musai, (paqja qoftë mbi të!) duke iu drejtuar Faraonit i tha: (Musai) **tha: "Tashmë ti e di se këto nuk i ka shpallur askush tjetër, përveç Zotit të qiellit dhe të Tokës..."** [2]

Megjithëse Faraoni nuk besonte, ai u thoshte njerëzve: **"Dhe Faraoni tha: "O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot <u>përveç meje!</u>..."**[3]

1. Sure "El Neml", ajeti 14.
2. Sure "El Isra", ajeti 102.
3. Sure "El Kasas", ajeti 38.

Porse Faraoni besoi vetëm kur po i afrohej mbytjes. Atëherë ai tha: **"...Besoj se s'ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit..."** [4]

Më parë mësuam se ky lloj besimi i detyruar nuk i pranohet njeriut[5], nëse mund të quhet besim.

Kështu që besimi ngrihet mbi prirjet e zemrës dhe përzgjedhjes në kundërshtim me dijen dhe njohjen. Nisur nga kjo besimi mund të konsiderohet vepër shpirtërore përzgjedhëse. Nëse do të zgjerohemi në kuptimin e veprës, besimin mund ta konsiderojmë prej të vërtetave të veprës.

Përsa i përket termit (mosbesim), nganjëherë përdoret kur nuk posedohet besimi, qoftë nga dyshimi apo nga padituria e thjeshtë *(el xhehlul basijt)*, apo nga padituria e përbërë *(el xhehlul murekeb),* apo nga prirja për të kundërshtuar besimin qëllimisht dhe për kryeneçësi. Herë tjetër mosbesimi veçohet me pjesën e fundit, që është kundërshtimi, kryeneçësia. Dhe kjo pjesë konsiderohet çështje e pranishme kundërshtuese e besimit.

Kufiri i besimit dhe mosbesimit

Nga ajetet kur'anore dhe nga transmetimet e ndryshme përfitohet se kufiri minimal i besimit, i cili nevojitet për të arritur lumturinë e përjetshme, është besimi në Allahu Një, të Vetëm e të Pashoq, besimi në shpërblimin dhe ndëshkimin në Botën Tjetër, besimi në rregullsinë e atyre që u është zbritur profetëve (paqja qoftë mbi ta!). Ky besim obligon që të punohet dhe të veprohet në bazë të mësimeve të Allahut dhe rregullave të Tij. Ndërsa, shkallët më të larta të besimit i përkasin profetëve dhe eulijave të Allahut (paqja qoftë mbi të gjithë ata!).

Kufiri minimal i mosbesimit është mohimi i teuhidit (monoteizmit), i profecisë, i Ringjalljes apo dyshimi në to,

4. Sure "Junus", ajeti 90.
5. Kthehu tek leksioni nëntë.

ose mohimi i një çështjeje që dihet që Allahu ia ka zbritur profetëve. Shkalla më e rrezikshme e mosbesimit është mohimi me kokëfortësi i këtyre të vërtetave, edhe pse i njohin ato, dhe luftimi i fesë të drejtë. Kështu që mohimi i monoteizmit (idhujtaria) është prej të vërtetave të mosbesimit. Hipokrizia është mosbesim *(kufr)* i brendshëm i shoqëruar me mashtrim dhe shtirje në shfaqjen e Islamit.

Hipokriti (jobesimtari i maskuar) do të marrë dënimin më të ashpër nga gjithë jobesimtarët. Ashtu si ka thënë edhe Kur'ani Fisnik: **Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit…"**[6]

Vërejtja e cila ka nevojë për përforcim është: Besimi (Islami) ose mosbesimi, të cilin e studion Jurisprudenca *(fikhu)* dhe që është tematikë e disa rregullave si përshembull: pastërtia e mishit të therur dhe hallakë i tij, lejimi i martesës, trashëgimia, apo ndalimi i saj nuk është si besimi ose mosbesimi që studiohet në parimet e fesë. Ka mundësi që dikush, edhe pse nuk beson me zemër në përmbajtjen e teuhidit, të profecisë dhe domosdoshmëritë e tyre, por ai shqipton dy dëshmitë dhe zbaton rregullat e jurisprudencës islame.

Vërejtja tjetër është se nëse njeriu nuk zotëron fuqinë e njohjes së parimeve të fesë për arsye të ndryshme si përshembull, është i çmendur, ka humbur kujtesën, ose nuk mundësi të njihet me fenë e vërtetë si rezultat i kushteve në të cilat jeton, atëherë ky njeri është i justifikuar për aq sa nuk ka mundësi.

Porse, kur njeriu është në gjendje dhe e ka mundësinë e fitimit të njohjes dhe të dijes por ai neglizhon dhe qëndron në gjendjen e dyshimit, ose kundërshton parimet e fesë dhe domosdoshmëritë e saj pa ndonjë argument, ai nuk është i justifikuar dhe do të ndëshkohet në dënimin e përjetshëm.

6. Sure "El Nisa", ajeti 145.

Ndikimi i besimit dhe i mosbesimit në lumturinë dhe në vuajtjen e përjetshme

Duke vërejtur të vërtetën se përsosuria e vërtetë njerëzore realizohet në hijen e afrimit te Allahu dhe se rënia e njeriut dhe shkatërrimi i tij janë rezultat i largimit nga Allahu i Madhëruar, arrijmë në përfundimin se besimi në Allahun e Madhëruar dhe në cilësitë e Tij, në ringjalljen dhe në profetësi mund t'i konsiderojmë si pemën e vërtetë të përsosurisë së njeriut. Ndërsa veprat e pëlqyera tek Allahu janë degët dhe gjethet.

Frutat e saj janë lumturia e përjetshme e cila shfaqet në Botën Tjetër. Pra, në qoftë se njeriu nuk mbjell në zemrën e tij farën e besimit dhe nuk e mbjell këtë bimë të begatë, por në vendin e saj mbjell farat e mosbesimit dhe të kundërshtimit helmuese për zemrën e tij, vërtet, ky njeri i ka humbur mirësitë e Allahut, frutet e pemës së mbjellë do të jenë ushqim xhehenemi.

Një njeri i tillë i devijuar, nuk ka rrugë që të ecë drejt lumturisë së përjetshme dhe as veprat e tij të mira nuk e kalojnë kufirin e kësaj jete.

Sekreti i gjithë kësaj është se çdo vepër përzgjedhëse konsiderohet lëvizje për shpirtin në drejtim të qëllimit që ka vepruesi.

Kush nuk beson në Botën e përjetshme dhe në afërsinë te Allahu, si mund ta dëshirojë këtë qëllim dhe ta përfytyrojë atë? Si mund t'i drejtojë veprat e tij në këtë drejtim? Natyrshëm që një person i tillë nuk mund të presë që të marrë shpërblimin e përjetshëm nga Allahu i Madhëruar.

Qëllimi i mundshëm i pranimit të veprave të mira që bëjnë jobesimtarët është se ato vepra mund të ndikojnë në lehtësimin e dënimit të tyre. Është e mundur që këto vepra të çojnë në zbutjen e shpirtit të kryeneçësisë dhe në mosadhurimin e vetvetes.

Argumente kur'anore

Vëmë re se Kur'ani Fisnik e përforcon faktin se besimi është një faktor bazë dhe ndikon në lumturinë e përjetshme të njeriut. Në shtesë të dhjetra ajeteve në të cilat përmendet puna e mirë pas besimit, në disa ajete të tjera Kur'ani e konsideron besimin kusht në ndikimin e veprave të mira në lumturinë e përjetshme të njeriut. Kur'ani thotë: **"Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi."**[7]

Kjo në njërën anë. Ndërsa në anën tjetër shohim se Kur'ani Fisnik na tregon se Allahu i Madhëruar ka përgatitur Xhehenemin dhe ndëshkimin e përjetshëm për jobesimtarët. Veprat e tyre të gabuara i konsideron si pemë pa fryte dhe i ngjason veprat e tyre me rërën, kokërrizat e së cilës fluturojnë dhe përhapen nga era e fortë duke mos lënë asnjë gjurmë:

"Vepra e atyre, që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbja e madhe."[8]

Në një ajet tjetër, Kur'ani Fisnik thotë se veprat e jobesimtarëve do të jenë në Ditën e Gjykimit si pluhuri në hapësirë: **"Dhe Ne do t'u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t'i shndërrojmë në pluhur e hi."**[9]

Një ajet tjetër e ka krahasuar me mirazhin të cilin e sheh i eturi nga larg por kur afrohet nuk sheh asgjë dhe nuk gjen ujë. **"Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë. Aty do të hasë në dënimin e Allahut, i Cili ia paguan llogarinë e tij të plotë, se Allahu**

7. Sure "El Nisa", ajeti 124. Shih gjithashtu: sure "El Nahl", ajeti 87, sure "El Isra", ajeti 19, sure "Taha", ajeti 112, sure "El Enbija", ajeti 94, sure "Gafir", ajeti 40.
8. Sure "Ibrahim", ajeti 18.
9. Sure "El Furkan", ajeti 23.

është i shpejtë në llogari."[10]

Dhe: **Ose janë si errësirat në detin e thellë, të cilat mbulohen nga dallgët që ngrihen njëra mbi tjetrën, duke pasur sipër tyre retë: shtresa errësire njëra mbi tjetrën, aq sa kur e nxjerr dorën e vet, njeriu pothuajse nuk e sheh fare atë. Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më dritë.**[11]

Në ajete të tjera theksohet se kërkuesit e dynjasë do të marrin atë që kërkuan në këtë jetë, porse në Botën Tjetër nuk do të kenë asgjë sepse ato që vepruan nuk do t'u sjellin dobi. Kur'ani thotë: **"Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t'ua shpërblejmë krejtësisht punët e tyre dhe në të nuk do t'u lihet gjë mangët. Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrgjë, përveç zjarrit. Do t'u shembet çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë dhe do t'u zhvlerësohet ajo që kanë punuar."**[12]

Pyetje:

1. Sqaro mendimin e Havarixhëve dhe Murxhive në fushën e besimit dhe mosbesimit. Sqaro të vërtetën që qëndron përballë këtyre dy mendimeve.

2. Trego të vërtetën e besimit dhe mosbesimit dhe marrëdhëniet e tyre me dijen dhe padijen.

3. Trego kufirin e domosdoshëm të besimit dhe mosbesimit.

4. Sqaro marrëdhëniet e idhujtarisë dhe hipokirizisë me mosbesimin.

5. Cili është raporti i Islamit dhe mosbesimit legjislativ (fikhij) me besimin dhe mosbesimin në apologji (kelamij).

6. Sqaro ndikimin e besimit dhe mosbesimit në lumturinë dhe vuajtjen e përjetshme.

7. Përmend argumenta kur'anorë rreth këtij ndikimi.

10. Sure "El Nur", ajeti 39.
11. Sure "El Nur", ajeti 40.
12. Sure "Hud", ajetet 15-16. Shih gjithashtu: sure "El Isra", ajeti 18, sure "El Shura", ajeti 20, sure "El Ahkaf", ajeti 20.

Leksioni i pesëdhjetëepestë

MARRËDHËNIA E NDËRSJELLTË MES BESIMIT DHE PUNËS

Hyrje

Më parë mësuam se dy faktorët bazë të lumturisë dhe vuajtjes së përjetshme të njeriut janë besimi dhe kufri (mosbesimi). Mësuam gjithashtu se besimi i palëkundur dhe i vazhdueshëm siguron arritjen e lumturisë së përjetshme. Edhe pse kryerja e gjynaheve ndikon që njeriu të ndëshkohet, nga ana tjetër, mosbesimi (*kufr*) i përhershëm çon në ndëshkimin e përhershëm. Me ekzistencën e këtij kufri, asnjë vepër e mirë nuk mund të ndikojë në lumturinë e përjetshme.

Gjithashtu, thamë se besimi dhe mosbesimi kanë aftësinë e forcimit dhe të dobësimit. Është e mundshme që shtimi i gjynaheve të çojë në rënien e besimit, dobësimin e tij deri në humbjen e tij. Po ashtu, veprat e mira mund të çojnë në dobësimin e rrënjëve të mosbesimit dhe ndoshta mund të përgatisin rrugën drejt besimit.

Prej këtu shfaqet një pyetje e rëndësishme rreth marrëdhënieve ndërmjet besimit dhe punës, përgjigjen e së cilës do të përpiqemi ta sqarojmë në këtë leksion.

Marrëdhënia e besimit me punën

Më sipër u qartësua se besimi është gjendje shpirtërore që buron nga dituria dhe prirja. Është e nevojshme që nga ky besim, besimtari të ketë qëndrueshmëri dhe këmbëngulje përgjithësuese për të vepruar domosdoshmëritë e asaj që beson. Bazuar në ato që thamë më sipër, kush e njeh të vërtetën, por

vepron në kundërshtim me cilëndo domosdoshmëri të asaj të vërtetë, në realitet nuk beson në të. Edhe sikur të luhatet në veprimin e saj, nuk beson siqerisht në atë të vërtetë. Kur'ani thotë: **"Arabët e shkretëtirës deklarojnë: "Ne besojmë". Thuaju: "Ju nuk keni besuar! Por më mirë thoni: 'Ne përulemi', pasi besimi ende nuk ka hyrë** (si duhet) **në zemrat tuaja. E, nëse i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk do t'ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja. Sigurisht, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**[1]

Besimi i vërtetë ka grada dhe shkallë por çdo gradë dhe shkallë nuk janë në përshtatshëmri të përhershme me veprat dhe deyrat të cilat i kërkon besimi. Ndoshta disa reagime epshore dhe zemëruese çojnë në dobësimin e besimit dhe në kryerjen e gjynahut. Mirëpo kjo nuk arrin deri në gradën e kundërshtimit të përhershëm dhe kundërshtimit të të gjitha detyrave dhe obligimeve të cilat dalin nga besimi. Është e qartë se sa më i fortë dhe më i përsosur të jetë besimi aq më ndikues do të jetë në praktikimin e veprave që i përshtaten atij.

Thënë shkurtimisht: Besimi në vetvete obligon vepra që i përshtaten atij. Shkalla e ndikimit të tij i nënshtrohet forcisë ose dobësisë sëbesimit. Si përfundim, vullneti i njeriut dhe vendosmëria e tij përcaktojnë kryerjen apo jo të një vepre.

Marrëdhënia e punës me besimin

Vepra e zgjedhur ose është e mirë dhe në përshtatje me besimin, ose është jo e mirë dhe në kundërshtim me besimin. Në pamjen e parë, këto lloj veprash kanë ndikim në forcimin e besimit dhe ndriçimin më të madh të zemrës. Në pamjen e dytë, veprat çojnë edhe në dobësimin e besimit dhe errësimin e zemrës. Nisur nga kjo themi se veprat e mira që kryen besimtari, të cilat burojnë nga besimi i tij, ato e shtojnë dhe e shumëfishojnë fuqinë e besimit dhe qëndrueshmërinë e tij,

1. Sure "El Huxhurat", ajeti 14.

si dhe hapin rrugën dhe stimulojnë për kryerjen e veprave të tjera të mira. Në një ajet të Kur'anit mund të përfitojmë rreth kësaj çështjeje: **"...Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë..."**[2]

Gjithashtu në ajete të tjera ka përforcuar rritjen dhe shtimin e besimit punëmirëve dhe të dritës e udhëzimit tyre.[3]

Në anën tjetër, nëse do të gjenden shkaqe dhe shtysa që janë në kundërshtim me ato që thërret besimi dhe e shtyjnë njeriun të kryejë vepra jo të mira dhe fuqia e besimit të tij nuk është në atë gradë që ta mbrojë atë nga kryerja dhe shfaqja e veprave të këqija, atëherë besimi i tij do të vazhdojë të dobësohet.

Në këtë mënyrë atij do t'i ofrohet ambjenti për kryerjen e gjynaheve të reja dhe përsëritjen e tyre. Në qoftë se njeriu do të vazhdojë në këtë gjendje, atëherë kjo gjendje do ta çojë drejt kryerjes së gjynaheve të mëdhaja dhe përsëritjes të tyre. pastaj, ky njeri gjynahqar do të vazhdojë të rrëzohet dhe të bjerë derisa të kërcënohet besimi i tij dhe të ndryshohet në mosbesim (kufr) dhe hipokrizi.

Kur'ani Fisnik na tregon për ata të cilët përfunduan në hipokrizi: **Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, deri në ditën kur do të dalin para Tij, sepse e shkelën premtimin dhënë Allahut. Ata e kishin zakon gënjeshtrën.**[4]

Dhe: **"Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe** (Xhehenemi)**, ngase i mohonin shpalljet e Allahut dhe talleshin me to."**[5]

Në ajete të shumta Kur'ani e përforcon dhe e dëshmon shtimin e mosbesimit, errësirës dhe ashpërsisë te jobesimtarët[6]

2. Sure "Fatir", ajeti 10.

3. Sure "Al Imran", ajeti 173, sure "El Enfal", ajeti 2, sure "El Teube", ajeti 124, sure "El Kehf", ajeti 13, sure "Merjem", ajeti 76, sure "El Ahzab", ajeti 22, sure "Muhamed", ajeti 17, sure "El Mudethir", ajeti 31.

4. Sure "El Teube", ajeti 77.

5. Sure "El Rrum", ajeti 10.

6. Sure "El Bekare", ajeti 10, sure "Al Imran", ajeti 90, sure "El Nisa", ajeti 137, sure "El Maide", ajeti 68, sure "El Teube", ajeti 37, sure "El Isra", ajetet 60, 82, sure "El Saf", ajeti 5, sure "Nuh", ajetet 24-27.

Konkluzioni

Duke vërejtur marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet besimit dhe punës dhe ndikimin e tyre në lumturinë e njeriut, ne mund ta krahasojmë jetën e lumtur me një pemë[7]rrënjët e saj janë besimi në Zotin Një, në Profetët e Zotit dhe në Librat e Tij, në Ditën e Gjykimit, në shpërblimin dhe ndëshkimin e Allahut. Trungu i saj është vendosmëria dhe këmbëngulja për kryerjen e punëve brenda kufijve të besimit. Ky trung mbin prej kësaj vendosmërie dhe këmbënguljeje pa ndërmjetës. Degët dhe gjethet e kësaj peme janë veprat e mira të cilat dalin nga rrënjët e besimit. Kurse frutat e saj janë lumturia e përjetshme. Në qoftë se nuk ekzistojnë rrënjët, nuk do gjendeshin as degët dhe as gjethet dhe nuk do mbarte frutat e kërkuara.

Duhet ta dimë se ekzistenca e rrënjëve nuk ofron gjithmonë ekzistencën e degëve dhe të gjetheve të përshtatshme dhe as marrjen e frytave të kërkuara. Ndonjëherë, si pasojë e faktorëve të ambjentit dhe rrethanave të tij, pema përballet me semundje të ndryshme. Gjithashtu, këta faktorë jo vetëm që nuk ndihmojnë në prodhimtarinë e pemës, por ato çojnë në tharjen e plotë të saj.

Gjithashtu, si shkak i shartimit të degës apo trungut të pemës, ka mundësi që ky shartim të shfaqë ndikime të tjera dhe mund të çojë në ndryshimin e plotë të pemës. Ky është shndërrimi i besimit në mosbesim (*kufr*) që quhet renegat (*irtidad*)

Thënë në formë përmbledhëse: Besimi në çështjet e përmendura është faktori bazë dhe themelor i lumturisë së njeriut. Por ndikimi i plotë i këtij faktori është i kushtëzuar me tërheqjen e lëndëve ushqyese të domosdoshme nëpërmjet veprave të mira dhe me përballimin e sëmundjeve dhe lëndëve të dëmshme që arrihet nëpërmjet largimit nga gjynahet. Po ashtu, moskryerja dhe lënia e obligimeve dhe kryerja e të ndaluarave të çon në dobësimin e rrënjëve të besimit. Jo vetëm

7. Sure "Ibrahim", ajetet 24-27.

kaq, ndoshta çon edhe në tharjen e tyre. Sikurse ndotja dhe besimi në mendimet dhe rrymat e devijuara dhe të humbura çojnë në ndryshimin e thelbit dhe të vërtetës së pemës së besimit të drejtë.

Pyetje:

1. Sqaro ndikimin e besimit në veprat e mira.

2. Shpjego ndikimin e veprave të mira dhe të këqija në forcimin e besimit dhe në dobësimin e tij.

3. Trego llojet e marrëdhënieve të ndërsjellta ndërmjet besimit dhe veprave, si dhe marrëdhëniet e veprave me lumturinë e njeriut.

Leksioni i pesëdhjetëegjashtë

VËZHGIME TË RËNDËSISHME

Hyrje

Ka njerëz të cilët nuk zotërojnë njohjen e mjaftueshme dhe kuptimin e nevojshëm rreth kulturës islame. Ata i vlerësojnë veprat njerëzore bazuar në principe të përcipta dhe të dukshme, pa marrë parasysh rëndësinë e faktorit nxitës dhe të qëllimit të vepruesit. Sikurse thuhet: ata nuk besojnë në mirësinë e vepruesit të këtyre veprave përballë mirësisë vepruese ose ata besojnë se vlera e veprave është e kufizuar me ndikimin e saj në jetën e kësaj bote tek të tjerët.

Të tillë njerëz janë goditur me devijim në komentimin dhe trajtimin e shumë parimeve dhe njohjeve islame. Ndër ato çështje është edhe gabimi i tyre në shpjegimin e rolit të besimit dhe marrëdhëniet e tij me veprat e mira; rolin shkatërrues të kufrit dhe idhujtarisë si dhe shpjegimi i përpasrësisë së disa punëve të vogla të përkohshme mbi veprat e mëdha dhe jetëgjata.

Për shembull, ata besuan se shpikësit e mëdhenj, të cilët ofruan mundësitë e rehatisë dhe qetësisë për të tjerët, ose vepërmirët dhe thirrësit e lirisë, të cilët luftuan në rrugën e lirisë së popujve të tyre, e kanë të domosdoshme të gëzojnë një vend të lartë dhe fisnik në Ahiret, edhe nëse nuk kanë qënë besimtarë dhe nuk e besonin Allahun dhe në Ditën e Gjykimit.

Ndoshta kjo çështje i çoi ata të thonë se besimi i domosdoshëm për lumturinë e vërtetë është besimi në vlerat njerëzore dhe fitimi përfundimtar i punëtorëve përpjekës në këtë dynja. Jo vetëm kaq, ata e konsideruan botëkuptimin (Allah) si botëkuptim vlerash të barabartë me normat morale.

Vërehet se pikat e dobëta dhe devijimi në këto lloj idesh dhe mendimesh, megjithëse u sqaruan në leksionet e kaluara, por për shkak të përhapjes së këtyre ideve të gabuara në kohën tonë dhe përshkak të rrezikshmërisë së tyre për brezat e ardhshëm, e pamë të nevojshme studimin e tyre me pak detaje.

Natyrisht studimi i kësaj çshtjeje në formë të plotë dhe gjithëpërfshirëse kërkon fushë më të gjerë. Do të paraqesim pikat dhe vërejtjet kryesore dimensionet e së cilave i përshtaten programit të këtij libri.

Përsosuria e vërtetë e njeriut

Nëse do të krahasojmë pemën e mollës me një pemë jofrutdhënëse në natyrën e saj është mëse normale se ne do ta konsideronim pemën e mollës me më shumë vlerë dhe më të rëndësishme se pema tjetër jofrutdhënëse. Ky rregull nuk e ka burimin vetëm tek përfitimi më i madh i njeriut nga pema frutdhënëse, porse pema e mollës e fiton vlerën dhe rëndësinë nga qënia e saj më e plotë dhe nga ndikimi i saj më i madh. Mirëpo vetë pema e mollës kur preket nga sëmundjet dhe devijon nga rruga e zhvillimit dhe e rritjes, ajo e humbet vlerën e saj dhe ndoshta do të bëhet shkak për prishjen e pemëve të tjera duke shkaktuar dëme dhe shkatërrime.

Atë që përmendëm rreth pemës munde ta themi edhe për njeriun kur e krahasojmë me krijesat e tjera të gjalla. Kur arrin përsosurinë e përshtatshme për të dhe shfaqen shenjat e ekzistencës që i përputhen natyrës së tij, ai është më i vlefshmi dhe ka më shumë rëndësi se gjithë krijesat e gjalla. Ndërsa, kur atë e godasin sëmundjet dhe devijimet, ai do të bjerë shumë poshtë dhe do të jetë më i dëmshëm se disa kafshë. Kur'ani Fisnik i ka konsideruar disa njerëz më të këqinj[1] dhe më të humbur se kafshët.[2]

1. Sure "El Enfal", ajeti 22.
2. Sure "El Araf", ajeti 179.

Në anën tjetër ata që e shohin pemën e mollës gjatë kohës që ajo lulëzon, hamendësojnë se ky është kulmi i lulëzimit dhe i zhvillimit të saj dhe nuk ka përsosuri më të madhe se kjo. Po ashtu edhe ata të cilët shohin vetëm përsosuritë e mesme të njeriut, e kanë të pamundur të kuptojnë të vërtetën dhe përsosurinë e tij përfundimtare. Sepse, vlera reale dhe e vërtetë e njeriut mund të kuptohet vetëm me njohjen përsosurisë së tij përfundimtare.

Mirëpo, përsosuria e vërtetë e njeriut nuk është e llojit të përsosurisë materiale ose natyrore sepse – ashtu sikurse e sqaruam edhe më parë–, njerëzorja dhe humanizmi i njeriut janë të lidhur me shpirtin që posedon ai.

Përsosuria njerëzore në realitet është përsosuria e vetë shpirtit. Kjo përsosuri arrihet nëpërmjet veprimtarisë dhe kryerjes së veprave përzgjedhëse, qoftë ajo veprimtari e brendshme e me zemër, ose veprimtari e jashtme nëpërmjet organeve të trupit. Është e pamundur njohja e kësaj përsosurie ose përllogaritja e saj nëpërmjet eksperimenteve të prekshme ose parametrave kimike. Është e natyrshme se nuk mund të arrihet në një përfundim rreth përsosurisë nëpërmjet rrugës së eksperimenteve dhe mjeteve eksperimentale.

Për këtë, nëse vetë njeriu nuk arrin në këtë përsosje dhe nuk e kupton atë nëpërmjet dijes hudhrij dhe dëshmisë së zemrës, atëherë është e domosdoshme që ta njohë nëpërmjet rrugës së argumentave logjikë ose nëpërmjet rrugës së Shpalljes dhe Librave qiellorë.

Nisur nga këndvështrimi i Shpalljeve, i Kur'anit Fisnik dhe nga transmetimet e Ehli Bejtit të pastër e të dlirë, nuk ka asnjë dyshim se përsosuria përfundimtare e njeriut është gradë nga gradët e ekzistencës së tij. Ajo është përmendur me thënien (afërsia hyjnore). Shenjat e saj përfaqësohen në ato mirësi të përjetshme dhe kënaqësi hyjnore të cilat do të shihen në Botën Tjetër. Rruga e përgjithshme e asaj përsosurie është adhurimi i Allahut dhe devotshmëria e përgjithshme në të gjitha fushat e jetës personale dhe shoqërore.

Ndërsa nga këndvështrimi logjik, mund të sillen argumenta të ndërlikuara dhe precize mbi këtë të vërtetë, si dhe ka nevojë për shpjegime filozofike të shumta. Ne do të përpiqemi t'i shpjegojmë këtu në formë të thjeshtë.

Shpjegimi logjik

Njeriu është i brumosur në natyrën e tij me dashurinë ndaj përsosurisë së pakufizuar. Ai e konsideron diturinë dhe fuqinë prej dukurive të tij. Arritja në të tillë përsosuri sjell kënaqësi të pakufizuar dhe lumturi të përjetshme. Njeriu e ka të lehtë të arrijë në këtë përsosuri nëqoftëse lidhet shpirtërisht me burimin e diturisë, fuqisë dhe përsosurisë absolute e të pakufizuar që është Allahu i Madhëruar. Kjo lidhje është përshkruar me afrimitet.[3]

Pra, përsosuria e vërtetë e njeriut është qëllimi i krijimit të tij. Kjo përsosuri arrihet në hijen e lidhjes dhe afrimitetit me Allahun e Madhëruar. Ndërsa njeriu, i cili nuk zotëron as shkallët më të ulta të kësaj përsosurie dhe të gradave të saj, pra, shkallën më të dobët të besimt, ai është i njëjtë me pemën që akoma nuk jep asnjë frut. Një pemë e tillë nëse humbet aftësinë e saj për të dhënë fruta, përshkak i prekjes së saj nga disa sëmundje, ajo do të jetë më e pavlerë se pema që në natyrën e saj nuk prodhon fruta.

Rëndësia e ndikimt të besimit në përsosurinë e njeriut dhe lumturinë e tij në njërën anë është cilësi e njeriut dhe veçori bazë për shpirtin e tij. Ajo është lidhje shpirtërore dhe përzgjedhëse me Allahun e Madhëruar. Pa këtë lidhje atij do t'i mohohet përsosuria e përshtatshme, shenjat dhe ndikimet e saj. Thënë ndryshe: Nuk do të arrijë njerëzorja e tij në fazën vepruese. Nëse ky njeri do të bënte përzgjedhje të gabuar ndaj kësaj dhuntie të lartë, ai e ka obliguar veten e tij për të kryer padrejtësitë më të shëmtuara e më të mëdhaja dhe kështu

3. Për t'u zgjeruar më tepër kthehu tek libri: *"Marifetu dhat li binaiha min xhedijd"*.

do ta meritojë dënimin e përjetshëm. Për shembullin e atyre Kur'ani Fisnik thotë: **"Krijesat më të këqija tek Allahu janë ata që mohojnë dhe që nuk do të besojnë."** [4]

Përfundimi: Si besimi edhe mosbesimi përcaktojnë drejtimin bazë të lëvizjes së njeriut: Ose drejtohet kah drejtimi i përsosurisë dhe lumturisë ose kah drejtimi i rënies dhe vuajtjes. Është e natyrshme se i fundit i tyre është ai që zotëron ndikimin përfundimtar dhe rrugëtimin e njeriut.

Roli i faktorëve dhe qëllimi

Nga pamja e parimit të përmendur sqarohet se vlera e vërtetë e veprave të përzgjedhura të njeriut është e lidhur me ndikimin e tyre në arritjen e përsosurisë së vërtetë, që do të thotë afërsia me Allahun e Madhëruar. Ndoshta disa vepra përshkruhen si të mira dhe të sakta si rezultat i ndikimit të tyre në një formë të caktuar.

Duhet theksuar se ndikimi i këtyre veprave në lumturinë e përjetshme të vepruesit të këtyre veprave qëndron në ndikimin e tyre në përsosurinë e shpirtit të tij.

Në anën tjetër, lidhja e veprave të jashtme me shpirt e vepruesit plotësohet nëpërmjet rrugës së dëshirës dhe veprat janë pa ndërmjetës. Kjo dëshirë për të vepruar buron nga prirjet, dashuria për qëllimin dhe rezultati i punës. Ky faktor është ai që krijon lëvizjen në brendësi të shpirtit në drejtim të qëllimit të dëshiruar për t'u kristalizuar në formën e dëshirës për veprim.

Pra, vlera e veprës së vullnetshme i nënshtrohet qëllimit të vepruesit dhe faktorit të tij. Nuk mund të ketë ndikim një veprim i mirë pa patur një veprues të mirë në përsosurinë e shpirtit dhe lumturinë e tij të përjetshme. Për këtë shkak ato vepra të cilat burojnë nga faktorë materialë dhe që janë për këtë dynja, nuk kanë ndikim në lumturinë e përjetshme. Shërbimi më i madh shoqëror nëse buron nga mburrja ato nuk ndikon

4. Sure "El Enfal", ajeti 55.

aspak tek vepruesi.[5] Është e mundur që kjo të çon njeriun në rënien dhe shkatërrimin e tij shpirtëror. Mbi këtë bazë, Kur'ani Fisnik e ka përforcuar dhe dëshmuar se ndikimin i veprave të mira në lumturinë e përjetshme kushtëzohet nga besimi dhe qëllimi për t'u afruar te Allahu (dëshira e afrimit te Allahut dhe kënaqësitë e Tij).[6]

Konkluzioni

• E para: Veprat e mira nuk kufizohen me shërbimin ndaj të tjerëve.

• E dyta: Shërbimet ndaj të tjerëve janë si adhurimet individuale të cilat ndikojnë në përsomërinë përfundimtare dhe lumturinë e përjetshme të vetë vepruesit, nëse veprat e tij burojnë nga faktorët dhe qëllimi hyjnor.

Pyetje?

1. Cila është gjëja që përfaqëson vlerën e vërtetë të çdo ekzistence?
2. Si mund ta njohim përsosurinë përfundimtare të njeriut?
3. Konstato këtë të vërtetë: Përsosuria përfundmtare e njeriut arrihet në hijen e lidhjes dhe afrimit me Allahun e Madhëruar.
4. Konstato këtë të vërtetë: Vërtet, ndikimi i veprave të mira në lumturinë e përjetshme të njeriut është i kushtëzuar me faktorin hyjnor.

5. Sure "El Bekare", ajeti 264, sure "El Nisa", ajetet 38, 142, sure "El Enfal", ajeti 47, sure "El Maun", ajeti 6.
6. Sure "El Nisa", ajeti 124, sure "El Nahl", ajeti 97, sure "El Isra", ajeti 19, sure "Taha", ajeti 112, sure "El Enbija", ajeti 94, sure "Gafir", ajeti 40, sure "El En'am", ajeti 52, sure "El Kehf", ajeti 28, sure "El Rrum", ajeti 38, sure "El Bekare", ajetet 207, 265, sure "El Nisa", ajeti 114, sure "El Lejl", ajeti 20.

Leksioni i pesëdhjetëeshtatë

HUMBJA DHE FALJA E GJYNAHEVE

Hyrje

Prej temave që parashtrohen rreth marrëdhënies së besimit dhe veprave të mira me lumturinë e përjetshme, gjithashtu marrëdhëniet e mosbesimit dhe gjynaheve me vuajtjentë përjetshme është: A janë të ndryshueshme apo të pandryshueshme marrëdhëniet ndërmjet çdo momenti prej momenteve të besimit dhe mosbesimit me rezultatet e Ahiretit?Po ashtu, a janë të ndryshueshme apo jo marrëdhënit e çdo vepre të mirë apo të keqe me shpërblimin dhe ndëshkimin?

Për shembull: A mundet të fshihen shenjat e gjynaheve me vepra të mira? Po kështu e kundërta: A mund të shuhen shenjat e veprave të mira nëpërmjet gjynaheve? A mund të themi se ata të cilët e kaluan një pjesë të jetës së tyre në mosbesim e gjynahe dhe pjesën tjetër në besim dhe bindje, për një periudhë do të përballen me dënimin dhe në një periudhë tjetër do të shpërlehen?Apo ato vepra do të peshohen dhe do të kompensojnë njëra-tjetrën dhe si rezultat i kësaj do të caktohet edhe përfundimi i njeriut, ose lumturi ose vuajtje në botën e përhershme dhe të përjetshme? Apo çështja ka formë tjetër?Kjo çështje në të vërtetë është çështja e "el habtu" humja dhe "el tekfijru", falja e gjynaheve[1] të cilat janë studiuar që në herët nga apologët Esharinj dhe Muatezilë. Ne këtu do të paraqesim shkurtimisht mendimin e Shiitëve mbi këtë temë.

1. Fjala "el habtu" dhe "el tekfijr" janë dy terma kur'anorë. I pari do të thotë mosndikimi i veprave të mira dhe bamirëse dhe e dyta do të thotë falje e gjynaheve.

Marrëdhënia ndërmjet besimit dhe mosbesimit

Në mësimet e kaluara u qartësua se çdo vepër nga veprat e mira dhe të përzgjedhura pa u shoqëruar me besim në parimet e fesë nuk ka asnjë ndikim në arritjen e lumturisë së përjetshme. Thënë ndryshe: Mosbesimi (*kufr*) e ndalon realizimin e ndikimit të veprave të mira. Duhet të shtojmë këtu se besimi i njeriut në fundin e jetës së tij i fshin shenjat e këqija të mosbesimit të kaluar. Shëmbulli i saj është si drita e cila zbardh errësirat e mëparshme. E kundërta e kësaj është se mosbesimi (*kufr*) në fund të jetës i fshin shenjat e besimit të mëparshëm, i nxin faqet e librit të punëve të njeriut e humb dhe e devijon nga udha e drejtë që të jetë si zjarri që bie në lëm dhe gjithçka menjëherë.

Sjellim edhe një shembull tjetër rreth kësaj ideje: Besimi është si llambë që ndriçon fort. Ajo ndriçon shtëpinë e zemrës dhe të shpirtit si dhe largon errësirat prej tyre. Ndërsa kufri është fikia e kësaj llambe. Me fikjen e saj ikën ndriçimi dhe gjenden errësirat. Meqënëse shpirti njerëzor është i lidhur me këtë botë materiale, botën e ndryshimeve dhe trasformimeve, atëherë ai është gjithmonë i ekspozuar para dritës dhe errësirës, fuqisë së dritës e errësirës dhe errësirës së tyre. Por në çastin që kalon nga kjo botë dhe mbyllen para tij dyert e kësaj bote për të përzgjedh mes besimit dhe mosbesimit, sado që të përpiqet që të kthehet edhe një herë në këtë botë për të punuar për largimin e errësirave, kurrë nuk do të ndodhë, sado që të dëshirojë.[2]

Nuk ka asnjë vend për mëdyshje ose dyshim se Kur'ani Fisnik e pohon këtë lloj ndikimi dhe ndikimin mes besimit dhe mosbesimit (*kufrit*). Këtë e tregojnë ajetet e shumta. Prej tyre ajeti 9 i sures "El Tegabun": **"...Atij që beson në Allahun dhe bën vepra të mira, Allahu do t'ia falë gjynahet..."**

Dhe, ajeti 217 i sures "El Bekare": **"...Ata që e mohojnë fenë dhe vdesin si mohues, - veprat e tyre (të mira) do të**

2. Leksioni dyzet e nëntë.

humbasin në këtë botë dhe në tjetrën. Ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë."

Marrëdhënia ndërmjet veprave të mira dhe veprave të gabuara

Atë që përmendëm mbi marrëdhënien ndërmjet besimit dhe mosbesimit mund ta përfytyrojmë edhe ndërmjet veprave të mira dhe të këqija por jo në formë të përgjithshme, ku regjistrohen gjithmonë në librin e njeriut veprat e tij të mira dhe fshihen dhe largohen prej tij veprat jo të mira që ka kryer në të kaluarën ose të regjistrohen gjithmonë veprat e tij të gabuara dhe të fshihen ose të largohen veprat e mira që ka kryer në të kaluarën (siç kanë menduar disa apologë prej Mu'tezilëve).

Të vërtetohet gjithmonë rezultati i arritur në peshoren, bashkimin dhe kompensimin ndërmjet veprave të tij të kaluara duke vërejtur sasinë dhe cilësinë e tyre (siç kanë besuar disa të tjerë).

Në fushën e veprave është e nevojshme të thuhet me detaje si vijon: Ekzistojnë disa vepra të mira. Nëse kryhen në formë të saktë e të pranuar, i fshijnë shenjat e veprave të këqija të kryera më parë siç është pendimi. Nëqoftëse bëhet në formën e kërkuar, atëherë njeriut pendues i falen gjynahet dhe i fshihen punët e këqija.[3] Pedimi i ngjason dritës, e cila i përqëndron rrezet e saj mbi pikën e errët me saktësi që ta ndriçojë atë.

Porse kjo nuk do të thotë se çdo punë e mirë fshin gjurmët e çdo gjynahu. Kështu që ka mundësi që besimtari të sprovohet me ndëshkim për një periudhë e më pas hyn në Xhenetin e përjetshëm. Nga kjo duket sikur shpirti i njeriut përbëhet nga dimensione dhe aspekte të ndryshme dhe çdo grup prej punëve të mira dhe të këqija është i lidhur më një prej këtyre

3. Sure "El Nisa", ajeti 110, Sure "Al Imran", ajeti 135, sure "El En'am", ajeti 54, sure "El Shura", ajeti 25, sure "El Zumer", ajeti 53.

dimensioneve. Psh. vepra e mirë e lidhur me dimensinin A nuk e fshin gjurmën e gjynahet lidhur me dimensionin B, vetëm nëse vepra e mirë ka fuqi, forcë dhe dritë sa të përfshijë edhe pjesët tjera të shpirtit. Ose gjynahu ka arritur në një shkallë aq të madhe të shëmtisë, saqë njollos të gjitha dimensionet e tjera të shpirtit. Në shumë transmetime është përcjellë se namazi i pranueshëm i pastrojnë gjynahet dhe bëhet shkak për faljen e tyre. Në Kur'anin Fisnik thuhet: **"Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija..."**[4]

Disa gjynahe siç është keqtrajtimi i prindërve, pirja e alkolit, për një kohë pas kryerjes së tyre, ndalojnë pranimin e adhurimeve, ose dhënia e sadakasë me qëllim fyerjeje, e prish shpërblimin sikurse e përmend Kur'ani Fisnik: **"O ju që keni besuar! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato** (atyre që ua keni dhënë) **dhe duke fyer..."**[5]

Përcaktimi i llojeve dhe sasisë së ndikimit të veprave të mira dhe të këqija tek njëra-tjetra, është e domosdoshme ta njohim nëpërmjet Shpalljes dhe transmetive të pagabueshmëve (paqja qoftë mbi ta!) dhe është e pamundur vendosja e një rregulli të përgjithshëm për të gjitha veprat.

Në përfundim të këtij leksioni është e nevojshme të theksohet se ndoshta veprat e mira dhe të këqija ndikojnë në veprat e tjera në këtë botë për të keq ose për të mirë. Theksojmë se sjellja e mirë ndaj të tjerëve dhe veçanërisht ndaj prindërve dhe të afërmve, ndikon në zgjatjen e jetës si dhe në largimin e sëmundjeve dhe sprovave. Mosrespektimi i të moshuarve, i të mëdhenjve dhe veçanërisht i mësuesve dhe edukatorëve ka ndikim negativ në arritjen e rezultateve. Por, arritja e këtyre ndikimeve në këtë botë nuk do të thotë se njeriu ka marrë në formë të plotë shpërblimin apo ndëshkimin e tij sepse vendi ku do të merret shpërblimi apo ndëshkimi është Bota Tjetër.

4. Sure "Hud", ajeti 114.
5. Sure "El Bekare", ajeti 264.

Pyetje:

1. Sqaro kuptimin e termave *"el habt"*, humbje dhe *"et tekfijr"* dhe falje gjynahesh.

2. Cilat janë format të cilat mund të përfytyrohen marrëdhëniet ndërmjet besimit dhe mosbesimit (*kufr*)? Cila është forma e saktë prej tyre?

3. Cilat janë format të cilat mund të supozohen në marrëdhëniet ndërmjet veprave të mira dhe të këqija? Cila është forma më e saktë prej tyre?

4. Vallë, ndikimet në këtë botë të veprave të mira apo të këqija a e marrin pozitën e shpërblimit dhe ndëshkimit në Botën Tjetër apo jo?

Leksioni i pesëdhjetëetetë

VEÇORITË E BESIMTARËVE

Hyrje

Në studimin lidhur me monotetizmin (Teuhidi)[1] na u qartësua se vullneti i Allahut është i lidhur (esalaten) me mirësitë dhe përsosuritë, ndërsa të këqijat dhe mangësitë lidhen me vullnetin e Allahut (tetebuan). Është natyrshme se vullneti i Allahut në çështjen e njeriut është i lidhur (esalaten) me përsosurinë e tij dhe arritjen e tij në lumturinë e përjetshme, si dhe me furnizimin e tij me mirësi të përjetshme.

Ndërsa ndëshkimi i gjynahqarëve dhe dënimin e tyre, që burojnë nga veprat e tyre të gabuara që vetë i përzgjedhën, vullneti i urtë i Allahut është lidhur me to tetebuan. Nëse sprova me ndëshkim dhe vuajtje në ahirte nuk do të ishin çështje të domosdoshme për zgjedhjen e tyre, atëherë mëshira e pakufishme e Allahut do të bënte që asnjë krijesë të mos sprovohej me dënim.

Duhet thënë se vetë mëshira e pakufishme e Allahut ka gjykuar krijimin e njeriut me veçorinë dhe dallimin e përzgjedhjes. Është e nevojshme zgjedhja e një prej dy rrugëve: Ruga e besimit ose rruga e mosbesimit. Që d o të thotë arritja te përfundimi i mirë ose i keq. Duhet patur parasysh ndryshimi mes tyre se arritja në një përfundim të mirë lidhet esaleten me vullnetin e Allahut të vërtetë, ndërsa përfundimi i keq dhe i dhimbshëm arrihet me vullnetin tetebuijji.

Vetë ky dallim bën që të merret ana pozitive në krijim dhe zbatim të legjislacioneve. Që do të thotë: Të krijohet njeriu në formën që veprat e mira të ndikojnë më thellë në krijimin e

1. Shih, "*Kitabu et teuhijd*", vëll. 11.

personalitetit të tij dhe të ngarkohet legjitimish me detyra të thjeshta dhe të lehta, që njeriu të mos ketë nevojë për detyra të vështira dhe të rënda në rrugën e realizimit të lumturisë së tij dhe të shpëtimit nga ndëshkimi i përjetshëm.[2]

Gjithashtu, në pozitën e shpërblimit dhe të ndëshkimit, të anojë ana e shpërblimit dhe mëshira e Allahut të jetë parësore ndaj zemërimit të Tij.[3] Kjo parësi dhe ky anim i mëshirës kristalizohet në çështjet, ku disa prej të cilave do t'i përmedim këtu:

Shumëfishimi i shpërblimeve

Veçoria e parë me të cilën Allahu i ka dalluar ata të cilët kërkojnë rrugën e lumturisë në pozitën e shpërblimit është se Ai nuk i shpërblen ata barabartë me shpërblimin që meritojnë nga kryerja e veprave të tyre, por ua shton shpërblimin.

Këtë të vërtetë e ka theksuar qartësisht Kur'ani Fisnik në shumë e shumë ajete. Ndër to përmendim ajetin 89 të suren "El Neml": **"Ata që kanë bërë vepra të mira, do të kenë shpërblim më të mirë..."**

Në ajetin 23 të sures "El Shura" Allahu i Madhëruar thotë: "**Atij që bën vepër të mirë, Ne do t'ia shtojmë shpërblimin."**

Në ajetin 26 të sures "Junus" Allahu i Madhëruar thotë: **Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër...!"**

Në ajetin 40 të sures "El Nisa" Allahu i Madhëruar thotë: **"Vërtet, Allahu nuk dëmton askënd asnjë grimë, por, nëse** (dikush) **bën mirësi, Allahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërblim të madh. »**

Në ajetin 160 të sures "El En'am" Allahu i Madhëruar thotë: **"Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t'i bëhet kurrfarë padrejtësie."**

2. Sure "El Bekare", ajeti 185, sure "El Haxh", ajeti 78.
3. Mëshira e Tij është më parësore se zemërimi i Tij.

Falja e gabimeve të vogla

Veçoria tjetër është se besimtarët nëqoftëse u largohen gjynaheve të mëdhaja Allahu i Madhëruar ua fal gjynahet e vogla dhe ja u fshin gjurmët atyre.

Në ajetin 31 të sures "El Nisa" Allahu i Madhëruar thotë: **"Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t'jua falim gabimet tuaja të vogla dhe do t'ju shpiem në një vend të nderuar."**

Është e qartë se falja e gjynaheve të vogla për ata besimtarë nuk kushtëzohet me pendim, sepse pendimi është i nevojshëm edhe për faljen gjynaheve të mëdhaja.

Përfitimi nga veprat e të tjerëve

Një tjetër veçori që Allahu i Madhëruar u ka dhënë besimtarëve është se: Allahu i Madhëruar e pranon istigfarin (kërkimin e faljes) së melekëve dhe të robëve të zgjedhur punëmirë për besimtarët[4] dhe i përgjigjet gjithashtu lutjes së besimtarëve që bëjnë për vetat e tyre dhe për faljen e besimtarëve të tjerë. Gjithashtu, ia dërgon shpërblimin e veprave që një të tjerët ia dhurojnë një besimtari.

Këto përmbajtje janë përmendur në shumë ajete dhe transmetime. Por meqenëse kjo temë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen e ndërmjetësimit, do ta studiojmë atje më gjerësisht. Në këtë leksion do të mjaftohemi vetëm me përmendjen kalimtare të saj.

4. Sure "Gafir", ajeti 7, sure "Al Imran", ajeti159, surer "El Nisa", ajeti 64, sure "El Mumtehine", ajeti 12, sure "Ibrahim", ajeti 41.

Pyetje:

1. Cili është sekreti i përparësisë së mëshirës hyjnore?

2. Sqaro qartësisht këtë përparësi në krijim dhe legjislacion.

3. Shpjego të vërtetat e kësaj përparësie në shpërblimin dhe ndëshkimin e njeriut.

Leksioni i pesëdhjetëenëntë

NDËRMJETËSIMI

Hyrje

Prej veçorive me të cilat Allahu i Madhëruar i ka dalluar besimtarët është: Në rast se besimtari e ruan besimin e tij deri në vdekje dhe nuk kryen gjynahe të cilat ia largojnë atij mbarësinë, ose e çojnë në një përfundim të keq apo ia shtojnë dyshimet dhe mëdyshjen; thënë në një fjali: (nëse largohet nga kjo botë dhe ai është besimtar), atëherë i tillë besimtar nuk do të përballet me ndëshkimin e përjetshëm dhe do t'i falen gjynahet e vogla për shkak të largimit nga gjynahet e mëdhaja.

Gjithashtu, atij do t'i falen gjynahet e mëdha, nëqoftëse pendohet me pendim të pranueshëm dhe të plotë. Nëse nuk e bën një pendim të tillë atëherë do të përballet me vështirësitë dhe dhimbjet e dynjasë, do të përjetojë ndëshkimin e Barzahut si dhe në qëndrimet e para të Ringjalljes dhe të Kiametit do t'i paraqiten të gjitha gabimet dhe gjynahet e tij. Nëse nuk pastrohet plotësisht nëpërmjet kësaj nga balta e gjynaheve dhe gabimeve të tij, atëherë është ndërmjetësimi ai që do të luajë rolin e tij në shpëtimin e njeriut nga ndëshkimi i Xhehenemit.

Ndërmjetësimi është nga dukuritë më të mëdha e më gjithëpërfshirëse të mëshirës hyjnore. E posaçme për evlijatë e Allahut, veçanërisht për Profetin e nderuar dhe Ehli Bejtin e tij të pastër e të dlirë (paqja e Allahu qoftë mbi ta!).[1]

Bazuar në shumë transmetime, pozita e lartë dhe e nderuar[2], e cila i është premtuar Profetit Fisnik (paqja dhe bekiet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në

1. Biharu el Enuar, vëll. 8, fq. 37-40.
2. Sure "El Isra", ajeti 79.

Kur'anin Fisnik, është pozita e ndërmjetësimit. Në ajetin fisnik thuhet: **"e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur."**[3]

Kjo tregon për faljen hyjnore e cila përfshin ata të cilët e meritojnë dhe që arrihet me ndërmjetësinë e Profetit paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Nga këtu, shpresa më e madhe dhe shpëtimi i fundit për besimtarët gjynahqarë është ndërmjetësimi. Por në të njëjtën kohë duhet që ata të mos jenë të sigurtë nga dënimi i Allahut.

Të jenë plotësisht të kujdesshëm me qëllim që të mos veprojnë ato vepra që i çojnë në përfundim të keq, në zveshjen e besimit në çastin e daljes së shpirtit dhe të vdekjes. Ata nuk duhet t'i kenë zemrat e tyre shumë të lidhura me çështjet e kësaj dynjaje deri në atë gradë sa të të jenë të zemëruar ndaj Allahut sepse mendojnë që Allahu i Madhëruar nëpërmjet vdekjes po i ndan nga gjërat që ata duan, mallëngjehen dhe janë të lidhur fort pas tyre.

Kuptimi i ndërmjetësimit

Termi (*shefaatu*), ndërmjetësim e ka prejardhjen nga fjala (*shefa*) që do të thotë çift. Në përdorimet tradicionale do të thotë që një person i respektuar kërkon diçka nga një person i madh që ta falë dhe mos ta ndëshkojë kriminelin, ose kërkon t'ua shtojë shpërblimin disa punonjësve dhe shërbyesëve. Ndoshta, shkaku i përdorimit të termit ndërmjetësim (*shefaatu*) në këto çështje: ky krimineli nuk e meriton faljen, si dhe punëtori dhe shërbyesi nuk e meritojnë shtimin e shpërblimit por nëpërmjet kërkesës së ndërmjetësuesit realizohet.

Në mesin e njerëzve është e njohur personi e pranon ndërmjetësimin e ndërmjetësit për shkak të frikës se nëse nuk e pranon ndërmjetësinë e tij atëherë do të ndihet keq dhe do të lëndohet ndërmjetësuesi. Në këtë rast ai do të ndalohet nga kënaqësia e shoqërimit të tij apo e shërbimit të tij ose

3. Sure "El Duha", ajeti 5.

mospranimi i ndërmjetësimit të tij mund të deri aty sa të preket nga disa dëme dhe dëmtime nga ana e ndërmjetësuesit.

Duhet theksuar se idhujtarët të cilët besonin dhe i përshkruan Krijuesit të gjithësisë disa cilësi njerëzore, ndër to nevoja për shoqëri, për zbavitje dhe për të jetuar me bashkëshorte, nevoja për ndihmës dhe bashkëpunëtorë në punën e tyre, frika ndaj bashkëpunëtorëve dhe ortakëve, e të ngjashme me to, për t'i kërkuar falje krijuesit të tyre të madh që t'i falë, apo të jetë i butë ndaj tyre ose për t'i shpëtuar zemërimit të tij, ata ndërmjetësonin tek ai zota të supozuar, ose i frikësoheshin adhurimit të engjujve dhe xhindëve, ose u nënshtroheshin idhujve dhe thoshin: **"...Këta janë ndërmjetësit tanë te Allahu.."!**[4]

Gjithashtu, në një ajet tjetër thuhet: **"...Ne i adhurojmë ato vetëm që të na afrojnë tek Allahu..."**[5]

Për besimet e kota e pagane në kohën e injorancës, Kur'ani Fisnik thotë: **"...nuk do të kenë as mbrojtës, as ndihmës tjetër përveç Tij…"**[6]

Mirëpo duhet përforcuar çështja se mohimi i atyre ndërmjetësve apo mohimi i ndërmjetësisë, nuk do të thotë mohim i plotë i ndërmjetësimit. Në vetë Kur'anin Fisnik ka ajete që tregojnë për konstatimin e ndërmjetësimit (me lejen e All-llahut). Në to përmenden kushtet e ndërmjetësuesve dhe atij që do të ndërmjetësohet për të.

Është e nevojshme të dimë se pranimi i ndërmjetësisë nga ana e Allahut për ndërmjetsit e lejuar nga Ai, nuk është për shkak të frikës apo ndonjë nevoje që Allahu ka për ta, por ndërmjetësimi është rugë të cilën Allahu e ka hapur për të gjithë ata të cilët nuk zotërojnë as gradën më të ulët dhe më të vogël të meritimit të mëshirës së përjetshme. Për ndërmjetësimi janë caktuar disa kushte dhe rregulla të posaçme.

4. Sure "Junus", ajeti 18,. Shih gjithashtu: sure "Rrum", ajeti13, sure "El En'am", ajeti 94, sure "El Zumer", ajeti 43.
5. Sure "El Zumer", ajeti 3.
6. Sure "El En'am", ajeti 51, sure "El En'am", ajeti 70, sure "El Sexhde", ajeti 4, sure "El Zumer", ajeti 44.

Në realitet dallimi mes ndërmjetësimit të vërtetë dhe ndërmjetësimit të gabuar është dallimi mes besimit në sundim e administrim me lejen e All-llahut dhe sundimit dhe administrimit të pavarur. Këtë temë e cekëm në pjesën e teuhidit.[7]

Nganjëherë termi ***ndërmjetësim*** përdoret në kuptim më të gjerë se kaq për të përfshirë shfaqjen e çdo ndikimi të mirë te njeriun nëpërmjet një tjetri siç është ndërmjetësimi i prindërve për fëmijët e tyre dhe e kundërta e kësaj, ndërmjetësimi i mësuesve dhe i edukuesve për nxënësit e tyre, deri edhe muezini (thirrësi i ezanit) për namazfalësit të cilët e kujtojnë namazin kur dëgjojnë ezanin dhe shkojnë në xhamia. Në të vërtetë ky ndikim i mirë që gjendet në dynja dhe ndikon te të tjerët, po ky do të shfaqet në Ditën e Gjykimit në formën e ndërmjetësimit dhe ndihmës.

Vërejtja tjetër: Kërkimi i faljes në këtë dynja për ata të cilët kryejnë gjynahe, gjithashtu, është një lloj ndërmjetësimi. Edhe duaja për të tjerët kur i kërkohet All-llahut që t'ia plotësojë nevojat atyre, në të vërtet konsiderohet si lloj ndërmjetësimi tek Allahu sepse e gjithë kjo është ndërmjetësim tek Allahu i Madhëruar për ta mirësuar një njeri ose për t'ia larguar atij të keqen.

Kushtet e ndërmjetësimit

Ashtu si e theksuam më sipër kushti kryesor i ndërmjetësisë, ose pranimi i ndërmjetësisë për dikë është: Leja e Allahut ashtu si është përmendur në ajetin 255 të sures "El Bekare": **"...Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij...?"**

Në ajetin 3 të sures "Junus": **"…S'ka ndërmjetës tek Ai, përveçse me lejen e Tij…"**

Gjithashtu në ajetin 109 të sures "Taha" thuhet: **"Atë ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç**

7. Kapitulli i njehësimit, leksioni i gjashtëmbëdhjetë.

ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala."

Në ajetin 23 të sures "Sebe" Allahu i Madhëruar thotë: **"Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai jep leje..."**

Në ajetet e përmendura përgjithësisht vërtetohet leja e Allahut. Porse nga ato ajetet nuk flitet për veçoritë dhe karakteristikat e atyre që u jepet leja për ndërmjetësim. Mirëpo, në disa ajete të tjera mund të dallohen më qartë kushtet që duhet të plotësojnë të dyja palët: Ndërmjetësi dhe ai që do të ndërmjetësjë. Ndër këto ajete përmendim ajetin 86 i sures "El Zuhruf" që thotë: "**Ata që u adhuruan në vend të Allahut, nuk do të mund të ndërmjetësojnë për askënd, përveç atyre që dëshmuan për të Vërtetën dhe e dinë mirë** (se s'ka Zot tjetër të vërtetë veç Allahut)."

Ka mundësi që qëllimi te thënia (kush dëshmon të vërtetën) të jetë dëshmitarë të veprave, të cilët me dijen që ju ka dhënë Allahu, i dinë veprat e robëve dhe qëllimet e tyre.

Ata mund të dëshmojnë për vlerën dhe mënyrën e e kryerjes së veprave të tyre. Gjithashtu, në përshtatje të gjykimit dhe temës mund të thuhet se edhe ndërmjetësit duhet të kenë dije të tillë ku mund të përcaktojnë ata presona që e meritojnë ndërmjetësimin. Vërtet, këto dy kushte gjenden te të pamëkatëshmit (paqja qoftë mbi ta!)

Në anën tjetër, nga disa ajete përfitohet se është e nevojshme që ata të cilët do të ndërmjetësohen, All-llahu i Madhëruar të jetë i kënaqur me ta. Ajeti 28 në suren "El Enbija" thotë: **"...ndërsa ata ndërmje-tësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur..."**

Në ajetin 26 të sures "El Nexhm" thuhet: **"Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi, veçse pasi të japë leje Allahu, për kë të dojë e të pëlqejë Vetë!"**

Është më se e qartë se qëllimi i të qënit i kënaqur Allahu nga ata të cilët do të ndërmjetësohen nuk është që veprat e tyre të jenë të gjitha të kënaqshme përndryshe nuk do të kishin

nevojë për ndërmjetësim, por qëllimi është që vetë personi të jetë i kënaqur me fenë dhe besimin e tij siç e shpjegojnë transmetimet këtë kuptim.

Nga ana tjetër, disa ajete përmendin cilësitë e atyre që nuk i përfshin ndërmjetësimi siç thuhet në ajetin 100 të sures "El Shuara" ku me gojën e idhujtarëve thuhet **"Tashmë ne nuk kemi asnjë ndërmjetësues** (tek Allahu)."

Në suren "El Mudethir", nga ajeti 40 deri në ajetin 48 tregohet se kur pyeten kriminelët për shkakun e futjes në zjarr ata përmendin disa si vepra të cilat i çuan ata në zjarr si: lënia e namazit[8], nuk kanë ushqyer të varfrit, kanë përgënjeshtruar Ditën e Gjykimit. Më pas në Kur'anin Fisnik thuhet: **"Atyre nuk ju vlen ndërmjetësimi i ndërmjetësuesëve"**.

Nga këto ajete gjithashtu kuptohet se idhujtarët dhe mohuesit e Kiametit, të cilët nuk e adhurojnë Allahun, nuk i ndihmojnë të varfrit dhe nuk i janë përbajtur parimeve të vërteta për ta nuk do të ndërmjetësohet asnjëherë. Duhet theksuar se kërkimi i faljes (istigfari) i Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në dynja konsiderohet një lloj ndërmjetësimi, për ata të cilët tregohen kryelartë dhe i ndalojnë të tjerët nga kërkimi i istigfarit dhe ndërmjetësimit të profetit, nuk pranohet fafja e tij.[9] Gjithashtu, rezulton se mohuesit e ndërmjetësimit nuk përfshihen në ndërmjetësim. Kjo është përcjellë në shumë transmetime.[10]

Konkluzioni: Ndërmjetësi, në shtesë të lejes së Allahut për të ndërmjetësuar, duhet të që të mos jetë prej atyre që kryejnë gjynahe dhe të jetë i aftë që të vlerësojë shkallët e përuljes dhe të kundërshtimit te të tjerët. Ky ndërmjetës në sajë të asaj që zotëron do të ringjallet me dëshmorët dhe të

8. Ka thënë Imam Sadik në çastet e fundit të jetës të tij fisnike: "*Shefatin tonë nuk e meriton ai që lë namazin.*" Biharul Enuar, vëll. 4, fq. 2.

9. Sure "El Munafikun", ajetet 5-6.

10. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "*Kush nuk beson tek ndërmjetësimi im, Allahu mos ia dhëntë ndërmjetësimin tim.*" Biharul Enuar, vëll. 8, fq. 58 dhe 84.

sinqertët.[11] Në anën tjetër duhet thënë se: Kush meriton ndërmjetësinë e tij në shtesë të lejes së Allahut, duhet të besojë sinqerisht në Allahun, në Profetët nëë Ditën e Gjykimit dhe të besojë gjithshka që i ka zbritur Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ndër to të besojë se vetë ndërmjetësimi që është i vërtetë, si dhe duhet të jetë i qëndrueshëm në besim deri në fund të jetës së tij.

Pyetje:

1. Shpjego kuptimin e ndërmjetësimit dhe vendet e përdorimit të saj.

2. Trego dallimin ndërmjet ndërmjetësisë së vërtetë dhe ndërmjetësisë së gabuar idhujtare.

3. Sqaro kriteret e ndërmjetësuesit.

4. Trego kushtet e atij që do të ndërmjetësohet.

11. **Ata që besojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij, pikërisht ata janë njerëzit e sinqertë dhe dëshmorë te Zoti i tyre…**" (Sure "Hadijd", ajeti 19)

Leksioni i gjashtëdhjetë

KEQKUPTIMIET MBI NDËRMJETËSIMIN DHE PËRGJIGJET E TYRE

Janë hedhur disa dyshime mbi ndërmjetësimin. Në këtë leksion do të paraqesim më të rëndësishmet e tyre dhe do t'u përgjigjemi:

1. Keqkuptimi i parë: Janë disa ajete kur'anore të cilat tregojnë se në Ditën e Gjykimit nuk do të pranohet ndërmjetësimi i askujt. Ndër to përmendim ajetin (48) të sures El Bekare i cili thotë: **"Dhe ruajuni një ditë kur askush askujt nuk do të mund t'i kryejë asgjë, kur nuk pranohet për të** (jobesimtarin) **ndonjë ndërmjetësim dhe nuk pranohet për të kompesim, e as që do të ndihmohet ata** (fajtorët)".

Përgjigja: Shembulli i këtyre ajeteve, të cilat janë përcjellë në pozitën e mohimit të ndërmjetësimit, nuk është i saktë dhe nuk mundet që t'i nënshtrohet një rregulli ose një formule të saktë tek e cila mund të besojnë disa njerëz. Duhet shtuar këtu që këto ajete janë përgjithësuese. Veçohen ato ajete të cilat e pranojnë ndërmjetësimin me lejen e Allahut dhe i nënshtrohen rregullave të caktuara. Këtë e shpjeguam edhe në leksionin e kaluar.

2. Keqkuptimi i dytë: Është e nevojshme që ndërmjetësuesit me ndërmjetësimin e tyre të ndikojnë tek Allahu i Madhëruar. Që do të thotë: ndërmjetësimi i tyre të jetë i pranueshëm dhe të falen gjynahet. Falja e tyre është një vepër Hyjnore.

Përgjigja: Pranimi i ndërmjetësimit nuk do të thotë nënshtrim ndaj ndikimit, sikurse pranimi i pendimit dhe përgjigja ndaj lutjes nuk do të thotë nënshtrim. Në të gjitha rastet veprat e adhurimit bëjnë të detyrueshme pranimin e mëshirës

Hyjnore. Në terminologji përdoret si një kusht që pranohet dhe jo kusht që veprohet.

3. Keqkuptimi i tretë: Është e nevojshme që në këtë ndërmjetësim të jenë ndërmjetësuesit më të mëshirshëm se Allahu i Madhëruar. E gjitha kjo bazuar në atë se po të mos jetë ndërmjetësimi i tyre ata do të do të ndëshkoheshin pak ose do të dënoheshin përjetësisht.

Përgjigja: Mëshira e ndërmjetësuesve dhe keqardhja e tyre e ka burimin tek mëshira e pakufishme e Allahut të Madhëruar. Thënë ndryshe, ndërmjetësimi është një mënyrë dhe rrugë të cilën e ka dhënë vetë Allahu i Madhëruar për të falur ata që bëjnë gjynahe. Në të vërtetë ajo konsiderohet nga gradat më të larta të mëshirës Hyjnore e cila shfaqet dhe shndrin tek robërit e tij të mirë që i janë larguar gjynaheve. Ashtu si janë edhe lutja dhe pendimi mënyra dhe rrugë të tjera që i ka bërë Allahu i Madhëruar për të kaluar nevojat, ose falje për gjynahet.

4. Keqkuptimi i katërt: Në qoftë se ligji Hyjnor për ndëshkimin e gjynahqarëve tregon drejtësi, atëherë pranimi i ndërmjetësimit për ata që do të ndëshkohen është në kundërshtim me drejtësinë. Në qoftë se shpëtimi nga ndëshkimi që bëhet në sajë të ndërmjetësimit është i pranueshëm nga drejtësia atëherë ligji i ndëshkimit që ka dalë para ndërmjetësimit është një ligj që bie në kundërshtim me drejtësinë.

Përgjigja: Të gjitha ligjet Hyjnore qofshin ato për ndëshkim para ndërmjetësimit apo për të shpëtuar nga ndëshkimi pas ndërmjetësimit janë ligje që bien dakort me drejtësinë dhe urtësinë Hyjnore.

Dakortësia e këtyre dy çështjeve, pra, e drejtësisë dhe urtësisë, nuk do të thotë bashkim ndërmjet dy të kundërtave dhe kjo për shkak të ndryshimit të temave.

Sqarim rreth kësaj: Ligji për të ndëshkuar është shkaku i kryerjes së gjynaheve, pavarësisht shtysave dhe çështjeve që shtyjnë dhe obligojnë për realizimin e ndërmjetësimit dhe pranimin e tij. Ligji për të shpëtuar nga dënimi është bërë për shkak të arritjes këto çështje dhe shtysa të cilat i përmendëm

më lart. Ekzistojnë edhe teori të shumta për ndryshimin e ligjit bazuar në ndryshimin temës lidhëse me rregullat dhe përafrimet krijuese. Drejtësia e një ligji të abroguar, sa i përket kohës së tij, nuk bie ndesh me drejtësinë e ligjit abrogues në kohën mbas abrogimit. Pranimi i caktimit të sprovës para duasë apo sadekasë nuk e kundërshtojnë dakortësinë e largimit të saj apo pas sadekasë. Ligji për faljen e gjynaheve pas ndërmjetësimit gjithashtu nuk bie në kundërshtim me ligjin për ndëshkimin para se të realizohet ndërmjetësimi.

5. Keqkuptimii pestë: Allahu i Madhëruar i ka konsideruar pasuesit e shejtanit si shkaktarë për marrjen e dënimit. Sikurse është përcjellë në dy ajetet e mëposhtme të sures El Hixhr, ajeti 42-43 ku thuhet: **"Se ti ndaj robërve të Mi** (të sinqertë) **nuk ke kurrfarë force (as fizike dhe as mendore), përveç atyre të humburve që vijnë pas teje E s'ka dyshim se xhehenemi është vendpremtimi i të gjithë atyre."**

Në realitet ndëshkimi i gjynahqarëve në ahiret është prej ligjeve Hyjnore. Ne e dimë që ligjet Hyjnore nuk pranojnë ndryshime. Sikurse është përcjellë edhe në ajetin 43 të sures Fatir: **"E në ligjin e Allahut kurrë nuk do të hasësh devijim."**

Atëherë si ndryshon ky ligj Hyjnor në fushën e ndërmjetësisë?

Përgjigje: Pranimi i ndërmjetësisë mbi gjynahqarët pranohet duke u bazuar në kushte. Ligjet Hyjnorë nuk pranojnë ndryshime. Sqarojmë gjithashtu se ligjet Hyjnorë i nënshtrohen principeve dhe standarteve reale. Çdo ligj nuk e pranon ndryshimin me krijimin e kushteve ato që ekzistojnë dhe nuk ekzistojnë, por shprehjet të cilat tregojnë këto rregulla përgjithësisht nuk janë në pozitën që tregojnë dhe sqarojnë të gjitha temat dhe kushtet e tyre të ndryshme.

Pra, janë disa raste të cilat përmblidhen nga pamja e jashtme e ajeteve që lidhen me disa rregulla të ndryshme, megjithëse ajeti në të vërtetë është më i veçantë. Vërejmë se çdo ligj nuk pranon ndryshim edhe pse shihen kornizat dhe kushtet reale për temën e tyre (veçanërisht kornizat dhe kushtet që përmendëm).

Ky rregull është rregulli i ndërmjetësimit. Ai është i qëndrueshëm dhe nuk pranon ndryshime.

6. Keqkuptimi i shtatë: Premtimi i ndërmjetësimit u jep njerëzve guxim për të kryer gjynahe dhe për të devijuar nga rruga e drejtë.

Përgjigja për këtë kundërshtim shfaqet gjithashtu edhe në fushën e pranimit të pendimit, dhe faljes të gjynaheve. Gjithpërfshirja e ndërmjetësimit dhe faljes për një person kushtëzohet nga kushte që është e pamundur të arrihen nga gjynahet. Nga kushtet e përgjithshme të pranimit të ndërmjetësimit për dikë është ruajtja e besimit të ndërmjetësuesit deri në çastet e fundit të jetës. Ne e dimë që askush nuk mund të jetë i sigurtë në realizimin e këtij kushti. Në anën tjetër, kush kryen një gjynah dhe ka humbur shpresën për t'u falur dhe penduar, atë do ta kaplojë dëshpërimi.

Ky dëshpërim bën që të dobësohet motivimi i tij për t'u larguar nga të këqijat dhe e shtyn më tepër në vazhdimin e gabimeve dhe devijimeve. Rruga e edukimit të edukatorëve Hyjnorë i mban njerëzit gjithmonë në dy gjendje atë të frikës dhe shpresës. Ata nuk japin shpresë nga mëshira Hyjnore deri në atë masë që të sigurohen nga sprovat Hyjnore, sikurse nuk futin frikën e ndëshkimit Hyjnor deri në atë gradë sa të dëshpërohen dhe demoralizohen nga mëshira Hyjnore. Ne e dimë se të dyja këto gjendje konsiderohen nga të mëdhatë.

7. Keqkuptimi i shtatë: Ndikimi i ndërmjetësisë në shpëtimin nga ndëshkimi do të thotë ndikimi i veprave të të tjerëve (ndërmjetësuesëve) në lumturinë dhe shpëtimin nga vuajtjet. Ndërkohë që ajeti famëlartë **"Njeriu do të marrë vetëm atë që ka vepruar"** tregon se ajo që ka vepruar dhe është përpjekur njeriu, do t'i japë lumturinë.

Përgjigja: Përpjekja e njeriut për të arritur në qëllimin e synuar ndonjëherë bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe vazhdon deri në fund të rrugës dhe ndonjëherë tjetër bëhet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë duke shfrytëzuar shkaqet dhe ndërmjetësimet. Personi i cili përfshihet në ndërmjetësim bën përpjekje të mëdha në rrugën e realizimit të lumturisë.

E gjithë kjo për shkak të përmbushjes së kushteve të domosdoshme për realizimin e ndërmjetësimit. Në qoftë se është një realizim i mangët atëherë do të kalojë një periudhë vuajtjesh në Berzekh dhe në stacionet e ndryshme gjatë fillimit të Kijametit. Sidoqoftë ai ka i mbjellë vetë rrënjët e lumturisë në zemrën e tij dhe ai është besimi, të cilin ndonjëherë e ujit me vepra të mira që të mos thahet deri në fund të jetës së tij.

Pra lumturia përfundimtare e njeriut e ka burimin tek veprat dhe përpjekjet e tij, edhe pse ndërmjetësit kanë ndikimin e tyre në marrjen e fruteve nga kjo pemë, ashtu sikurse vërehet në dynja. Përpjekjet e të tjerëve kanë ndikimin e tyre në udhëzimin e njerëzve dhe edukimin e tyre, por ndikimi i tyre nuk do të thotë mohimi i punës personale dhe derdhja e energjive në këtë fushë.

Pyetje:

1. Me ekzistimin e ajeteve që e mohojnë ndërmjetësimin si mundemi të besojmë në realizimin e saj?

2. A obligon ndërmjetësimi ndikimin e të tjerëve tek Allahu i Madhëruar?

3. Ndërmjetësimi e bën të detyrueshme që ndërmjetësit të jenë më të mëshirshëm se Allahu i Madhëruar?

4. Sqaro marrëdhënien ndërmjet ndërmjetësisë dhe drejtësisë Hyjnore.

5. A na çon ndërmjetësimi drejt ndryshimit të rregullave Hyjnore?

6. Premtimi për ndërmjetësim a i bën më të guximshëm gjynahqarët për të vazhduar në devijimin e tyre?

7. Sqaro fjalinë e mëposhtme: *Ndërmjetësimi nuk bie në kundërshtim me personat që e kanë burimin e lumturisë nga puna dhe përpjekjet e tyre.*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

TEMA **FAQJA**

Parathënie.....**5**
Hyrje.....**15**
Leksioni i parë: Çfarë është feja?.....**18**
Leksioni i dytë: Kërkimi rreth fesë..... **25**
Leksioni i tretë: Kushti vlerësues për jetën njerëzore.....**32**
Leksioni i katërt: Mënyra e trajtimit të çështjeve bazë të vizionit kozmik.....**38**
Leksioni i pestë: Njohja e Allahut.....**45**
Leksioni i gjashtë: Rruga e lehtë për njohjen e Allahut.....**50**
Leksioni i shtatë: Vërtetimi i Ekzistentit të domosdoshëm (*Vaxhibu'l vuxhud*).....**56**
Leksioni i tetë: Cilësitë e Allahut.....**64**
Leksioni i nëntë: Cilësitë Qenësore.....**73**
Leksioni i dhjetë: Cilësitë Vepruese..... **81**
Leksioni i njëmbëdhjetë: Cilësitë e tjera Vepruese.....**88**
Leksioni i dymbëdhjetë: Studimi i faktorëve të devijim.....**95**
Leksioni i trembëdhjetë: Keqkuptime dhe zgjidhje.....**101**
Leksioni i katërmbëdhjetë: Botëkuptimi materialist.....**107**
Leksioni i pesëmbëdhjetë: Materializmi dialektik.....**113**
Leksioni i gjashtëmbëdhjetë: Njësimi i Allahut.....**121**
Leksioni i shtatëmbëdhjetë: Kuptimet e Njësimit.....**128**
Leksioni i tetëmbëdhjetë: Detyrimi dhe liria e zgjedhjes.....**135**
Leksioni i nëntëmbëdhjetë: Vendimi dhe caktimi.....**144**
Leksioni i njëzetë: Drejtësia hyjnore.....**154**

Leksioni i njëzetenjëtë: Vështrim rreth çështjeve të profetësisë.....**166**
Leksioni i njëzetedytë: Nevoja e njeritu për revelatën dhe mesazhin.....**172**
Leksioni i njëzetetretë: Keqkuptime dhe sqarime.....**179**
Leksioni i njëzetekatërt: Pagabueshmëria e profetëve.....**187**
Leksioni i njëzetepestë: Argumentet mbi pagabueshmërinë e profetëve.....**194**
Leksioni i njëzetegjashtë: Keqkuptime dhe sqarime.....**201**
Leksioni i njëzeteshtatë: Mrekullia.....**210**
Leksioni i njëzetetetë: Keqkuptime dhe sqarime.....**216**
Leksioni i njëzetenëntë: Veçoritë e profetëve.....**222**
Leksioni i tridhjetë: Njerëzit dhe profetët.....**229**
Leksioni i tridhjetëenjë: Profeti i Islamit.....**237**
Leksioni i tridhjetëedytë: Mrekullia e Kur'anit fisnik.....**243**
Leksioni i tridhjetëetretë: Ruajtja e Kur'anit nga ndryshimet.....**251**
Leksioni i tridhjetëekatërt : Islami fe universale dhe e përjetshme.**256**
Leksioni i tridhjetëepestë: Vula e profetësisë.....**263**
Leksioni i tridhjetëegjashtë: Imamati (Udhëheqësia).....**269**
Leksioni i tridhjetëeshtatë: Nevoja e pranisë së imamit.....**275**
Leksioni i tridhjetëetetë: Caktimi i imamit.....**281**
Leksioni i tridhjetëenëntë: Pagabueshmëria dhe dituria e imamit.....**287**
Leksioni i dyzet: Imam Mehdiu (Allahu ia shpejtoftë ardhjen!)..**294**
Leksioni i dyzetenjë: Rëndësia e njohjes së përfundimit.....**303**
Leksioni i dyzetedy: Marrëdhëniet e temës së Ringjalljes me shpirtin.....**310**
Leksioni dyzetetretë: Abstraksioni i shpirtit.....**315**
Leksioni i dyzetekatërt: Vërtetimi i Ringjalljes.....**321**
Leksioni i dyzetepestë: Ringjallja në Kur'anin fisnik.....**327**

Leksioni i dyzetegjashtë: Përgjigjet e Kur'anit për dyshuesit e Ringjalljes.....**334**
Leksioni i dyzeteshtatë: Premtimi i Allahut rreth Kiametit...**338**
Leksioni i dyzetetetë: Karakteristikat e Botës Tjetër.....**343**
Leksioni i dyzetenëntë: Nga vdekja tek Ringjallja.....**349**
Leksioni i pesëdhjetë: Paraqitja e Kiametit në Kur'an.....**355**
Leksioni i pesëdhjetëenjë: Krahasimi mes kësaj jete dhe Jetës Tjetër.....**367**
Leksioni i pesëdhjetëedy: Marrëdhëniet e dynjasë me ahiretin.....**373**
Leksioni i pesëdhjetëetretë: Lloji i marrëdhënieve mes dynjasë dheahiretit.....**380**
Leksioni i pesëdhjetëekatërt: Roli i besimit dhe i mohimit në lumturinë dhe vuajtjeën e përjetshme.....**384**
Leksioni i pesëdhjetëepestë: Marrëdhënia e ndërsjelltë mes besimit dhe punës.....**391**
Leksioni i pesëdhjetëegjashtë: Vëzhgime të rëndësishme.....**396**
Leksioni i pesëdhjetëeshtatë: Humbja dhe falja e gjynaheve.**402**
Leksioni i pesëdhjetëetetë: Veçoritë e besimtarëve.....**407**
Leksioni i pesëdhjetëeenëntë: Ndërmjetësimi.....**411**
Leksioni i gjashtedhjetë: Keqkuptime dhe sqarime.....**418**